



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS

Gjykata Supreme

Vrhovni Sud - Supreme Court

VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS



Prishtinë, 2024



VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS

Prishtinë 2024

Nëntor 2024

Shtypur në Prishtinë

Hartimi dhe botimi i materialit udhëzues: “Vendime të Përzgjedhura të Gjykatës Supreme” është mundësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, ndërkaq shtypja dhe printimi nga Projekti: Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI) Chemonics.

Aspektin teknik dhe përmbledhës të këtij botimi e realizuan gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës:

Afrim SHALA, Rasim RASIMI, Mejreme MEMAJ,

Agim MALIQI, Valdete DAKA, Beshir ISLAMI

Muhamet REXHA, Rrustem THAQI, Zenel LEKU

dhe Fatmir GECA – Këshilltar në Kabinetin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrja.....7

VENDIME TË PËRZGJEDHURA NGA LËMIA PENALE

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.611/2023 i datës 06.12.2023.....9

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.614/2023 i datës 16.01.2024.....15

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.628/2023 i datës 21.12.2023.....23

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.688/2023 i datës 25.03.2024.....30

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.64/2024 i datës 17.04.2024.....52

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.113/2024 i datës 23.04.2024.....64

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.303/2024 i datës 12.06.2024.....76

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PA-II.Nr.1/2023 i datës 19.10.2023.....84

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.613/2023 i datës 22.12.2023.....97

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.618/2023 i datës 06.12.2023.....105

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.690/2023 i datës 10.01.2023.....112

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.40/2024 i datës 06.02.2024.....116

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.73/2024 i datës 04.04.2024.....123

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.194/2024 i datës 02.04.2024.....129

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.250/2024 i datës 15.05.2024.....132

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.384/2023 i datës 22.12.2023.....137

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.404/2023 i datës 05.10.2023.....150

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.443/2023 i datës 31.10.2023.....154

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.504/2023 i datës 29.11.2023.....158

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.562/2023 i datës 25.03.2024.....163

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.591/2023 i datës 22.12.2023.....172

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.157/2024 i datës 16.04.2024.....	177
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.193/2024 i datës 29.05.2024.....	182
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.281/2024 i datës 11.06.2024.....	186
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.417/2023 i datës 29.08.2023.....	192
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.428/2023 i datës 31.08.2023.....	197
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.468/2023 i datës 31.10.2023.....	203
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.481/2023 i datës 25.09.2023.....	215
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.659/2023 i datës 27.12.2023.....	219
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.16/2024 i datës 16.01.2024.....	222
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.37/2024 i datës 30.01.2024.....	227
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.57/2024 i datës 06.02.2024.....	231
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.173/2024 i datës 26.03.2024.....	234
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.179/2024 i datës 26.03.2024.....	238
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.253/2024 i datës 18.06.2024.....	242
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.265/2024 i datës 15.05.2024.....	252
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.271/2024, i datës 29.05.2024.....	255
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.277/2024 i datës 15.05.2024.....	259
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.333/2024, i datës 12.06.2024.....	266
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.345/2024 i datës 18.06.2024.....	270
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.402/2023 i datës 26.10.2023.....	275
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.425/2023 i datës 21.09.2023.....	280
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.578/2023 i datës 11.01.2024.....	285
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.95/2024 i datës 28.02.2024.....	288
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.135/2024 i datës 30.05.2024.....	292

Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.366/2024 i datës 14.06.2024.....	298
Aktgjykimi i kolegjit penal të GJSK - PML.Nr.405/2024 i datës 23.07.2024.....	301

PJESA E DYTË

VENDIME TË PËRZGJEDHURA NGA LËMIA CIVILE

Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr. 505/2021, i datës 07.05.2024.....	305
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - E.Rev.nr.26/2023, i datës 21.11.2023.....	312
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - CN.nr.38/2023, i datës 13.12.2023.....	326
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.211/2023, i datës 07.06.2023.....	329
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.390/2023, i datës 01.11.2023.....	336
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.543/2023, i datës 16.01.2024.....	344
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.89/2024, i datës 07.03.2024.....	351
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.222/2024, i datës 23.05.2024.....	358
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.226/2024, i datës 30.05.2024.....	363
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.282/2024, i datës 12.07.2024.....	373
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.303/2024, i datës 17.07.2024.....	382
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.337/2023, i datës 20.09.2023.....	388
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.381/2023 i datës 27.09.2023.....	392
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.506/2023, i datës 15.12.2023.....	398
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.E.nr.16/2024, i datës 24.04.2024.....	404
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.8/2024, i datës 31.01.2024.....	410
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.97/2024, i datës 12.03.2024.....	415
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.139/2024, i datës 04.04.2024.....	420
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.169/2024, i datës 18.04.2024.....	425

Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.304/2024, i datës 16.07.2024.....	429
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.316/2024, i datës 29.07.2024.....	433
Aktvendim i kolegjit Civil të GJSK - Rev.nr.339/23, i datës 29.11.2023.....	438
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.448/23, i datës 06.11.2023.....	448
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.467/23, i datës 22.01.2024.....	453
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.508/23, i datës 17.01.2024.....	462
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.544/23, i datës 26.12.2023.....	472
Aktvendim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.564/23, i datës 11.03.2024.....	480
Aktvendim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr. 5/24, i datës 07.02.2024.....	490
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.21/24, i datës 08.02.2024.....	500
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.92/24, i datës 21.05.2024.....	510
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK - Rev.nr.94/24, i datës 21.05.2024.....	519
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK Rev.nr.290/2023, datë 22.11.2023.....	531
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK Rev.nr. 383/2023, i datës 26.10.2023.....	537
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK Rev.nr. 459/2019 i datës 05.12.2023.....	542
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK Rev.nr. 511/2019 i datës 25.01.2024.....	547
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK Rev.nr.352/2022, datë 22.03.2023.....	553
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK Rev.nr.23/2024, datë 22.07.2024.....	559
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK Rev.nr.56/2024, datë 18.07.2024.....	569
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK Rev.nr.248/2023 datë 06.11.2023.....	584
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK Rev.nr.251/2024 datë 03.07.2024.....	591
Aktgjykim i kolegjit civil të GJSK Rev.nr.262/2023 datë 27.11.2023.....	600

Hyrje

Gjykata Supreme, në mbështje të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe legjislacionin në fuqi, është autoriteti më i lartë gjyqësor i cili ka juridiksion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Si e tillë, luan një rol kyç në sistemin gjyqësor, duke unifikuar praktikën gjyqësore përmes vendimeve të saj dhe duke siguruar një interpretim dhe zbatim konsistent të ligjit në të gjitha nivelet e gjyqësorit.

Në përmbushjen e misionit të saj, Gjykata Supreme synon të garantojë një proces të drejtë dhe të rregullt gjyqësor, si një prej shtyllave të rëndësishme mbi të cilat bazohet mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të garantuara nga Kushtetuta e vendit dhe instrumentet ndërkombëtare.

Për shkak se shumë vendime gjyqësore janë përfshirë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural, të njëjtat kanë rezultuar në prishje ose kthimin e tyre në rigjykim. Andaj, Gjykata Supreme është angazhuar që nga viti 2023, në botimin e Përmbledhjes së Vendimeve të Përzgjedhura, nga lëmia penale dhe ajo civile.

Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është ofrimi i zgjidhjeve për çështjet dhe dilemat e ndryshme me të cilat ballafaqohen gjyqtarët e instancave më të ulëta. Njëkohësisht edhe udhëzimi i tyre, përmes vlerësimit të ofruar nga kolegjet e Gjykatës Supreme lidhur me rrethanat e çështjeve përkatëse, se si të veprohet në situatat e ngjashme duke respektuar dhe aplikuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore dhe njëherit praktikat dhe standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Realizimi i këtij botimi është mundësuar nga Akademia e Drejtësisë, e cila në përputhje me mandatin e saj mbështet zhvillimin profesional të gjyqtarëve. Ky botim do të publikohet në faqet zyrtare të Akademisë së Drejtësisë dhe të Gjykatës Supreme, duke mundësuar qasje të lehtë për gjithë profesionistët ligjor.

Fejzullah Rexhepi

Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës

Pjesa e Parë

VENDIME TË PËRZGJEDHURA NGA LËMIA

PENALE

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.611/2023, i datës 06.12.2023

”Thika si armë e ftohtë në kuptim të elementeve të figurës së veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.94/2023, të datës 05.07.2023, i pandehuri R.B., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së dhe ndaj tij është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej treqind (300) euro, të cilin dënim, do ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.
2. Nëse i pandehuri R.B. nuk mundet ose nuk dëshiron që ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që njëzet (20) euro e dënimit me gjobë do të barazohet me një (1) ditë burgim.
3. Janë konfiskuar thika me gjatësi tehu prej 16 cm. dhe kaçavida e gjatësisë së njëjtë dhe të njëjtat pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë do të shkatërrohen nga organi kompetent.
4. Është detyruar i pandehuri R.B. që të paguajë në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumë prej tridhjetë (30) euro; për fondin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) euro, si dhe shpenzimet e procedurës, sipas llogarisë përfundimtare.
5. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.498/2023, të datës 09.10.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të pandehurit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
6. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësja e të pandehurit R.B., avokatja L.K., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës që këto aktgjykime të ndryshohen apo të njëjtat të anulohen, ashtu që kjo çështje t’i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.
7. Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.353/2023, e datës 23.11.2023 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit R.B., të refuzohet si e pabazuar.
8. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:
- kërkesa është e bazuar.
9. Mbrojtësja e të pandehurit R.B., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me shkelje të ligjit penal, të cilat shkelje i referohen si përgjegjësisë penale të të pandehurit, ashtu edhe rrethanave që janë marrë parasysh me rastin e shqiptimit të dënimit.
10. Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura të mbrojtëses së të pandehurit R.B., Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të bazuara.
11. Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje të ligjit penal nga neni 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së në dëm të të pandehurit R.B., ndërsa kjo shkelje nuk është evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.
12. Nga aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë shihet se i pandehuri R.B., ishte akuzuar dhe shpallur fajtor për shkak të veprës penale “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së që ndërlidhet me posedimin e një thike me gjatësi tehu prej 16 cm. dhe një kaçavidë të një madhësie po aq sa thika, në kohën, datën, vendin dhe mënyrën e përshtuar si më lart.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se në këtë rast, veprimet kryerëse të të pandehurit R.B., të përshkruara në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk përbëjnë veprë penale, për shkak se si thika e lartcekur, ashtu edhe kaçavida nuk e posedojnë atributin e “armës së ftohtë” që është element themelor i figurës së veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, për arsye që do të paraqiten në vijim.
2. Kështu, në nenin 366 të KPRK-së është parashikuar vepra penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, ku në paragrafin 1. të këtij neni është parashikuar se këtë formë themelore të kësaj veprë penale e kryen “Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet”.
3. Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në: mbajtjen në pronësi, kontrollon ose posedim të armëve dhe për t’u konsideruar se është kryer kjo formë e kësaj veprë penale, duhet që veprimet e kryerjes të jenë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla.
4. Siç shihet, kjo dispozitë ligjore është e karakterit udhëzues, apo ndryshe e ashtuquajtur “dispozitë blankete”, pasi në lidhje me veprimet e kryerjes së kësaj veprë penale udhëzon aplikimin e ligjit të zbatueshëm për armët, e që në këtë rast, ligj i zbatueshëm për armët është Ligji nr. 05/L -022 për Armët i datës 23.07.2015.
5. Duke u bazuar në nenin 2, paragrafi 1.24. të këtij Ligji, “Armë e ftohtë” konsiderohet çdo mjet që mund të përdoret për sulm apo për shkaktim të lëndimeve trupore, duke përdorë forcë fizike nga sulmuesi në rastet kur ato mbahen, në tubime publike, në objekte publike apo në vende të ngjashme. Gjithashtu, në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se “Klasifikimi i tyre (armëve të ftohta) përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga organi kompetent”.

6. Andaj, bazuar në këtë dispozitë ligjore, është e nevojshme që zbatohen edhe aktet nënligjore të nxjerra nga organi kompetent me të cilin është përcaktuar klasifikimi i armëve të ftohta.
7. Në këtë drejtim, akt i tillë me të cilin është bërë klasifikimi i armëve të ftohta është Udhëzimi Administrativ Nr.14/2010 për Armët e Ftohta i Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 12.05.2010.
8. Në nenin 2, paragrafi 1.2. të këtij Udhëzimi është parashikuar se *“Arma Melee nënkupton armën e ftohtë të dizajnuar kryesisht për të mos përfshirë predhë apo të mos përdoret si e tillë, si dhe nga ana tjetër që përdoret për të therur apo qëlluar cakun në gjatësi të shtrirjes së dorës”*, kurse në paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se *“Lista specifike për nga nën-kategoritë armëve të ftohta gjendet në: Shtojcën 1 (Armët qitëse) dhe Shtojcën 2 (Armët Melee)”*.
9. Në Shtojcën 2. të këtij Udhëzimi janë përcaktuar Armët Melee, të cilat janë klasifikuar në tre (3) grupe dhe atë: 1) Armët e mprehta; 2) Armët e topitura dhe 3) Kombinim i armëve të mprehta dhe armëve të topitura.
10. Mandej, armët e mprehta janë klasifikuar në dy (2) grupe dhe atë: 1) Thikat dhe 2) Shpatat.
11. Ndërsa, në vijim të kësaj Shtojce janë përcaktuar llojet e thikave të cilat janë klasifikuar dhjetë (10) grupe dhe atë në:
 - 11.1. Thika hapëse anësore, thikë fshikull (*“sëitch”*) (ose mjet tjetër i ngjashëm), që ka tehun që hapet automatikisht nga forca centrifugale ose e gravitetit ose nga shtypja e butonit, sustës ose pajisjes së brendshme ose të ngjitur në dorezën e thikës;
 - 11.2. Thika balistike që hedh tehe të ngjashme si thika të çfarëdo materiali përmes mjeteve që janë të ndryshme nga eksplozivët;
 - 11.3. Thika hapëse frontale që tërhiqet gjer në dorezë nga forca centrifugale ose e gravitetit ose nëse aplikohet shtypje në buton, sustë ose pajisje të ngjitur ose që formon pjesë të këllëfit, dorezës ose tehut të thikës.
 - 11.4. Shpuesi me shtytje, thikë shtytëse apo thumb shtytës, ose ndonjë pajisje tjetër që përbëhet nga tehet me një skaj të mprehtë ose shumë skaje të mprehta ose majë që ka

- dorezë të ngjitur tërthorazi për tehu ose maje, dhe mundëson tehun ose majën që të mbështeten për shuplake të dorës, ashtu që të mund të shkaktohet therje ose prerje përmes goditjes ose përmes shtypjes;
- 11.5. Thikë me dorezë me mbrojtëse për gishta ose ndonjë pajisje që përbëhet nga tehet me një skaj të mprehtë ose shumë skaje të mprehta e pajisur me dorezë të ndërtuar nga substanca e fortë që mund të jetë e pajisur me dorezë me kanale për gishta të dorës së shfrytëzuesit për të mbrojtur gishtat dhe për të rritur efektin e goditjes ose shtyrjes, ose që është adaptuar për aso përdorimi;
- 11.6. Thikë flutur ose ndonjë pajisje tjetër që përbëhet nga tehet me një skaj të mprehtë ose shumë skaje të mprehta, ose majë që kapet për dy doreza të ngjitura për tehu ose majë përmes kunjave të tërthortë boshtor dhe ka mundësinë e hapjes përmes forcës centrifugale ose të gravitetit;
- 11.7. Thika yll ose ndonjë pajisje tjetër që përbëhet nga një numër i pikave këndore, tehe ose maja të qitura jashtë rreth pikës së boshtit qendror dhe janë të dizajnuara për t'u rrotulluar rreth boshtit qendror gjatë fluturimit pasi që të hedhet në drejtim të caktuar;
- 11.8. Thikat qitëse të cilat thika pothuajse gjithmonë janë në një copë, në vend se thika tradicionale që e kanë të prodhuar dorezën ndaras nga brisku. Qëllimi i këtij prodhimi është krijimi i një thike të qëndrueshme me një shpërndarje të ekuilibruar të peshës. Përveç kësaj, disa thika qitëse janë me dy tehe, edhe pse skajet e thikave qitëse janë pothuajse gjithmonë të topitura (për të parandaluar thikën nga prerja e duarve flakës në disa kapje);
- 11.9. Bajonete që është thikë e përshtatur për t'u vendosur në skajin e grykës së një pushke dhe e përdorur si armë në lufta të afërme dhe
- 11.10. Thika të pazbulueshme të cilat janë thika që janë bërë nga kombinimi i materialeve të cilat nuk mund të zbulohen në mes detektorëve metali.
12. Duke u bazuar në këtë që u theksua më lart, rezulton se thikat si armë të mprehta janë të klasifikuara në dhjetë (10) grupe me karakteristikat e paraqitura më lart, ndërsa në këtë rast, thika që është konfiskuar nga i pandehuri R.B. nuk bën pjesë në asnjërën prej këtyre grupeve të thikave, andaj, edhe rrjedhimisht nuk konsiderohet as "armë e ftohtë" në kuptim të veprës penale për të cilën i njëjti ishte akuzuar dhe shpallur fajtor.

13. Nga shkresat e lëndës (në të cilat gjendet edhe thika) shihet që thika që është konfiskuar nga i pandehuri R.B. është një thikë që përdoret zakonisht në kuzhina të ndryshme për përgatitjen e ushqimit.
14. Andaj, bazuar në arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se në rastin konkret thika e lartcekur nuk konsiderohet “armë e flohtë”, kështu që mbi bazën e saj edhe veprimet kryerëse të të pandehurit R.B., të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk përbëjnë elementet e veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së.
15. Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që të aprovon kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe i ndryshojë aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, duke e liruar nga akuza të pandehurin R.B., për veprën penale për të cilën ishte akuzuar sipas aktakuzës së lartcekur të Prokurorisë Themelore në Gjilan.
16. Thika e lartcekur dhe kaçavida do t’i kthehen të pandehurin R.B., duke e pasur parasysh faktin se i njëjti është liruar nga akuza, duke i pasur për bazë arsyet paraqitura më lart.
17. Meqenëse, i pandehuri R.B. është liruar nga akuza për shkak të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, atëherë Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në nenin 453, paragrafi 1 të KPP-së ka vendosur që shpenzimet e procedurës penale të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës.
18. Nga arsyet që janë theksuar më lart dhe në bazë të nenit 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.614/2023, i datës 16.01.2024

”Vepra penale vrasja e mbetur në tentativë, si e tillë mund të ekziston edhe në rastet kur të dëmtuarit nuk i shkaktohen fare lëndime trupore, por edhe në rastet kur të dëmtuarit mund t’i jenë shkaktuar lëndime të lehta apo të rënda“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.41/2011, të datës 20.06.2023, i dënuari E.I., është shpall fajtor për shkak të veprës penale *“Vrasja”* e mbetur në tentativë, nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vjetëve, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa në dënimin e shqiptuar, të dënuarit do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak prej datës 03.05.2011 deri më datën 23.01.2012.
2. Në bazë të nenit 60, paragrafi 1 të KPK-së, është konfiskuar në mënyrë të përhershme arma automatike AK-47, me numër serik 1423812, e kalibrit 7.62x39 mm., e cila pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë do të shkatërrohet nga Policia e Kosovës.
3. Është detyruar i dënuari E.I. që të paguan shpenzimet e procedurës penale në shumë prej njëqindnjëzet (120) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzetë (20) euro dhe në emër të kompensimit të viktimave të kiritit shumë prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.
4. I dëmtuari Xh.I. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.
5. Në bazë të nenit 362, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), është refuzuar akuza për shkak të veprës penale *“Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”*, nga neni 328, paragrafi 1 të KPK-së, kurse në bazë të nenit 362, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të KPP-

së, është refuzuar akuza për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”, nga neni 328, paragrafi 2 të KPK-së.

6. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.520/2023, të datës 26.09.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
7. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë të përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur:
 - i dënuari E.I. dhe mbrojtësi i tij, avokati A.S.K., për shkak të shkeljeve të ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, duke propozuar që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta të ndryshohen, ashtu që i dënuari të shpallët fajtor për shkak të veprës penale “Lëndimi i rëndë trupor”, nga neni 154, paragrafi 1 të KPK-së ose aktgjykimet e lartcekura të anulohen dhe kjo çështje të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
8. Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.356/2023, e datës 29.11.2023 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, të refuzohet si e pabazuar.
9. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:
 - kërkesa është e pjesërisht e bazuar.
10. I dënuari E.I. dhe mbrojtësi i tij, avokati A.S.K. në kërkesën e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendojnë se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë janë të përfshira me shkelje të ligjit penal, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me arsyetimin se në

këtë rast kemi të bëjmë me vepër penale të lëndimit të rëndë trupor dhe në asnjë rrethanë nuk kemi të bëjmë me veprën penale vrasjes të mbetur në tentativë.

11. Dashja e të dënuarit E.I., ditën kritike nuk ka qenë që ta privon nga jeta të dëmtuarin Xh.I., pasi që siç e ka konstatuar edhe eksperti i balistikës, arma ka qenë funksionale dhe sikur ta dëshironte që ta privonte nga jeta të dëmtuarin, atëherë fare lehtë do ta mund ta bënte një gjë të tillë. Në fakt, i dënuari siç e ka potencuar edhe në deklaratimet e tij në të gjitha fazat e procedurës penale, ditën kritike ishte nisur me automjetin e tij për ta sjellë një mjek për nënën e tij që ishte e sëmurë dhe në momentin që ka dalë nga oborri në rrugë, e ka hasur të dëmtuarin Xh.I. dhe vëllain e tij me traktor, të cilët nuk kanë pranuar që t'ia lirojnë rrugën. Pas një konflikti verbal në mes të të dënuarit dhe të dëmtuarit, i dënuari E.I. ka marrë armën në mënyrë që ta frikësojë të dëmtuarin me bindje të thellë se kur ta sheh me armë në dorë do e lirojë rrugën, mirëpo i dëmtuari jo që nuk ia ka liru rrugën, por ka tentuar t'ia marrë armën, duke e kapur me dy duart për tytë, ku në përpjekje e sipër se cili po e zotëron armën, ka ardhur deri te shkretpja aksidentale e armës dhe plagosja e të dëmtuarit.
12. Se i dënuari E.I. nuk ka pasur për qëllim që ta privon nga jeta të dëmtuarin Xh.I., vërtetohet edhe nga ekspertiza balistike, ku shihet se është konstatuar se arma ishte funksionale dhe po ashtu nuk është tentuar shkretpja e serishme, sepse po të kishte ndodhur një gjë e tillë, atëherë do të ishte vërejtur ndonjë element apo karakteristikë e gjilpërës goditëse në kapsulën ndezëse të fishekut.
13. Gjithashtu, pretendohet se edhe arsyetimi i aktgjykimeve të instancave më të ulëta është kundërtënë dhe i paqartë, edhe për faktin se i është falur besimi dy (2) provave që janë kundërtënëse njëra me tjetrën dhe atë: ekspertizës balistike me konstatimet e lartcekura dhe deklaratimit të vëllait të të dëmtuarit/dëshmitarit F.I., i cili kishte deklaruar se i dënuari E.I. ka tentuar disa herë ta ngreh/shkretp këmbëzën, por arma ju ka bllokuar.
14. Shkelje tjetër e pretenduar sipas të dënuarit dhe mbrojtësit të tij është bërë edhe me rastin e dëgjimit si dëshmitar të F.I.t, pasi që i njëjti është vëlla i të dëmtuarit dhe dihet besueshmëria e kësaj prove për ta nxjerrë të vërtetën në procedurë penale.

15. Në anën tjetër, edhe ekspertiza mjeko-ligjore, lëndimet që pësuar i dëmtuari Xh.I. i ka kualifikuar si lëndime të rënda trupore, kështu që duke u bazuar të gjitha këto që u theksuan më lart, në këtë rast kemi të bëjmë me vepër penale të lëndimit të rëndë trupor dhe assesi me vepër penale të vrasjes të mbetur në tentativë.
16. Përveç këtyre, pretendohet se gjykatat e instancave më të ulëta nuk e kanë llogaritur saktë kohën prej kur është në paraburgim i dënuari E.I., pasi që është dashur llogaritur periudhën kohore prej datës 01.05.2011, e jo prej datës 03.05.2011.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shikimit të shkresave të lëndës dhe analizimit të pretendimeve të të dënuarit dhe mbrojtësit të të tij, konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të mund të ndikonin në ligjshmërinë e këtyre vendimeve gjyqësore.
2. Dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket veprës penale “*Vrasja*” e mbetur në tentativë, nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së rezulton të jetë është i qartë, nuk është në kundërshtim me vetveten dhe është në harmoni me arsyetimin.
3. Në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës shihet që janë paraqitur dhe përshkruar në mënyrën e duhur elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale të lartcekur, përkatësisht faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale të lartcekur, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të KPK-së.
4. Gjithashtu, në arsyetimin e këtij aktgjykimi janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat e aktgjykimit dhe për të gjitha faktet e rëndësishme për çështjen.
5. Arsyetim i veçantë dhe i mjaftueshëm është paraqitur edhe sa i përket çështjes së dashjes së të dënuarit E.I. për ta privuar nga jeta të dëmtuarin Xh.I., si dhe sa i përket

edhe pretendimeve tjera të mbrojtjes në lidhje me ngjarjen që ishte zhvilluar ditën kritike.

6. Po ashtu, edhe dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e këtij aktgjykimi janë vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta sa i përket këtyre pretendimeve.
7. Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet se në këtë rast janë vlerësuar dhe analizuar në mënyrën e duhur të gjitha provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu siç është parashikuar me nenin 360, paragrafi 2 të KPP-së, duke përfshirë këtu edhe deklarinin e dëshmitarit F.I. dhe ekspertit të balistikës z. L.R., ku më pastaj, pas një procesi të tillë, janë nxjerrë konkluzionet e caktuara, që kanë të bëjnë si me gjendjen faktike, ashtu edhe aspekte tjera juridike.
8. Është evidente se dëshmitari F.I. e përshkruar ngjarjen nga këndvështrimi i tij, për atë çka kishte parë ditën kritike, pasi që ishte edhe dëshmitar okular në vendin e ngjarjes, ku i njëjti kishte sqaruar rrjedhën e ngjarjes, nga momenti kur i dënuari e kishte vendosur veturën e tij para traktorit të tyre, mandej se si i dënuari kishte hyrë brenda në shtëpinë e tij, e kishte marrë automatikun dhe kishte dalë në rrugë, duke vrapuar në drejtim të traktorit, ku në afërsi të traktorit edhe kishte shtënë në drejtim të të dëmtuarit, ndërsa pas kësaj kishte treguar edhe veprimet tjera që i kishte ndërmarrë i dënuari, në drejtim të tij, duke pretenduar se i dënuari e kishte drejtuar automatikun edhe në drejtim të dëshmitarit, ku kishte dashur që ta gjuaj të njëjtin, duke e tërhequr mekanizmin - kamzën për gjuajtje, mirëpo arma është bllokuar. Në këtë mënyrë, rezulton që dëshmitari në fjalë e përshkruar ngjarjen ashtu siç e ka perceptuar ditën kritike, duke treguar veprimet të cilat i kishte ndërmarrë i dënuari në drejtimin e tij dhe të dëmtuarit.
9. Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson si të pabazuar edhe pretendimin se është bërë shkelje e dispozitave të procedurës penale, kur është vendosur që të dëgjohet dëshmitari F.I., sepse i njëjti është vëlla i të dëmtuarit Xh.I., pasi që me dispozitat ligjore të KPP-së nuk është e ndaluar që të dëgjohet si dëshmitar vëllai i palës së dëmtuar. Bazuar në nenin 120, paragrafi 1 të KPP-së, si dëshmitar duhet thirret *“personi për të cilin besohet se mund të jep informata për veprën penale, për kryerësin dhe për*

rrethanat e rëndësishme për procedurën penale”. Ndërsa, në këtë rast, siç është cekur edhe më lart, z.F.I. ishte dëshmitar okular ditën kritike, andaj edhe drejtë është vepruar kur është vendosur që të dëgjohet si dëshmitar, pasi që i njëjti ka dhënë informata të rëndësishme për veprën penale, kryesin dhe rrethanat tjera të rëndësishme në lidhje me këtë rast. Mirëpo, në situata të tilla, është përgjegjësi e trupit gjykues që të çmon me ndërgjegje besueshmërinë e provave të tilla, ndërsa një proces i tillë zbatohet duke e pasur në konsideratë, edhe nenin 360, paragrafi 2 të KPP-së, në të cilën dispozitë ligjore është parashikuar se *“Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar”*. Andaj, edhe vetëm fakti se personi i caktuar është vëlla i palës së dëmtuar, si i tillë, nuk përbën pengesë ligjore që i njëjti edhe të dëgjohet si dëshmitar në rastin përkatës, nëse besohet se personi në fjalë mund të jep informata për veprën penale, për kryesin dhe për rrethanat e rëndësishme për procedurën penale.

10. Nën anën tjetër, Gjykata Supreme e Kosovës pas analizimit dhe shikimit të shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim se dashja e të dënuarit E.I., ditën kritike kishte qenë që ta privon nga jeta të dëmtuarin Xh.I., andaj edhe në këtë rast nuk bëhet fjalë për veprën penale *“Lëndimi i rëndë trupor”*, nga neni 154, paragrafi 1 të KPK-së, siç pretendohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, kështu që edhe qëndrimet në këtë drejtim të gjykatave të instancave më ulëta janë vlerësuar si të drejta dhe të ligjshme.
11. Siç me të drejtë e kanë arsyetuar edhe gjykatat e instancave më të ulëta, tek i dënuari ditën kritike ka ekzistuar dashja që ta privon nga jeta të dëmtuarin, pasi që i njëjti ka ndërmarrë veprime të caktuara me qëllim që të dëmtuarin ta privon nga jeta, ashtu që fillimisht me automjetin e tij e ka bllokuar rrugën e të dëmtuarit që të lëviz me traktorin e tij, e pastaj ka hyrë në shtëpinë e tij, nga ku e ka marrë armën dhe ka dalë sërish në rrugë, ku ishte i dëmtuari, ka shkuar dhe është afruar tek traktori dhe me pushkë gjysmë-automatike nga një distancë shumë e afërt rreth 50 cm., ka shtënë në të dëmtuarin, në pjesë vitale të trupit-në kraharorin e djathtë, i vetëdijshëm se ajo mund të ishte fatale për jetën e të dëmtuarit, e që si pasojë e të cilit veprim, të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe të rrezikshme drejtpërdrejt për jetën e tij, në momentin e shkaktimit të tyre.

12. Përndryshe, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se vepra penale “*Vrasja*” e mbetur në tentativë, nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, si e tillë mund të ekziston edhe në rastet kur të dëmtuarit nuk i shkaktohen fare lëndime trupore, por edhe në rastet kur të dëmtuarit mund t’i jenë shkaktuar lëndime të lehta apo të rënda, siç është rasti konkret. Për të ekzistuar tentativa në raste të tilla, është e rëndësishme dashja e kryesit, nëse kryesi ka qenë i vetëdijshëm për veprën penale, përkatësisht për veprimet e tij dhe pasojën (“*elementi intelektual*”) dhe e dëshiron kryerjen e veprës penale, përkatësisht dëshiron që të shkaktohet pasoja e caktuar (“*elementi volitiv*”). Në raste të tilla, kur dashja e kryesit është e orientuar në privimin e personit nga jeta, ndërsa fakti që janë shkaktuar lëndime të rënda trupore mund të merret për bazë vetëm si rrethanë rënduese me rastin e caktimit të dënimit. Andaj, edhe fakti se të dëmtuarit Xh.I. i janë shkaktuar lëndime të rënda trupore, gjë që është vërtetuar edhe nga ekspertiza mjeko-ligjore, nuk mund të jetë faktor determinues për të përcaktuar se në këtë rast kemi të bëjmë me veprë penale “*Lëndimi i rëndë trupor*”, nga neni 154, paragrafi 1 të KPK-së, pasi që siç është theksuar edhe më lart, dashja e të dënuarit E.I. ka qenë që ta privon nga jeta të dëmtuarin dhe si rezultat i kësaj, me të drejtë është konstatuar se në veprimet kryerëse të tij qëndrojnë elementet e veprës penale “*Vrasja*” e mbetur në tentativë, nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së.
13. Bazuar në nenin 20 të KPK-së, për ekzistimin e tentativës së veprës penale, është e rëndësishme që të përmbushën tre (3) kushte: që të ndërmerret veprimi i kryerjes së veprës penale; që veprimi të ndërmerret me dashje dhe që të mos shkaktohet pasoja e dëshiruar nga ana e kryerësit.
14. Në këtë rast, të gjitha këto kushte janë përmbushur, pasi që i dënuari E.I., kishte ndërmarrë veprime për ta privuar nga jeta të dëmtuarin Xh.I.; se të gjitha këto veprime, i dënuari i kishte ndërmarrë me dashje që ta privon nga jeta të dëmtuarin dhe përkundër kësaj, nuk ishte shkaktuar pasoja e dëshiruar, përkatësisht nuk është shkaktuar vdekja e të dëmtuarit.
15. Duke ju referuar pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që të rikujton se në praktikën tonë gjyqësore kanë ekzistuar edhe raste tjera që personi është privuar nga jeta me një (1) të shtënë nga arma e zjarrit, andaj edhe në këtë rast, fakti që eksperti i balistikës ka konstatuar se arma ka qenë funksionale (duke e pasur parasysh se në armë gjendeshin edhe tre (3) fishekë

të tjerë) nuk është e rëndësishme për të përcaktuar kualifikimin juridik të veprës penale, pasi që nga të gjitha rrethanat e rastit konkret, siç cekur edhe më lart, është vërtetuar dashja e të dënuarit ka qenë e orientuar për ta privuar nga jeta të dëmtuarin, përveç tjerash, edhe duke e pasur parasysh llojin e armës, vendin e goditjes së të dëmtuarit, mënyrën se si është zhvilluar ngjarja para dhe pas gjuajtjes me armë, mosmarrëveshjet e mëhershme në mes të palëve, etj.

16. Në këtë mënyrë, pretendimet e lartcekura të të dënuarit dhe të mbrojtësit të tij janë vlerësuar si të pazabzuara, ndërsa qëndrimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë konsideruara të drejta dhe të ligjshme.
17. Mirëpo, pretendimi i paraqitur në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në lidhje me llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës është i bazuar dhe në këtë drejtim është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit, nga neni 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6 të KPP-së. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës, në veçanti nga aktvendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, GJPP.nr.33/2011, i datës 03.05.2011, për caktimin e paraburgimit, shihet që i dënuari E.L., ishte privuar nga liria më datën 01.05.2011, e jo më datën 03.05.2011, siç është konstatuar gabimisht në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Andaj, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovon pjesërisht kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe i ndryshojë aktgjykimet e lartcekura, vetëm sa i përket llogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim, ndërsa në pjesët tjera, këto aktgjykime mbesin të pandryshuara.
18. Duke u bazuar në arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 dhe neni 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.628/2023, i datës 21.12.2023

”Bashkëkryerja, si formë e bashkëpunimit ekziston edhe në rastet kur dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale, duke kontribuar thelbësisht në kryerjen e veprës penale“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.83/19, të datës 21.10.2022, të dënuarit: A.D. dhe F.B., janë shpall fajtor për shkak të veprës penale *“Vrasja”* të mbetur në tentativë dhe në bashkëkryerje, nga neni 178, lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së, ndërsa i dënuari A.D. edhe për vepër penale *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*, nga neni 374, paragrafi 1 të KPRK-së. Për shkak të kryerjes së veprave penale të lartcëkura, ndaj të dënuarit F.B. është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vjetëve, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 30.07.2018 deri më datën 23.01.2019, ndërsa ndaj të dënuarit A.D. është shqiptuar dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vjet e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 30.07.2018 deri më datën 20.09.2018.
2. E akuzuara L.B., konform nenit 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale, është liruar nga akuzat.
3. Nga të dënuarit është konfiskuar një (1) predhë dhe një (1) gëzhjojë e kalibrit 7.62mm.
4. Të dënuarit: A.D. dhe F.B., janë detyruar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë secili veç e veç paushallin gjyqësor me nga pesëqind (500) euro, si dhe të paguajnë secili shumën prej pesëdhjetë (50) euro në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

5. Të dëmtuarit: G.M. dhe T.P. për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.
6. Automjeti “M.B. ...”, me ngjyrë të bardhë, me targa Zvicerane ...-...-..., është vendosur që t’i kthehet pronarit F.M. nga Gj.
7. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.703/2022, e datës 16.06.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesat e mbrojtësve të të dënuarve A.D. dhe F.B., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
8. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur:
 - mbrojtësi i të dënuarit F.B., avokati S.M., për shkak shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe shkeljes së ligjit penal, me propozimin që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja penale të kthehet në rigjykim apo të ndryshohen aktgjykimet në fjalë, në atë mënyrë që i dënuari të lirohet nga akuza dhe
 - i dënuari A.D., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7 lidhur me nenin 369 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi matjen e dënimit, si dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozimin që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa të lirohet akuza i dënuari ose kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
9. Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.363/2023, e datës 01.12.2023 ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit F.B. dhe e të dënuarit A.D., të refuzohen si të pabazuara.
10. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1, lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:- kërkesat janë të pabazuara.

11. Mbrojtësi i të dënuarit F.B., pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin pasi që është i mangët, i paqartë dhe kontradiktor në pjesën që ka të bëjë me faktet vendimtare mbi të cilat gjykata e shkallës së parë e ka bazuar aktgjykimin e saj. Së pari, në dispozitiv të aktakuzës thuhet se: "... të akuzuarit F.B. dhe A.D., kanë qenë të nxitur nga e akuzuara L.B....", pas një mosmarrëveshje paraprake që ka pasur L. me F.M., me dashje ka tentuar ta privoi nga jeta G.M. - vëllain e F.M.". Ndërsa, në dispozitivin e aktgjykimit është hequr fjala "*të nxitur nga e akuzuara L.B.*". Pra, gjykata e shkallës së parë ka vënë në pikëpyetje ekzistimin e dashjes së të dënuarit F.B., për kryerjen e kësaj vepre penale, pra është bërë e paqartë se si e vërtetoi gjykata ekzistimin e dashjes së të dënuarit Fatlum që ta privoi nga jeta G. M. Tutje thekson se në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë e ka konsideruar si të vërtetuar gjendjen faktike si në vijim se: ".. natën kritike të akuzuarit F.B. dhe A.D., se bashku me automjetin "*M.*", A. si vozitës dhe F. si pasagjer në ulësen e prapme, ku me të vërejtur automjetin "*F.*", i akuzuari A. e ndjek nga mbrapa saktësisht në rrugën "*S.*", në S., ia jep pistoletën të akuzuarit F., në pamundësi që të gjuaj vetë, pasi që ishte duke vozitur, F. nga ulësja e mbrapme ku ishte, me dashje shtënë me armë në drejtim të automjetit "*F.*", ku ishin të dëmtuarit G.M. e T.P., me ç'rast e godet automjetin "*F.*", në xhamin e pasmë, më saktësisht tek fshisa e xhamit". Po ashtu, fakti se në dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtim gjyqësor, ka pasur kundërtënie, sepse dëshmitarët e kanë përshkruar rastin e natës kritike secili në mënyrën e vetë, ashtu që në arsyetimin e aktgjykimit me asnjë fjalë nuk është sqaruar se si e ka vërtetuar gjykata saktësinë e dëshmive të dëshmitarëve. Gjykata duke vepruar në këtë mënyrë, nuk ka arritur që në arsyetimin e të jep arsye të qarta e të plota se si ka evituar kundërtënitë në mes të dëshmive të dëshmitarëve, pasi ata kanë dhënë dëshmi krejtësisht kontradiktore, ashtu siç ka qenë dashur të veproi sipas nenit 369, paragrafët 6 dhe 7 të KPP-së.
12. Gjithashtu, mbrojtësi pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë edhe me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ku gabimisht është vërtetuar gjendja faktike dhe kjo ka reflektuar edhe në zbatimin e gabuar të ligjit penal në dëm të të dënuarit. Asgjë nuk është vërtetuar as nga elementet subjektive, por as nga ato objektive që përbëjnë figurën e veprës penale të vrasjes në tentativë, sepse dashja si element subjektiv i veprës penale nuk është vërtetuar me asnjë provë, pastaj as rrethanat

e kryerjes së veprës penale, por ajo është supozuar dhe si e tillë është vërtetuar nga gjykatat e të dy instancave.

13. I dënuari A.D., në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e lartcekura përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që gjykatat nuk e kanë dhënë arsye për faktet vendimtare. Dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me arsyetimin, ngase sipas arsyetimit del se i dënuari nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në kryerjen e veprës penale, nuk është plotësuar figura e veprës penale, i njëjti në asnjë moment nuk e ka përdorur armën, të pandehurit tjetër as nuk i kanë thënë të gjuajnë e as nuk e kanë nxit, prandaj në rastin konkret gjykata gabimisht ka cilësuar veprën penale si vrasje e mbetur në tentativë, me çka ka shkelur ligjin penal në dëm të dënuarit.
14. Gjithashtu, pretendon se provat të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk janë vlerësuar drejtë nga ana e trupit gjykues, sepse incizimet që janë sjellë si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor janë ndarë vetëm sekuencat të cilat kanë dashur t'i shkojnë në favor të përshkrimit të aktakuzës, prandaj konsideron se gjykata nuk e ka përmbushur detyrimin e saj në lidhje me themelimin e dyshimit të bazuar mirë, ashtu siç e përcakton neni 19 i KPP-së.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikojë shkresat e lëndës dhe analizojë pretendimet e lartcekura, konstatojë se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal, siç pretendohet në kërkesa.
2. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë përpiluar në formën e parashikuar me ligj, pasi që përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas neni 369 të KPP-së (“Përmbajtja dhe forma e aktgjykimit”), si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsyetimit.
3. Duke ju referuar pretendimeve të të dënuarit A.D. dhe mbrojtësit të të dënuarit F.B., Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se dispozitivi i këtyre

aktgjytimeve është i qartë, nuk është në kundërshtim me vetveten dhe është në harmoni me arsyetimin e tyre, si në kuptim të përshkrimit të veprimeve kryerëse, ashtu edhe në aspekte tjera.

4. Gjithashtu, duke ju referuar pretendimeve nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është përshkruar në mënyrë të hollësishme vepra penale për të cilën janë shpallur fajtor të dënuarit: A.D. dhe F.B., së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal.
5. Nga kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se janë paraqitur këto elemente të figurës së veprës penale dhe atë: koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale dhe se vepra penale ishte kryer pas një mosmarrëveshje që kishte e akuzuara L.B. lidhur me kthimin e automjetit “M.B. ...”, tek pronari F.M., respektivisht vëllait të tij - të dëmtuarit G.M., e pasi që i dënuari takohet me të njëjtën, e përcjellin me shpejtësi automjetin “F..” me targa 07-800-BP, në të cilin ishte i dëmtuari G.M. dhe vjehri i tij-i dëmtuari T.P. dhe në një moment i dënuari A.D. ia jep pistoletën e kalibrit 7.62x25 mm., të dënuarit F.B., i cili me dashje tenton që t’i privoj nga jeta, duke shtënë në drejtim të automjetit “F..”, me ç’rast nga të shtënat është goditur parafango e mbrapme e automjetit “F..”.
6. Në këtë mënyrë, rezulton se në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, tek pjesa e përshkrimit të veprimeve kryerëse janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme të gjitha rrethanat dhe faktet të cilat i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale për të cilën është shpall fajtor të dënuarit: A.D. e F.B.
7. Po ashtu, edhe në arsyetimin e këtij aktgjykimi shihet qartë që janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat e aktgjykimit, përshkrimet e dhëna në arsyetim përmbajnë të gjitha arsyet për faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërtënëse, ndërsa pjesa e arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë përfshirë arsyet në lidhje me vlerësimin e pretendimeve

ankimore, si dhe shkeljet, për të cilat gjykata në fjalë është kujdesur sipas detyrës zyrtare.

8. Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe nga shkresat tjera të lëndës rezulton se në këtë rast janë vlerësuar dhe analizuar në mënyrën e duhur të gjitha provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu siç është parashikuar në nenin 361, paragrafi 2 të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale, duke përfshirë këtu edhe incizimet e kamerave dhe deklarimet e dëshmitarëve, ku pastaj pas një procesi të tillë, mandej janë nxjerrë konkluzionet e caktuara, që kanë të bëjnë si me gjendjen faktike, ashtu edhe çështje tjera juridike.
9. Përveç që nuk janë të përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, me aktgjykimet e lartcekura nuk është shkelur as ligji penal në dëm të dënuarve: F.B. dhe A.D., pasi që veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha elementet e figurës së veprës penale “*Vrasja*” të mbetur në tentativë dhe në bashkëkryerje, nga neni 178 lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së, kurse veprimet tjera të të dënuarit A.D. i përbëjnë të gjitha elementet e figurës së veprës penale “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*”, nga neni 374, paragrafi 1 të KPRK-së, për të cilat të njëjtit edhe janë shpall fajtor.
10. Është e qartë që i dënuari A.D., nuk ka shtënë me armë në drejtim të të dëmtuarve G.M. dhe T.P., pasi që me armë në drejtim të të dëmtuarve kishte shtënë i dënuari F.B.
11. Mirëpo, pavarësisht kësaj, i dënuari A.D., në këtë rast ka vepruar si bashkëkryerës, pasi që kontributi i tij në kryerjen e veprës penale të “*Vrasjes*” nga neni 178 të KPRK-së, e cila kishte mbetur në tentativë, kishte qenë thelbësor.
12. Kjo për faktin se i njëjti pasi që ishte takuar me të dënuarin F.B., e kishin pritur të akuzuarën L.B. që të del nga Stacioni Policor në Suharekë, e cila kishte shkruar për shkak të problemit lidhur me kthimin e automjetit të dëmtuarve, ndërsa pas kësaj i dënuari A.D., e kishte vozitur automjetin “*M.B. ..*” dhe me shpejtësi e kishin përcjellë automjetin në të cilin gjendeshin të dëmtuarit, të cilët lëviznin para tyre dhe për një moment i njëjti ja jep pistoletën e kalibrit 7.62x25 mm. të dënuarit F.B., i cili me dashje që t’i privon nga jeta shtënë në drejtim të automjetit në të cilin gjendeshin të dëmtuarit.

13. Në këtë mënyrë dhe duke ju referuar edhe të dhëna tjera të cilat mund të vërtetohen nga shkresat e lëndës, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës veprimet e të dënuarit A.D., siç janë : kontaktet dhe takimi me të dënuarin F.B. afër Stacionit Policor në Suharekë; çështja e problemit në lidhje me kthimin e automjetit; se i dënuari A.D. e kishte vozitur veturën me një shpejtësi dhe me këtë veturë e kishin përcjellë veturën në cilën gjendeshin të dëmtuarit; se nga vetura në lëvizje të cilën e drejtonte i dënuari A.D. është shtënë në drejtim të veturës në të cilën gjendeshin të dëmtuarit; se i dënuari A.D. ja kishte dhënë armën të dënuarit F.B., për ta kryer veprën penale, si dhe mandej duke i pasur parasysh edhe veprimet tjera që janë ndërmarrë nga të dënuarit, atëherë në këtë rast bëhet fjalë për institutin juridik të bashkëkryerjes sipas nenit 31 të KPRK-së në mes të të dënuarit A.D. dhe të dënuarit F.B. për ta kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor.
14. Në nenin 31 të KPRK-së është parashikuar se bashkëkryerja ekziston *“nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër”*.
15. Bazuar në këtë dispozitë ligjore, bashkëkryerja manifestohet në dy (2) mënyra:
- a) Duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose
 - b) Duke kontribuar thelbësisht në kryerjen e veprës penale në ndonjë mënyrë tjetër.
16. Në këtë rast, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se i dënuari F.B. kishte *“marrë pjesë në kryerjen e veprës penale”* për të cilën është shpallur fajtor, ndërsa i dënuari A.D., kishte *“kontribuar thelbësisht në kryerjen e veprës penale”* për të cilën është shpallur fajtor, duke vepruar në mënyrën e përkthuar më lart dhe të gjitha këto veprime, të njëjtit i kishin ndërmarrë me dashje, por që vepra e tyre (pasoja e dëshiruar) kishte mbetur në tentativë.
17. Përndryshe, duhet theksuar se kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë përmbajnë edhe pretendime të caktuara që ndërliken me gjendjen faktike, mirëpo, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se konform nenit 432, paragrafi 2 të KPP-së, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, andaj edhe rrjedhimisht pretendimet e tilla janë shqyrtuar fare.
18. Andaj, nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.688/2023, i datës 25.03.2024

”Për t’u konsideruar se është kryer vepra penale pastrimi i parave, përveç elementeve tjera, është e domosdoshme që të vërtetohet edhe aspekti subjektiv, i cili aspekt konsiston në rastet kur personi “duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal,... apo duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal...” ndërmerr veprimet kryerëse të veprës penale, veprime këto që duhet të ndërmerren me dashje dhe me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, sistemimit, apo veprimeve tjera të përcaktuara me dispozitat përkatëse ligjore“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Rrjedha e përgjithshme e procedurës penale

- 1.1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.27/2019, të datës 23.12.2022, të pandehurit: B. A., H. H., A. H., V. Sh., S. P., M. K., Xh.B., N. Sh., S. B., I. B., Sh. L., E. Ç., J. G., B. R., J. L. dhe A. H., duke u bazuar në nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), secili veç e veç, janë liruar nga akuza, për shkak të veprës penale *“Shpërlarja e parave”*, (vepra penale në bashkim dhe vazhdimësi) në bashkëkryerje në kundërshtim me nenet 23 dhe 71 të KPRK-së, që ishte në fuqi deri më datën 31.12.2012, vepër penale kjo e paraparë edhe në nenet 31 dhe 81 të KPRK-së, që ishte në fuqi prej datës 01.01.2013, në kundërshtim me nenin 10 (2) të Rregullores së UNMIK-ut, nr.2004/2 *“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të përafërta”*, po ashtu në kundërshtim me nenin 32 të Ligjit nr. 03/L-196 për *“Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizimit”*, në fuqi prej datës 30.07.2010, gjithashtu e paraparë në nenin 56 (1) të Ligjit nr. 05/L-096 për *“Parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit”*, në fuqi prej datës 15.06.2016, siç referohet në nenin 308 të KPRK-së, pasi që nuk është provuar se të njëjtit t’i kenë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar.
- 1.2. Është anuluar pjesërisht urdhëresa e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, PPR.KR.nr.222/2014, të datës 26.04.2016, me të cilën janë sekuestruar përkohësisht

paluajtshmëritë si më poshtë dhe është urdhëruar ndalimi i tjetërsimit të këtyre paluajtshmërive apo objekteve ndërtimore, si dhe çdo ndryshim në librat kadastral, për ngastrat që janë objekt i kësaj çështje penale, si në vijim:

- Ngastra kadastrale nr...., ... – P., kompania “M. B. SHPK”, e përfaqësuar nga S B;
- Ngastra kadastrale nr...., ... – P., I. B.;
- Ngastra kadastrale nr....-..., ... – P., E. Ç.;
- Ngastra kadastrale nr...-..., ... – P., B. R.;
- Ngastra kadastrale nr...-, ... – P., J. L. dhe A. H.;
- Ngastra kadastrale nr....-..., ... – G., N. Sh.;
- Ngastra kadastrale nr....-..., ... – G., S. P.;
- Ngastra kadastrale nr.../..., ... – G., A. H.; - Ngastra kadastrale nr.../..., – G., H. H. dhe - Ngastra kadastrale nr.../..., ...– G., H. H.

- 1.3. Pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, titullarëve të këtyre paluajtshmërive - pronarëve, iu lejohet disponimi me të gjitha autorizimet që burojnë nga të drejtat pronësore për këto ngastra kadastrale.
- 1.4. Shpenzimet e procedurës penale është vendosur se do të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës.
- 1.5. Palët e dëmtuara - familja P., familja N. dhe Agjencia e Privatizimit të Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest juridiko-civil.
- 1.6. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.21/2023, e datës 05.07.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

2. *Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë*

- 2.1. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Kryeprokurori i Shtetit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.4. të KPP-së, shkeljes së

ligjit penal, nga neni 432, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, nga neni 432, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së, duke propozuar që të aprovohet si e bazuar kjo kërkesë, ndërsa të konstatohet se aktgjykimet e lartcekura të instancave më të ulëta janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me shkelje të ligjit penal në favor të të pandehurve: B. A., H. H., A. H., V. Sh., S. P., M. K., Xh. B., N. Sh., S. B., I. B., Sh. L., E. Ç., J. G., B. R., J. L. dhe A. H.

3. Përgjigjet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë

3.1. Ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, përgjigje kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të pandehurit B. A., avokati K.K., i cili konsideron se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale edhe as me shkelje të ligjit penal në favor të të pandehurit, pasi që në radhë të parë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i bazuar në prova që gjenden në shkresa të lëndës. Gjithashtu, edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, ndërsa pretendimet ankimore të prokurorit të shtetit janë të përgjithësuara dhe jo konkrete. Duke e pasur parasysh natyrën e veprës penale dhe pretendimin e prokurorit të shtetit se nga Deklarata Tatimore e vitit 2005, i pandehuri B. A. kishte fituar vetëm 790 Euro, në seancës e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.11.2022, mbrojtja e të pandehurit kishte propozuar dy (2) prova dhe atë: Formularët e Deklarimit Vjetor për vitet 2004 dhe 2005, nga të cilat shihet se i pandehuri B. A., gjatë vitit 2004 ka pasur fitim në shumë prej 53,283.53 Euro, kurse gjatë vitit 2005, ka pasur fitim në shumë prej 77,636.35 Euro. Andaj, edhe mbi bazën e kësaj, si dhe duke e pasur parasysh se prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka propozuar asnjë provë të vetme për të vërtetuar pretendimet e tij, kurse në anën tjetër, pretendimet e paraqitura të cilat janë të përgjithësuara dhe jo konkrete kanë të bëjnë me rastin “*Toka I*”, kështu që mbrojtësi i të pandehurit B. A., ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar;

- mbrojtësi i të pandehurit H. H., avokati A.B., i cili thekson se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është një përshkrim i ankesës dhe i aktakuzës, andaj edhe janë një tregues se aktakuza ka qenë e padrejtë, konfuze dhe pa mbështetje në prova. I pandehuri H. H., nuk e ka njohur asnjërin nga të akuzuarit e grupit tjetër dhe as me të pandehurit e këtij rasti, përjashto të pandehurin B. A., ndërsa paluajtshmërinë e ka blerë me mirëbesim, e ka paguar përmes xhirollogarisë bankare dhe se nuk është gjetur asnjë veprim inkriminues në sjelljet e tij. Andaj, edhe konsideron se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës dhe as me shkelje të ligjit penal, pasi që në to janë paraqitur arsyet se pse të pandehurit janë liruar nga akuza, kështu që edhe ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar;

- mbrojtësi i të pandehurit V. Sh., avokati H.H., i cili thekson se gjykatat e instancave më të ulëta kanë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta, andaj edhe nuk qëndrojnë pretendimet e prokurorit të shtetit. Në këtë rast, i pandehuri V. Sh., kontratat e shitblerjes i ka vërtetuar në gjykatë dhe sipas procedurës ligjore i njëjti e ka bërë edhe regjistrimin e pronës. Është i drejtë edhe konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se është i paqëndrueshëm pretendimi i prokurorit të shtetit se i pandehuri V. Sh., e ka ditur apo ka pasur arsye për të ditur që parcelat e tokës janë në pronësi shoqërore apo janë fitim i krijuar nga aktivitetet kriminale.

- mbrojtësja e të pandehurit S.P., avokatja T.Zh. që thekson se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar, pasi që aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta nuk janë të përfshira me shkeljet e pretenduara. I pandehuri S. P., duke i përfillur tërësisht dispozitat ligjore në fuqi ka lidhur kontratë mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e cilat është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me shenjen VR.nr..., të datës 18.09.2007, me shitësin V.Sh., në shumë prej njëqindpesëdhjetetë mijë (153.000) euro, i cili çmim në tërësi është paguar, gjë që vërtetohet edhe nga fletëpagesat e lëshuara nga ProCredit Bank. Të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dëshmojnë në mënyrë të qartë dhe të plotë pafajësinë e të pandehurit;

- mbrojtësi i të pandehurit N. Sh., avokati S.S., i cili konsideron se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të refuzohet si e pabazuar, pasi që nuk qëndrojnë

pretendimet se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale apo edhe me shkelje tjera ligjore;

- i pandehuri I. B., i cili ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar, pasi që gjykatat e instancave më të ulëta drejtë kanë vendosur kur kanë konstatuar se provat e ofruara janë të paqarta dhe të pa mjaftueshme për të arritur deri tek konkludimi se janë formuar elementet e veprës penale dhe

- mbrojtësi i të pandehurit J.G., avokati I.D., i cili përveç tjerash thekson se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal, andaj edhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të refuzohet si e pabazuar.

4. Konstatimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

5. Pretendimet në lidhje me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

- 5.1. Kryeprokurori i Shtetit në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që ndërlidhen me formën dhe përmbajtjen e aktgjyimit, përkatësisht përpilimin me shkrim të aktgjyimit, sipas dispozitave ligjore të cilat kanë qenë në fuqi gjatë kohës së marrjes së këtij aktgjykimi, duke qenë se aktgjykimi është i paqartë dhe i pakuptueshëm, ka një mospërputhje në mes të fakteve të paraqitura në dispozitiv dhe përmbajtjes së provave të përshkruara në arsyetim, ndërsa në arsyetim të aktgjyimit nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe të qarta lidhur me faktet vendimtare të cilat gjykata i ka vërtetuar apo nuk i ka vërtetuar.

- 5.2. Më tutje, pretendohet se arsyetimi është në kundërshtim me provat e paraqitura dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e vendosjes së kësaj çështje penale.
- 5.3. Në arsyetim të aktgjykimit në fjalë, pasi përshkruhen fjalët përfundimtare të palëve dhe paraqitjes së deklaratave për secilin nga të dënuarit, gjykata vijon duke konstatuar se “ashtu që të gjitha këto rrethana krijojnë besueshmëri të shkallës së lartë se këto paluajtshmëri janë regjistruar në regjistrat kadastral konform dispozitave ligjore në fuqi, andaj edhe gjykata vlerëson se mbrojtja e të pandehurit B. A. (apo edhe të pandehurve tjerë) është e sinqertë, objektive dhe e bazuar në fakte dhe prova që gjenden në shkresa të lëndës”. Në këtë mënyrë, gjykata e shkallës së parë një përshkrim të tillë të deklaratave e ka bërë me një konkludim të paarsyetuar se përse ja ka falur besimin mbrojtjes së tyre e jo dëshmive të paraqitura nga prokurori i shtetit, e që një gjë e tillë bie në kundërshtim me nenin 369 të KPP-së. Kjo dispozitë ligjore e detyron gjykatën që në rastet kur i akuzuari lirohet nga akuzat, në arsyetim veçanërisht të shënohet arsye e paraparë në nenin 363 të KPP-së.
- 5.4. Pretendohet se gjykata e shkallës së parë, përveç përshkrimit të dispozitës ligjore të nenit 7 të KPP-së, në arsyetim të aktgjykimit ku përshkruhen deklaratat e dëshmitarëve të propozuar nga prokurori i shtetit, nuk ka bërë vlerësimin e duhur të këtyre deklarimeve, ashtu siç kërkohet me dispozitat ligjore të KPP-së, pasi që përveç konstatimit se “Gjykata ka vlerësuar dëshmitë e këtij dëshmitari, mirëpo të njëjtat nuk i gjeti relevante në vërtetimin e ndonjë fakti të rëndësishëm në këtë çështje penale”, nuk ka dhënë ndonjë arsyetim përmbajtësor se pse këto deklarata nuk janë relevante.
- 5.5. Në mënyrë të njëjtë është vepruar edhe me vlerësimin e provave materiale të cilat janë dorëzuar së bashku me aktakuzë dhe përmes parashtrësës së datës 28.04.2022, të cilat janë administruar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 01.11.2022, e që në këtë aspekt, pretendohet se arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i ndërtuar në kundërshtim me dispozitat ligjore, përmes të cilave e detyrojnë gjykatën që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, ndërsa këtë gjë ta bëjë me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojë si faktet kundër të pandehurve, ashtu edhe ato në favor të tyre.

- 5.6. Se gjykata e shkallës së parë e ka marrë aktgjykimin me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dëshmon edhe fakti se në disa pjesë të arsyetimit, gjykata në fjalë nuk u është referuar provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, por provave në të cilat është bazuar aktakuzat. Një situatë e tillë dëshmon faktin se pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, gjykata nuk ishte marrë me vlerësimin e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, por, ashtu siç kishte vepruar edhe qysh pas përfundimit të shqyrtimit fillestar, kur kishte hedhur aktakuzën dhe në këtë fazë të procedurës e kishte pushuar procedurën penale, tani edhe në arsyetimin e aktgjykimit ju ishte referuar: *“provat mbi të cilat është bazuar aktakuzat”, “nga të dhënat si në aktakuzë”*, etj. duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 360 të KPP-së.
- 5.7. Gjithashtu, Kryeprokurori i Shtetit konsideron se gjykata e shkallës së parë, përveç refuzimit të kërkesës së prokurorit të shtetit për t’u dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit/dëmtuarit përfaqësuesin e familjes P., duke mos respektuar dispozitat ligjore të KPP-së kishte vepruar edhe me rastin e refuzimit të propozimit për të dëgjuar edhe dëshmitarë tjetër (A. M., A.V. dhe E.G.), duke mos dhënë arsytet e mosmiratimit të propozimit konkret në lidhje me këtë çështje, ashtu siç përcaktohej në nenin 369, paragrafi 7 të KPP-së. Po ashtu, gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë asnjë-herë nuk kishte ftuar askënd nga institucionet e Republikës së Kosovës, që ishin propozuar si palë e dëmtuar, siç është Agjencioni i Kosovës për Privatizim, ndërsa në aktakuzë janë paraqitur prova të mjaftueshme që konsiderojnë se pse konsiderohet palë e dëmtuar.
- 5.8. E për më tepër, edhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë për anulimin e pjesërisht të urdhërësës së lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, PPP.KR.nr.222/2014, e datës 26.04.2016, me të cilin është vendosur që *“Pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, titullarëve të këtyre paluajtshmërive-pronarëve iu lejohet disponimi me të gjitha autorizimet që burojnë nga të drejtat e pronësisë për këto ngastra kadastrale. Palët e dëmtuara: familja P., familja N. dhe Agjencia e Privatizimit e Kosovës për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil”* është marrë pa asnjë arsyetim, ashtu siç parashihet me nenin 369, paragrafi 9 të KPP-së.
- 5.9. Po ashtu, theksohet se gjykata e shkallës së parë ka arritur në konkludimin se deklarimet e të pandehurve: B. A., H. H., A. H., V. Sh., S. P., M. K., Xh. B., N. Sh., S. B., I. B., Sh.L., E. Ç., J. G., B. R., J. L. dhe A. H. janë *“të sigjerta, me besueshmëri të lartë,*

objektive dhe të bazuar në prova” vetëm nga fakti se “lidhja e kontratave ishte bërë në formë të shkruar” apo se “pagesa e dëshmuar përmes transaksioneve bankare” apo se “bartja e pronësisë ishte arritur që të bëhet në emër të të pandehurit” pa e vlerësuar saktësinë e provave kundërtëhënëse dhe argumentet e prokurorit të shtetit se ishin pikërisht këto veprime të të pandehurve si mjete të përdorura me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës dhe burimit të prejardhjes së pasurisë që realisht ishte fituar nga një aktivitet i dëshmuar kriminal.

5.10. Në anën tjetër, sipas pretendimeve në kërkesë, edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që gjykata në fjalë nuk i ka evituar shkeljet e bëra nga gjykata e shkallës së parë, andaj edhe si i tillë ky aktgjykim është i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Përtej kësaj, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që në arsyetim të këtij aktgjykimi vetëm janë përshkruar konstatimet e gjykatës së shkallës së parë dhe duke konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as me shkelje të ligjit penal, ndërsa edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, kurse nuk janë shtjelluar dhe as arsyetuar pretendimet në mënyrë konkrete.

5.11. Gjykata e shkallës së dytë është mjaftuar me përshkrimin e disa pretendimeve ankimore, të përgjigjeve në ankesë dhe në pjesën më të madhe vetëm ka përshkruar provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, thjeshtë duke përsëritur konkludimet e gjykatës së shkallës së parë se “Prokuroria nuk ka ofruar prova se blerësit e këtyre paluajtshmërive tani të pandehurit B. A., deri te i pandehuri A. H., të kenë pasur çfarëdo lidhje subjektive me të akuzuarit tjerë të pjesës tjetër të aktakuzës “Toka 1”, përmes të cilave do të provohej fakti se të akuzuarit e kanë ditur apo kanë mundur të ishin në dijeni se ...”.

6. *Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me pretendimet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale*

Fillimisht, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që të sqaron se duke u bazuar në nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat

paraqitësi i kërkesës pretendon, në këtë rast të pretendimeve të paraqitura nga Kryeprokurori i Shtetit.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale apo edhe me shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale, të cilat do mund të ndikonin në ligjshmërinë dhe drejtshmërinë e këtyre aktgjyqimeve, siç pretendohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, për arsyet që do të paraqiten në vijim.
2. Megjithëse pretendimet fillestare nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk janë shumë konkrete, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përpiluar duke i pasur në konsideratë të gjitha standardet dhe kriteret që parashikoheshin në nenin 370 të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale (Kodi Nr. 04/L123 i Procedurës Penale, i datës 13.12.2012), duke ju referuar specifikave të rastit konkret.
3. Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka mundur që të vërej ndonjë paqartësi apo kundërrthënie të theksuar, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e cila do të mund të ndikonte mandej në drejtshmërinë dhe ligjshmërinë e këtij aktgjykimi.
4. Në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet që janë paraqitur dhe përshkruar në mënyrën e duhur të gjitha elementet e nevojshme, ku janë paraqitur të gjithë të pandehurit, duke filluar nga i pandehuri B. A., e deri tek i pandehuri A. H., si dhe veprat penale për të cilat të njëjtit janë liruar nga akuza, duke e specifikuar edhe bazën ligjore për një gjë të tillë, duke ju referuar nenit 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale, mandej, arsyet pse të njëjtit janë liruar nga akuza, për të vazhduar me vendimin për anulimin e pjesërishtëm të urdhërësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilin ishin sekuestruar përkohësisht

paluajtshmëritë e specifikuar në këtë pjesë të aktgjykimit, si dhe vendimet në lidhje me shpenzimet e procedurës dhe udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil.

5. Sa i përket pretendimeve në lidhje me pjesën e arsyetimit, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat e aktgjykimit dhe për të gjitha faktet vendimtare, ku një vëmendje e veçantë shihet se i është kushtuar edhe çështjes së vlerësimit të provave dhe aspekteve subjektive të veprave penale për të cilat ishin akuzuar të pandehurit: B. A., H. H., A. H., V.Sh., S. P., M. K., Xh. B., N. Sh., S., B., I. B., Sh. L., E. Ç., J. G., B. R., J. L. dhe A. H.
6. Arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë në këto drejtime, por jo vetëm, rezultojnë edhe të qarta dhe gjejnë mbështetje edhe në provat të cilat janë proceduar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa përfundimet e gjykatës së shkallës së parë rezultojnë të jenë konkrete dhe të logjikshme, e që burojnë natyrshëm nga vetë përmbajtja e këtyre provave të proceduara, të cilat si të tilla, nuk kanë qenë edhe të pakta.
7. Vlerësohet si i pabazuar pretendimi nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar saktësinë e provave kundërtënësë dhe nuk ka paraqitur arsye se pse ju ka falur besimin deklarimeve të të pandehurve.
8. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme e Kosovës vëren se të pandehurit në këtë rast kanë shpjeguar në mënyrë të hollësishtme mënyrën se si kanë ardhur deri tek blerja e paluajtshmërive, të cilat paluajtshmëri kanë qenë objekt i aktakuzë, duke sqaruar se bartja e të drejtave pronësore mbi këto paluajtshmëri është bërë duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore, se për këto paluajtshmëri kanë përpiluar kontrata në formë të shkruar, të cilat kontrata janë vërtetuar në gjykatat kompetente, se pagesat e çmimit të blerjes së këtyre paluajtshmërive janë bërë përmes transaksioneve bankare, përkatësisht përmes xhirollogarive bankare dhe se nuk kanë pasur asnjë ndalesë apo pengesë ligjore për shitblerjen e këtyre paluajtshmërive.
9. Përtej këtyre të theksuarave më lart, nga shkresat e lëndës shihet që të pandehurit kanë shpjeguar edhe prejardhjen e të hollave me të cilat të njëjtit kanë blerë këto

paluajtshmëri, të cilat kryesisht kanë qenë hua të siguruara nga familjarë dhe miq të ndryshëm apo nga kreditë e realizuara në bankat komerciale, pastaj nga kursimet e siguruara ndër vite, përfshirë edhe punën në botën e jashtme, të ardhurat e siguruara nga bizneset e tyre, apo nga shitja e paluajtshmërive tjera të cilat të njëjtit i kanë pasur në pronësi, pastaj mënyrën e kontaktit për blerjen e tokës, se disa prej tyre ishin njoftuar për shitjen e tokës, duke e parë shpalljen në rrugë dhe numrin e telefonit, ndërsa disa nga të pandehurit tjerë kanë shpjeguar edhe motivet pse i kanë blerë paluajtshmëritë, e që kanë qenë qoftë ndërtimi i objekteve të caktuara për banim, qoftë se paluajtshmëria kishte qenë në afërsi të vendit ku ata kanë banuar apo kanë ushtruar biznesin e tyre dhe kanë dashur që ta zgjerojnë veprimtarinë e biznesit të tyre, etj.

10. Gjithashtu, nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton që janë vlerësuar edhe provat tjera të cilat ishin proceduar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, mirëpo nga të njëjtat nuk është vërtetuar ndonjë fakt relevantë që ndërlidhet me veprat penale për të cilat janë akuzuar të pandehurit: B.A., H. H., A. H., V. Sh., S. P., M. K., Xh. B., N. Sh., S. B., I. B., Sh. L., E. Ç., J. G., B. R., J. L. dhe A. H., pasi që në shumë aspekte, provat përkatëse janë ndërlidhur me grupin e të akuzuarve sipas aktakuzës i cili identifikohet si rasti *"Toka I"*.
11. Në arsyetimin e aktgjykimit, shihet se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta, se pse dhe si ka ardhur deri tek konkludimi se në këtë rast të pandehurit: B.A., H. H., A. H., V. Sh., S. P., M. K., Xh. B., N. Sh., S. B., I. B., Sh. L., E. Ç., J. G., B. R., J. L. dhe A. H., nuk është provuar që të kenë pasur ndonjë lidhje subjektive me të akuzuarit: Sh. S., F. G., E. G., Sh. M., E. U. dhe I. S., i cili është identifikuar si rasti *"Toka I"* dhe të kenë ditur apo të kenë mund të ishin në dijeni se vendimi gjyqësor, regjistrat kadastral apo fletat poseduese të jenë siguruar nga veprimet e kundërligjshme, përkatësisht nga aktiviteti kriminal i grupit të të akuzuarve sipas aktakuzës *"Toka I"*.
12. Bazuar në të gjitha provat e proceduara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në këtë rast nuk është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se të pandehurit: B.A., H. H., A. H., V. Sh., S. P., M. K., Xh. B., N. Sh., S. B., I. B., Sh. L., E. Ç., J. G., B. R., J. L. dhe A. H., t'i kanë kryer veprat penale për

të cilat janë akuzuar, siç përshkruhet më hollësisht në dispozitivin e aktakuzës dhe të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

13. Kjo për faktin se për t'u konsideruar se është kryer vepra penale për të cilën janë akuzuar të pandehurit e lartcekur, përveç elementeve tjera, është e domosdoshme që të vërtetohet edhe aspekti subjektiv, i cili aspekt konsiston në rastet kur personi *“duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal,... apo duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal...”* ndërmer veprimet kryerëse të veprës penale, veprime këto që duhet të ndërmerren me dashje dhe me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, sistemimit, apo veprimeve tjera të përcaktuara me dispozitat përkatëse ligjore.
14. Në anën tjetër, barra e përgjegjësisë (*onus probandi*) për ofrimin e provave për të vërtetuar këtë aspekt të veprës penale, por jo vetëm, i ka takuar prokurorit të shtetit, i cili siç rezulton nga shkresat e lëndës nuk ka arritur që të prezantojë prova të mjaftueshme përmes së cilave do të vërtetohej përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se të pandehurit e lartcekur të kenë pasur ndonjë lidhje subjektive me grupin e të akuzuarve, i cili është identifikuar si rasti *“Toka 1”* dhe të kenë ditur apo të kenë mund të ishin në dijeni se vendimi gjyqësor, regjistrat kadastral apo fletat poseduese të jenë siguruar nga aktiviteti kriminal i grupit të të akuzuarve sipas rastit të lartcekur. Kjo për faktin se nga provat e procedura gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor nuk rezulton që të jetë vërtetuar një element i tillë, për të cilën gjë, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsye të qarta dhe të mjaftueshme, të cilat si të tilla edhe gjejnë mbështetje pikërisht në këto prova të proceduara.
15. Në kontekst të këtyre që u theksuan më lart dhe duke qenë se të gjithë të pandehurit akuzoheshin se paluajtshmëritë kontestuese i kanë blerë me një çmim më të lirë se çmimi i tregut, ndërsa bazueshmëria e çmimit të tregut ishte ndërtuar mbi bazën e mendimit të ekspertëve ndërkombëtar, sipas të cilës, çmimi minimal për periudhën 2010-2015, në atë rajon, për shitblerjen e tokave bujqësore ka qenë pesëmbëdhjetë (15) euro për metër katror, është tejet e rëndësishme që të vihet në pah se nga shkresat e lëndës shihet që gjykata e shkallës së parë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare kishte konstatuar faktin se gjatë zhvillimit të procedurës së hetimeve, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Policisë së Kosovës, më datën 17.03.2015, i është drejtuar me

një kërkesë Zyrës së Drejtorisë së Kadastrit në Prishtinë, nga e cila ka kërkuar që t'i dorëzohen kopjet e kontratave të shitblerjes së paluajtshmërive për regjionin e Ç., dhe atë vendet e quajtura “Mirkovica”, “Mirkovica Mali Breg”, “Mirkovica Veliki Breg”, “Mirkovica Breg”, “Mirkovica Do Puta”, “Mirkovica Milina”, “Mirkovica Potik”, “Kunovaci” dhe “Veternik” për periudhën 2010-2014.

16. Drejtorja për Kadastër në Prishtinë, kishte kthyer përgjigje dhe kishte siguruar disa kopje të kontratave për disa prona tjera të cilat janë shitur në zonat dhe periudhën e lartcekur kohore, nga të cilat vërtetohet se të pandehurit: B.A., H. H., A. H., V. Sh., S. P., M. K., Xh. B., N. Sh., S. B., I. B., Sh. L., E. Ç., J. G., B. R., J. L. dhe A. H., paluajtshmëritë që janë objekt i aktakuzës i kanë blerë me një çmim më të lart, se sa çmimi i paluajtshmërive sipas këtyre kontratave.
17. Kjo për faktin se përmes këtyre kontratave që janë siguruar nga Drejtorja për Kadastër në P., konstatohet fakti se kemi të bëjmë me zona përafërsisht të njëjta kadastrale dhe me periudha të përafërta kohore të shitblerjes, kur edhe ishte bërë shitblerja e paluajtshmërive që janë objekt i aktakuzës. Kështu, që nga këto prova nuk vërtetohet fakti se çmimi i shitblerjes së këtyre paluajtshmërive që janë objekt i aktakuzës, të ketë qenë me i ulët se çmimi i tregut për atë periudhë kohore dhe për zonat përafërsisht të ngjashme.
18. Mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, por jo vetëm, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë ka përbushur detyrimet e saj, që tani derivojnë, nga neni 369, paragrafi 10 të KPP-së, pasi që në arsyetimin e aktgjykimit të saj është paraqitur në mënyrë të veçantë arsyeja se pse të pandehurit e lartcekur janë liruar nga akuza, duke konstatuar se në këtë rast nuk është provuar se të pandehurit të kenë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar.
19. Nga shkresat e lëndës, shihet që gjykata e shkallës së parë deri tek një konkludim i tillë kishte ardhur pas procedimit të një numri të konsiderueshëm të provave, të cilat janë të elaboruara në mënyrë të hollësishme në aktgjykimin e kësaj gjykate, e të cilat prova rezultojnë se janë vlerësuar, duke e pasur për bazë edhe kriteret që parashihen në nenin 360, paragrafi 2 të KPP-së.

20. Pavarësisht disa shprehjeve të përdorura në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me provat e administruara, nga procesverbalet e seancës të shqyrtimit gjyqësor dhe shkresat tjera të lëndës shihet se provat mbi bazën e të cilave është mbështetur aktgjykimi i kësaj gjykate janë prova që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, andaj edhe pretendimi i paraqitur në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë se në këtë rast është cenuar neni 360, paragrafi 1 të KPP-së nuk qëndron.
21. Sa i përket pretendimit nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë se gjykata e shkallës së parë duke mos respektuar dispozitat përkatëse ligjore ka refuzuar propozimet për dëgjimin e dëshmitarëve tjerë dhe nuk ka paraqitur arsye për mosmiratimin e propozimeve të tilla, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 369, paragrafi 7 të KPP-së, Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron të pabazuar, për së paku tre (3) arsye.
22. *Së pari*, përmes procesverbaleve të seancave të shqyrtimit gjyqësor shihet që gjykata e shkallës së parë në disa raste kishte refuzuar propozimin e prokurorit të shtetit për dëgjimin e dëshmitarëve të tjerë dhe për secilin rast kishte paraqitur arsye për një gjë të tillë.
23. Kështu, nga procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 31.10.2022, rrjedh se gjykata e shkallës së parë kishte refuzuar propozimin e prokurorit të shtetit për dëgjimin si dëshmitarë të këtyre personave: A. M. dhe A. V., me arsyetimin se të njëjtit në rastin e identifikuar si *“Toka I”* e posedojnë cilësinë e të akuzuarve, pasi që bëhet fjalë për një çështje të njëjtë penale, me një aktakuzë me numër të njëjtë dhe personi i njëjtë, nuk mund të ketë edhe cilësinë e dëshmitarit dhe cilësinë e të akuzuarit në çështjen e njëjtë penale.
24. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se sipas dispozitave ligjore të nenit 123, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së, *“si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje i bashkëpandehuri derisa zbatohet procedurë e përbashkët apo e veçantë, përveç kur i bashkëpandehuri është dëshmitar bashkëpunues sipas nenit 231 të këtij Kodi”*. Pavarësisht se ky Kod nuk ka qenë në fuqi në kohën e zbatimit të shqyrtimit gjyqësor, edhe nën supozimin se një vendim i tillë i gjykatës së shkallës së

parë është në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore që ishin në fuqi në kohën kur zhvillohej shqyrtimi gjyqësor, prapë se prapë një aspekt i tillë nuk do të mund të evitohej tani për tani, pasi që siç është theksuar më lart, dispozita ligjore e nenit 123, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së, e ndalon që në cilësinë e dëshmitarit të dëgjohej i bashkëpandehuri, përveç rasteve kur i bashkëpandehuri është dëshmitar bashkëpunues, sipas nenit 231 të këtij Kodi, ndërsa në këtë rast nuk vjen në shprehje aspekt i tillë.

25. Sa i përket dëshmitarit E. G., në shkresat e lëndës shihet që gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar propozimin e prokurorit të shtetit, që i njëjti të dëgjohej në cilësi të dëshmitarit, duke e pasur parasysh edhe parimin e ekonomizimit të procedurës penale, pasi që sipas dokumentacionit mjekësor, shihet që i njëjti kishte qenë në një gjendje të rëndë shëndetësore.
26. Kurse, nga procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor i datës 31.10.2022, shihet që është refuzuar propozimi për dëgjimin e dëshmitares D. P., për shkak se prokurori i shtetit nuk kishte ofruar arsye të mjaftueshme se çka do të mund të dëshmonte e njëjta, pasi që e njëjta nuk është dëgjuar si dëshmitare në asnjë fazë të mëparshme të procedurës penale, siç nuk janë ofruar as të dhëna tjera personale për identifikimin e adresës së saj.
27. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se duke u bazuar në nenin 120, paragrafi 1 të KPP-së (neni 124, paragrafi 1 të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale), *“si dëshmitar thirret personi për të cilin besohet se mund të jep informata për veprën penale, për kryerësin dhe për rrethanat e rëndësishme për procedurën penale”*, ndërsa duke u bazuar në nenin 283 të KPP-së (neni 288 i Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale), *“Palët, edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor mund të kërkojnë që në shqyrtim gjyqësor të thirren dëshmitarë të rinj, mirëpo kërkesa e palëve duhet të jetë e arsyetuar dhe të shënojnë se cilat fakte duhet provuar dhe me cilat prova të propozuara. Ndërsa, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e aprovon këtë kërkesë në rastet kur dëshmitari i ri, ka qenë i panjohur në kohën e konfirmimit të aktakuzës ose nuk e përsërit në mënyrë të konsiderueshme dëshmitarin, ekspertin apo provën tjetër dhe e drejta e të pandehurit në gjykim të drejtë mund të dëmtohet duke refuzuar kërkesën”*. Bazuar në atë që u theksua më lart, rezulton që

gjykata e shkallës së parë nuk ka cenuar parimet bazë që janë të përcaktuara në këto dispozita ligjore kur ka refuzuar propozimin e prokurorit të shtetit për dëgjimin e dëshmitares se lartcekur, për faktin se prokurori i shtetit nuk ka arritur që të përmbush detyrimet që burojnë pikërisht nga këto dispozita ligjore.

28. *Së dyti*, sa i përket dëgjimit të dëshmitarëve tjerë dhe ftesës për të marrë pjesë në cilësinë e palës së dëmtuar, nga procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor nuk rezulton që prokurori i shtetit të ketë pasur pretendime apo vërejtje në këtë drejtim të cilat do t'i kishte ngritur gjatë rrjedhës së procedurës penale që është zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë.
29. Dhe *së treti*, sa i përket pretendimeve në lidhje me administrimin e provave tjera apo dëgjimin e dëshmitarëve tjerë, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton parimin themelor të procedurës penale se “jo çdo propozim i palëve për administrimin e provave të caktuara duhet që detyrimisht të aprovohet nga gjykata”.
30. Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se është nën autoritetin e gjykatave që të vlerësojnë në çdo rast konkret, nëse duhet aprovuar apo jo propozimet e tilla të palëve, duke e pasur parasysh natyrën e çështjes dhe specifikat e saj, rëndësinë e provës, si dhe fakteve që pretendohet të vërtetohen përmes provës së propozuar.
31. Në këtë drejtim, në nenin 252, paragrafi 2 i KPP-së (neni 258, paragrafi 2 i Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale) janë parashikuar situatat kur gjykata mund të mos e aprovojë propozimin e palëve për administrimin e provave të caktuara. Kështu, në nenin 252, paragrafi 2 të KPP-së është parashikuar se “*gjykata mund të ndalojë marrjen e provave: nëse marrja e provave të tilla për të plotësuar provat tjera është e panevojshme dhe e tepërt sepse çështja në fjalë është e njohur në vija të përgjithshme; nëse fakti që do të provohet është i parëndësishëm për vendimin apo është provuar; nëse prova është tërësisht e papërshtatshme, e pamundshme ose e paarritshme ose nëse kërkesa bëhet për të zvarritur procedurën*”.
32. Në këtë rast, nga shkresat e lëndës rezulton se gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor që është mbajtur në gjykatën e shkallës së parë janë administruar një numër i konsiderueshëm i provave, andaj edhe administrimi i provave tjera përmes të cilave

nuk do të mund vërtetohet ndonjë aspekt i rëndësishëm i çështjes penale nuk është i arsyeshëm dhe as i nevojshëm.

33. Sa i përket vendimit të gjykatës së shkallës së parë për anulimin e pjesërishtëm të urdhërësës së lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, PPP.KR.nr.222/2014, e datës 26.04.2016, me të cilin është vendosur që “Pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, titullarëve të këtyre paluajtshmërive-pronarëve iu lejohej disponimi me të gjitha autorizimet që burojnë nga të drejtat e pronësisë për këto ngastra kadastrale” dhe vendimit që “Palët e dëmtuara: familja P., familja N., dhe Agjencia e Privatizimit e Kosovës për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil”, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se arsyetimin e këtyre vendimeve duhet shikuar në kontekstin e tërë çështjes penale, arsyeve pse gjykata e shkallës së parë kishte lëshuar urdhërësën PPP.KR.nr.222/2014, e datës 26.04.2016 dhe mënyrës së vendosjes së kësaj çështje me aktgjykim nga gjykata e shkallës së parë.
34. Duke e pasur parasysh se të pandehurit: B.A., H. H., A. H., V. Sh., S. P., M. K., Xh. B., N. Sh., S. B., I. B., Sh. L., E. Ç., J. G., B. R., J. L. dhe A. H., janë liruar nga akuza, pasi që nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të njëjtit i kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar, atëherë edhe vendimet e gjykatës së shkallës së parë sa i përket këtyre dy (2) çështjeve vlerësohen të drejta dhe të ligjshme.
35. Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet që me rastin e vendosjes në lidhje me anulimin e pjesërishtëm të urdhërësës së lartcekur, gjykata në fjalë ishte bazuar në nenin 116 të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale, ku në paragrafin 1 të këtij neni është parashikuar se “*Sendet e sekuestruara përkohësisht gjatë procedurës penale i kthehen pronarit ose poseduesit kur procedura pezullohet ose pushohet dhe nuk ka bazë për konfiskimin e tyre*”.
36. Në anën tjetër, pavarësisht se nuk është arsyetuar shprehimisht vendimi në lidhje me udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil, siç është theksuar edhe më lart, një vendim të tillë duhet shikuar në kontekst tërë çështjes penale dhe mënyrës së vendosjes së kësaj çështje penale me aktgjykim nga gjykata e shkallës së parë, duke e pasur parasysh se në këtë rast është marrë aktgjykim lirues, pasi që nuk është provuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se të pandehurit e lartcekur i kanë kryer veprat penale për

të cilat janë akuzuar, kurse në nenin 463, paragrafi 3 të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale (tani neni 462, paragrafi 3 i KPP-së) ishte parashikuar se “*Kur gjykata marr aktgjykim me të cilin i pandehuri lirohet nga akuzat ose me të cilin akuzat refuzohet apo kur me aktvendim pushohet procedura penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil*”. Andaj, bazuar në këto arsye, rezulton se edhe vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil është i drejtë dhe gjen mbështetje në këto dispozita ligjore.

37. Gjithashtu, siç është theksuar edhe më lart, as aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk rezulton të jetë i përfshirë me shkelje tjera esenciale të dispozitave të procedurës penale apo me shkelje tjera të cilat do të mund të ndikonin në ligjshmërinë dhe drejtshmërinë e këtij aktgjykimi.
38. Pavarësisht faktit se disa pjesë të arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë janë tërësisht përshkruese të disa pjesëve të arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, megjithatë në pjesën tjetër të arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë janë ofruar arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat e rëndësishme në këtë çështje penale.
39. Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë shihet se janë vlerësuar pretendimet thelbësore ankimore të ngritura në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta sa i përket këtyre pretendimeve, por edhe sa i përket shkeljeve tjera për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, kështu që edhe në këtë drejtim, pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë rezultojnë të pabazuara.

7. Pretendimet në lidhje me shkeljen e ligjit penal

1. Kryeprokurori i Shtetit pretendon se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të përfshira edhe me shkelje të ligjit penal në favor të të pandehurve: B.A., H. H., A. H., V. Sh., S. P., M. K., Xh. B., N. Sh., S. B., I. B., Sh. L., E. Ç., J. G., B. R., J. L. dhe A. H. Kjo për faktin se gjykatat në fjalë kanë marrë aktgjykim lirues në kundërshtim me provat e shumta të cilat i ka ofruar prokurori i shtetit për secilin nga të pandehurit, të cilat prova dëshmojnë se të pandehurit ishin të përfshirë në shitblerjen e pronave, thjeshtë për të fshehur përfitimin e krimit, ku blerësit janë ose figura që janë të caktuara

në mënyrë specifike për të vepruar ose mashtrues, të cilët konsiderohen kryes të veprës penale “Pastrimi i parave”.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se kishin ndodhur tre (3) lloje të transferëve të pronës, objekt i “Aktakuzës së parë” dhe “Aktakuzës së dytë” dhe atë:

- a. Shitja mashtruese e ndërmarrë thjeshtë për të fshehur përfitimin e krimit, ku blerësit janë ose figura që janë të caktuara në mënyrë specifike për të vepruar ose mashtrues, prandaj ata janë bashkëkryes të veprës penale “Pastrimi i parave”;
 - b. Shitjet e vërteta kur blerësit janë në dijeni që pasuria është përfitim nga krimi, të cilin ata e blejnë me një çmim të konsiderueshëm nën vlerën e tregut dhe janë bashkëkryerës të veprës penale “Pastrimi i parave” dhe
 - c. Shitjet e vërteta ku blerësit nuk janë në dijeni ose nuk kanë arsye për të qenë në dijeni që pasuria është përfitim nga vepra penale, ata e blejnë në çmim që është koherent me vlerën e tregut, janë të besueshëm dhe nuk mund të konsiderohen bashkëkryes të veprës penale “Pastrimi i Parave”.
2. Me të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokurori i shtetit kishte dokumentuar se të pandehurit e lartcekur nuk i takojnë grupit të tretë të përshkruar më lart.
3. Gjithashtu, pretendohet se në arsyetimin e aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë vetëm ka dhënë një “vështrim” të përgjithshëm të cilësimit juridik të veprës penale, duke konkluduar se *“Në rastin konkret për tu gjetur në kushtet e kryerjes së kësaj vepre penale është e nevojshme që të pandehurit B. A. deri te i pandehuri A. H., duke e ditur ose ka pasur arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal (vijon me përshkrimin e dispozitës ligjore). Në rastin konkret, nuk jemi në përmbushje të asnjërit nga këto elemente qenësore të kësaj vepre penale, konsumimi i të cilave është i domosdoshëm për tu shpallur fajtor për kryerjen e të njëjtës”*.
4. Në fund, pretendohet se duke e pasur parasysh faktin se në këtë rast nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se paluajtshmëritë janë bartur

në emër të personave të tretë përmes falsifikimit të dokumenteve, atëherë konfiskimi i të njëjtave ka qenë i domosdoshëm dhe i detyrueshëm, edhe pse prokurori i shtetit e kishte kërkuar një gjë të tillë, ashtu që së paku të rikthejë pjesërisht pronën publike të Republikës së Kosovës, e cila ishte marrë përmes mashtrimeve nga grupi i organizuar kriminal, i cili ndiqet sipas “Aktakuzës së parë”, në rastin me numër të njëjtë të lëndës. Kjo për faktin se bazuar në dispozitat ligjore të nenit 92, paragrafi 1 të KPRK-së në fuqi “Pasuria apo mjeti që është përfituar me vepër penale konfiskohet sipas dispozitave të KPRK-së”.

8) *Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me pretendimet për shkelje të ligjit penal*

1. Gjykata Supreme e Kosovës i konsideron të pabazuara edhe pretendimet në lidhje me shkeljen e ligjit penal, pasi që gjykatat e instancave më të ulëta, drejtë kanë vepruar kur të dënuarit: B.A., H. H., A. H., V. Sh., S. P., M. K., Xh. B., N. Sh., S. B., I. B., Sh. L., E. Ç., J. G., B. R., J. L. dhe A. H., secilin veç e veç, i kanë liruar nga akuza, pasi që siç është theksuar edhe më parë, pas administrimit dhe vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka rezultuar që të jenë vërtetuar të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprave penale për të cilat të njëjtit janë akuzuar.
2. Me theks të veçantë për arsyet që janë paraqitur më parë, në këtë rast nuk është arritur që të provohet aspekti subjektiv i veprës penale (*mens rea*) për të cilën të njëjtit janë akuzuar, e që i referohet “dashjes, dijenisë dhe qëllimit të caktuar”, të cilat elemente, si të tilla janë pjesë përbërëse e figurës së kësaj vepre penale.
3. Në nenin 56, paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizimit të datës 25.05.2016, është parashikuar se veprën penale “Pastrimi i parave” e kryen “Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin IX të Kodit të procedurës penale të Kosovës, zhvillon veprimet e mëposhtme,”.

4. Bazuar në këtë dispozitë ligjore e cila është ekuivalente me dispozitat e ligjeve të mëparshme, por edhe duke u bazuar në dispozitat tjera të KPRK-së, rrjedh se elemente themelore të kësaj vepre penale konsiderohen edhe “dashja, dijenia dhe qëllimi i caktuar”, të cilat elemente, duke u bazuar në nenin 22 të KPRK-së mund të nxirren nga rrethanat faktike të rastit, i cili proces vie pas administrimit dhe vlerësimit të provave. Të gjitha këto elemente subjektive duhet t’i ndërlidhen me faktin se personi apo kryesi duhet të vërtetohet përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se duke e ditur ose duke pasur për të ditur, se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale ose duke besuar se pasuria e caktuar fitohet me ndonjë formë të aktivitetit kriminal...”, ndërmerr veprimet kryerëse që janë të përcaktuara në mënyrë alternative në dispozitën e lartcekur ligjore. Pra, për ekzistimin e kësaj vepre penale, nuk mjafton vetëm manifestimi i elementeve objektive të figurës së veprës penale (*actus reus*), por duhet që krahas këtyre, të vërtetohen edhe aspektet subjektive të veprës penale, të cilat aspekte, për arsyet e paraqitura më parë, nuk është arritur që të vërtetohen.
5. Gjithashtu, bazuar edhe në veprimet kryerëse të përshkruara në aktakuzë, në këtë rast, nga provat e procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është arritur që të vërtetohet as fakti që të pandehurit e lartcekur të kenë realizuar shitblerjen e pronave me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, sistemimit, lëvizjes dhe pronësisë apo në çfarëdo rrethanash, me qëllim të asistimit të të akuzuarve nga rasti i identifikuar si “Toka 1”, andaj edhe rrjedhimisht, në këto dimensione nuk kemi të bëjmë me shkelje të ligjit penal në favor të të pandehurve të lartcekur, siç pretendohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.
6. Në fund, janë vlerësuar si të pabazuara edhe pretendimet në lidhje me konfiskimin e pasurive të paluajtshme, duke pasur parasysh në këtë rast të pandehurit: B.A., H. H., A. H., V. Sh., S. P., M. K., Xh. B., N. Sh., S. B., I. B., Sh. L., E. Ç., J. G., B. R., J. L. dhe A. H., janë liruar nga akuza, për arsyet që janë paraqitur edhe më parë, pasi që nuk është vërtetuar se të njëjtit, të kenë pasur çfarëdo lidhje subjektive me të akuzuarit e rastit të identifikuar si “Toka 1”, apo që të pandehurit të kenë ditur apo kanë mundur të ishin në dijeni se vendimet gjyqësore, regjistri kadastral apo fletët poseduese të të akuzuarve nga rasti “Toka 1” të jenë siguruar nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal apo të jetë vërtetuar ndonjë marrëveshje në mes tyre për pastrimin e parave, andaj edhe si rezultat i kësaj, gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka anuluar pjesërisht

urdhëresën PPP.KR.nr.222/2014, e datës 26.04.2016, pasi që tani për tani nuk mund të zbatohen dispozitat ligjore të konfiskimit të këtyre paluajtshmërive, për arsyet që janë paraqitur më parë.

7. Duke u bazuar në arsytet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar, andaj edhe në bazë të nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.64/2024, i datës 17.04.2024

”Deklaratat e të pandehurit të dhëna në çfarëdo konteksti me vullnet dhe pa shtrëngim nuk mund të shpërbejnë si provë ndaj të bashkëpandehurve në të njëjtën procedurë penale apo edhe në procedurën e veçuar, përveç kur ky Kod në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se deklarata e tillë mund të shërbej si provë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.628/2014, të datës 07.06.2023, të dënuarit: A. D. dhe A. D., konform nenit 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), janë liruar nga akuza për shkak të veprave penale: “Vrasje e rëndë”, nga neni 147, paragrafi 1, nën-paragrafët 3 dhe 11 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe “Vrasje e rëndë” e mbetur në tentativë, nga neni 147, paragrafi 1, nën-paragrafët 3 dhe 11 lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së, ndërsa i pandehuri A. D., edhe për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”, nga neni 328, paragrafi 2 të KPK-së, pasi që nuk është provuar se të njëjtit i kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar.
2. Shpenzimet e procedurës penale është vendosur se do të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës, kurse të dëmtuarit: M. (Xh.) B., A. (R.) B., I. (A.) B., B. (A.) B., S. (A.) B. dhe A. (A.) B., të gjithë nga fshati ... (D.), komuna e K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.
3. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.41/2023, e datës 18.10.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa e ka hedhur si të palejuar ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar A. B., avokatit J. M.
4. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës

penale, kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, nga neni 432, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. lidhur me nenin 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. dhe nenin 369, paragrafi 7 të KPP-së; nenin 369, paragrafi 10 lidhur me nenin 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3.; nenin 346; nenin 7; nenin 345, paragrafi 2 dhe nenin 360 të KPP-së, me propozimin që të aprovet kjo kërkesë, ndërsa të konstatohet se aktgjykimet e lartcekura përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale, kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, shkelje këto në favor të të pandehurve: A. D., dhe A. D.

5. Përgjigje ndaj kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërinë kanë paraqitur:

- I pandehuri A. D., duke propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar, pasi që asnjëri nga pretendimet e paraqitura në të nuk qëndron, duke pasur parasysh se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje tjetër të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të ndikojnë në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, si dhe
- Mbrojtësja e të pandehurit A. D., avokatja K.K., e cila thekson se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar, për disa arsye. Së pari, e tërë përmbajtja e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë i referohet gjendjes faktike të vërtetuar me dy aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, kurse në anën tjetër, Prokurori i Shtetit i referohet në veçanti deklaratave të të dënuarve: Shpend Q. dhe B. H., si dhe familjarëve të të dënuarit B. H., e që një pretendim i tillë është i kundërligjshëm, pasi në nenin 119, paragrafi 5 të KPP-së, është parashikuar se *“Deklaratat e të pandehurit të dhëna në çfarëdo konteksti me vullnet dhe pa shtrëngim nuk mund të shërbejnë si provë ndaj të bashkëpandehurve në të njëjtën procedurë penale apo edhe në procedurën e veçuar, përveç kur ky Kod në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se deklarata e tillë mund të shërbejë si provë”*. Të dënuarit Sh. Q., dhe B. H., janë shpallur fajtor dhe janë dënuar me aktgjykim të formës së prerë për këtë çështje penale, pasi që është vërtetuar në mënyrë të pa kontestuar se të njëjtit e kanë kryer veprën penale, kurse sa i përket familjarëve të të dënuarit B. H., dhe dëshmitarëve tjerë, e po ashtu edhe të dëmtuarit B. B., absolutisht asnjëri nga ta nuk ka deklaruar apo vërtetuar ndonjë pretendim të aktakuzës. Në këtë rast, aktakuza i referohet në tërësi tani të ndjerit N. C., i cili me

aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza dhe kjo çështje penale kundër tij ishte “*res judicata*”, i cili ishte vlarë në mënyrë misterioze, pak kohë pas dëshmisë së tij në këtë çështje penale. Dispozitivi i aktakuzës është tejet konfuz dhe i paqëndrueshëm, duke u mbështetur në një sërë deklaratash të pabazuara dhe të mbështetura vetëm mbi bazë të thashethemeve të një grupacioni të caktuar të njerëzish (familjarë të të dënuarve: B. H. dhe Sh. Q.).

6. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e paraqitura në përgjigjet në këtë kërkesë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:
 - kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.
7. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë thekson se duke e pasur për bazë se në këtë rast kemi disa prova kundërtënëse, atëherë nëse lexohen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, vërehet që përpos përshkrimit të deklaratave të dëshmitarëve, nuk ka asnjë vlerësim, e aq më pak që nuk ka vlerësim të veçantë të saktësisë së këtyre provave kundërtënëse, që paraqet një standard më të lartë se pikat tjera të aktgjykimit, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 369, paragrafi 7 të KPP-së.
8. Mandej, pretendohet se në aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta nuk janë paraqitur asnjë vlerësim arsyetimi se përse u kërkoi dëshmitarëve betimin dhe përse pas betimit, sërish nuk u fali besimin, pasi që konsiderohet përgjithësisht, se kur një dëshmitar betohet, atëherë besueshmëria e atyre dëshmitarëve është e një shkalle pak më të lartë se sa kur nuk betohet.
9. Shkelje tjetër e dispozitave të procedurës penale pretendohet se është bërë edhe kur gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka urdhëruar marrjen e provave shtesë që nuk janë paraqitur nga palët, ashtu siç parashihet në nenin 346 të KPP-së, kur ato konsiderohen të domosdoshme për përcaktimin e të vërtetës, pasi që në rastin konkret dëshmitari F. H., e ka përmendur dëshmitarin S. S., por edhe tashmë të ndjerin A. H., ndërsa nga shkresat e lëndës, nuk rezulton që të njëjtit të jenë ftuar për të dhënë dëshmitë e tyre. Gjykata ka për detyrë që secilën çështje penale ta sqarojë deri në bazat e përtej çdo

dyshimi të bazuar dhe gjithashtu ka për detyrë që madje edhe nëse palët nuk e bëjnë një gjë të tillë, të urdhërojë prova shtesë.

10. Dhe në fund, në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendohet se pavarësisht faktit se në nenin 360 të KPP-së përcaktohet se gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtim gjyqësor, kjo nuk do të thotë me automatizëm se besimi duhet t'i falet vetëm deklaratave në seancën gjyqësore, e jo edhe deklaratave të bëra para policisë apo prokurorisë. Madje, gjykatat e kanë për detyrë që të arsyetojnë se cila deklaratë është më e besueshme dhe përse ka ndryshim të deklaratave, ndërsa një gjë e tillë ka ndodhur në faqen 10 të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë – pasuesi i parë apo pse nuk i është falur besimi deklaratës së dëshmitarit okular R. T.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e paraqitura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me shkelje të dispozitave të procedurës penale, në favor të të dënuarve: A. D. dhe A. D., të cilat do të mund të ndikojnë mandej në ligjshmërinë dhe drejtshmërinë e tyre.
2. Fillimisht, edhe në këtë çështje penale, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që të sqaron dy (2) aspekte të rëndësishme që ndërlidhen me kompetencat e saj dhe atë:
 3. *Së pari*, Gjykata Supreme e Kosovës, si autoriteti më i lartë gjyqësor në Republikën e Kosovës (neni 103.2 i Kushtetutës) nuk është “gjykatë e faktit” dhe sipas nenit 432, paragrafi 2 të KPP-së, *“kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike”*, andaj edhe pretendimet e tilla nuk mund të jenë arsye për paraqitjen e këtij mjeti juridik. Mbi bazën e këtyre të theksuarave, disa pretendime të ngritura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit këtë drejtim, nuk janë shqyrtuar fare nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe

4. *Së dyti*, bazuar në nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas kërkesës për mbrojtjen e ligëshmërisë, në parim, kufizohet vetëm në verifikimin e pretendimeve të paraqitura nga palët dhe personat tjerë të autorizuar në lidhje me shkeljet ligjore (*“Tantum devolutum quantum appellatum”*), ndërsa nuk shqyrton çështje tjera përtej këtyre pretendimeve.

5. Pas analizimit të aktgjykimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se nuk qëndrojnë pretendimet e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit se në këtë rast provat e proceduara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor nuk janë vlerësuar në mënyrën e parashikuar me ligj. Qëndron fakti se në këtë rast ekzistojnë prova të caktuara të cilat në lidhje me vërtetimin ose mos vërtetimin e fakteve të caktuara janë kundërtënëse, mirëpo të gjitha këto prova, por edhe provat tjera që janë proceduar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor janë vlerësuar duke i pasur në konsideratë kriteret ligjore të përcaktuara me nenin 360, paragrafi 2 të KPP-së, në të cilën dispozitë ligjore është parashikuar se *“gjykatat detyrohen që me ndërgjegje të vlerësojnë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrin përfundimin nëse fakti konkret është provuar”*. Në këtë rast, nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë shihet që secila provë, përkatësisht secila deklaratë e dëshmitarëve është vlerësuar në mënyrë individuale, ndërsa më pastaj në raport edhe me provat tjera që janë proceduar, kurse në fund janë nxjerrë përfundimet se cilat fakte janë provuar, përkatësisht nëse është arritur që të provohet ndonjë fakt relevant, në veçanti ndonjë fakt relevant që ndërliiden me përgjegjësinë penale të të pandehurve: A. D., dhe A. D., përkitazi me veprat penale për të cilat ishin akuzuar.

6. Përtej këtij aspekti, duke qenë se këtë rast kishte disa prova që në lidhje me vërtetimin ose mos vërtetimin e fakteve të caktuara ishin kundërtënëse, atëherë rezulton se vlerësimi i tyre është bërë duke e pasur në konsideratë edhe kriterin e përcaktuar në nenin 369, paragrafi 7 të KPP-së, në të cilën dispozitë ligjore është përcaktuar se *“saktësia e provave të tilla duhet të vlerësohet në mënyrë të veçantë”*. Pavarësisht faktit se në këtë dispozitë ligjore është parashikuar një standard më i lartë i vlerësimit të provave të tilla, megjithatë në këtë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar saktësisht se në çka konsiston një mënyrë e tillë e vlerësimit të saktësisë së provave kundërtënëse

dhe cili nivel duhet të arrihet për t'u konsideruar se është përmbushur një standard i tillë ligjor.

7. Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se një kriter i tillë i vlerësimit të saktësisë së provave kundërthënëse duhet shikuar dhe analizuar në rrethanat specifike të secilit rast veç e veç, duke e pasur parasysh edhe natyrën, kompleksitetin dhe shumë aspekte tjera që ndërliiden, si me faktet që pretendohet të vërtetohen, ashtu edhe me vetë përmbajtjen dhe natyrën e provave kundërthënëse. Gjithashtu, është e rëndësishme që të theksohet se tek *“vlerësimi në mënyrë të veçantë i saktësisë së provave kundërthënëse”* duhet të aplikohet edhe standardi i përcaktuar në nenin 360, paragrafi 2 të KPP-së (*“vlerësimi me ndërgjegje i çdo prove veç e veç dhe në lidhje me provat tjera”*), por kuptohet në një nivel më të lartë, përkatësisht në një mënyrë më të veçantë, ndërsa një gjë e tillë bëhet sipas bindjes së brendshme - subjektive të gjykatës / trupit gjykues, e cila bindje duhet të formohet mbi bazën e provave të proceduara në seanca të shqyrtimit gjyqësor. Në këtë rast, siç është theksuar edhe më lart, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës është arritur që saktësia e provave kundërthënëse të vlerësohet në mënyrë të veçantë, duke i pasur për bazë standardet e përcaktuara më lart, andaj edhe pretendimet e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit nuk qëndrojnë.
8. Në linjë me këtë mënyrë të vlerësimit të provave kundërthënëse, gjykata e shkallës së parë, gjithashtu ka paraqitur edhe arsye të qarta dhe të mjaftueshme për secilën provë veç e veç, se përse ju është falur besimi provave të caktuara, përkatësisht se përse nuk ju është falur besimi provave të tjera.
9. Padyshim se ndër provat e tilla kundërthënëse në kuptim të vërtetimit / mos vërtetimit të fakteve relevante kishin qenë edhe deklaratat e dy (2) tashmë të dënuarve me aktgjykim të formës së prerë për këto vepra penale për të cilat ishin akuzuar edhe të pandehurit: A. D. dhe A. D. dhe atë: Sh. Q. dhe B. H., por gjithashtu edhe deklarinimet e të pandehurit N. C.
10. Në lidhje me deklarinimet e tashmë të dënuarve: Sh. Q. dhe B. H., si dhe të pandehurit N. C., gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar dhe arsyetuar se deklarinimet e tyre nuk mund të merren si dëshmi mbi të cilat mund të bazohet aktgjykimi, pasi të njëjtit janë *“dëshmitarë të privilegjuar”*, në kuptim të nenit 123, paragrafi 1, nën-

paragrafi 1.3. të KPP-së, që të njëjtit kanë qenë në të njëjtën çështje penale me të pandehurit: A.D. dhe A. D., dhe nuk kanë qenë dëshmitarë bashkëpunues sipas nenit 231 të KPP-së.

11. Përkitazi me çështjen e lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton se në nenin 123, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së është parashikuar se *“Si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje i bashkëpandehuri derisa zbatohet procedurë e përbashkët apo e veçuar, përveç kur i bashkëpandehuri është dëshmitar bashkëpunues, sipas nenit 231 të këtij Kodi”*, kurse në nenin 119, paragrafi 5, fjalina e dytë të KPP-së është parashikuar se *“Deklaratat e të pandehurit të dhëna në çfarëdo konteksti me vullnet dhe pa shtrëngim nuk mund të shpërbejnë si provë ndaj të bashkëpandehurve në të njëjtën procedurë penale apo edhe në procedurën e veçuar, përveç kur ky Kod në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se deklarata e tillë mund të shërbej si provë”*.
12. Përtej këtij aspekti ligjor, është e rëndësishme që të theksohet se të dënuarit: B. H. dhe Sh. Q., pas dënimit nga Gjykata e Qarkut në P. me burgim afatgjatë, kanë vepruar kinse me qëllim të ndriçimit të rastit, duke bërë takime me anëtarët e familjeve të tyre derisa kanë qenë në B. e D., ashtu siç kanë deklaruar edhe dëshmitarët: M. Q., si dhe familjarët-të afërmit e të dënuarit B. H. dhe atë: F. H.; A. H., B. H. dhe F. H., të cilët nga shkresat e lëndës shihet se janë përpjekur që të mbështesin të dënuarit: B. H. dhe Sh. Q., për ta zbuluar të vërtetën dhe t'i detyronin të pandehurit: A. D. dhe A. D., sipas tyre ishin të përfshirë në veprat penale, sipas mendimit të tyre, që t'i pranonin përgjegjësitë e tyre, duke organizuar takime në Burgun e D dhe atë me avokatin T.R., por as nga përmbajtja e këtyre bisedave nuk mund të vërtetohen veprimet e të pandehurve: A. D. dhe A. D., të përshkruara në aktakuzë, pasi që në takimet e lartcekura, pjesëmarrësit tjerë kishin për qëllim që t'i bindin këta dy (2) të pandehur që ata ta pranonin përgjegjësinë e tyre.
13. Ndërsa, nga shkresat e lëndës shihet se hetimet ndaj të pandehurve: A. D., dhe A. D., ishin hapur vetëm pas deklaratave të të dënuarve: B. H. dhe Sh. Q., të dhëna në prokurori, pasi që ata veçse ishin gjykuar për veprën penale të njëjtë.
14. Në anën tjetër, gjykata e shkallës së parë kishte paraqitur arsye të mjaftueshme dhe kishte vlerësuar në mënyrë të veçantë edhe deklaratimet e dëshmitarëve: B., A., F. dhe F.

H., si dhe M. Q. e A. A., të cilat deklarime janë cilësuar si deklarime indirekte, pasi që këta dëshmitarë nuk kanë qenë në vendin e ngjarjes, por të njejtit vetëm kishin thënë gjëra, që ua kishin thënë të dënuarit: B. H. dhe Sh. Q. Në mënyrë të njejtë, janë vlerësuar edhe deklarimet e dëshmitarëve: A. K. dhe N. K., të cilët nuk e kishin parë ngjarjen drejtpërdrejt, por ata kishin folur vetëm për çështjen e automjetit, i cili është supozuar të jetë motivi i veprave penale, por këto deklarime janë vlerësuar si të pamjaftueshme për t'i bazuar akuzat e prokurorisë, pasi që këta dy (2) dëshmitarë nuk kishin qenë në gjendje që të thonin se në çfarë mase të pandehurit: A. D. dhe A. D., kanë qenë të interesuar dhe të përfshirë në shumën e parave që N. K. dhe tani i ndjeri N.B. duhej t'ia kthenin A. K.

15. Po ashtu, nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet se dëshmitari R. T., kishte qenë dëshmitar okular, mbi dëshminë e të cilit, gjykata, në gjykimin e parë e kishte bazuar vendimin e saj, ku i njëjti, si në fazën e hetimeve, ashtu edhe në fazën e shqyrtimit gjyqësor, kishte përmendur dy (2) njerëz në vendin e ngjarjes, të identifikuar si: B. H. dhe Sh. Q., kurse në anën tjetër, as dy (2) zyrtarët policor: N. A. dhe R. M., që kanë patrulluar në vendin e ngjarjes, nuk kishin parë të pandehurit: A. D. dhe A. D., në rrugën për te *“Ura e Lepencit”*.
16. Kurse, të pandehurit: A. D. dhe A. D., nga shkresat e lëndës shihet se e kanë mohuar kryerjen e veprave penale për të cilat ishin akuzuar, me ç’rast i pandehuri A. D., e kishte pohuar faktin se kishte bërë një vizitë te i dënuari B. H. në Burgun e D. së bashku me familjarët e të dënuarit në fjalë, të cilët ishin përpjekur që ta bindnin atë, për ta marrë përgjegjësinë e vrasjeve dhe tentim vrasjes, duke e detyruar të njëjtin që të shkonte në zyrën e avokatit T.R., të cilin e ka dëgjuar duke folur në telefon me prokurorin e rastit, me qëllim që i pandehuri A. D., të jepte dëshmi e cila do ta zbardhte rastin.
17. Të gjitha këto prova, por jo vetëm, rezultojnë se janë vlerësuar në mënyrë individuale, por edhe në raport me të gjitha provat tjera që janë proceduar gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i pasur në konsideratë edhe standardet përkatëse ligjore, ku gjykata e shkallës së parë pas një procesi të tillë, me të drejtë kishte konstatuar se prokurori i shtetit nuk kishte arritur që të paraqiste prova të mjaftueshme për të vërtetuar se të pandehurit: A. D. dhe A.D., të kenë kryer veprat penale për të cilat ishin akuzuar, duke i marrë për bazë edhe provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor ndaj tashmë të dënuarve: B. H.

dhe Sh. Q., i cili rast kishte përfunduar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 24.09.2012.

18. Mandej, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se bazuar në nenin 338, paragrafi 1 të KPP-së, gjykata (gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari i procedurës paraprake, kur vepron sipas nenit 147 të KPP-së), para marrjes në pyetje të dëshmitarit, mund të kërkojë dhënien e betimit. Në situata të tilla, betimi konsiderohet një akt formal dhe paraqet një mjet provues plotësues me të cilin mund të përforcohet dhënia e dëshmisë së dëshmitarit që ka dhënë betimin, mirëpo edhe një provë e tillë, përkatësisht dëshmia e dëshmitarit i cili ka dhënë betimin duhet që t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit dhe çmuarjes nga ana e gjykatës, sikurse provat tjera që janë proceduar në shqyrtim gjyqësor. Qëndron fakti se kur një dëshmitar betohet, atëherë besueshmëria e tij është e një shkalle pak më të lartë, mirëpo, vetëm një aspekt i tillë, përkatësisht vetëm fakti se një dëshmitar nën betim ka dhënë një dëshmi nuk nënkupton “*a priori*” se dëshmia e tij mund të shërben si provë, të cilës domosdoshmërisht duhet që t'i falet besimi nga ana e gjykatës, pasi që një gjë e tillë varet nga rrethanat specifike të secilit rast veç e veç, duke i pasur parasysh edhe provat tjera që janë proceduar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe vetë kredibilitetin e dëshmitarit përkatës.
19. I njëjti standard i përcaktuar më lart, vlen edhe sa i përket dëshmitarëve të caktuar të cilët kanë dhënë betimin në këtë çështje penale, për të cilët, gjykatat e instancave më të ulëta kanë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta se pse nuk ju është falur besimi, ndërsa i është falur besimi provave tjera që janë proceduar në shqyrtim gjyqësor, andaj, edhe pretendimet e Zyrës së Kryeprokuroorit të Shtetit edhe në këtë drejtim nuk qëndrojnë.
20. Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron të pabazuar edhe pretendimin e Zyrës së Kryeprokuroorit të Shtetit që ndërlidhet edhe me zbatimin e nenit 346 të KPP-së për marrjen e provave shtesë nga gjykata (“*ex officio*”), edhe pse të njejtat nuk janë paraqitur nga palët. Kjo për faktin se bazuar në nenin 346, paragrafi 1 të KPP-së, sigurimi i provave shtesë, sipas detyrës zyrtare nga ana e gjykatës, është vetëm një mundësi fakulative, por nuk është detyrim, siç pretendohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, ndërsa një mundësi e tillë fakulative vjen në shprehje vetëm në rastet kur konsiderohet e “domosdoshme” për përcaktimin e së vërtetës. Përkundrazi, Gjykata

Supreme e Kosovës thekson se në çështje penale të natyrës së tillë, është detyrim në radhë të parë, i prokurorit të shtetit që të ofron prova për të vërtetuar aspekte të rëndësishme që ndërlidhen me veprën penale përkatëse dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit. Pra, barra e të provuarit, kryesisht dhe në parim, bie mbi prokurorin e shtetit dhe një detyrim i tillë derivon nga vetë natyra e parimit të prezumimit të pafajësisë, që është i parashikuar dhe garantuar, jo vetëm me dispozitat ligjore vendore (dispozitat ligjore dhe kushtetuese), por edhe me dokumente të rëndësishme ndërkombëtare dhe është promovuar vazhdimisht edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (çështja “*Capeau kundër kundër Belgjikës*”, nr.42914/98, aktgjykimi i datës 13.01.2005, paragrafi 25; çështja “*Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës*”, nr.10590/83, aktgjykimi i datës 06.12.1988, paragrafi 77, etj.).

21. Gjithashtu, edhe në Direktivën nr.343/2016 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 09.03.2016, për fuqizimin e aspekteve të caktuara të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për të qenë prezent në gjykim në procedurë penale, në pikën 22, është parashikuar se “*Barra e provës për vërtetimin e fajësisë së të dyshuarve dhe të akuzuarve është e prokurorisë dhe çdo dyshim duhet të jetë në dobi të të dyshuarit apo të akuzuarit*”.
22. Pra, bazuar në këto që u theksuan më lart, rezulton qartë se gjykata ka të drejtë (neni 325, paragrafi 4 i KPP-së) dhe mundësi (neni 346, paragrafi 1 i KPP-së) që gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, “*ex officio*” të urdhëron shqyrtimin e provave të caktuara, nëse një gjë e tillë është e “domosdoshme” për përcaktimin e së vërtetës, mirëpo tek rastet e veprave penale të tilla, për të cilat janë akuzuar të pandehurit: A. D. dhe A. D., në radhë të parë, barra e propozimit dhe sigurimit të provave që ndërlidhen me veprën penale përkatëse dhe përgjegjësinë penale eventuale të të pandehurit, bie mbi prokurorin e shtetit.
23. Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron të pabazuar edhe pretendimin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit në lidhje me çështjen e vlerësimit të deklaratave të dhëna në polici dhe para prokurorit të shtetit, në raport me ato të dhëna në seanca të shqyrtimit gjyqësor, për faktin se edhe në këtë aspekt, gjykata e shkallës së parë rezultoi se ka qenë konsistente, pasi që në aktgjykimin e saj ka paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me deklaratimet e dëshmitarëve, si të atyre të dhëna në procedurën

paraprake dhe në gjykimin e parë që ishte zhvilluar ndaj tani të dënuarve: B. H. dhe Sh. Q., ashtu edhe sa i përket deklarimeve të paraqitura gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësore në çështjen penale ndaj të pandehurve: A. D. dhe A. D.

24. Në këtë drejtim, kur bëhet fjalë për deklaratimet e dëshmitarit R. T., në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur arsye të mjaftueshme se pse gjykata në fjalë i kishte vlerësuar si të besueshme deklaratimet e tij të dhëna në procedura të mëparshme, duke mos i marrë për bazë deklaratimin e tij të mëvonshëm, pasi që është konstatuar se shmangia e këtij dëshmitari nga deklaratimet e tij të mëparshme, ishte bërë pas takimeve që kishte pasur me familjarët e tani të dënuarve: B. H. dhe Sh. Q., të cilët pas dënimit të tyre me aktgjykim të formës së prerë, vazhdimisht kishin bërë përpjekje për ndryshimin e rrethanave dhe versionit të ngjarjes, duke kontaktuar edhe vetë të pandehurin A. D., i cili edhe kishte shkuar në Burgun e D. për ta vizituar të dënuarin B. H.
25. Përndryshe, duhet theksuar se tani në nenin 334 të KPP-së është parashikuar në mënyrë shprehimore edhe mundësia e përdorimit të dëshmisë së mëparshme të personave (në këtë rast të dëshmitarëve), nëse gjykata bindet se personat në fjalë i janë nënshtruar ndërhyrjes, siç është situata në rastin konkret.
26. Kështu, në paragrafin 1 të këtij neni është parashikuar se *“Marrja në pyetje në procedurë paraprake dhe deklaratat në procedurë paraprake pranohen dhe mund të përdorën si dëshmi e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit gjyqësor, nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues bindet se dështimi i personit për të dhënë dëshmi ose për të dëshmuar ndryshe nga provat e dhëna në marrjen në pyetje në procedurë paraprake ose deklaratat e procedurës paraprake është ndikuar nga ndërhyrje e padrejtë, duke përfshirë kërcënimet, frikësimin, lëndimin, ryshfetin ose detyrimin”*. Kurse, kurse në paragrafin 2 të këtij neni është parashikuar se *“Për qëllime të paragrafit 1 të këtij neni, ndërhyrja e padrejtë mund të lidhet me interesat fizike, ekonomike, pronësore ose të tjera të personit ose të një personi tjetër”*.
27. Në fund, si rezultat i të gjitha këtyre që u paraqiten më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur deri tek konkludimi se përmes aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se gjykata në fjalë ka përbushur edhe detyrimet e saj për të paraqitur arsye

edhe sa i përket çështjeve tjera, referuar nenit 369, paragrafit 7 të KPP-së. Në këtë kontekst, nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet që janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe në mënyrë të plotë arsye mbi bazën e të cilave, gjykata në fjalë ka konstatuar se në këtë rast nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të pandehurit: A. D. dhe A. D., t'i kenë kryer veprat penale për të cilat ishin akuzuar, ashtu siç është parashikuar në nenin 369, paragrafi 10 të KPP-së.

28. Gjithashtu, edhe nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë rezulton se janë vlerësuar të gjitha pretendimet e rëndësishme ankimore të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta sa i përket këtyre pretendimeve.
29. Në këtë mënyrë, duke u bazuar në arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.113/2024, i datës 23.04.2024

”Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë ka përgjegjësinë që t’i vlerëson pretendimet e paraqitura në ankesë dhe të tregojnë shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare. Megjithatë, duhet theksuar se detyrimi i gjykatave (në këtë rast edhe i Gjykatës së Apelit të Kosovës) që të paraqesin arsye në vendimet përkatëse gjyqësore, nuk nënkupton përgjigje të hollësishe në çdo pretendim dhe argument të palëve. Vëllimi dhe shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye, ndryshon varësisht nga natyra e vendimit gjyqësor dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të secilit rast veç e veç“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.1/2023, të datës 12.05.2023, i dënuari A. S., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Lëndimi i rëndë trupor”, nga neni 189, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.1. të KPRK-së (Kodi Nr. 04/L-082 i datës 20.04.2012) dhe ndaj të njëjtit për shkak të kryerjes së kësaj vepre penale është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) vjetëve, në të cilin dënim do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 07.04.2018 e tutje. Ndaj të dënuarit A. S., është vazhduar paraburgimi derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, kurse pala e dëmtuar – Sh. M., nga fshati ..., komuna e S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil. Është detyruar i dënuari A. S. që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëmijë (1,000) euro dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumë prej pesëdhjetë (50) euro, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.482/2023, të datës 06.10.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar – Sh. M., dhe të mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit A. S., avokati Besnik Berisha, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, duke propozuar që aktgjykimet e lartcekura të gjykatave të instancave më të ulëta të anulohen, ashtu që çështja penale t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë, tek një tjetër trup gjykues ose aktgjykimet e lartcekura të ndryshohen, ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza apo ndaj të ndaj të dënuarit të shqiptohet një sanksion më i ulët.

4. Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.66/2024, e datës 26.02.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A. S., të refuzohet si e pabazuar.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pas i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe nga përgjigja në këtë kërkesë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

6. Mbrojtësi i të dënuarit A. S., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se gjykata e shkallës së dytë nuk ka shqyrtuar, analizuar dhe vlerësuar pretendimet specifike ankimore të mbrojtjes, por që e njëjta gjykatë vetëm se i ka përsëritur qëndrimet juridike dhe faktike të gjykatës së shkallës së parë.
7. Pretendohet se në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë janë paraqitur arsye kontradiktore dhe konkludime të paqëndrueshme sa i përket veprës penale, natyrës së lëndimeve që ka pësuar i ndjeri D. M., përgjegjësisë penale të të dënuarit A. S., raportit të autopsisë, si dhe në raport me vlerësimin e provave tjera që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, në veçanti: sqarimet e ekspertit mjeko ligjor Dr. D. H., si dhe deklarimet e dëshmitarëve N. K., Sh. M., B. B., D. A., dhe L. S., pastaj dështimit të gjykatës së shkallës së parë për të kryer rikonstrukcionin e vendit të ngjarjes dhe për të ndërmarrë veprimet tjera procedurale të theksuara me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.600/2022, të datës 15.12.2022,

me të cilin ishte vendosur që të kthehet çështja në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, duke përfshirë këtu edhe aspekte tjera që ndërlidhen me shkallën e përgjegjesisë penale, përkatësisht gjendjen e dehur të të dënuarit natën kritike.

8. Sipas mbrojtjes, gjykata e shkallës së dytë, përveç që nuk ka arritur që të vlerëson në mënyrën e duhur provat kundërtënëse të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, ajo në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka krijuar një identitet të ri faktik, në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, kurse në anën tjetër, nuk është arritur që të paraqiten arsye të qëndrueshme në drejtim të vlerësimit të mbrojtjes së të dënuarit A. S.
9. Gjithashtu, në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtja e të dënuarit pretendon se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të përfshira edhe me shkelje të ligjit penale, nga neni 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPP-së, sepse në këtë rast është zbatuar ligji penal i pafavorshëm për të dënuarin A. S. Në këtë drejtim, në vend se të zbatohet neni 186, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.2. lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.1. të KPRK-së (Kodi Nr.06/L-074), si normë penale më e favorshme për të dënuarin A.S., në këtë rast është zbatuar neni 189, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.1. të KPRK-së (Kodi Nr.04/L-082).
10. Sipas mbrojtjes, neni 186, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.2. lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.1. të KPRK-së (Kodi Nr.06/L-074), përbën normë penale më të favorshme, në raport me nenin 189, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.1. të KPRK-së (Kodi Nr.04/L-082), pasi që në këtë normë është përcaktuar kufiri maksimal i dënimit deri në dhjetë (10) vjet, i cili nuk përcaktohet me normën penale të zbatuar, në raport me të cilën normë, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë edhe mendimin juridik nr.578/2016, të datës 10.11.2016.
11. Në këtë mënyrë, zbatimi i gabuar i ligjit penal në dëm të të dënuarit A. S., reflektohet edhe në lartësinë e dënimit më burgim të shqiptuar në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) vjet, i cili dënim tejkalon kufirin maksimal të dënimit me burgim prej dhjetë (10) vjet, të përcaktuar në nenin 186, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.2. lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.1. të KPRK-së (Kodi Nr.06/L-074).

12. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë e ka dënuar të dënuarin A. S., që prezumohet se ka rrezikuar jetën e tashmë të ndjerit D. M., me një sanksion penal dukshëm më të lartë se të dënuarin F. M., që me veprimet e tij ka shkaktuar vdekjen e të ndjerit, kurse në anën tjetër, pretendohet se nuk janë vlerësuar në mënyrën e duhur edhe rrethanat përkatëse që janë konsideruar si rrethana rënduese.
13. Në vijim të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë janë listuar edhe disa pretendime tjera që ndërlidhen me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, shkelje këto të parapara me nenin 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. lidhur me nenet 3, paragrafi 2 (“*In Dubio Pro Reo*”); 7, paragrafi 2; 8, paragrafi 2; 9, paragrafi 1; 360, paragrafi 2; 369, paragrafi 7 dhe neni 406, paragrafi 3 të KPP-së.
14. Përndryshe, duhet theksuar se në disa pjesë të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë rezulton se janë paraqitur pjesë të shkëputura të procesverbalit të seancave të shqyrtimit gjyqësor, duke paraqitur pyetjet konkrete të parashtuara, si dhe përgjigjes specifike të dëshmitarëve të caktuar.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit A. S., konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç pretendohet në kërkesë, mirëpo me këto aktgjykime është shkelur ligji penal sipas nenit 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPP-së në dëm të të dënuarit, siç me të drejtë pretendohet edhe në kërkesë, ndërsa një shkelje e tillë e ligjit penal, mandej ka rezultuar edhe më shqiptimin e një dënimi më të rëndë, siç do të elaborohet në vijim.
2. Sa i përket pretendimeve për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç është theksuar edhe më lart, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit A.S., nuk qëndrojnë, pasi që si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas dispozitave përkatëse ligjore, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsytimit.

3. Duke e përjashtuar kualifikimin ligjor të veprës penale, dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, në pjesët tjera, përmban të gjitha elementet e nevojshme, ashtu siç është parashikuar në nenin 369, paragrafët 3 - 4 të KPP-së dhe në asnjë rrethanë nuk rezultojnë që të jetë i paqartë apo në kundërtë me arsyetimin, si dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilat janë vlerësuar si prova të besueshme dhe kredibile.

4. Duke ju referuar pretendimeve të mbrojtjes, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta për të gjitha pikat e aktgjykimit (duke mos e llogaritur kualifikimin ligjor të veprës penale), ashtu siç parashihet në nenin 369, paragrafët 6 dhe 7 të KPP-së dhe se përshkrimet e dhëna në arsyetimin e këtij aktgjykimi, përmbajnë të gjitha arsyet për faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërtë nëse apo të mangëta.

5. Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet se në këtë rast janë vlerësuar dhe analizuar në mënyrë të duhur të gjitha provat që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, ashtu siç është parashikuar në nenin 360, paragrafi 2 të KPP-së, ku më pastaj, pas një procesi të tillë, janë nxjerrë konkluzionet e caktuara, që kanë të bëjnë si me gjendjen faktike, ashtu edhe aspekte tjera juridike. Në këtë drejtim, rezultojnë se janë analizuar dhe vlerësuar përveç tjerash, edhe deklaratimet e dëshmitarëve, mendimet dhe konstatimet e ekspertëve mjeko-ligjor, të cilat gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të detajuar ka elaboruar dhe sqaruar eksperti mjeko ligjor Dr. D. H., ndërsa më pastaj, janë nxjerrë konkluzione të caktuara, të cilat si të drejta dhe të ligjshme pranohen edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.

6. Për secilën provë të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe deklaratimet e dëshmitarëve: Shk. M., D. A., A. N., L. K., L. S., N. K., M. Ll., B. B., Sh. M., Dr. A. H. dhe Dr. A. M., ekspertëve mjeko-ligjor Dr. F. D., dhe Dr. D. H., provat materiale, mandej edhe mbrojtjen e të dënuarit A.S., gjykata e shkallës së parë rezultojnë se ka bërë një vlerësim dhe analizim të duhur, duke çmuar besueshmërinë, rëndësinë dhe vlerën provuese të secilës provë veç e veç dhe në lidhmëri me provat tjera, duke e krahasuar mandej edhe me mbrojtjen e të dënuarit.

7. Gjithashtu, nga shkresat e lëndës shihet se gjykata e shkallës së parë ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe ka pasur parasysh udhëzimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës, të theksuara në aktvendimin PAKR.nr.600/2022, të datës 15.12.2022, kur ishte vendosur që të kthehet rasti në rigjykim, andaj edhe në këtë drejtim, nuk bëhet fjalë për cenim të nenit 406, paragrafi 3 të KPP-së, pasi që pikërisht nga dëgjimi i dëshmitarëve, por edhe të ekspertit mjeko – ligjor, edhe pastaj nga mbrojtja e vetë të dënuarit A. S., kishte argumentuar se në këtë rast ishte arritur që të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se i dënuari e kishte kryer veprën penale për të cilën ishte akuzuar, andaj edhe pretendimet e mbrojtjes në këtë drejtim nuk qëndrojnë.
8. Sa i përket çështjes së rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, nga shkresat e lëndës shihet se gjykata e shkallës së parë kishte dalë në vendin e ngjarjes për të bërë shikimin e vendit ku është kryer vepra penale, ku edhe kishte konstatuar dhe arsyetuar se pse nuk mund të bëhet rikonstruksioni i vendit të ngjarjes.
9. Po ashtu, nga shkresat e lëndës rezulton se konstatimet dhe arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me përgjegjësinë penale të të dënuarit A. S., kanë mbështetje në provat e administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, pasi që nga deklaratimet e disa dëshmitarëve shihet që është argumentuar se natën kritike të ndjerin D. M., e kishte goditur fillimisht i dënuari dhe atë me një mjet të fortë, përkatësisht me një dorëz (kondak) të thikës, e që këto aspekte është arsyetuar se janë vërtetuar përveç me deklaratimet e dëshmitarëve: N. K., Sh. M. dhe B. B., edhe nga provat materiale të cilat gjenden në shkresa të lëndës, mandej nga ekspertiza mjeko - ligjore, por edhe deklarata e ekspertit mjeko – ligjor Dr. D. H., i cili kishte paraqitur sqarimet e duhura në lidhje me këtë ekspertizë. Në anën tjetër, edhe vetë i dënuari A. S., nuk i kishte mohuar faktet se si kishte ardhur deri tek konflikti fizik me të ndjerin D. M., natën kritike në kafene, mirëpo duke e mohuar faktin se e kishte goditur të ndjerin, e cila rrethanë, siç është theksuar edhe më lart, është arsyetuar mjaftueshëm se është argumentuar nga provat tjera që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor.
10. Nga shkresat e lëndës, po ashtu shihet se eksperti mjeko - ligjor Dr.D. H., në seancën e shqyrtimit gjyqësor kishte sqaruar në mënyrë detale shkaqet e vdekjes së të ndjerit D. M., ku kishte konstatuar se te dy plagët që kishte pësuar i ndjeri kishin qenë vdekje prurëse, përkatësisht kishin qenë shkaktar të vdekjes së të ndjerit dhe se edhe njëra dhe

tjetra do të shkaktonin vdekjen e të ndjerit, si pasojë e grumbullimit të gjakut në kokën e të ndjerit, kurse nga provat tjera që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe bindëse se njërën plagë e kishte shkaktuar fillimisht i dënuari A. S., kurse plagën tjetër e kishte shkaktuar i dënuari tjetër F. M., të cilin fakt e kishte pranuar edhe vetë i dënuari në fjalë. Gjithashtu, eksperti në fjalë shihet se ka sqaruar se te këto dy plagë të shkaktuara janë të ndara dhe nuk kanë lidhmëri ndërmjet veti, kurse secila prej këtyre dy plagëve ka qenë vdekje prurëse dhe se po të ekzistonte vetëm njëra plagë, pasoja do të ishte prapë vdekje prurëse.

11. Gjykata Supreme e Kosovës i konsideron të pabazuara edhe pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit A. S., që ndërlidhen me parimin "*In Dubio Pro Reo*", sipas nenit 3, paragrafi 2 të KPP-së, pasi që në këtë rast nuk ekziston asnjë mëdyshje lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen në drejtim të përgjegjësisë penale të të dënuarit, kurse në anën tjetër, nuk është vërejtur që në këtë rast të jenë cenuar as nenet 8, paragrafi 2 dhe 9, paragrafi 1 të KPP-së, pasi që gjykata e shkallës së parë e ka bazuar aktgjykimin e saj në provat e shqyrtuara dhe të verifikuara në shqyrtim gjyqësor, ndërsa mbrojtja nuk është vërejtur që të ketë pasur pozitë të pabarabartë me organin e akuzës.
12. Gjykata Supreme e Kosovës i konsideron si të pabazuara edhe pretendimet e mbrojtjes në drejtim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, pasi që nga arsyetimi i aktgjykimit në fjalë rezulton se janë shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore thelbësore të mbrojtjes të paraqitura në ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.
13. Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë rezulton se janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe konkludime të qëndrueshme sa i përket pretendimeve përkitazi me veprën penale, natyrën e lëndimeve që ka pësuar i ndjeri D. M., dhe përgjegjësinë penale të të dënuarit A. S., por edhe sa i përket aspekteve tjera që ndërlidhen me shkallën e përgjegjësisë penale, përkatësisht gjendjen e dehur të të dënuarit natën kritike dhe çështje tjera të rëndësishme.
14. Gjykata Supreme e Kosovës edhe në këtë çështje penale e shih të nevojshme që të sqarohet se referuar nenit 404, paragrafi 1 të KPP-së, Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë ka përgjegjësinë që t'i vlerëson pretendimet e paraqitura në

ankesë dhe të tregon shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare. Megjithatë, duhet theksuar se detyrimi i gjykatave (në këtë rast edhe i Gjykatës së Apelit të Kosovës) që të paraqesin arsye në vendimet përkatëse gjyqësore, nuk nënkupton përgjigje të hollësishme në çdo pretendim dhe argument të palëve. Vëllimi dhe shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye, ndryshon varësisht nga natyra e vendimit gjyqësor dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të secilit rast veç e veç.

15. Në këtë drejtim, është e rëndësishme që të sqarohet se janë argumentet thelbësore të palëve që duhet të adresohen dhe vlerësohen, ndërsa aspekte të tilla janë theksuar qartësisht edhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në praktikën e saj gjyqësore (rasti “*Hiro Balani kundër Spanjës*”, aktgjykimi i datës 09.12.1994, paragrafi 27; rasti “*Van de Hurk kundër Holandës*”, aktgjykimi i datës 19.04.1994, paragrafi 61; rasti “*Higgins dhe të tjerët kundër Francës*”, aktgjykimi i datës 19.02.1998, paragrafi 42. etj.). Se çka konsiderohet argument dhe pretendim thelbësor, varet nga specifikat e secilit rast veç e veç, ndërsa në këtë çështje penale, rezulton se Gjykata e Apelit e Kosovës i ka vlerësuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet thelbësore të mbrojtjes të ngritura në ankesën kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë.
16. Bazuar në këto që u theksuan më lart dhe referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ankesa kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë, por jo vetëm, mund të përmban edhe pretendime të caktuara të cilat nuk do të thotë se çdo herë duhet të konsiderohet si “pretendime thelbësore” të çështjes përkatëse, ndërsa vetëm pretendimet thelbësore, të cilat konsiderohen si të tilla, duhet që të jenë objekt i trajtimit dhe vlerësimit nga gjykata e shkallës së dytë, përkatësisht nga Gjykata e Apelit e Kosovës. Andaj, edhe në këtë drejtim, pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk janë të bazuara.
17. Mirëpo, pretendimet e mbrojtjes në lidhje me shkeljet e ligjit penal, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të bazuara, pasi që në këtë rast është shkelur ligji penal nga neni 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPP-së në dëm të të dënuarit A. S., ngase lidhur me veprën penale të gjykuar është zbatuar ligji penal që nuk mund të zbatohet, ndërsa një aspekt i tillë ka reflektuar edhe me shqiptimin e një dënimi më të rëndë.

18. Kështu, nga shkresat e lëndës shihet se i dënuari A. S., ishte akuzuar për shkak të veprës penale “Lëndimi i rëndë trupor”, nga neni 189, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr. 04/L-082 i datës 20.04.2012) dhe për këtë vepër penale, është shpallur fajtor me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, i cili aktgjykim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit e Kosovës. Bazuar në shkresat e lëndës dhe në kualifikimin ligjor të veprës penale rezulton se figura e kësaj forme të veprës penale përbëhet nga shkaktimi i lëndëve të rënda trupore të personit tjetër me mjet të rrezikshëm dhe duke e rrezikuar jetën e personit tjetër. Duke u bazuar në nenin 189, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.1. të KPRK-së (Kodi Nr. 04/L-082 i datës 20.04.2012) rezulton se për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar “dënim me burgim jo më pak se tre (3) vjet”, çka do të thotë që në këtë dispozitë ligjore është përcaktuar vetëm minimumi i posaçëm i dënimit me burgim, por nuk është përcaktuar maksimumi i posaçëm i dënimit me burgim. Në situata të tilla, kur nuk përcaktohet maksimumi i posaçëm i dënimit, në këtë rast i dënimit me burgim, atëherë duhet të zbatohen dispozitat përkatëse ligjore që përcaktojnë maksimumin e përgjithshëm të dënimit përkatës, përkatësisht të dënimit me burgim. Në këtë mënyrë, sa i përket veprës penale të lartcekur, përkitazi me maksimumin e dënimit me burgim duhet të zbatohet neni 45, paragrafi 1 i KPRK-së (Kodi Nr. 04/L-082 i datës 20.04.2012), në të cilën dispozitë ligjore është parashikuar se dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet më tepër se njëzetepesë (25) vjet. Në këtë mënyrë, duke u bazuar në këto që u theksuan më lart, rrjedhimisht mund të konstatohet se për veprën penale “Lëndimi i rëndë trupor”, nga neni 189, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr. 04/L-082 i datës 20.04.2012) është parashikuar dënim me burgim jo më pak se tre (3) vjet deri në njëzetepesë (25) vjet. Ndërsa, në nenin 186, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.2. lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr. 06/L-074 i datës 23.11.2018), në të cilën është parashikuar vepra penale “Lëndimi i rëndë trupor”, të kryer me mjet të rrezikshëm dhe që ka rezultuar me rrezikimin e jetës së personit tjetër është parashikuar dënim me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

19. Pra, nga kjo që u theksua më lart, shihet se Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Kodi Nr. 06/L-074 i datës 23.11.2018), konsiderohet “ligj më i favorshëm” për të dënuarin

A. S., pasi që për formën e njëjtë të veprës penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor ka parashikuar dënim më të butë, në krahasim me Kodin Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr. 04/L-082 i datës 20.04.2012), i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Në të dyja këto kode (neni 3, paragrafët 1 dhe 2) është parashikuar se *“Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Në rast se ligji ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm”*.

20. Mbi bazën e të gjitha këtyre që u paraqiten më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në këtë rast është dashur që i dënuari A. S., të shpallet fajtor për shkak të veprës penale “Lëndimi i rëndë trupor”, nga neni 186, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.2. lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr. 06/L-074 i datës 23.11.2018), duke i zbatuar dispozitat ligjore të këtij Kodi, pasi që konsiderohet ligj më i favorshëm për të dënuarin, ndërsa mos zbatimi i këtyre dispozitave ligjore ka rezultuar edhe me shkeljen e ligjit penal në dëm të të dënuarit në fjalë, siç është cekur edhe më lart.
21. Referuar këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se është parim themelor i së drejtës penale që “ndaj kryesit (të pandehurit) të zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale”, mirëpo, nëse ligji në fuqi ka ndryshuar para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë gjykatat janë të detyruar që ta zbatojnë “ligjin më të favorshëm”. Me fjalë të tjera, zbatimi i ligjit më të favorshëm është detyrim, ndërsa se kur konsiderohet se ligji është apo jo më i favorshëm, kjo varet nga specifikat e secilit rast veç e veç. Padyshim, se njëra prej aspekteve që duhet vlerësuar në këtë drejtim, është edhe dënimi i parashikuar për veprën penale përkatëse, nëse ligji i ri ka parashikuar dënim më të butë për veprën penale përkatëse, atëherë si i tillë duhet trajtuar si ligj më i favorshëm për kryesin e veprës penale, përkatësisht të pandehurin, siç është situata me rastin konkret.
22. Andaj, edhe mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në këtë drejtim është e bazuar dhe vendosi që të ndryshojë aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta vetëm sa i përket kualifikimit ligjor të veprës penale dhe dënimit të shqiptuar, ashtu që veprimet kryerëse të të dënuarit A. S., të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimet të gjykatës së

shkallës së parë janë kualifikuar si vepër penale “Lëndimi i rëndë trupor”, nga neni 186, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.2. lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr. 06/L-074 i datës 23.11.2018) dhe ndaj të dënuarit në fjalë për shkak të kryerjes së kësaj vepre penale shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nëntë (9) vjetëve, kurse në pjesët tjera, aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta do të mbeten të pandryshuara.

23. Më rastin e caktimit të kohëzgjatjes së dënimit me burgim ndaj të dënuarit A. S., përveç vlerësimit të aspekteve dhe kritereve të parashikuara në nenin 69, paragrafët 1 -3 të KPRK-së (Kodi Nr. 06/L-074 i datës 23.11.2018), Gjykata Supreme e Kosovës e ka marrë për bazë si rrethanë rënduese edhe faktin se goditja me mjet të rrezikshëm – dorëz (kondak) të thikës nga ana e të dënuarit kishte shkaktuar plagën e cila nga ekspertët mjeko-ligjor është kualifikuar si “plagë vdekje prurëse”, të cilën çështje gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor e ka sqaruar në mënyrë të hollësishme edhe eksperti i mjekësisë ligjore Dr. D. H., ndërsa një rrethanë i tillë nuk përbën element të figurës së veprës penale, përkatësisht të kualifikimit ligjor të veprës penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor i dënuari në fjalë. Gjithashtu, si rrethanë rënduese janë vlerësuar edhe sjelljet e të dënuarit A. S., pas kryerjes së veprës penale, pasi që nga shkresat e lëndës shihet se i njëjti së bashku me të dënuarin F. M., si dhe me disa dëshmitarë të tjerë kishin bërë përpjekje për t’iu shmangur përgjegjësisë penale, duke realizuar takime me dëshmitarë të caktuar, me qëllim dhënies dhe ndryshimit të dëshmimeve në favor të tyre. Ndërsa, në anën tjetër, duke u bazuar edhe në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si rrethana lehtësuese për të dënuarin A. S., janë vlerësuar gjendja e dobët ekonomike në familjen e tij, niveli i ulët i shkollimit dhe fakti se i njëjti është prind i tre (3) fëmijëve.

24. Në fund, duhet përmendur se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë përmban edhe pretendime të caktuara që në një mënyrë ndërliken edhe me gjendjen faktike, mirëpo, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se konform nenit 432, paragrafi 2 të KPP-së, ky mjet i jashtëzakonshëm juridik nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, andaj edhe rrjedhimisht pretendimet e tilla nuk janë shqyrtuar fare.

25. Në këtë mënyrë, nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A.S. është e bazuar, kështu që duke u bazuar në nenin 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.303/2024, i datës 12.06.2024

”Pranimi i fajësisë është e drejtë ekskluzive e të pandehurit dhe pavarësisht faktit se gjykata para se të vendos që të miraton ose jo pranimin e fajësisë duhet që të merr pikëpamjet e prokurorit të shtetit, mbrojtësit, të dëmtuarit ose viktimës (neni 242, paragrafi 5, fjalia e fundit e KPP-së), kjo parimisht nuk nënkupton se pikëpamjet e subjekteve të tilla janë të detyrueshme dhe faktor determinues, nëse duhet miratuar apo jo pranimin e fajësisë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.83/2005, të datës 09.01.2024, i dënuari R. P., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Vrasja” e mbetur në tentativë, nga neni 30, alineja 1 të LPK-së lidhur me nenin 19 të LPJ-së dhe për këtë veprë penale është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.
2. Duke u bazuar në nenin 362, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ndaj të dënuarit R. P., është refuzuar akuza për shkak të veprës penale “Zotërimi, kontrollimi, posedimi apo përdorimi i armës” nga neni 8.2. lidhur me nenin 8.6. të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/7, të datës 04.06.2001, ndërsa është konfiskuar revolja e markës “TT”, me numër serik 204089, e kalibrit 7.62x25 dhe është urdhëruar Policia e Kosovës që këtë armë ta shkatërroj sipas procedurave përkatëse ligjore.
3. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin e PAKR.nr.165/2024, e datës 12.04.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e paraqitura, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
4. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligshmërisë kanë paraqitur:

- i dënuari R. P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozimin që Gjykata Supreme e Kosovës t’i anulojë

aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë dhe

- mbrojtësi i të dënuarit R. P., avokati D. D., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, me propozimin që Gjykata Supreme e Kosovës t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

5. Kryeprokurori i Shtetit, me shkresat KMLP.II.nr.203/2024, e datave 21.05.2024 dhe 27.05.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të të dënuarit dhe mbrojtësit të tij, të refuzohet si të pabazuara.

6. Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, si dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe përgjigjen në kërkesa të Kryeprokurorit të Shtetit, gjeti se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të pabazuara.

7. Fillimisht është e rëndësishme që të theksohet se si i dënuari R. P., ashtu edhe mbrojtësi i tij në kërkesat e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë e kontestojnë vendimin e gjykatës së shkallës së parë për miratimin e pranimit të fajësisë, duke konsideruar se në këtë rast nuk janë përbushur kushtet ligjore që kërkohen për një gjë të tillë, siç parashihet me nenin 242 të KPP-së.

8. Ndërsa, mbrojtësi i të dënuarit në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se si mbrojtës nuk ishte pajtuar me pranimin e fajësisë, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë nuk mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza dhe në provat materiale të cilat janë prezantuar nga prokurori i shtetit të cilat nuk janë bazë për fajësinë e të dënuarit, andaj, edhe sipas mbrojtësit për këto arsye, gjykata e shkallës së parë nuk është dashur që ta miraton pranimin e fajësisë.

9. Gjithashtu, në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është kundërtshënës, i paqartë dhe i mangët, si dhe në të nuk janë përkrahur të gjitha rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, të cilat do të mund të mund të rezultonin edhe me shkelje të ligjit penal, pasi që në këtë rast, është dashur që të zbatohet instituti i mbrojtjes së nevojshme, nga neni 12 i KPRK-së.
10. Përveç këtyre, mbrojtësi i të dënuarit, pretendon se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk janë paraqitur arsye për të gjitha pikat e aktgjykimit, duke ju referuar këtu edhe mungesës së paraqitjes së arsyeve në lidhje me dënimin e shqiptuar, kurse i dënuari pretendon se dy herë e kishte pranuar fajësinë, mirëpo asnjëherë nuk e kishte pranuar përgjegjësinë penale, siç e kërkon ligji, përkatësisht elementin e dashjes që ta privon nga jeta të dëmtuarin M. A.).
11. Gjithashtu, pretendohet se edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje ligjore, pasi që gjykata në fjalë, nuk ka dhënë përgjigje në shkeljet e pretenduara, duke u arsyetuar se bëhet fjalë për gjendjen faktike që nuk mund të jetë objekt vlerësimi, meqë i dënuari R. P., e ka pranuar fajësinë.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit të shkresave të lëndës konstatoi se kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të pabazuara, për faktin se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje të esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit R. P.
2. Në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme është paraqitur vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari R. P., së bashku me të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme që e përbëjnë figurën e veprës penale “Vrasja” të mbetur në tentativë, si dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal, ashtu siç parashihet në nenin 369, paragrafi 4 lidhur me nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së.

3. Nga dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet se veprimet kryerëse për të cilat është shpallur fajtor i dënuari R. P., janë të përshkruara në pikën III. dhe fakti se në lidhje me “datën, vendin, mënyrën dhe arsyet” e kryerjes së veprës penale, gjykata në fjalë, ju ka referuar pikës I. të dispozitivit, në asnjë mënyrë nuk rezulton me ndonjë paqartësi apo kundërrthënie, duke e pasur parasysh se në këtë rast, të përfshirë kanë qenë edhe të dënuarit M. A. dhe Sh. P., të cilët janë shpallur fajtor për vepra penale që ndërlidhen më këtë rast. Andaj, sikurse në këtë rast, ashtu edhe në rastet tjera nga praktika gjyqësore, referimi në pika tjera të dispozitivit të aktgjykimit, në situata të caktuara, është një metodë e zakonshme dhe adekuate e përshkrimit të veprimeve kryerëse, me qëllim që të shmangies së përsëritjes së fjalëve të njëjta, kështu që kjo mënyrë e përshkrimit të veprimeve kryerëse në asnjë mënyrë nuk ka shkaktuar ndonjë kundërrthënie apo paqartësi. Nga kjo pikë e dispozitivit të aktgjykimit shihet se i dënuari R. P., më datën 12.08.2003, rreth orës 11:50, në rrugën “....”, në V., për shkak të një konflikti të mëparshëm ndërmjet familjes A. dhe asaj P., rreth kontestit të kalimit të rrugës e cila i kishte ndarë dy familjet, kur para dy viteve, anëtarët e familjes A., vendosin rrjetën metalike në derën e shtëpisë së familjes P., që kjo familje të mos ketë dalje në këtë rrugë, e në ditën e lartcekur, anëtarët e familjes P., e largojnë këtë rrjet, kurse më pas familja A., prapë tenton që ta vendos rrjetën në derën e cekur, ndërsa i dënuari R., me qëllim të privimit nga jeta të të dënuarit M. A., me armën e tipit “TT”, të kalibrit 7.62 mm, shtie shumë herë në drejtim të tij, por nga këto shtëna i dëmtuari M. A., nuk goditet.
4. Në anën tjetër, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj rezulton se ka paraqitur arsye të mjaftueshme edhe për të gjitha çështjet e tjera të rëndësishme, përkatësisht për të gjitha pikat e aktgjykimit, duke përfshirë këtu edhe paraqitjen e arsyeve sa i përket vendimit për miratimin e pranimit të fajësisë nga ana e të dënuarit R. P., ku me atë rast kishte vlerësuar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, të parashikuara në nenin 242 të KPP-së.
5. Në këtë drejtim, pas shikimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundimin se në këtë rast janë respektuar dispozitat përkatëse ligjore që i referohen pranimit të fajësisë në kuptim të neneve 241 - 242 të KPP-së, si në kuptim të përmbushjes së kushteve ligjore për miratimin e pranimit të

fajësisë, ashtu edhe në kuptim të respektimit të procedurës, si para, ashtu edhe pas marrjes së aktvendimit për miratimin e pranimit të fajësisë, andaj edhe pretendimet nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

6. Në këtë mënyrë, nga shkresat e lëndës dhe në veçanti nga procesverbali i fundit i shqyrtimit gjyqësor, i datës 06.12.2023, shihet se i dënuari – i akuzuari R. P., pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, e kishte pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën ishte akuzuar, përkatësisht veprës penale “Vrasja” e mbetur në tentativë, sipas dispozitave të lartcekura ligjore, duke shtuar: e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimin e fajësisë e kishte bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, në konsultim të mjaftuar me mbrojtësin e tij dhe pas sqarimeve të mjaftuara nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë.
7. Gjithashtu, nga shkresat e lëndës shihet se gjykata paraprakisht e kishte pyetur të dënuarin R. P. për disa çështje të rëndësishme që i referohen institutit të pranimit të fajësisë, e kishte udhëzuar dhe njoftuar për të drejtat që i takojnë sipas dispozitave ligjore, si dhe e kishte njoftuar për pasojat dhe natyrën e pranimit të fajësisë, se nëse e pranon fajësinë, atëherë nuk do të mbahet shqyrtimi gjyqësor, se nëse e pranon fajësinë, ka të drejtë që të ankohet vetëm sa i përket lartësisë së dënimit, por jo edhe faktit se a është apo jo fajtor dhe se pranimi i fajësisë është rrethanë lehtësuese me rastin e matjes së dënimit, e që nga këto që u theksuan më lart rezultojnë se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë nga neni 242, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. të KPP-së dhe është respektuar procedura përkatëse ligjore për një gjë të tillë.
8. Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që të sqaron se pranimi i fajësisë është e drejtë ekskluzive të të pandehurit dhe pavarësisht faktit se gjykata para se të vendos që të miraton ose jo pranimin e fajësisë duhet që të merr pikëpamjet e prokurorit të shtetit, mbrojtësit, të dëmtuarit ose viktimës (neni 242, paragrafi 5, fjalia e fundit e KPP-së), kjo parimisht nuk nënkupton se pikëpamjet e subjekteve të tilla janë të detyrueshme dhe faktor determinues, nëse duhet miratuar apo jo pranimin e fajësisë. Një gjë e tillë është përgjegjësi e gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues/ trupit gjykues dhe duhet të vlerësohet nga rrethanat specifike të secilit rast veç e veç, ndërsa nëse një gjë e tillë ndodh gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, atëherë,

ligjdhënësi ka parashikuar një qasje edhe më fleksibile, pasi që në nenin 322, paragrafi 2 të KPP-së është parashikuar se “Në shqyrtimin e pranimit të fajësisë së të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të dëgjojë mendimin e prokurorit të shtetit, të mbrojtësit dhe të dëmtuarit”. Pra, me fjalë të tjera, nëse është në pyetje miratimi ose jo i pranimit të fajësisë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, atëherë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, bazuar në dispozitën e lartcekur mund të dëgjojë, pra jo detyrimisht, mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

9. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, në situata të tilla, nëse duhet apo jo që të miratohet pranimi i fajësisë, përveç tjerash, janë të rëndësishme dy (2) aspekte:
10. *Së pari*, që në të vërtetë të përmbushen kushtet ligjore që parashihen në nenin 242, paragrafi 2 të KPP-së për miratimin e pranimit të fajësisë dhe
11. *Së dyti*, që gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari/trupi gjykues të binden se janë përmbushur të gjitha këto kushte ligjore për një gjë të tillë.
12. Nëse i referohemi rrethanave dhe specifikave të këtij rasti, shihet se në këtë rast janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për miratimin e pranimit fajësisë, edhe për shkak të fakti se pranimi i fajësisë, siç ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj, gjen mbështetje edhe në provat tjera që gjenden në shkresa të lëndës, të cilat janë të specifikuar në faqen 8-të të këtij aktgjykimi, kurse në anën tjetër, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vërejtur që aktakuza e ndryshuar, pas kthimit të rastit në rigjykim, të përmban ndonjë të ashtuquajtur “shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike”.
13. Duke i shikuar dhe analizuar shkresat e lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës ka vërejtur se i dënuari R. P., e kishte pranuar fajësinë edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore të mëparshme, ndërsa kishte qenë edhe vetë mbrojtësi aktual i të dënuarit, i cili gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 30.12.2019, i kishte propozuar gjykatës që ta miraton pranimin e fajësisë së të dënuarit, me arsyetimin se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë.

14. Duke ju referuar pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, përveç vendimit lidhur me miratimin e pranimit të fajësisë, rezultoi se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur arsye edhe sa i përket çështjeve të rëndësishme, duke përfshirë këtu edhe paraqitjen e arsyeve në lidhje me rrethanat përkatëse që janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimeve dhe në asnjë mënyrë kjo pjesë e aktgjykimit nuk paraqitet si e paqartë apo kundërtë.
15. Në këtë aspekt, rezultoi se sa i përket të dënuarit R. P., gjykata e shkallës së parë i kishte vlerësuar si rrethana lehtësuese faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, se nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar një kohë e gjatë dhe atë më shumë se njëzetë (20) vjet, se i dënuari kishte shprehur pendim dhe keqardhje për rastin e ndodhur në atë kohë dhe faktin se familjet në mes vete i kanë rregulluar raportet, pasi që të gjithë të dënuarin kishin deklaruar se janë pajtuar dhe që nga ajo kohë nuk kanë pasur asnjë problem tjetër, rrethanat personale të të dënuarit dhe se i njëjti më parë nuk kishte qenë i dënuar për ndonjë veprë penale tjetër, ndërsa nuk është gjetur ndonjë rrethanë rënduese.
16. Siç është theksuar edhe më lart, i dënuari R. P., ishte akuzuar dhe shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Vrasja” e mbetur në tentativë, nga neni 30, alinea 1 të LPK-së lidhur me nenin 19 të LPJ-së.
17. Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, konstatoi se në këtë rast nuk është shkelur as ligji penal në dëm të të dënuarit R. P., siç pretendohet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, pasi që veprimet e tij të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i përbëjnë të gjitha tiparet e figurës së veprës penale për të cilën ishte shpallur fajtor dhe nuk bëhet fjalë për ndonjë rrethanë që do të përjashtonte ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të dënuarit.
18. Në këtë drejtim, duke u bazuar në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe në shkresat tjera të lëndës shihet që i dënuari R.P., më datën, vendin, mënyrën dhe arsyet e theksuara më lart, me qëllim të privimit nga jeta të të dëmtuarit M. A., me armën e tipit “TT”, të kalibrit 7.62 mm, kishte shtënë shumë herë në drejtim të tij, por nga këto shtëna, i dëmtuari M. A. nuk ishte goditur. Nga gjithë kjo që u theksua më lart, rezultoi se veprimet e të dënuarit R. P. i përmbajnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale “Vrasje” në mbetur në tentativë, nga neni 30, alinea 1 të

LPK-së lidhur me nenin 19 të LPJ-së, pasi që i njëjti me qëllim të privimit nga jeta, në këtë rast të të dëmtuarit M. A., kishte shtënë me armën e tipit “TT”, të kalibrit, 7.62mm, shumë herë në drejtim të tij, por i njëjti nuk ishte goditur, e që rezulton se vepra penale e vrasjes kishte mbetur në tentativë, ndërsa për shkak të mënyrës se si është zhvilluar ngjarja ditën kritike dhe vazhdimësisë së ndërmarrjes së veprimeve nga ana e të dënuarit, nuk mund të bëhet fjalë as për institutin e mbrojtjes së nevojshme.

19. Në anën tjetër, përveç aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, siç është theksuar edhe më parë, me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk është përfshirë as aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi në fjalë rezulton se nuk përmban ndonjë të metë apo kundërthënie, ndërsa pjesa e arsytimit të këtij aktgjykimi përfshin arsyet në lidhje me vlerësimin e pretendimeve thelbësore ankimore të mbrojtjes dhe shkeljet që janë vlerësuar sipas detyrës zyrtare, ashtu siç është parashikuar në nenin 404, paragrafi 1 të KPP-së.

20. Andaj, edhe nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të pabazuara dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PA-II.Nr.1/2023, i datës 19.10.2023

”Prandaj, kjo Gjykatë, duke e marr parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, vendin e kryerjes së veprës penale, sjelljen e të akuzuarit para kryerjes së veprës penale si dhe pas kryerjes së veprës penale, faktin se vepra penale është kryer në “rrethana veçanërisht rënduese”, konsideron se dënimi të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, i vërtetuar edhe me aktgjykimin e shkallës së dytë, është i drejtë, i ligjshëm, dhe se i njëjti është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të dënuarit, dhe është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale dhe se këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.171/2021 e datës 6.4.2023, të akuzuarin G.K., e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale “Vrasje e rëndë” nga neni 173, paragrafi 1. nën paragrafi 1.3. të KPRK dhe veprës penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, paragrafi 1. të KPRK, dhe ia ka shqiptuar dënimin me burgim të përjetshëm. I akuzuari gjendet në masën e paraburgimit nga data 9.4.2020 e tutje. Të akuzuarit i janë konfiskuar: një (1) pistoletë e markës “Crvena Zastava”, me numër serik 37098, prodhim jugosllav, ngjyrë e zezë, një (1) karikator me gjashtë (6) fishek të kalibrit 7.65 mm si dhe një (1) pistoletë e markës “Zoraki”, me numër serik 000842, një (1) karikator dhe një (1) fishek, si objekte të kryerjes së veprave penale. Të dëmtuarit H.K. dhe A.K., nga fshati B. komuna e R., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko – civil. I akuzuari është obliguar që t’i paguajë shpenzimet procedurale, në emër të paushallit gjyqësorë shumë prej 400 €, po ashtu shpenzimet procedurale për përkthim të shkresave, shumë prej 13.38 €, si dhe shumë prej 50 €, në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimin.

2. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr. 301/2023 të datës 7.7.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, ndërsa aktgjykimin e ankimuar të shkallës së parë e ka vërtetuar.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve, ankesë në shkallë të tretë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit G.K., avokati A.R., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe ta anulojë aktgjykimet e ankimuara dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me parashtresën PPA.III-nr.9/2023 e datës 1. 9.2023, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit të shkallës së tretë për të cilën me rregull u informuan: Prokurori i Shtetit, I akuzuari, mbrojtësi i tij si dhe të dëmtuarit përmes përfaqësuesit të autorizuar të tyre, ngase sipas shkresave të lëndës ndodhen në Zvicër.
6. Në seancën e kolegjit morën pjesë: I akuzuari G.K. dhe mbrojtësi i tij avokati A.R., ndërsa Prokurori i Shtetit dhe përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara avokati A.M. edhe pse të njoftuar me rregull nuk prezantuan në seancën e kolegjit.
7. Në seancën e kolegjit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës bashkë me ankesat e ushtruara dhe propozimit me shkrim të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe pasi që aktgjykimi i ankimuar u vlerësua sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 394, paragrafi 1. të KPPK u gjet se:

Ankesa është e pabazuar.

8. Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit pretendohet se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 370, paragrafi 1. të

KPP, bazuar në faktet referuar arsyetimit të aktgjykimit të atakuar, vërtetohet se në të njëjtin në tërësi përshkruhen dhe ri përsëriten pretendimet e shkallës së parë, duke krijuar paqartësi dhe konfuzitet lidhur me faktet të cilat konsiderohen të vërtetuara ose të pavërtetuara duke mos dhënë asnjë vlerësim të saktësisë të provave kontradiktore, përkatësisht deklarimeve kontradiktore të dëshmitarëve të dhëna në polici, prokurori dhe gjykatë. Aktgjykimi i atakuar, ekskluzivisht është mbështetur në deklarimin e të akuzuarit Gani të dhënë në stacionin policor dhe pse deklarimi i të akuzuarit të dhënë në polici nuk mund të shpallë fajtorë duke u mbështetur vetëm në një deklaratë të tillë dhe duke i dhënë rëndësi vendimtare asaj, deklaratave supozuese të dëshmitarëve-bashkëshortës, fëmijëve, vëllezërve të kinse të privuarit nga jeta të B.K. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ja falë besimin deklarimeve supozuese të pjesës më të madhe të dëshmitarëve, edhe përkundër faktit se të njëjtit dëshmitarë nuk ishin prezent në Republikën e Kosovës me datën 11.02.2020 (koha për të cilën supozohet se i mbrojturi i im G. e ka privuar me dashje nga jeta vëllain B.K.).

9. Referuar arsyetimit të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së dytë kishte obligim procedural dhe ligjor t'i paraqesë në mënyrë të saktë dhe të plotë arsyet se cilat fakte i konsideron si të vërtetuara ose të pavërtetuara, duke dhënë vlerësimin e saktësisë së provave kontradiktore të dëshmitarëve të dhëna në intervistë si në polici, prokurori dhe gjykatë. Pretendohet më tutje në kërkesë se shkeljet e dispozitave të procedurës penale konsistojnë edhe për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk i jep rëndësi faktit themelor se, Prokuroria Themelore në Gjakovë nuk ka dërguar-ekspeduar ftesat për t'i mundësuar mbrojtjes asistimin me rastin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, që rezulton me provimin e të drejtës të mbrojtësit të dënuarit për të asistuar dhe për t'u bërë pyetje dëshmitarëve.
10. Shpallja e të akuzuarit fajtor dhe shqiptimi i dënimit me burgim të përjetshëm do të krijonte një praktikë të gabuar në R. e Kosovës e cila është në kundërshtim me parimin "kur nuk ka gjurmë, gjak dhe trup, nuk ka fajtorë", nisur nga fakti se edhe sot nuk është vërtetuar se B.K. është në jetë apo ka vdekur, pra gjykata vetëm supozon se Bajrami është privuar nga jeta nga i akuzuari G., mirëpo këtë supozim nuk ka arritur asnjëherë ta provoj dhe vërtetoj.

11. Shkeljet në procedurë konsistojnë në faktet se, Gjykata e Apelit është dashur që të vlerësoj se cilën provë materiale, deklaratimet e mbrojtës dhe në bazë të vlerësimit veç e veç të nxjerrë përfundimin meritor nëse fakti konkret është provuar e jo vetëm me formulim të përgjithësuar të konstatoj se si gjykata ka arritë të vërtetoj faktet se në veprimet e të dënuarit janë përmbushur elementet e veprës penale.

12. Përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me ankesë, në esencë vetëm janë përsëritur pretendimet e njëjta ankimore, të cekura tek baza ankimore shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, ku në esencë konstatohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet të cilat i ka nxjerrë në bazë të provave të proceduara. Gjykata e Apelit, në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me të gjitha provat materiale dhe shkresore vërteton se i akuzuari Gani është fajtor, duke bërë kështu përshkrimin e veprimeve të cilat i ka ndërmarr i dënuari me rastin e privimit të vëllait Bajram nga jeta.

13. Përshkrimin e veprimeve të akuzuarit, të cilin e mbështet gjykata e shkallës së dytë, bie ndesh me akt ekspertimin mjeko ligjor të datës 30.09.2022, dhe mendimi përfundimtar i ekspertëve është provë thelbësore dhe bazë e mjaftueshme për të larguar çdo dilemë. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, e sidomos kur merret parasysh se në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se vepra penale nuk është kryer nga i dënuari, dhe se gjykata e shkallës së parë në mungesë të provave konkrete krejt gjendjen faktike e bazon në deklaratën e vetme të dënuarit të dhënë në polici, por nuk merr parasysh fare edhe provat materiale prova këto nga të cilat nuk vërtetohet asgjë në mënyrë konkrete në drejtim të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor. Pastaj, kundërthëniet e deklaratave të dëshmitarëve e duke marrë parasysh edhe faktin se asnjëri nga këta nuk janë dëshmitarë okular, por gjithë atë që e deklarojnë e kanë bërë në bazë të dëgjimit. Konsiderojmë se gjykata e shkallës së dytë ka marrë një vendim në kundërshtim me të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ashtu që mbrojtja konsideron se aktgjykimi i atakuar, sipas të gjitha bazave juridike, nuk mund të jetë i qëndrueshëm dhe doemos duhet të anulohet sepse nuk ka mbështetje në prova të drejtpërdrejta që do të argumentojnë fajësinë e të akuzuarit.

14. Më tutje në kërkesë theksohet se të akuzuarit G., në asnjë stadë të zhvillimit të procedurës hetimore dhe gjyqësore nuk i janë bërë ekzaminimet e duhura dhe të nevojshme, kontrollet neuropsikiatrike dhe psikologjike për t'u konstatuar gjendja shpirtërore e shëndetit mendor, kur dihet fakti se i njëjti në të kaluarën ka qëndruar në izolim për një kohë të gjatë, 15 vite në burgun e shtetit të Zvicrës. Shkelja e dispozitave të KPP, vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ka rezultuar me aplikimin e gabuar të ligjit material - dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Mbrojtja konsideron se në veprimet e të akuzuarit G.K., nuk janë konsumuar elementet e veprës penale që i vihet në barrë "*Vrasje e rëndë*" nga neni 173, paragrafi 1. nën paragrafi 1.3. të KPRK, bazuar në faktet se gjykatat e instancës më të ulët kanë dështuar t'i vlerësojnë dhe administrojnë provat materiale, për mbrojtjen trajtohen pa ndikim në këtë çështje penale. Gjykatat e instancës më të ulët aktgjykimin e atakuar e bazojnë ekskluzivisht në dëshmitarë dhe deklarinimin e të akuzuarit në stacionin policor, si dhe në dëshminë kinse të dëshmitarit S.K. Mbrojtja nuk e konteston faktin se G.K. është fajtorë për veprën penale "*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*" nga neni 366, paragrafi 1. të KPRK.
15. Përkitazi me vendimin mbi dënimin, theksohet në ankesën e mbrojtësit se: aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë, janë të pa qarta lidhur me vlerësimin e rrethanave të rëndësishme për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit penal, dhe gjykatat nuk arritën që me prova të besueshme dhe bindëse të vërtetojnë se i akuzuari G.K. ka privuar nga jeta vëllain B.K., ashtu që në rastin konkret mungojnë të gjitha prezumimet ligjore, faktike që i akuzuari të shpallet fajtor.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as me shkelje të ligjit penal, ashtu siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit në ankesën e tij. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë dhe i shkallës së dytë është i kuptueshëm, i qartë dhe konkret si dhe në përputhshmëri të plotë me arsyetimin, përpilimi i të cilave është bërë konform dispozitave të nenit 369, paragrafi 4. lidhur me nenin 364 të KPPK, ku janë përfshirë gjitha faktet dhe rrethanat nga të cilat plotësohen të gjitha elementet e veprës

penale “Vrasje e rëndë” nga neni 173, paragrafi 1. nën paragrafi 1.3. të KPRK, për të cilën veprë i akuzuari G.K. është shpall fajtorë.

2. Po ashtu në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, përveç që janë përshkruar të gjitha veprimet inkriminuese të akuzuarit, përkitazi me mënyrën se si është kryer vepra penale në fjalë, po ashtu janë përshkruar edhe veprimet inkriminuese që përbëjnë formën cilësuese të veprës penale të vrasjes, pra bëhet fjalë për vrasje të rëndë të kryer ndaj anëtarit të familjes, pra vëllait të dënuarit, e pastaj janë përshkruar edhe veprimet inkriminuese të akuzuarit të ndërmarra në momentin kritik të kryerjes së veprës penale, por edhe veprimet tjera të akuzuarit, përkitazi me motivin e kryerjes së veprës penale, por edhe faktet dhe rrethanat që edhe i kanë paraparirë kryerjes së veprës penale e që në bazë të veprimeve në fjalë, rezultojnë se bëhet fjalë për veprën penale të vrasjes së rëndë të kryer me dashje direkte nga i akuzuari G.K., e jo sikur që pretendon mbrojtësi i të dënuarit se nuk është kryer vepra penale nga i akuzuari.
3. Në arsyetimet e aktgjykimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale duke u bazuar në dispozitat e nenit 369, paragrafi 6. dhe 7. të KPPK, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu i njëjti është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin, ku janë paraqitur të gjitha arsyet në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së parë me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe me rastin e zbatimit të caktuar të dispozitave të kodit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës penale të tij.
4. Gjithashtu gjykata ka bërë vlerësimin e provave konform nenit 360, paragrafi 2. të KPP, me ç’rast ka dhënë arsyet e qarta, për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe mënyrën se si ka ardhur deri te kryerja e veprës penale nga i akuzuari. Arsyet e dhëna në arsyetimin e aktgjykimeve janë të drejta dhe të ligjshme dhe kanë mbështetje të plotë në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, të cilat arsyetime të gjykatës i pranon edhe kjo Gjykatë, sidomos kur në dispozitiv janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat që kanë mbështetje, përveç në provat materiale në shkresat e lëndës, si proceverbali i vendit të ngjarjes, raporti i bastisjes dhe fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes edhe në deklaratat e të dënuarit G.K., por edhe dëshmitarëve H.K., A.K., A.K., J.C., M.B., S.B., I.K., e sidomos në deklaratat e dëshmitarëve M.K. dhe S. K.,

por edhe të A.S., ku nga dëshmitarët në fjalë, janë vërtetuar në detaje raportet në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerit, duke i përshkruar në detaje, se si i akuzuari G.K. dhe tani i ndjeri kanë pasur raporte jo të mira, e që sipas dëshmitarëve në fjalë kryesisht kanë pasur mospajtime rreth pronës së tyre. Ditën kritike, i akuzuari ka shkuar tek tani i ndjeri B.K. që t'i japë një shumë të parave që i kishte marr nga miku i djalit të tani të ndjerit B., për t'ia dhënë tani të ndjerit sipas porosisë së djalit të tij, ku pasi tani i ndjeri nuk i pranon paratë në fjalë dhe pasi grinden përkritazi me këtë, i akuzuari pastaj shkollon në shtëpi ku e merr një armë të zjarrit dhe kthehet tek tani i ndjeri B.K., ku edhe ka shtënë me armë zjarri në drejtim të tij e duke e lënë të vdekur në vendin e ngjarjes.

5. Natyrisht që gjykata e shkallës së parë, një konkludim të tillë e ka aprovuar, pasi më parë ka bërë vlerësimin e provave në pajtim me dispozitat e nenit 360, paragrafi 2. të KPPK, ku përveç deklaratës së të akuzuarit G.K., deklaratë kjo që është dhënë në polici, ka marrë parasysh sidomos edhe deklaratat e dëshmitarëve S.K. dhe M.K., deklarata këto nga të cilat vërtetohet se dëshmitarët në fjalë kanë biseduar drejtpërsëdrejti me të akuzuarin dhe nga vet ai kanë kuptuar se i njëjti, pra i akuzuari e ka privuar nga jeta tani të ndjerin B.K., deklarata këto që kanë mbështetje edhe në deklaratën e dëshmitarit A.S. -nipi i të dënuarit dhe tani të ndjerit B, i cili ka sqaruar faktet dhe rrethanat se si i akuzuari G.K. i ka dërguar armën e zjarrit për ta shitur, armë kjo me të cilën i dënuari e kishte kryer veprën penale të vrasjes, ku i akuzuari e kishte porositur të mos i tregonte askujt e sidomos familjarëve të tani të ndjerit B.K. Po ashtu nga raporti i ekspertimit, nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë të datës 31.03.2020, ka rezultuar se kjo pistoletë është funksionale dhe se dëshmia e evidentuar me shifër D#2 një (1) gëzhgojë pjesë e kalibrit 7.65x17 mm është shkrepur nga pistoletat e dëshmisë D#R, e cila është gjetur në oborrin e të ndjerit B.
6. Kështu në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe po ashtu edhe për mënyrën se si ka ardhur deri te kryerja e veprës penale nga i akuzuari G.K., ku përkritazi me faktet dhe rrethanat, së pari ka marrë parasysh deklaratat e vet të akuzuarit, i cili në mbrojtjen e tij, në deklaratën e dhënë në polici, nuk e ka mohuar kryerjen e veprës penale në drejtim të vëllait të tij, përkundrazi e ka përshkruar në detaje se si e ka privuar nga jeta tani të ndjerin B.K., pastaj se si e ka djegur kufomën dhe si e ka hedhur të njejtën me qëllim që të fshihen gjurmët e vrasjes. Përveç kësaj, dëshmitarët e familjes së të dënuarit dhe

dëshmitarët e familjes së tani të ndjerit, kanë vërtetuar se pikërisht i akuzuari G.K. është personi që e ka privuar nga jeta tani të ndjerin B., prandaj konkludimet e gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari me dashje direkte e ka privuar nga jeta të ndjerin janë të drejta dhe të arsyeshme dhe të bazuara në prova dhe shkresat tjera të lëndës.

7. Gjykata e shkallës së parë, kur ka konstatuar faktet dhe rrethanat e cekura më lartë, ka marrë parasysh deklaratën e të akuzuarit përkitazi me mënyrën si e ka kryer veprën penale të vrasjes, pra deklaratën e të akuzuarit dhënë në polici, ka marr parasysh edhe deklaratat e dëshmitarëve S.K. dhe M.K., A.S., dhe provat e tjera materiale. Gjykata nga dëshmitarët dhe provat materiale të lartcekura, në mënyrë të padyshimtë, ka vërtetuar faktin se i akuzuari G.K., ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë ndaj viktimës B.K., në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, pasi që i njëjti me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, në vazhdimësi ka tentuar që të fsheh provat, siç ka bërë fillimisht me pistoletën, të cilën e ka dërguar tek nipi i tij A.S.
8. Pretendimin nga ankesa, se gjykata e shkallës së parë nuk ka patur të drejtë të bazohet vetëm në deklaratën e të akuzuarit të dhënë në polici, kjo Gjykatë e vlerëson si pretendim të pabazuar, për faktin se gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë ka dhënë arsyetim të plotë të qartë dhe të mjaftueshëm, duke sqaruar se bëhet fjalë për deklaratën e të akuzuarit të dhënë në polici në mënyrë të rregullt e në prezencë të mbrojtësit të tij dhe se aktgjykimi i ankimuar nuk mbështetet vetëm në një deklaratë por edhe në deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, e sidomos në ato të dëshmitarëve S.K., M.K., dëshmitarë këta që kanë biseduar drejtpërsëdrejti me të akuzuarin G.K. dhe në prezencën e tyre, i akuzuari e ka paranuvar se e ka privuar nga jeta tani të ndjerin B.K., e që të gjitha këto deklarata pastaj mbështeten edhe me provat materiale si procesverbali i shiqimit të vendit të ngjarjes dhe fotodokumentacioni ku vërtetohet vendi ku ka qenë i ndezur zjarri, pastaj deklarata e dëshmitarit që vërteton ndezjen e zjarrit por edhe dëshmitari A.S. që vërteton faktet dhe rrethanat përkitazi me dorëzimin e armës nga i dënuari, që të gjitha këto fakte dhe dëshmi që i vërteton edhe vet i akuzuari, në deklaratën e tij në polici, prandaj edhe nuk mund të bëhet fjalë për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kur gjykata e ka bazuar aktgjykimin e saj në deklaratën e të akuzuarit por edhe në deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, prandaj edhe pretendimet

në këtë drejtim janë të pabazuara dhe kjo gjykatë e mbështet në tërësi arsyetimin e gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore.

9. Përkitazi me pretendimet ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sipas vlerësimit të kësaj gjykate këto pretendime janë të pabazuara dhe si të tilla nuk qëndrojnë. Gjykata e shkallës së parë, lidhur me këtë bazë ankimore, ka dhënë arsyetimin e qartë dhe të plotë me të cilin arsyetim të kësaj gjykate pajtohet edhe kjo Gjykatë, për faktin se me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar edhe gjendjen faktike, kur ka vërtetuar se ditën kritike, pas një konflikti verbal në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerit B.K., për shkak të raporteve të tyre pronësore, i akuzuari ka shkuar në shtëpinë e tij dhe pasi e ka marrë armën e zjarrit, të përshkruar më detajisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, e ka privuar nga jeta të ndjerin B.K., ku më pastaj edhe e ka djegur kufomën e të ndjerit në zjarrin që e kishte ndezur në oborrin e shtëpisë së tani të ndjerit, ku përkitazi me këtë, vet i akuzuari ka deklaruar në prezencën e dëshmitarëve S.K. dhe M.K., pastaj këtë e ka pranuar edhe në polici gjatë deklaratës së dhënë në praninë e mbrojtësit të tij. Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartë cekura, rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se i akuzuari G.K. është kryerës i veprës penale” Vrasje e rëndë” nga neni 173, paragrafi 1. nën paragrafi 1.3. të KPRK, është i drejtë dhe në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari i ka ndërmarrë të gjitha veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën është shpall fajtor dhe është dënuar, andaj edhe pretendimi ankimor se në këtë çështje penalo-juridike është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit është i pabazuar.
10. Përkitazi me pretendimin ankimor të mbrojtësit të akuzuarit, se shkeljet e dispozitave të procedurës penale konsistojnë edhe për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk i jep rëndësi faktit themelor se, Prokuroria Themelore në Gjakovë, nuk i ka dërguar-ekspeduar ftesat për t'i mundësuar mbrojtjes asistimin me rastin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, që rezulton me privimin e të drejtës të mbrojtësit të dënuarit për të asistuar dhe për të bërë pyetje dëshmitarëve, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ky pretendim është i pabazuar, për faktin se mos informimi i mbrojtësit për të marr pjesë në veprime hetimore apriori nuk e bënë provën të jetë e papranueshme, pasi që mbrojtja e kishte mundësinë për ta kundërshtuar ligjshmërinë dhe t'i vë në diskutim

provat e siguruar gjatë veprimeve të caktuara hetimore gjatë fazave të mëturjesme të procedurës penale, shkelja e tillë duhet të vlerësohet në kontekstin e ndikimit në rregullsinë dhe ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe në rastin konkret kjo nuk paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

11. Pretendimin e mbrojtësit të dënuarit se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e atakuar e bazon ekskluzivisht në deklaratimet e familjarëve - dëshmitarëve dhe deklaratimit të të akuzuarit në stacion policor, sipas vlerësimit të kësaj gjykate ky pretendim nuk qëndron, për faktin se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të vet, në faqen 48 të aktgjykimit, ka dhënë arsyetimin e plotë dhe të qartë lidhur me këtë pretendim, me të cilin pajtohet edhe kjo Gjykatë, pa u lëshuar edhe njëherë në elaborimin e saj.

12. I pabazuar është pretendimi i mbrojtësit, se viktima ishte i përfshirë në konflikte serioze me persona të tjerë, për faktin se lidhur me këtë pretendim të gjithë dëshmitarët e dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor janë deklaruar lidhur me faktet dhe rrethanat për këtë, dhe gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetimin e plotë dhe të qartë për këtë pretendim, të cilën kjo gjykatë nuk e sheh të arsyeshëm ta elaboroj, ngase ekziston arsyetimi i qartë dhe i kuptueshmëm nga gjykatat e instancave më të ulëta të cilat kanë dhënë arsyetim lidhur me këtë pretendim të mbrojtjes.

13. Po ashtu, sa i përket pretendimit të mbrojtësit se gjykata ja ka falur besimin deklaratave të dëshmitarëve - familjarëve të të ndjerit të cilat janë në kundërshtim me provën materiale - ekspertizën e datës 06.10.2021, e punuar nga ekspertja H.M. dhe B.M. - specialist të lartë për Serologji dhe ADN, kjo Gjykatë vlerëson se edhe ky pretendim i mbrojtjes është i pabazuar, për faktin se edhe lidhur me këtë pretendim të mbrojtjes, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetimin e plotë në aktgjykimin e vet, në faqen 43 të aktgjykimit, me të cilin arsyetim të dhënë pajtohet edhe kjo gjykatë, për faktin se nga ekspertiza e lartcekur, ka rezultuar që mostrat e rërës që janë dërguar për ekzaminim kanë rezultuar negative për prezencën e ADN-së njerëzore.

14. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar, se nga dëgjimi i dëshmitarëve dhe nga provat e tjera të administruara është vërtetuar fakti se i akuzuari e ka djegur trupin e viktimitës, ashtu siç është shtjelluar më lartë, për çka fakti se mostra e rërës së dërguar

në AKF, ka rezultuar negative për prezencën e ADN-së njerëzore, nuk e bënë të pabesueshëm faktin e djegies së trupit të viktimës, pasi që edhe në ekspertizë është konstatuar se ADN-ja ka mundur të jetë e shkatërruar ose materiali gjenetik ka munguar në këto mostra të rërës, e kur ky konstatim vlerësohet në raport me veprimet të cilat i ka ndërmarr i dënuari, bëhet edhe më e besueshme që mostrat janë shkatërruar, sepse i dënuari për djegien e kufomës ka përdorur materiale të ndryshme, si drunjë, plastikë, thasë letre, dërrasa, letër të zezë për izolim dhe gjëra tjera, duke e djegur trupin e viktimës për 2-3 ditë me radhë.

15. Lidhur me pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit, se në asnjë stad të zhvillimit të procedurës hetimore dhe gjyqësore, të akuzuarit nuk i janë bërë ekzaminimet e duhura dhe të nevojshme, kontrolltet neuro-psikiatrike dhe psikologjike për të konstatuar gjendjen shpirtërore dhe të shëndetit mendor, kjo gjykatë vlerëson se ky pretendim i mbrojtësit është i pabazuar për faktin se në asnjë fazë të procedurës penale nuk ka pasur asnjë dyshim për shëndetin mendor të akuzuarit as nga palët e as nga organet të cilat e kanë zhvilluar procedurën dhe dyshimi për këtë nuk është paraqitur as nga mbrojtësi i të akuzuarit, se kryesi i veprës penale ka mundur të jetë i papërgjegjshëm në kohën e kryerjes së veprës penale.
16. Dhe për derisa në asnjë fazë të procedurës nuk është paraqitur ndonjë dyshim për gjendjen shëndetit mendor të akuzuarit, as nga palët e as nga organet, edhe nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka asnjë dokumentacion mjekësor që tregon se i akuzuari të ketë kërkuar trajtim mjekësor lidhur me shëndetin mendor, dhe kjo gjendje nuk është shfaqur në asnjë fazë të procedurës, duke përfshi procedurën paraprake, konfirmimin e aktakuzës, shqyrtimin gjyqësor në shkallë të parë, por ky pretendim për shëndetin mendor të akuzuarit është paraqitur vetëm në fazën e ankimit, kjo gjykatë vlerëson se ky pretendim i mbrojtjes në këtë fazë mund të jetë vetëm një pretendim, më shumë për zvarritjen e procedurës se sa për për sqarimin e përgjegjshmërisë.
17. Në të drejtën penale vlenë prezumimi i natyrshëm i rrëzueshëm se çdo kush që lind, lind mendërisht i aftë, ngase niset nga një supozim i bazuar se të gjithë personat janë të përgjegjshëm, janë psiqikisht normal dhe prandaj janë edhe në gjendje që të kuptojnë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojnë sjelljet e tyre. Prandaj, në procedurën penale

administrohen provat se a ka qenë një person i përgjegjshëm apo jo vetëm në rastet konkrete, kur lind dyshimi i bazuar se kryesi i veprës penale ka qenë i papërgjegjshëm.

18. Përveç aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, siç është theksuar edhe më parë, me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk është përfshirë as aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë.
19. Në këtë aspekt, pjesa e arsytimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i ka të përfshira arsyet në lidhje me vlerësimin e pretendimeve ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit, si dhe janë paraqitur shkeljet e ligjit, të cilat janë shqyrtuar sipas detyrës zyrtare, ashtu siç është parashikuar në nenin 404, paragrafi 1. të KPP-së.
20. Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, shihet që gjykata në fjalë i ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit G.K., për veprat penale për të cilat i njëjti ishte shpallur fajtor.
21. Lidhur me pretendimin e mbrojtësit për vendimin mbi dënimin, kjo Gjykatë vlerëson se duke pasur parasysh rrethanat e theksuara e në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit, për veprat e kryera penale e në të cilat thirret në arsyetimin e aktgjykimit dhe duke i vlerësuar të njëjtat përkitazi me pretendimet ankimore, janë të pabazuara pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit G.K., se dënimi është i ashpër.
22. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e cekura ankimore nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe atë konform dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK, ku si rrethana rënduese ka marr shkallën e lartë të dashjes, pra vendosmërinë për kryerjen e veprës penale. Që do të thotë se i njëjti këtë vepër penale e ka kryer me paramendim, duke pasur shkallë të lartë të dashjes, motivin e kryerjes së veprës penale që ishte rreth problemeve pronësore të cilat i kishte me viktimën, vëllain e tij tani të ndjerit B.K., mënyrën e kryerjes së veprës penale, pra i akuzuari shkon në shtëpinë e tani të të ndjerit dhe ka shtënë në drejtim të tij në momentin kur as që pritej nga tani i ndjeri, pastaj sjelljen e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale, ku i njëjti e merr kufomën e tani të ndjerit dhe e djeg në

zjarr, pastaj i fsheh pjesët e mbetura të kufomës të djegura nga zjarri, krejt këtë me qëllim të fshehjes së krimit, pastaj faktin se i njëjti ka qenë i dënuar edhe më parë dhe atë për veprë penale të vrasjes, shkallën e dëmit të shkaktuar familjes së të ndjerit, sjelljen e mëparshme të akuzuarit, ku nga njoftimi nga autoritetet Zvicerane, lidhur me evidencën kriminale të akuzuarit G.K., të marra nga ILECU me datën 13.10.2021, është konstatuar se i njëjti nga Gjykata Penale e Kasacionit në Llozanë, me datën 09.02.2004 është dënuar me burgim të përjetshëm për vrasje, lëndime trupore dhe shkelje të detyrës së kujdesit ose edukimit. I njëjti është liruar me kusht nga burgu me datën 27.11.2016 për periudhën e lirimit me kusht 5 vite dhe e ka të ndaluar hyrjen në Zvicër deri më datën 10.10.2023. E po ashtu i akuzuari edhe me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, P.nr.6/2016 të datës 12.03.2018 i formës së prerë me datën 05.04.2018, është shpall fajtor për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK.

23. Prandaj, kjo Gjykatë, duke e marr parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, vendin e kryerjes së veprës penale, sjelljen e të akuzuarit para kryerjes së veprës penale si dhe pas kryerjes së veprës penale, faktin se vepra penale është kryer në “rrethana veçanërisht rënduese”, konsideron se dënimi të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, i vërtetuar edhe me aktgjykimin e shkallës së dytë, është i drejtë, i ligjshëm, dhe se i njëjti është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të dënuarit, dhe është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale dhe se këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK.

24. Nga arsyet e cekura më lartë, e konform nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimimit.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.613/2023, i datës 22.12.2023

”Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë paraqitur arsye të mjaftueshme se pse kjo gjykatë nuk ja ka falur besimin provave të cilat i ka administruar gjykata e shkallës së parë, e që nga shkresat e lëndës rezulton se provat mbi të cilat gjykata e shkallës së dytë e mbështet aktgjykimin e vet dhe e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë dalin të jenë kundërtë dhe të paqarta dhe nuk japin bazë të mjaftueshme për vendosje si në rastin konkret siç ka vepruar gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes në këtë çështje penale“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.262/2022, të datës 03.04.2023, të dënuari M. B., është shpall fajtor për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 173, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.3,1.4 dhe 1.11 të KPRK, për të cilën vepër gjykata e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) vite, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merre formën e prerë. Të dënuarit, me aktvendim të veçantë i është vazhduar masa e paraburgimit derisa ky aktgjykim të merr formën e prerë, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e kësaj gjykate. Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 27.05.2022 i llogaritet në dënimin e shqiptuar. Në pajtim me nenin 85 të KPRK e lidhur me nenet 513, 514 dhe 515 të KPP, të dënuarit i është shqiptuar edhe masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor. Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor e shqiptuar ndaj të dënuarit do të zgjasë për aq kohë sa do të ketë nevojë për trajtimin mjekësor-psikiatrik për të dënuarin.
2. Kohëzgjatja e masës së trajtimit të detyruar psikiatrik me ndalim, do të bazohet në raportet dhe rekomandimet e ekspertëve të psikiatrisë pranë Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në P.. Masa e trajtimit të detyruar psikiatrik ndaj të dënuarit do të ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor në Institutin e Psikiatrisë Forenzike në P.. Obligohet Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në P., të pranoj të dënuarin M. B. për trajtim mjekësor në kohën siç është paraparë në dispozitivin e

këtij aktvendimi. Instituti i Psikiatrisë Forenzike në P. obligohet që t'i dërgoj raporte me shkrim kësaj gjykate mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit brenda periudhës 6 mujore.

3. Në bazë të dispozitës së nenit 169 paragrafi 4 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve penale së pari do të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor. Koha e kaluar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim në bazë të nenit 515 paragrafi 3 të KPP-së.
4. Gjykata mund të pushoj apo ndryshoj masën e trajtimit të detyruar psikiatrik me ndalim, atëherë kur sheh të nevojshme dhe pasi që të ketë pranuar raportet dhe rekomandimet e ekspertëve të psikiatrisë për ndryshimin apo pushimin e masës bazuar në suksesin e trajtimit mjekësor. Gjykata nga i dënuari në mënyrë të përhershme konfiskon dy thikat të cilat janë përdorur për kryerjen e veprës penale, të cilat pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë do të asgjësohen nga Policia e Kosovës. Është obliguar i dënuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 550 €, paushallin gjyqësor në shumë prej 30 €, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 €.
5. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.380/2023, të datës 08 gusht 2023, ka vendosur që të aprovohet si e bazuar ankesa Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarës L. M., përkritazi me vendimin mbi dënimin, dhe ankesa e Prokurorisë, përkritazi me vendimin për ndryshimin e masës për trajtim të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institucionin e Kujdesit Shëndetësore, dhe ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ashtu që, Gjykata e Apelit e Kosovës, të dënuarin M. B., për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 173 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.11 të KPRK, e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 28 (njëzet e tetë) vitesh, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 27.05.2022 e deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi. Anullohet aktgjykimi përkritazi me vendimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e

kujdesit shëndetësor. Refuzohet ankesa e mbrojtësit të dënuarit e paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Në pjesët e tjera aktgjykimi mbetet i pandryshuar.

6. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit M. B., avokati M.H., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që ta aprovon si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshohen aktgjykimet e kundërshtuara, në atë mënyrë që i dënuari M. B. të shpallet fajtor për veprën penale të vrasjes nga neni 173 paragrafi 1 nën paragrafi 1,3 dhe 1.11 lidhur me nenin 18 paragrafi 2 të KPRK, për të cilën do ti shqiptohet një dënim më i ulët dhe në bazë të nenit 85 paragrafi 1 të KPRK dhe 513,514 dhe 515 të KPP-së, ti shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor (më afër e përshkruar në dispozitivin II të aktgjykimit të shkallës së parë) ose aktgjykimet të anulohen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

7. Zyra e Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.355/2023, e datës 29.11.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pazuar.

8. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejshëm: KPP) dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

9. Mbrojtësi i të dënuarit M. B., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, pretendon se Gjykata e Apelit e Kosovës në arsyetimin e aktgjykimit të saj, ka tejkaluar kompetencat e shqyrtimit të ankesës, ashtu që në mënyrë arbitrare pa kurrfarë mbështetje ligjore i zgjeron vetës kompetencat që aktgjykimin e shqyrtoi. Në dëm të dënuarit M. B. është shkelur ligji penal në mënyrë, që edhe pse ka ekzistuar ekspertiza e Institutit të psikiatriisë forenzike për shëndetin mendor të dënuarit, gjykata e shkallës së dytë në

aktgjykimin e saj duke e hedhur në tërësi mendimin e ekspertizës së psikiatrisë e arsyeton qëndrimin e saj përmes analizës së deklaratave të dëshmitarëve të dëgjuar në pjesët që kanë të bëjnë me sjelljet e të dënuarit gjatë periudhës kohore para kryerjes së veprimeve inkriminuese, por edhe të vrojtimeve të drejtpërdrejta në seancën e kolegjit.

10. Pretendohet se gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje dhe gabim të rëndë, për këtë mbrojtja ju ka referuar edhe literaturës juridike (pasi që në praktikën gjyqësore nuk ka hasur në ndonjë rast të ngjashëm) e cila mes tjerash konsideron “ Për të folur për karakteristikat ose natyrën e sëmundjes mendore-psikike që mund të bëjnë të papërgjegjshëm ose me përgjegjësi esencialisht të zvogëluar mendore kryerësin e veprës penale, është punë e rëndë dhe tejkalon kompetencat e njohurive profesionale të juristit. Kjo për shkak se bëhet fjalë për dukuri dhe çështje thjeshtë të lëmisë së shkencës së mjekësisë, përkatësisht të shkencës së psikiatrisë dhe psikopatologjisë.
11. Thekson në kërkesë se në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, mes tjerash vërehet edhe mungesa e njohurive të mjaftueshme për të bërë dallimin në mes të gjendjes së pallogaritshmërisë së kryerësit në momentin e kryerjes së veprës penale e cila në tërësi përjashton përgjegjësinë për çfarë kryerësit të tillë mund t'i shqiptohet vetëm masë e obligueshme e shërimit psikiatrik dhe veprës së kryer në gjendje esencialisht të zvogëluar mendore në kuadër të së cilës kryerësi ndërmerr veprime, i planifikon ato dhe si të tilla i kryen, porse gjendja e tij për të kuptuar pasojat e atyre veprimeve është tejet e ngushtuar si rezultat i gjendjes mendore nga e cila vuan.
12. Pretendohet më tutje në kërkesë se arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së dytë nuk paraqet vlerësimin e gjendjes së fakteve të vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë, por i tërë arsyetimi i aktgjykimit, polemizon fund e krye me ekspertizën psikiatrike dhe mendimin e ekspertës së dhënë në shqyrtimin gjyqësor duke u vënë kështu në pozitën mbi mendimin shkencor institucional.
13. Nga e gjithë kjo, sipas mbrojtësit rezultojnë se për të dënuarin është shkelur ligji penal në dëm të tij dhe kanë rrjedhë pasoja tejet të rënda ngase sipas ekspertëve të psikiatrisë është vlerësuar se i njëjti duhet të trajtohet përmes masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe e gjithë kjo me qëllim të ndërmarrjes së masave të shërimit të të njëjtit.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke i vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit në kërkesë dhe shkresat e tjera të lëndës , vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të dënuarit janë të bazuara, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 7. të KPP.
2. Kjo gjykatë vlerëson se në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, nuk janë dhënë arsye të qarta lidhur me faktet vendimtare vlerësimin e gjendjes së fakteve të vërtetuara me provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë si dhe për faktet për dënimin e shqiptuar.
3. Në këtë drejtim, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i paqartë dhe në kundërshtim me vet veten, me arsyetimin dhe përmbajtjen e shkresave të lëndës.
4. Kjo Gjykatë vlerëson se, mos paraqitja e arsyeve në aktgjykim në lidhje me aspektet e theksuara më lartë sipas dispozitave të lartcekura ligjore, konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, sipas nenit 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 7. të KPP.
5. Në këtë drejtim, në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë paraqitur arsye të mjaftueshme se pse kjo gjykatë nuk ja ka falur besimin provave të cilat i ka administruar gjykata e shkallës së parë, e që nga shkresat e lëndës rezultojnë provat mbi të cilat gjykata e shkallës së dytë e mbështet aktgjykimin e vet dhe e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë dalin të jenë kundërtënjës dhe të paqarta dhe nuk japin bazë të mjaftueshme për vendosje si në rastin konkret siç ka vepruar gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes në këtë çështje penale.
6. Nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, rezultojnë se kjo gjykatë e ka anashkaluar në tërësi mendimin e ekspertizës së Institutit të Psikiatrisë Forenzike e cila ekspertizë, ka konstatuar se i dënuari M. B. në momentin e kryerjes së veprës penale, aftësinë mendore për ta kuptuar veprën dhe për të kontrolluar veprimet e tij ka pasur të

zvogëluar esencialisht. Ky konstatim i Gjykatës së Apelit bie në kundërshtim me ekspertizën e Institutit të Psikiatrisë Forenzike, e me të cilën ekspertizë është dhënë mendim mbi shëndetin mendor të dënuarit M. B. dhe vendimin për anulimin e kësaj mase e arsyeton me qëndrimin e saj përmes analizës së deklaratave të dëshmitarëve të dëgjuar në pjesët që kanë të bëjnë me sjelljet e të dënuarit.

7. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, për të vlerësuar karakteristikat ose natyrën sëmundjes mendore-psikike që mund të bëjnë të papërgjegjshëm ose me përgjegjësi esencialisht të zvogëluar mendore kryerësin e veprës penale, janë kompetent ekspertët e fushës përkatëse, siç në rastin konkret gjykata shkallës së parë ka kërkuar nga ekspertët e fushës përkatëse, duke urdhëruar që të bëhet ekspertiza për të përcaktuar gjendjen e shëndetit mendor për të dënuarin. Në këtë drejtim, ekspertët e Institutit të Psikiatrisë Forenzike kanë rekomanduar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor për të dënuarin. Për këtë arsye, kur në procedurë penale lindë dyshimi se një person në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka qenë i përgjegjshëm, gjykata e fiton në ndihmë ekspertin përkatës nga kjo fushë. Prandaj, në rastin konkret veprimi i Gjykatës së shkallës së dytë është në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 133 paragrafi 1 i KPP në të cilën parashihet se me qëllim të ndriçimit dhe vërtetimit të fakteve relevante në procedurë penale mund të angazhohen persona të cilët në bazë të kualifikimit të tyre profesional ndihmojnë organet që zhvillojnë procedurën penale. Për më tepër, sipas nenit 392 par.1 dhe 2 të KPPK, Gjykata e Apelit, në rast se vlerëson se është e nevojshme që për shkak të dilemës lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ka mundur që të hap shqyrtim dhe të merr prova të reja apo të urdhëroj ekspertizë të re nga grupi i ekspertëve të fushës përkatëse, por jo të merr vet rolin e ekspertit, pasi që gjykata nuk ka ekspertizën e duhur në këtë fushë. Çdo ndërhyrje në këtë drejtim mund të qoj në arbitrarizëm gjatë vendosjes.
8. Nga aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, rezulton se në aktgjykim nuk janë dhënë arsye përmbajtjesore lidhur me administrimin e këtyre provave dhe nuk bëhet vlerësimi i tyre në kontekst të provuarit të qartë të këtyre dëshmvive të cilat janë në kundërshtim me ekspertizën për shëndetin mendor të të dënuarit.

9. Nga të theksuarat si më lartë, Kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi i shkallës së dytë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 404 paragrafi 1 të KPP, ngase nuk janë vlerësuar drejt pretendimet e ankesës.
10. Përkundrazi, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përmban një arsytim të përgjithësuar dhe të mangët, duke mos i elaboruar dhe shtjelluar pretendimet thelbësore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të dënuarit, duke i anashkalluar dhe konsideruar si jo të drejta konkludimet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me provat të cilat janë administruar nga gjykata e shkallës së parë.
11. Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron se gjykata e shkallës së dytë, edhe sa i përket shqiptimit të dënimit, është dashur që në lidhje me këto pretendime të mbrojtjes, të paraqes arsye të qarta dhe të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare për dënimin.
12. Andaj, kjo gjykatë, vlerëson se është i bazuar pretendimi nga kërkesa se, Gjykata e Apelit me rastin e ashpërsimit të dënimit të dënuarit, duke i shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 28 (njëzet e tetë) vite dhe me anulimin e masës për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalim, masë e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë me rekomandimin e ekspertëve të fushës përkatëse, është shkelur edhe ligji penal në dëm të dënuarit, për faktin se gjykata i ka tejkaluar kompetencat e veta edhe duke i shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 28 (njëzetetë) vite, për çka i mungon arsytimi për faktet vendimtare lidhur me lartësinë e dënimit, të cilat i ka marr për bazë Gjykata e Apelit me rastin e ashpërsimit të dënimit, e duke marrë parasysh dispozitën e nenit 42 par. 1 dhe 2 të KPK.
13. Andaj, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit M. B., ndërsa të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së njëjtë në rigjykim.
14. Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilat janë përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë.

15. Në rigjykim, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i evitoj të gjitha shkeljet e lartcekura si dhe të vlerësoj pretendimet nga ankesa , e pastaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje juridiko penale.

16. Nga arsyet që janë theksuar më lart dhe në bazë të nenit 438, paragrafi 2. të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.618/2023, i datës 06.12.2023

”Kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 të KPP, pasi që i mungon plotësisht arsyetimi përkritazi me faktet vendimtare, ndërsa ai i shkallës së dytë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 404 paragrafi 1 të KPP, ngase nuk janë vlerësuar pretendimet e ankesës“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.95/2022, të datës 26.05.2023 të dënuarit A.D. dhe B.H. janë shpallur fajtor për veprën penale grabitja në bashkëkryerje nga neni 317 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe janë gjykuar si në vijim : i dënuari A.D. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) viteve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 25.01.2022 deri me datë 04.07.2022 si dhe nga data 21.07.2022 deri me datë 27.07 2022 të cilin dënim duhet ta mbaj brenda 15 ditëve pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 1.500.00 (njëmijë e pesëqind euro) të cilin dënim duhet ta paguajë brenda 15 ditëve pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk paguhet i njëjti konform nenit 43 paragrafi 3 të KPRK do të zëvendësohet me dënim me burg ku për një ditë me burg do ti llogaritet me 20 € të gjobës.
2. I dënuari B.H. është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 25.01.2022 deri me datë 04.07.2022 si dhe nga data 26.04.2023 deri me datë 24.05.2023 të cilin dënim duhet ta mbaj brenda 15 ditëve pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 1.500.00 (njëmijë e pesëqind euro) të cilin dënim duhet ta paguajë brenda 15 ditëve pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk paguhet i njëjti konform nenit 43 paragrafi 3 të KPRK do të zëvendësohet me dënim me burg ku për një ditë me burg do ti llogaritet me 20 € të gjobës.

3. Janë obliguar të dënuarit që në mënyrë solidare ti paguajnë të gjitha shpenzimet procedurale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, për paushallin gjyqësor secili veç e veç shumën prej 100 € dhe po ashtu secili veç e veç shumën prej 50 €, në emër të kompensimit të viktimave të krimit.
4. E dëmtuara S.M. për realizmin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.
5. Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.456/2023, e datës 13.09.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të dënuarve A.D dhe B.H., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
6. Kundër këtyre aktgjykimëve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur:
 - mbrojtësi i të dënuarit A.D., avokati A.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 dhe 369 paragrafi 7 të KPP dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 385 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP , me propozim që kërkesa të aprovet si e bazuar dhe të anulohen aktgjykimet e kundërshtuara, ndërsa çështja penale t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.
 - mbrojtësja e të dënuarit B.H., avokatja F.C.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 dhe 369 paragrafi 7 të KPP dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 385 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP , me propozim që kërkesa të aprovet si e bazuar dhe të anulohen aktgjykimet e kundërshtuara, ndërsa kjo çështje penale t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.
7. Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.358/2023, e datës 29.11.2023 ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve A.D. dhe B.H. të refuzohen si të pabazuara.

8. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi e vlerësojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatojë se:

- kërkesat e mbrojtësve janë të bazuara.

9. Mbrojtësit e të dënuarve A.D. dhe B.H. në kërkesat e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendojnë se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 të KPP, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, ka kundërthënie me vet veten dhe arsyet e tij është i paqartë dhe nuk është konkret. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk i përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale. Aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 369 paragrafi 7 të KPP, në të cilën dispozitë përcaktohet se “ gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyes i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet për të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit. Më tutje në kërkesat e mbrojtësve të dënuarve pretendohet se gjykata me rastin e marrjes së aktgjykimit të kundërshtuar në asnjë rast nuk ka potencuar se cilat fakte i ka vërtetuar dhe cilat nuk i ka vërtetuar, nuk e ka vlerësuar drejt deklaratën e të dëmtuarës e cila çdoherë ka qenë kundërthënëse në vetvete. Mbrojtja pretendon se gjykata aktgjykimin e ka mbështetur vetëm në një provë materiale CD dhe të njëjtës ia ka falur besimin se i mbrojturi i tij kur ka ndodhur rasti e ka frekuentuar vendin e ngjarjes ku është kryer vepra penale.

10. Pretendohet se edhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase kjo gjykatë, në arsyetimin e aktgjykimit vetëm ka përshkruar konstatimet e gjykatës së shkallës së parë pa dhënë asnjë arsye për pretendimet nga ankesa, por është mjaftuar me konstatimet sterotype “ nuk qëndrojnë pretendimet”. Gjykata e Apelit pikë për pikë i ka përshkruar arsyetimet

e gjykatës së shkallës ë parë. Gjykata e Apelit në asnjë rast nuk është marrë me pretendimet e mbrojtjes në ankesë, nuk ka dhënë arsye konkrete.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shqyrtoj shkresat e lëndës dhe aktgjykimet e kundërshtuara me ankesë, vlerëson se pretendimet në kërkesat e mbrojtësve janë të bazuara. Fillimisht kjo Gjykatë, e sheh të nevojshme që të sqaron se me nenin 369 të KPP-së është parashikuar në përgjithësi “Përmbajtja dhe forma e aktgjykimet me shkrim”, ku në paragrafin 6. të këtij neni është parashikuar se “Gjykata në arsyetimin e aktgjykimet paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimet”, ndërsa në paragrafin 7. të këtij neni është parashikuar se “Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërtënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij”.
2. Bazuar në këto dispozita ligjore, rezulton se gjykata duhet që në arsyetimin e aktgjykimet të paraqes arsyet për çdo pikë të aktgjykimet (paragrafi 6. i nenit të lartcekur), ndërsa paraqitja e arsyeve ka të bëjë si me aspekte faktike, ashtu edhe me aspekte juridike të rastit përkatës.
3. Në këtë drejtim, mos paraqitja e arsyeve në aktgjykimet në lidhje me aspektet e theksuara më lartë sipas dispozitave të lartcekura ligjore, konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, sipas nenit 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 7. të KPP.
4. Nga këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që në arsyetimin e aktgjykimet të saj të paraqes arsye të qarta dhe të mjaftueshme në lidhje me faktet relevante juridike, e që rezulton se këtë të rast, aktgjykimet në fjalë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje këto të përmendura më lart.

5. Në këtë drejtim, në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, nuk është e mjaftueshme vetëm të paraqiten provat të cilat janë administruar, por duhet të konstatohet se çka është vërtetuar me ato prova dhe a është vërtetuar se të dënuarit e kanë kryer veprën për të cilën janë shpallur fajtor. Provat e administruara të cilave gjykata ua ka falur besimin janë kundërthënëse, e dëmtuara nuk ka mundur ta bëjë identifikimin e njërit të akuzuar, por ka bërë vetëm identifikimin të akuzuarit tjetër. Edhe sipas dëshmisë së dëshmitarit F.S. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, del se ai të akuzuarit i ka takuar diku rreth orës 14.00 ose 15.00 të ditës kritike, ndërsa nga shkresat e lëndës rezultojnë se ngjarja ka ndodhur diku rreth orës 12:44 minuta, kurse nga deklaratat e dëshmitarit në fjalë të paraqitur më datën 24.02.2022 në stacionin policor në Fushë Kosovë, i njëjti kishte deklaruar se të dënuarit i ka takuar rreth orës 11:00, e që nga kjo shihet se kjo deklaratë ka qenë kundërthënëse përmes së cilës bëhet fjalë për kohë të ndryshme, kur ai ishte takuar me të dënuarit. Nga CD, nuk ka mundur të bëhet identifikimi i të dënuarve përveç që është konstatuar se të dënuarit kur ka ndodhur ngjarja e kanë frekuentuar vendin e ngjarjes, e që gjykata kësaj prove ja ka falur besimin duke e ndërlidhur me deklaratën e të dëmtuarës. Nga të theksuarat si më lartë, gjykata e shkallës së parë nuk e ka bërë vlerësimin e drejtë të provave për faktin se provat dalin të jenë kundërthënëse.
6. Nga arsyetimi i aktgjykimit rezultojnë se gjykata e shkallës së parë përveç që ka shënuar përmbajtjen e deklaratës së të dëmtuarës, deklaratës së dëshmitarit dhe CD si prova, të cilave edhe ua ka falur besimin, në arsyetimin e aktgjykimit nuk jepen arsye përmbajtësore lidhur me administrimin e këtyre provave dhe nuk bëhet vlerësimi i tyre në kontekst të provuarit të qartë të këtyre dëshmive dhe vërtetimit të drejtë të ekzistimit apo mos ekzistimit të veprës penale për të cilën të dënuarit ngarkohen sipas aktit akuzues.
7. Andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate të gjitha këto përbëjnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat aktgjykimin e kundërshtuar e bëjnë juridikisht të paqëndrueshëm dhe të cilat domosdoshmërisht edhe kanë kushtëzuar anulimin e aktgjykimit në fjalë.

8. Nga të theksuarat si më lartë, Kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 të KPP, pasi që i mungon plotësisht arsyetimi përkitazi me faktet vendimtare, ndërsa ai i shkallës së dytë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 404 paragrafi 1 të KPP, ngase nuk janë vlerësuar pretendimet e ankesës.
9. Në këtë mënyrë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç është theksuar edhe më lart dhe këto shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.
10. Përkundrazi, edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përmban një arsyetim të përgjithësuar dhe të mangët, duke mos i elaboruar dhe shtjelluar pretendimet thelbësore të paraqitura në ankesa, të cilat edhe nuk kanë qenë të pakta, si dhe duke i anashkaluar dhe konsideruara si të drejta dhe të ligjshme konkludimet e gjykatës së shkallës së parë, edhe pse të njëjtat kanë qenë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron se gjykata e shkallës së dytë është dashur që në lidhje me këto pretendime të mbrojtjes, të paraqes arsye të qarta dhe të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare- vendimin mbi dënimin. Duke vepruar kështu gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me pretendimet e mbrojtjes sipas ankesës.
11. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se mos paraqitja e arsyeve në lidhje me pretendimet thelbësore të mbrojtjes, përveç që përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara më parë, një gjë e tillë përbën edhe shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.
12. Andaj, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovoj si të bazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve A.D dhe B.H., ndërsa të anulohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

13. Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilat janë përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

14. Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktoj edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitoj të gjitha shkeljet e lartcekura, ku pas administrimit të serishëm të të gjitha provave, duhet të marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm për çdo pikë të aktgjykimit, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

15. Nga arsyet që janë theksuar më lart dhe në bazë të nenit 438, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.690/2023, i datës 10.01.2023

”Duke u bazuar në nenin 44, paragrafi 1. të KPRK, zëvendësimi i dënimit me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj, është vetëm një mundësi që e ka në dispozicion gjykata, përkatësisht një gjë e tillë nuk është detyrim“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1349/2021, të datës 14.04.2022, të dënuari Gj.P. është shpall fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186, paragrafi 1.lidhur me nenin 31 të KPRK dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (muaj) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në kuptim të nenit 44 të KPRK, me pëlqimin e të dënuarit dënimin me burgim i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) € të cilin dënim është obliguar i dënuari ta paguaj në tre këste mujore duke filluar nga data 1-10 të secilit muaj, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I dënuari B.S., është shpall fajtor për veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 1.200 (njëmijë e dyqind) €, në të cilin dënim i llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak nga data 12.12.2019 deri më datë 12.02.2020. Të dënuarit janë obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për paushallin gjyqësor të paguajnë nga 20 €, për kompensimin e viktimave të krimit nga 30 €, për ekspertizën mjeko ligjore shumë prej 20 €. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.
2. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1427/2022, të datës 01.11.2023, me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar M.S. e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket vendimit mbi dënimin ashtu që Gjykata e Apelit të dënuarin Gj.P., për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, ndërsa të dënuarin B.S. për veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim do të ekzekutohet pas

plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dënuarit B.S., koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe në arrest shtëpiak nga data 12.12.2019 deri më datë 12.02.2020 , i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim. Në pjesët tjera aktgjykimi i ankmuar mbetet i pandryshuar.

3. Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit B.S., avokati M.Sh., për shkak të shkëljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ashtu që të ndryshohet aktgjykimi Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe të mbetet në fuqi aktgjykimi i shkallës ë parë ose me pëlqimin e të dënuarit të vendos në pajtim me nenin 44 të KPRK.
4. Zyra e Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.406/23, të datës 26.12.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoj shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësoj pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoj se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

6. Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se me një masë të lartë të dënimit siç i është shqiptuar të dënuarit nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, që si parim në vete ka edukimin, risocializimin që i dënuari me dënimin e mbajtur të kthehet si anëtar i dobishëm i shoqërisë ku në rastin konkret dënimi është shumë i lartë dhe do të ndikoj negativisht në zhvillimin e tij psiko-fizik. Edhe përkundër rrethanave lehtësuese të cilat janë paraqitur në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë si pranimi i fajësisë, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, vijimi i rregullt i procedurës rrethana të cilat ka qar gjykatën e shkallës së parë deri te dënimi i dhënë. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit ka kërkuar edhe zëvendësimin e dënimit me burgim në lartësi prej 6 (gjashtë) muaj në dënim me gjobë në mënyrë që të arrihet qëllimi i dënimit të shqiptuar dhe të bëhet risocializimi i të dënuarit.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se pretendimet e mbrojtësit të dënuarit janë të pabazuara, për faktin se me aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit.
2. Duke vlerësuar pretendimet e të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme fillimisht të theksoj faktin se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të shkeljes së ligjit penal lidhur me dënimin e shqiptuar, përkatësisht faktin se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, të ndryshuar me aktgjykimin e shkallës së dytë, ndaj të dënuarit është shqiptuar dënimi me burgim.
3. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar në suaza të dispozitës së nenit 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, e cila dispozitë parasheh dënimin me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit.
4. Në faqen e 5-të të aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë janë theksuar të gjitha rrethanat që kanë ndikuar në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit e po ashtu edhe janë renditur rrethanat lehtësuese dhe rrethanat rënduese të cilat janë marrë për bazë lidhur me shqiptimin e dënimit. Ndërsa, gjykata e shkallës së dytë, në faqen 4 të aktgjykimin të saj, duke theksuar edhe rrethana tjera të cilat nuk janë vlerësuar si rrethana rënduese, ka vendosur që ta ashpërsoj dënimin.
5. Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385, paragrafi 5. të KPP, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet vetëm në rastet kur gjykata i ka tejkualuar kompetencat ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit, ndërsa në rastin konkret nuk ka ndodhur një gjë e tillë.
6. Përndryshe, duhet theksuar faktin se nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimeve të shqiptuara, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkualuar kompetencat ligjore, kështu që edhe pretendimet e mbrojtësit të tij në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

7. Në lidhje me pretendimin për zëvendësimin e dënimit sipas nenit 44 të KPRK, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se duke u bazuar në nenin 44, paragrafi 1. të KPRK, zëvendësimi i dënimit me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj, është vetëm një mundësi që e ka në dispozicion gjykata, përkatësisht një gjë e tillë nuk është detyrim.
8. Fakti që ndaj të dënuarit është shqiptuar dënimi me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj, nuk do të thotë se çdo herë detyrimisht, duhet që të dënuarit t'i jepet mundësia që një dënim i tillë të zëvendësohet në dënim me gjobë.
9. Se a do t'i jepet mundësia të dënuarit që t'i zëvendësohet dënimi me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj në dënim me gjobë, është çështje që e vlerëson gjykata në çdo rast konkret, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat e rastit konkret, rrethana këto që mund t'i referohen si veprës penale, ashtu edhe vetë të dënuarit (cilësive dhe sjelljeve të tij).
10. Edhe në nenin 44, paragrafi 1. të KPRK është parashikuar se “*kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar*”, e që do të thotë se zëvendësimi i dënimit të tillë me burgim në dënim me gjobë është në diskrecionin e gjykatës, e cila duhet të vlerësoj nëse një gjë e tillë është e arsyeshme apo jo.
11. Andaj, në këtë mënyrë, duke u bazuar në këto që u theksuan më lartë dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.40/2024, i datës 06.02.2024

”Kjo Gjykatë, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët me rastin e vendosjes lidhur me këtë çështje penalo juridike nuk kanë dhënë arsyetim të mjaftueshëm për faktet vendimtare, për faktin se nuk kanë arritur të vërtetojnë se në rastin konkret a bëhet fjalë për një plagë apo për dy plagë tek i dëmtuari dhe kush ia shkaktoi lëndimet të dëmtuarit njëri i dënuar apo të dy të dënuarit, gjegjësisht gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur ta arsyetoj faktin se në cilat prova është bazuar kur ka konstatuar se i dëmtuari i ka dy plagë (kur të gjitha provat që gjinden në shkresat e lëndës-provat materiale-ekspertiza dhe ekspertët mjeko ligjorë të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor nuk e kanë vërtetuar këtë dhe dëshmojnë se i dëmtuari ka vetëm një plagë)”.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.361/2021 e datës 15.05.2023, të dënuarit H.Sh. dhe A.B., i ka shpallur fajtor për veprat penale vrasja në tentativë nga neni 172, lidhur me nenin 28 e 31 të KPRK-së dhe secilin veç e veç për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paaautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi.1 të KPRK-së, ndërsa të dënuarin A.B. për veprën penale pjesëmartja në rrahje nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK dhe për këto vepra i ka gjykuar: Të dënuarin H.Sh., pasi që i ka përcaktuar për veprën e parë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vite dhe për veprën e dytë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, me aplikimin e dispozitave për shqiptimin e dënimeve për veprat penale në bashkim konform nenit 76 të KPRK e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vite e 1 (një) muaj, në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, prej datës 08.02.2021 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Të dënuarin A.B., pasi që i ka përcaktuar për veprën e parë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vite dhe për veprën e dytë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, me aplikimin e dispozitave për shqiptimin e dënimeve për veprat penale në bashkim konform nenit 76 të KPRK e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vite e 1 (një) muaj, në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, prej datës 08.02.2021 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

2. Të dënuarin A.B. e ka shpall fajtor për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në afat prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale.
3. Të dënuarit janë obliguar që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të dënuarit H.Sh. dhe A.B. secili veç e veç të paguajnë shumën prej 200 € ndërsa i dënuari A.B. shumën prej 50 € si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, secili veç e veç shumën prej nga 50 €. I dëmtuari F.Xh., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.
4. Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.470/2023 e datës 13.10.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të dënuarve H.Sh. dhe A.B., ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.
5. Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:
 - mbrojtësi i të dënuarit H.Sh., avokati H.J., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurës penale, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe aplikimit të gabuar dhe jo të drejt të drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën si të bazuar dhe ti ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara ashtu që të dënuarin ta liroi nga akuzat apo aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.
 - mbrojtësi i të dënuarit A.B., avokati A.Gj., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën si të bazuar dhe të anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

6. Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me parashtrësën KMLP.II.nr.20/2024 e datës 24.01.2024, ka propozuar, që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve, të refuzohen si të pabazuara.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

Kërkesat e mbrojtësve për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të bazuara.

2. Mbrojtësi i të dënuarit H.Sh., pretendon në kërkesë se, të dy aktgjykimet përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 të KPP, për faktin se aktgjykimet nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 paragrafi 8 të këtij kodi, paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 zbatimi i gabueshëm i dispozitave të KPP. Pretendohet më tutje në kërkesë se aktgjykimet i shkallës së parë nuk i përmban arsyet për faktet vendimtare, ndërsa arsyet e paraqitura janë të paqarta e mjaft kontradiktore pa mbështetje në shkresat e lëndës. Gjykata ka pasur fakte kontestuese ku në aktgjykimet thuhet se për gjykatën kontestuese kishin mbetur zbardhja e fakteve se kush ia kishte shkaktuar këto plagë të dëmtuarit. Ky fakt kontestues për gjykatën sipas dispozitave ligjore duhet të shkojnë në favor të dënuarit e jo në dëm të tij krejt kjo në kuptim të parimit in dubio proreo.

3. Theksohet në kërkesë se, Gjykata e Apelit është dashtë të konstatoj se bëhet fjalë për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila ka ndikuar në marrjen e vendimit nga gjykata e shkallës së parë. Për çudi gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes ja fal besimin vetëm një prove deklarates së një dëshmitari i cili është shokë i të dëmtuarit dhe pjesëmarrës në rrahje e nuk ja fal besimin as një prove tjetër siç është ekspertiza mjeko ligjore, deklarata e mjekut në seancë gjyqësore, deklarata e dy dëshmitarëve okularë, në të njëjtën mënyrë vepron edhe gjykata e shkallës së dytë e injoron ankesën e mbrojtjes, nuk i vlerëson fare thëniet ankimore, për çka vendimi i tillë është dashtë të anulohet. Më tutje në kërkesë theksohet se, gjykatat e instancës më të ulët, nuk i janë përmbajtur zbatimit të dispozitave të nenit 370 paragrafi 7 të KPP,

gjegjësisht të vërtetohet se në cilat prova është bazuar gjykata se i dëmtuari i ka dy plagë. Theksohet se të gjitha provat në shkresat e lëndës e dëshmojnë pafajësinë e të dënuarit H.Sh. Në kërkesë elaborohen provat e administruara dhe mendimi dhe konstatimi i ekspertizës duhet të jetë i qartë se në rastin konkret a është një plagë apo dy plagë. Theksohet se me mendimet e dhëna nga ekspertët e fushës përkatëse dhe ekspertizat e tyre kjo gjë ka mbetur e pasqaruar dhe se në bazë të dispozitës së nenit 262 paragrafi 2 të KPP, gjykata nuk e shpall fajtor të akuzuarin duke u mbështetur vetëm në një provë.

4. Mbrojtësi të dënuarit A.B., pretendon se, aktgjykimi i kundërshtuar është i përfshirë me shkelje esenciale nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 10 e lidhur me nenin 369 paragrafi 6 dhe 7 të KPP, se arsyet e paraqitura nga gjykata e shkallës së parë, janë në kundërtënie të plotë me përmbajtjen e shkresave të lëndës, e po ashtu ka kundërtënie në mes dispozitivit dhe arsytimit, për faktin se i dënuari A.B. nuk e ka ndërmarr asnjë veprim inkriminues në drejtim të goditjes me thikë në të dëmtuarin F.Xh., dhe nuk vërtetohet me asnjë provë. Gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e sajë nuk ka paraqitur arsye për faktet vendimtare nuk ka paraqitur arsye të qarta se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Theksohet më tutje në kërkesë se gjykata e shkallës së parë, fare nuk e ka vlerësuar edhe mendimin e ekspertëve mjeko ligjor, ku kemi dy mendime të ekspertëve nga të cilat nuk rezulton bindshëm dhe në mënyrë të argumentuar se kemi të bëjmë me dy lëndime por vetëm me një. Aktgjykimi nuk mund të mbështetet në deklaratat e dëshmitarëve se kemi të bëjmë me dy plagë të goditur siç ka vepruar gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë por vetëm kur ka mbështetje në mendimin e ekspertëve, e ky mendim në rastin konkret mungon sepse nuk është zgjidhur dilema se a kemi të bëjmë me një apo me dy goditje-lëndime.
5. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve, janë të bazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave janë parashtruar kërkesat përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat pretendohet.
6. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas dispozitës së nenit 384 par.1 nënpar.1.10 të KPPK-së, përkatësisht nenit 369 par.6 dhe 7 të KPPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur arsyetim për çdo pikë të aktgjykimin, përkatësisht nuk ka paraqitur

qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara.

7. Bazuar në shkresat e lëndës rrjedh se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e bazon në dëshminë e të dëmtuarit, dëshminë e dëshmitarit E.Xh. dhe në provat materiale- ekspertizën e punuar nga eksperti mjeko ligjor Dr. N.U., i cili ekspert është deklaruar edhe në shqyrtimin gjyqësor lidhur me ekspertizën e punuar, e po ashtu në shqyrtim është marr për bazë edhe mendimi i ekspertit Dr. Artan Haxhiu.
8. Nga ekspertiza mjeko ligjore e datës 13.03.2021, e që ka të bëjë me natyrën e lëndimit të dëmtuarit F.Xh., rezulton se mendimi i ekspertit mjeko ligjor është i paqartë dhe lënë shumë dilema, se në rastin konkret a është një plagë apo janë dy plagë. Eksperti mjeko ligjor Dr. N.U., i dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor lidhur me këtë çështje, ka deklaruar se i gjithë dokumentacioni mjekësor dëshmon se tek i dëmtuari F.Xh. ekziston vetëm një plagë prerëse e cila është konstatuar në regjionin e majtë të qafës.
9. Edhe eksperti tjetër mjeko ligjor Dr. A.H., në seancën e shqyrtimit gjyqësor është përgjigjur “ Ne nuk mund ta vëmë një mendim përfundimtar se a kanë qenë një apo dy plagë, por nuk përjashtohet asnjëra nga këto dy mundësi. Pra lidhur me këtë se i dëmtuari a ka pasur një plagë apo dy plagë janë deklaruar dy ekspertë, mirëpo që ka mbetur e pa sqaruar dhe me dilemë se a bëhet fjalë vetëm për një plagë apo dy plagë dhe nuk ka mundur të vërtetohet nga gjykata e shkallës së parë drejtë fakti se te i dëmtuari F.Xh., ka ekzistuar vetëm një plagë apo dy plagë dhe a ishte goditur nga njëri i dënuar apo e kishin goditur dy të dënuarit dhe kush ja ka shkaktoi plagën. Pra, mbi bazën e këtyre provave dhe mendimeve të ekspertëve mjeko ligjor, nuk rezulton se aktgjykimi e ka mbështetur në prova materiale, sepse nga këto mendime nuk kemi një mendim të prerë, pa dilema, se a bëhet fjalë për një apo dy plagë, kur dihet se aktgjykimi nuk mund të mbështetet në supozime, por në fakte dhe prova.
10. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejt provat materiale-ekspertizën mjeko ligjore dhe mendimet e eksperteve mjeko ligjor të dhëna lidhur me këtë fakt të pavërtetuar, dhe nuk janë paraqitur arsye të mjaftueshme lidhur me kundërthëniet që janë paraqitur dhe dilemat

rreth kësaj çështje, nga kjo rrjedh se edhe dispozitivi i aktgjykimit është paqartë, kundërthënë me vetveten dhe në kundërshtim edhe me arsyetimin e aktgjykimit.

11. Kjo Gjykatë, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët me rastin e vendosjes lidhur me këtë çështje penalo juridike nuk kanë dhënë arsyetim të mjaftueshëm për faktet vendimtare, për faktin se nuk kanë arritur të vërtetojnë se në rastin konkret a bëhet fjalë për një plagë apo për dy plagë tek i dëmtuari dhe kush ia shkaktoi lëndimet të dëmtuarit njëri i dënuar apo të dy të dënuarit, gjegjësisht gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur ta arsyetoj faktin se në cilat prova është bazuar kur ka konstatuar se i dëmtuari i ka dy plagë (kur të gjitha provat që gjinden në shkresat e lëndës-provat materiale-ekspertiza dhe ekspertët mjeko ligjorë të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor nuk e kanë vërtetuar këtë dhe dëshmojnë se i dëmtuari ka vetëm një plagë).
12. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes i ka besuar vetëm dëshmisë së të dëmtuarit dhe një dëshmitari i cili ishte shokë i të dëmtuarit dhe pjesëmarrës në rrahje e besimin nuk ja fal asnjë prove tjetër siç janë ekspertiza mjeko-ligjore, deklaratat e mjekëve ligjor Dr. N.U. dhe Dr. A.H., mendimin e tyre të dhënë në shqyrtimin gjyqësor lidhur me këtë fakt, nga të cilat prova është vërtetuar e kundërta, se në rastin konkret kemi të bëjmë vetëm me një plagë.
13. Meqenëse në rastin konkret konstatimet e ekspertëve sipas ekspertizave nuk janë të qarta dhe nuk dihet për sa plagë bëhet fjalë për një plagë apo dy plagë, dhe vënë në pikëpyetje dilemën se kush të dëmtuarit ja shkaktoi plagën gjegjësisht a ishte i goditur i dëmtuari vetëm prej njërit të dënuar apo u godit nga të dy të dënuarit dhe dilema për këtë ka mbetur e pasqaruar, vendimi i gjykatës së shkallës së parë i vërtetuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, tani për tani nuk mund të pranohet, nga kjo Gjykatë, andaj u vendos që çështja të kthehet në rivendosje.
14. Në këtë mënyrë, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ti aprovojë si të bazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve, ndërsa të anulohen aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

15. Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara më lart, me të cilat është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e të cilat nuk janë evituar as me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet serish në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

16. Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitojë të gjitha shkeljet e lartcekura, ndërsa pas ndërmarrjes së veprimeve procedurale të sugjeruara dhe administrimit të serishëm të të gjitha provave, të kërkoj të bëhet një ekspertizë nga grupi i ekspertëve të fushës përkatëse e pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penale juridike.

17. Nga arsyet që janë theksuar më lart dhe në bazë të nenit 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.73/2024, i datës 04.04.2024

”Sipas dispozitës së nenit 17 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të Lartë Publik dhe deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (që ishte në fuqi) shprehet:

Kushdo që shkel detyrimet e përcaktuara me këtë ligj, që nuk janë vepra penale, zyrtari i lartë bënë kundërvajtje dhe dënohet”.

“Nga përshkrimi ligjor i ligjit-përkatësisht nenit 17, qartë rezulton, se për mos deklarim apo deklarim të pasaktë të pasurisë, të përfitur në mënyrë të ligjshme, nga neglizhenca e deklaruesit, paraqet veprim të kundërligjshëm, por tërheq përgjegjësi kundërvajtëse e assesi vepër penale, për faktin se norma shprehet “nëse nuk është vepër penale“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PM.nr.642/2023 të datës 27.04.2023, të dënuarin I. R., e ka shpall fajtor për veprën penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 437 paragrafi 2 të KPRK dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do ti ekzekutohet nëse i dënuari në periudhën e verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata do t’ia zëvendësojë me dënim me burgim duke ia llogaritur për çdo 20 € me një ditë burgim. Është obliguar i dënuari që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor shumë prej 20 € dhe për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumë prej 20 €.
2. Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PA1.nr.866/2023 e datës 20.10.2023, e ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit

vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin me kusht ashtu që Gjykata e Apelit të Kosovës, të dënuarit I. R., për veprën për të cilën është shall fajtor nga gjykata e shkallës së parë i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) € i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata do t'ia zëvendësojë me dënim me burgim duke ia llogaritur për çdo 20 € me një ditë burgim.

3. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur: Mbrojtësi të dënuarit I. R., avokati R. L. nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ashtu që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosije.
4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.42/2024 e datës 02.02.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 paragrafi1 lidhur me nenin 436 paragrafi1 të KPPK-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

- mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, pretendon se, gjykatat me aktgjykimet e kundërshtuara kanë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga se nuk kanë dhënë arsye të qarta që kanë të bëjnë me faktet relevante, pse në rastin konkret i dënuari nuk e ka deklaruar pasurinë për faktin se kjo veprë penale kryhet vetëm me dashje jo me pakujdesi dhe nuk kanë dhënë asnjë arsye se cili ishte qëllimi i të dënuarit për ta mos e deklaruar këtë pasuri, a e bëri këtë me dashje dhe se këtë pasuri e kishte fituar në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme, e që aktgjykimin e bënë juridikisht të paqëndrueshëm. Më tutje në kërkesën e mbrojtësit bëhet elaborimi i dispozitës së nenit 17 të ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave të këtij ligji , me arsyetimin se sipas kësaj dispozite “kushdo që

shkel detyrimet e përcaktuara me këtë ligj, *që nuk janë vepra penale*”, zyrtari i lartë publik bënë kundërvajtje dhe dënohet për kundërvajtje.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të dënuarit I. R., janë të bazuara, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarit, ndërsa këto shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.
2. Sipas shkresave të lëndës dhe aktgjykimeve të kundërshtuara rezulton se i pandehuri me rastin e deklarimit të pasurisë si prodekan i Fakultetit të Mjekësisë, ka lëshuar ta deklaroj një pasuri-truall në fshatin M. komuna e Gj. dhe tokën e trashëguar nga paraardhësi i tij në fsh. N. komuna e K., të cilën pasuri në vitet paraprake e kishte deklaruar.
3. Kjo gjykatë vlerëson se mos deklarimi i pasurisë apo deklarimi i rrejshëm i pasurisë përbën vepër penale nga neni 430 të KPRK, vetëm kur kjo pasuri është *përfiturar në mënyrë të paligjshme* por jo edhe atëherë kur pasuria e padeklaruar apo e deklaruar gabimisht, është e fituar në mënyrë të ligjshme dhe deklaruesi nuk ka pas asnjë arsye që ta fshehtë atë pasuri, por nga neglizhenca, pakujdesia nuk e ka deklaruar, apo nuk e ka deklaruar saktë.
4. Sipas dispozitës së nenit 17 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të Lartë Publik dhe deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (që ishte në fuqi) shprehet:
5. Kushdo që shkel detyrimet e përcaktuara me këtë ligj, *që nuk janë vepra penale*, zyrtari i lartë bënë kundërvajtje dhe dënohet.
6. Nga përshkrimi ligjor i ligjit-përkatësisht nenit 17, qartë rezulton, se për mos deklarim apo deklarim të pasaktë të pasurisë, *të përfiturar në mënyrë të ligjshme*, nga neglizhenca

e deklaruesit, paraqet veprim të kundërligjshëm, por tërheq *përgjegjësi kundërvajtëse* e assessi *vepër penale, për faktin se norma shprehet “nëse nuk është vepër penale”*.

7. Sipas këtij neni, zyrtari publik është penalisht përgjegjës, vetëm po që se pasurinë nuk e ka deklaruar fare apo e ka deklaruar rrejtshëm (p.sh. kinse e ka trashëguar, ju ka dhuruar etj. Ngase e ka të përfituar në mënyrë të paligjshme dhe nuk mund të arsyetoj, se ka i ka ardhë kjo pasuri.
8. Dispozita e nenit 430 të KPRK, i përmban dy forma të veprimit dhe një paragraf konfiskimi e cila përcakton se **1.** Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarinim e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. **2.** Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarinim e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili falsifikon ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. **3.** Vlera e padeklaruar ose e deklaruar rrejtshëm e pasurisë, të ardhurave, dhuratave ose të dobisë tjetër pasurore, *konfiskohet*.
9. *Neni 430 është emërtuar: Mos raportim apo raportim i rremë.....*
10. Kjo Gjykatë vlerëson se, nuk mund konsiderohet raportim *i rremë*, kur zyrtari, gabimisht e ka deklaruar pasurinë e fituar ligjërisht, por nga pakujdesia ka gabuar, p.sh. nga tri parcela të ligjshme (*të trashëguara*) vetën 1 e ka deklaruar në formular, ky është deklarim *jo i saktë* por *jo i rrejtshëm*, pastaj, mos deklarimi fare i ndonjë pasurie, p.sh. shtëpi të blerë nga të ardhurat personale-kredi , trashëgim etj. nuk është vepër penale, por është kundërvajtje.
11. Ky nen sanksionon vetëm mos deklarimin fare të ndonjë pasurie, apo deklarimi i rrejtshëm (p.sh. mënyrën e fitimit etj.) që është përfituar në mënyrë të paligjshme, në mënyrë të qartë e konfirmon paragrafi 3. i cili shprehet: *Vlera e padeklaruar ose e deklaruar rrejtshëm e pasurisë, të ardhurave, dhuratave ose të dobisë tjetër pasurore, konfiskohet*.

12. Sipas nenit 92 të KPK, konfiskohet vetëm pasuria e përfitur me vepër penale, nuk mund të konfiskohet pasuria e pa deklaruar dhe në asnjë rast, të proceduar penalisht në gjykatat e Kosovës, *nuk është zbatuar paragrafi 3. nuk është konfiskuar pasuria e padeklaruar apo e padeklaruar në mënyrë të pasaktë, ngase ka qenë e përfitur në mënyrë të ligjshme, ndërsa paragrafi 3 nuk i lë diskrecion gjykatës, nuk thotë” mund”* por gjykata detyrimisht nëse e shpall fajtor të pandehurin për këtë vepër penale, atij i konfiskohet pasuria e padeklaruar, apo e deklaruar rrejshëm, ndërsa u tha më sipër, konfiskohet vetëm pasuria e përfitur me vepër penale jo edhe ajo e fituar në mënyrë të ligjshme.
13. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se, sikur qëllimi i ligdhënësit të ishte që çdo mos deklaram të pasurisë ta konsideronte vepër penale, nuk do e përdorte shprehjen *“nëse nuk është vepër penale“* dhe nuk do parashihte dënime për kundërvajtje, ngase nuk mund veprimi i *njëjtë të jetë edhe kundërvajtje edhe vepër penale*. Deri tani, në asnjë rast, për mos deklaram të pasurisë apo deklarimit jo të saktë, nuk janë iniciuar procedura për kundërvajtje siç e parasheh ligji, pse po ekzistuan këto dispozita ndëshkuese për kundërvajtje?, *ose kur do vihen në zbatim këto dispozita ndëshkuese për kundërvajtje në praktikë?*
14. Vetë fakti se Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë, ka paraparë dispozita ndëshkuese për kundërvajtje, duke i përcaktuar saktë edhe gjobat, shpjen në përfundim të qartë dhe lehtas të kuptueshëm *për këndo se “mos deklarimi apo deklarimi jo i saktë i pasurisë e cila është e përfitur në mënyrë të ligjshme”* është vetëm kundërvajtje, në asnjë mënyrë vepër penale e që ndëshkohet sipas nenit 17 të Ligjit të cituar.
15. Sikur qëllimi i ligdhënësit të ishte: që si pasurinë e fituar në mënyrë të ligjshme edhe atë të paligjshme të pa deklaruar apo të deklaruar në mënyrë jo të saktë , *ta sanksiononte si vepër penale*, në Ligjit Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave Për të Gjithë Personat Zyrtarë Ligjit Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave Për të Gjithë Personat Zyrtarë, *nuk do parashihte kundërvajtje* për mos deklarim të

pasurisë, por do i rregullonte vetëm procedurat por jo edhe dispozitat ndëshkuese për kundërvajtje, *pastaj neni 430 do ishte* ndryshe i strukturuar , dm.th. do përmbante paragraf të posaçëm, për pasurin e padeklaruar dhe të përfituar me abuzim dhe paragraf të posaçëm për pasurinë e padeklaruar apo të deklaruar në mënyrë të pa saktë, por të fituar në mënyrë të ligjshme, ngase në aspektin penal, nuk mund të kenë të njëjtin status (dënimi i njëjtë) si pasuria e ligjshme si ajo e paligjshme e pa deklaruar.

16. Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë përfshirë me shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarit, dhe për këtë arsye u vendos që konform neni 438 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.194/2024, i datës 02.04.2024

”Janë të bazuara pretendimet e mbrojtëses të të dënuarit se gjykata e shkallës së dytë nuk e ka njoftuar të dënuarin për seancën e kolegjit me qëllim që të paraqes aspektet dhe argumentet e tij lidhur me ketë çështje penale. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate duke mos e njoftuar të dënuarin për seancën e kolegjit është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë e të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të KEDNJ”.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm P.nr.427/2023 datë 06.06.2023, i dënuari S.D. është shpall fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, për të cilën veprë është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dënuarit konform nenit 64 të KPRK i është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i drejtimit të automjetit në periudhën prej 1 (një) viti, pas kryerjes së dënimit. Në dënimin e shqiptuar të dënuarit i është llogaritur edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 20.05.2023 e deri m datë 06.07.2023. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Është obliguar i dënuari që të paguaj taksën për kompensimin e Viktimave të Krimit në shumë prej 20 €, shpenzimet e procedurës penale për ekspertizë të komunikacionit në shumë prej 124 € dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €.
2. Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.1141/2023 datë 14.12.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ankesën e mbrojtëses të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.
3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit, avokate Sh.R., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar

kurse aktgjykimin e Gjykatës së Apelit ta anuloj dhe çështjen t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rivendosje.

4. Ndaj kërkesës së mbrojtëses të të dënuarit është përgjigjur Prokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.113/2024 datë 25.03.2024, me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.
5. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 paragrafi 1 dhe 436 paragrafi 1 të KPP-së, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se: -Kërkesa është e bazuar.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Janë të bazuara pretendimet e mbrojtëses të të dënuarit se gjykata e shkallës së dytë nuk e ka njoftuar të dënuarin për seancën e kolegjit me qëllim që të paraqes aspektet dhe argumentet e tij lidhur me këtë çështje penale. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate duke mos e njoftuar të dënuarin për seancën e kolegjit është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë e të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të KEDNJ.
2. Për raste të tilla, me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës KL.nr.104/2016 datë 29 maj 2017, është konkluduar (bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së) se garantitë e përmbajtura në nenin 6 paragrafi 1 e 3 të Konventës vazhdojnë të zbatohen në të gjitha fazat e procedurës penale. E drejta në mbrojtje sipas dispozitës së lartcekur të Konventës përfshinë të drejtën e të akuzuarit për të mbrojtur veten, të drejtën për ndihmë juridike duke përfshirë ndihmën juridike falas si dhe të drejtën e të akuzuarit për të qenë i pranishëm në të gjitha veprimet në procedurë. Duke mos ia mundësuar të akuzuarit që të merr pjesë në seancën e mbajtur në shkallë të dytë lidhur me akuzën penale kundër tij sipas konkludimit të Gjykatës Kushtetuese është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm i garantuar me Kushtetutën e Kosovës dhe Konventën Evropiane.
3. Për arsyet e lartcekura është anuluar vetëm aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe çështja i kthehet të njëjtës në rigjykim e cila duhet të evitohet shkeljet e lartcekura duke e njoftuar

të dënuarín dhe mbrojtësin e tij për seancën e kolegjit e pastaj të merr vendim në këtë çështje.

4. Nga, sa u tha me lartë e konform dispozitës së nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr. 250/2024, i datës 15.05.2024

”Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, qëndron pretendimi nga kërkesa e Prokurorisë së Shtetit se është shkelur ligji penal në dobi të pandehurit. Sipas Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës, si ligj i veçantë, Dogana e Kosovës është institucion shtetëror që është e rregulluar dhe funksionon sipas rendit juridik të Shtetit të Republikës së Kosovës, Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare, ligjeve dhe akteve të brendshme mbi bazën e të cilave kryen punët dhe përgjegjësitë që i takojnë në të gjitha rastet, e në rastin konkret edhe në lidhje me atë që zyrtarët e Institucionit të Doganës së Kosovës e kanë bërë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj me aktvendimin P.nr.441/19 të datës 05.07.2023, e ka aprovuar kërkesën e mbrojtësit të pandehurit V. D. për kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe provat e marra me rastin e kontrollimit nga Dogana e Kosovës në subjektin afarist –deponinë N:T:P. “E” i ka shpall prova të papranueshme dhe e ka hedhur aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë e ka pushuar procedurën penale ndaj të pandehurit V. D., për veprën penale shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.
2. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PN.nr.1258/23 të datës 31.08.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.
3. Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur Prokuroria e Shtetit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të aprovohet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë si e bazuar dhe të konstatohet se aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në favor të pandehurit.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 paragrafi. 1 lidhur me nenin 436 paragrafi. 1 të KPP dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se: -kërkesa është e bazuar.
5. Prokurori i Shtetit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, përveç tjerash pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me shkelje të ligjit penal në dobi të pandehurit V. D., për faktin se të gjitha provat si ato personale dhe materiale vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK. Theksohet se të gjitha provat që janë prezantuar dhe paraqitur me aktakuzën e prokurorisë të datës 13.09.2019, gjykatat e instancave më të ulëta nuk i kanë vlerësuar drejtë pasi që me gjitha provat pa asnjë dyshim provohet se veprimet e të pandehurit përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën akuzohet. Pretendohet se vendimi i gjykatës së Apeli kur ka konstatuar se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejt, po ashtu nuk është aspak i drejt dhe i bazuar, për faktin se provat e siguruar nga dogana e Kosovës, raporti i kontrollit nga ana e tyre i realizuar nga Sektori i Auditimit me datën 13.08.2015 në hapësirat dhe adresën e Biznesit N.T.P. “ E....”, është siguruar në mënyrë të ligjshme dhe ky raport është provë e pranueshme.
6. Më tutje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, theksohet se veprimet e zyrtarëve të Doganës së Kosovës kanë qenë në tërësi në korniza të përcaktuara nga ligji në këtë rast me Kodin Doganor dhe i Akcizave në Kosovë me Nr. 03/L-109, si ligj i veçantë. Më tutje në kërkesë janë elaboruar dispozitat ligjore të këtij ligji që e rregullojnë këtë çështje, me arsyetimin se veprimet e Doganës së Kosovës kanë qenë të ligjshme, ndërsa aktvendimet e të dy gjykatave janë përfshirë me shkelje të ligjit penal në dobi të pandehurit, andaj është propozuar që Gjykata Supreme ta aprovoj kërkesën si të bazuar dhe të konstatojë se të dy aktvendimet gjyqësore janë marrë me shkelje të ligjit në favor të pandehurit.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shikimit të shkresave të lëndës dhe aktvendimeve të kundërshtuara, vlerëson se pretendimet e Prokurorit në kërkesë për mbrojtjen ligjshmërisë janë të bazuara, për arsytet të cilat do ti paraqesim në vijim:
2. Aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë i vërtetuar edhe me aktvendimin e Gjykatës së Apelit, nga shkresat e lëndës rezultojnë të jetë i paqartë, jo i plotë dhe në kundërshtim me arsyetimin e dhënë, për arsye se: nga aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë rezultojnë se gjykata e ka aprovuar kërkesën e të pandehurit për kundërshtimin e provave dhe e ka hedhur aktakuzën dhe e ka pushuar procedurën penale ndaj të pandehurit për veprën penale të cilën ja ngarkonte aktakuzën, me arsyetimin se aktakuzën është mbështetur në prova të papranueshme-pasi që Prokuroria nuk ka arritur që të sigurojë asnjë provë me të cilën do të vërtetonte që policia e kishte aprovimin e gjyqtarit të procedurës paraprake për të realizuar kontroll në deponinë e të pandehurit. Gjykata provat e siguruar nga Prokuroria sa i përket të pandehurit V. D., i ka shpallur prova të papranueshme, pasi që të njëjtat janë siguruar në kundërshtim me dispozitat e KPP-së, se provat e siguruar përmes kontrollit të deponisë të të pandehurit janë siguruar-marrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 243 dhe nenit 251 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale.
3. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nga shkresat e lëndës, rezultojnë se aktakuzën e Prokurorisë ka qenë e bazuar në të gjitha provat personale dhe materiale të paraqitura në aktin akuzues, nga të cilat prova të paraqitura, rezultojnë se i pandehuri ka kryer veprën penale shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK.
4. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, qëndron pretendimi nga kërkesa e Prokurorisë së Shtetit se është shkelur ligji penal në dobi të pandehurit. Sipas Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës, si ligj i veçantë, Dogana e Kosovës është institucion shtetëror që është e rregulluar dhe funksionon sipas rendit juridik të Shtetit të Republikës së Kosovës, Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare, ligjeve dhe akteve të brendshme mbi bazën e të cilave kryen punët dhe përgjegjësitë që i takojnë në të gjitha rastet, e në rastin konkret edhe në lidhje me atë që zyrtarët e Institucionit të Doganës së Kosovës e kanë bërë, realizuar me datën 13.08.2015, në hapësirat dhe

adresën e biznesit N.T.P. “E...” ku në mënyrë të drejtë dhe plotësisht të bazuar në ligje kanë kryer kontrollin pa paralajmërim. Veprimin e tillë zyrtarëve të Doganës së Kosovës ua mundëson Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, si ligji i veçantë.

5. Neni 19 i Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës, përcakton” se Dogana në përputhje me kushtet e parapara me dispozitat ligjore në fuqi, mund të kryejë të gjitha kontrollet, që ajo i konsideron të nevojshme, për tu siguruar se legjislacioni doganor po aplikohet drejtë.
6. Prandaj nga kjo dispozitë rezulton se të gjitha veprimet ndërmarra të zyrtarëve të Doganës së Kosovës dhe provat të cilat janë siguruar, janë prova legjitime, kanë qenë në pajtim me Kodin Doganor dhe i Akcizave të Kosovës.
7. Përtej kësaj, edhe me dispozitat e nenit 42 paragrafi 1, 198, 199 dhe nenit 200 paragrafi 1,2,3 të Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës, shprehimisht thuhet se mallrat e sjella në Kosovë duhet të barten pa vonesë nga personi i cili i sjell ato në Kosovë.
8. Po ashtu në bazë të nenit 198 të këtij Kodi thuhet se borxhi doganor i importit lind me rastin e vendosjes në qarkullim të lirë të mallrave që iu nënshtrohen detyrimeve të importit ose vendosjes së këtyre mallrave nën procedurën e importit të përkohshëm, me lirim të pjesshëm nga detyrimet e importit, në nenin 200 paragrafi 1,2,3 të këtij Kodi thuhet se borxhi doganor në import lind me rastin e shmangies së paligjshme nga mbikëqyrja doganore e mallrave, të cilat i nënshtrohen obligimit të pagesës së detyrimeve të importit, borxhi doganor lind në çastin kur mallrat i shmangen mbikëqyrjes doganore.
9. Nga të theksuarat më lartë, në rastin konkret sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, dy gjykatat e instancave më të ulëta, gabimisht e kanë aplikuar ligjin respektivisht janë bazuar vetëm në dispozitat e KPP- me arsyetimin se provat e siguruar nga Dogana e Kosovës janë prova të papranueshme sepse nuk janë siguruar në mënyrë të ligjshme.
10. Por nga shkresat e lëndës rezulton se në rastin konkret Dogana e Kosovës në bazë të nenit 19 të Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës, në përputhje me dispozitat ligjore

në fuqi, mund të kryejë të gjitha kontrollet, që ajo i konsideron të nevojshme, për të siguruar se legjislacioni doganor po aplikohet drejtë. Andaj veprimet e ndërmarra nga ana e zyrtareve doganor në rastin konkret kanë qenë, veprime plotësisht të drejta dhe të ligjshme dhe në pajtim me Kodin Doganor dhe i Akcizave të Kosovës si ligj i veçantë, që e zbatojnë Doganat e Kosovës. Andaj nga të theksuarat si më lartë në rastin konkret ndaj të pandehurit V. D. gjykatat e instancave më të ulëta gabimisht kanë aplikuar ligjin penal ngase me provat që i ka ofruar Prokuroria në aktakuzë, lidhur me këtë çështje penale rezulton se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e veprës penale për të cilën e ngarkonte aktakuza.

11. Nga këto shkaqe, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar sa i përket shkeljes së ligjit penal në dobi të pandehurit V. D., gjegjësisht aplikimi i ligjit i cili nuk ka mundur të aplikohet, u konstatua dhe u muarr vendimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 438.par.2 të KPPK.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.384/2023, i datës 22.12.2023

”Sipas dispozitës së nenit 270 par.1 të KPP -para se gjykata të mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë që ishte mjet, prokurori i shtetit e provon në shqyrtimin kryesor se pasuria ishte mjet i veprës penale për të cilën i pandehuri është dënuar. Kurse, sipas par.2 të njëjtit nen -nëse pasuria që është mjet i takon një pale të tretë, pasuria konfiskohet nëse:

2.1. pasuria ka qenë dhuratë e njoollorur; ose

2.2. pala e tretë e dinte ose mund të kishte dyshuar në mënyrë të arsyeshme se pasuria është përdorur si mjet“.

”Në rastin konkret nuk rezulton kontestues fakti se vetura e marrë me qira ishte përdorur si mjet i kryerjes së veprës penale, por nuk ishte argumentuar se ishte argumentuar se pala e tretë e dinte ose mund të kishte dyshuar në mënyrë të arsyeshme se pasuria është përdorur si mjet, për çka kjo gjykatë i kishte ndryshuar në këtë drejtim aktgjykimet e instancave me të ultë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.17/2022 datë 7 tetor 2022, të pandehurit T.S., A.B., S.R, F.R dhe A.Rr. i ka shpall fajtor për shkak se si bashkekzekutor e kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, parashikuar me nenin 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK, kurse të pandehurin A.B. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 366 par.1 të KPP, për të cilën i ka gjykuar:
 - T.S. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej tri (3) viteve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.12.2020 deri me 7.10.2022, dhe me gjobë në shumë prej 5000 (pesëmijë)€, të cilën gjobë është obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit apo me pëlqimin e tij mund ta paguajë edhe me këste;

- A.B. për veprën e parë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) viteve e tetë (8) muajve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 21.12.2020 deri me 7.10.2022, dhe dënime me gjobë në shumë prej 2500 (dy mijë e pesëqind) €, për veprën e dytë penale e ka gjykuar me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) € dhe konform dispozitës së nenit 76 par.2 nënpar.2.2 të KPRK e ka gjykuar me dënim unik me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë)€, të cilën gjobë është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit apo me pëlqimin e tij mund ta paguajë edhe me këste;
 - S.R me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) viteve e tetë (8) muajve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 16.12.2020 deri me 7.10.2022, dhe dënime me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) €, të cilën gjobë është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit apo me pëlqimin e tij mund ta paguajë edhe me këste; -F.R me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve e gjashtë (6) muajve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.12.2020 deri me 30.11.2022, dhe dënime me gjobë në shumë prej 1.500 (njëmijë e pesëqind) €, të cilën gjobë është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit;
 - A.Rr. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) viteve e tetë (8) muajve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.12.2020 deri me 7.10.2022, dhe dënime me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) €, të cilën gjobë është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit apo me pëlqimin e tij mund ta paguajë edhe me këste;
2. Konform dispozitës së nenit 92, 115, 282, 283 e 284 të KPP të pandehurve ju janë konfiskuar:
- sasia e narkotikut e llojit “marihuanë” me peshë të përgjithshme prej 47796.03.025 gram
 - të pandehurit T. i janë konfiskuar para të gatshme 3x100€ me numër serik UB3088698032; EA685013617 dhe EA2491143283; para të gatshme 1x50 me numër serik MD 1969642178; para t; gatshme 1x20 me numër serik UD5310264852; para të gatshme 1x20 franga zvicerane me numër serik 15M3328912; para të gatshme 1x10

franga zvicerane me numër serik 16C0607794; para të gatshme një dollar; një telefon “Samsung 6S”- ngjyrë; e zezë; me kartelë IPKO; një telefon “Samsung 10S”- ngjyrë e zezë, pa kartelë; çelësi i veturës 689-KS-510; librezë e veturës CRA 1173592 në emër të A.B.; dy kontrata-autorizime të veturave; vetura e tipit “F...” me targa ... -.- ..., ngjyrë e bardhë, me numër të sasisë Ë... në emër të A.B.;

-të pandehurit Fidan një telefon “IPHONE”- ngjyrë e zezë me numër të IPKO-së 049457-204; një telefon “Nokia” i zi; një çelës i veturës O..., me targa ...-.-...; para të gatshme 4x20 me numër serik U..., N..., UE5536208645 dhe EC1912639616; para të gatshme 1x10 me numër serik YA3542806871; para të gatshme 4x20 me numër serik UC4434243886, NA3903762718, UE5536208645 dhe EC1912639616; para të gatshme 1x5 me numër serik NB2012776848; IPKO; vetura O... B.. karvan, ngjyrë hiri me targa ...-.-..., me numër të sasisë Ë.. dhe me numër të librezës;

-të pandehurit A.Rr. para të gatshme 3x100 € me numër serik NA5214051316, EA7051080628, UB3078112583; para të gatshme 1x200€, me numër serik UC7041821158; para të gatshme 3x5 me numër serik NC6410415329, NC4825038266 dhe MA152563427; librezë e veturës “A....”- karvan me targa të Sllovakisë nr....-., ngjyrë hiri me nr. DK...; polisa e sigurimit me nr...., dhe numër serik-..., një çelës i veturës “A...” nr....-.; vetura “A...”- karvan, me targa sllovaqe dhe numër të shasisë Ë....; Iphone 12, me numër IMEI

-të pandehurit A.B. një armë gjahu- dy tytshë me numër serik 1., 32 copë fishek të kalibrave të ndryshëm.

3. Aktgjykimi i lartcekur në procedurën ankimore me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti special APS.nr.47/2022 datë 19 prill 2023 është ndryshuar sipas ankesave të mbrojtësve të pandehurve T.S., F.R e A.Rr. dhe sipas detyrës zyrtare vetëm përkritazi me pjesën konfiskuese dhe të pandehurit T.S. i janë kthyer sendet e konfiskuara si: para të gatshme 3x100 € me numër serik UB3088698032; EA685013617 dhe EA2491143283; para të gatshme 1x50 me numër serik MD 1969642178; para t; gatshme 1x20 me numër serik UD5310264852; para të gatshme 1x20 franga zvicerane me numër serik 15M3328912; para të gatshme 1x10 franga zvicerane me numër serik 16C0607794; para të gatshme një dollar; një telefon

“Samsung 6S”- ngjyrë; e zezë; me kartelë IPKO; një telefon “Samsung 10S”- ngjyrë e zezë, pa kartelë; çelësi i veturës ...-.-...; libreza e veturës CRA në emër të A.B.; dy kontrata-autorizime të veturave; vetura e tipit “F..” me targa ...-.-., ngjyrë e bardhë, me numër të sasisë E... në emër të A.B.; të pandehurit F.R para të gatshme 4x20 me numër serik UC4434243886, NA3903762718, UE5536208645 dhe EC1912639616; para të gatshme 1x5 me numër serik NB2012776848; kurse të pandehurit A.Rr. i janë kthyer para të gatshme 3x100 € me numër serik NA5214051316, EA7051080628, UB3078112583; para të gatshme 1x200 €, me numër serik UC7041821158; para të gatshme 3x5 me numër serik NC6410415329, NC4825038266 dhe MA152563427. Ankesat e mbrojtësve të pandehurve në pjesët tjera janë refuzuar si të pabazuara, po ashtu është refuzuar si e pabazuar edhe ankesa e prokurorit dhe ato të mbrojtësve të pandehurve A.B. dhe S.R.

4. Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të dënuarit A.B. avokati M.N., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që kërkesa të aprovohet, aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim apo të ndryshohen apo të ndryshohen ashtu që i dënuari të shpallet fajtor për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale nga neni 267 par.2 të KPRK dhe ndaj tij të shqiptohet një dënim me i butë kurse të lirohet nga akuza për veprën penale nga neni 366 par.1 të KPRK;

-mbrojtësi i të dënuarit F.R avokati T.A., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në marrjen e vendimit gjyqësor, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë;

-mbrojtësi i të dënuarit S.R, avokati G.R., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në marrjen e vendimit gjyqësor me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë;

-mbrojtësi i të dënuarit A.Rr. avokati R.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovet aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë;

-mbrojtësi i palës së dëmtuar F.... S.R.O me nr...., avokati N.T., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që kërkesa të aprovet, aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen sa i përket pjesës konfiskuese përkritazi me automjetin A..., dhe në këtë pjesë çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë.

5. Ndaj kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë është përgjigjur Prokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.231/2023 datë 7 gusht 2023 me propozim që kërkesa e mbrojtësit të dëmtuarës të hedhet si e papranueshme, kurse kërkesat e mbrojtësve të dënuarve të refuzohen si të pabazuara.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

- kërkesat e mbrojtësve të dënuarve A.B., S. e FR. nuk janë të bazuara, kërkesa e të dënuarit A.Rr. është e bazuar vetëm sa i përket pjesës konfiskuese, kurse, kërkesa e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarës F....R S.R.O nuk është e lejuar.

- a) pretendimet e mbrojtësve në kërkesa lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vlerësimi i kësaj gjykate përkritazi me to:

1. Mbrojtësi i të dënuarit A.B. në kërkesë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar me nenin 384 par.1 nënpar.1.8, 1.10 e 1.12 të KPP, sepse në arsyetim të aktgjyqimeve gjykatat nuk kanë paraqitë arsye për çdo pikë të aktgjyqimit përkritazi me të mbrojturin e tij, nuk

janë paraqitë qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron si të vërtetuara apo të pavërtetuara, e në mënyrë të veçantë nuk është bërë vlerësimi lidhur me saktësinë e provave kundërthënëse dhe arsyet të cilat janë bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjes juridike - veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të dënuarit. Gjykata e shkallës së parë përkitazi me të mbrojturin e tij tërësisht e ka bazuar aktgjykimin në mbrojtjen e të dënuarit Fidan të dhënë në polici dhe prokurori i cili ka qenë shumë kontraverz dhe e ka mohuar në shqyrtimet gjyqësore dhe me këtë është shkelur dispozita ligjore e nenit 262 par.2 të KPP. Me tej mbrojtësi citon dëshmitë e dëshmitarëve të këtij rasti si dëshminë e E.B., A.S., F.B., K.H., të ekspertës së balistikës Sh.Sh. dhe mbrojtjet e të dënuarve me pretendim se gjykatat nuk i kanë vlerësuar drejt mbrojtjet e të dënuarve në raport me provat e administruara.

2. Përkitazi me këtë bazë ligjore pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve S. e F.R janë të njëjta. Kështu, këta mbrojtës pretendojnë se është shkelur dispozita e nenit 384 e KPP sepse aktgjykimet janë bazuar në prova të papranueshme, ngase si prova kryesore lidhur me vendosjen janë marrë përgjimet telefonike dhe prokuroria dhe gjykata nuk ju kanë ofruar provë se të njëjta janë lejuar siç e parasheh kodi i procedurës penale. Gjatë shqyrtimeve gjyqësor kanë kërkuar që t'i lejohet dëgjimi i audio përgjimeve por kjo kërkesë nuk është marrë parasysh dhe kanë pasur qasje vetëm në transkriptimin e tyre nga policia. Gjykata vendimin e saj e ka bazuar në deklaratën e të dënuarit F.R të dhënë në polici, kurse në të njëjtën deklaratë i njëjti nuk është i njoftuar se është i liruar nga dëshmia në raport me prindin e tij, kurse konform nenit 128 par.1 nënpar.1.2 të KPP – deklarata është e papranueshme kur personi është i liruar nga dëshmimi, por nuk është vënë në dijeni për këtë ose shprehimisht nuk ka hequr dorë nga kjo e drejtë, apo kur udhëzimi dhe heqja dorë nuk është shënuar në procesverbal.
3. Kurse, mbrojtësi i të dënuarit A.Rr. pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar me nenin 384 par.1 nënpar.1.9, 1.10 dhe par.2 pika 2.4, 2.5, 2.6 e 2.7 të KPP, sepse dispozitivit e aktgjykimit janë të pakuptueshëm, në kundërshtim me arsyetimin e tyre, në to nuk janë paraqit arsyet lidhur me faktet vendimtare. Ka kundërthënënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimet e aktgjyqimeve dhe përmbajtjes së shkrësave të lëndës. Aktgjykimet nuk janë përpilua konform dispozitës

së nenit 369 të KPP dhe mbështeten në prova të papranueshme, dhe si të tilla janë të paligjshme.

4. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e lartcekura nuk janë të bazuara. Vlen të theksohet se mbrojtësi i të dënuarit A.B. edhe pse i kundërshton aktgjykimet e kundërshtuara për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga arsyetimi del se e konteston gjendjen faktike, për të cilën bazë kërkesa nuk mund të paraqitet, ngase kontestohen konkludimet e gjykatave në bazë të provave të administruara. Kurse, mbrojtësi i të dënuarit A.Rr. në ketë drejtim vetëm parafrazon dispozitat ligjore (nenin 384 par.1 nënpar.1.9, 1.10) por nuk jep arsye se ku manifestohen këto shkelje. Megjithatë, kjo gjykatë i vlerësoj ato dhe gjeti se janë të pabazuara. Aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkelje esenciale të pretenduara në kërkesa, ngase në arsyetimin e tyre janë paraqitur arsye të duhura dhe të drejta mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje juridiko-penale, ato kanë mbështetje në prova të administruara dhe janë arsyetuar drejt dhe plotësisht në pajtim me nenin 370 par.7 të KPP, kështu që arsyet të cilat i ka dhënë gjykata e shkallës së parë për qëndrimin dhe vlerësimin e saj përkritazi me provat e administruara dhe mbrojtjet e të dënuarve si të drejta i ka aprovuar edhe shkalla e dytë dhe si të tilla i aprovon edhe kjo gjykatë. Ndërsa, a e ka bazuar gjykata vendimin e saj në deklaratën e dhënë të të dënuarit Fidan në polici dhe prokurori do të behet fjalë në kuadër të pretendimeve përkritazi me shkeljen e ligjit penal.
5. Kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara edhe pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve S. e F.R dhe A.Rr. se aktgjykimet mbështeten në prova të papranueshme. Në fakt këto pretendime jo vetëm që janë të pabazuara por edhe të paqarta sepse nuk mund të kuptohet se në çka konsistojnë ato. Konform dispozitës së nenit 436 par.1 të KPP kjo gjykatë me rastin e vendosjes mbi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon, por nuk mund të supozoj se çka ka dashur të thotë paraqitësi i kërkesës. Konform dispozitave ligjore nenit 251 par.2 të KPP provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky kod ose dispozita të tjera të ligjit parashikojnë kështu. Mbrojtësit në kërkesa nuk theksojnë se cilat prova janë të papranueshme dhe me rastin e marrjes së tyre cila dispozitë është shkelur. Kurse, nga fakti se nuk ju është lejuar dëgjimi i audio përgjimeve dhe kërkesa e tyre është refuzuar nuk mund të

pretendohet se ato janë të papranueshme, ngase me dispozita ligjore nuk parashihet një gjë e tillë. Në fakt përgjimet siç del nga shkresat e lëndës janë marrë konform dispozitave ligjore, dhe meqenëse audio përgjimet janë transkriptuar dhe mbrojtësit i kanë pas në dispozicion është fare pa rëndësi fakti se gjykata ka refuzuar propozimin e tyre që të dëgjohen audio përgjimet. Ndërsa, është krejtësisht i pabazuar pretendimi se është shkelur dispozita e nenit 128 par.1 nënpar.1.2 të KPP, sepse i dënuari Fidan nuk është njoftuar se është i liruar nga dëshmia në raport me prindin e tij, ngase kjo dispozitë vlen për dëshmitarët e jo edhe për të pandehurit, i pandehuri F. në polici dhe prokurori nuk është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, por e ka dhënë mbrojtjen e tij si i pandehur, për çka kjo gjykatë pretendimet e mbrojtësit në këtë drejtim i konsideron edhe jo serioze. Në fakt konform dispozitës së nenit 122 par.3 të KPP informatat e dhëna nga i pandehuri mund të përdoren si dëshmi në gjykatë, por, sa këto informata janë të mbështetshme respektivisht provojnë elementet e veprës penale, shkaktimin e dëmit apo ndonjë çështje me rëndësi është çështje që vlerësohet nga gjykata.

- b) pretendimet e mbrojtësve përkitazi me shkeljet e ligjit penal dhe vlerësimi i kësaj gjykate përkitazi me këto pretendime:
1. Mbrojtësi i të dënuarit A.B. përkitazi me këtë bazë ligjore pretendon se është shkelur ligji penal dëm të dënuarit pasi që ai nuk ka ndërmarr kurrfarë veprimesh që do të mund të konsideroheshin veprime inkriminuese që përmbushin elementet e veprës penale nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK. Nga deklaratat e të bashkakuarve del se i dënuari ka pas kontakt vetëm me të dënuarin T., kurse me S. e F. nuk ka pas raporte të mira për shkak të problemeve familjare, dhe ai inkriminohet vetëm në bazë të deklaratimit të dënuarit F. në polici dhe prokurori. Sipas këtij mbrojtësi gjykatat e kanë shkelur ligjin penal në dëm të këtij të dënuari kur e kanë shpall fajtor për veprën penale të armëmbajtjes, nga neni 366 par.1 të KPRK për shkak se eksperti i balistikës ka deklaruar se arma ka qenë jofunksionale dhe është dashur që të behet riparimi i saj për tu bërë funksionale dhe arma ka qenë e vjetër dhe nuk ka pjesë që e njëjta të riparohet për shkak se është e modelit të vjetër dhe pjesët për këtë armë mund të gjinden vetëm në T. Ky mbrojtës në kuadër të shkeljes së ligjit penal e kundërshton edhe vendimin për dënim, me pretendim se nuk janë vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe po të ishin vlerësuar drejt pretendon se do të shqiptohej një dënim me i butë.

2. Edhe përkitazi me këtë bazë ligjore pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve S. e F.R janë të njëjta. Kështu, në kërkesa theksohet se me asnjë provë relevante nuk është vërtetuar se të dënuarit e kanë kryer veprën penale për të cilën janë shpallë fajtor, sepse nga vetë aktgjykimi dhe arsyetimi nuk formohen elementet qenësore për ekzistimin e kësaj vepre penale. Të dënuarit nuk i kanë konsumuar elementet e kësaj vepre penale ngase narkotikun nuk e kanë shpërnda, ble dhe as nuk e kanë shitur dhe transportuar. Sipas mbrojtësit të dënuarit F. i mbrojturi i tij vetëm e ka transportuar duke shfrytëzuar mendjelehtësinë dhe moshën e re nga personat që janë përballur edhe me herët me këso vepra penale me të cilët është bashkakuzuar. Po ashtu në kuadër të kësaj baze ligjore këta mbrojtës i kundërshtojnë edhe vendimet e shqiptuara.
3. Kurse, mbrojtësi i të dënuarit A.Rr. përkitazi me këtë bazë pretendon se është shkelur ligji penal në dëm të mbrojturit të tij për shkak se i mbrojturi i tij ka mundur të shpallet fajtor për veprën penale ndihmë nga neni 33 të KPRK në kryerjen e veprës penale nga neni 267 par.1 të KPRK. Sipas këtij mbrojtësi edhe konfiskimi i veturës se tij është bërë në kundërshtim me nenin 92 të KPRK sepse, sipas këtij neni mund të konfiskohet vetëm pasuria e përfitur me vepër penale.
4. Edhe përkitazi me këtë bazë ligjore mbrojtësit e të dënuarve nuk kanë dhënë arsye të qarta se në çka konsistojnë këto shkelje, kurse arsyet e dhëna në kërkesa i referohen gjendjes së fakteve, ngase, cilave prova dhe pse gjykata ua ka falë besimin, e cilave jo, madje qoftë ai edhe i gabuar ka të bëjë me gjendjen faktike, për të cilën bazë kërkesa nuk mund të ushtrohet, mirëpo, meqë gjendja faktike e determinon edhe zbatimin e ligjit penal kjo gjykatë i vlerësoj ato dhe gjeti se e nuk e venë në dyshim saktësinë e fakteve të vërtetuar me aktgjykime respektivisht janë të pabazuara.
5. Vlen të theksohet se pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve se nuk është provuar se të mbrojturit e tyre kanë kryer veprën penale nuk janë të bazuara. Nga shkresat e lëndës del se të dënuarit janë njohur mes veti me përjashtim të A.Rr.t. I dënuari T. të dënuarit A. e ka djalë halle, S. e ka djalë F., kurse A. e ka dhëndër S.
6. Nga provat e administruara, dëshmitë e dëshmitarëve, masat e fshehta teknike –të përgjimit dhe vëzhgimit dhe provat tjera të theksuara me detajisht në aktgjykimin e shkallës së parë dhe vet mbrojtja e të dënuarve del qartë se sasia e narkotikut e llojit

marihuanë në peshë prej 47 kg është siguruar në M. dhe është sjellë në Kosovë nga persona të panjohur fillimisht në fshatin L. dhe prej këtij fshati deri në P. Personi që nga personat e panjohur e kishte siguruar sasinë e narkotikut ishte T. personi që e kishte transportuar këtë sasi të narkotikut me veturë prej fshatit L. deri në P. ishte F., dhe personi që duhej t'i dorëzohej sasia e narkotikut ishte A. Transporti i kësaj sasive të narkotikut deri në P. është bërë nën përcjelljen edhe të dënuarve A.B. dhe S.R. Nga përgjimet telefonike vërtetohet se të dënuarit kanë vepruar në bashkëkryerje në këtë ngjarje, fillimisht ishin marrë vesh i dënuari T. me të dënuarin A., e pastaj me të dënuarin S. e F., dhe me 12.12.2020 rreth orës 19:30 në oborrin e SHSKUK respektivisht në parkingun e Entit Higjienik janë zënë në flagrancë tre të dënuarit T.S., F.R e A.Rr. derisa po e bartnin sasinë e narkotikut nga vetura "O.." në veturën "A...", të cilën e ka vozitur i dënuari A.

7. Në kuadër të kësaj gjendje faktike kjo gjykatë vlerëson se janë tërësisht të pabazuara pretendimet se nuk është provuar se të dënuarit e kanë kryer veprën penale. Qëndron fakti se i dënuari Fidan e ka pranuar veprën penale në polici dhe prokurori, por të pabaza janë pretendimet se gjykata e ka mbështet aktgjykimin në pranimin e këtij të dënuari, sepse gjendja faktike sikurse me lartë është vërtetuar nga provat materiale – masat e fshehta të përgjimit – bisedat e përgjuara telefonike në mes të dënuarve, dëgjimi i dëshmitarëve dhe mbrojtja e të gjithë të dënuarve, dhe konkludimet e gjykatave përkitazi me përgjegjësen penale të të dënuarve i mbështet edhe kjo gjykatë, dhe meqë gjykatat në këtë drejtim janë dhënë arsye të qarta të cilat i mbështet edhe kjo gjykatë nuk e sheh te nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësime në këtë drejtim.
8. Pretendimet e mbrojtësit të dënuarit A. se në veprimet e këtij të dënuari qëndrojnë elementet e veprës penale të ndihmës në veprën penale nga neni 267 par.2 të KPP janë të pabazuara. Kjo për faktin se sipas dispozitës së nenit 33 par.2 të KPRK ndihma për të kryer veprë penale përfshin, por nuk kufizohet në dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve të kryerjes së veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes se veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale.

9. Duke pasur parasysh faktin se sasia e narkotikut ishte e dedikuar për t'ju dorëzuar të dënuarit A., dhe në telefonin e tij kishte pranuar një foto të vend parkimit në oborrin e QKUK-së nga një numër slllovak dhe gjatë pranimit të sasisë së narkotikut është zënë kjo gjykatë bazuar në dispozitën e lartcekur vlerëson se as që mund të behet fjalë për ndihmë në kryerjen e veprës penale për të cilën është shpall fajtor.

10. Kjo gjykatë i vlerësoj si të pabazuara edhe pretendimet e mbrojtësit A.B. sa i përket veprës penale nga neni 366 par.1 të KPRK. Nuk është kontestues fakti se arma e gjetur tek shtëpia e të dënuarit A. ka qenë jo funksionale, mirëpo nga ky fakt nuk mund të pretendohet se i dënuari nuk mund të shpallet fajtor për këtë veprë penale. Kjo për faktin se sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertes së balistikës Shake Shala e cila është dëgjuar edhe në shqyrtimin gjyqësor arma edhe pse ka qenë e bllokuar dhe jo funksionale, nuk i ka funksionuar siguresa e cila e liron mekanizmin goditës, e njëjta me ndërrimin e pjesëve të dëmtuara, ndërrimin komplet të mekanizmit të këmbëzës ka mund të behet funksionale. Kurse, sipas ligjit për armë nr/05/L-022 - armë e çaktivizuar apo jofunksionale janë armë e kategorisë A, B, C dhe D, pjesët thelbësore të të cilave janë bërë në mënyrë të përhershme dhe të papërshtatshme për përdorim përmes çaktivizimit, duke siguruar se të gjitha pjesët thelbësore të armës janë bërë në mënyrë të përhershme jofunksionale dhe të pamundshme për t'u lëvizur, zhvendosur dhe për t'u modifikuar që do t'ia mundësonte armës për t'u riaktivizuar. Procedurat teknike dhe kërkesat e shënjitimit për çaktivizim duhet të vërtetohen nga organi kompetent. Kurse, sipas par. 3 nënpar.3.4 të këtij ligji nuk konsiderohen armë ato të cilat janë bërë të papërdorshme (të çaktivizuara) në mënyrë të përhershme, përmes zbatimit të procedurave teknike të cilat janë të përcaktuara nga organi kompetent.

11. Pra, duke pasur parasysh faktin se arma nuk ka qenë jofunksionale në mënyrë të përhershme pa bazë pretendohet se i dënuari është dashtë të lirohet nga akuza për këtë veprë penale.

12. Pretendimet e mbrojtësit të dënuarit A.Rr. përkitazi me konfiskimin e veturës se të mbrojturit të tij janë të bazuara. Në të vërtetë edhe pse mbrojtësi thirret vetëm në nenin 92 të Kodit Penal pretendimet në këtë drejtim janë të bazuara për këto arsye:

13. Nuk rezulton kontestues fakti se vetura “A..”- A.. karvan me targa të regjistrimit te Sllovak NR-...-, ngjyrë hiri, është përdorur nga i dënuari A. për kryerjen e veprës penale, dhe me akuzë është propozuar që kjo veturë të konfiskohet si mjet që është përdorur për kryerjes e veprës penale. Mirëpo, në rastin konkret nga shkresat e lëndës del se kjo veturë nuk është në pronësi të të dënuarit, por është në pronësi të palës së tretë – kompanisë së FENRIR CARS me seli në Sllovakia nga e cila i dënuari e kishte marrë veturën me qira, një fakt i tillë theksohet edhe në aktgjykimin e shkallës së parë.
 14. Por, sipas dispozitës së nenit 270 par.2 të Kodit të Procedurës Penale, nëse pasuria që është mjet i takon një pale të tretë, pasuria konfiskohet nëse: pasuria ka qenë dhuratë e njoollor ose pala e tretë e dinte ose mund të kishte dyshuar në mënyrë të arsyeshme se pasuria është përdorur si mjet. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës nuk rezultojn asnjë indikacion se vetuar e marrë me qira (fakti se vetura është marrë me qira nga i dënuari nga kompania F...R.S.R.O vërtetohet edhe nga kërkesa e kësaj kompanie që ia ka bërë gjykatës për kthimin e veturës, e të cilës ia ka bashkëngjitur edhe kontratën për qira, e të cilën kërkesë gjykata fare nuk e ka vlerësuar) ka qenë dhuratë e njoollor ose pala e tretë e dinte ose mund të kishte dyshuar në mënyrë të arsyeshme se pasuria është përdorur si mjet. Prandaj, kjo gjykatë e aprovoj kërkesën e mbrojtësit në këtë drejtim dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
 15. Vlen të theksohet se pretendimet në kërkesat e mbrojtësve të dënuarve sa i përket vendimit për dënim nuk qenë objekt shqyrtimi ngase përkitazi me ketë bazë ligjore nuk mund të ushtrohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.
- c) vlerësimi i kësaj gjykatë përkitazi me ankesën e të dëmtuarës F...S.R.O.:
1. Në këtë çështje juridiko penale kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar edhe përfaqësuesi i autorizuar (avokati N.T.) i të dëmtuarës F...S.R.O me nr.... me adresë P., ... N. me përfaqësues D.J. urban lidhur me automjetin A..., me numër të targave NR-...-... cili me aktgjykimet e kundërshtuara është konfiskuar si mjet i kryerje së veprës penale nga i dënuari A.Rr. e që tani me kërkesë pretendohet se është në pronësi të palës “Renta car F... S.R.O”, të shtetit të Sllovakisë.
 2. Kjo gjykatë pas shqyrtimit të kërkesës gjeti se ajo është e palejuar ngas sipas dispozitës së nenit 433 par.1 të KPP- kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqes Zyra e

Kryeprokurorit të Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë me nenin 424 par.1 të këtij kodi.

3. Pra, bazuar në dispozitën e lartcekur pala e dëmtuar nuk mund të ushtrojë këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, prandaj kjo gjykatë e hodhi atë si të palejuar.
4. Nga sa u tha me lartë e konform dispozitës së nenit 437, 438 par.1 pika 1.1 e 435 par.2 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.404/2023, i datës 05.10.2023

"Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë konform nenit 423 par.1 nënpar.1.3 të KPP mund të rishikohet nëse: zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale. Në rastin konkret parashtruesi i kërkesës faktet të cilat e vejnë në pikëpyetje gjendjen faktike të vërtetuar me aktgjykim të formës së prerë nuk i ka argumentuar me prova, por i ka propozuar gjykatës që të nxjerrën prova lidhur me këto fakte, por në kërkesën për rishikim të procedurës penale përveç bazës ligjore, pala duhet të tregojë provat me të cilat argumenton faktet në të cilat mbështet kërkesa".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, P.nr.26/2002 datë 17 shtator 2002, i dënuari A.A., për veprën penale vrasje, parashikuar me nenin 30 par.2 pika 3 të LPK, është gjykuar me tridhjetë e pesë (35) vite burgim, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 24 gusht 2001 e tutje.
2. Në procedurën ankimore aktgjykimi i lartcekur është vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin AP.nr.90/2003 datë 30.04.2003.
3. Aktgjykimet e lartcekura janë vërtetuar edhe në shkallën tretë, me aktgjykimin e kolegjit të veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës API.nr.2/2003 datë 9 mars 2004.
4. Kërkesë për rishikim të procedurës ka paraqitur i dënuari, të cilën kërkesë Gjykata Themelore në Gjiilan duke vendosur përkitazi me kërkesën me aktvendimin KP.nr.7/2022 datë 6 mars 2023, e ka refuzuar si të pabazuar.
5. Kundër këtij aktvendimi i dënuari ka paraqitur ankesë, kurse Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën, e ka refuzuar atë si të pabazuar me aktvendimin PN.nr.417/2023 datë 29 maj 2023.

6. Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar i dënuari, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes së dispozitave nga neni 427 i KPP të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit, me propozim që kërkesa të aprovohet dhe aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që në këtë çështje juridiko penale të lejohet rishikimi i procedurës penale ose të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosije.
7. Prokurori i Shtetit me parashtrësën me shkrim KMLP.II.243/2023 datë 15 gusht 2023 ka propozuar që kërkesa të refuzohet.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.
2. Në kërkesë i dënuari thekson se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas dispozitës së nenit 426 par.2 të KPP. Sipas të dënuarit fillimisht gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se nuk ekzistojnë arsye ligjore për rishikim ngase i dënuari nuk ka paraqitur asnjë provë apo dëshmi konkrete me të cilën do të argumentonte pafajësinë e tij, por në kërkesë nuk është aluduar në pafajësinë por në rikualifikim të veprës penale nga vrasje e rëndë për të cilën është gjykuar në vrasje të zakonshme për të cilën parashihet dënim më i butë. Pastaj, sipas të dënuarit në kërkesë është kërkuar të merren provat:
 - ekspertiza nga lëmi e ADN-së për të përcaktuar se njollat e gjakut në këmbën e karriges të kujt kanë qenë;
 - është kërkuar që të bëhet rikonstruimi i vendit të ngjarjes, në mënyrë që nga dëshmitarët e dëgjuar të cilët kanë qenë komshinj të tij, të arrihet të vërtetohet se bagazhi i veturës ka qenë i hapur para ngjarjes apo pas ngjarjes në mënyrë që të nxirret e vërteta se a ka qenë ngjarje e parapërgatitur siç pretendohet apo nuk ka qenë - rrethana këto që ndikojnë në rikualifikimin e veprës penale, po ashtu është kërkuar që të merren mostra dhe ti nënshtrohen ekzaminimit molekular dhe gjenetik të gjurmëve dhe njollave

të gjendura në bagazhin e veturës, për të përcaktuar se kur ka mund të ketë qenë i hapur bagazhi, si një rrethanë që tregon qëllimin nëse ka ekzistuar apo jo në rastin konkret, gjithnjë duke iu referuar rrethanave të cilat ndikojnë në rikualifikimin e veprës penale.

- është propozuar që të dëgjohej një dëshmitar - për të cilin tani për tani ka vendosur që të mbetet anonim për shkak të ndjeshmërisë së rastit, nga e cili dëshmi do të vërtetohet se tani i ndjeri ka qenë ai i cili i ka pasur obligim të dënuarit, dhe nuk ka qenë i dënuari ai i cili për përfitime materiale e ka ftuar të ndjerin në shtëpinë e tij siç kanë konkluduar gjykatat.

3. Për të gjitha këto gjykata është mjaftuar të jep arsyetim me dy fjalë se kinse të gjitha këto prova janë marrë në shqyrtim me rastin e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë. Kurse, bazuar në dispozitën e nenit 426 par.2 të KPP, pasi që kolegji shqyrtues merr përgjigjen në kërkesë kryetari i kolegjit urdhëron ekzaminimin. Me ekzaminim duhet kuptuar vetëm verifikimin e ekzistimit e fakteve të paraqitura në kërkesë dhe mbledhjen e provave që janë parashtruar në të, e që kjo nënkupton vetëm gjurmim jo vërtetim të fakteve, administrim apo vlerësim të provave të paraqitura. Kurse, në rastin konkret nuk është ndërmarrë asnjë veprim vetëm është theksuar se këto prova të propozuara janë marrë në konsideratë nga gjykatat.
4. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme në kërkesë nuk janë të bazuara, për këto arsye:
 - 4.1. Siç del nga shkresat e lëndës i dënuari A.A., me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.nr.26/2002 datë 17 shtator 2002, për veprën penale vrasje, parashikuar me nenin 30 par.2 pika 3 të LPK, është gjykuar me tridhjetë e pesë (35) vite burgim. Në procedurën ankimore aktgjykimi i lartcekur është vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin AP.nr.90/2003 e datës 30.04.2003. Aktgjykimet e lartcekura janë vërtetuar edhe në shkallën e tretë, me aktgjykimin e kolegjit të veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës API.nr.2/2003 datë 9 mars 2004.
 - 4.2. Ndaj aktgjykimeve të lartcekura kërkesë për rishikim ka paraqitur i dënuari konform bazës ligjore të parashikuar me nenin 423 par.1 nënpar.1.3 e 1.5 të KPP, për shkak se zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat vetë ose se bashku me provat

e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimit e tij sipas një dispozite me të butë penale dhe në rastin e dënimit për veprë penale në vazhdim ose vepra tjera penale të cilat sipas ligjit përfshijnë disa veprime të njëjta ose të ndryshme, zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja që tregojnë se i dënuari nuk e ka kryer veprimin që është përfshirë në veprën penale për të cilën ai është dënuar dhe ekzistimi i fakteve të tilla do të ishte me ndikim vendimtar në caktimin e dënimit.

- 4.3. Qëndron fakti se sipas dispozitës së nenit 426 par.2 të KPP, kur gjykata nuk e hedh kërkesën, kopja e kërkesës i dërgohet prokurorit të shtetit ose palës kundërshtare, e cila ka të drejtë që brenda tetë ditëve të përgjigjet në kërkesë. Pasi që gjykata të marrë përgjigje në kërkesë ose kur kalon afati për paraqitjen e përgjigjes, kryetari i kolegjit shqyrtues urdhëron gjurmimin dhe shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura në kërkesë dhe në përgjigje. Mirëpo, në rastet kur kërkesa për rishikim mbështetet në nenin 423 par.1 nënpar.1.3 e 1.5 të KPP kolegji shqyrtues vlerëson nëse faktet dhe provat e reja janë të cilësisë së tillë që mundësojnë ndryshimin e vendimit të formës së prerë, pra, këto fakte dhe prova mund ta vënë në dyshim gjendjen faktike të përcaktuara në procedurat e mëparshme, nëse kolegji shqyrtues formon bindjen se faktet dhe provat janë të përshtatshme dhe mund të rezultojnë me ndryshim të aktgjykimit e miraton kërkesën, nëse jo e refuzon atë.
- 4.4. Në fakt në kërkesë i dënuari faktet e cekura në kërkesë të cilat sipas tij e vejnë në pikëpyetje gjendjen faktike të vërtetuara me aktgjykimin e formës së prerë nuk i ka argumentuar me prova, por i ka propozuar gjykatës që nxjerr prova lidhur me këto fakte, përkundër faktit se në kërkesën për rishikim të procedurës penale përveç bazës ligjore, pala duhet të tregojë provat, me të cilat argumenton faktet në të cilat mbështet kërkesa. Pastaj çështja e motivit të kryerjes së veprës penale, mbrojtjes së nevojshme kanë qenë objekt shqyrtimi nga të tri instancat dhe faktet e cekura në kërkesë nuk janë të atilla me të cilat vihen në dyshim konkludimet e gjykatave në këtë drejtim.
5. Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes, kjo gjykatë vlerëson pa bazë pretendohet në kërkesë se vendimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë nuk janë të bazuara.
6. Nga sa u tha më lart dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.443/2023, i datës 31.10.2023

”Tejkalimi i aktakuzës në kuptimin subjektiv nënkupton kur me aktgjykim është përfshirë edhe ndonjë person i cili nuk ka qenë i përfshirë me aktakuzë ose i cili fare nuk ka qenë i akuzuar. Pastaj, gjykata me rastin e kualifikimit të veprës penale nuk është e lidhur me përshkrimin e gjendjes faktike në dispozitiv të akuzës, ajo është lidhur me përshkrimin faktik të dispozitivit të akuzës, kur e shpall fajtor për të njëjtën veprë penale, por edhe në këto raste gjykata është e autorizuar që duke mos e prekur bazën faktike të ngjarjes të bëjë ndryshime në përshkrimin e ngjarjes ashtu siç rezulton nga provat e administruara nga shqyrtimi gjyqësor“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktakuzën e Prokurorit Themelor në Prishtinë PP/I.nr.897/2022 datë 9.03.2023 i dënuari E.M., është akuzuar për shkak të veprave penale: trafikimi me njerëz, parashikuar me nenin 165 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK, dhunim në tentativë, parashikuar me nenin 227 par.4 pika 4.4 lidhur me par.1 e 28 të KPRK dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 366 par.1 të KPRK.
2. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me aktgjykimin PKR.nr.143/2023 datë 26 prill 2023, të dënuarin e ka shpall fajtor për veprën penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion, nga neni 234 par.1 të KPRK, për të cilën e ka gjykuar me dymbëdhjetë (12) muaj burgim dhe dënim me gjobë në shumë prej 10.000(dhjetëmijë)€. Në dënimin me burgim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 21.12.2022 e tutje. Ndaj të dënuarit është shqiptuar edhe dënimi plotësues- ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej tri vitesh.
3. Aktgjykimi i lartcekur në procedurën ankimore sipas ankesës së Prokurorit Themelor dhe mbrojtësit të dënuarit me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës –

Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.341/2023 datë 13 korrik 2023 është vërtetuar.

4. Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në pjesën dënuese ka paraqit mbrojtësi i të dënuarit avokati Sabri Ademi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovet aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza apo të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë. Ka kërkuar që ndaj të dënuarit të shtyhet ekzekutimi i sanksionit penal.
5. Ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë është përgjigjur Prokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.267/2023 datë 5 shtator 2023 me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:
 - kërkesa nuk është e bazuar.
2. Mbrojtësi i të dënuarit edhe pse aktgjykimet i kundërshton për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk konkretizon se cila dispozitë është shkelur. Kështu, sipas mbrojtësit aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale për faktin se me asnjë provë, fakt apo dëshmi nuk është vërtetuar se i dënuari e ka kryer veprën penale mundësimi apo detyrimi në prostitucion, nga neni 234 par.1 të KPRK të ri kualifikuar nga gjykata e për të cilën është shpall fajtor, ngase gjykata është dashtë të merr aktgjykim lirues siç ka vepruar për veprat tjera penale (dhunim në tentativë dhe armëmbajtje pa leje). Pra, gjykata nuk ka mundur ta ndryshojë përshkrimin dhe kualifikimin e veprës penale nën pikën I të akuzës nga vepra penale trafikimi me njerëz, nga neni 165 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK dhe të dënuarin ta shpall fajtor për një vepër penale tjetër mundësimi apo detyrimi në prostitucion nga neni 234 par.1 të KPRK

për të cilën nuk ka pasur prova. Duke vepruar kështu e ka tejkaluar akuzën, respektivisht fushëveprimin e fakteve nga akuza, sepse meqë nuk ka gjetur prova për veprën penale sipas akuzës është dashtë që ta lirojë për këtë veprë e jo t'i referohet dispozitës së nenit 359 par.2 të KPP, se gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale, edhe pse gjykata është e lidhur me përshkrimin e veprës penale të cilin përshkrim e ka ndryshuar në tërësi. Përveç kësaj, sipas mbrojtësit me asnjë provë materiale apo dëshmi nuk është vërtetuar se i dënuari e ka kryer veprën penale për të cilën është gjykuar, kurse, edhe dëshmia e të dëmtuarës në këtë drejtim është jo kredibile, e meqë aktgjykimet janë të përfshira me këto shkelje, sipas mbrojtësit edhe vendimi mbi dënimin me burgim, dënimin plotësues dhe shpenzimet e procedurës penale nuk është i drejtë.

3. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet në kërkesë nuk janë të bazuara. Në fakt edhe pse mbrojtësi me kërkesë aktgjykimet i kundërshton për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penal, nga përmbajtja e kërkesë del se kryesisht kundërshtohet gjendja faktike ngase kontestohen konkludimet e gjykatave në bazë të provave të administruara. Megjithatë, kjo gjykatë i vlerësoj pretendimet në kërkesë dhe gjeti se ato janë të pabazuara. Nga fakti se gjykata veprën penale të trafikimit me njerëz për të cilën është akuzuar i dënuari, e ka rikualifikuar në veprë penale mundësimi apo detyrimi në prostitucion, nuk mund të konkludohet se është tejkaluar akuza. Ngase, tejkalimi i aktakuzës në kuptimin objektiv nënkupton tejkalimin e aktakuzës kur me aktgjykim përfshihet edhe ndonjë veprë tjetër penale e cila nuk ka qenë objekt i aktakuzës. Kurse, tejkalimi i aktakuzës në kuptimin subjektiv nënkupton kur me aktgjykim është përfshirë edhe ndonjë person i cili nuk ka qenë i përfshirë me aktakuzë ose i cili fare nuk ka qenë i akuzuar. Pastaj, gjykata me rastin e kualifikimit të veprës penale nuk është e lidhur me përshkrimin e gjendjes faktike në dispozitiv të akuzës, ajo është lidhur me përshkrimin faktik të dispozitivit të akuzës, kur e shpall fajtor për të njëjtën veprë penale, por edhe në këto raste gjykata është e autorizuar që duke mos e prekur bazën faktike të ngjarjes të bëjë ndryshime në përshkrimin e ngjarjes ashtu siç rezulton nga provat e administruara nga shqyrtimi gjyqësor. Në rastin konkret provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor kanë provuar një gjendje tjetër faktike nga ajo e përshkruar në akuzë që ka determinuar një kualifikim tjetër ligjor, pra, në bazë të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk është provuar se i dënuari e kishte trafikuar (rekrutuar, transferuar, strehuar ose pranuar) të dëmtuarën me qëllim të

shfrytëzimit seksual, por qëllimi i tij ishte mundësimi apo detyrimi në prostitucion, prandaj, pa bazë pretendohet se gjykata nuk ka mundur ta beje rikualifikimin e veprës penale, por është dashur ta lirojë nga akuza.

4. Pretendimet sa i përket shkeljes së ligjit penal kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (ngase pretendohet se nuk është provuar se i dënuari e ka kryer veprën penale për të cilën është gjykuar) për të cilën bazë ligjore kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të parashtrahet – neni 432 par. 2 i KPP. Përkundër kësaj, kjo gjykatë vlerëson se pretendimet në këtë drejtim nuk e venë në dyshim saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara me vendimet kundër të cilave është paraqitur kërkesa dhe nuk ka shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit.
5. Kurse, edhe pretendimet sa i përket dënimit të shqiptuar nuk qenë objekt shqyrtimi ngase as përkitazi me këtë bazë ligjore nuk mund të paraqitet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.
6. Nga sa u tha më lart dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.504/2023, i datës 29.11.2023

”Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë konform nenit 423 par.1 nënpar.1.1 të KPP mund të rishikohet nëse: provohet se aktgjykimi është mbështetur në dokument të falsifikuar ose në deklaram të rremë të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit. Kurse, sipas par.3 të nenit 423 të KPP - në rastet nga paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2 ose paragrafit 2 i këtij neni, me aktgjykim të formës së prerë duhet vërtetuar se personat e tillë a janë shpallur fajtor për veprat penale përkatëse. Kur procedura kundër këtyre personave nuk mund të zbatohet për shkak se kanë vdekur ose ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, faktet nga paragrafit 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 ose paragrafi 2 i këtij neni mund të vërtetohen edhe me prova të tjera. Në rastin konkret gjykatat e kanë refuzuar kërkesën për rishikim të procedurës penale me arsyetimin se për tu lejuar rishikimi i procedurës penale konform dispozitës së nenit 423 par.1 nënpar.1.1 të KPP duhet të ekzistoj aktgjykimi i formës së prerë, por ky konkludim nuk ka mbështetje ligjore, ngase në rastet kur ekzistojnë pengesa për zhvillimin e procedurës penale si imuniteti, parashkrimi, amnistia, falja vdekja apo nuk dihet identiteti i autorit të falsifikimit, nuk kërkohet aktgjykim i formës së prerë kur këto rrethana mund të provohen edhe me mjetet tjera provuese“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për të mitur PKR.nr.132/2022 datë 15.03.2023, P.K., për veprën penale dhunimi, parashikuar me nenin 193 par.3 pika 5 lidhur me par.4 dhe nenin 23 të KPK është gjykuar me pesë (5) vite e gjashtë (6) muaj burgim.
2. Në procedurën ankimore aktgjykimi i lartcekur është ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.225/2023 datë 10 maj 2023 përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale dhe vendimit për dënim ashtu që veprimet e të pandehurit janë cilësuar si vepër penale e dhunimit, parashikuar me nenin 193 par.4 lidhur me nenin 23 të KPK dhe i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve.

3. Kundër aktgjykimeve të lartcekura ka paraqitur kërkesë për rishikim të procedurës penale mbrojtësi i të dënuarit dhe Gjykata Themelore në Pejë respektivisht kolegji shqyrtues, duke vendosur përkitazi me kërkesën me aktvendimin PK.nr.110/2023 datë 19.07.2023, e ka refuzuar atë si të pabazuar.
4. Aktvendimi i lartcekur në procedurën ankimore sipas ankesës së mbrojtësit të dënuarit, është vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.1001/2023 datë 29.08.2023.
5. Kundër aktvendimit të shkallës së parë dhe shkallës së dytë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit avokati Y.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën për mbrojtjen të ligjshmërisë si të bazuar dhe të anulohen aktvendimet e kundërshtuara dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë ose të ndryshohen ashtu që të aprovohet kërkesa për rishikim të procedurës penale.
6. Ndaj kërkesës së mbrojtësit është përgjigjur Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.302/2023 datë 3 tetor 2023, me të cilën ka propozuar që kërkesa e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:
 - kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.
2. Fillimisht kjo Gjykatë e sheh të nevojshme të theksoj rrjedhën e procedurës penale në këtë çështje juridiko penale:
3. Siç del nga shkresat e lëndës me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë (tani Gjykata Themelore në Pejë) P.nr.241/2012 datë 6.11.2012 i pandehuri P.K., për veprën penale

të dhunimit, nga neni 193 par.3 pika 5 lidhur me par.4 të KPK (kodi penal i vitit 2004 i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale) është gjykuar me dy (2) vite burgim në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 29.02.2012 deri me 6.11.2012. Ky aktgjykim në procedurën ankimore sipas ankesës së mbrojtësit është anuluar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.222/2013 datë 13.03.2014 dhe çështja i është kthyer në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

4. Në rigjykim Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti për të mitur me aktgjykimin PKR.nr.141/2015 datë 15.07.2021 të pandehurin për veprën penale të lartcekur e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve e tetë (8) ditëve. Ky aktgjykim në procedurën ankimore sipas ankesës së të dëmtuarës me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.217/2022 datë 6.07.2023 është anuluar dhe çështja është kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
5. Në rigjykim gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin PKR.nr.132/2022 datë 15.03.2023 i pandehuri shpallet fajtor për veprën penale dhunimi, nga neni 193 par.3 pika 5 lidhur me par.4 dhe nenin 23 të KPK dhe gjykohet me pesë (5) vite e gjashtë (6) muaj burgim. Në procedurën ankimore ky aktgjykim ndryshohet nga Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PAKR.nr.225/2023 datë 10.05.2023 sa i përket cilësimi juridik dhe vendimit për dënim, ashtu që ajo gjykatë gjen se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë elementet e veprës penale të dhunimit, nga neni 193 par.4 lidhur me nenin 23 të KPK, për të cilën gjykohet me dy (2) vite burgim.
6. Mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjyqimeve të fundit të formës së prerë ka paraqitur kërkesë për rishikimin e procedurës penale, konform dispozitës së nenit 423 par.1 pika 1.1 dhe 1.3 të KPP, me arsyetim se janë paraqitur prova të reja, të cilat argumentojnë se ankesa ishte e palejuar, për faktin se nuk ishte paraqitur nga e dëmtuara, rrethanë kjo që vërtetohet nëpërmjet ekspertizës grafologjike.
7. Gjykata Themelore në Pejë duke vendosur përkitazi me kërkesën e ka refuzuar atë si të pabazuar, me arsyetim se procedura mund të rishikohet sipas kësaj baze ligjore vetëm nëse kemi aktgjykim të formës së prerë me të cilin personi i tillë është shpallë fajtor, e në rastin konkret një aktgjyqimi i tillë nuk ekziston, dhe për faktin se e dëmtuara gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar se e ka paraqitur vetë ankesën. Vendimi i gjykatës së

shkallës së parë është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, me arsyetim se vendimi i ankimuar është i drejt dhe i ligjshëm.

8. Se pari, kjo Gjykatë vlerëson se konkludimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë se për ta lejuar rishikimin e procedurës konform nenit 423 par.1 nënpar.1.1 duhet të ekzistoj aktgjykimi i formës së prerë nuk kanë mbështetje ligjore ngase në rastet kur ekzistojnë pengesa për zhvillimin e procedurës penale si imuniteti, parashkrimi, amnistia, falja, vdekja, nuk dihet identiteti i autorit të falsifikimit nuk kërkohet aktgjykimi i formës së prerë kur këto rrethana mund të provohen edhe me mjete tjera provuese. Sipas gjykatave të instancave me të ulëta nëse për shembull aktgjykimi është bazuar në dëshminë e rrejshme të dëshmitarit (që ka qenë provë vendimtare për vendim) dhe në ndërkohë ai vdesë nuk mund të rishikohet procedura penale.
9. Në rastin konkret kemi një provë të re-ekspertizës grafologjike nga e cila rezulton se nënshkrimi i të dëmtuarës në ankesë nuk është i saj, e që si pasojë e kësaj anekse çështja është kthyer në rigjykim, pra, rezulton se ankesa ka qenë e palejuar, kurse aktgjykimi i shkallës së parë i marrë në rigjykim (që ka pasuar pasi që gjykata e apelit e ka aprovuar ankesën e bërë në emër të dëmtuarës), dhe aktgjykimi i gjykatës së apelit me të cilin është bërë i plotfuqishëm aktgjykimin i shkallës së parë janë të kundërligjshme, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për të mitur PKR.nr.141/2015 datë 15.07.2021 me të cilin i dënuari është gjykuar me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve e tetë (8) ditëve është i formës së prerë.
10. Së dyti, lidhur me kërkesën për rishikim të procedurës penale ka vendosur gjykata jo kompetente. Ngase, nevoja për rishikim është paraqitur në Gjykatën e Apelit, dhe pa afatshmeria dhe pa lejueshmëria janë çështje e shkallës së dytë, e jo të shkallës së parë, e kjo nënkupton se gjykata e shkallës së parë është dashtë t'ia dërgojë shkallës së dytë si gjykatë kompetente, e jo të vendos vetë siç ka vendosur. Gjykata e shkallës së parë do të kishte kompetencë për të vendosur vetëm për faktet e reja që mund të ndikojnë në aktgjykimin e shkallës së parë- ndryshimin nga liruesi në dënues, nga dënuesi në dënues-cilësimi juridik apo vendimin për dënim, por jo për rrethana me të cilat pretendohet se ankesa nuk ishte nënshkruar nga personi ligjërisht i legjitimuar për ankesë (e dëmtuara), por nga persona të panjohur.

11. Për arsyet e mësipërme, kjo gjykatë çështjen e kthej në Gjykatën e Apelit e cila në riprocedurë duhet të vendos se pari për ligjshmërinë e kërkesës (lejueshmërinë) për rishikimin e procedurës penale, e pastaj për ankesën e paraqitur nga e dëmtuara, e nëse vlerëson se ankesa nuk është paraqitur nga personi i legjitimuar me ligj (që sipas ekspertizës del se nënshkrimi është falsifikuar), të gjitha vendimet që kanë pasuar si rezultat i kësaj ankese duhet evituar dhe çështja duhet të kthehet në gjendjen para kësaj ankesë si “res judicata”.

12. Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është aprovuar si e bazuar, dhe në pajtim me dispozitën e nenit 438 par.1 nënpar.1.2 të KPP është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.562/2023, i datës 25.03.2024

”Vepra penale e vrasjes në gjendje të tronditjes së fortë mendore, nga neni 174 të KPRK ekziston në rastet kur dikush e privon nga jeta një person, por pa fajin e tij ka rënë në një tronditje të fortë mendore (psikike) për shkak të sulmit, keqtrajtimit ose fyerjes së rëndë nga ana e viktimës. Elemente dhe karakteristika të vrasjes në gjendje të afektit mendor janë: sulmi, keqtrajtimi, fyerja e rëndë, dhe tronditja e fortë. Sulmi mund të jetë çdo veprim i njeriut i drejtuar me qëllim që ta lëndoj apo rrezikoj ndonjë të mirë të mbrojtur të kryerësit të kësaj vepre. Mirëpo, sulmi i shkaktuar, i provokuar e përjashton ekzistimin e kësaj vepre penale (i dënuari është ai që ka shkuar të i ndjeri pasi që janë marrë vesh që mos të ketë me probleme rreth transportit). Fyerja e rëndë nënkupton cenimin e rëndë të nderit dhe autoritetit të personit tjetër, kjo reflektohet me dhembje të madhe psikike, emocionale, dhembje kjo e cila me arsye shkakton revoltë indinjatë. Tronditja e fortë mendore është gjendje e jashtëzakonshme psikike, është gjendje e shkallës së të lartë e afektit, gjendje kjo e cila ka ndikim të madh në aftësinë e kryerësit që të veproj pa menduar mirë. Pra, nga kjo rezulton se sulmi dhe fyerja duhet të jenë sipas mënyrës dhe intensitetit të tilla që mund ta sjellin të akuzuarin në gjendje të tronditjes së fortë, pra, jo çdo fjalosje, fyerje apo sulm“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktakuzën PP.I.nr.206/2020 datë 1.04.2021 i pandehuri A. S. është akuzuar për veprën penale vrasje e rëndë, parashikuar me nenin 173 par.1 nënpar.1.5 të KPRK dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 366 par.1 të KPRK, kurse B. S. për shkak të veprës penale shtytje në vrasje të rëndë, parashikuar me nenin 173 par.1 nënpar.1.5 lidhur me nenin 32 të KPRK.
2. Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.198/2021 datë 6 prill 2023 të pandehurin A. S. e ka shpall fajtor për veprat penale vrasje, parashikuar me nenin 172 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 366 par.1 të KPRK-së, kurse të pandehurin B. S. për veprën penale mos

lajmërimi i veprave penale apo kryesve të veprave penale apo kryesve të tyre, parashikuar me nenin 378 par.1 nënpar.1.9 të KPRK. Të pandehurit A. pasi që ia ka caktuar dënimin me burgim për secilën veprë dhe atë për veprën penale të vrasjes dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëzet e tri (23) viteve, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjysmë për armëmbajtje pa leje, konform dispozitës së nenit 76 par.1 të KPRK e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 24 viteve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 6.05.2021 e tutje. Të pandehurin B. S. për veprën penale për të cilën e ka shpall faktor e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë muajve (18), në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 6.05.2020 deri me 4.06.2021.

3. Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda duke vendosur sipas ankesave të Prokurorit dhe mbrojtësit të pandehurit A. me aktgjykimin PAKR.nr.404/2023 datë 15 shtator 2023 i ka refuzuar ato si të pabazuara, kurse aktgjykimin e shkallës së parë përkritazi me këtë të pandehur e ka vërtetuar, kurse me aprovimin e ankesës së prokurorit dhe mbrojtësit të pandehurit B. S. aktgjykimin i shkallës së parë përkritazi me këtë të pandehur është anuluar dhe çështja është kthyer në rigjykim.
4. Kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe atij të shkallës së dytë në pjesën refuzuese (përkritazi me të dënuarin A. S.) kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit A. S. avokati E. K. (i angazhuar në këtë fazë), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza apo ndaj tij të shqiptohet dënim me burgim për shkak të veprës penale vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore (kështu theksohet në kërkesë) apo anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë.
5. Ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë është përgjigjur Prokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.324/2023 datë 13 nëntor 2023, me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa nuk është e bazuar.

- a) Pretendimet e mbrojtësit përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljet e ligjit penal

1. Sipas mbrojtësit në këtë çështje juridiko penale aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar me nenin 384 par.2 nënpar.2.2 e 2.7 të KPP, ngase janë shkelur të drejtat e mbrojtjes, dhe aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 par.7 e 8 të KPP. Sipas mbrojtësit janë shkelur të drejtat e mbrojtjes sepse gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar drejt dhe me paanshmëri propozimin e mbrojtjes lidhur me faktin se në veprimet e të dënuarit formohen elementet qenësore të veprës penale vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor, dhe si pasojë është shkelur edhe neni 6 i Konventës evropiane për të drejtat e njeriut apo e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, shkelje kjo e cila nuk është eliminuar as nga gjykata e shkallës së dytë. Gjykata e shkallës së parë nuk jep arsye se cilat ish-in provat vendimtare kur të dënuarit e shpalli fajtor për veprën penale, por me shumë i përshkruan provat e administruara dhe nuk i analizon me argumentet e paraqitura nga mbrojtja, dhe nuk mori parasysh hetimin e dobët dhe të anshëm të prokurorit sepse por të kishim një hetim profesional do të rezultonte ndryshe gjendja në këtë çështje penale, kurse gjykata e shkallës së dytë në vend që t'i eliminon këto shkelje , edhe vet i shkel dispozitat procedurale. Kjo për faktin se në këtë çështje ishte akuzuar dhe shpall fajtor edhe vëllai i të dënuarit – B. S. për veprën penale, nga neni 378 par.1 nënpar.1.9 të KPRK,dhe ishte mbajti shqyrtimi gjyqësor i përbashkët, gjykata e shkallës së dytë lidhur me të dënuarin A. e refuzon ankesën me arsyetimin se nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale, kurse përkitazi me të pandehurin B. S. gjen se ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.10 të KPRK.

- b) vlerësimi i kësaj gjykate përkitazi shkeljet e lartcekura të pretenduara nga ana e mbrojtësit
1. Pas shqyrtimit të pretendimeve në kërkesë në raport me aktgjykimet e kundërshtuara dhe shkresat e lëndës kjo gjykatë gjen se ato janë të pabazuara.
 2. Se pari, vlen të theksohet se dispozita e nenit 384 par.2 nënpar.2.2. i referohet shkeljes së të drejtës në mbrojtje, pra, kur gjykimi mbahet pa mbrojtjes, e jo kur gjykata refuzon një pretendim apo propozim të mbrojtjes. Kurse, siç del nga aktgjykimet e kundërshtuara gjykatat kanë dhënë arsye të qarta se pse pretendimet e mbrojtjes se veprimet e të dënuarit janë marrë në gjendje të afektit mendor janë të pabazuara. Në të vërtetë pretendimet e mbrojtësit në kërkesë se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar drejt dhe me paanshmëri propozimin e mbrojtjes se i dënuari veprimet i ka ndërmarre në gjendje të afektit mendor, për këtë gjykatë nuk janë të qartë se në çka konsistojnë këto pretendime, kur siç u cek edhe me lartë gjykatat jo vetëm që kanë dhënë arsye në këtë drejtim por përkitazi me afektin mendor janë dëgjuar edhe ekspertët.
 3. Pastaj, të pabazuara janë edhe pretendimet se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 par.7 e 8 të KPP. Ngase, gjykata e shkallës së parë ne arsyetim të aktgjykimet të kundërshtuar ka përshkruar ecurinë e ngjarjes së zhvilluar duke theksuar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar, faktet vendimtare përkitazi me ekzistimin e veprës penale për të cilën e ka shpall fajtor dhe përgjegjësisë penale të tij, ajo ka dhënë arsye se perse ka konsideruar se janë vërtetuar ato. Gjykata në pajtim me dispozitën e nenit 369 par.6 të KPP ka paraqitur arsye për çdo pikë të aktgjykimet, ka vlerësuar provat e administruara si ato materiale dhe jo materiale, dëshmitë e dëshmitarëve dhe ekspertizat mbi gjendjen mendore të të dënuarit, të cilët ekspertë kanë dhënë mendimin e tyre edhe përkitazi me afektin mendor. Në fakt janë dhënë arsye të qarta përkitazi me dëshmitë e dëshmitarëve duke dhënë arsye se në cilat rrethana të ngjarjes këtyre dëshmitë ju ka besuar dhe në cilat jo, e po ashtu ka dhënë arsye se perse nuk i ka besuar mbrojtjes se të dënuarit dhe mbrojtësit të tij.

4. Se treti, nga fakti se në këtë çështje ishte akuzuar dhe shpall fajtor edhe vëllai i të dënuarit – B. S. për veprën penale, nga neni 378 par.1 nënpar.1.9 të KPRK, dhe ishte mbajti shqyrtimi gjyqësor i përbashkët, kurse, gjykata e shkallës së dytë lidhur me të dënuarin A. e refuzon ankesën me arsyetimin se nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale, kurse përkitazi me të pandehurin B. gjen se ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penal, nuk mund të konkludohet siç pretendon mbrojtësi se edhe aktgjykimi i shkallës së parë përkitazi me të dënuarin A. është i përfshirë me shkelje esenciale. Kjo për faktin se vëllai i të dënuarit nuk ka qenë i akuzuar se ka vepruar si bashkë ekzekutor me të dënuarin, por ka qenë i akuzuar për veprën penale shtyjtje në vrasje, ndërsa është shpall fajtor për veprën penal mos lajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre, nga neni 378 par.1 nënpar.1.9 të KPRK, dhe meqë veprat penale janë të ndryshme dhe përgjegjësia është individuale, shkeljet esenciale në të cilat është përfshi aktgjykimi i shkallës së parë përkitazi me vëllain e të dënuarit nuk mund t'i atribuohen pjesës përkitazi me të dënuarin sepse nuk janë të njëjta.

c) Pretendimet e mbrojtësit përkitazi me shkeljet e ligjit penal

1. Sa i përket shkeljes së ligjit penal mbrojtësi pretendon se në rastin konkret si gjykata e shkallës së parë ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë shkelur ligjin penal në dëm të dënuarit kur kanë konkluduar se i dënuari e ka kryer veprën penale që ishte objekt i akuzës ngase i kanë mbivlerësuar provat e akuzës dhe nuk i kanë vlerësuar provat e mbrojtjes. Gjykata e shkallës së parë lidhur me ngjarjen gabimisht dhe në mënyrë të njëanshme ua ka falur besimin dëshmitarëve B1. S1., B2. S2., B3. e N. S. të cilët ishin vëllezër të viktimës dhe nuk i ia ka falë besimin dëshmisë së dëshmitarit F. Xh.. Dëshmitarët e theksuar nuk kanë dëshmuar në mënyrë reale dhe nuk kishin deklaruar fare mbi rrethanën se në momentin kritik a e kishin ofenduar, provokuar apo e kishin sharë të dënuarin A. duke ia sharë nënën në mënyrë më të ultë të mundshme dhe duke shkuar apo duke ecur se bashku me viktimën në drejtim të dënuarit me qellim që ta sulmojnë. Ndërsa, dëshmitari F. Xh. në dëshminë e tij në të gjitha fazat e procedurës kishte dëshmuar se kishte dëgjuar vëllezërit e viktimës kur se bashku me viktimën e kishin ofenduar rëndë të dënuarin A. duke i thënë “ ta ...nenen”, e duke shkuar se bashku në drejtim të dënuarit me qellim që ta sulmojnë, mirëpo sipas këtij dëshmitari ofendimin apo sharjen në mënyrë me të theksuar e kishte përdor viktimia i cili me lopatë në dorë

ka ecur në drejtim të tij duke e mbajtur në gjendje gatishmërie për ta goditur dhe duke i thënë se me këtë “ lopatë ta hjekë kokën dhe ta ... nanen”. I gjendur në këto rrethana pëson tronditje të fortë mendore ashtu që e humb kontrollin dhe me qellim të zbrapsjes apo evitimit të sulmit e nxjerr revolen dhe shkrep njëherë në ajër, por tani duke mos qenë vetvetja e godet të ndjerin me pasoja për jetën e tij. Kurse, konkludimet e gjykatës se me asnjë provë nuk argumentohet fakti se tani i ndjeri A. S. e ka provokuar apo sjellë të akuzuarin në atë gjendje që do të ndikonte në kryerjen e veprës penale nuk qëndrojnë. Sipas mbrojtësit gjykatat nuk e kanë vlerësuar drejt mendimin e eksperteve të psikiatrisë forenzike Dr. J. Z. e Dr. A. B., sepse, përderisa eksperti J. Z. ka mbetur pranë qëndrimit të tij eksperti tjetër A. B. ka pas vlerësim ndryshe gjatë deklarimit të tij në shqyrtim gjyqësor, ngase i njëjti në shqyrtim ka deklaruar se kur një person ofendohet në nënë, motër tek disa persona mundet të shkaktoj shqetësim të lehtë, hidhërim dhe tronditje mendore, por ky ekspert në deklarimin e tij asnjëherë nuk e ka mohuar faktin se tek i dënuari frika ka qenë prezent edhe në kohën kur ka zbritur detyrimisht nga kombi dhe frika ka ekzistuar edhe në vendin e ngjarjes por është në kundërshtim me vetveten kur deklaroi se frika nuk shkakton tronditje të fortë mendore. Sipas mbrojtësit në rrethanat e lartcekura vepra penale e vrasjes është kryer në mbrojtje të nevojshme në pajtim me nenin 12 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, sepse i dënuari e ka zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetes dhe se karakteri i mbrojtjes ishte në proporcion me shkallen e rrezikut që paraqiste sulmi. Madje sipas mbrojtësit i dënuari ka mundur që veprën penale ta ketë kryer nën prezencën e nevojës ekstreme në pajtim me nenin 13 par.3 lidhur me par.1 të KPRK, sepse fillimisht ka shkrepur në ajër me qellim që ta parandalon sulmin dhe nga pakujdesia ka shkrepur me armë në ajër dhe këtu i tejkalon kufijtë e nevojës ekstreme.

2. Vlen të theksohet se pretendimet në kërkesë përkritazi me shkelje të ligjit penal me shumë i referohen gjendjes faktike për të cilën bazë kërkesa nuk lejohet të ushtrohet, por meqë janë të ndërlidhura me shkelje të ligjit penal kjo gjykatë i vlerësoj këto pretendime dhe gjeti se janë të pabazuara.
3. Fillimisht vlen të theksohet se i dënuari nuk është shpall fajtor për veprën penale që ishte objekt i akuzës, ngase ka qenë i akuzuar për veprën penale të vrasjes së rëndë, parashikuar me nenin 173 par.1 nënpar.1.3 të KPRK, kurse është shpall fajtor për veprën penale të vrasjes, nga neni 172 të KPRK.

4. Pastaj, në këtë çështje juridiko penale nuk rezulton kontestues se i dënuari, vëllai i tij, i ndjeri dhe vëllezërit e tij kanë qenë duke punuar në firmën “ ... “, ku pronar ishte T. T.. I dënuari dhe i ndjeri nuk kanë pas mosmarrëveshje në mes veti deri në ditën e ngjarjes. Ditën e ngjarjes me 6.05.2020 kanë pas mosmarrëveshje për shkak se i dënuari një ditë me parë (me 5.05.2020) nuk kishte shkuar për t’i marrë të ndjerin, vëllezërit e tij dhe punëtorët tjerë të cilët udhëtonin për në vendin e punës me kombi bus-in e firmës. Ditën e ngjarjes kur shkon se bashku me vëllain e tij për t’i marrë sipas udhëzimeve të vëllait të pronarit, i ndjeri e zbret të dënuarin kurse kombin e drejton njeri nga vëllezërit S., e pastaj i dënuari zbret nga kombi se bashku me vëllain e tij, të cilët shkojnë në shtëpinë e tyre për ta marrë veturën private për të shkuar në punë, kurse pasi që i dënuari se bashku me vëllain e tij shkon në punë ndodh vrasja.
5. Sipas shkresave të lëndës del se pasi që shkon i ndjeri me vëllezërit e tij në punë, i ndjeri bisedon me pronarin e firmës -dëshmitarin T. rreth problemit të transportit, i cili ia tërheq vërejtjen që mos me pas më probleme, gjysmë ore më vonë shkon në punë edhe i dënuari me vëllain e tij, dhe dëshmitari T. bisedon me të dënuarin dhe të ndjerin lidhur me problemin që kishin pasur rreth transportit, dhe pas tërheqjes së vërejtjes dhe pajtimit në mes tyre që të mos të ndodh më e njëjta gjë, i ndjeri largohet në drejtim të vendit ku duhej të punonte, kurse ngjarja kishte ndodhur pasi që i ndjeri shkon në vendin ku duhej të punonte. Pasi që dëshmitari T. largohet nga ta rreth 100 -150 metra, dëgjon të shtënat dhe kur kishte kthyer kokën kishte parë të dënuarin, kurse të ndjerin që kishte rënë në tokë.
6. Se i ndjeri ditën e ngjarjes është privuar nga jeta me armë nga i dënuari, nuk mohohet as nga i dënuari, por sipas tij i ndjeri e kishte sharë dhe sulmuar me lopatë. Sipas raportit të autopsisë del se vdekja ishte e dhunshme dhe ishte rrjedhojë e fashitjes së qendrave vitale në tru, dhe gjakderdhjes së brendshme dhe të jashtme në kokë të shkaktuara nga predha e hedhur nga arma e zjarrit e dorës. Lëndimet në pjesën e pasme të qafës, në 8.5 cm nga lapra e veshit të majtë dhe mu në lugun e qafës paraqesin vrimën hyrës, dhe kanalin nëpër të cilën kalon predha (ku edhe është gjeta predha- ky lëndim ka qenë vdekjeprurës). Drejtimi i predhës nga pas - para lehtësisht nga e djathta majtas dhe lehtësisht nga poshtë lart. Dëmtimet në anën e djathtë të shpinës në 145 cm mbi shputë dhe 9 cm nga mesi i shpinës paraqesin plagë tangjentore e përcjell me dërmishje e

shkaktuar tangjenarisht nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrit. Në vendin e ngjarjes janë gjetur tri gëzhoja të cilat sipas ekspertizës balistike janë shkrepur nga arma të cilën e ka përdorur i dënuari ditën e ngjarjes.

7. Dëshmitarët e kësaj ngjarje vëllezërit e të ndjerit si B1. S1., B2. S2., N. e B3. S3, të cilët kanë punuar në vendin e njëjtë me të ndjerin dhe kanë qenë prezentë kur është privuar nga jeta i ndjeri- vëllai i tyre, në dëshmitë e tyre janë konsekuentë përkritazi me faktin se pasi që i ndjeri është ndarë nga dëshmitari T. dhe është kthyer në vendin e tij të punës, i dënuari i ka shkruar pas dhe pasi që e ka thirrur në emër ka shtënë tri herë në drejtim të tij. I vetmi dëshmitar në këtë çështje që ka deklaruar se i dënuari është sharë nga i ndjeri dhe vëllezërit e tij është F. Xh.. Përkritazi me gjendjen mendore të të dënuarit në kohën e kryerjes së veprës penale në këtë çështje penale kemi dy ekspertiza njëra e datës 3.3.2022 dhe tjetra e 13.10.2022 dhe nga konkludimi i tyre del se i dënuari në kohën e kryerjes së veprës penale nuk vuante nga ndonjë çrregullim mendor i natyrës së përhershme apo të përkohshme, kurse në momentin e kryerjes së veprës për të cilën ngarkohet aftësia e të kuptuarit dhe kontrollit të veprimeve të veta ka qenë e ruajtur. Ekspertet e këtyre ekspertizave në shqyrtimin gjyqësor janë dëgjuar edhe përkritazi me afektin mendor bazuar në dëshminë e dëshmitarit F. Xh. se i ndjeri e ka sharë të dënuarin dhe mbrojtjen e këtij fundit si ndjeri po shkonte në drejtim të tij me lopatë në dorë të ngritur lartë duke e sharë me nënë dhe duke e kërcënuar me fjalët “me këtë kaci kam me ta hek krytë”, por, ekspertët edhe në këtë drejtim kanë deklaruar se aftësia mendore e të dënuarit ka qenë e ruajtur, se gjatë dhe pas veprës penale veprimet e tij nuk kanë pas shpëputje apo humbje të vetëdijes të cilat do të mund të cilësoheshin si afekt.
8. Bazuar në rrethanat e lart cekura sipas vlerësimit të kësaj Gjykatë konkludimi i gjykatave se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale të vrasjes, nga neni 172 të KPRK është i bazuar, kurse pretendimet e mbrojtjes se i dënuari ka vepruar në gjendje të afektit mendor nuk janë të bazuara. Vepra penale e vrasjes në afekt mendor, nga neni 174 të KPRK ekziston në rastet kur dikush e privon nga jeta një person, por pa fajin e tij ka rënë në një tronditje të fortë mendore (psikike) për shkak të sulmit, keqtrajtimit ose fyerjes së rëndë nga ana e viktimës. Elemente dhe karakteristika të vrasjes në gjendje të afektit mendor janë: sulmi, keqtrajtimi, fyerja e

rëndë, dhe tronditja e fortë. Sulmi mund të jetë çdo veprim i njeriut i drejtuar me qëllim që ta lëndoj apo rrezikoj ndonjë të mirë të mbrojtur të kryerësit të kësaj vepre. Mirëpo, sulmi i shkaktuar, i provokuar e përjashton ekzistimin e kësaj vepre penale (i dënuari është ai që ka shkuar të i ndjeri pasi që janë marrë vesh që mos të ketë me probleme rreth transportit). Fyerja e rëndë nënkupton cenimin e rëndë të nderit dhe autoritetit të personit tjetër, kjo reflektohet me dhembje të madhe psikike, emocionale, dhembje kjo e cila me arsye shkakton revoltë indinjatë. Tronditja e fortë mendore është gjendje e jashtëzakonshme psikike, është gjendje e shkallës së të lartë e afektit, gjendje kjo e cila ka ndikim të madh në aftësinë e kryerësit që të veproj pa menduar mirë. Pra, nga kjo rezulton se sulmi dhe fyerja duhet të jenë sipas mënyrës dhe intensitetit të tilla që mund ta sjellin të akuzuarin në gjendje të tronditjes së fortë, pra, jo çdo fjalosje, fyerje apo sulm. Në këtë drejtim përkitazi me sharjet por edhe sulmin siç pretendon i dënuari janë deklaruar edhe ekspertët, prandaj, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret me të drejtë gjykatat kanë konkluduar se nuk ka vrasje në afekt, e duke pasur parasysh ecurinë e ngjarjes të përshkruar me lartë as që mund të bëhet fjalë për mbrojtje të nevojshme siç pretendon mbrojtësi.

9. Vlen të theksohet se mbrojtësi pretendon se është shkelur edhe ligji penal për faktin se të dënuarit i është shqiptuar dënimi i cili nuk është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të dënuarit, mirëpo, këto pretendime nuk qenë objekt shqyrtimi ngase kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të vendimit për dënim.

10. Nga sa u tha më lart dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.591/2023, i datës 22.12.2023

"Sipas dispozitës së nenit 29 të Kodit Penal të Kosovës -gjykata mund ta lirojë nga dënimi personin i cili tenton të kryejë veprë penale me mjet të papërshtatshëm ose ndaj objektit të papërshtatshëm. Kurse kriter themelor për tu për tu konsideruar një tentativë e papërshtatshme është vlerësimi se me mjetet që janë përdorur ndaj objektit përkatës, në situatat dhe rrethanat konkrete, askush nuk do të mund të kryente veprë penale".

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë - Divizioni Penal, me aktgjykimin P.nr.85/2020 datë 7 korrik 2022, të dënuarit M.M. e F.K., për veprën penale vjedhje e rendë në tentativë, parashikuar me nenin 315 par.1 pika 1.1 dhe nenin 28 e 31 të KPRK, i ka gjykuar të dënuarin M. me nëntë (9) muaj burgim, dhe dënim me gjobë në shumë prej shtatëqind (700)€, kurse të dënuarin F. me tetë (8) muaj burgim dhe dënim me gjobë në shumë prej dyqind(200)€, në të cilat ju është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 7.02.2020 deri me 8.03.2020. Nëse të dënuarit dënimin me gjobë nuk mund ta paguajnë apo nuk dëshirojnë të njëjtat do tu zëvendësohen me burgim ashtu që në një ditë burgimi do tu llogariten nga 20€ të gjobës.
2. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur përkitazi me ankesat e mbrojtësve të pandehurve, me aktgjykimin PA1.nr.683/2023 datë 26 shtator 2023, i ka aprovuar ankesat vetëm pjesërisht dhe aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar vetëm sa i përket vendimit për dënim, ashtu që ajo gjykatë të dënuarin M. e ka gjykuar me shtatë (7) muaj burgim dhe me gjobë në shumë prej katërqind (400)€, kurse të dënuarin F. me gjashtë (6) muaj burgim dhe me dënim me gjobë në shumë prej njëqind (100)€. Në dënimet e shqiptuara me burgim ju është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 7.02.2020 deri me 8.03.2020.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

-mbrojtësi i të dënuarit M.M., avokati U.P., pa cekur bazat ligjore, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar, kurse aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë ose të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza;

-mbrojtësi i të dënuarit F.K., avokati B.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar, kurse aktgjykimi i shkallës së dytë të anulohet dhe të vendos në bazë të dispozitës së nenit 438 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 të KPP (kështu theksohet në ankesë).

4. Ndaj kërkesave të mbrojtësve është përgjigjur Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.344/2023 datë 17 nëntor 2023, me propozim që kërkesat të refuzohen si të pabazuara.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesat nuk janë të bazuara.

2. Mbrojtësi i të dënuarit F.K., me kërkesë kryesisht e kundërshton aktgjykimin e shkallës së dytë, pa konkretizuar se cila dispozitë është shkelur, por pretendon se gjykata e shkallës së dytë sikurse edhe gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye për provat e administruara, nuk e kanë vlerësuar drejt heqjen dorë vullnetare nga rasti, faktin se hedhja e shkumës tek alarmi a është depërtim, a ka qenë bombola dhe pipëza të përshtatshme për objektin që pretendon prokuroria. Me tej sipas mbrojtësit Gjykata e Apelit kur çështja është kthyer në rigjykim në atë gjykatë të dënuarit ia kanë llogaritur vetëm kohën e kaluar në paraburgim, kurse vuajtja e dënimit për dy muaj fare nuk është llogaritur.

3. Mbrojtësi i të dënuarit M.M., pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPP pasi që nuk kanë arsye për faktet vendimtare, kurse arsyet e dhëna janë të paqarta, kontradiktore. Gjykatat vetëm kanë bërë numërimin e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe citojnë deklaratat e dëshmitarëve pa bërë analizë të këtyre dëshmimeve dhe se përmes tyre a janë vërtetuar elementet e veprës penale. Sipas mbrojtjes gjykatat fare nuk kanë marr mundin të vlerësojnë argumentet e paraqitura nga mbrojtja dhe nuk janë analizuar fare pretendimet përkitazi me institutin e tentativës së papërshtatshme absolute si për kah mjeti ashtu edhe në objekt. Mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale shkuma me pip e llojit “Eürth” nuk është mjet i përshtatshëm për të shkaktuar dëm apo pasojë qoftë ndaj kamerës apo alarmit të bankomat-tit të TEB-bankës ose ndonjë sendi tjetër, gjë që konfirmohet edhe nga deklarata e përfaqësuesit të të dëmtuarës i cila ka deklaruar se në rastin konkret nuk ka pasur asnjë lloj dëmi material të vetëm në kamera dhe dëm të bankoma-tit, dhe për këtë shkak nuk kanë kërkuar kompensim dëmi. Pra, sipas mbrojtjes kemi të bëjmë me tentativë të papërshtatshme nga neni 29 i KPRK dhe atë të formës absolute si për ka mjeti dhe objekti dhe se nuk janë realizuar elementet e përgjithshme dhe ato të posaçme që përbëjnë figurën e veprës penale. Madje, edhe nën supozimin se është vërtetuar kryerja e veprës penale, dënimi i shqiptuar është në kundërshtim me ligjin, pasi që të dy gjykatat nuk e kanë bërë as për së afërmi baraspeshimin e rrethanave përkatëse, dhe nuk kanë marrë parasysh sjelljen e mirë të dënuarit, faktin se është person familjar, në moshë të re, i gjendjes së varfër ekonomike, bashkëpunimin me gjykatën, por edhe me organet e ndjekjes qysh nga faza parapenale.
4. Vlen të theksohet se në kërkesa sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk theksohet se në çka konsistojnë kundërhëniet dhe paqartësitë e aktgjytimeve, por vetëm parafrazohet dispozita ligjore. Sipas dispozitës së nenit 436 të KPP me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon, por nuk mund të supozojë se çka ka dashur të thotë parashtruesi i kërkesës. Më gjithë këtë, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimet janë të qarta, dhe përkitazi me faktet vendimtare gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme, bindëse dhe të logjikshme, duke dhënë arsye si cilat fakte i merr si të vërtetuara dhe cilave

provave ua ka falë besimin, arsye këto që si të drejta i ka vlerësuar edhe gjykata e shkallës së dytë dhe si të tilla i aprovon edhe kjo gjykatë.

5. Edhe pretendimet përkitazi me shkelje të ligjit penal sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara dhe nuk e venë në dyshim aplikimin e ligjit penal. Fillimisht kjo gjykatë vlerëson se qëndron fakti se sipas dispozitës së nenit 29 të kodit penal gjykata mund ta lirojë nga dënimi personin i cili tenton të kryejë veprë penale me mjet të papërshtatshëm ose ndaj objektit të papërshtatshëm. Pra, sipas kësaj dispozite tentativa e papërshtatshme ekziston në rastet kur personi dëshiron kryerjen e veprës penale dhe me atë qëllim e ndërmer veprimin e kryerjes, mirëpo, për shkak të mjeteve që i përdor, apo objekti ndaj të cilit është ndërmarrë veprimi i kryerjes, objektivisht ka qenë e pamundur të kryhet vepra penale.
6. Së pari, në rastin konkret del qartë se të dënuarit e kanë dëshiruar kryerjen e veprës penale dhe veprimet i kanë ndërmarrë me qëllim të kryerjes së saj, fakt ky që vërtetohet nga pranimi i veprës penale nga të dënuarit (madje i dënuari M., e ka pranuar veprën edhe në shqyrtimin gjyqësor).
7. Së dyti, si kriter themelor për tu konsideruar një tentativë e papërshtatshme është vlerësimi se me mjetet që janë përdorur ndaj objektit përkatës, në situatat dhe rrethanat konkrete, askush nuk do të mund të kryente veprë penale. Në rastin konkret nuk mund të konkludohet se mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale (shkuma e cila me një pip të bombolës është hedhur në alarm të bankomatit dhe alarm të market-it) dhe objekti ndaj të cilit janë ndërmarrë veprimet nuk ishin të përshtatshme për kryerjen e veprës penale dhe me to askush nuk mund të kryente veprë penale. Përveç kësaj mbrojtësit me asgjë nuk e argumentojnë faktin se pse mjeti dhe objekti ishin të papërshtatshme për kryerjen e veprës penale, kurse nga mos shkaktimi i pasojës nuk mund të konkludohet se kemi të bëjmë me tentativë të papërshtatshme.
8. Pra, sipas vlerësimit të kësaj gjykate në këtë çështje juridiko penale me asnjë provë nuk vihet në dyshim saktësia e fakteve vendimtare të vërtetuara me vendimet kundër të cilave është paraqitë kërkesa jo vetëm sa i përket përgjegjësisë penale të të dënuarve dhe elementeve të veprës penale për të cilën të dënuarit janë shpall fajtor dhe gjykuar, pra, kjo gjykatë mbështet në tersi konkludimin e gjykatave se në veprimet e të dënuarve

qëndrojnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale të vjedhjes së rëndë në tentativë.

9. Pretendimet e mbrojtësit të dënuarit M., sa i përket vendimit për dënim nuk qenë objekt shqyrtimi sepse për këtë bazë konform nenit 432 të KPP kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet.

10. Kurse, edhe pretendimet e mbrojtësit të dënuarit F.K., se të mbrojturit të tij nuk i është llogaritur koha e kaluar në vuajtje të dënimit nuk janë të bazuara. Sipas dispozitës së nenit 79 të KPP në dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, në masën edukative institucionale dhe dënim me gjobë llogaritet koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale, por jo edhe vuajtja e dënimit.

11. Nga sa u tha me lartë e konform dispozitës së nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.157/2024, i datës 16.04.2024

”Sipas dispozitës së nenit 18 par. 1 të Kodit Penal, personi që ka kryer vepër penale konsiderohet i paaftë mendërisht, nëse në kohën e kryerjes së veprës lëngonte nga një sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, nëse kishte çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor, që e ka prekur funksionin mendor, dhe, si pasojë e kësaj, nuk ka qenë në gjendje t’i kuptojë ose t’i kontrollojë veprimet a mosveprimet e tij apo të kuptojë se kryen vepër penale. Kurse, par.2 të të njëjtit nen - personi që ka kryer vepër penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij/saj për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve apo mosveprimeve të tij/saj ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në par.1 të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm. Pra, përgjegjshmërinë esenciale të zvogëluar, sikundër papërgjegjshmëri mund ta shkaktojnë sëmundjet mendore kronike apo të përkohshme, çrregullimet mendore dhe ngecjet në zhvillimin mendor, por të cilat nuk janë të asaj natyre dhe intensiteti që ta shpjen personin në gjendje plotësisht të papërgjegjshme, dhe personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës. Kurse, kryesit të tillë gjykata mund t’i shqiptojë krahas dënimit edhe masën e trajtimit të detyrueshëm me ndalim apo në liri, varësisht nga propozimi i mjekëve“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.694/2022 datë 13 shtator 2023, i pandehuri Sh. H. është shpall fajtor për veprën penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 185 par.1 pika 1.4 të KPRK, për të cilën është gjykuar me kusht, ashtu që i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, dhe është urdhëruar që ky dënim mos të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda afatit prej dy (2) viteve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen veprën penale. Konform dispozitës së nenit 515 të Kodit të procedurës penale të pandehurit i është shqiptuar edhe masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, që do të behet në Qendrën e Shëndetit mendor në Gjakovë pasi pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Masa e shqiptuar do të pushohet kur trajtimi ose rehabilitimi më nuk janë të nevojshëm, por e njëjta nuk mund të kalojë tre vite. Është obliguar Shërbimi Sprovues - Drejtoria Rajonale në Gjakovë që ta mbikëqyr zbatimin e masës dhe për këtë ta njoftojë gjykatën çdo gjashtë muaj.

2. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1437/2023 datë 8 dhjetor 2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të mbrojtëses, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit avokatja A.P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës këto aktgjykime t'i anulojë, ashtu që çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
4. Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.nr.91/2024 datë 12 mars 2024, ka propozuar që kërkesa të aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, par.1 lidhur me nenin 436, par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

2. Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale mbrojtësja pretendon se në rastin konkret janë shkelur të drejtat e mbrojtjes, sepse i mbrojturi i saj është marrë në pyetje pas arrestimit pa prezencën e mbrojtësit në kundërshtim me nenin 56 e 57 të KPP i cili parasheh si i pandehuri duhet të këtë mbrojtës nga marrja në pyetje për herë

të parë e deri në përfundim të procedurës penale me vendim të formës së prerë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses. Ndërkaq zyrtarët policor ishin në dijeni për paaftësinë mendore të të mbrojturit të saj, sepse një konstatim i tillë ishte vërtetuar nga konstatimi i mjekut nga Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë datë 14.08.2021.

3. Sa i përket shkeljes së ligjit penal mbrojtësja pretendon se në rastin konkret ndaj të mbrojturit të saj është shqiptuar dënimi me burgim të kushtëzuar konform nenit 1 par.2 të kodit penal, mirëpo, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata e shkallës së parë e ka shpërfill këtë nen duke mos e marrë parasysh fare domosdoshmërinë e shqiptimit të një dënimi, e aq me pak shkallën dhe natyrën e rrezikshmërisë për të drejtat e njeriut dhe të vlerave shoqërore. Kjo për faktin se sipas mbrojtëses një dënim i tillë është i panevojshëm dhe jo i domosdoshëm në këtë rast, duke ditur që një dënim i tillë nuk do të kishte efekt përderisa i mbrojturi i saj vuan nga çrregullime mendore dhe po trajtohet në qendrën e shëndetit mendor në Gjakovë. Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj është thirrur në nenin 17 të kodit penal i cili parasheh se kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje ose nga pakujdesia. Bazuar në të gjitha raportet mjekësorë të mjekëve të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës rezulton se i mbrojturi i saj ka çrregullim të paspecifikuar psikotik F 29 (ICD 10) dhe çrregullim mendor dhe i sjelljes si pasojë e përdorimit të kanaboideve F 12.2 (ICD 10). Sipas ekspertëve ky çrregullim mendor karakterizohet me çrregullim të sjelljes, impulsivitetit që vështirë kontrollohet, krijim i realicioneve të paqëndrueshme me të tjerët, çrregullime perceptive, drealizim dhe depersonalizim si dhe çrregullim në të menduar në formë të ideve të madhështisë, të cilat kanë qenë prezentë në rastin konkret. Ndërkaq, sa i përket momentit të kryerjes së veprës penale aftësia për t'i kuptuar veprimet dhe pasojat e veprimeve dhe mosveprimeve të veta ka qenë e zvogëluar në masën esenciale. Andaj, në kuptim të nenit 17 të kodit gjykata nuk do të duhej t'i shqiptojë një dënim për kryerje të veprës penale nga një person që nuk ka qenë i aftë mendërisht në momentin e kryerjes së veprës penale dhe ku elementi i dashjes nuk është vërtetuar e as nuk do të mund të vërtetohej dhe aktgjykimi do të duhej të thirrej në nenin 18 të kodit penal sipas të cilit personi i cili ka kryer veprën penale konsiderohet i paaftë mendërisht nëse në kohën e kryerjes së veprës penale lëngonte nga një sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme,

nëse kishte çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor që e ka prekur funksionimin e tij/saj mendor dhe si pasojë e kësaj, nuk ka qenë në gjendje që të kuptojë natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij/saj ose nuk ka qenë në gjendje t'i kontrollojë veprimet ose mos veprimet e tij/saj apo të kuptojë se kryen vepër penale. Pastaj, në rastin konkret kemi të bëjmë me aktakuzë me propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, dhe nuk është propozuar shqiptimi i sanksionit penal, për çka gjykata ka shkelur ligjin penal – nenin 385 par.1 nënpar.1.5 të KPP ngase gjykata ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore.

4. Pas shqyrtimit të pretendimeve të lartcekura kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e mbrojtëses nuk janë bazuara.
5. Është e evidente se nga shkresat e lëndës del si dënuari pas arrestimit në polici është marrë në pyetje, pa prezencë të mbrojtësit dhe se konform dispozitës së nenit 57 të KPP i pandehuri duhet të këtë mbrojtës nga marrja në pyetje për herë të parë e deri në përfundim të procedurës penale me vendim të formës së prerë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve mendore dhe kështu është i paafët që të mbrohet vetë me sukses. Mirëpo, kjo shkelje nuk i bën aktgjykimet me të meta të atilla të cilat do të kushtëzonin anulimin e tyre, sepse kjo shkelje është konvaliduar gjatë fazave tjera të procedurës.
6. Pastaj, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara edhe pretendimet për shkelje të ligjit penal. Qëndron fakti se, sipas dispozitës së nenit 18 par. 1 të Kodit Penal, personi që ka kryer vepër penale konsiderohet i paafët mendërisht, nëse në kohën e kryerjes së veprës lëngonte nga një sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, nëse kishte çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor, që e ka prekur funksionin mendor, dhe, si pasojë e kësaj, nuk ka qenë në gjendje t'i kuptojë ose t'i kontrollojë veprimet a mosveprimet e tij apo të kuptojë se kryen vepër penale e, po ashtu, është e evidente se nga raporti mjekësor (i cili nuk lë dilema përkitazi me përgjegjshmërinë e të dënuarit) mbi gjendjen mendore të të dënuarit, i bërë në Qendrën Klinike Universitare –Instituti i Psikiatriisë Forenzike të Kosovës nga mjekët përkatës, del se i dënuari ka çrregullim të pa specifikuar psikotik F29 (ICD 10) dhe çrregullim mendor dhe i sjelljes si pasojë e përdorimit të kanaboideve F12.2 (ICD10) dhe këto sëmundje karakterizohen me çrregullim në të menduar, dhe çrregullime tjera të cekura me detajisht në ekspertizë”,

mirëpo, siç del nga ky raport dhe siç ceket edhe në kërkesën e mbrojtëses, si pasojë e kësaj përgjegjshmëria e tij ishte e zvogëluar, gjë që nuk e përjashton përgjegjësin penale - neni 18 par.2 i kodit penal. Pra, sipas ekspertizës neuropsikiatrike, përgjegjshmëria e të dënuarit në kohën e kryerjes së veprës penale ishte e zvogëluar, por jo aq sa ai të mos ishte në gjendje që në tersi t'i kuptonte veprimet e tij apo ta kuptonte veprën penale, prandaj, pa bazë pretendohet në kërkesë se i dënuari nuk ishte në gjendje të kuptonte veprimet e veta dhe nuk kishte dashje, ashtu siç pretendohet pa bazë se në rastin konkret nuk është dashur që ndaj tij të shqiptohet dënimi me kusht. Kjo, për faktin se sipas dispozitës së nenit 18 par.2 të kodit penal personi që ka kryer vepër penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij/saj për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve apo mosveprimeve të tij/saj ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në par.1 të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm. Pra, nga kjo dispozitë del se përgjegjshmërinë esenciale të zvogëluar, sikundër papërgjegjshmërie mund ta shkaktojnë sëmundjet mendore kronike apo të përkohshme, çrregullimet mendore dhe ngecjet në zhvillimin mendor, por të cilat nuk janë të asaj natyre dhe intensiteti që ta shpien personin në gjendje plotësisht të papërgjegjshme, dhe personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës. Kurse, kryesit të tillë gjykata mund t'i shqiptojë krahas dënimit edhe masën e trajtimit të detyrueshëm me ndalim apo në liri, varësisht nga propozimi i mjekëve.

7. Përveç, kësaj është irrelevant fakti se në rastin konkret kemi të bëjmë me aktakuzë me propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, dhe nuk është propozuar shqiptimi i sanksionit penal, ngase prokurori në akuzë jo vetëm tek personat me aftësi të zvogëluar mendore por edhe në raste tjera nuk e propozon dënimin apo llojin e tij që duhet t'i shqiptohet të pandehurit, prandaj pa bazë pretendohet se gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore.
8. Nga arsyet që janë theksuar më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.193/2024, i datës 29.05.2024

"Në rastin konkret pasi që aktgjykimi i formës së prerë është anuluar me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në rigjykim është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit respektivisht është shkelur parimi "referomacio in peus" sepse vepra penale është ricilësuar në një veprë penale me të rëndë sesa ajo për të cilën ishte akuzuar dhe shpall fajtor i dënuari".

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, me aktgjykimin P.nr.145/2022 datë 19 prill 2023, të pandehurin Xh. Sh., e ka shpall fajtor për veprën penale, lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 188 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditësh, i cili me pëlqimin e të pandehurit konform dispozitës së nenit 47 të KPRK i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej një mijë e gjashtë (1600)€. Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë gjobën, atëherë do të ekzekutohet dënimi me burgim.
2. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr. 1045/2023 datë 18 dhjetor 2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit, kurse e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit avokati A.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në marrjen e vendimit gjyqësor, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar, kurse aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim.

4. Ndaj kërkesës së mbrojtësit është përgjigjur Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën me shkrim KMLP.II.nr.112/2024 datë 26 mars 2023, me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është pjesërisht e bazuar.
2. Mbrojtësi në kërkesë pretendon se në këtë çështje janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk konkretizon se cila dispozitë është shkelur por pretendon se me asnjë provë nuk është argumentuar fakti se i mbrojturi i tij e ka kryer veprën penale dhe e tërë akuzat është ngritë në bazë të supozimeve të dëmtuarit. Në rigjykim nuk është vepruar sipas sugjerimeve të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, vetëm është ndryshuar baza ligjore e veprës penale nga lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 në lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK duke shkelur të drejtën e të pandehurit dhe dëgjimit të dëmtuarit dhe policit hetues për të vërtetuar faktin se ku ka mbetur boksi i hekurit si provë në të cilën është thirrur gjatë 11 seancave gjyqësore , por gjyqtari i çështjes kalon në fjalën përfundimtare dhe e shpall aktgjykimin. Ndërsa, këto shkelje nuk janë trajtuar as nga gjykata e shkallës së dytë veçanërisht ndryshimi i bazës ligjore nga ana e prokurorit dhe atë pas pesë viteve.
3. Vlen të theksohet se pretendimet e mbrojtësit përkritazi me bazën ligjore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale i referohen bazës ligjore - vërtetimi i gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për të cilën bazë kërkesa nuk mund të ushtrohet – neni 432 i KPP) ngase kontestohen gjendja e fakteve, dhe këto pretendime nuk qenë objekt shqyrtimi nga ana e kësaj gjykate.
4. Kurse, pretendimet sa i përket cilësimit të veprës penale në rigjykim, e që kanë të bëjnë me bazën ligjore të zbatimit të ligjit penal kjo gjykatë i vlerësoj si të bazuara, për këto arsye:

5. Siç del nga shkresat e lëndës i dënuari me akuzë është akuzuar për veprën penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 188 par.2 lidhur me par.1 të KPRK. Përkitazi me këtë veprë penale nga gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin P.nr.125/2019 datë 31.01.2022, është shpall fajtor dhe gjykuar, i cili aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë PA1.nr.441/2022 datë 23.06.2022.
6. Aktgjykimet e lartcekura kjo gjykatë me aktgjykimin Pml.nr.315/2022 datë 17.08.2022 i ka anuluar dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim sipas detyrës zyrtare për faktin se kishte dyshime se a ishte vërtetuar elementi cilësues i veprës penale nga par.2 i nenit 188 - mjeti që mund të shkaktojë lëndim të rënd trupor (goditja me boks të hekurit).
7. Në rigjykim prokurori në fillim të shqyrtimit gjyqësor sipas vërejtjeve të kësaj gjykate dhe bazuar në dëshminë e të dëmtuarit e kishte ricilësuar veprën penale në lëndim të lehtë trupor, parashikuar me nenin 188 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.14 të KPRK, dhe pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin P.nr.145/2022 datë 19 prill 2023 për veprën penale të lartcekur e ka dënuar me 90 ditë burgim, i cili me pëlqimin e të dënuarit i është zëvendësuar me gjobë në shumë prej njëmijë e gjashtëqind (1600)€, i cili aktgjykim është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin PA1.nr.1045/2023 datë 18 dhjetor 2023.
8. Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes kjo gjykatë vlerëson se në rigjykim është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit respektivisht është shkelur parimi “referomacio in peus” sepse vepra penale është ricilësuar në një veprë penale me të rëndë sesa ajo për të cilën ishte akuzuar dhe shpall fajtor i dënuari. Kështu, për veprën penale për të cilin i dënuari fillimisht është akuzuar dhe shpall fajtor- lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 të KPRK është paraparë dënimi deri në tri (3) vjet burgim, kurse për veprën penale të ricilësuar në rigjykim e për të cilën edhe është shpall fajtor i dënuari, nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK parashihet dënimi me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet. Meqë, minimumi i dënimit është i përcaktuar me 3 muaj del se i dënuari është shpall fajtor për një veprë penale me të rëndë. Në këtë rast është shkelur dispozita e nenit 439 par.4 i KPP. Sipas par.1 të këtij neni në qoftë se aktgjykimi i formës së prerë anulohet dhe lënda kthehet për gjykim të ri, procedura merr për bazë aktakuzën e mëparshme ose atë pjesë të saj që ka të bëjë me

pjesën e anuluar të aktgjykimit. Sipas par.4 të të njëjtit nen me rastin e marrjes së vendimit të ri, gjykata detyrohet me ndalesën e paraparë me nenin 395 të këtij kodi (dënim dhe ricilësimi i veprës penale nuk mund të ndryshohet në dëm të tij). Pra, ricilësimi i veprës penale dhe shpallja fajtor për këtë veprë penale është bërë në dëm të dënuarit.

9. Duke pasur parasysh të lartcekurat, në kontekst të vlerësimit të provave të administruara në këtë çështje juridiko penale kjo gjykatë i vlerësoj veprimet e të dënuarit në raport me të dëmtuarin dhe gjeti se nuk është argumentuar fakti se i dëmtuari është goditur me boks nga i dënuari, por nga provat e administruara del se është goditur me grusht, për çka edhe veprimet e të dënuarit i cilësoj si veprë penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK.
10. Ndërsa, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i kanë vlerësuar gjykatat me rastin e matjes së dënimit veçanërisht faktin se vepra penale është ricilësuar në një veprë penale dukshëm me të butë dhe nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar një kohë e gjatë, kurse nga shkresat e lëndës nuk rezultojnë të dhëna se i dënuari ka ra ndesh me ligjin, kjo gjykatë të dënuarit për veprën penale të ricilësuar sipas kësaj gjykate, i shqiptoj dënim sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të tij, dhe se me të do të mund të ndikohet në parandalimin e tij nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij, por edhe në parandalimin e të tjerëve nga kryerja e veprave penale, respektivisht do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK.
11. Nga sa u tha me lartë e konform dispozitës së nenit 438 par.1 pika 1.1 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.281/2024, i datës 11.06.2024

"Sipas nenit 439 par.1 të KPP - në qoftë se aktgjykimi i formës së prerë anulohet dhe lënda kthehet për gjykim të ri, procedura merr për bazë aktakuzën e mëparshme ose atë pjesë të saj që ka të bëjë me pjesën e anuluar të aktgjykimit. Sipas par.4 të njëjtit nen me rastin e marrjes së vendimit të ri, gjykata detyrohet me ndalesën e paraparë me nenin 395 të këtij kodi (dënimi dhe ricilësimi i veprës penale nuk mund të ndryshohet në dëm të tij- parimi reformacio in peius)".

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.132/2023 datë 11 gusht 2023, të pandehurin Sh. L., e ka shpall fajtor për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë, parashikuar me nenin 173 par.1 nënpar.1.3 lidhur me nenin 28 të KPRK, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.01.2023 e tutje.
2. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.546/2023 datë 19 tetor 2023, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit dhe aktgjykimin e lartcekur e ka ndryshuar vetëm sa i përket vendimit për dënim, ashtu që të pandehurin për veprën penale për të cilën është shpall fajtor e ka gjykuar me katër (4) vite e dy(2) muaj burgim, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.01.2023 e tutje. Ankesa e prokurorit është refuzuar, kurse ajo e të dëmtuarit nuk është shqyrtuar.
3. Kundër aktgjykimeve të lartcekura kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit dhe kjo Gjykatë me aktgjykimi Pml.nr.579/2023 datë 6.12.2023, e ka aprovuar kërkesën e mbrojtësit dhe aktgjykimet janë anuluar dhe çështja është kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. Në rigjykim gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin PKR.nr.4/2024 datë 5 shkurt 2024, të pandehurin Sh. L., e ka shpall fajtor për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë, parashikuar me nenin 173 par.1 nënpar.1.3 lidhur me nenin 28 të KPRK, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.01.2023 e tutje.
5. Në procedurën ankimore, sipas ankesës së prokurorit dhe mbrojtësit të pandehurit Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur përkitazi me ankesat me aktgjykimin PAKR.nr.143/2024 datë 12 prill 2024, i ka refuzuar ankesat si të pabazuara dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.
6. Ndaj aktgjyqimeve të lartcekura, ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësi i të dënuarit, avokati F.Sh., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar, kurse aktgjyqimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim.
7. Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën me shkrim KMLP.II.nr.158/2024 datë 13 maj 2024, me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

I. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:
 - kërkesa është pjesërisht e bazuar.
2. Mbrojtësi në kërkesë pretendon se aktgjykimi i shkallës së dytë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse nuk janë dhënë arsye përkitazi me pretendimet e mbrojtësit të paraqitura në ankesë. Gjykata e shkallës së dytë nuk i është referuar dokumentacionit mjekësor të të pandehurit, sipas të cilave i njëjti pas aksidentit të pësuar vite me parë, në bazë të fletë lëshimit të lëshuar nga katër profesionistë psikiatrik kishin konstatuar në mënyrë të qartë i dënuari kishte pësuar ndryshime në

sferën perceptive të tipit të halucinacioneve auditive, pra, sfera e gjykimit ishte e prekur. Sipas mbrojtësit gjykata e shkallës së dytë nuk e ka vlerësuar në masën e duhur shkallën e përgjegjësisë penale ashtu siç është përcaktuar edhe në dokumentacionin mjekësor dhe konstatimet e psikiatrive që kanë konstatuar se gjendja e tij shëndetësore nuk është në rregull, duke qenë se siç është vërtetuar edhe në shqyrtimin gjyqësor, i dënuari me parë nuk ka qenë i dënuar dhe këto rrethana e ulin nivelin e përgjegjësisë penale, e të cilat do të duhej të paraqisnin rrethanë posaçërisht lehtësuese. Me tej sipas mbrojtësit marr parasysh këto rrethana dhe duke iu referuar dokumentacionit mjekësor i dënuari është dashur të dërgohet në trajtim të detyrueshëm mjekësor-konform dispozitës së nenit 506 të KPP. Pastaj, as gjykata e shkallës së parë dhe as ajo e shkallës së dytë nuk kanë marr për bazë asnjë nga vërejtjet nga Gjykata Supreme me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së sanksionit penal dhe nuk i kanë përfill vërejtjet e dhëna, e asnjë nga kërkesat e palës së pandehur të dhëna përmes përfaqësuesit të tij. Për me tepër në këtë çështje kur i dënuari fillimisht është gjykuar me pesë (5) vite burgim, gjykata e shkallës së dytë e kishte ulur dënimin me burgim në katër (4) vite e dy (2) muaj, kurse në rigjykim kur i dënuari dënohet përsëri me pesë (5) vite burgim gjykata e shkallës së dytë e vërteton dënimin me burgim duke vepruar kështu në kundërshtim me vendimin e saj paraprak.

3. Vlen të theksohet se pretendimet e mbrojtësit se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk janë të bazuara. Siç del nga shkresat e lëndës i dënuari është akuzuar për veprën penale të vrasjes së rendë në tentativë, parashikuar me nenin 173 par.1 nënpar.1.3 të KPRK. Në seancën filltare datë 22.03.2023, mbrojtësi bazuar në dokumentacionin mjekësor – fletë lëshimin nr... datë 27.07.2022 dhe shkresat tjera mjekësore kishte kërkuar që të behet ekspertiza psikiatrike e të dënuarit, të cilën kërkesë gjykata e kishte aprovuar. Sipas ekspertizës të bëre nga grupi prej katër ekspertëve të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës rezulton se i dënuari nuk vuan nga çrregullimi i kualitetit psikotik, nuk ka prapambetje mendore dhe në momentin e kryerjes së veprës penale për të cilën ngarkohet, aftësia e të kuptuarit dhe kontrolles së veprimeve të veta ka qenë e ruajtur. Po ashtu, rezulton se ekspertet kanë pas në dispozicion dokumentet mjekësor në të cilat thirret mbrojtësi në kërkesë. Pastaj, në seancën e radhës pasi që i dënuari është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet e tij në procedurë, e ka pranuar fajësinë dhe mbrojtësi është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të dënuarit.

4. Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes për këtë gjykatë nuk është e qartë se në çka e mbështet pretendimin mbrojtësi se nuk është vlerësuar në masë të duhur përgjegjësia penale e të dënuarit, dhe i njëjti është dashtë të dërgohet në trajtim të detyrueshëm mjekësor-konform dispozitës së nenit 506 të KPP, kur kihet parasysh fakti se nuk kemi të bëjmë me një person të paaftë mendërisht që në kohën e kryerjes së veprës penale lëngonte nga ndonjë sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme apo person me aftësi të zvogëluar mendore, e duke pasur parasysh këtë as gjendja shëndetësore nuk mund të trajtohet si rrethanë posaçërisht lehtësuese, prandaj pretendimet në këtë drejtim kjo gjykatë i konsideron jo serioze dhe krejtësisht të pabazuara.
5. Kurse, pretendimet sa i përket shqiptimit të dënimit nga gjykata e shkallës së dytë në rigjykim, e që kanë të bëjnë me bazën ligjore të zbatimit të ligjit penal kjo gjykatë i vlerësoj si të bazuara, për këto arsye:
6. Siç del nga shkresat e lëndës fillimisht i dënuari me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë PKR.nr.132/2023 datë 11 gusht 2023, është gjykuar me pesë (5) vite burgim. Në procedurën ankimore aktgjykimi i lartcekur është ndryshuar nga gjykata e shkallës së dytë sipas ankesës së mbrojtësit të dënuarit vetëm sa i përket vendimit për dënim, ashtu që ajo gjykatë të dënuarin për veprën penale për të cilën është shpall fajtor e ka gjykuar me katër (4) vite e dy(2) muaj burgim, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.01.2023 e tutje, ankesa e prokurorit është refuzuar, kurse ajo e të dëmtuarit nuk është shqyrtuar.
7. Aktgjykimet e lartcekura kjo gjykatë me aktgjykimin Pml.nr.579/2023 datë 6.12.2023 i ka anuluar dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim në shkallë të parë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale.
8. Në rigjykim i dënuari përsëri me aktgjykimin PKR.nr.4/2024 datë 5 shkurt 2024, shpallet fajtor dhe dënohet me pesë (5) vite burgim, kurse gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin PAKR.nr.143/2024 datë 12 prill 2024, duke vendosur përkitazi me ankesën e prokurorit dhe mbrojtësit të dënuarit i refuzon ato si të pabazuara dhe aktgjykimin e shkallës së parë e vërteton.

9. Bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se në rigjykim është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, respektivisht është shkelur parimi “referomacio in peus” sepse i dënuari është dënuar me dënim me të rëndë në rigjykim. Në këtë rast është shkelur dispozita e nenit 439 par.4 i KPP. Sipas par.1 të këtij neni në qoftë se aktgjykimi i formës së prerë anulohet dhe lënda kthehet për gjykim të ri, procedura merr për bazë aktakuzën e mëparshme ose atë pjesë të saj që ka të bëjë me pjesën e anuluar të aktgjykimit. Sipas par.4 të të njëjtit nen me rastin e marrjes së vendimit të ri, gjykata detyrohet me ndalesën e paraparë me nenin 395 të këtij kodi (dënim dhe ricilësimi i veprës penale nuk mund të ndryshohet në dëm të tij). Pra, gjykata e shkallës së dytë duke e vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë e ka shkel parimin e lartcekur- respektivisht ligjin penal në dëm të dënuarit.
10. Vlen të theksohet se për veprën penale për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë, nga neni 173 par.1 nënpar.1.3 të KPRK për të cilën është gjykuar i dënuari parashihet dënimi jo me pak se dhjetë vite burgim ose me burgim të përjetshëm. Në rastin konkret vepra ka mbetur në tentativë dhe sipas dispozitës së nenit 28 par.3 të KPRK-së, personi që tenton të kryejë veprën penale dënohet, sikur ta kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet. Kurse, sipas dispozitës së nenit 71 të KPRK, gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit, kur ligji e parasheh që dënimi i kryesit mund të zbutet apo të zvogëlohet, kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë që qëllimi i dënimit mund të arrihet dhe me shqiptimin e dënimit me të butë ose në rastet kur kryesi e pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë. Sipas dispozitës së nenit 72 të KPRK kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 të KPRK nëse për veprën penale për të cilën është paraparë si masë me e ultë dënimi me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet, dënimi mund të zbutet deri në pesë (5) vjet. Meqë i dënuari, e ka pranuar fajësinë gjykata e shkallës së parë konform dispozitës së nenit 72 të KPRK e ka gjykuar me pesë vite burgim, kurse gjykata e shkallës së dytë e ka ulë dënimin në katër (4) vite e dy (2) muaj burgim, pra, gjykata e shkallës së dytë e ka shkel ligjin penal në favor të dënuarit – neni 385 par.1 nënpar.1.5 të KPP, sepse e ka ulur dënimin nën minimumin e veçantë.

11. Mirëpo, pavarësisht faktit se gjykata e shkallës së dytë e ka shkelur ligjin penal në favor të dënuarit, pasi që është anuluar aktgjykimi i formës së prerë, në rigjykim me rastin e marrjes së vendimit të ri, gjykatat detyrohen me ndalesën e paraparë me nenin 395 të këtij kodi (dënim dhe ricilësimi i veprës penale nuk mund të ndryshohet në dëm të tij, pra, gjykata e shkallës së dytë nuk ka mundur të veprojë në dëm të dënuarit, prandaj kjo gjykatë e aprovoj kërkesën në këtë pjesë dhe i ndryshojë aktgjykimet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

12. Nga sa u tha me lartë e konform dispozitës së nenit 438 par.1 pika 1.1 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.417/2023, i datës 29.08.2023

”Ky rast është i rëndësishëm për faktin se ka pasur dilema fakti i pjesëmarrjes së tre e më tepër personave në rrahje dhe a konsiderohet pjesëmarrës edhe personi që më vonë ka vdekur.

Me këtë rast është konstatuar se edhe personi i cili pas rrahjes ka vdekur konsiderohet pjesëmarrës në rrahje dhe me këtë përmbushet kushti objektiv i pjesëmarrjes së më tepër se tre personave në rrahje“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.76/2022 të datës 27.02.2023, të dënuarin A.Z. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj në të cilin dënim i ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim nga data 03.02.2021 e tutje. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 50 €, në emër të shpenzimeve të procedurës penale, shumën prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 50 € në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse përfaqësuesi i palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.295/2023 e datës 26.06.2023, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar dhe mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
3. Kundër këtyre aktgjyqimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi e të dënuarit A.Z., avokati G.R., nga M., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale me propozim që Gjykata

Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara t'i ndryshon dhe të dënuarin ta liron nga akuza apo lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.251/2023 e datës 22.08.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
5. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur ligji penal, meqë në veprimet e të dënuarit nuk manifestohen elementet qenësore të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, përkatësisht gjykatat gabimisht kanë konkluduar se është realizuar vepra penale. Pretendohet se kryerës i veprës penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPRK-së është personi apo personat të cilët kanë marrë pjesë në rrahje e për të cilët është konstatuar se nuk kanë kryer vrasjen apo lëndimin veçanërisht të rëndë trupor dhe ku kërkohet pjesëmarrja e së paku tre personave, kurse në rastin konkret sipas përshkrimit të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është konstatuar se pjesëmarrës në rrahje kanë qenë vetëm i akuzuari L.B. dhe tani i ndjeri A.M. dhe që nga ky konstatim rrjedh se nuk është përmbyshur kushti që në rrahje të marrin pjesë së paku tre persona. Meqë i akuzuari L.B. nuk mund të konsiderohet pjesëmarrës në rrahje pasi që i njëjti është kryerës i veprës penale të vrasjes ndaj të ndjerit A.M. e po ashtu pjesëmarrës në rrahje nuk mund të konsiderohet as tani i ndjeri A.M. pasi që i njëjti nuk ka bërë kurrfarë sulmi ndaj L.B. dhe se pa fajin e tij është privuar nga jeta.
6. Në vijim të kërkesës janë paraqitur pretendime përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqë në aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh janë konsideruar të vërtetuara apo të pavërtetuara dhe nuk janë vlerësuar saktësia e provave kundërthënëse. Theksohet fakti se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pakuptueshëm, konfuz dhe juridikisht i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, meqë vetëm është konstatuar se në rrahje kanë marrë pjesë tre persona dhe pa dhënë sqarime se cilët ishin ata tre persona të cilët morën pjesë në rrahje dhe çfarë veprime konkrete morën. Për më

tepër, në këtë çështje penale është vërtetuar se F.K. është fjalosur me L.B., ndërsa rrahja është shkaktuar mes të L.B. dhe A.M. e që këta dy persona nuk mund ta kenë cilësinë e personave që kanë marrë pjesë në rrahje pasi që L.B. nuk mund të konsiderohet pjesëmarrës në rrahje pasi që është kryerës i veprës penale të vrasjes ndaj të ndjerit A.M. e po ashtu pjesëmarrës në rrahje nuk mund të konsiderohet as tani i ndjeri A.M. pasi që i njëjti pa fajin e tij është privuar nga jeta.

7. Tutje pretendohet se gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsye përkitazi me pretendimet e ngritura ankimore pikërisht përkitazi me plotësimin e kushtit të pjesëmarrjes në rrahje të të dënuarit, meqë nuk është përgjigjur në pretendimin se për pjesëmarrje në rrahje duhet pjesëmarrja e së paku tre personave e që në rastin konkret kjo nuk ka ndodhur.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:
 - kërkesa nuk është e bazuar.
2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.
3. Duke shqyrtuar pretendimet konkrete të paraqitura në kërkesën e mbrojtëses së të dënuarës se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje të ligjit penal, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara, meqë sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës në veprimet e të dënuarit janë realizuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPRK-së, ashtu që përfundimet e nxjerra nga ana e dy gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore në tersi i pranon edhe kjo gjykatë.

4. Duke u referuar në përmbajtjen e dispozitës së nenit 187 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se: *“Kushdo që merr pjesë në rrahje, e cila rezulton me vdekje ose lëndim të rëndë trupor të personit, për pjesëmarrje në rrahje dënohet...”*

5. Nga leximi i kësaj dispozite ligjore del se me këtë vepër penale inkriminohet pjesëmarrja në rrahje (si kusht subjektiv) dhe vdekja apo lëndimi i rëndë trupor (si kusht objektiv) e që në rastin konkret këto dy kushte janë plotësuar. Meqë në këtë rrahje kanë marrë pjesë tani i dënuari A.Z., F.K. dhe tani i ndjeri A.M., e po ashtu është plotësuar edhe kushti objektiv se në këtë rrahje një person ka humbur jetën (tani i ndjeri A.M.). Për më tepër, sipas dinamikës së ngjarjes së përshkruar del se konflikti fizik ka ndodhur mes këtyre personave e që involvimi i tani të dënuarit del të jetë i qartë kur disa herë e godet me shkelma dhe grushte tani të ndjerin dhe i cili pastaj kishte vdekur pas dërgimit në spital, si pasojë e goditjes me thikë nga ana e të akuzuarit L.B.. Pra për tu konsideruar se është kryer vepra penale e pjesëmarrjes në rrahje nuk është e domosdoshme ndërmarrja e ndonjë veprimi konkret në rrahje, por është e mjaftueshme edhe inkurajimi dhe përkrahja e ndonjërit nga personat e involvuar në rrahje, në këtë rast e F.K., kurse në rastin konkret del se pjesëmarrës në rrahje ishte edhe vet tani i ndjeri, meqë nga shkresat e lëndës del se i njëjti menjëherë pas therjes me thikë kishte marrë disa goditje nga ana e tani të dënuarit. Për më tepër, nga konstatimet e aktgjykimeve të dy instancave më të ulëta gjyqësore dhe shkresat e lëndës del se tani i ndjeri menjëherë pas therjes me thikë dhe goditjes me shkelm dhe grusht nga ana e të dënuarit për disa minuat kishte pasur vetëdije dhe kishte qëndruar në këmbë, mirëpo pas një kohe të shkurtër i ishte përkeqësuar gjendja shëndetësore si pasojë e plagës së shkaktuar me thikë nga ana e L.B.t dhe që më vonë kishte rezultuar me vdekjen e tij.

6. Pretendimi i potencuar në kërkesë se gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur arsyetim të plotë përkitazi me pjesëmarrjen e së paku tre personave e që paraqet kushtin për tu kryer kjo vepër penale, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, del të jetë pretendim i pabazuar. Meqë gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj ka paraqitur arsyetim të plotë për të gjitha faktet vendimtare dhe veçanërisht për numrin e pjesëmarrësve në rrahje, për më tepër, arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është në tersi i pranueshëm edhe për Gjykatën Supreme të Kosovës dhe se nga shkresat e lëndës del se në mënyrë të drejtë gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar faktin se natën kritike mes të F.K. dhe L.B.t në njërën anë dhe A.M. në anën tjetër kishte pasur

fillimisht një fjalosje e cila kishte eskaluar në konflikt fizik mes tyre dhe që i akuzuari L.B. pastaj me thikë e kishte goditur dy herë në atriumin e majtë të zemrës tani të ndjerin A.M. e që pas kësaj në konflikt ishte involvuar edhe tani i dënuari A.Z. duke e goditur disa herë me shkelma dhe grushte tani të ndjerin, ashtu që arsyetimin dhe konkludimet e theksuar në faqen e njëmbëdhjetë të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të cilat përfundime i aprovon në tërësi edhe kjo gjykatë.

7. Edhe pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, megjithatë, bazuar në përmbajtjen e saj janë paraqitur kryesisht pretendime përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Mirëpo, bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPP-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, andaj pjesa e kërkesës e paraqitur për këtë bazë është refuzuar si e pabazuar.
8. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.428/2023, i datës 31.08.2023

”Ky rast është i rëndësishëm për faktin se e dëmtuara – dëshmitarja kishte dhënë deklarime kontradiktore në faza e ndryshme të procedurës penale dhe gjykata nuk kishte arritur të i shpjelloj këto deklarime dhe në aspekt kritik të bëj vlerësimin e tyre aq më tepër kur ky deklaram ishte në kundërshtim edhe me provat tjera materiale“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti për të Mitur, me aktgjykimin PM.nr.23/2022 të datës 22.12.2022, të dënuarin M.I. e ka shpallur fajtor për veprën penale dhunimi nga neni 227 par.7 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 22.12.2021 e tutje. I dënuarit është obliguar në pagesën e shumës prej 50 €, në emër të shpenzimeve të procedurës penale, shumën prej 200 (dyqind) €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 50 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për të Mitur, me aktgjykimin PAKR.nr.100/2023 e datës 18.04.2023, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
3. Kundër këtyre aktgjyqimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit avokati T.G., nga P., për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga

akuza apo që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.258/2023 e datës 24.08.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
5. Në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit pretendohet për shkelje të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore pasi që në rastin konkret është dënuar për veprën penale dhunimi nga neni 227 i KPRK-së e cila dispozitë përkufizon se: “Kushdo që e detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me burgim prej dy (2) deri 10 (dhjetë) vjet”, e që nga përkufizim kuptohet se për tu konsideruar se është kryer kjo veprë penale duhet të përmbushen dy kushte: që të jetë kryer akti seksual dhe që akti të jetë kryer nën ndonjë formë të detyrimit dhe pa pëlqimin e subjektit pasiv- viktimës dhe mungesa e cilitdo prej këtyre kushteve nënkupton se nuk kemi të bëjmë me veprën penale të dhunimit. Tutje me nenin 225 par.4 të KPRK-së është përkufizuar edhe akti seksual “Shprehja akt seksual nënkupton penetrim sado i vogël i organit seksual ose i objektit për qëllime seksuale në cilëndo pjesë të trupit të personit ose penetrim sado i vogël në hapjen anale, orale apo gjenitale të personit me ndonjë send për qëllim seksual ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit, ose me cilëndo pjesë të kafshës”.
6. Kurse në rastin konkret pretendohet se nuk është vërtetuar me asnjë provë të ketë ndodhur akti seksual madje as nga ekspertizat mjekësore që janë bërë të dëmtuarës nuk dëshmohe kryerja e aktit seksual. Sipas ekspertizave mjekësore në pjesët e ekzaminuara të trupit të të dëmtuarës D.M. nuk është gjetur ndonjë mbetje e ADN-së të të dënuarit e që kjo vërteton se mes këtyre personave nuk ka ndodhur akti seksual. Për më tepër, edhe vet e dëmtuara gjatë kontrollit në spital me datë 22.12.2021 ka mohuar marrëdhënien seksuale, kurse gjykatat në aktgjykimet e tyre nuk kanë përshkruar mënyrën se si është kryer akti seksual, por vetëm kanë potencuar se ka ndodhur akti i tillë. Parimi i ligjshmërisë qartëson se për aq sa për veprën penale të dhunimit duhet që në mënyrë shprehimore të ekzistoj akti seksual dhe mos vërtetimi i aktit automatikisht eliminon mundësinë e kryerjes së veprës penale.

7. Në vijim pretendohet se me asnjë provë nuk është dëshmuar akti seksual në mes të të dënuarit dhe të dëmtuarës e që për këtë çështje ka kontradikta mes vet deklarimeve të të dëmtuarës e cila deri sa në deklarimin e saj të datës 22.12.2021 në Policinë e Kosovës ka mohuar kryerjen e aktit seksual dhe e cila deklaratë është dhënë të nesërmen dhe kur e dëmtuara kishte memorie të freskët, e të cilën deklaratë e konfirmon edhe gjatë kontrollit mjekësor në Spitalin e Gjakovës po ashtu me datë 22.12.2021. Kurse në deklaratat e dhëna në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me datë 03.02.2022 dhe në Gjykatën Themelore në Gjakovë me datë 19.07.202, e dëmtuara ka deklaruar se ka pasur marrëdhënie seksuale me të dënuarin, por se këtë e ka bërë me vullnetin e saj, e që ky ndryshim i deklarimeve është bërë pa vullnetin e saj dhe si pasojë e presionit dhe ndikimit familjar. Megjithatë edhe në deklaratimet e saja në prokurori dhe gjykatë nuk e ka përshkruar fare se si ka ndodhur akti seksual e cila do të duhej të konsiderohej si rrethanë e dyshimtë dhe e pa provuar dhe të vlerësohet në favor të të dënuarit. përkundër kësaj gjykata e shkallës së parë nuk ka administruara si prova deklaratimet e të dëmtuarës në polici dhe po ashtu nuk ka dhënë arsyetim për këto deklarime kontradiktore të saja,. Madje nuk ka dhënë arsyetim se përse nuk i fali besim deklarimeve të të dënuarit i cili vazhdimisht ka mohuar të ketë kryer veprën penale dhe kjo lë dyshime për objektivitetin dhe paanshmërinë e gjykatave në vendimmarrje.
8. Pretendohet për shkelje lidhur me përkufizimet e provave nga neni 257 par.2 të KPP-së, pasi që “gjykata të dënuarin nuk e shpall fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaratimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit”, kurse në rastin konkret gjykata e shkallës së parë është bazuar vetëm në deklaratat kontroverse të të dëmtuarës të dhëna në prokurori dhe gjykatë ku ka deklaruar se ka kryer aktin seksual me pëlqimin e saj dhe në tërësi është shpërfillur deklarimi i saj në polici ku ka mohuar kryerjen e aktit seksual dhe aktgjykimi është bazuar vetëm në një deklaratë dhe me këtë është shkelur dispozita në fjalë dhe në shkelje të dispozitave të procedurës penale.
9. Gjithashtu janë paraqitur pretendime për përbërjen e trupit gjykues në gjykatën e shkallës së parë ku theksohet fakti se në përbërje të trupit gjykues për të mitur ka marrë pjesë gjyqtari i cili është gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec. Kurse shkelje pretendohen edhe nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, meqë seanca gjyqësore është mbajtur në Departamentin e Përgjithshëm dhe jo në

Departamentin për të Mitur, duke u bazuar në procesverbalin e kësaj seance dhe i cili gabim nuk është korrigjuar, siç është përcaktuar me dispozitat në fuqi.

10. Më tutje pretendohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 369 të KPP-së, pasi që aktgjykimi nuk përmban të gjitha të dhënat e nevojshme, meqë i dënuari është shpallur fajtor për veprës penale të dhunimit e që figura e kësaj vepre penale përbëhet nga kryerja e aktit seksual dhe nga detyrimi i subjektit pasiv gjegjësisht mungesës së pëlqimit për aktin seksual e që kjo nënkupton se do të duhej të jepet një përshkrim lidhur me mënyrën e kryerjes së aktit seksual, si element thelbësor i kësaj vepre penale. Është dashur të paraqitet arsyetim për mënyrën e kryerjes së aktit seksual, faktet përmes së cilave është kryer akti seksual, përse nuk i është falur besimi deklaratës së të dëmtuarës dhënë në polici, por i është falur besimi deklarimeve të saj në prokurori dhe gjykatë dhe po ashtu përse nuk i është besuar deklaratave të të dënuarit dhe ekspertizave mjekësore.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, janë të bazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet. Meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas dispozitës së nenit 384 par.2 nënpar.2.7 të KPPK-së, përkatësisht nenit 369 par. 7 të KPPK-së, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur arsyetim me rastin e vërtetimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarit. Nga përmbajtja e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del se vetëm është bërë përshkrimi i provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe nuk është bërë vlerësimi i tyre që të shpiejnë deri tek një konkludim, për më tepër, përshkrimi i dispozitivit të aktgjykimit

të gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me shkresat e lëndës, përkritazi me vërtetimit të veprës penale dhe përgjegjesisë penale të të dënuarit.

3. Sipas pikëpamjes së Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin konkret arsyetimi i aktgjykimit është në kundërshtim me shkresat e lëndës, meqë me rastin e vlerësimit të dëshmisë së dëshmitares- të dëmtuarës D.M. është konstatuar se dëshmia e saj gjatë deklarimit në prokurorinë e shtetit dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ishte e besueshme dhe reale. Kurse njëkohësisht nuk janë arsyetuar fare deklarimet e saja në polici dhe me rastin e kontrollit mjekësor në Spitalin e Gjakovës (deklarime të dhëna menjëherë pas ngjarjes), me ç'rast e njëjta kishte dhënë deklaratë plotësisht kontradiktore në raport me deklarimin e saj në prokurori dhe polici. Për më tepër, deklarimet e të dëmtuarës dalin të jenë fakte vendimtare në këtë çështje penale pasi që skeleti i aktakuzës është konstruktuar pikërisht mbi bazën e deklarimeve të saj. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë nuk kishte bërë vlerësim kritik të deklarimit të të dëmtuarës në raport me provat tjera të administruara dhe atë në rend të parë me mbrojtjen e të dënuarit i cili në mënyrë konsistente kishte mohuar kryerjen e veprës penale gjatë të gjitha fazave të procedurës penale dhe po ashtu kishte potencuar disa fakte të rëndësishme përkritazi me të kaluarën e të dëmtuarës e të cilat kishin mbetur tërësisht jashtë arsyetimit nga gjykata e shkallës së parë. Përtej kësaj, deklarimet e lartë cekura të të dëmtuarës dalin se nuk janë në përputhshmëri dhe nuk kishin ndërlidhje as me provat e tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjegjësisht ekspertizën mjeko-ligjore, dëshminë e ekspertit mjeko-ligjor gjatë shqyrtimit gjyqësor në të cilën është konstatuar fakti se gjatë ekzaminimit ano-vaginal janë konstatuar shqyerje të vjetra në cipën e vajzërisë dhe nuk janë konstatuar dëmtime trupore të freskëta, pastaj edhe raportin e ekspertit të AKF-së dhe dëshminë e ekspertit gjatë shqyrtimit gjyqësor përkritazi me ekzaminimin e mostrave MP21-118 (ku testi i spermës ka dhënë rezultat negativ dhe nuk janë identifikuar spermatozoid), e që të gjitha këto prova të cilat vënë në dyshim të plotë gjendjen faktike të konstatuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, përkritazi nuk korrespondon me përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.
4. Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPP-së, të cilat shkelje nuk janë

eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë e cila përmes një shablloni standard të krijuar anashkalon në tërësi pretendimet ankimore të paraqitura nga ana e mbrojtësit të të dënuarit edhe përkitazi me ndryshimin e deklarimeve nga ana e të dëmtuarës dhe provat tjera kontradiktore të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, shkeljet e theksuara më lart e vënë në dyshim edhe gjendjen faktike pasi që nuk është vërtetuar saktësia e fakteve vendimtare dhe të cilat nuk janë në harmoni me provat e administruara, me ç'rast janë interpretuar në mënyrë të gabuar, përkundër faktit se dyshimet eventuale do të duhej të interpretohen duke respektuar parimin e mirënjohur juridik "in dubio pro reo" i përcaktuar me dispozitën e nenit 3 par.2 të KPP-së, se "Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.", nga kjo arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjykimeve të kundërshtuara dhe shqyrtim të serishëm të kësaj çështje.

5. Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të administroj provat ekzistuese e sipas nevojës edhe prova tjera e pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.
6. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 438 par. 1 pika 1.2 të KPPK -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.468/2023, i datës 31.10.2023

"Ky rast është i rëndësishëm për faktin se janë caktuar tri ekspertiza të ekspertëve të ndryshëm të lëmisë së psikiatrisë forenzike dhe të cilët kanë pasur mendime të ndara mes vet ekipit të tyre përkitazi me gjendjen mendore të të pandehurve.

E rëndësishme është se gjykata e shkallës së parë ka kombinuar mendimet e ndara të ekspertëve dhe në bazë të tyre ka arsyetuar aktgjykimin e saj i cili ka rezultuar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.65/2018 e datës 27.12.2022, të dënuarin D.L. e ka shpallur fajtor për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 dhe 1.11 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 24 (njëzetekatër) vite, kurse për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga 2 (dy) vite, ashtu që e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 25 (njëzetepesë) vite, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e paraburgimit prej datës 26.08.2016 e deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë. Kurse të dënuarin S.L. e ka shpallur fajtor për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vite, kurse për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga 2 (dy) vite, ashtu që e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) vite, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e paraburgimit prej datës 26.08.2016 e deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë. Të dënuarit janë obliguar që secili veç e veç në pagesën e shumës prej nga 500 €, në emër të shpenzimeve të procedurës penale, shumën prej nga 150 €, në emër të paushallit gjyqësor, dhe shumën prej nga 50 €, në fondin për kompensimin e viktimave

të kimit, kurse përfaqësuesit e të ndjerëve për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

1. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.131/2023 të datës 04.04.2023, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të dënuarve dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

2. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit D.L., avokati B.B., nga P., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulon dhe lëndën ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;

- mbrojtësja e të dënuarit S.L., avokate K.K., nga P., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara t'i ndryshon dhe të dënuarin të e liroj nga akuzat ose aktgjykimet e kundërshtuara të i anulon dhe lëndën ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

3. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.282/2023 e datës 19.09.2023, ka propozuar që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohen si të pabazuara.

4. Në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit D.L. është theksuar se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në faktin e mos ndërmarrjes së veprimeve të udhëzuara nga ana e gjykatës së shkallës së dytë sipas aktgjykimit PAKR.nr.257/2018 të datës 03.07.2018. Por gjykata ka vijuar me të njëjtat shkelje edhe në aktgjykimin e kundërshtuar duke paraqitur arsye dhe konkludime të njëjta dhe tërësisht të paqëndrueshme dhe kontradiktore përkitazi me faktet vendimtare, përkatësisht nuk ka arritur të përcaktoj

përgjegjësinë penale të të dënuarit D.L. në lidhmëni me tronditjen e fortë mendore të krijuar në momentin e gjuajtjes me armë nga ana e tij. Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk është paraqitur saktësisht përshkrimi i veprimeve të të dënuarit D.L. që e përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari, përkatësisht nuk qëndron fakti se me rastin e ndërmarrjes së veprimit nga ana e të dënuarit është rrezikuar jeta e personave të tjerë prezent në vendin e ngjarjes përveç ndaj personit ndaj të cilit është kryer veprimi. Pretendohet se gjykata e shkallës së parë në rigjykim ka dështuar të shqyrtoj të gjitha çështjet kontestuese dhe nuk ka arritur të vlerësoj gjendjen e tronditjes mendore të të dënuarit, nuk janë eliminuar kontradiktat e shfaqura nga ana e ekspertëve dhe sqarimi i kontradiktave të dëshmimeve të dëshmitarëve, vlerësimi i mbetjeve të nitriteve dhe nitrateve në duart e të ndjerit B.R., faktet që shihen përmes videoincizimeve, vlerësimi i ekspertizave balistike, gjurmëve të gjakut të gjetura në kafkën e revoles F.. e cila i takon profilin të të dënuarit S.L., përcaktimi i shkakut të vdekjes së të ndjerëve. Tutje theksohet se nuk në arsyetimi të aktgjykimit nuk janë eliminuar dhe sqaruar kontradiktat e dëshmitarëve, përkundër faktit se janë dëgjuat disa dëshmitar dhe atë pesë të familjes R., dy anëtar të familjes L. dhe dy dëshmitar të palëve të cilët nuk ishin të përfshirë në proces, por kontradiktat e dëshmimeve të tyre nuk janë sqaruar dhe atë prej fillimit të ngjarjes, gjegjësisht shkuarjes së të dënuarit D.L. para derës së shtëpisë së të ndjerëve, fjalët që kishte përdore aty, përgjigjen-reagimin e të tjerëve, kush kënd e sulmoi i pari dhe me çfarë mjeti dhe cilat ishin reagimet e të ndjerëve, e që të gjitha këto çështje nuk janë shqyrtuar me rastin e rigjykimit të rastit.

5. Gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur arsyetim të qëndrueshëm për gjendjen mendore të të dënuarit, si element qenësor i veprës penale, dhe për më tepër, janë injoruar në tërësi të gjeturat e profesionistëve, përkatësisht ekspertëve të fushës të cilat ishin të bazuara dhe ekspertizat e përpiluara vetëm se janë cituar e të cilat ekspertiza kanë qenë edhe të ndara, mirëpo në këtë rast gjykata e shkallës së parë i ka falë besimin vetëm njërit nga ekspertët (J.Z.), kurse njëkohësisht nuk i ka falur besim ekspertizës së dy ekspertëve të tjerë (S.R. dhe B.B., meqenëse ekspertizat e tyre në tërësi janë të ndryshme edhe pse kanë qenë pjesë e një ekipi.
6. Në vijim të kërkesës pretendohet se si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale domosdoshmërisht ka ardhur deri te shkelja e ligjit penal dhe kundërligjshmëria e sanksionit penal. Theksohet fakti se për tu realizuar vepra penale e

vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1.5 lidhur me nenin 11 të KPRK-së, kryerësi duhet të veproj me dashje të dyfishtë, së pari të ketë qëllim privimin e caktuar nga jeta dhe rrezikimi konkret i jetës së personave të tjerë, kurse realizimi i veprës penale sipas paragrafit 11, te kryerësi duhet të ekzistoj dashja për të privuar nga jeta dy apo më shumë persona. Kurse në rastin konkret nuk kanë ekzistuar asnjëra nga këto rrethana, dhe për më tepër, veprimet e të dënuarit janë kryer si pasojë e sulmit brutal të shkaktoar ndaj babait të tij dhe se veprimi i tij ka ardhur si pasojë e tronditjes së fortë mendore dhe si rezultat i kësaj nuk ka mundur që të dënuarit të i shqiptohet sanksioni penal për këtë veprë penale.

7. Më tutje në kërkesë janë paraqitur pretendimet për shkelje ligjore nga ana e gjykatës së shkallës së dytë duke potencuar faktin se kjo gjykatë nuk ka arritur që të i shqyrtoj dhe vlerësoj pretendimet ankimore specifike dhe nuk ka arritur që të paraqes arsyetim bindës dhe me këtë rast ka anashkuar në tersi parimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Konkretisht nuk ka arsyetuar pretendimet ankimore përkritazi me gjendjen mendore të të dënuarit D.L. dhe i cili arsyetim nuk ka përfillur mendimin e ekspertëve: Dr. F.D., Dr. A.B., N.H. (punëtor social) dhe ekspertës N.M. dhe të cilat mendime kanë konkluduar se veprimi i të dënuarit ka qenë në gjendje të afektit mendor dhe mendimin e ekspertëve Dr. Sh.H., A.G. dhe A.V., të cilët kanë paraqitur mendimin e tyre se veprimi i të dënuarit nuk ishte bërë nën afektin mendor. Ashtu që si rezultat i këtyre kontradiktave ishte urdhëruar ekspertiza e tretë në përbërje nga ekspertët Dr. J.Z., Dr. S.R. dhe Dr. B.B. dhe e cila ekspertizë është nënshkruar vetëm nga Dr. J.Z. por jo edhe nga anëtarët e tjerë dhe në të cilin konstatim janë paraqitur mendime të ndara mes ekspertëve deri sa eksperti Dr. J.Z. ka konstatuar se i dënuari ka qenë i aftë të kuptoj veprimet e veta, konstatimet e dy anëtarëve të tjerë Dr. S.R. dhe Dr. B.B. ndryshojnë në tërësi duke konstatuar se i dënuari në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë në gjendje të afektit mendor dhe se ngjarja ka ndodhur jashtë kontrollit të tij. Arsyetime të qarta dhe të qëndrueshme nga ana e gjykatës së shkallës së dytë nuk janë paraqitur as përkritazi me dashjen dhe motivin e kryerjes së veprës penale, janë shpërfillur dhe injoruar në tersi pretendimet ankimore për fotodokumentacionin dhe lëndimet e marra nga i dënuari tjetër S.L. Janë shpërfillur dhe anashkuar në tersi pretendimet ankimore rreth dinamikës së zhvillimit të ngjarjes, pozicionet e qitjes dhe shkaktimin e plagëve vdekjeprurëse. Kontradiktat mes dëshmitarëve dhe kundërligjshmëria e shpalljes si provë e papranueshme e raportit

të ekspertizës së Institutit të Psikiatrisë Forenzike e datës 27.05.2019 e përpiluar nga ana e ekspertes N.M. Përtej kësaj përmes këtij arsyetimi gjykata e shkallës së dytë me paraqitjen e arsyetimeve të paqëndrueshme dhe nuk ka bërë sanimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, përkundrazi janë dhënë arsyetime abstrakte, të përgjithësuar, dhe të pa konkretizuara lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

8. Në kërkesë mbrojtësja e të dënuarit S.L. thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.2 lidhur me nenin 369 të KPP-së dhe kjo për faktin se në aktgjykim prej 88 faqesh mbi 70 faqe është bërë përshkrimi i deklaratave të të dëshmitarëve dhe të dëmtarëve, sikurse janë listuar provat materiale, por pa ndonjë analizë e mirëfilltë e tyre dhe duke mos i ndërlidhur njëra tjetrën.
9. Pretendohet se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqë është i pakuptueshëm, kundërthënë me brendinë e tij dhe me arsyetimin në raport me të dënuarin S.L. dhe posaçërisht me arsyetimin e përshkruar në faqen 33 pasusi i fundit dhe faqen 4 të pasusit të parë. Këto përshkrime faktike janë kundërthënëse dhe të paqarta mes veti dhe me dispozitivin e aktgjykimit dhe veçanërisht me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Kjo paqartësi pretendohet se vazhdon edhe në faqen e 34 të arsyetimit të aktgjykimit ku është konstatuar se *“predhat që kanë goditur viktimat ishin tejshkuese do të thotë asnjë predhë nuk ka mbetur në trupin e viktimave, kurse për viktimën B.R. së paku tri presh kishin prekur organet vitale kur kishin shkaktuar vdekjen dhe se të akuzuarit kishin shtënë me armë së paku prej kate pozicioneve, tyta e armës në raport me viktimën distanca ishte më shumë se një metër”*. Ndërkaq në faqen 59 të aktgjykimit është konstatuar se *“nga deklaratimet e ekspertit të balistikës dhe ekspertiza balistike është vërtetuar se gjashtë gëzhoja ishin të armës Glock 17 e dy nga arma Fiestar, ku njëra gëzhojë mban numrin 13 në skicën e vendit të ngjarje, ndërsa tjetra gëzhojë ka mbetur në tytën e armës fierstar dhe mban numrin 10”*. Pra edhe nën supozimin se i dënuari S.L. ka përdorur dhe ka shtënë me armë në tani të ndjerin B.R. me armën Fiestar prej së cilës është gjetur një gëzhojë dhe një tjetër në tytë të revoles, atëherë janë dy të shtëna dhe si ka mundësi që i njëjti ka shtënë së paku prej katër pozicioneve.

10. Në kërkesë pretendohet se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë vlerësimin e saktë të provave kundërrhënëse dhe veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale për të dënuarin S.L. edhe pse në këtë çështje janë dëgjuar dhjetë dëshmitar, prej tyre pesë anëtar të familjes R., dy të familjes L. dhe dy dëshmitar neutral. Kurse të gjithë dëshmitarët - anëtarët e familjes R. përkundër deklarimeve kontradiktore mes veti dhe me njëri-tjetrin, por se përpiqen të përputhen mes vete vetëm me një fjali të vetme se kinse S.L. ka pasur armë e disa prej tyre e plotësojnë se ka shtënë në drejtim të tani të ndjerit B. Kjo është e natyrshme pasi që i ndjeri B.R. ka më shumë plagë, pra gjashtë ndërsa i ndjeri tjetër R.R. kishte vetëm një plagë, kurse nga ekspertiza e balistikës është vërtetuar se D.L. me armën tij Glock -17 ka shtënë shtatë herë aq sa kanë plagë dy viktimat, ndërsa me armën Firestar është shtënë vetëm një herë që përputhet me deklarinin e të dënuarit S.L.
11. Tutje në kërkesë janë paraqitur pretendime se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me provat materiale dhe me relevancë që janë raporti i autopsisë, ekspertiza balistike dhe ekspertiza e ADN-së. Përmes raportit të autopsisë për të ndjerin B.R. është konstatuar se plagë e shkaktimit të vdekjes është plaga nr. 2 por se nuk është sqaruar se kush nga të dënuarit e shkaktuan këtë plagë D.L. apo S.L., pasi që në aktakuzë dhe as në aktgjykim nuk janë të përshkruara veprimet individuale të të dënuarve. Gjithashtu edhe nga raporti i përpiluar nga ana e AKF-së mbi gjetjen e grimcave barotike në duart e tani të ndjerit B.R. për të cilat gjurmë prokuroria assesi nuk është pajtuar, kurse në aktgjykimin e ankimor është konstatuar se "me siguri se grimcat e barotit janë bartur në duart e tani të ndjerit Burim nga ajri kur ka shtënë i dënuari S.L.", por atëherë pse këto gjurmë barotike nuk u gjetën tek i ndjeri tjetër R.R. dhe se nuk u gjetën as te gjurmët e gishtërinjve të të dënuarit S.L. E gjithashtu potencohet fakti se gjykata e shkallës së parë ka anashkaluar në tërësi lëndimet trupore të pësura nga i dënuari S.L. ditën kritike.
12. Në vijim të kërkesës pretendohet se si pasojë e shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale ka pasur edhe shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit S.L., ngase nuk është provuar me asnjë provë relevante qoftë të drejtpërdrejte qoftë të tërthortë se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është gjykuar dhe kjo bazohet edhe në faktin se i njëjti fillimisht është dyshuar për veprën penale pjesëmarrje në rrache dhe pas dy muajve është bërë zgjerimi i hetimit dhe mbi këtë bazë

i njëjti mund të jetë fajtor vetëm për këtë vepër penale. Kurse theksohet fakti se edhe gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk ka paraqitur asnjë përgjigje apo sqarim për asnjë pretendim ankimor në raport me të dënuarin S.L. dhe e cila qasje parashtron nevojën që të paraqitet mjeti i jashtëzakonshëm juridik- mbrojtja e ligjshmërisë.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara.

2. Gjykata Supreme e Kosovës, konstatoj se janë të bazuara pretendimet të paraqitura nga mbrojtësit e të dënuarve se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban arsyetim lidhur me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarve. Për më tepër, shkeljet e theksuara më lartë nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë i cili gjithashtu është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPPK-së. Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del se nuk është analizuar edhe nuk janë zbatuar udhëzimet e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë sipas aktvendimit PAKR.nr.257/2018 të datës 03.07.2018, meqë të njëjtat udhëzime nuk janë zbatuar apo janë zbatuar vetëm formalisht dhe jo substancialisht dhe të cilat udhëzime do të qartësonin dinamikën e zhvillimit të kësaj vepre penale.
3. Bazuar në përmbajtjen e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë janë parashtruar dy çështje fundamentale dhe atë çështja se veprimi i të dënuarin D.L. a ishte si rezultat i afektit mendor, si dhe çështja e pjesëmarrje së të dënuarit tjetër S.L. në kryerjen e veprës penale.

4. Gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar disa çështje vendimtare në këtë çështje penale dhe të cilat aktgjykimin e bëjnë juridikisht të paqëndrueshëm dhe atë së pari lidhur me gjendjen mendore në të cilën ka vepruar i dënuari D.L. dhe me këtë rast del se janë formuar tri ekiye të ekspertëve dhe atë e para në përbërje nga ekspertët: Dr. F.D., Dr. A.B., N.H. (punëtor social) dhe të cilët kanë konkluduar se veprimi i të dënuarit D.L. ka qenë në gjendje të afektit mendor, pastaj është urdhëruar ekspertiza e dytë nga ekspertët: Dr. Sh.H., A.G. dhe A.V. dhe është vazhduar me ekspertizën e tretë nga ekspertët: Dr. J.Z., Dr. S.R. dhe Dr. B.B. dhe e cila ekspertizë është nënshkruar vetëm nga Dr. J.Z., por jo edhe nga anëtarët e tjerë dhe në të cilin konstatim janë paraqitur mendime të ndara mes ekspertëve deri sa eksperti Dr. J.Z. ka konstatuar se i dënuari ka qenë i aftë të kuptoj veprimet e veta, konstatimet e dy anëtarëve të tjerë Dr. S.R. dhe Dr. B.B. ndryshojnë në tërësi duke konstatuar se i dënuari në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë në gjendje të afektit mendor dhe se ngjarja ka ndodhur jashtë kontrollit të tij, pra nga këto ekspertiza del se janë në kundërshtim me njëra tjetrën, dhe për më tepër, kanë pasur përfundime të ndryshme edhe mes vet ekspertëve që kanë përpiluar këto ekspertiza.
5. Në këtë aspekt nuk është dhënë një arsyetim bindës dhe i plotë përkitazi me besueshmërinë e këtyre ekspertizave, por vetëm janë përshkruar ekspertizat dhe mendimet e ekspertëve pa një analizë të mirëfilltë të këtyre ekspertizave dhe me një fjali të thjeshtë është ardhur deri te kombinimi i mendimeve të ekspertëve (shih faqen e 80 pasusin e tretë të arsyetimit) e që kjo nuk do të duhej të ndodhte, meqë gjykata do të duhej që paqartësitë dhe mendimet e ekspertëve të i eliminoj gjatë shqyrtimit gjyqësor. Përtej kësaj caktimi i ekipeve të ekspertëve në asnjë rrethanë nuk duhet të nënkuptohet si mburojë për gjykatën në shtjellimin e çështjeve që bien në kompetencat e saja, meqë është në kompetencë ekskluzive e gjykatës në këtë rast të dy shkallëve që të japin konkludime dhe përfundime për provat e administruara dhe në këtë rast edhe ekspertizat e ekspertëve duhet çmuar vetëm si prova në mesin e provave tjera të administruara dhe të cilat nuk duhet të prevalojnë karshi provave tjera.
6. Gjykata Supreme e Kosovës vëren se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsyetim të plotë dhe bindës përkitazi me faktin se verimet e të dënuarit D.L. a ishin kryer nën afektin mendor apo jo dhe arsyetimi lidhur me këtë institut juridik do të duhej të ndërlihej dhe interpretohej në dritën e dispozitës së nenit 174 të KPRK-së e cila ka

përcaktuar se: *“Kushdo që personit tjetër e privon nga jeta në gjendje të tronditjes së fortë mendore të shkaktuar pa fajin e tij nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e personit të vrarë”*.

7. Kjo dispozitë duhet të trajtohet në tërësinë e saj dhe që e rëndësishme është të theksohet fakti se tronditja e fortë mendore nuk duhet të çmohet ekskluzivisht si çështje mjekësore dhe e cila situatë zgjidhet ekskluzivisht përmes ekspertizave përkatëse, por paraqet një kombinim të aspektit mjekësor dhe aspektit faktik dhe duke trajtuar dinamikën e zhvillimit të ngjarjes dhe atë prej fillimit të mosmarrëveshjeve mes të familjes së D.L. dhe tani të dënuarve (përshkrim nga dispozitivi i aktgjykimit), për të vazhduar me ditën kritike, përkatësisht kalimin e të dënuarit S.L. disa minuta para ngjarjes afër shtëpisë së tani të ndjerëve dhe faktin se D.L. i kishte parë armë kallashnikov në dorë (përshkrim nga dispozitivi i aktgjykimit) dhe pastaj mënyra dhe rrethanat e shkuarjes së të dënuarit D.L. afër shtëpisë së të ndjerëve, fillimi i konfliktit, ardhja e të dënuarit tjetër S.L. në vendin e ngjarjes dhe deri në përmbylljen e këtij konflikti. Ashtu që këto episode të zhvillimit të ngjarjes duhet të trajtohen si një tërësi e që përveç ekspertizave, kjo të vërtetohet edhe përmes provave tjera dhe në kombinim të tyre të arrihet deri te konkludimi se në çfarë gjendje ishte i dënuari D.L., para dhe gjatë ndërmarrjes së veprimit të privimit nga jeta të tani të ndjerëve, meqë edhe nga shkresat e lëndës nuk del të jetë kontestuese pjesëmarrja e tij në këtë vepër penale. Në këtë aspekt do të duhej të analizohej dhe arsyetohej edhe sjellja e tani të ndjerëve deri në momentin e privimit të tyre nga jeta e posaçërisht e të ndjerit B.R., fakti se a kishte apo nuk kishte *sulm, keqtrajtimit apo fyerje të rëndë* dhe atë pa fajin e tani të dënuarit dhe pastaj të gjitha këto aspekte të arsyetoheshin në tërësinë e kësaj ngjarje. Meqë, siç del nga shkresat e lëndës në këtë çështje penale nuk del të jetë kontestuese pasoja e veprës penale, por kontestuese dalin të jenë mënyra dhe rrethanat se si veproi i dënuari D.L.
8. Sipas këndvështrimit të Gjykatës Supreme të Kosovës aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën më të madhe të tij përmban përshkrim të provave të administruara dhe fare pak analizë të provave të administruara dhe veçanërisht përkitazi me ekspertizat e përpiluara nga ana e ekspertëve të psikiatrisë forenzike dhe të cilat ekspertiza i kombinon dhe me një fjali arsyetim e përmbyllë këtë çështje që del të jetë vendimtare në këtë çështje penale.

9. Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj nuk ka dhënë arsytim përkitazi me disa fakte vendimtare përkitazi me armët e përdorura në ditën kritike edhe përkundër faktit se gjatë procedurës hetimore dhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore janë bërë ekspertizat përkatëse balistike dhe janë dëgjuar ekspertët përkatës, megjithatë nuk është dhënë arsytim sipas dispozitave ligjore dhe i plotë përkitazi me këto prova të administruara. Bazuar në shkresat e lëndës del se nuk është kontestuese se në ditën kritike janë përdorur së paku dy armë dhe atë një pistoletë Firestar-model M-43, e kalibrit 9x19 mm., me numër serik 2857 dhe nga e cila pistoletë është konstatuar se janë shkrepuar dy predha e në bazë të gëzhjave të gjetura në vendin e ngjarjes janë të evidentuara me numrat: 10/1 dhe 13, dhe një pistoletë Glock-model 17, e kalibrit 9x19, me numër serik në kornizë G58793 (e përdorur nga i dënuari D.L.) nga e cila ishin shkrepuar gjashtë predha e në bazë të gëzhjave të gjetura në vendin e ngjarjes janë evidentuar me numrat: 5, 8, 12, 16, 17, dhe 22, e gjithashtu në vendin e ngjarjes janë gjetur edhe dy predha të evidentuara si dëshmitë 18 dhe 21, por të cilat nuk kanë pasur karakteristika të mjaftueshme individuale për identifikim pozitiv se nga cila armë janë gjuajtur, por me probabilitet se ishin shkrepuar nga arma Glock-17.
10. Megjithatë ekspertizat në fjalë nuk janë arsyetuar mjaftueshëm dhe nuk janë bashkë dyzuar me provat e tjera të cilat janë administruar dhe atë: së pari me raportin e ekspertimit AKF2016-0089, me ç'rast tek tani i ndjeri B.R. përkatësisht në dorën e djathtë të tij e evidentuar si dëshmia #1 dhe #2 janë evidentuar prani të nitriteve dhe nitrateve të cilat janë të pranishme edhe te mbetjet e qitjes me armë të zjarrit me prejardhje nga barutet, kurse në mostrat e evidentuara si dëshmitë #3 dhe #4 të marra nga i ndjeri tjetër R.R. nuk është evidentuar prani e nitriteve dhe nitrateve. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj në mënyrë tepër sipërfaqësore i qaset kësaj prove e cila provë është e rëndësishme të vërtetohet se si ka ardhur deri tek prezenca e grimcave barotike tek i ndjeri B.R. dhe kjo veçanërisht duke e ndërlidhur me faktin se bazuar në shkresat e lëndës del se pistoletë Firestar-model M-43, e kalibrit 9x19 mm., me numër serik 2857 është gjetur pikërisht në vendin e ngjarjes dhe se në kafkën e kësaj arme ishin evidentuar gjurmë të gjakut të tani të dënuarit S.L. Nga përshkrimi i mësipërm sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës del se kanë mbetur të pashtjelluara dhe të pa arsyetuara faktet e potencuar, dhe për më tepër, të cilat fakte janë vendimtare për shtjellimin e kësaj çështje penale, posaçërisht sa i përket të dënuarit S.L. Për më tepër, këto prova materiale duhet të ishin ndërlidhur me dëshmitë e dëshmitarëve të

dëgjuar me fokus të vlerësimit të raporteve personale dhe familjare të dëshmitarëve me tani të ndjerët dhe të dënuarit, pastaj po ashtu provat e sipër cekura të analizohen dhe vlerësohen në ndërlidhje me video incizimin në të cilën shihet i dënuari S.L. duke shkuar dhe duke u larguar në vendin e ngjarjes për të cilin nuk flitet fare në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë tani më të anuluar.

11. Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPPK-së, të cilat shkelje nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë e cila përmes një shablloni standard të krijuar anashkalon në tërësi pretendimet ankimore të paraqitura nga ana e mbrojtësve të të dënuarve përkitazi me tërësinë e provave të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë në mënyrë tepër sipërfaqësore ka trajtuar pretendimet ankimore dhe me një arsyetim të zbehtë nuk ka paraqitur arsyetim bindës për çështjet kontestuese të cekura më lartë, përtej kësaj është shqetësues qasja e kësaj gjykate në raport me seriozitetin e rastit e që kjo më së miri shihet se në këtë aktgjykim përveç që evidentohen mospërputhje të natyrës juridike evidentohen edhe shpërputhje të natyrës logjike dhe të përcjella me një sërë gabimesh të natyrës teknike. Për më tepër, shkeljet e theksuara më lart nga ana e dy instancave më të ulëta gjyqësore e vënë në dyshim edhe gjendjen faktike pasi që nuk është vërtetuar saktësia e fakteve vendimtare dhe të cilat nuk janë në harmoni me provat e administruara, me ç'rast janë interpretuar në mënyrë të gabuar, nga këto arsye, kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë dalin se janë të bazuara, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjyqimeve të kundërshtuara dhe shqyrtim të serishëm të kësaj çështje.

Udhëzimet me rastin e rigjyimit të çështjes

1. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të administroj provat ekzistuese e sipas nevojës edhe prova tjera e pas kësaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike. Në rend të parë duhet të eliminoj paqartësitë e zhvillimit të ngjarjes, përkatësisht të vërtetoj hollësisht dhe saktësisht mënyrën e veprimit të të dënuarve, përkatësisht të sqarohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë forma e veprimit të tyre, të analizohet në hollësi e tërë dinamika e ngjarjes në mënyrë

kronologjike prej asaj se çka i kishte paraprirë ngjarjes kritike e deri te përfundimi i saj dhe posaçërisht të sqarohet veprimi i të dënuarit D.L. dhe mënyra e veprimit të tij, se veprimi i tij a ishte si pasojë e tronditjes së fortë mendore apo jo, përkatësisht se a kishte ardhur në atë pozitë për të kryer vrasjet pa fajin e tij apo jo, të sqarohen eventualisht veprimet e tani të ndjerëve lidhur me këto rrethana dhe tutje në bazë të veprimeve eventuale të të ndjerëve, nëse kanë ndodhur të kalohet në stadin e përcaktimit të intensiteti i sulmit, keqtrajtimit apo fyerjes së rëndë e pas vërtetimit të këtyre rrethanave faktike të vazhdohet me shtjellimin e aspektit mjekësor përkatësisht të vërtetimit të gjendjes emocionale afektit mendor dhe veprimi i tij a ishte bërë nën këtë gjendje apo jo. Për këtë aspekt duhet që edhe një herë të analizohen ekspertizat që gjenden në shkresat e lëndës dhe pas kësaj eventualisht të dëgjohen ekspertët dhe pastaj të shikohet nevoja për ekspertë të tjera dhe pas kësaj të vepohet brenda kompetencës së gjykatës që të ekspertizat të i çmoj si të besueshme apo jo dhe në bazë të tyre dhe provave tjera të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

2. Të qartësohet fakti i pakontestueshëm se si u gjenden gjurmët barotike në duart e të ndjerit B.R. dhe gjaku i të dënuarit S.L. në kafkën e revoles Firestar-model M-43, e kalibrit 9x19 mm., me numër serik 2857 dhe atë sipas provave që gjenden në shkresave të lëndës apo eventualisht të përcaktohen edhe ekspertë të tjerë të lëmive përkatëse dhe që këto prova të ndërlidhen me provat e tjera e në veçanti me dëshmitë e dëshmitarëve që ishin në vendin e ngjarjes dhe video incizimin në të cilën shihet shkuarja dhe kthimi i të dënuarit S.L. në vendin e ngjarjes, meqë të gjitha këto çështje del se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, nuk rezulton se janë qartësuar dhe arsyetuar mjaftueshëm.
3. Nga sa u parashtrua më lartë del se pretendimet e theksuara në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë ishin të bazuara, andaj Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.481/2023, i datës 25.09.2023

”Ky rast është i rëndësishëm për faktin se gjykata e shkallës së dytë kishte ashpërsuar dënimin të pandehurve edhe pse nuk kishte pretendime në ankesën e paraqitur nga ana e prokurorit të shtetit. GJSK ka kthyer dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.78/2023 e datës 09.03.2023, të dënuarit S.H., V.V. dhe A.M., i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhje me nenin 31 të KPRK-së, dhe i ka gjykuar secilin me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 8 (tetë) muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej nga 5000 (pesëmijë) €, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 15.09.2022 deri me datë 21.02.2023. Të dënuarit janë obliguar në pagesën e shumës prej 50 €, në emër të paushallit gjyqësor, dhe shumën prej 50 €, në emër të kompensimit të viktimave të krimit. Është urdhëruar konfiskimi i përhershëm i substancave narkotike të llojit mariuhanë me peshë prej 16.989,6 gr, substancës narkotike të llojit kokainë me peshë prej 94,7 gr., dy peshore digjitale dhe një makinë për mbylljen e qeseve, vetura e markës “A..”, ngjyrë hiri me targa të regjistrimit ..-...-..., para të gatshme në shumë prej 650 €, dhe pesë telefona mobil.
1. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.235/2023 e datës 19.05.2023, ka aprovua pjesërisht si të bazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë vetëm përkritazi me vendimin për dënim në atë mënyrë që të dënuarit S.H., V.V. dhe A.M. i ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga 3 (tri) vite, kurse dënimin me gjobë e ka marrë si të vërtetuar. Pjesërisht ka aprovuar ankesat e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe mbrojtësve të të dënuarve S.H. dhe A.M. dhe

ka anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për vendimin për konfiskim të veturës së markës “A..”, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..-...-., dhe dy telefonave L. 13 pro max dhe një telefoni L. 6 dhe çështja është kthyer në rigjykim. Janë refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të dënuarve lidhur me sanksionin penal, kurse pjesët e tjera të aktgjykimit kanë mbetur të pandryshuara.

2. Kundër këtyre aktgjyqimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit S.M., avokati M.B. nga P., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimin e kundërshtuar të e ndryshon dhe të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë apo të anulohet aktgjykimin e kundërshtuar dhe lënda të kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë;

- mbrojtësi i të dënuarit V.V., avokati F.L. nga P., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimin e kundërshtuar të e ndryshon dhe të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë apo të anulohet aktgjykimin e kundërshtuar dhe lënda të kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë;

- mbrojtësi i të dënuarit A.M. avokati K.F. nga P., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë të e ndryshon dhe të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

3. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.291/2023 e datës 19.09.2023, ka propozuar që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohen si të pabazuara.

4. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit S.H. thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka tejkaluar pretendimet ankimore të paraqitura nga ana e Prokurorisë Themelore

në Prishtinë, meqë me rastin e shqyrtimit të ankesës ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPP-së. Për më tepër, pretendohet se ankesa e parashtruar nga ana e prokurorisë përveç faktit që në hyrje të saj thekson bazën e ankesë për shkak të vendimit për sanksionin penal nuk është potencuar ndonjë rrethanë rënduese që do të kishte ndikim në ashpërsimin e dënimit, ashtu që gjykata e shkallës së dytë nuk ka mundur të bëjë ndryshimin e vendimit për dënimin e shqiptuar dhe me këtë është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit.

5. Mbrojtësi i të dënuarit V.V., gjithashtu ka paraqitur pretendime përkitazi me shkeljen e ligjit penal duke potencuar faktin se gjykata e shkallës së dytë duke vepruar sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë gabimisht ka bërë ndryshimin e vendimit për dënim pasi që ankesa e prokurorisë nuk kishte të bënte me vendimin për dënim dhe atë duke u bazuar në përmbajtjen e ankesës nuk janë paraqitur pretendime për vendimin për dënim por pretendime për vendimin për konfiskimin e veturës. Kurse nga përmbajtja e ankesës del se prokuroria nuk ka paraqitur asnjë rrethanë me ndikim që do të ndikonte në ashpërsimin e dënimit, megjithatë gjykata e shkallës së dytë ka bërë ndryshimin e dënimit duke ashpërsuar dënimin e shqiptuar, përkundër faktit që në aktgjykimin e saj ka konstatuar se nuk ka rrethana të reja rënduese.
6. Pretendime të ngjashme janë paraqitur edhe nga ana e mbrojtësit të të dënuarit A.M. duke theksuar faktin se gjykata e shkallës së dytë pas ankesës së prokurorisë dhe përkundër faktit se nuk ishte paraqitur ndonjë rrethanë rënduese që do të ndikonte në ashpërsimin e dënimit, megjithatë gjykata e shkallës së dytë ka bërë ndryshimin e vendimit për dënimin e shqiptuar duke ashpërsuar dënimin.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesa, gjeti se:

- kërkesat janë të bazuara.

2. Duke shqyrtuar pretendimet konkrete të paraqitura në kërkesat e mbrojtësve të të dënuarve se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 385 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 394 par.1 të KPP-së, sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë të bazuara, meqë gjykata e shkallës së dytë me rastin e shqiptimit të ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të ankesës, me ç'rast si rezultat i aprovimit të ankesës është bërë ndryshimi i vendimit për dënim në atë mënyrë që është ashpërsuar dënimi i shqiptuar në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përkitazi me ashpërsimin e dënimit është bërë në aplikim të gabuar të ligjit penal nga neni 385 par.1 nënpar.1.5 të KPP-së, meqë bazuar në shkresat e lëndës dhe posaçërisht nga ankesa e paraqitur nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë del se përveç faktit se në hyrje të ankesë është theksuar baza ankimore - për shkak të vendimit për sanksionin penal, por në fakt nga përmbajtja e ankesës del se bëhet fjalë për vetëm për konfiskimin e sendeve dhe nuk është theksuar as edhe një pretendim i vetëm përkitazi me vendimin për dënim, dhe për më tepër, nuk është propozuar fare ashpërsimi i dënimit. Nga kjo del se vendimi i gjykatës së shkallës së dytë për ashpërsimin e dënimit del të jetë vlerësuar përtej kufijve të ankesës së parashtruar dhe atë në dëm të të dënuarve.

4. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.659/2023, i datës 27.12.2023

”Me këtë rast në mënyrë arbitrare janë çmuar si rrethana rënduese fakte të pakonfirmuara lidhur me dënimet e të dënuarit dhe të cilat nuk kanë referencë të qartë fillimisht se a janë vendime të formës së prerë dhe pastaj se për çfarë natyre të lëndëve bëhet fjalë. Përtej kësaj si rrethanë rënduese është çmuar edhe elementi i veprës penale për të cilin i dënuari është shpallur fajtor dhe është dënuar“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm P.nr.411/2023 të datës 10.07.2023, i dënuari I.H., është shpallur fajtor për veprën penale mos përfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditëve, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 23.05.2023. I dënuari është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 € dhe në fondin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 €, kurse e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1094/2023 e datës 05.10.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit, avokate B.D., nga Gj., për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështje të kthehet në rigjykim.
4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.385/2023 e datës 20.12.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

5. Në kërkesë, mbrojtësja e të dënuarit pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë të përfshirë me shkelje të ligjit penal, përkatësisht dispozitave të nenit 69 par.3 të KPP-së, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin meqë dënimi i shqiptuar janë vlerësuar më pak rrethanat lehtësuese karshi rrethanave rënduese. Për më tepër, pretendohet se në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë si rrethanë rënduese është marrë fakti se nga e kaluara kriminale e tij rezulton se nuk është hera e parë që ka kryer vepra penale të dhunës në familje edhe pse ky konstatim nuk është arsyetuar përmes evidencës penale që do të dëshmonte se i dënuari ka kryer vepra penale të njëjta apo të ngjashme dhe as që është cekur ndonjë numri i lëndës apo ndonjë vendim i formës së prerë.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar për arsyet si në vijim:
2. Aktgjykimi i shkallës së parë bazuar në referatin e paraqitura nga mbrojtësja e të dënuarit, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.7 të KPP-së, meqë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 369 par.8 të KPP-së e cila ka përcaktuar se: *“Kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit”*.
3. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ka çmuar si rrethanë rënduese fakte të pakonfirmuara lidhur me dënimet e të dënuarit dhe të cilat nuk kanë referencë të qartë fillimisht se a janë vendime të formës së prerë dhe pastaj se për çfarë natyre të lëndëve bëhet fjalë. Përtej kësaj si rrethanë rënduese është çmuar edhe elementi i veprës penale për të cilin i dënuari është shpallur fajtor dhe është dënuar, meqë si rrethanë rënduese është potencuar fakti se i dënuari nuk ka respektuar vendimin gjyqësor edhe pse është element i veprës penale mos

përfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, ashtu që me këtë rrethanë rënduese gjykata e shkallës së parë ka dyfishuar rrethanat rënduese në dëm të të dënuarit.

4. Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të marr një vendim të drejt dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.
5. Nga këto arsye, kjo gjykatë konform neni 438 par.1 pika 1.2 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.16/2024, i datës 16.01.2024

"Ky rast është i rëndësishëm për faktin se ekspertiza mjeko ligjore është përpiluar pa dokumentacion përkatës mjekësor, por vetëm në bazë zë fotografisë së të dëmtuarës, dhe për më tepër kjo fotografi nuk ka datë se kur është bërë dhe as të dhëna tjera.

E rëndësishme është që gjykata ka gabuar kur ka marrë si të besueshme ekspertizën e ekspertit e cila është përpiluar pa dokumentacion mjekësor".

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, me aktgjykimin P.nr.174/2022 e datës 20.02.2023, të dënuarin A.J., e ka shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 50 €, në emër të paushallit gjyqësor, dhe shumën prej 20 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.526/2023 e datës 18.09.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Sh.S., nga L., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulon dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.07/2024 e datës 10.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
5. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara përbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase gjykata e shkallës së parë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 14.12.2022 ka marrë aktvendim për thirrjen e ekspertit mjeko ligjor Dr. F.B. përkitazi me ekspertizën e përpiluar nga ana e tij, mirëpo i cili veprim procedural nuk është ndërmarrë dhe eksperti mjeko-ligjor nuk është dëgjuar në cilësi të ekspertit përkitazi me ekspertizën e tij. Pretendohet se dëgjimi i këtij eksperti është i rëndësishëm me qëllim të dhënies së sqarimeve shtesë dhe me këtë do të i mundësohej sfidimi i kësaj ekspertize nga ana e mbrojtjes, kjo për faktin se ekspertiza në fjalë është provë e papranueshme, meqë është nxjerrë pa dokumentacion mjekësor me të cilën do të vërtetohej se pala e dëmtuar ka kërkuar tretman mjekësor. Për më tepër, theksohet fakti se ekspertiza mjeko-ligjore me rastin e përcaktimit të llojit dhe pasojave të lëndimit trupor bazohet në shikimin e fotografive të të dëmtuarës, kurse fotografitë nuk përbajnë datë se kur janë bërë dhe po ashtu duhet të sqarohet eksperti mjeko-ligjor se si ka ardhur deri te mendimi i tij përkitazi me lëndimet trupore të të dëmtuarës vetëm mbi bazën e fotografive dhe pa dokumentacion mjekësor.
6. Pretendohet se gjykata e shkallës së parë shkelje të dispozitave të procedurës penale ka bërë edhe me rastin e mos dëgjimit të dëshmitarëve të propozuar nga ana e të dënuarit dhe me këtë rast ka bërë interpretim të gabuar të dispozitës ligjore, meqë dispozita e nenit 127 të KPP-së, ka paraparë lirin e dëshmitarëve nga dëgjimi i tyre në rast të afërsisë së tyre me të dënuarin dhe jo me palën e dëmtuar siç gabimisht është konstatuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë.
7. Në vijim të kërkesës janë paraqitur pretendime përkitazi me shkeljen e ligjit penal, përkatësisht lidhur me faktin se i dënuari është shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i lehtë trupore nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, pra se në vazhdimësi ka kryer veprën penale dhe e cila nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme, pos një fotografie të të dëmtuarës dhe ekspertizës mjeko-ligjore duke u bazuar në këtë fotografi dhe deklarimin e palës së dëmtuar.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të bazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet në kërkesë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitivave të procedurës penale sipas dispozitës së nenit 384 par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPP-së, meqë gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin të saj nuk ka paraqitur arsyetim me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarit.
3. Sipas pikëpamjes së Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur arsyetim të plotë, por në aktgjykimin e saj vetëm është bërë përshkrimi i mbrojtjes së të dënuarit dhe dëshmisë së dëshmitares- të dëmtuarës pa vlerësuar fare besueshmërinë e deklarimeve të tyre. Për më tepër, nuk është paraqitur arsyetim përkitazi me mos dëgjimin e ekspertit mjeko-ligjor, përkundër faktit se bazuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 14.12.2022 i njëjti ishte planifikuar të dëgjohet në shqyrtimin e datës 19.01.2023, mirëpo në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk është dhënë arsyetim se pse nuk u dëgjua eksperti në shqyrtimet gjyqësore në vijim të këtij procesi dhe me këtë të i mundësohej edhe palës tjetër përkatësisht mbrojtjes së të dënuarit të parashtrroj pyetje përkitazi me rrethanën se si ka ardhur eksperti deri tek përfundimi lidhur me ekspertizën mjeko-ligjore përkitazi me natyrën dhe llojin e lëndimeve trupore të pësuar nga ana e të dëmtuarës dhe posaçërisht faktin se ekspertizën e tij e ka mbështetur duke u bazuar vetëm në fotografitë e të dëmtuarës dhe pa dokumentacion tjetër mjekësor, pretendime këto të theksuara në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

4. Në këtë aspekt i rëndësishëm është edhe fakti se nuk është i njohur burimi e as data e fotografisë së të dëmtuarës dhe kjo duke u bazuar në shkresat e lëndës del se vepra penale pretendohet se është kryer me datë 17.11.2022, e dëmtuara rastin e ka paraqitur me datë 08.02.2022, kurse fotografitë përkitazi me lëndimet trupore i ka prezantuar gjatë marrjes në pyetje në polici, gjegjësisht me datë 21.08.2022 e që të gjitha këto aspekte nuk janë shqyrtuar dhe arsyetuar mjaftueshëm me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu mos dëgjimi i dëshmitarëve H.H. dhe F.H., del të jetë bërë në interpretim të gabuar të dispozitave të procedurës penale, meqë dispozita e nenit 127 të KPP-së ka përcaktuar lirimim e dëshmitarëve nga detyrimi për të mos dëshmuar në raport me të pandehurin dhe jo të dëmtuarën dhe kjo duke pasur parasysh se dëshmitarët dhe i dënuari nuk kanë lidhje për të cilat do të mund të liroheshin nga detyrimi për të dëshmuar në këtë çështje penale.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsyetim përkitazi me faktin se cilat ishin veprimet konkrete të të dënuarit në vazhdimësi, përveç se në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është potencuar fjala në vazhdimësi dhe i dënuari është shpallur fajtor për veprën penale të kryer në vazhdim, megjithatë përshkrimi i veprimeve të të dënuarit përqendrohet vetëm në përshkrimin e veprimeve të tij gjatë datës 17.11.2021, pra nuk ka përshkrim të veprimeve të të dënuarit në vazhdimësi (siç potencohet në përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit) që do të mund të cilësonin veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së. Për më tepër, neni 77 i KPRK-së ka përcaktuar kushte të posaçme për tu trajtuar një vepër penale në vazhdim, mirëpo për këtë aspekt nuk është dhënë arsyetim nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe kjo mënyrë e përshkrimit të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë paraqet një disharmoni mes përshkrimit të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit dhe është në kundërshtim me shkresat e lëndës, meqë në shkresat e lëndës del se i dënuari veprimin inkriminues e ka kryer vetëm me datën e përshkruar kurse veprimi i tij përshkruhet si vazhdimësi. Përtej kësaj, gjykata e shkallës së parë duhet pasur parasysh faktin se veprat penale kundër jetës dhe trupit nuk është e mundur të kryhen në vazhdim, meqë çdo cenim i integritetit trupor paraqet vepër të posaçme penale, andaj edhe cilësimi juridik se vepra penale është kryer në vazhdim bie ndesh me natyrën e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor.

6. Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPP-së, të cilat shkelje nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë. Për më tepër, shkeljet e theksuara më lart e vënë në dyshim edhe gjendjen faktike pasi që nuk është vërtetuar saktësia e fakteve vendimtare dhe nga kjo arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjyqimeve të kundërshtuara dhe shqyrtim të serishëm të kësaj çështje.

7. Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të administroj provat ekzistuese e sipas nevojës edhe prova tjera e pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

8. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 438 par. 1 pika 1.2 të KPPK -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.37/2024, i datës 30.01.2024

” Ky rast është i rëndësishëm për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit kishte marrë si rrethanë rënduese faktin se të dhënat nga e kaluara penale e të dënuarit dhe duke vlerësuar si rrethanë rënduese faktin se i dënuari në dymbëdhjetë raste ka qenë i dyshuar.

Rrethana rënduese duhet të vërtetohet përmes vendimeve të formës së prerë dhe jo për rastet kur i pandehuri është i dyshuar meqë ende nuk dihet epilogu i këtyre rasteve“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.57/2019 e datës 25.04.2023, të dënuarin A.Gj. e ka shpallur fajtor për veprën penale fajdeja nga neni 343 par.2 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 3000 (tremijë) €, kurse në dënimin e shqiptuar i ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 24.08.2016 deri më datë 14.04.2017. Të dënuarit i është konfiskuar shuma prej 11.700 €, si dhe është obliguar në pagesën e shumës prej 200 €, në emër të shpenzimeve të procedurës penale, shumës prej 150 €, në emër të paushallit gjyqësor, dhe shumës prej 30 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit. Kurse palës së dëmtuar është obliguar për kompensimin e dëmit në shumë prej 24.700 €.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.442/2023 e datës 11.10.2023, ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit vetëm përkitazi me konfiskimin dhe detyrimin për kompensimin e të dëmtuarit në atë mënyrë që vlera e konfiskimit në shumë prej 11.700 € i është kthyer të dëmtuarit M.J, ndërsa për pjesën e mbetur në shumë prej 13.700 € i dënuari është obliguar që të i paguajë të dëmtuarit R.J. Pjesa tjetër e aktgjykimit ka mbetur e pandryshuar.

3. Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë të përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë, kanë paraqitur mbrojtësit e të dënuarit, avokatët A.D. dhe G.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulon dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.19/2024 e datës 23.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
5. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se aktgjykimet e kundërshtuara janë të pakuptueshëm, kundërtë në brendinë e tyre dhe arsyet e dhëna dhe janë evidente kundërshtimet mes arsyetimit të paraqitur dhe përmbajtës së shkresave të lëndës, procesverbaleve dhe deklarimeve të dhëna nga palët gjatë procedurës penale.
6. Posaçërisht potencohet fakti se aktgjykimet e gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore janë të përfshira me shkelje esencial të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.10 lidhur me par.2 nënpar.2.5 dhe 2.7 lidhur me nenin 369 par.6 të KPP-së, pasi që gjykata e shkallës së parë si rrethana rënduese ka marrë për bazë të kaluarën kriminale të të dënuarit ku rezultoi se në dymbëdhjetë raste ka qenë i dyshuar, kurse në dy raste janë ngritur aktakuza e të cilat rrethana nuk mund të konsiderohen rrethana rënduese për faktin se nuk dihet epilogu i tyre. Kjo shkelje pretendohet se është bërë edhe nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, meqë përkundër faktit se kundër aktgjykimet të gjykatës së shkallës së parë mbrojtësi i të dënuarit ka paraqitur ankesë edhe përkritazi me vendimin për sanksionin penal, gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj nuk ka theksuar as edhe një fjali të vetme për arsyen e refuzimit të pretendimeve ankimore përkritazi me këtë pretendim. Për më tepër, gjykata e shkallës së dytë edhe sipas detyrës zyrtare do të duhej të bënte vlerësimin e dënimit të shqiptuar

nga ana e gjykatës së shkallës së parë e të cilat shkelje pretendohet se imponojnë anulimin e aktgjykimeve të kundërshtuara.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësve të të dënuarit janë të bazuara, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, përmban shkelje për të cilat pretendohet në kërkesë dhe aktgjykimet e kundërshtuara të dy instancave më të ulëta gjyqësore janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas dispozitës së nenit 384 par.1 nënpar.1.10 dhe par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.6 të KPPK-së, meqë fillimisht gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykitimit të saj ka paraqitur si rrethana rënduese të dhënat nga e kaluara penale e të dënuarit dhe duke vlerësuar si rrethanë rënduese faktin se i dënuari në dymbëdhjetë raste ka qenë i dyshuar, ndonëse nuk dihet ende epilogu final i këtyre rasteve. Kurse gjykata e shkallës së dytë gjatë procedurës ankimore, gjithashtu nuk ka shqyrtuar pretendimet e ngritura përkitazi me vendimin për dënimin e shqiptuar dhe me këtë rast në tërësi ka anashkaluar pretendimet ankimore, përkatësisht nuk ka paraqitur arsyetim përkitazi me pretendimet për vendimin për dënimin e shqiptuar, pretendime këto të theksuara në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.
3. Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë del se është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.10 dhe par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.6 të KPP-së dhe nga kjo arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjykitimit të kundërshtuar dhe shqyrtim të serishëm të kësaj çështje në gjykatën e shkallës së dytë.

4. Në rigjykim gjykata e shkallës së dytë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të vlerësoj të gjitha pretendimet ankimore të theksuar në ankesë e pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

5. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPP -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.57/2024, i datës 06.02.2024

”Ky rast është i rëndësishëm për faktin se nuk është dorëzuar aktgjykimi të pandehurit në gjuhën e tij amtare dhe është cenuar e drejta e tij në përdorimin e gjuhës“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.68/2021 e datës 15.02.2023, të dënuarin N. N. e ka shpallur fajtor për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej ... I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej ... €, në emër të shpenzimeve të procedurës penale, shumës prej ... €, në emër të paushallit gjyqësor, dhe shumës prej ... €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimet. Kurse palës së dëmtuar është obliguar që në emër të kërkesës pasurore juridike të i paguajë shumën prej ... €.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.406/2023 e datës 06.11.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit N. N., avokati Y.H. nga Gj., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulon dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.31/2024 e datës 31.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar.

5. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk i është dorëzuar të dënuarit në gjuhën serbe, përkatësisht i përkthyer në gjuhën e tij amtare të cilën e flet.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pa shqyrtuar pretendimet tjera të theksuara në kërkesë del se pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit është i bazuar, ngase bazuar në pretendimin e paraqitur, por edhe shkresat e lëndës del se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk i është dorëzuar në gjuhën serbe të dënuarit, me ç'rast është shkelur e drejta e tij e që rezulton të jetë shkelje e përcaktuar me dispozitën e nenit 384 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 14 par.8 të KPP-së, pretendime këto të theksuara në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.
3. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së dytë nuk ka vepruar në harmoni me dispozitën e nenit 14 par.8 të KPP-së, me ç'rast është përcaktuar se: *“Të pandehurit dhe personit i cili është në vuajtje të dënimit i cili nuk e kupton gjuhën e procedurës duhet siguruar, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, përkthimin e thirrjeve gjyqësore, vendimeve dhe parashtresave, në tërësi ose pjesërisht, varësisht nga fakti nëse ato janë relevante për qëllimin e mundësisht të të pandehurit ose personit që është në vuajtje të dënimit të ketë njohuri të rastit kundër tij, në gjuhën të cilën ai e përdor në procedurë, ose dokumenteve të tjera të cilat janë thelbësore për të siguruar që ai të jetë në gjendje të ushtrijë të drejtën e tij të mbrojtjes dhe të sigurohet paanshmëria e procedurave. Dokumentet thelbësore përfshijnë çdo vendim i cili e privon personin nga liria, çdo aktakuzë dhe çdo aktgjykim.”* Andaj, nga interpretimi i dispozitës së lartë cekur dhe shkresat e lëndës del se të dënuarit aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk i është dorëzuar në gjuhën e tij amtare dhe nga kjo arsye, kërkesa

për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për kthimin e çështjes me qëllim dorëzimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë të përkthyer në gjuhën e të dënuarit, përkatësisht në gjuhën serbe, meqë me këtë rast përveç cenimit të dispozitave të lartë cekura del se janë cenuar edhe e drejta e garantuar e përdorimit të gjuhës sipas nenit 30 par.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 par.3 nënpar.”e” të KELDNJ.

4. Nga këto arsye kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në këtë pjesë u aprovua dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me vërejtje se duhet të eliminohen shkeljet e cekura dhe gjykata e shkallës së dytë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna.
5. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPP -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.173/2024, i datës 26.03.2024

”Në këtë rast është interpretuar në mënyrë të gabuar ligji penal gjegjësisht vepra penale keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi nga neni 238 par.2 të KPRK-së. Pasi që nuk është bërë analizë e qëllimit të të pandehurit për të kryer këtë vepër penale“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për të Mitur, me aktgjykimin PM.nr.166/2021 e datës 10.05.2022, të pandehurin R.Q., e ka shpallur fajtor për veprën penale keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi nga neni 238 par.2 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 04.07.2017 deri me datë 04.08.2017. I pandehuri është obliguar në pagesën e shumës prej 100 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 50 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për të Mitur, me aktgjykimin PAKR.nr.410/2022 e datës 30.01.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit R.Q., avokati G.H. nga G., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe i pandehuri të lirohet nga akuza ose aktgjykimet të anulohen dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.
4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.99/2024 e datës 18.03.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

5. Në kërkesën e mbrojtësit të të *pandehurit* pretendohet se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë nuk kanë bërë në mënyrë të duhur dhe të qartë vlerësimin e provave të palëve në procedurë dhe përmes të cilave do të vërtetohej se në veprimet e të dënuarit a janë formësuar apo jo elementet qenësore të veprës penale që i vihet në barrë, sikurse ka përcaktuar dispozita ligjore, gjegjësisht i dënuari përmes veprimit apo mosveprimit të tij a e ka cenuar vlerën e mbrojtur, përkatësisht i dënuari a është përfshirë në kryerjen e kësaj vepre penale.
6. Pretendohet se me rastin e vlerësimit të provave gjegjësisht për të vërtetuar ekzistimin e elementet e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor do të duhej që në mënyrë të saktë të vërtetoheshin provat kundërtënëse dhe përmes tyre të vihej në përfundim se cilat prova konkrete kanë vërtetuar ekzistimin e veprës penale. Kjo për faktin se vet e dëmtuara gjatë deklarimit të saj ka theksuar faktin se asnjëherë nuk ka komunikuar me të dënuarin dhe e vërtetuar edhe përmes ekspertizës së telefonit të të dënuarit ku vërtetohet fakti se mes tyre nuk kishte kontakte telefonike dhe të cilat prova nuk janë marrë parasysh, meqë po të vlerësoheshin në mënyrë të drejtë atëherë i dënuari do të duhej të lirohej nga akuza.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

1. Edhe pse mbrojtësi në kërkesë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk evidentohen shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, por se bazuar në provat e administruara në këtë çështje gabimisht është zbatuar ligji penal kur i dënuari është shpall fajtor për veprën penale keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi nga neni 238 par.2 të KPRK-së. Pra, provat e administruara janë interpretuar në mënyrë të gabueshme dhe janë nxjerr konkludime të gabuara, dhe atë në dëm të të dënuarit, andaj, kjo rrjedhimisht e bën të mundur ndryshimin e aktgjykimeve të dy instancave më të

ulëta gjyqësore duke e vendosur këtë çështje në mënyrë meritore. Për më tepër, duke marrë parasysh faktin se kjo çështje njëherë ishte kthyer në rivendosje nga ana e gjykatës së shkallës së dytë sipas aktvendimit PKR. nr.157/2021 të datës 27.05.2021 me udhëzime shtesë për gjykatën e shkallës së parë dhe të cilat ishin adresuar gjatë rigjyqimit të rastit, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se meqë në shqyrtimet gjyqësore të të dy instancave më të ulëta gjyqësore, janë marrë në konsideratë të gjitha provat e mundshme për vendosjen e kësaj çështje penale, andaj nuk pati pengesa që kjo gjykatë duhet t'i jap epilog kësaj çështje penale.

2. Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa e mbrojtësit të dënuarit gjen se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë në shkelje të ligjit penal nga neni 385 par.1 nën par.1.1 të KPPK-së, pasi që veprimet për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor dhe dënuar nuk përbëjnë veprë penale.
3. Gjykata e shkallës së parë të pandehurin e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale keqpërdorim i fëmijëve në pornografi nga neni 238 par.2 të KPRK-së, duke përshkruar në dispozitiv të aktgjyqimit se: “... pas pranimit të fotove nudo i njëjti i ka shpërndarë tek axha i viktimës O.M...”. Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nga përshkrimi i theksuar më lartë si dhe nga shkresat e çështjes dhe provave të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor, rezulton se në rastin konkret në veprimet e të pandehurit nuk janë realizuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në fjalë.
4. Dispozita e nenit 238 par.2 të KPRK-së, ka përcaktuar se kryerja e kësaj vepre penale kryhet në mënyrë alternative dhe atë: “Kushdo që shet, shpërndan, promovon, shfaq, transmeton, ofron ose e vënë në dispozicion pornografinë për fëmijë”. Pra, nga përshkrimi i veprës penale, fillimisht duhet të përcaktoj se cilat janë elementet e kësaj vepre penale dhe më pas të konstatoj se a janë përmbushur apo jo elementet e kërkuara. Nisur nga kjo, Gjykata Supreme e Kosovës në tërësi pajtohet me konkludimet e nxjerra nga dy instancat gjyqësore se në rastin konkret sipas asaj që ceket në dispozitivin e aktgjyqimit të shkallës së parë nuk rezultojnë të jenë kontestuese rrethanat objektive të rastit dhe atë se: i pandehuri kishte dërguar (shpërndarë) disa foto nudo të të dëmtuarës A.M. tek axha i saj O.M. dhe se e dëmtuara ishte fëmijë (e moshës 13 vjeçare, 9 muaj dhe 13 ditë). Mirëpo nga këto rrethana, del se kontestuese është rrethana subjektive,

përkatësisht fakti se dërgimi i këtyre fotove a ishte bërë me qëllim të pornografisë apo për qëllime të njoftimit të tij dhe ishte pikërisht ky aspekt që bëri dallimin mes interpretimit të bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe të cilin konstatim e kishte pranuar edhe gjykata e shkallës së dytë në njërën anë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës në anën tjetër. Nga interpretimi i normës ligjore del se veprimet e dërgimit të fotove me përmbajtje pornografike duhet të bëhen me qëllim që personit që i dërgohen të përjetoj kënaqësi seksuale përmes pamjeve të këtyre fotografive dhe në të të ekspozohen personat e kategorizuar si fëmijë. Kurse në rastin konkret nga shkresat e lëndës del se fotografitë i ishin dërguar tek axha i të dëmtuarës që nuk ka asnjë rezonim logjik se ishin dërguar për këtë qëllim, përkundrazi dërgimi i fotove ishte bërë me qëllim krejtësisht tjetër të informimit të tij dhe përmes tij edhe prindërve të të dëmtuarës për sjelljet e saja dhe në asnjë rrethanë për qëllime të pornografisë, siç gabimisht interpretojnë dy instancat më të ulëta gjyqësore.

5. Se dërgimi i fotografive nga ana e të pandehurit ishte bërë pa qëllimet e kërkuara të dispozitës ligjore del edhe duke analizuar provat e administruara dhe atë nga vet dëshmitari i cili kishte pranuar fotografitë O.M. i cili pohon faktin se "...qëllimi i të pandehurit ishte i mirë por veprimi i tij i keq...", pastaj nga vet e dëmtuara e cila mohoi kategorikisht çfarëdo komunikimi me të pandehurin dhe aq më pak dërgimin e fotove nga ana e saj, e konfirmuar edhe përmes ekzaminimit të telefonit të të pandehurit ku nuk konstatohen kontakte mes tij dhe të dëmtuarës, pa potencuar këtu edhe mbrojtjen e të pandehurit i cili që nga fillimi i procedurës penale ka theksuar qëllimin e dërgimit të fotove me qëllime të parandalimit të sjelljes së të dëmtuarës dhe në asnjë rrethanë për qëllime të tjera.
6. Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se dy gjykatat e instancave më të ulëta në gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, gabimisht kanë aplikuar ligjin material, gjegjësisht kanë nxjerrë konkludime të gabuara dhe ishte i drejtë pretendimi nga kërkesa se në dëm të të pandehurit është bërë shkelja e ligjit penal nga neni 385 pika 4 të KPP-së, ashtu që pretendimi u aprovua dhe u vendos që i pandehuri të lirohet nga akuza.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.179/2024, i datës 26.03.2024

"Në këtë rast në mënyrë të gabuar është aplikuar gjykimi në mungesë".

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.191/2022 të datës 16.05.2023, të dënuarin M. B. e ka shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronës, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.2 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 17.09.2020 deri me datë 10.03.2021. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 50 €, në emër të paushallit gjyqësor, dhe shumën prej 50 €, në fondin për kompensimin e viktimave të kimit, kurse i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.378/2023 e datës 21.12.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit M. B., avokati Ekrem Pira nga V., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cila kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara të i anulon dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim ose aktgjykimet të ndryshohen dhe të dënuarit të i shqiptoj dënim më të butë.

4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.104/2024 e datës 19.03.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
5. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara përbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase gjykata e shkallës së parë nuk e ka përpiluar aktgjykimin e saj në pajtim me dispozitën e nenit 369 par.4, 6 dhe 7 të KPP-së, kjo për faktin se dispozitivi i aktgjykimit nuk përmban të dhënat e nevojshme që në veprimet e të dënuarit janë formësuar elementet e figurës së veprës penale. Gjithashtu nuk janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë saktësia e provave vendimtare për të përcaktuar veprën penale dhe përgjegjësinë penale të të dënuarit. Pretendohet se arsyetim tërësisht i paqartë është paraqitur mes përbajtjes së shkresave të lëndës dhe deklarimeve të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e të dënuarit, në njërën anë dhe dëshmitarëve në anën tjetër dhe përfundimeve të nxjerra përmes këtyre deklarimeve kontradiktore.
6. Më tutje në kërkesë gjithashtu pretendohet se gjykata e shkallës së parë gjatë zhvillimit të procedurës ka shkelur dispozitat e neneve nenit 5 dhe 6 të KEDLNj dhe nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:
 - kërkesa është e bazuar.
2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të bazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, përbajnë shkelje për të dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas dispozitës së nenit 384 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 303 par.2 të KPP-së, meqë gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar dispozitat ligjore përkitazi me gjykimin në mungesë të të dënuarit.

3. Sipas pikëpamjes së Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për zbatimin e gjykimit në mungesë vetëm pjesërisht ka respektuar dispozitën ligjore të nenit 303 par.2 dhe 4 të KPP-së dhe të cilat kanë përcaktuar se: *“I akuzuari konsiderohet se heq dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor në rrethanat e mëposhtme: 2.1. kur i akuzuari ka qenë i pranishëm në seancë fillestare dhe është informuar për datën e shqyrtimit gjyqësor nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në pajtim me nenin 280 dhe 282 të këtij Kodi, apo gjatë ndonjë seance tjetër gjyqësore dhe i akuzuari është njoftuar për detyrimin për të qenë i pranishëm për gjykim dhe se gjykimi mund të vazhdojë nëse i akuzuari vullnetarisht nuk paraqitet për gjykim; ose 2.2. Ka qenë i pranishëm në gjykim, por më pas nuk është paraqitur në seancat gjyqësore pasuese dhe është informuar për datën e re të shqyrtimit kryesor në pajtim me nën-paragrafin 2.1 të këtij neni, 4. Për të vendosur nëse do të mbajë gjykimin në mungesë të të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mban seancë dëgjimore për të përcaktuar përse i akuzuari mungon dhe për të vlerësuar çdo sqarim apo dëshmi nëse i akuzuari ka vendosur vullnetarisht të mungojë në gjykim. Në veçanti, në marrjen e këtij vendimi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr parasysh nëse janë bërë përpjekje të arsyeshme për të gjetur të akuzuarin”.*
4. Duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura dhe procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 24.04.2023, me ç’rast është marrë aktvendimi për mbajtjen e gjykimit në mungesë del se vetëm pjesërisht janë plotësuar kushtet ligjore për zbatimin e gjykimit në mungesë. Duke marrë për bazë shkresat e lëndës dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë rrjedh se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë i ka përfunduar të gjitha veprimet e përcaktuara me dispozitat e neneve 172 dhe 173 të KPP-së, mirëpo për tu realizuar gjykimi në mungesë dhe në zbatim të nenit 303 par.2 dhe 4 të KPP-së është e detyrueshme që të gjitha kushtet e përcaktuara të përmbushen në mënyrë kumulative dhe atë: përcaktimi i faktit se cila ishte arsyeja e mungesës së të akuzuarit e aspektit subjektiv apo objektiv dhe gjithashtu që i akuzuari paraprakisht gjatë një seance (qoftë fillestare apo gjyqësore) që kishte marrë pjesë do të duhej të njoftohej se mungesa e tij gjatë shqyrtimeve të ardhshme gjyqësore mund të vazhdojë me gjykim në mungesë, përkatësisht shqyrtimi gjyqësor do të mbahet pa prezencën e tij. Pra, siç del nga shkresat e lëndës i akuzuari nuk ka pasur mundësi të deklarohet për arsyen e mungesës së tij dhe

gjithashtu nuk ka qenë i njoftuar se gjykimi kundër tij mund të vazhdohet pa prezencën e tij, kushte këto të domosdoshme për të zbatuar gjykimin në mungesë të përcaktuara sipas dispozitave ligjore të përshkruara më lartë.

5. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykimi në mungesë duhet parë si përjashtim dhe në dritën e faktit se mungesa e të akuzuarit cenon disa të drejta të tij të garantuara si pjesë e një procesi të rregullt gjyqësor, andaj në dritën e këtij parimi është e domosdoshme që kriteret për aplikimin e gjykimin në mungesë të plotësohen në tërësi sipas dispozitave të procedurës penale dhe po ashtu të drejtat e të akuzuarit të respektohen edhe në dritën e Kushtetutës së Kosovës dhe KEDLNJ.
6. Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 303 par.2 të KPP-së, të cilat shkelje nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe nga kjo arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjytimeve të kundërshtuara dhe shqyrtim të serishëm të kësaj çështje.
7. Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo- juridike.
8. Nga sa u parashtua më lartë e në kuptim të nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPP -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.253/2024, i datës 18.06.2024

"Në këtë rast është interpretuar në mënyrë të gabuar dashja e të pandehurve dhe dijenia e tyre për të kryer këtë veprë penale".

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.155/2022 e datës 30.09.2022, të dënuarit Xh. B. dhe B. T. i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, dhe i ka gjykuar të dënuarin Xh. B. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, kurse të dënuarit B. T. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite. Të dënuarve u është shqiptuar dënimi plotësues - ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratën publike në kohëzgjatje prej nga 2 (dy) vite i cili dënim do të ekzekutohet pas mbajtjes së dënimit me burgim nga ana e të dënuarve, janë obliguar në pagesën në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej nga 200 €, si dhe nga 50 € në fondin për kompensimin e viktimave të krimit. Kurse të dëmtuarës Ministrisë së Infrastrukturës janë obliguar në kompensimin e dëmit në mënyrë solidarë në shumë prej 29.824,18 €.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.729/2022 e datës 12.09.2023, pjesërisht ka aprovuar ankesën e mbrojtësve të të dënuarit B. T. përkritazi me vendimin për dënim duke ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në atë mënyrë që të dënuarin B. T. për veprën penale të shpallur fajtor e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, kurse ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe mbrojtësve të të dënuarve, kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit Xh. B., avokat S.M. nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarin të e liroj nga akuza ose të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;

- mbrojtësit e të dënuarit B. T. avokatët A.V. dhe F.L. nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarin ta liroj nga akuza apo të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.142/2024 e datës 26.04.2024, ka propozuar që kërkesat e mbrojtësve të të dënuarve të refuzohen si të pabazuara.
5. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit Xh. B. thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara me dispozitën e nenit 384 par.2, nënpar.2.1, 2.2 dhe 2.7 të KPP-së, ngase gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara, për më tepër, edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë se pse e konsideron të ligjshëm aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe nuk ka vlerësuar në mënyrë të duhur, të qartë dhe të kuptueshme pretendimet ankimore të paraqitura. Theksohet se aktgjykimet e kundërshtuara nuk kanë arritur që të arsyetojnë ekzistimin e veprës penale dhe se bazohen vetëm në deklarinimet e dëshmitares V. R. dhe njëkohësisht anashkalojnë në tërësi deklarinimet e dëshmitarëve tjerë dhe atë A. Zh., M. E., H. D. dhe H. M. dhe të cilët si anëtarë të komisionit për vlerësimin e ofertave të tenderit pohojnë faktin se nuk kanë pasur kurrfarë ndikimi për vlerësimin e ofertave dhe aq më pak presion apo ndërhyrje nga ana e të dënuarit. Nga kjo rrjedh se aktgjykimet mbështeten vetëm në dëshminë e dëshmitares V. R. e cila e inkriminon të dënuarin, kurse njëkohësisht deklarinimet e

dëshmitarëve A. Zh., M. E., H. D. dhe H. M. jo vetëm që nuk trajtohen por nuk merren fare parasysh.

6. Theksohet se edhe gjykata e shkallës së dytë ka vepruar në mënyrë të njejtë duke vlerësuar se ka pasur prova të mjaftueshme me të cilat është vërtetuar fajësia e të dënuarit, por se nuk sqarohen më tutje se mbi cilat prova është vërtetuar fajësia e të dënuarit, pos dëshmisë së dëshmitares V. R. pasi që prova tjera nuk ka pasur dhe në kundërshtim me të gjitha provat materiale të administruara. Kurse fakti se ka pasur një shënim në librin e protokolit të MI, kjo nuk e vërteton fajësinë e të dënuarit pasi që i njëjti ka pasur detyrën e sekretarit të përgjithshëm në këtë ministri dhe nuk ka qenë detyrë e tij mbajtja e librit të protokolit, por kjo ka qenë detyrë e arkivistes dhe e cila do të duhej që të raportonte tek drejtori i administratës në kuadër të ministrisë.
7. Në vijim të kërkesës pretendohet për faktin se as prokuroria e as gjykata nuk kanë përpiluar ekspertizë financiare apo ekspertizë nga fusha e prokurimit me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike dhe përkundër që mbrojtja ka propozuar ekspertizë të kësaj lëmie kjo është refuzuar nga ana e gjykatës pasi që ekspertiza do të shërbente në vërtetimin e drejtë dhe real të gjendjes, aq më tepër që i dënuari është shpallur fajtor për veprën penale ku theksohet se operatorit ekonomik “Famis” i është pamundësuar fitimi i tenderit si pasojë e veprimeve të të dënuarit. Kurse gjykata e shkallës së dytë thekson faktin se të dënuarit nuk akuzohen për çështje të procedurës së prokurimit e që kjo bie në tërsi në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe faktin se akuza dhe aktgjykimi kanë të bëjnë pikërisht me çështjen e prokurimit pasi që si pasojë e kësaj i është mundësuar fitimi i tenderit operatorit ekonomik me çmim më të pafavorshëm dhe atë për shumë prej 30.000 €.
8. Më tutje pretendohet se ndaj të dënuarit është shkelur ligji penal, meqë mungojnë elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe atë dashja dhe kundërligjshmëria e që kjo ndërlihet me faktin se për të u realizuar vepra penale duhet të plotësohen katër elementet dhe atë veprimi, kundërligjshmëria, përcaktueshmëria dhe fajësia dhe mungesa e njërit nga këto elemente rezulton se nuk është realizuar vepra penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor dhe është gjykuar.

9. Pretendohet se tek i dënuari nuk është vërtetuar elementi i parë përkatësisht veprimi për të kryer këtë veprë penale pasi që i njëjti ka vepruar në tërësi sipas kompetencave të tij në cilësinë sekretarit të përgjithshëm të MI dhe kompetencat i ka ushtruar konform dispozitivave të tij ligjore dhe mes kompetencave të tjera ka pasur edhe aprovimin e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e tenderëve siç ka vepruar edhe me nxjerrjen e vendimit të datës 21.06.2016 duke ndryshuar përbërjen e komisionit për vlerësimin e ofertave të kompanive ofertuese në këtë tender publik. Mirëpo i njëjti nuk ka pasur kompetenca të tjera për dhënien e kontratës operatorit përkatës pasi që këtë kompetencë e ka pasur komisioni vlerësues si dhe menaxheri i prokurimit, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret e që duhet pasur parasysh faktin se operatori i cili ka pasur çmimin më të lirë, përkatësisht operatori ekonomik "F." ishte shpallur i papërgjegjshëm për shkak të mos plotësimit të kushteve e që si rezultat i kësaj nuk kishte paraqitur as ankesë duke u pajtuar me faktin se eliminimi ishte si shkak i mos plotësimit të kushteve të tenderit për faktin se sipas dosjes së tenderit udhëheqësi i punishtes kishte qenë i angazhuar edhe në një projekt tjetër të kësaj Ministrie e që nuk ishte plotësuar kushti i përcaktuar në ofertë që udhëheqësi i punishtes të jetë vazhdimisht në punishte. Përtej kësaj, komisioni vlerësues i ofertave nuk është vendimmarrës por paraqet vetëm rekomandim për dhënien e tenderit, kurse mbetet në përgjegjësinë e zyrtarit përgjegjës të prokurimit që të pranojë apo refuzojë këtë rekomandim nga ana e komisionit dhe në asnjë rrethanë kjo nuk mund të atribuohet sekretarit të përgjithshëm të MI, por anëtarëve të komisionit dhe zyrtarit të prokurimit pasi që i njëjti nuk ka kompetencë vendimmarrëse as të karakterit këshillues dhe as rekomandues. Për më tepër veprimi i të dënuarit përkatësisht detyrimi i tij kinse për të protokolluar vendimin një muaj më herët nuk është vërtetuar me asnjë provë përveç deklarimit të dëshmitares V. R. e cila vet ka bërë protokollimin dhe është përgjegjëse për protokollimin e shkresave - vendimeve.
10. Në vijim të kërkesës pretendohet se nuk është plotësuar as elementi i dytë, përkatësisht kundërligjshmëria meqë nxjerrja e vendimit ... nuk paraqet veprim të kundërligjshëm sepse është nxjerrë në përputhje me nenin 48 të Ligjit Nr.03/L-189 në cilësinë e sekretarit të përgjithshëm duke ndryshuar anëtarin e komisionit, madje kundërligjshmëria nuk plotësohet edhe po të vëretohej se protokollimi ishte bërë një muaj më herët pasi që i dënuari nuk është përgjegjës i protokollit të shkresave në Ministri. Për më tepër, në rastin konkret përkatësisht vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari kryhet

vetëm me dashje direkte dhe kryesi duhet të jetë i vetëdijshëm për veprën e tij dhe njëkohësisht pasojën e saj e që me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk është paraqitur arsyetim përkitazi me këtë element, përveç se është theksuar fakti se dashja është vërtetuar përmes përgatitjes superiore shkollore të të dënuarve, kurse te i dënuari Xh. B. fakti se është afër gradës shkencore të doktorit të shkencave dhe fakti se ka përvojë të gjatë në menaxhimin e që kjo paraqet një arsyetim sipërfaqësor dhe absurd në praktikën gjyqësore.

11. Pretendohet se në veprimet e të dënuarit nuk janë manifestuar elementet e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, meqë bazuar në dispozitën ligjore veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale ekziston në rastet kur personi zyrtar vepron duke shfrytëzuar pozitën e vet zyrtare apo autorizimin me tejkalim të kufijve të autorizimeve të tij ose duke mos i kryer detyrat e tij zyrtare përfiton për vete apo për tjetrin dhe me këtë rast duhet theksuar faktin se ofertuesi me çmimin më të lirë në këtë rast ... “F.” ishte shpallur operator i papërgjegjshëm për shkak të mos plotësimit të kushteve të kontratës- angazhimit të mbikëqyrësit njëkohësisht në dy vend punishte dhe në këtë mënyrë fitues i tenderit është shpallur operatori tjetër ekonomik.
12. Mbrojtësit e të dënuarit B. T., avokatët A.V. dhe F.L., theksojnë se aktgjykimi i kundërshtuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka marrë parasysh udhëzimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës të dhëna në aktvendimin e saj PAKR.nr.24/2022 të datës 28.03.2022, meqë nuk ka eliminuar vërejtjet përkitazi me dëshminë e dëshmitares E. A., së pari për faktin e mos lajmërimit të kërcënimit dhe detyrimit të pretenduar nga ana e saj dhe kjo dëshmi do të duhej të vlerësohej në ndërlidhje me provat tjera të administruara. Përtej kësaj, arsyetimi i paraqitur përveç se është i mangët gjithashtu nuk është ndërlidhur me provat tjera të administruara, meqë po të bëhej një ndërlidhje e tillë, atëherë dëshmia e kësaj dëshmitare do të duhej të vlerësohej si jo e besueshme, kjo për faktin se raporti me të cilin fitues i tenderit ishte shpallur kompania “F.” fare nuk ishte dorëzuar tek tani i dënuari, për më tepër, kjo dëshmi nuk ka edhe logjikën e arsyeshme pasi që nga shkresat e lëndës del se vetëm njëra anëtare e komisionit- dëshmitarja është larguar, kurse kanë mbetur dy anëtarët e tjerë e që vota e saj në asnjë rrethanë nuk ishte votë vendimtare në përcaktimin e fituesit të tenderit.

13. Pretendohet se gjykata e shkallës së parë ka refuzuar caktimin e ekspertizës përkitazi me shkaktimin e dëmit dhe se arsyetimi i dhënë se vlera e dëmit ndërlidhet me diferencën e çmimit të fituesit të parë kompanisë “F.” dhe të kompanisë fituese së dytë “S.” është në shumë prej rreth 30.000 € dhe të cilin refuzim e kishte përkratur edhe gjykata e shkallës së dytë. Megjithatë pretendohet se i dënuari është shpallur fajtor për faktin se me veprimet e tij ka mundësuar marrjen e tenderit kompanisë “S.” edhe atë duke e detyruar dëshmitaren E. A. të tërhiqet nga komisioni dhe me këtë është mundësuar që fituese e tenderit të shpallet kompania “F.” dhe kjo tregon domosdoshmërinë e përpilimit të ekspertizës përmes së cilës do të vërtetoheshin faktet se cilës kompani do të duhej ti jepej tenderi dhe se kjo paraqet elementin esencial të kësaj çështje pasi që në këtë çështje pretendimi kryesor është për faktin se tenderin e ka fituar një kompani e cila nuk do të duhej të shpallej fituese dhe nëse kjo nuk do të ndodhte, atëherë nuk do të kishte pasoja të kësaj vepre penale e me këtë do të mungonte kundërligjshmëria dhe njëkohësisht qëllimi i të dënuarit. Njëkohësisht përpilimi i ekspertizës do të mundësonte edhe përcaktimin e saktë të lartësisë së dëmit që gjithashtu paraqet komponentë të rëndësishme në këtë çështje penale.
14. Në vijim të kërkesës pretendohet për faktin se gjykata e shkallës së parë ka tejkaluar akuzën e paraqitur nga ana e prokurorisë së shtetit për faktin se është ndryshuar përshkrimi faktik sipas aktakuzës dhe dispozitivit të aktgjykimit duke ndryshuar togfjalëshin tejkalon kompetencat, ushtron ndikim (përshkrim në aktakuzë) me fjalët ka ndërmarr veprime të kundërligjshme dhe është pajtuar me shkaktimin e pasojës (përshkrim në dispozitiv të aktgjykimit) duke bërë përshtatje me elementet e veprës penale, dhe për më tepër, duke shtuar shumë prej 29.824,18 € me çka ka obliguar të dënuarit në kompensimin e kësaj shume edhe pse kjo shumë nuk është përshkruar në aktakuzë me të cilën është rënduar pozita e të dënuarit në procedurës në favor të prokurorisë së shtetit.
15. Më tutje theksohet se si rezultat i shkeljeve procedurale janë paraqitur pretendime lidhur me shkeljen e ligjit penal duke potencuar faktin se i dënuari nuk është penalisht përgjegjës për veprën penale meqë mungon dashja direkte dhe i cili vlerësim ishte bërë nga ana e shkallës së dytë edhe me rastin e kthimit të kësaj çështje në rigjykim, me ç’rast janë paraqitur vërejtje serioze për përshkrimin e veprimeve dhe për realizimin e elementeve të veprës penale. Për më tepër, duke u referuar në përshkrimin e dispozitivit

të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë theksohet se i dënuari është pajtuar me shkaktimin e pasojës e që del se ky formulim është në kundërshtim me dashjen direkte pasi që përmes kësaj kryerësi i veprës penale shkaktimin e pasojës e dëshiron dhe jo të pajtohet me shkaktimin e saj pasi që kjo do të nënkuptonte dashje eventuale dhe për të cilën nuk duhet të përgjigjet penalisht. Gjithashtu në këtë rast mungon lidhja kauzale mes veprimit dhe pasojës së shkaktuar pasi që duke u bazuar në përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del se i dënuari kishte detyruar dëshmitaren E. A. të jep dorëheqje si kryetare e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe me këtë i është mundësuar fitimi i tenderit kompanisë “S.”, mirëpo kjo në asnjë rrethanë nuk vërtetohet duke u bazuar në faktin se komisioni ka qenë i përbërë nga tre anëtarë dhe kur të kemi parasysh faktin se rekomandimet merren me shumicë të votave e që ndërimi i një anëtari nuk përbën fuqi votuese të mjaftueshme për të ndryshuar qëndrimin e komisionit e që përveç kësaj komisioni merr rekomandim dhe jo vendim, siç gabimisht është interpretuar e që në këtë mënyrë del se ka munguar lidhja kauzale shkak-pasojë.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve janë të bazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet në kërkesa dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas dispozitës së nenit 384 par.2, nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPP-së, meqë gjykata e shkallës së parë në aktgjykimit të saj nuk ka paraqitur arsyetim me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarve.

3. Sipas pikëpamjes së Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur arsyetim të plotë dhe të qartë përkitazi me provat e administruara, por në aktgjykimin e saj vetëm është bërë përshkrimi i mbrojtjes së të dënuarve dhe dëshmisë së dëshmitarëve pa vlerësuar fare besueshmërinë e deklarimeve të tyre. Për më tepër, me rastin vlerësimit të dëshmimeve nuk ka arritur që të paraqes arsyetim për secilën provë të administruar gjegjësisht për secilin dëshmitar të dëgjuar dhe posaçërisht dëshmitarët të cilët kanë qenë pjesë e komisionit për vlerësimin e ofertave për tenderin në fjalë dhe dëshmitë e tyre janë cilësuar si të pabesueshme pa u arsyetuar se nga ishte ardhur në përfundim se këto dëshmi janë të pabesueshme.
4. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ka paraqitur arsyetim të qëndrueshëm përkitazi me dy aspekte të rëndësishme të kësaj çështje penale, së pari refuzimin për caktimin e ekspertit të prokurimit, kjo duke pasur parasysh faktin se e tërë baza e kësaj çështje ka të bëjë pikërisht me këtë fushë për të cilën njohuritë dhe ekspertiza e ekspertëve do të ndihmonte në ndriçimin e kësaj çështje penale dhe çështja e dytë përkitazi me raportin e vlerësimit të komisionit në përbërje prej E. A., H. D. dhe M. E., dhe i cili raport është përpiluar dhe nënshkruar nga anëtarët duke rekomanduar që fitues i tenderit të jetë ... “F.”, por e diskutueshme dhe nuk është sqaruar fakti se ky raport a ishte dorëzuar të dënuarit B. T. me qëllim të vazhdimit më tutje të procedimit të kësaj çështje të prokurimit.
5. Përtej kësaj në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk ishte paraqitur arsyetim i qëndrueshëm përkitazi me ofertën e ... “F.” se në fakt nga vet përmbajtja e aktgjykimeve të kundërshtuara del se baza e shkeljes ndërliidhet me faktin se ky operator ekonomik nuk është shpallur fitues mbi faktin se ka pasur çmim më të lirë se operatori fitues, përkatësisht ... “S.”. Për më tepër edhe vet dëmi i pretenduar në shumë prej 29.824,18 €, buron në tërësi si rezultat i operatorit ekonomik më të shtrenjtë. Mirëpo me këtë rast nuk janë marrë për bazë provat materiale dhe as dëshmitë e dëshmitarëve, përkatësisht anëtarëve të komisionit vlerësues se operatori ekonomik “F.” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se nuk i kishte plotësuar kushtet e përcaktuara në tenderin e shpallur që stafi i tij punues të mos angazhohet në punishte të tjera.

6. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, vërehet se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë pamjaftueshëm është arsyetuar përgjegjësia penale e të dënuarve, përkundër faktit se dispozita e nenit 21 par.2 i KPRK-së, ka përcaktuar se: *“Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj”*, dhe e cila ndërlihet me dispozitën e nenit 22 i KPRK-së, se: *“Dijenja, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike”*. Bazuar në këtë, del se dashja si element subjektiv i veprës penale duhet të vlerësohet bazuar në rrethanat objektive të veprimeve të të dënuarve dhe duke u bazuar në veprimet konkrete të tyre duhet të arrihet konkludimi se a manifestohen apo jo elementet e kësaj vepre penale e posaçërisht dashja direkte e tyre. Arsyetimi i dashjes dhe qëllimit të të dënuarve duke u mbështetur në përgatitjen e tyre shkollore i theksuar në faqen e 23 të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në asnjë rrethanë nuk duhet të merret si bazë për një vendim fajësie, përndryshe shkollimi dhe përgatitja e tyre shkollore mund të shërbej si rrethanë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit pas shpalljes eventuale fajtor të tyre, mirëpo në asnjë rrethanë si përcaktues i fajësisë së tyre, siç në mënyrë të gabuar ka konkluduar gjykata e shkallës së parë. Nga kjo rrjedh se në aktgjykimin e kundërshtuar të gjykatës së shkallës së parë nuk është arsyetuar aspekti i dashjes, përkatësisht është dhënë arsyetim sipërfaqësor, përkundër faktit se dashja paraqet elementin esencial subjektiv të figurës së kësaj vepre penale.
7. Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPPK-së, të cilat shkelje nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë. Për më tepër, shkeljet e theksuara më lart e vënë në dyshim edhe gjendjen faktike pasi që nuk është vërtetuar saktësia e fakteve vendimtare dhe nga kjo arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjyqimeve të kundërshtuara dhe shqyrtim të serishëm të kësaj çështje.

Udhëzimet me rastin e rigjykimit të çështjes

1. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të administroj provat ekzistuese e sipas nevojës edhe prova tjera e pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe

të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike. Në rend të parë duhet të eliminoj paqartësitë e zhvillimit të ngjarjes, përkatësisht të vërtetoj hollësisht dhe saktësisht mënyrën e veprimit të të dënuarve, përkatësisht të sqarohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë forma e veprimit të tyre, të analizohet në hollësi e tërë dinamika e ngjarjes në mënyrë kronologjike prej shpalljes së tenderit, vlerësimin e ofertave të komisionit të parë, përpilimi i raportit dhe mënyra e dorëzimit të tij tek zyrtari i prokurimit, si dhe në fund raporti i komisionit të dytë që shpalli fitues operatorin ekonomik “S.”.

2. Duke pasur parasysh se rasti ndërlidhet me vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik konkurrues në tender dhe se ndryshimi mes shumësh më të lartë dhe më të ulët ka paraqitur bazën e aktakuzës është e nevojshme angazhimi i ekspertit përkatës i prokurimit publik i cili do të sqaronte çështjet e diskutueshme përkitazi me ecurinë e tenderit që nga shpallja e tij e deri në shpalljen e fituesit të tenderit. Në këtë aspekt fokusi duhet të mbetet tek ndryshimi i komisionit dhe mënyra e dorëzimit të raportit vlerësimit të ofertave nga ana e komisionit, përkatësisht mënyra standarde e dorëzimit të këtij raporti zyrtarit të prokurimit dhe veprimet e tij të mëtejme në rast se nuk pajtohet me vlerësimin e komisionit vlerësues. Posaçërisht të vlerësohet aspekti ligjor i veprimit në rastet e shpalljes së operatorit ekonomik të papërgjegjshëm se në fakt a mund të merret oferta e tij si bazë për të paraqitur shumësh e humbjes, përkatësisht përfitimit të operatorëve të tjerë ekonomik. Andaj, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se të gjitha këto çështje duhet të sqarohen përmes një ekspertizë të detajuar nga ana e ekspertit të fushës përkatëse, përkatësisht të prokurimit dhe pas kësaj të veprohet brenda kompetencës së gjykatës dhe në bazë të tyre dhe provave tjera të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.
3. Nga sa u parashtua më lartë e në kuptim të nenit 438 par.1, nënpar.1.2 të KPP -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.265/2024, i datës 15.05.2024

”Në këtë rast është interesant fakti se është arsyetuar vetëm pjesa liruese e aktgjykimit kurse pjesa dënuese nuk është arsyetuar fare“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, me aktgjykimin P.nr.468/2018 e datës 11.01.2023, të dënuarin H.B. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 186 par.1 lidhur me par.4 të KPRK-së duke i shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 900 (nëntëqind) €. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 20 €, në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe shumën prej 30 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, kurse i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.
2. Me të njëjtin aktgjykim i dënuari sipas dispozitës së nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së është liruar nga akuza për shkak se nuk është provuar se ka kryer veprën penale shtytja në lëndimin e lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 32 të KPRK-së.
3. Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1394/2023 e datës 22.02.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të dënuarit kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
4. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati V.S. nga L., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarin të e liron nga akuza ose të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën të e kthej në rigjykim.

5. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.148/2024 e datës 02.05.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
6. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.10 të KPP-së, për shkak se pikës së dytë të dispozitivit të aktgjykitimit i mungon plotësisht arsytimi. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përmban arsyetim vetëm përkitazi me pikën e parë të dispozitivit të aktgjykitimit përkatësisht për veprën penale shtytje në kryerjen e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 32 të KPRK-së, me të cilën i dënuari është liruar nga akuza, kurse për veprën penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, përkatësisht veprën penale ngacmimi nga neni 186 par.1 lidhur me par.4 të KPRK-së nuk është paraqitur fare arsyetim.
7. Pretendohet se edhe gjykata e shkallës së dytë lidhur me pjesën dënuese të aktgjykitimit nuk ka paraqitur arsyetim të mirëfilltë dhe nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet konkrete të theksuara në ankesë, mirëpo vetëm në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme ka theksuar se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë duke u bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve, ekspertizën mjeko-ligjore dhe fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës. Mirëpo një arsyetim i tillë pretendohet se është i paqëndrueshëm pasi që dëshmitarët dhe ekspertiza mjeko-ligjore nuk ka pasur të bëjë me veprën penale të ngacmimit për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, por këto prova ndërlidhen vetëm me veprën penale të shtytjes në lëndim të lehtë trupor e për të cilën veprës penale i dënuari është liruar nga akuza.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të bazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas dispozitës së nenit 384 par.2 nënpar.2.10 të KPP-së, pasi që aktgjykimet të gjykatës së shkallës së parë i mungon plotësisht arsyetimi përkitazi me pjesën dënuese të tij.
3. Nga përmbajtja e aktgjykimet të gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht dispozitivi i saj del se aktgjykimi i kundërshtuar përbëhet nga dy pjesë dhe atë pjesa e parë që ka të bëjë me pjesën liruse të saj e që bën fjalë për veprën penale shtytje në kryerjen e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 32 të KPRK-së e që i dëmtuari H.I. dhe që dëshmitarët e dëgjuar (B.S., B.S., M.M., B.N. dhe B.S.) e po ashtu, edhe ekspertiza mjeko-ligjore kanë qenë prova përmes të cilave është shqyrtuar pjesa e aktgjykimet liruës dhe përmes këtyre provave nuk është vërtetuar se i pandehuri të ketë kryer veprën penale në fjalë. Mirëpo në pjesën e aktgjykimet dënues gjykata e shkallës së parë për të gjithë këta dëshmitar nuk ka paraqitur fare arsyetimi përkitazi me këtë pjesë, përveç faktit se ka përshkruar fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe ka arsyetuar rrethanat për dënimin e shqiptuar.
4. Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.10 lidhur me nenin 369 par.7 të KPP-së, të cilat shkelje nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë e cila përmes një shablloni standard të krijuar anashkalon në tërësi pretendimet konkrete ankimore të paraqitura nga ana e të dënuarit, nga kjo arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjykimeve të kundërshtuara dhe shqyrtim të serishëm të kësaj çështje.
5. Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të administroj provat ekzistuese e sipas nevojës edhe prova tjera e pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.
6. Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPP -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.271/2024, i datës 29.05.2024

"Në këtë rast është interpretuar në mënyrë të gabuar ligji penal gjegjësisht vepra penale e rrezikimit të trafikut publik që përkundër faktit se i pandehuri ishte përmbajtur rregullave të lëvizjes së automjetit gjykata e kishte shpallur fajtor dhe e kishte gjykuar".

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, me aktgjykimin P.nr.501/2021 e datës 10.11.2023, të dënuarin V. H. e ka shpallur fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 e 1 të KPRK-së, dhe për këtë veprë e ka gjykuar me dënim me kusht me burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari brenda kohës së verifikimit në afat prej 3 (tri) viteve nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale. Në dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrestin shtëpiak nga data 22.12.202 deri më datë 19.03.2021. I dënuari është obliguar që në emër të programit për kompensim të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 551.00 (pesëqindpesëdhjetenjë) euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit 101.20 (njëqindnjë) euro e 20 (njëzet) cent, në emër të super-ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej 450.00 (katërqindpesëdhjetë) euro, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro. Përfaqësuesin ligjor të të dëmtuarit të ndërjerit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.
2. Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1682/2023 e datës 20.03.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, ankesën e mbrojtësit të dënuarit, si dhe ankesën e vetë të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit V. H., avokati K.B. nga Gj., për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni

432 i KPP-së, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPP-së, si dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale e të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimet e kundërshtuara t'i ndryshojë dhe të dënuarin ta liroi nga akuza.

4. Ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit është përgjigjur Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.nr.150/2024 e datës 03.05.2024, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e mbajtur, shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), çmoi thëniet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

2. Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë shkelje të ligjit penal nga neni 385 par.1 të KPP-së, sepse në veprimet e të dënuarit nuk manifestohen elementet qenësore që përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor. Gjykata thekson se gjykata ankimore nuk ka dhënë sqarime dhe fare nuk ka arsyetuar pretendimet ankimore. Tutje në kërkesë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë duke tentuar që të argumentojnë fajësinë e të dënuarit kanë shmangur citimet kryesore të ekspertit të komunikacionit dhënë në shqyrtim gjyqësor, me ç'rast ka argumentuar se: “mungon veprimi i kundërligjshëm i të dënuarit dhe se pasoja do të mund të shkaktohej edhe po të veprohej me kohë nga i dënuari”. Gjatë administrimit të provave e sidomos sipas mendimit dhe konstatimit të grupit të ekspertëve të komunikacionit është vërtetuar se i dënuari ka qenë duke vozitur me 42km/h, deri te aksidenti në trafik në të cilin ka humbur jetën i ndjeri kishte me ardhë edhe sikur i akuzuari ta drejtonte automjetin me shpejtësi prej 50 km/h, aq sa është e lejuar që do të thotë se aksidenti ka qenë i paevitueshëm dhe se i dënuari i ka ndërmarr

të gjitha veprimet për parandalimin e këtij aksidenti por në pamundësi për shkak të lëshimeve të të ndjerit i cili ditën kritike e ka kaluar rrugën ku nuk kishte vendkalim për këmbësor.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të dënuarit se aktgjykimet janë përfshirë me shkelje të ligjit penal janë të bazuara.
4. Nga shkresat e lëndës rezulton se me administrimin e provave e sidomos sipas mendimit dhe konstatimit të grupit të ekspertëve të komunikacionit është vërtetuar se deri te aksidenti në trafik në të cilin ka humbur jetën i ndjeri kishte me ardhë edhe sikur i akuzuari ta drejtonte automjetin me shpejtësi prej 50 km/h, aq sa është e lejuar që do të thotë se aksidenti ka qenë i paevitueshëm për shkak të lëshimeve të të ndjerit. Aktgjykimi është në kundërshtim të plotë me konstatimin e ekspertëve të komunikacionit ku sipas të cilit rezulton se nuk ka asnjë lidhje kauzale në mes të veprimeve të dënuarit dhe pasojës së ndaluar dhe asnjëra nga gjykatat nuk kanë dhënë sqarime në lidhje me këtë. Ekspertët e komunikacionit kanë konstatuar në ekspertizën e tre ekspertëve të komunikacionit se shpejtësia e lëvizjes së automjetit “R. E.”, para se të ndodh aksidenti, ka qenë 42 km/h, bazuar në gjurmët e frenimit, ndërsa distanca e automjetit “R. E.”, në momentin kur këmbësori ka qenë duke e kaluar rrugën nga ana e djathtë në anën e majtë, ku nuk kishte vendkalim për këmbësor, pra vija ndarëse ka qenë 18.8 metra, kjo distancë është shumë më e vogël se distanca e sigurisë të shpejtësia e kufizuar prej 50 km/h që e ka vlerën 75 metra. Ky rezultat tregon se shoferi nuk ka pasur mundësi teknike për shmangien e këtij aksidenti edhe në rast se do të lëvizte sipas kufizimit të shpejtësisë prej 50 km/h, për shkak të lëshimeve të pjesëmarrësit tjetër të komunikacionit – tani të ndjerit i cili sipas ekspertizës së tre ekspertëve të komunikacionit ka bërë këto lëshime: - këmbësori ka bërë kalimin e rrugës në vendin ku nuk ka të shënuar “vendkalim për këmbësor”, duke mos pasur kujdes të shtuar ndaj mjeteve që lëvizin në rrugë, me të cilin rast për shkak të pakujdesisë nuk ka arritur të kaloj rrugën, dhe - ka qenë i obliguar që kalimin e rrugës ta bëjë me kujdes të shtuar dhe ti lëshoi të gjitha mjetet të cilat lëvizin në rrugë.
5. Duke pasur parasysh ketë gjendje të çështjes, kjo gjykatë vlerëson se në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit V. H., me të drejtë pretendohet se në rastin konkret ndaj të mbrojturit të tij është shkelur ligji penal në dëm të tij.

6. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme në rastin konkret me administrimin e provave nuk është vërtetuar se i dënuari e ka kryer veprën penale dhe me aplikimin e drejt e ligjit penal, në bazë të nenit 363 par.1 të KPP u vendos që të lirohet nga akuza.
7. Për shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pronësoro juridike, u vendos në bazë të neneve 454 par.1 dhe 463, par.3 të KPP-së.
8. Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 438 par.1, nënpar.1.3 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.277/2024, i datës 15.05.2024

” Në këtë rast është interpretuar në mënyrë të gabuar ligji penal gjegjësisht vepra penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 të KPRK-së.

Pasi që nuk është bërë analizë e qëllimit të të pandehurit për të kryer këtë veprë penale“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.2028/2018 e datës 18.05.2022, të pandehurit M1. M1. dhe M2. M2. i ka shpallur fajtor për veprën penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 të KPRK-së dhe e ka gjykuar të pandehurën M1. M1. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) €, kurse të pandehurin M2. M2. e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale dhe dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) €. Të pandehurit janë obliguar në pagesën e shumës prej nga 50 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumë prej nga 30 €, në fondin për kompensimin e viktimave të kriminit, kurse e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1237/2022 e datës 13.02.2024, ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ankesën e mbrojtësit të të pandehurve dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

3. Kundër këtyre aktgjyqimeve, kërkesë të përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë, kanë paraqitur mbrojtësi i të pandehurës M1. M1., avokati I.D. nga G. dhe i pandehuri M2. M2., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjyqimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.154/2024 e datës 07.05.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
5. Në kërkesën e paraqitur pretendohet për shkelje të ligjit penal, meqë veprimet e të pandehurve nuk përbëjnë elementet e kërkuara të veprës penale për të cilën të pandehurit janë shpallur fajtor dhe janë dënuar nga ana e dy gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore. Konkretisht mungon elementi esencial i kësaj vepre penale, përkatësisht nuk është manifestuar dashja e të pandehurve për kryerjen e veprës penale dhe sikur gjykata e shkallës së parë të verifikonte dhe të merrte në konsiderim mbrojtjen e të pandehurve, por edhe provat e tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, do të nxirrte përfundime të kundërta dhe me këtë të pandehurit nuk do të i shpallte fajtor, por do të i lironte nga akuzat pasi që veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale. Në të njëjtën mënyrë është vepruar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë e cila gjatë procedurës ankimore nuk ka trajtuar në mënyrë të duhur pretendimet ankimore dhe nuk ka paraqitur arsyetim të plotë dhe të qartë përkitazi me faktin se veprimet e të pandehurve nuk kanë paraqitur vepër penale.
6. Në kërkesën e paraqitur janë theksuar edhe një mori pretendimesh tjera, mirëpo të njëjtat për shkak të natyrës së vendimit të marrë nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë përshkruar dhe as nuk janë trajtuar tutje për shkak të relevancës së tyre.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe

pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se: - kërkesa e përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

2. Duke u bazuar në shkresat e kësaj çështje penale dhe në provat e administruara në këtë çështje penale del se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë në shkelje të ligjit penal nga neni 385 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, pasi që vepra për të cilën të pandehurit janë shpallur fajtor dhe janë dënuar nuk përbën vepër penale. Pra, provat e administruara nga ana e dy gjykatave më të ulëta gjyqësore janë interpretuar në mënyrë të gabueshme dhe rrjedhimisht janë nxjerr konkludime të gabuara, dhe atë në dëm të të pandehurve, andaj, kjo e bën të mundur ndryshimin e aktgjykimeve duke e vendosur këtë çështje në mënyrë meritore.
3. Gjykata e shkallës së parë të pandehurit i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 të KPRK-së, duke përkrahur në dispozitivin e aktgjykimit të saj se: *“...nuk kanë paraqitur saktë të dhënat e kërkuara në formular lidhur me paluajtshmërinë në sipërfaqe prej 450 m2, që gjendet në Zonën Kadastrale LL., e blerë sipas kontratës së shitblerjes me numër VR.nr... të datës 04.05.2012 dhe e regjistruara në regjistrat kadastral të Komunës së G. me datë 27.03.2013.*
4. Gjykata Supreme e Kosovës në tërësi pajtohet me konkludimet e nxjerra nga dy instancat gjyqësore se në rastin konkret sipas asaj që ceket në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë nuk rezultojnë të jenë kontestuese rrethanat se: - të pandehurit kanë qenë zyrtar të lartë publik (M1. M1. – drejtoresh e administratës dhe Përkrahjes në KQZ, kurse M2. M2. – kryeshef i AKK); - se të njëjtit kanë pasur detyrim ligjor të deklarimit të pasurisë së tyre në AKK; - se me rastin e plotësimit të formularit për deklarim të pasurisë për vitin 2013 nuk kanë paraqitur paluajtshmërinë në sipërfaqe prej 450 m2, që gjendet në Zonën Kadastrale LL., e blerë sipas kontratës së shitblerjes me numër VR.nr... të datës 04.05.2012 dhe e regjistruara në regjistrat kadastral të Komunës së G. me datë 27.03.2013.
5. Mirëpo nga këto rrethana, ashtu siç është pretenduar edhe në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, del se kontestuese është fakti se përmes këtij deklarimi të paraqitur në

mënyrë jo të saktë (siç është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit) a ishin përmbushur elementet e veprës penale në fjalë dhe se deklarimi jo i saktë i pasurisë a ishte bërë me qëllim të deklarimit të rrejshëm për të fshehur pasurën apo ishte si rezultat i informacioneve të pamjaftueshme të të pandehurve lidhur me deklarimin e pasurive sipas formularit për deklarim të pasurisë, përkatësisht a ishte plotësuar aspekti i dashjes së të pandehurve që përmes deklarimit të rremë të mos paraqesin këtë pasuri në formularin e deklarimit të pasurisë së tyre dhe se ishin pikërisht këto dy aspekte që kanë bërë dallimin mes interpretimit të bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe të cilin konstatim e kishte pranuar edhe gjykata e shkallës së dytë në njërën anë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës në anën tjetër.

6. Fillimisht në këtë çështje penale është e nevojshme analiza e dispozitës së nenit 430 par.2 të KPRK-së e cila ka përcaktuar se: *“Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili bën deklaratë të rreme ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë...”*.
7. Nga leximi i kësaj dispozite dhe përshkrimi i dispozitivit të aktgjykimit të gjykatë së shkallës së parë vërehet një paqartësi e interpretimit të kësaj dispozite pasi që dispozita ligjore është e formuluar duke përcaktuar veprimin në dy forma alternative të kryerjes së veprës penale dhe atë: bën deklaratë të rreme ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, kurse në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është përshkruar një formë e cila nuk është e përfshirë në dispozitën ligjore, pra me këtë rast në fakt është rishkruar dispozita ligjore duke shtuar edhe formën e tretë alternative e kësaj vepre penale, përkatësisht mos paraqitjen e saktë e të dhënave në formularë.
8. Përtej kësaj, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore elementet e kësaj vepre penale do të duhej interpretuar në tërësinë e saj, përkatësisht në elementet e saj objektive dhe subjektive dhe të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative dhe jo në mënyrë fragmentare, siç janë interpretuar nga ana e gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore. Andaj, fillimisht është e rëndësishme të përcaktohen elementet e kësaj vepre penale dhe më pas të konstatohet se a janë përmbushur apo jo elementet e kërkuara. Siç u tha në pjesën e epërme të këtij aktgjykimi dhe duke u bazuar në shkresat e kësaj çështje penale, konkludimet e nxjerra

nga dy instancat gjyqësore se në rastin konkret sipas asaj që ceket në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë nuk rezultojnë të jenë kontestuese rrethanat objektive të rastit dhe atë se: të pandehurit kishin detyrim ligjor deklarimin e pasurisë dhe nuk kishin deklaruar paluajtshmërinë në sipërfaqe prej 450 m², që gjendet në Zonën Kadastrale LL., e blerë sipas kontratës së shitblerjes me numër VR.nr... të datës 04.05.2012 dhe e regjistruara në regjistrat kadastral të Komunës së G. me datë 27.03.2013. Mirëpo nga këto rrethana, ashtu siç është pretenduar edhe në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, del se kontestuese janë rrethanat subjektive përkatësisht fakti se a ishte qëllimi i të pandehurve deklarimi i rremë i pasurisë dhe ishte pikërisht ky aspekt që bëri dallimin mes interpretimit të bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe të cilin konstatim e kishte pranuar edhe gjykata e shkallës së dytë në njërën anë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës në anën tjetër.

9. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës elementet e kërkuara sipas dispozitës ligjore të nenit 430 par.2 të KPRK-së duhet të kenë referencë në Ligjin nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, kurse në nenin 17 është përcaktuar se *“Kushdo që shkel detyrimet e përcaktuara me këtë ligj, që nuk janë vepra penale, zyrtari i lartë bënë kundërvajtje dhe dënohet”*. Kurse nga përshkrimi ligjor rezulton, se për mos deklarim apo deklarim të pasaktë të pasurisë, të përfutur në mënyrë të ligjshme, nga neglizhenca e deklaruesit, paraqet veprim të kundërligjshëm, por nuk tërheq përgjegjësi penale. Intenca e këtij neni është inkriminimi i zyrtarit publik vetëm po që se pasurinë nuk e ka deklaruar fare apo e ka deklaruar rrejshëm dhe në asnjë rrethanë pasurinë të cilën e ka realizuar në mënyrë të ligjshme. Për më tepër, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara ka konstatuar se pasuria në fjalë është blerë përmes kontratës së shitblerjes e vërtetuar në Gjykatën Komonale në Prishtinë, kurse pagesa ishte bërë përmes transferit bankar nga blerësja – tani e pandehura M1. M1. tek shitësi D. Z.. Ashtu që këto fakte e bëjnë në tërësi të besueshme edhe deklarimin e të pandehurve se nuk kishin pasur për qëllim fshehjen e kësaj pasurie e aq më tepër që e pandehura M1. M1. kishte paraqitur kërkesë me shkrim në Komunën e G. për të regjistruar këtë pronë në emër të saj e që këto fakte në tërësi e provojnë se qëllimi i të pandehurve nuk ishte mos paraqitja e kësaj prone në formularin e deklarimit të pasurisë së tyre, meqë i saj ishte si rezultat i përfitimit të ligjshëm të saj.

10. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se, sikur qëllimi i ligdhënësit të ishte që çdo mos deklaram të pasurisë ta konsideronte vepër penale, nuk do e përdorte shprehjen “ nëse nuk është vepër penale “ dhe nuk do parashihte dënime për kundërvajtje, ngase nuk mund veprimi i njëjtë të jetë edhe kundërvajtje edhe vepër penale. Deri tani, në asnjë rast, për mos deklaram të pasurisë apo deklarimit jo të saktë, nuk janë iniciuar procedura për kundërvajtje siç e parasheh ligji, pse po ekzistuan këto dispozita ndëshkuese për kundërvajtje.
11. Vetë fakti se neni 17 i Ligji nr. 04/L-050, ka paraparë dispozita ndëshkuese për kundërvajtje, duke i përcaktuar saktë edhe gjobat, shpjen në përfundim të qartë dhe lehtas të kuptueshëm se “*mos deklarimi apo deklarimi jo i saktë i pasurisë e cila është e përfituar në mënyrë të ligjshme*” është vetëm kundërvajtje. Sikur qëllimi i ligdhënësit të ishte: që si pasurinë e fituar në mënyrë të ligjshme edhe atë të paligjshme të pa deklaruar apo të deklaruar në mënyrë jo të saktë , ta sanksiononte si vepër penale, nuk do parashihte kundërvajtje për mos deklaram të pasurisë, por do i rregullonte vetëm procedurat por jo edhe dispozitat ndëshkuese për kundërvajtje, pastaj neni 430 i KPRK-së do ishte ndryshe i strukturuar, dm.th. do përmbante paragraf të posaçëm, për pasurin e padeklaruar dhe të përfituar me abuzim dhe paragraf të posaçëm për pasurinë e padeklaruar apo të deklaruar në mënyrë të pa saktë, por të fituar në mënyrë të ligjshme, ngase në aspektin penal, nuk mund të kenë të njëjtin status si pasuria e ligjshme si ajo e paligjshme e pa deklaruar.
12. Në përmbyllje të këtij aktgjykimi, Gjykata Supreme e Kosovës shpreh shqetësimin e saj përkitazi me standardin e aplikuar së pari nga ana e Prokurorisë së Shtetit e mbështetur pastaj nga ana e dy gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore, të cilat përdorën një standard minimal dhe që veprimet e të pandehurve i cilësuan si veprime që përbëjnë vepër penale dhe atë pa një vlerësim dhe analizë të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirëse të provave që ishin në shkresat e lëndës dhe njëkohësisht duke bërë interpretim të gabuar të ligjit penal. Me këto veprime del se janë shkelur rregullat bazike të prezumimit të pafajësisë të garantuara *përmes mekanizmave të brendshëm* neni 31 par.5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 3 i KPP-së, meqë gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të të pandehurit, e posaçërisht këtë duke

e ndërlidhur me *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë *“in peius”* ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë *“in favorem”* ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet, *si dhe përmes mekanizmave të jashtëm* KEDLNj dhe GJEDLNj e së ndërtuar përmes vendimeve të saja: Minelli & Zvicrës, Murray & Britanisë së Madhe, Tefler & Austrisë, Lavents & Letonisë, etj., në të cilat vendime rëndësi vendimtare i kushtohet parimit të prezumimit të pafajësisë, përkatësisht kërkesës që kryerja e detyrave nga ana e anëtarëve të një gjykate nuk duhet të filloj me idenë e paracaktuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të akuzuarit.

13. Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje të ligjit penal dhe të cilat shkelje nuk janë mënjeluar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë e cila vendosi sipas mjetit të rregullt juridik dhe njëkohësisht pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit i paraqitur në kërkesë ishte i bazuar, andaj për këtë arsye u vendos që konform nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.333/2024, i datës 12.06.2024

”Ky rast është i rëndësishëm për faktin se i pandehuri është shpallur fajtor vetëm bazuar në një provë, përkatësisht në deklarinimin e të pandehurit tjetër e që me këtë rast është cenuar dispozita e nenit 119 par.5 të KPP-së (pjesa e dytë e kësaj dispozite) e cila ka përcaktuar se: “Deklaratat e të pandehurit të dhëna në çfarëdo konteksti me vullnet dhe pa shtrëngim, nuk mund të shërbejnë si provë ndaj të bashkëpandehurve në të njëjtën procedurë penale apo edhe në procedurën e veçuar, përveç kur ky Kod ne mënyrë shprehimore ka përcaktuar se deklaratat e tillë mund të shërbejnë si provë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1050/2022 të datës 20.02.2024, të dënuarin A. M. dhe E. M. i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1, nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe i ka gjykuar të dënuarin A. M. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €, kurse të dënuarin E. M. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €. Të dënuarit janë obliguar në pagesën e shumës prej nga 20 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej nga 30 € në emër të taksës për kompensimin e viktimit të krimit, kurse përfaqësuesi i palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1050/2022 të datës 20.02.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit E. M. kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit E. M., avokati A.I. nga F., për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e

Kosovës të i ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarin të e liroj nga akuza apo të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen të e kthen në rigjykim.

4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.189/2024 e datës 04.06.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
5. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2, nënpar.2.1 lidhur me nenin 369 par.6 dhe 7 të KPP-së, sepse arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë mbështetet ekskluzivisht në deklaratën e të dënuarit A. M. e dhënë me datë 21.02.2020 në Stacionin Policor në F. e të cilën deklaratë të tij i pandehuri E. M. nuk ka mundur të e kundërshton. Me këtë rast pretendohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 119 par.5 të KPP-së, pasi që aktgjykimin në pjesën e të pandehurit E. M. e mbështet në deklaratën e të dënuarit tjetër dhe e cila sipas kësaj dispozite nuk mund të shërbej si provë ndaj të bashkëpandehurve në të njëjtën procedurë, meqë kjo është në kundërshtim edhe me dispozitën e nenit 257 par.1 të KPP-së.
6. Pretendohet se si rrjedhojë e shkeljeve të lartë cekura është cenuar edhe ligji penal në dëm të të pandehurit E. M. për arsye se i pandehuri nuk është kryerës i kësaj vepre penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është gjykuar.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i bazuar, ngase aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë në shkelje të ligjit penal

nga neni 385 par.1 nënpar.1.4 të KPP-së, pasi që është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet.

3. Gjykata e shkallës së parë të pandehurin E. M. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1, nënpar.1.1 të KPRK-së, duke u mbështetur në provat e prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor të cilat janë përshkruar në faqen pesë dhe gjashtë të aktgjykimit dhe atë: dëgjimin e dëshmitarëve I. B., A. G., I. A., raportin fillestar të incidentit nr... të datës 21.02.2020, raportin e policit hetues ..., deklaratimet e përfaqësuesit të Kompanisë “A. E.” lidhur me vlerësimin e dëmit të shkaktuar, vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve ... të datës 21.02.2020, vërtetimin për kthimin e sendeve nga i dënuari tek roja e Kompanisë “A. E.”. Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nga përshkrimi i theksuar me lartë, rezulton se në rastin konkret me asnjë provë nuk është vërtetuar fajësia e të pandehurit E. M.
4. Duke u bazuar në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të cilat konstatime janë aprovuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë del se nga provat e lartë cekura nuk është provuar se kryerës i kësaj vepre penale është edhe i pandehuri E. M.. Kjo për faktin se asnjë nga dëshmitarët e dëgjuar natën kritike nuk e kishin parë të pandehurin në vendin e ngjarjes, por dëshmitë e tyre në tërësi i bazojnë vetëm mbi deklarinimin e të dënuarit tjetër A. M.. Është konkludim i përgjithshëm i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë se fajësia e të pandehurit është vërtetuar si rezultat i deklarinimit të të dënuarit A. M. apo si rrjedhojë e deklarinimit të tij.
5. Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimet e paraqitura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe duke u ndërlidhur me dispozitën ligjore të nenit 119 par.5 të KPP-së (pjesa e dytë e kësaj dispozite) e cila ka përcaktuar se: *“Deklaratat e të pandehurit të dhëna në çfarëdo konteksti me vullnet dhe pa shtrëngim, nuk mund të shërbejnë si provë ndaj të bashkëpandehurve në të njëjtën procedurë penale apo edhe në procedurën e veçuar, përveç kur ky Kod ne mënyrë shprehimore ka përcaktuar se deklarata e tillë mund të shërbej si provë”*. Konkludoj se në këtë çështje gjyqësore skeleti i aktakuzës, por edhe i aktgjyqësorëve të dy instancave më të ulëta gjyqësore, përkitazi me të pandehurin E. M. është i bazuar pikërisht në deklarinimin e të dënuarit tjetër A. M. dhe i cili deklarim është dhënë vetëm gjatë procedurës paraprake. Përtej kësaj tentimi i improvizimit të gjykatës së shkallës së parë përmes dëgjimit të

dëshmitarit I. A. (zyrtar policor), gjithashtu del të jetë i pamjaftueshëm, meqë ky dëshmitar është dëshmitar indirekt dhe pohon të dëgjuarat prej të dënuarit A. M., pra në fakt bën një ri deklaram të pohimeve të këtij të dënuari. Kurse në mënyrë të ngjashme edhe dëshmitari tjetër I. B. kishte pohuar se kishte parë edhe një person tjetër që ishte pjesëmarrës në këtë vjedhje dhe që kishte ikur nga vendi i ngjarjes. Mirëpo nuk kishte paraqitur informacion të plotë se ky person a ishte i pandehuri E. M. apo ndonjë person tjetër pasi që personi kishte ikur nga vendi i ngjarjes.

6. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në rastin konkret nuk është përmbushur standardi i kërkuar sipas dispozitave të neneve 119 par.5 dhe 257 par.1 të KPP-së dhe për këtë arsye konstatoi se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm pjesëmarrja edhe e të pandehurit E. M. në kryerjen e kësaj vepre penale, andaj në rastin konkret aktgjykimet e gjykatave të dy instancave më të ulëta janë përfshirë në shkelje të ligjit penal, ashtu që pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit i paraqitur në kërkesë ishte i bazuar, andaj në kuptim të nenit 438 par.1, nënpar.1.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.345/2024, i datës 18.06.2024

” Ky rast ka të bëjë me konfiskimin e sendit të personit të tretë pa i dhënë mundësinë e deklaramit të tij“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.64/2023 të datës 07.11.2023, i dënuari S. H., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale kontrabandimi me migrantë nga neni 164 par.1 të KPRK-së, duke e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 200 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimin shumën prej 50 €. Konform nenit 277 par.1 të KPP-së është konfiskuar kamioni i markës “M.”, ngjyrë të verdhë, me targa të regjistrimit ..., me rimorkio dhe lejet përkatëse të qarkullimit për kamion dhe rimorkio.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.15/2024 të datës 22.02.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar, kurse ka hudhur si të palejuar ankesën e përfaqësuesit të ndërmarrjes “E.” SHPK.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:
 - Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë si të bazuar kërkesën, të anuloj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe çështja të kthehet në rigjykim vetëm përkitazi me shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë së përfaqësuesit të palës së tretë;
 - mbrojtësja e të dënuarit S. H., avokate V.M. nga Gj., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e

vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë si të bazuar kërkesën, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen të e kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;

- përfaqësuesi i palës së tretë, avokatit I.D. nga Gj., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë si të bazuar kërkesën, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe sendet e konfiskuara të i kthehen pronarit të ndërmarrjes “E.” SHPK.

4. Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.149/2023 e datës 31.05.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.
5. Në kërkesë Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, meqë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, pasi që gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të ankesës së përfaqësuesit të palës së tretë ka hudhur si të palejuar ankesën, përkundër faktit se me dispozitën e nenit 381 par.4 të KPP-së është përcaktuar se ankesë kundër aktgjykimit mund të paraqes edhe personi pasuria e të cilit është konfiskuar. Në këtë mënyrë del se është cenuar e drejta e palës së tretë që të shqyrtohet konfiskimi i pasurisë nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.
6. Në kërkesën e paraqitur nga ana e mbrojtëses së të dënuarit theksohet se aktgjykimet e kundërshtuara përbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënpar.1.2 të KPP-së, meqë të dënuarit i është shkelur e drejta në mbrojtës e garantuar me dispozitën e nenit 52 të KPP-së dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pretendohet se një e drejtë e tillë të dënuarit i garantohet që nga fillimi i procedurës penale, kurse të dënuarit gjatë mbajtjes së seancës së hetimit të veçantë i është mohuar kjo e drejtë pasi që nuk ka pasur mbrojtës, përkundër faktit se në këtë seancë ka qenë prezent avokati Idriz Daci, mirëpo i njëjti ka qenë përfaqësues i palës së tretë, përkatësisht përfaqësuese i ndërmarrjes “E.” SHPK. Një shkelje e tillë pretendohet se është shkelje e cila ka ndikuar në vendimin gjyqësor pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është bazuar në procesverbalin e shqyrtimit të veçantë

hetimor ku janë dëgjuar të dëmtuarit dhe në bazë të këtyre deklarimeve i dënuari është shpallur fajtor. Për më tepër, gjykata e shkallës së dytë këtë shkelje ka qenë dashur ta evitoj sipas detyrës zyrtare, mirëpo mos shqyrtimi i kësaj shkelje ka ndikuar që aktgjykimi të mbështetet në prova të papranueshme të marra gjatë procesverbalit të hetimit të veçantë dhe në deklarime të të dëmtuarve të cilat janë marrë në mungesë të avokatit të të dënuarit.

7. Kurse në kërkesën e përfaqësuesit të palës së tretë theksohet fakti se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke kontestuar konfiskimin e pasurisë së personit të tretë i cili nuk ka pasur njohur për veprimtarinë e të dënuarit, andaj edhe konfiskimi i pasurisë është bërë në mënyrë jo ligjore.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, par.1 lidhur me nenin 436, par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pa vlerësimin të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit është e bazuar, kërkesa e mbrojtëses së të dënuarit është e pabazuar, kurse kërkesa e përfaqësuesit të palës së tretë është e palejuar.

2. Duke shqyrtuar pretendimet e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të paraqitura në kërkesën për mbrojtjes e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se pretendimet e theksuara përkitazi me mos shqyrtimin e ankesës nga ana e gjykatës së shkallës së dytë dalin të jenë të bazuara, pasi që me dispozitën e nenit 381 par.4 të KPP-së është lejuar ankesa edhe personit pasuria e të cilit është konfiskuar. Përkundër faktit se në kërkesën në fjalë është propozuar kthimi i çështjes në gjykatën e shkallës së dytë për të vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të palës së tretë, mirëpo bazuar në shkresat e lëndës dhe parimin e ekonomizimit të procedurës penale, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur ndryshimin e aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë, meqë vlerëson se nuk ishin plotësuar kushtet e përcaktuara ligjore për të urdhëruar konfiskimin e përhershëm të pasurisë së palës së tretë, përkatësisht pronarit të Kompanisë “E. D.” nga N. P..

3. Gjykata Supreme e Kosovës nuk aprovon konkludimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me konfiskimin për faktin se në rastin konkret rrjedh se nuk janë vlerësuar kriteret për konfiskim dhe se si është mundësuar kryerja e veprës penale me sendin e konfiskuar-kamionin dhe rimorkion. Gjykata e shkallës së parë do të duhej të përdorte testin e nevojshëm për vërtetimin e faktit vendimtar se i dënuari a ishte pronar i kamionit dhe pas kësaj të vërtetonte pronarin e kamionit dhe rimorkios dhe gjithashtu të vërtetonte njohurinë e palës së tretë se kamioni po përdorej për qëllime të jashtë ligjshme, përkatësisht të i jepte mundësinë e deklarimit të palës së tretë përkitazi me këto fakte dhe pastaj të bënte konfiskimin. Gjykata Supreme të Kosovës në rastin konkret aplikoi testin duke filluar me faktin se automjeti i konfiskuar a ishte pronë e të dënuarit dhe pastaj faktin e njohurive të palës së tretë se kamioni i tij po përdorej për qëllime të jashtëligjshme - kontrabandimin me migrantë. Ashtu që përmes këtij testi Gjykata Supreme e Kosovës, konkludoj se fillimisht nga shkresat e lëndës, përkatësisht dokumentacioni i kamionit dhe rimorkios del fakti se automjeti ishte pronë e personit juridik përkatësisht pronarit të Kompanisë “E. D.” nga N. P. dhe i cili gjatë rrjedhës së procedurës nuk ishte vërtetuar se kishte pasur njohuri se automjeti ishte duke u përdorur për kryerjen e veprës penale, meqë nuk ishte vërtetuar njohuria e palës së tretë- pronarit të kamionit se i njëjti ishte përdorur për kryerjen e veprës penale dhe me këtë nuk është plotësuar kushti për konfiskim të përcaktuar sipas dispozitave ligjore.

4. Gjykata Supreme e Kosovës tutje vlerëson se çështja e pronës si e drejtë e karakterit absolut është e mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe instrumentet ndërkombëtare, përkatësisht nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ dhe kjo paraqet obligime shtesë për gjykatat e rregullta në zbatimin e tyre gjatë vendimmarrjes lidhur me pretendimet e palëve të treta dhe duhet të merr parasysh dy faktorë kryesorë. Së pari, gjykata merr parasysh nëse pala e tretë e prekur a ka patur mundësi t’i paraqesë pretendimet ndaj pasurisë në mënyrë efektive, dhe nëse këto pretendime janë shqyrtuar në proceset e zbatimit. Nga ky këndvështrim e rëndësishme të përmendet edhe praktika e GJEDNJ në rastin BKM Logjistik kundër Sllovenisë, *“...me ç’rast është konstatuar se konfiskimi i pronës së palës së tretë mund të arsyetohej vetëm nëse interesat e palës së tretë që do ti kthehet prona peshonin më shumë se sa rreziku i kthimit të pronës dhe fakti se nuk ishte përshtatur për kontrabandim dhe nuk kishte rrezik se edhe në të ardhmen do të përdorej për kontrabandim, prandaj konfiskimi i pronës nga ana e autoriteteve janë konsideruar si të paarsyeshme, joproporcionale dhe paraqesin shkelje*

të nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ.”. Kurse në rastin konkret ndonëse pala e dëmtuar, përkatësisht pronari i automjetit kishte paraqitur pretendime, mirëpo pretendimet e tij nuk janë shqyrtuar me rastin e konfiskimit të përfundimtar dhe përkundër faktit se automjeti nuk kishte dizajnim të posaçëm për transportin e migrantëve, si dhe në të ardhmen nuk kishte rrezik se do të përdorej për destinim të tillë pasi që pronari kishte sjellje të përgjegjshme, përkatësisht nuk rezulton nga shkresat e lëndës se ishte i involvuar në kryerjen e veprës penale.

5. Sa i përket pretendimeve të mbrojtëses së të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se pretendimi i theksuar në kërkesë del të jetë i pabazuar pasi që duke u bazuar në shkresat e lëndës del se i dënuari gjatë tërë kohës ishte përfaqësuar nga mbrojtësi I.D. dhe atë që nga marrja në pyetje në polici, pastaj gjatë seancës për caktimin e masës së paraburgimit dhe posaçërisht gjatë seancës së veçantë hetimore, me ç’rast shihet se i njëjti ka qenë përfaqësues i të dënuarit e kjo më së miri vërehet edhe me faktin se pikërisht ky mbrojtës ka ushtruar ankesa kundër aktvendimit për caktimin- vazhdimin e paraburgimit, dhe për më tepër, i njëjti mbrojtës ka paraqitur kërkesë për hudhjen e aktakuzës pikërisht në emër të të dënuarit, andaj pretendimi se ky mbrojtës nuk ka përfaqësuar të dënuarin është tërësisht i pabazuar. Fakti se tani i njëjti mbrojtës vazhdon në këtë fazë të procedurës penale (fazën e ankesës) përfaqësimin e palës së tretë në asnjë rrethanë nuk e bën përfaqësimin e të dënuarit të mangët gjatë fazave të mëparshme të procedurës penale.
6. Sa i përket kërkesës së përfaqësuesit të palës së tretë, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se dispozita e nenit 433 par.1 të KPP-së, ka përcaktuar se kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqes: Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Andaj, nga kjo dispozitë ligjore del se i dëmtuari, përkatësisht përfaqësuesi i palës së tretë nuk është në mesin e këtyre personave me të drejtë të paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, andaj edhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ishte e papranueshme.
7. Nga sa u parashtrua më lart e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.402/2023, i datës 26.10.2023

"Rasti kur Gjykata Supreme ka ndryshuar aktgjykimet e kundërshtuara me kërkesë dhe ndaj të pandehurit ka refuzuar akuzën, në mbështetje të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 lidhur me nenin 357 par.1 nënpar.1.3 të KPP, për faktin se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë ndjekjen penale dhe pengojnë ndjekjen penale, ngase procedura e hetuesisë është pushuar dhe hetimi dhe ngritja e aktakuzës, pas aktvendimit për pushimin e hetimit, kanë qenë të paligjshme dhe sipas tyre nuk ka mundur të procedohet më, në mënyrën si kanë vepruar instancat më të ulëta".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.13/2020 të datës 12.09.2022, i pandehuri B.B., është shpallur fajtor, për shkak të veprës penale vrasje, nga neni 30 al.1 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK) si ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe për këtë vepër penale i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 07.09.1999 deri më datë 31.12.1999 si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 15.12.2021 e deri më datë 12.09.2022. Ndaj të dënuarit me vendim të posaçëm është caktuar masa e paraburgimit, pas shpalljes së aktgjykimit nga data e shpalljes e tutje. Të dëmtuarit R. dhe A.M., për realizimin e kërkesës pronësoro-juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil-juridik. I pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 150 €, në emër të shpenzimeve gjyqësore shumën prej 300 (treqind) €, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
2. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin, PAKR.nr.660/2022 e datës 28.02.2023, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

3. Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë të mbrojtjes së ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit B.B., avokati B.T., nga P., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe shkeljes së dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, shkeljes së të drejtave të garantuar me Kushtetutën e Kosovës me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, dhe i dënuari të lirohet nga aktakuza ose të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

4. Në kërkesë, mbrojtësi i të pandehurit, avokati B.T., pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.10 të KPP, të cilat shkelje konsistojnë në faktin aktgjyqësor iu mungon plotësisht arsyetimi, nuk janë vlerësuar provat kundërtënësore si dhe nuk a arsyetim lidhur me faktet vendimtare mbi bazën e të cilave është marrë vendimi mbi fajësinë. Në mes të pretendimeve tjera, mbrojtësi pretendon se nga gjykatat është shkelur neni 159 i KPP, i cili ka qenë në fuqi deri më datën 16.02.2023, meqenëse i pandehuri është shpallur fajtor duke u bazuar në një aktakuzë të paligjshme, të parregullte dhe të pasafatshme. Kjo për faktin se hetimet kundër të pandehurit janë filluar me datën 07.09.1999 në bazë të aktvendimit për fillimin e hetimeve Hep.nr.109/1999 të gjyqtarit hetues, e sipas Ligjit të Procedurës Penale të ish RSFJ të vitit 1977 (i cili ligj ka qenë në fuqi). Hetimet kanë vazhduar deri më datën 12.04.2018 kur me aktvendimin PP-nr.22/1999 nga Prokurori i Shtetit janë pushuar hetimet për shkak të kalimit të afatit prej 2 (dy) viteve për zhvillimin e hetimeve. Mbrojtja konsideron se e gjithë procedura e cila është zhvilluar pas kësaj date është arbitrare dhe e paligjshme sepse është shkel edhe neni 542 i KPPK (i cili ka qenë në fuqi kur është marrë vendimi për pushimin e hetimeve) me të cilin nen është paraparë që “nëse me hyrjen në fuqi të këtij Kodi është duke ecur ndonjë afat, afati i tillë llogaritet në pajtim me dispozitat e këtij kodi, përveç nëse afati i mëparshëm ka qenë më i gjatë ose dispozitat e këtij kapitulli parashohin ndryshe”. Pra, nga të dy gjykatat gabimisht është interpretuar kjo dispozitë, meqenëse në kohën kur ka qenë në fuqi LPP i RSFJ (Ligji i Procedurës Penale), nuk ka pas limit kohor për zhvillim të hetimeve e sipas nenit 175 të këtij ligji, ndërsa të gjitha provat e siguruar pas marrjes së vendimit për pushimin e hetimeve janë prova të papranueshme.

Të gjitha këto kanë bërë që shpallja e të pandehurit fajtor të jetë e kundërligjshme dhe arbitrare si dhe me shkelje të ligjit penal në dëm të njëjtit.

5. Prokuroria e Shtetit të Kosovës, me parashtrësën KMLP.II.nr.242/2023 e datës 16.08.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

Se kërkesa për mbrojtja të ligjshmërisë është e bazuar.

2. Gjykata Supreme, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe bazuar në shkresat e çështjes gjen se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale të parashikuara nga neni 384 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 159 par.1 dhe shkelje të ligjit penal, të parashikuar nga neni 385 par.1 nënpar.1.3 të KPP, nga arsytet si më poshtë:
3. Nga shkresat e lëndës vërtetohet se hetimet kundër të pandehurit janë filluar në bazë të aktvendimit për fillimin e hetimeve, Hep.nr.109/1999 datë 07.09.1999, të gjyqtarit hetues të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, e sipas Ligjit të Procedurës Penale të ish RSFJ të vitit 1977 (i cili ligj ka qenë në fuqi), më tej nga shkresat e çështjes rezulton se Gjykata Themelore në Prishtinë, më datën 27.10.2015 i ka dërguar shkresat HPQ.nr.29/99, në kompetencë të Prokurorisë Themelore në Pejë. Prokurori i rastit, me aktvendimin PPNr.22/99 datë 12.04.2018, ka pushuar hetimin me arsyetim se nuk kanë përfunduar në afat prej 2 viteve, afat ky i paraparë me nenin 159 par.1 të KPP, më tutje nga shkresat e çështjes vërtetohet se me shkresën PPP/I-nr.40/18 datë 21.11.2018, Prokurori i është drejtuar Zyrës Federale të Drejtësisë në RF të Gjermanisë, me kërkesë për ndihmë juridike ndërkombëtare që të merren në pyetje dëshmitarët R. dhe A.M. lidhur me ngjarjen e ditës kritike me 29 gusht 1999. Me datën 19.08.2019, shteti Gjermanisë i ka përcjellë dëshmit e kërkuara dhe me datën 27.01.2020 me

aktvendimin për fillimin e hetimeve PP/I-nr.01.2020, Prokurori i rastit ka filluar hetimet përsëri ndaj të pandehurit B.B. për shkak të veprës penale vrasja, nga neni 30 al.1 të Ligjit Penal të Kosovës(LPK).

4. Me datën 07.02.2020 nga Prokuroria Themelore në Pejë, është ngritur aktakuza PP/I-nr.01/2020, ndaj të pandehurit B.B., për shkak të vrasje, nga neni 30 al.1 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK).
5. Nga kjo gjendje e çështje, qartë rezultojnë se procesi është de legjitimuar dhe komprometuar në prokurori, në rrethana të tilla gjykata është dashur që në shqyrtimin e parë fillestar ta hedh aktakuzën ngase është ngritur pa mbështetje ligjore, për faktin se prokurori i çështjes, me aktvendimin, PP-nr.22/99 e datës 12.04.2018, me të drejtë ka pushuar hetimin, me arsyetim se brenda afati prej 24 muajve nuk është ngritur aktakuza, ngase me dispozitat kalimtare të KPP të vitit 2012, përkatësisht neni 540 është theksuar, se dispozita e këtij kodi zbatohen përshtatshmërisht për çdo procedurë penale të filluar para hyrjes në fuqi të këtij kodi në të cilën nuk është ngritur aktakuza. Më datë 27.01.2020, po ky prokuror, në kundërshtim me ligjin, me aktvendimin PP/I-nr.01.2020, i fillon hetimet edhe pse i kishte pushuar, me arsyetim se ka siguruar prova të reja dhe më pas kishte ngritur edhe aktakuzën, për shkak të veprës penale vrasje, nga neni 30 al.1 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK).
6. Prokurori mund t'i rihap hetimet, vetëm po qe se i ka pushuar hetimet konform neni 158 par.1 nënpar.1.1 të KPP, me arsyetim se nuk ka siguruar prova që atij i japin bazë të mjaftueshme për ta adresuar çështjen në gjykatë dhe ndërkohë ka siguruar prova, që imponojnë nevojën e rihapjes së hetimit, mirëpo kur hetimet i pushon në bazë të neni 159 par.1. për shkak se nuk janë përfunduar brenda 24 muajsh (*plus 6 muaj shtesë*), në asnjë mënyrë ligjërisht nuk mund të hapën më.
7. Në rrethana të përshkruara dhe bazuar në rrjedhën e procesit hetimor, gjykata është dashur ose ta hedhë akuzën para shqyrtimit gjyqësor apo të merr aktgjykim procedural-refuzim i aktakuzës, për shkak se pas pushimit të hetimit (përpos pushimit nga neni 158 par.1 nënpar.1.1 të KPP) i pandehuri nuk mund të ndiqet penalisht.

8. Gjykata e Apelit me neglizhencë i ka shmangë këto shkelje evidente të referuara nga ankuesi, e që e ka detyrim ligjor që shkeljet e ligji t'i vlerësoj *ex officio* edhe atëherë kur palë nuk pretendon në mjetin juridik, me "arsyetim" se shkeljet nuk ekzistojnë dhe se aktgjykimi është i drejtë dhe i ligjshëm.
9. Nga arsyet e parashtruara më sipër, Gjykata Supreme ka ndryshuar aktgjykimet e kundërshtuara me kërkesë dhe ndaj të pandehurit ka refuzuar akuzën, në mbështetje të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 lidhur me nenin 357 par.1 nënpar.1.3 të KPP, për faktin se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë ndjekjen penale dhe pengojnë ndjekjen penale, ngase procedura e hetuesisë është pushuar dhe hetimi dhe ngritja e aktakuzës, pas aktvendimit për pushimin e hetimit, kanë qenë të paligjshme dhe sipas tyre nuk ka mundur të procedohet më, në mënyrën si kanë vepruar instancat më të ulëta.
10. Nga të gjitha këto që u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitës së nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPP.
11. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 462 par.3 të KPPK.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.425/2023, i datës 21.09.2023

”Rasti lidhur e përgjegjësini e personit juridik bazuar në nenin 5 par.3 të Ligjit për Përgjegjësini e Personave Juridik, ku potencohet se “përgjegjësia e personit juridik bazohet në fajësinë e personit përgjegjës”, dhe fakti se në rastin konkret tani më është konstatuar se i pandehuri (personi fizik) nuk është fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, andaj edhe është liruar edhe personi juridik“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Klinë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.125/2022 të datës 22.09.2022, i dënuari I.G, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 të KPRK-së, dhe i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari, në afat prej 2 (dy) vitesh nga data e plotfuqishmërisë të aktgjykimin, nuk kryen ndonjë veprë të re penale. Ndërsa KEDS-Kompania Kosovare për Distribuium dhe Furnizim me Energji elektrike-Dega në Klinë, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 800 (tetëqind) euro, të cilin dënim e pandehura duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.
2. Të dënuarit janë obliguar që t'i kompensojnë shpenzimet e paushallit gjyqësor secili veç e veç në shumë prej nga 20 (njëzetë) euro, si dhe kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh kur aktgjykimi merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. Pala e dëmtuar M.P., për kërkesën pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil-juridik.
3. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm me aktgjykimin PA1.nr.1629/2023 e datës 20.04.2023, ka refuzuar ankesën e përbashkët të mbrojtësve të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
4. Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur: mbrojtësi i të dënuarit I.G., avokati Sh.S. nga F.K., për shkak të shkeljeve esenciale të

dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 e par.2 të KPP-së dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 385 par.1, nënpar.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoi si të bazuar kërkesën, të anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështja t'i kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë ose t'i ndryshojë dhe të dënuarin ta liroi nga akuza.

5. Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.255/2023 e datës 29.08.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësi i të dënuarit.

Pretendimet nga kërkesa

6. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit I.G, pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 370 par.6,7 dhe 8 të KPPK, të cilat shkelje qëndrojnë në faktin se në arsyetim të aktgjykimit të shkallës së parë nuk janë dhënë arsye për të gjitha pikat e aktgjykimit e sidomos për faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit mbi dënimin. Po ashtu, mbrojtja pretendon se në arsyetim të aktgjykimit nuk janë dhënë arsye se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, veçanërisht me rastin e vërtetimit të veprës penale. Sa i përket shkeljes së ligjit penal, në kërkesë pretendohet se është shkel ligji penal në dëm të të dënuarit, meqenëse i njëjti nuk është përgjegjës penalisht dhe se ligji penal është zbatuar gabimisht. Kjo për faktin se në veprimet e të dënuarit nuk janë përmbushur elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi shkresat e kësaj çështje penale, në kuptim të dispozitës së nënti 435 par.1 dhe 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë gjeti se:

Kërkesa është e bazuar, për arsye si në vijim:

2. Nuk është kontestuese se më datë 10.07.2017, në fshatin C., Komuna e K. nga rrjeti elektrik telat e rrymës ishin këputur dhe rënë në tokë, i dëmtuari M.P., kishte lëshuar

bagëtitë e tij për kullos, me ç ‘rast dy lopë të t’ia kishin rënë në kontakt me qarkun elektrik -telat e shkëputur dhe kishin ngordhur, gjithashtu nuk është kontestuese se përgjegjës për krijimin e një situatë të tillë të rrezikshme ishte i pandehuri si person përgjegjës për mirëmbajtjen e rrjetit në atë pjesë të fshatit, gjithashtu nuk është kontestuese se me ngordhjen e dy lopëve të dëmtuarit i ishte shkaktuar dëm në vlerë prej 2500 euro.

3. Kontestuese rezulton të jetë fakti se mos veprimi të akuzuarit (*mos evitimi i rrezikut*) a konsiderohen veprë penale?
4. Kur kemi të bëjmë me veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 1 dhe 2. Të KPK, ajo i ka dy forma të mundshme alternative të kryerjes së kësaj veprë penale:
 1. Rrezikimi i madh për jetën njerëzve dhe
 2. Shkaktimi i dëmit të konsiderueshëm material.
5. Sipas aktakuzës, në situatën konkrete është konsumuar forma e dytë e mundshme e kësaj veprë penale, shkaktimi i dëmit të konsiderueshëm material (në dispozitiv nuk përmendet forma e parë; rrezikimi i madhe për jetën e njerëzve). Meqenëse në këtë ngjarje dëmi material që i është shkaktuar të dëmtuarit ishte 3600 euro, nuk janë përmbushur kushtet ligjore për ekzistimin e kësaj veprë penale, nga neni 365 par. 1. të KPK, për faktin se sipas nenit 113 par.32.të KPK, dëm i konsiderueshëm konsiderohet dëmi prej 5000-15000 euro, ndërsa në rastin konkret lartësia e dëmit ishte 3600 euro (sipas vet të dëmtuarit).
6. Edhe sikur vlera e dëmit të ishte 5000 euro e sipër, në rrethana si është zhvilluar procesi nga fillimi, nuk do kishte zgjidhje tjetër për Gjykatën Supreme pos të merr aktgjykim lirues, për faktin se procesi ishte i kontaminuar ligjërisht qysh nga nisja, për këto arsye: Kur vepra penale është kryer nga personi përgjegjës në kuadër të personit juridik, përgjegjësi mban kryesi - personi përgjegjës dhe personi juridik edhe atë, për veprën penale nga paragrafi 2 i nenit 365, në asnjë mënyrë nga paragrafi 1. siç gabimisht është cilësuar vepra penale nga përfaqësuesi i akuzës dhe ky cilësim pa asnjë analizë logjike dhe juridike është pranuar nga dy gjykata instancionale (*paragrafi 1. nuk bënë fjalë për person përgjegjës*), pastaj në situatën e tillë, aktakuza duhet t’i përmbaj dy dispozitiva;

një për personin juridik dhe një për kryesin - personin përgjegjës, ngase veprimet-mosveprimi nuk është i njëjtë për dytë.

7. Mënyra si është ndërtuar ngjarja në dispozitivin e aktakuzës nga prokurori dhe për keqardhje është pranuar nga dy gjykatat, rezulton se personi juridik dhe personi përgjegjës janë bashkëkryerës edhe pse në vendim gjykata formalisht nuk i është referuar nenit 31 të KPK?! , ngase aktgjykimi ka vetëm një dispozitiv dhe në pjesën fajësuese është konstatuar: *“janë fajtorë, me çka kanë kryer ...“?*, të njëjtën shprehje gjykata e ka përdorur në arsyetimin e aktgjykimit (*faqe 9 pas. i fundit*). Në situatën kur përdoret shprehja: *“janë fajtorë, kanë kryer veprën penale“* nënkupton se janë bashkëkryerës, pavarësisht se i referohemi ose jo normës që bënë fjalë për bashkëkryerjen.
8. Së pari nuk është e mundur të ekzistoj edhe pakujdesia edhe bashkëkryerja (ngase të pakujdesia nuk ka marrëveshje për të kryer veprën penale) edhe sikur vepra penale të ishte kryer me dashje, nuk është e mundur bashkëkryerja në mes personit juridik dhe personit përgjegjës, për faktin se për të ekzistuar kjo formë e parë e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale, duhet plotësuar dy kushte; kushti subjektiv marrëveshja në mes të kryesve për të kryer veprën penale, e që është e pamundur të ekzistoj marrëveshja me personin juridik dhe kushti i dytë objektiv, që secili të marrë pjesë në veprimin e kryerjes apo të kontribuoj thellësisht në shkaktimin e pasojës.
9. Personi juridik është krijesë juridike, person fizik virtual, i cili ka të drejta dhe detyrime dhe më së shpeshti paraqiten në formë të ndërmarrjes, korporatës apo qeveri, e që përbëhet prej shumë personave, të cilat për arsye praktike ligji i konsideron si një, kështu që bashkëkryerja është e pamundur në mes të këtyre subjekteve të veprës penale.
10. Nga shkresat e lëndës rezulton se edhe Gjykata e Apelit, në mënyrë sipërfaqësore e ka trajtuar çështje dhe ka lejuar që një aktgjykim me të meta tillë të konfirmohet, më një standard-narrativ shabllon të krijuar tani *“se pretendimet nga ankesa janë të pabazuara dhe se shkeljet e pretenduara nuk ekzistojnë”*, edhe pse për çdo jurist, është lehtë e dukshme, se mosveprimi, si element qenësor i veprës penale, në rastin konkret nuk kishte atributet e veprës penale, për shkak të vlerës së dëmit që ishte shkaktuar, pastaj se aktgjykimi ishte në të gjitha dimensionet i paligjshëm dhe i paqartë si: në strukturë,

përshkrim të ngjarjes, cilësim juridik (në pjesën fajësuese ka dy cilësime; njëherë konstatohej se kanë kryer vepër penale nga neni 365. par. 6 lidhur me 1 pastaj vazhdohej prapë se kanë kryer vepër penale nga neni 365.par. 6??), në arsyetim.

11. Gjykata e Apelit, si gjykatë e dytë instancionale pas Gjykatës Supreme, ka obligim ligjor, që detyrimisht ta shqyrtoj ankesën për shkelje procedurale dhe ligjore edhe atëherë kur ankuesi këto shkelje nuk i ka vënë në pah edhe pse në rastin konkret, ankuesi kishte pretenduar se aktgjykimi është përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore, Gjykata ankimore ishte mjaftuar me konstatim: “*se shkeljet e pretenduara nuk ekzistojnë*”. Qasja e këtillë sipërfaqësore e Gjykatës së Apelit, krijon pasiguri juridike, për faktin se në situata të caktuara mundësitë ligjore të Gjykatës Supreme, për t’i evituar pasojat e lëshimeve të tilla, janë të limituar, veçmas kur bëhet fjalë për kërkesën e paraqitur në dëm të pandehurit.
12. Meqenëse kërkesa është paraqitur nga i pandehuri, kjo Gjykatë, nuk do kishte asnjë mundësi për t’i evituar të metat, edhe sikur të kishte vepër penale (*u sqarua më sipër këtu nuk bëhet fjalë për vepre penale*), ngase nuk do ekzistonte vepra penale për të cilën i pandehuri është shpallë fajtorë , por vepra penale nga paragrafi 2. e që është më e rënd se ajo nga paragrafi 1 . dhe gjykata e kufizuar nga standardi “*reformatio in peius*” nuk do të mund ta korrigjonte , gjithashtu as kthimi i çështjes në rigjykim nuk do të kishte zgjidhë asgjë, për shkak të standardit që e pamundëson një korrigjim në dëm të pandehurit.
13. Sa i përket të pandehurës KEDS, kjo Gjykatë gjen se bazuar në nenin 5 par.3 të Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik, potencohet se “përgjegjësia e personit juridik bazohet në fajësinë e personit përgjegjës”, dhe në rastin konkret nga fakti se tani më është konstatuar se i pandehuri I.G., nuk është fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, andaj edhe u vendos si në dispozitiv si më lartë.
14. Nga arsyet e përshkruara më sipër, Gjykata Supreme në mbështetje të nenit 438. par. 1. nënp. 1.1. lidhur me nenin 363. par. 1. Nënp. 1.1. të KPK, ndryshoi aktgjykimet e atakuar me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.578/2023, i datës 11.01.2024

”Rastet kur aktakuza e ngritur drejtpërdrejtë nga ana e Prokurorisë është në kundërshtim me nenin 101 par.2 i KPP (tash neni 99 par.2 të KPP) dhe nenin 241 të KPP (tash neni 234 të KPP) dhe gjykata e shkallës së parë është dashur që të njëjtën ta hedh dhe ta pushoj procedurën e në bazë të nenit 253 par.1.3 të KPP (tash neni 248 par.1.3 të KPP)“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr. 792/2014 datë 04.05.2023, i pandehuri L.I., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale legalizim i përmbytjes së rreme nga neni 403 par.1 të KPK, dhe për këtë veprë penale i është shqiptuar dënime me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në afat verifikues prej 2 (dy) viteve, nuk kryen veprë të re penale. I pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor dhe të shpenzimeve gjyqësore, të paguajë shumën prej 20 (njëzetë) € dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 30 (tridhjetë) €, e të gjitha këto në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
2. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1128/2023 datë 18.10.2023, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit ,ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.
3. Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë të mbrojtjes së ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokat F.K., nga P., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimet e atakuara të ndryshohen, dhe i dënuari të lirohet nga aktakuza.
4. Prokuroria e Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr. 336/2023 datë 09.11.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

-kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e bazuar.
2. Në kërkesë, mbrojtësi i të pandehurit, pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nënpar. 1.6 dhe par.2 nënpar. 2.1, 2.4, 2.6 dhe 2.7 të KPP, të cilat shkelje konsistojnë në faktin aktgjyqimeve iu mungon plotësisht arsyetimi lidhur me faktin se i pandehuri është shpallur fajtor për një vepër penale pa pasur aktvendim për fillimin e hetimeve. Duke u nisur nga fakti se në rastin konkret vepra penale legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 të KPK, është e sanksionuar deri me 5 vjet, prokurori është dashur të kryej hetime e jo të ngrit aktakuzë të drejtpërdrejtë. Këto shkelje të dispozitave të procedurës penale për pasojë kanë pasur edhe shkeljen e ligjit penal me vet faktin se i pandehuri është shpallur fajtor bazuar në aktakuzën e paligjshme.
3. Gjykata Supreme , duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe bazuar në shkresat e çështjes gjen se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje të ligjit penal në dëm të pandehurit e nga arsyet si më poshtë:
4. Nga shkresat vërtetohet se hetimet kundër të pandehurit janë filluar me datën 10.02.2014, nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, sipas aktvendimit për fillimin e hetimeve PP.II.nr.9034/2013 datë 06.02.2014. për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPK. Me datën 27.02.2014, nga e njëjta Prokurori, është marrë vendim për zgjerim të hetimeve edhe për veprën penale mashtrimi nga neni 335 të KPK dhe me datën 25.03.2014 është ngrit aktakuza PP.II.nr.9034/2014, për këto dy vepra penale kundër të pandehurit L.I. Me datën 31.03.2014, është ngritur aktakuza, nga e njëjta Prokurori me numër të njëjtë, kundër të njëjtit të pandehur, për këto dy vepra penale dhe për veprën penale legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 të KPK.
5. Më tutje nga shkresat vërtetohet se i pandehuri asnjëherë nuk është marrë në pyetje lidhur me këtë vepër penale (legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 të KPK) dhe se për këtë vepër penalë është akuzuar me aktakuzë të drejtpërdrejtë.

6. Gjykata Supreme , vlerëson se, Prokuroria Themelore në Prishtinë, nuk ka mundur të ngrit aktakuzë të drejtpërdrejtë ndaj të pandehurit L.I, me që për këtë vepër penale, nuk është marrë vendim për hetime e as për zgjerim të hetimeve përdërisa për këtë vepër penale është paraparë dënimi deri në 5 vjet. Pra, edhe sipas KPP i cili ka qenë në fuqi në kohën e hetimeve, neni 101 par.2 i KPP(tash neni 99 par.2) ka paraparë se “kur policia apo ndonjë person tjetër bënë kallëzim penal tek prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një vepër penale ose për disa vepra penale, asnjëra nga të cilat nuk dënohet me më shumë se tre vjet burgim, dhe prokurori i shtetit vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën, prokurori i shtetit mund të ngrit aktakuzë sipas nenit 241 (tash neni 234) të KPP”. Andaj, në këtë situatë, rrjedh se aktakuza e ngritur drejtpërdrejtë nga ana e Prokurorisë është në kundërshtim me nenin 101 par.2 i KPP (tash neni 99 par.2 të KPP) dhe nenin 241 të KPP (tash neni 234 të KPP) dhe gjykata e shkallës së parë është dashur që të njëjtën ta hedh dhe ta pushoj procedurën e në bazë të nenit 253 par.1.3 të KPP (tash neni 248 par.1.3 të KPP).
7. Po ashtu duhet të theksohet se të pandehurit nuk i është dhënë mundësia të të deklarohet lidhur me veprën penale për të cilën është akuzuar sepse nuk është marrë në pyetje nga ana e prokurorit të çështjes dhe është dashur që t’i epet mundësia të jep mbrojtjen e tij lidhur me këtë vepër penale. Të gjitha këto përbëjnë edhe shkelje të drejtës për një gjykim të drejtë e sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut si dhe shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sipas Kodit të Procedurës Penale i cili ka qenë në fuqi në kohën e ngritjes së aktakuzës, nuk ka qenë e paraparë mundësia që të ngritët aktakuzë pa marrjen në pyetje të pandehurit kur është dyshuar se ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënim më i lartë se 3 vjet dënim me burgim (neni 151 par.1 të KPP), ndërsa me Kodin i cili është sot në fuqi kjo mundësi ekziston por duhet të përmbushen paraprakisht disa kushte ligjore (neni 149 par.1 lidhur me nenin 234 par.2 të KPP).
8. Nga të gjitha këto që u tha më lartë si dhe duke marrë parasysh se i pandehuri është shpallur fajtor mbi bazën e një aktakuze të ngritur në kundërshtim të dispozitave të procedurës penale ku për pasojë të këtyre shkeljeve gabimisht është zbatuar edhe ligji penal në dëm të njëjtë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitës së nenit 438 të KPP.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.95/2024, i datës 28.02.2024

"Marrja aprovimet retroaktiv të urdhrit për kontroll nga gjykata dhe pasojat e mos marrjes ku si i tillë ky kontroll është provë e papranueshme, respektivisht provat e mbledhura gjatë kontrollit janë prova të pa pranueshme sepse nuk është marrë aprovim retroaktiv gjyqësor dhe kontrolli është zbatuar në shkelje të dispozitave nga ky Kapitull të cilat kanë rezultuar në zbatim të gabuar dhe të pariparueshëm të drejtësisë".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti, P.nr. 179/2022 datë 20.01.2023, i dënuari A.A., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPK, dhe për këto veprë penale i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 30.04.2022 deri më 19.05.2022. Nga i dënuari janë konfiskuar në mënyrë të përhershme dhe atë para në vlerë prej 955.00€, një fletore me llogari të ndryshme, 1291 çipa me vlera të ndryshme, deler (lloji çipit), 4 palë letra bixhozi dhe mbajtës të çipave.
2. I dënuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor dhe të shpenzimeve gjyqësore, të paguajë shumën prej 70(shtatëdhjetë)€, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
3. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin, PA1.nr.343/2023 datë 14.12.2023, ka aprovuar pjesërisht ankesën e mbrojtësit të dënuarit dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin ashtu që dënuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 30.04.2022 deri më 19.05.2022. Në pjesën tjetër aktgjykimi ka mbetë i pandryshuar.

4. Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë të mbrojtjes së ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokat Y.H., nga Gj., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe shkeljes së të drejtave të garantuar me Kushtetutën e Kosovës (neni 31) me propozim që aktgjykimet e atakuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.
5. Prokuroria e Shtetit të Kosovës, me parashtrësën KMLP.II.nr. 56/2024 datë 15.02.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:
 - kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e bazuar.
2. Në kërkesë, mbrojtësi i të pandehurit, avokat Y.H., pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nënpar. 1.10 të KPPK, të cilat shkelje konsistojnë në faktin aktgjykimeve iu mungon plotësisht arsyetimi, nuk janë vlerësuar provat kundërtënëse si dhe nuk a arsyetim lidhur me faktet vendimtare mbi bazën e të cilave është marrë vendimi mbi fajësinë. Në mes të pretendimeve tjera, mbrojtësi pretendon se kontrolli në lokalin afarist të dënuarit respektivisht urdhëresa mbi lejimin retroaktiv të kontrollit nuk është administruar si provë sepse nuk ekziston, çka e bënë këtë kontroll provë të pa papranueshme e që kishte ndikim në ligjshmërinë e vendimit mbi përgjegjësinë penale të dënuarit si dhe në sekuestrimin e provave dhe parave të cilat pastaj janë konfiskuar në kundërshtim me dispozitat përkatëse.
3. Gjykata Supreme, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe bazuar në shkresat e çështjes e duke mos i vlerësuar pretendimet tjera gjen se aktgjykimet janë të përfshira

me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.1 dhe 2.5 të KPPK, e të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor e nga arsyet si më poshtë:

- nga shkresat vërtetohet se pas kontrollit në lokalitetin në Viti në Rr."H.J.", ku dyshohej se organizohej bixhoz i paligjshëm, me datën 30.04.2022 në ora 03:00, të realizuar nga njësia e patrullës në SP Viti dhe NJRSH Gjilan, po të njëjtën ditë është kërkuar, nga gjyqtarja e procedurës paraprake, aprovim retroaktiv gjyqësor i kontrollit. Përkundër faktit që, Gjykata Supreme i ka kërkuar edhe shkresat shtesë nga Gjykata Themelore – Dega në Viti, vendimi për lejimin retroaktiv të kontrollit nuk është gjetur, pra i njëjti nuk është nënshkruar (lejuar) nga gjyqtarja e procedurës paraprake. Po ashtu nga procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 17.01.2023 vërtetohet se është lexuar si provë kërkesa për aprovimin retroaktiv të kontrollit, por jo edhe aprovimi i gjyqtarës së procedurës paraprake.

4. Gjykata Supreme gjen se konform dispozitës së nenit 110 par.3 të KPPK i cili Kod ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer kontrolli, përcaktohet se:

“Përrjashtimisht, në rrethana të ngutshme, kur urdhri me shkrim për kontroll nuk mund të merret me kohë dhe nëse ekziston rrezik real për vonesë, që mund të rezultojë me humbjen e provave, ose rrezik ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve, zyrtari i autorizuar i policisë mund të fillojë kontrollin në bazë të lejes gojore nga gjyqtari kompetent”.

Ndërsa paragrafi 6 i po të njëjtit nen, parasheh se:

“Kur policia ndërmerr kontroll pa urdhër të shkruar gjyqësor, brenda afatit prej dymbëdhjetë (12) orësh pas kontrollit i dërgon raport lidhur me këtë prokurorit të shtetit dhe gjyqtarit kompetent nëse për këtë çështje është caktuar ndonjë gjyqtar në mënyrë që të merret aprovimi retroaktiv gjyqësor i kontrollit, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës”.

5. Nga këto rrjedhë se nga gjykata nuk është marrë aprovim retroaktiv për kontroll dhe si i tillë ky kontroll është provë e papranueshme, respektivisht provat e mbledhura gjatë kontrollit janë prova të pa pranueshme sepse nuk është marrë aprovim retroaktiv

gjyqësor dhe kontrolli është zbatuar në shkelje të dispozitave nga ky Kapitull të cilat kanë rezultuar në zbatim të gabuar dhe të pariparueshëm të drejtësisë.

6. Për më tepër, kjo gjykatë gjen se në arsyetim të aktgjykimit të shkallës së parë, nuk janë dhënë arsye lidhur me kontrollin dhe faktin se edhe pse është lexuar si provë kërkesa për urdhër retroaktiv të kontrollit, se pse nuk është dhënë ky urdhër nga gjykata dhe çka ka ndodh me provat të cilat janë mbledhur gjatë këtij kontrolli. Ndërsa Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, po ashtu nuk jep arsyetim lidhur me pretendimet nga ankesa e për këtë fakt, e që është përbënë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.10 të KPPK, ashtu si me të drejt edhe potencon mbrojtja në kërkesë.
7. Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet së pari t'i shpallë prova të papranueshme ato prova të cilat janë mbledhur gjatë kontrollit, t'i veçon të njëjtat dhe pastaj pas administrimit dhe vlerësimit të provave tjera të merr një vendim meritor.
8. Nga të gjitha këto që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitës së nenit 438 të KPP.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.135/2024, i datës 30.05.2024

”Rastet kur të pandehurit, sipas vet akuzës janë akuzuar për vepër penale të kryer në vazhdimësi, atëherë, duhet të vlerësohet se kur bëhet fjalë për këtë lloj të veprave penale, këto konsiderohen si një vepër penale dhe si kohë e kryerjes së veprës penale konsiderohet koha e ndërmarrjes së fundit dhe pasojat e mos përcaktimit të saktë të veprimit të fundit “.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.2557/2021 të datës 23.06.2023, të pandehurit N.O. e A.G. janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje shpërdorimi nga neni 257 par.3 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 23 të KPK dhe për këtë vepër penale i është shqiptuar secilit veç e veç dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 3 (tri) vite, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. Të pandehurit janë obliguar që në mënyrë solidare të kompensojnë dëmin, në shumë prej 255.398,41 €, në Buxhetin e Republikës së Kosovës në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit si dhe janë obliguar që secili veç e veç të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej nga 500 € si dhe shumë prej nga 20 € në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.
2. Me të njëjtin aktgjykim ndaj të pandehurve është refuzuar akuza për shkak të veprës penale, shmangia nga tatimi nga neni 249 par.1 të KPK, për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit absolut të ndjekjes penale. Sa i përket kërkesës pasurore për këtë vepër penale, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest të rregullt civilo – juridik, ndërsa shpenzimet e procedurës penale është vendosur të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.
3. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin, PA1.nr.1241/2023 e datës 19.12.2023, me rastin e ankesës së mbrojtësit të dënuarit N.O. dhe mbrojtësit të akuzuarit A.G., e sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, vetëm lidhur me vendimin mbi dënimin, ashtu që të pandehurit N.O. dhe të pandehurit A.G., për veprën penale për të

cilën janë shpallur fajtor i ka shqiptuar secilit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa në pjesë të tjera aktgjykimi ka mbetur i pandryshuar.

4. Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të dënuarit N.O., avokati F.L. nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin me propozim që kërkesa të aprovohet dhe aktgjykimet të ndryshohen ashtu që të refuzohet akuza për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit, ose të lirohet nga akuza ose aktgjykimet të anulohen dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje dhe rigjykim;

- mbrojtësi i të dënuarit A.G., avokati H.Sh. nga P., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që kërkesa të miratohet dhe aktgjykimet të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë apo të ndryshohen dhe i pandehuri të lirohet nga akuza, dhe

- i dënuari N.O., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore me propozim që të aprovohet kërkesa dhe i pandehuri të lirohet nga akuza apo të refuzohet akuza ndaj të njëjtit për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes penale ose aktgjykimet të anulohen dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

5. Prokuroria e Shtetit të Kosovës, me parashtrës KMLP.II.nr.76/2024 e datave 29.02.2024, 15.03.2024 dhe datës 29.05.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të pandehurve dhe e vet të pandehurit N.O. të refuzohen si të pabazuara.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, janë të bazuara.

2. Në kërkesë, mbrojtësi i të pandehurit N.O., në mes të pretendimeve tjera pretendon se ndaj të pandehurit është shkelur ligji penal dhe atë neni 385 par.1, nënpar.1.2 të KPP-së, meqenëse në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim absolut të ndjekjes penale, ngase nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar fakti se llogaria bankare e OJQ “U...”, ka qenë e hapur deri në vitin 2015 dhe që të dy gjykatat duke pasur parasysh dënueshmërinë e veprës penale kanë konstatuar se nuk është arritur afati parashkrimit absolut. Megjithatë, nga shkresat e lëndës është vërtetuar dhe atë sipas vetë konstatimit të ekspertëve, se veprimi i fundit i të pandehurit në rastin konkret ka qenë viti 2012. Edhe pse xhirollogaria është e vërtetë se ka qenë e hapur deri në vitin 2015, mirëpo vetë gjykata e shkallës së parë i ka fal besimin ekspertizës e cila ka konstatuar se tërheqja e fundit nga xhirollogaria është bërë më datën 31.07.2012.
3. Edhe mbrojtësi i të pandehurit A.G., avokati H.Sh., në kërkesë, ka pretendimin e njëjtë sikur edhe mbrojtësi i të pandehurit N.O., duke theksuar se grupi prej 3 ekspertëve financiar, kanë përpiluar ekspertizën dhe në faqen 16 të saj kanë konstatuar se: nga paraqitja tabelare e llogarisë bankare në faqen 8 deri në faqen 15 të kësaj ekspertize si dhe të elaborimit tekstual të mësipërm, hyrja e fundit në këtë llogari ka qenë më datë 14.03.2012, ndërsa tërheqja e fundit më datë 20.03.2012 e pastaj deri më datën 31.07.2012 kanë qenë vetëm dalje në emër të provizionit bankar nga 1 €, në muaj, e po me këtë datë gjendja e llogarisë ka qenë zero. Andaj, aktgjykimet janë të përfshira në shkelje të ligjit penal meqenëse nga dispozitivi i aktgjykimit rrjedh se i pandehuri është shpallur fajtor për periudhën kohore nga viti 2006 deri në vitin 2015 edhe pse në asnjë mënyrë nuk është përshkruar se çfarë veprime ka kryer në vitin 2014, 2014 apo në vitin 2015 edhe pse nga ekspertiza vërtetohet se në xhirollogari për të cilën ka qenë i autorizuar i pandehuri, nga data 30.07.2012, nuk ka pasur asnjë para dhe nuk ka pasur asnjë tërheqje të çfarëdo shume.

4. Edhe vetë i pandehuri N.O., në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në mes të pretendimeve tjera ka edhe pretendime se ndaj të njëjtit është shkelur ligji penal, meqenëse xhirollogaria e OJQ-së, për të cilën ai ka pasur autorizim të bëjë tërheqje, nga periudha 30.07.2012 e deri në vitin 2015 nuk ka pas mjete dhe nga e njëjta nuk është bërë asnjë tërheqje e mjeteve. Duke marrë parasysh se veprat penale shpërdorimi nga neni 257 par.3 lidhur me par.1 dhe lidhur me neni 23 të KPK-së, është e dënueshme me maksimumin e dënimit 5 (pesë) vite burgim, duke u nisur nga fakti se veprimi i fundit inkriminues eventual, ka ndodhur në vitin 2012 dhe si rrjedhojë ka kaluar dyfishi i afatit të parashkrimit dhe është arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale e siç përcaktohet me nenin 90 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 91 par.6 të KPK-së.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, fillimisht duhet të theksohet se ka vlerësuar pretendimin kryesor të paraqitur nga mbrojtësit e të pandehurve N.O. dhe A.G., i cili pretendim ka të bëjë me faktin se është arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, duke konsideruar se ky pretendim është si çështje paraprake e cila duhet të vendoset e duke mos u lëshuar fare në pretendimet tjera të paraqitura në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe ka gjet se ndaj të pandehurve është shkelur ligji penal e për çka do të flitet më poshtë.
6. Nga shkresat e çështjes kjo Gjykatë gjen se të pandehurit N.O. dhe A.G., janë akuzuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale shpërdorim nga neni 257 par.3 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 23 të KPK-së, ku të njëjtit sipas dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë edhe janë shpallur fajtor sepse “në vazhdimësi, për gjatë periudhës kohore 2006-2015, në bashkëkryerje, me qëllim për t’i sjellë vetit apo tjetrit dobi pasurore të kundërligjshme kanë përvetësuar pasurinë e luajtshme të personave të tjerë e cila iu është besuar atyre ...”. Po ashtu, kjo gjykatë vlerëson se nga shkresat e çështjes respektivisht nga ekspertiza financiare e përpiluar nga grupi i ekspertëve është konstatuar se: “... hyrja e fundit e mjeteve në këtë llogari ka qenë më datë 14.03.,2012, ndërsa tërheqja e fundit më datë 20.03.2012, e pastaj deri më datë 23.07.2012 kanë qenë vetëm dalje në emër të provizionit të bankës nga 1 € në muaj dhe po me këtë datë gjendja e llogarisë ka qenë zero.
7. Kjo gjykatë, po ashtu gjen se të pandehurit janë akuzuar për veprën penale në vazhdimësi dhe për të vlerësuar afatin e arritjes së parashkrimit të ndjekjes penale, është dashur që të vlerësohet cili ka qenë veprimi i fundit inkriminues eventual i të pandehurve, e që në rastin konkret është tërheqja e fundit e mjeteve e cila sipas vetë

ekspertizës financiare, të cilës edhe i është falur besim nga gjykatat është data 20.03.2012. Edhe pse qëndron konstatimi se llogaria ka qenë e hapur deri në fund të vitit 2015 megjithatë nga e njëjta ekspertizë është konstatuar se më datë 23.07.2012 llogaria ka rënë në vlerën zero, pra e njëjta përkundër faktit që ka qenë funksionale nuk ka pasur hyrje-dalje rrjedhimisht as të pandehurit nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të tërheqjes së mjeteve financiare nga kjo xhirollogari, andaj, edhe veprimi i tyre i fundit inkriminues eventual, është dashur që nga dy gjykatat të konsiderohet data 20.03.2012 kur edhe është bërë tërheqja e fundit nga kjo xhirollogari.

8. Meqenëse të pandehurit, sipas vet akuzës janë akuzuar për veprë penale të kryer në vazhdimësi, kjo gjykatë, vlerëson se kur bëhet fjalë për këtë lloj të veprave penale, këto konsiderohen si një veprë penale dhe si kohë e kryerjes së veprës penale konsiderohet koha e ndërmarrjes së fundit. Pra, të dy gjykatat kanë dështuar që të konstatojnë se cili ka qenë veprimi i fundit apo ndërmarrja veprimit të fundit, edhe pse nga shkresat vërtetohet se grupi i ekspertëve ka dhënë sqarime të sakta lidhur me këtë fakt dhe vet gjykatat i kanë fal besim kësaj prove të administruar.
9. Po ashtu, Gjykata Supreme gjen se vepra penale shpërdorimi nga neni 257 par. 3 lidhur me par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Republikës së Kosovës, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, ka parashikuar dënim me burgim prej 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet. Sipas nenit 90 par.1, nënpar.1.4 po të njëjtit Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 5 (pesë) vjet, nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se 3 (tre) vjet burgim, ndërsa sipas nenit 91 par.6 të këtij Kodi, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale). Duke marrë parasysh se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka marrë formën e prerës më datë 19.12.2023, dhe duke marrë parasysh se veprimi i fundit inkriminues eventual, sipas akuzës dhe dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, bazuar edhe nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, është 20.03.2012, kjo gjykatë ka gjetur se më datë 20.03.2022, është arritur afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale.
10. Duke u nisur nga të gjitha këto që u thanë më lart, kjo gjykatë gjen se ndaj të pandehurve N.O. dhe A.G., është shkelur ligji penal në dëm të njëjtëve kur të njëjtët janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale shpërdorim nga neni 257 par.3 lidhur me par.1 dhe

lidhur me neni 23 të KPK-së, meqenëse është arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale dhe ndaj të njëjtëve është dashur të refuzohet akuza e konform neni 362 par.1, nënpar.1.3 të KPPK-së.

11. Andaj, kjo gjykatë bazuar në të gjitha këto që u thanë më lartë dhe në mbështetje të neni 438 par.1, nënpar.1.2 të KPPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.366/2024, i datës 14.06.2024

“Rastet kur nuk është zbatuar dispozita e nenit 398 par. 3 të KPP-së sipas të cilës dispozitë Gjykata e Apelit duhet të vendos për të gjitha ankesat kundër një aktgjykimi me një vendim. Pra, gjykata shkallës së dytë ka shkelur nenin 398 par.3 të KPP-së dhe kjo shkelje ka ndikuar në ligjshmërinë vendimit gjyqësor, me faktin se ankesa e mbrojtësit të dënuarit nuk është shqyrtuar fare kjo e bënë aktgjykimin të pakuptueshëm dhe të paqartë dhe si i tillë edhe me të meta të cilat e kushtëzojnë anulimin e tij“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr. 364/2022 datë 31.03.2023, të dënuarit A.Z. dhe D.G. janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 325 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK, dhe për këtë veprë penale secilit veç e veç, i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti si dhe dënim me gjobë, në lartësi prej nga 200 (dyqindtë) €, të cilin dënim janë obliguar ta paguajnë në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë. Nëse të dënuarit nuk dëshirojnë apo nuk mund të paguajnë gjobën e njëjta do t’iu zëvendësohet me dënim me burgim, duke i llogaritur për çdo ditë burgu nga 20€ të gjobës.
2. Të dënuarit janë obliguar që në emër të paushallit gjyqësor dhe të shpenzimeve gjyqësore, të paguajnë secili shumën prej nga 20 (njëzetë) € dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20 (njëzetë) €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimin, e nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
3. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin, PA1.nr.19/2024 datë 22.03.2024, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit D.G., ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

4. Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë të mbrojtjes së ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A.Z., avokat G.R.K., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimet e atakuara në ndryshohen ose të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.
5. Prokuroria e Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr. 127/2024 datë 12.04.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit të aprovohet si e bazuar.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

-kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e bazuar.

2. Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit A.Z., pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga se as ai e as mbrojtësi i tij nuk është njoftuar për datën dhe kohën e seancës e shkallës së dytë, në fakt me aktgjykim të shkallës së dytë fare nuk është shqyrtuar ankesa e tij.
3. Fillimisht duhet të theksohet se Gjykata Supreme, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe bazuar në shkresat e çështjes gjen se Gjykata e Apelit të Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë pasi që aktgjykimi i saj është anuluar nga kjo gjykatë, ka caktuar seancën e kolegjit me datën 22.03.2024 dhe për këtë seancë ka njoftuar palët: Prokurorinë e Apelit, të akuzuarin D.G. dhe mbrojtësin e tij avokat D.F. si dhe të dëmtuarin, ashtu siç edhe është konstatuar në procesverbal të seancës së kolegjit. Por, Gjykata Supreme, me aktgjykimin Pml.nr.566/2023 datë 14.11.2023, kishte anuluar në tërësi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.670/2023 datë 18.09.2023 duke aprovuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve A.Z. dhe D.G. dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim. Andaj, për seancën e rigjykimit, është dashur të njoftohen edhe i akuzuari A.Z. dhe

mbrojtësi i tij ndërsa është dashur që të shqyrtohet dhe vlerësohet edhe ankesa e tij e paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë.

4. Pra, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, siç me të drejtë potencon edhe në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit A.Z., është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 nënpar.2.1 të KPP-së, sepse nuk është zbatuar dispozita e nenit 398 par. 3 të KPP-së sipas të cilës dispozitë Gjykata e Apelit duhet të vendos për të gjitha ankesat kundër një aktgjykimi me një vendim. Pra, gjykata shkallës së dytë ka shkelur nenin 398 par.3 të KPP-së dhe kjo shkelje ka ndikuar në ligjshmërinë vendimit gjyqësor. Për më tepër, kjo gjykatë vlerëson se me faktin se ankesa e mbrojtësit të dënuarit A.Z. nuk është shqyrtuar fare dhe kjo e bënë aktgjykimin të pakuptueshëm dhe të paqartë dhe si i tillë edhe me të meta të cilat e kushtëzojnë anulimin e tij.
5. Po ashtu, duhet të theksohet se Gjykata Supreme, nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve tjera nga kërkesa, me që kjo shkelje e potencuar dhe e konstatuar e bënte të pamundur vlerësimin e tyre.
6. Në rigjykim, Gjykata e Apelit, fillimisht duhet të sigurohet që palët të cilat kanë ushtruar ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë si dhe palët tjera, të njoftohen për datën dhe kohën e seancës së shkallës së dytë dhe pastaj t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe pas vlerësimit të tyre të merr një vendim meritor lidhur me këtë çështje penale.
7. Nga të gjitha këto që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitës së nenit 438 par.1.2 të KPP-së.

Aktgjykimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

PML.Nr.405/2024, i datës 23.07.2024

”Rasti kur në favor të dënuarit, është shkelur ligji penal nga ana e gjykatës së shkallës së dytë me tejkalimin e kompetencave ligjore, kur i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë(6)muajve , pra nën minimumin e paraparë ligjor dhe kur gabimisht është aplikuar dispozita e nenit 72 të KPK-së për çka është konstatuar shkelja e tillë duke mos e prekur vendimin e formës së prerë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr. 308/2023 datë 23.11.2023, i dënuari P.A., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, dhe për këtë veprë penale, i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data. 26.09.2023 deri më 26.11.2023. I dënuari është obliguar që në emër të kompensimit të dëmit palës së dëmtuar t’ia paguajë shumën prej 5100 (pesëmijënjëqind) €.
2. I dënuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) € dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimet shumën prej 20 (njëzetë) €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
3. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin, PA1.nr.126/2024 datë 12.03.2024, ka aprovuar ankesën e mbrojtëses së të dënuarit P.A., përkitazi me vendimin mbi dënimin, ashtu që të dënuarit për veprën për të cilën është shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, në të cilin dënim është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 26.09.2023 deri më 26.11.2023, ndërsa ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë është refuzuar si e pabazuar. Në pjesën tjetër aktgjykimi ka mbetur i pandryshuar.

4. Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, kërkesë të mbrojtjes së ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori nga Zyra e kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.I.18/22024 datë 14.06.220224, për shkak të shkeljes së ligjit penal me propozim që të aprovohet kërkesa dhe të konstatohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë në shkelje të ligjit penal e të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

II. Vlerësimi i kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:
-kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e bazuar.
2. Në kërkesë, pretendohet se aktgjykimi shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje të ligjit penal e të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, e meqenëse, gjykata shkallës së dytë me rastin e vlerësimit të llojit dhe lartësisë së vendimit mbi dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, ka ndryshuar vendimin mbi dënimin duke tejkuluar kompetencat e veta ligjore dhe duke shkelur dispozitën e nenit 72 të KPK-së, sepse ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat e zbutjes së dënimit kur i ka shqiptuar dënim me burg nën minimumin e përcaktuar ligjor.
3. Gjykata Supreme, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe bazuar në shkresat e çështjes gjen se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të ligjit penal në dobi të pandehurit e nga arsyet e cekura si më poshtë:

-i dënuari në shqyrtim fillestar ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe gjykata ka aprovuar një pranim të tillë duke konstatuar paraprakisht se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 242 i KPPK. Gjykata shkallës së parë, me rastin e matjes së dënimit ka dhënë arsyet lidhur me llojin dhe lartësinë e vendimit mbi dënimin, duke arsyetuar të gjitha rrethanat si lehtësuese ashtu edhe ato rënduese dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.

-gjykata e shkallës së dytë, me rastin e vlerësimit të pretendimeve ankimore të mbrojtëses së të dënuarit, ka aprovuar pjesërisht ankesën dhe ka ndryshuar vendimin

mbi dënimin duke i shqiptuar të dënuarit dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë(6)muaj.

-duhet të theksohet se dispozita e nenit 72 par. 1 nënpar.1.3 të KPK-së, parasheh se *“kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 të KPK-së, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve si në vijim: nëse për veprën penale është paraparë si masë më ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një(1)vit burgim”*. Pra, gjykata e shkallës së dytë, gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 72 të KPK-së, sepse për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2 nënpar.2.1 të KPK-së, është paraparë dënimi me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet dhe gjykata as me dispozitat e kufijve të zbutjes së dënimit nga neni 72 par.3 nënpar.1.3 të KPK-së, nuk ka mundur t'i shqiptoj dënim me burgim nën një (1) vit burgim, çka me ë drejtë pretendohet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

4. Andaj, kjo gjykatë ka vlerësuar se në favor të dënuarit P.A., është shkelur ligji penal nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, kur i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, pra nën minimumin e paraparë ligjor, ngase gabimisht është aplikuar dispozita e nenit 72 të KPK-së dhe ka konstatuar shkeljen e tillë duke mos e prekur vendimi e formës së prerë.
5. Nga të gjitha këto që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitës së nenit 438 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së.

**VENDIME TË PËRZGJEDHURA NGA LËMIA
CIVILE**

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr. 505/2021, i datës 07.05.2024

"Gjykata Supreme e Kosovës me kërkesën e datës 22.09.2022, për kontroll incidental, tek Gjykata Kushtetuese, shtroi dyshimin për vendimmarrjen e gjykatave të instancës më të ulët, për kushtetutshmërinë e nenit 17 të Ligjit për Arsimin e Lartë si të ndërlidhur dhe me qellim të vlerësimit të pikës 1.6 të nenit 117, të Statutit të UP-se, dhe se a ishte kompetencë e Gjykatave të rregullta apo ishte kompetencë e ekskluzive e Gjykatës kushtetuese. Gjykata Kushtetuese sqaron se në bazë të procedurave të kësaj gjykate, kërkesa e shqyrtimit dhe vlerësimit të pikës 1.6, të nenit 117 të Statutit të Universitetit të Prishtinës do të ishte e mundur vetëm nëse do të iniciohej procedura nga brenda 8 ditësh, nga dita e miratimit të Statutit, nga së paku 10 deputet të Kuvendit të Kosovës. Gjykata Kushtetuese konstaton se nuk plotësohet kushti i pranueshmerisë, sepse Statuti i Universitetit të Prishtinës nuk është ligj, dhe kërkesa për këtë arsye kërkesa nuk duhet pranuar.

Gjykata Supreme nuk e pranoi përfundimin e gjykatave të instancës më të ulët, ku ky nen i Statutit shpallë diskriminues dhe në kundërshtim me kushtetutën për faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës e kishte miratuar këtë statut, duke qenë organi më i lartë legjislativ, i cili i ushtron kompetencat në përputhje me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: miraton Kushtetutën, ligje, rezoluta, deklarata dhe akte të tjera të përgjithshme, vendos ta ndryshojë Kushtetutën, shpall referendum, në pajtim me ligjin, ratifikon traktate ndërkombëtare, miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës, dhe të gjitha këto akte nuk mund të shqyrtohen në pikëpamje të kushtetutshmërisë nga gjykatat e rregullta, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se Statuti i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nuk është akt i thjeshtë nënligjor, i nxjerr nga pushtetit ekzekutiv, Rregullore e brendshme e Kuvendit, por është aprovuar si mënyrë e zbatimit të vet Ligjit të arsimit të lartë. Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se gjykatat e rregullta nuk mund të vlerësojnë pajtueshmërinë e kësaj norme sepse me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe për të interpretuar përfundimisht përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1360/2021, të datës 09.06.2021, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me seli në Prishtinë, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.35/2019, i datës 17.12.2020, me të cilin është aprovuar në tërësi, si e bazuar, kërkesëpapia e paditësit F.H., nga Prishtina dhe anuluar vendimi (njoftimi) i Senatit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në Prishtinë, Nr.4/472, i datës 05.10.2018, me të cilin është refuzuar kandidatura e paditësit, për pozitën profesor asistent pranë të paditurit, si i kundërligjshëm dhe detyrohet i padituri, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë të përgjithshme prej 290.00€, në afat prej shtatë (7) ditësh, nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
2. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion i autorizuari të paditurit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta pranojë si të bazuar revizionin, ndërsa aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje.
3. Paditësi, në përgjigje të revizionit ka kërkuar që Gjykata Supreme ta hedh revizionin si të pa lejuar ose që revizioni të refuzohet si i pa bazuar.
4. Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK) si dhe sipas pretendimeve të revizionit, shqyrtoi aktgjykimin e goditur, si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se: Revizioni i të paditurit është i bazuar.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Përpara se të vendos lidhur me revizionin e të paditurit, Gjykata Supreme, më datën 22.09.2022, në bazë të nenit 113 paragrafi 8 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me neni 52 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i

paraqiti kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë, me Kushtetutën e Kosovës, të nenit 17, paragrafi 1 i Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr.04/L-037, lidhur me nenin 177 pika 1.6 të Statutit të Universitetit të Prishtinës. Gjykata Supreme pati për bazë faktin se Statuti i Universitetit është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjykata Supreme, suspendojë procedurat, deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me aktvendimin në rastin KO147/22, lidhur me kërkesën e Gjykatës Supreme të Kosovës, ka vendosur që të shpallë kërkesën të papranueshme duke e deklaruar se Statuti i Universitetit të Prishtinës nuk është ligj dhe prandaj nuk janë plotësuar kushtet për pranimin e kësaj kërke.

2. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, F.H. nga P., më datën 08.01.2019, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që t'i miratohet kërkesëpadia e paditësit dhe të anulohet vendimi (njoftimit) i Senatit të Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në Prishtinë, nr. 4/72, i datës 05.10.2018, dhe që të detyrohet i padituri, t'ia kompensojë të gjitha shpenzimet procedurale deri në përfundim të saj.
3. Gjykata e shkallës së parë, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, ka administruar këto prova: shpalljen për konkurs, me Nr.prot.1/73, të datës 27.04.2018, për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Prishtinës, vendimin Nr. Prot.02/477, i datës 16.05.2018, mbi emërimin e Komisionit Profesional Vlerësues (recensues); Raportin e Komisionit Vlerësues me numër 03/177, i datës 29.05.2018, për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik (për mësimdhënës), Propozimi i Fakultetit Juridik me numër Nr.prot.03/255, i datës 13.07.2018, për zgjedhjen e stafit akademik, pas shpalljes së raporteve në buletinin e Universitetit, Njoftimi me numër Nr. prot. 4/472, i datës 27.11.2018, Ankesën e datës 03.12.2018, me numër të pranimit 05.5/1 dhe njoftimin me numër Nr. prot. 102, i datës 15.01.2019, lidhur me ankesën e parashtruar kundër vendimit të Senatit dhe pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresat tjera të lëndës ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjyqimit të shkallës së parë.

4. Gjykata ka arsyetuar se kandidati për pozitën Profesor - Asistent këtu paditësi F.H., përjashtuar kushtin e moshës kishte plotësuar të gjitha kriteret e konkursit për tu përzgjedhur në këtë pozitë duke filluar nga kriteri i gradës shkencore, publikimet shkencore, përvojën e punës në procesin mësimor në arsim të lartë, por i vetmi kusht në bazë të cilit është refuzuar kandidati ka qenë mosha e tij, e që rezulton të jetë më e lartë se 50 vite, e që kjo moshë sipas të paditurit, e bën paditësin të papërshtatshëm për të themeluar marrëdhënie pune për herë të parë, tek e paditura për pozitën në fjalë, me pretendimin se kjo është një rregull e përcaktuar me Statut, të cilën e ka miratuar Kuvendi i Republikës së Kosovës, që do të thotë se i njëjti e ka fuqinë e ligjit. Senati i Universitetit nuk e kishte aprovuar propozimin e Komisionit dhe e kishte refuzuar kandidaturën e paditësit për arsye të parapara në nenin 177 pika 1.6 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, e që ka të bëjë me moshën e kandidatit.

5. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se përcaktimi i kriterit moshë më të ulët se mosha e pensionimit, për përzgjedhjen e kandidatit për pozitën Profesor - Asistent është në kundërshtim me nenin 17 paragrafi 5 dhe 6, neni 26 të Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, neni 5 dhe 8 të Ligjit të Punës, dhe me nenin 174 të Statutit të UP-së sepse ky nen përcakton bazat mbi të cilat duhet të bazohet përzgjedhja për personel akademik, e që janë kualifikimet dhe përvoja e punës e vlefshme për të gjitha gradat akademike, andaj është vlerësim i Gjykatës, se vendosja e kushtit të moshës për të hyrë në një profesion të caktuar mund të bëhet vetëm me ligj dhe atë kur e kërkon natyra e punës ose një kusht i tillë është i domosdoshëm për mbrojtjen e shëndetit të punësuarit por edhe për qëllime legjitime që mund ti ketë punëdhënësi e që në rastin konkret, kriteri moshë nuk është i përcaktuar me ligje dhe se caktimi i këtij kriteri me Statut, nuk është bërë me qëllim të mbrojtjes së shëndetit tek i punësuarit e nga e paditura nuk është pretenduar ndonjë qëllim legjitim për këtë kriter andaj përcaktimi i kriterit në moshë dhe atë vetëm për kandidatët që për herë të parë themelojnë marrëdhënie pune për pozitën në fjalë e që do të thotë për kandidatët e jashtëm e jo edhe për ata që ri-zgjedhën, kandidatët e brendshëm paraqet trajtim më pak të favorshëm se sa trajtohen kandidatët e brendshëm në një situatë të ngjashme dhe atë mbi bazën e moshës, andaj kjo mënyrë e trajtimit paraqet diskriminim në bazë të moshës si formë e diskriminimit që është përcaktuar me nenin 4 paragrafi.2 të Ligjit Nr.05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi.

6. Gjykata e Apelit, në procedurën sipas ankesës së të paditurit, vlerësoi se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkellje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, ndërsa nuk qëndrojnë pretendimet tjera të palës paditëse të cekura në ankesë. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë aktgjykimi i atakuar është mjaftë i qartë si në pjesën e dispozitivit ashtu edhe të arsytimit, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materialo juridike, ka nxjerrë përfundimin e drejtë lidhur me vendosjen meritore. Prandaj gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore në tërësi ka aprovuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
7. Gjykata Supreme e Kosovës, në një gjendje të tillë të çështjes, përfundimet dhe vendosjen e gjykatave të instancës më të ulët, nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshme, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, mbi gjendjen e tillë të vërtetuar faktike, të dy gjykatat e lartë përmendura gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Gjykata nuk e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë, dhe të gjykatës së shkallës së dytë, për shkak se me aktgjykimet e atakuara gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe nuk ka pasur shkellje thelbësore të dispozitave të Ligjit të procedurës kontestimore, mirëpo nga ana e gjykatës të shkallës së parë gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, e po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale kur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar si të drejtë dhe të ligjshëm.
8. Gjykata Supreme nga shkresat e lëndës ka gjetur, se kontestuese në mes palëve është fakti se Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" e kishte refuzuar zgjedhjen e kandidatit këtu paditësit F.H. në thirrjen akademike Profesor - Asistent për lëndët e sipër përmendura në Fakultetin Juridik për shkak të mosplotësimit të kushteve të

parapara me nenin 177 pika 1.6 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, e që ka të bëjë me moshën e kandidatit. Për këtë kandidatit e kishte njoftuar me njoftimin e datës 27.11.2018, nr. protokollit 4/472 ndaj të cilit paditësi brenda afatit kishte ushtruar ankesë pranë Komisionit për Ankesa dhe Parashtesa të UP-së, për të cilën ankesë nuk kishte vendosur brenda afatit të përcaktuar. Pra kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte vetëm ligjshmëria e refuzimit për emërim të kandidatit F.H. për pozitën Profesor - Asistent pranë të paditurit, për shkak të moshës së tij, kriter ky i përcaktuar në Statutin e të paditurit, për çka kandidati, këtu paditësi ishte njoftuar nga Senati i Universiteti të Prishtinës "Hasan Prishtina" me njoftimin Nr.prot.4/472 i datës 27.11.2018.

9. Gjykata Supreme e Kosovës me kërkesën për kontroll incidental, tek Gjykata Kushtetuese, shtroi dyshimin për vendimmarrjen e gjykatave të instancës më të ulët, për kushtetutshmërinë e nenit 17 te Ligjit për Arsimin e Larte si te ndërlidhur dhe me qellim të vlerësimit të pikës 1.6 të nenit 117, të Statutit të UP-se, dhe se a ishte kompetencë e Gjykatave të rregullta apo ishte kompetencë e ekskluzive e Gjykatës Kushtetuese (shih aktgjykimin në rastin nr. KI207/19), por pas aktvendimit lidhur me këtë rast, mori në shqyrtim revizionin e të paditurit ku Gjykata Kushtetuese është deklaruar vetëm për pranueshmërinë e kërkesës së Gjykatës Supreme të Kosovës për kontroll incidentale dhe kërkesën e ka deklaruar të pa pranueshme. Gjykata Kushtetuese sqaron se në bazë të procedurave të kësaj gjykate, kërkesa e shqyrtimit dhe vlerësimit të pikës 1.6, të nenit 117 të Statutit të Universitetit të Prishtinës do të ishte e mundur vetëm nëse do të iniciohej procedura nga brenda 8 ditësh, nga dita e miratimit të Statutit, nga së paku 10 deputet të Kuvendit të Kosovës(pika 69 e Aktvendimit nr.KO147/22). Në pikën 71 të aktvendimit të njëjtë, Gjykata Kushtetuese konstaton se nuk plotësohet kushti i pranueshmerisë, sepse Statuti i Universitetit të Prishtinës nuk është ligj, dhe kërkesa për këtë arsye kërkesa nuk duhet pranuar.
10. Gjykata Supreme e Kosovës nuk e konteston gjendjen faktike dhe mos përputhësinë e nenit 17 te Ligjit për Arsimin e Larte si të ndërlidhur dhe me qellim të vlerësimit të pikës 1.6 të nenit 117, të Statutit të UP-se, me Ligjin e Punës dhe Ligjin Nr.05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi, por konsideron se duke u nisur nga fakti se Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr.04/L-037, është nxjerr nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa Statuti i Universitetit të Prishtinës është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës

së Kosovës, dhe gjykatat e rregullta nuk kanë kompetencë të marrin në shqyrtim kushtetutshmërinë e këtyre dispozitave, qoftë edhe si dispozita të Statutit, por të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës.

11. Nisur nga fakti se Kuvendi i Republikës së Kosovës është organi më i lartë legjislativ, i cili i ushtron kompetencat në përputhje me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: miraton Kushtetutën, ligje, rezoluta, deklarata dhe akte të tjera të përgjithshme, vendos ta ndryshojë Kushtetutën, shpall referendum, në pajtim me ligjin, ratifikon traktate ndërkombëtare, miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës, dhe të gjitha këto akte nuk mund të shqyrtohen në pikëpamje të kushtetutshmërisë nga gjykatat e rregullta, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se Statuti i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nuk është akt i thjeshtë nënligjor, i nxjerr nga pushtetit ekzekutiv, Rregullore e brendshme e Kuvendit, por është aprovuar si mënyrë e zbatimit të vet Ligjit të arsimit të lartë. Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se gjykatat e rregullta nuk mund të vlerësojnë pajtueshmërinë e kësaj norme sepse me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe për të interpretuar përfundimisht përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën. Duke shqyrtuar përputhshmërinë e kësaj norme me Kushtetutën, gjykatat e instancës më të ulët kanë tejkaluar kompetencën sepse një tagër e tillë i takon Gjykatës Kushtetuese, dhe çdo vlerësim i kushtetutshmërisë i akteve të nxjerra në seanca plenare të Kuvendit të Kosovës, nga ana e gjykatave të rregullta cenon pushtetin legjislativ, nga ai gjyqësor. Nga ana tjetër nëse pala konsideron se njoftimi i Senatit të Universitetit të Prishtinës, i bazuar në Statutin e Universitetit me fuqinë e miratimit në Kuvend, është kundër kushtetues, mund të drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë individuale.
12. Andaj duke ju referuar të cekurave si dhe Statutit të Universitetit të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se kërkesëpapia e paditësit është e pa bazuar.
13. Për shkak se me aktgjykimin e atakuar si dhe atë të shkallës së parë, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, mirëpo në këtë rast, gabimisht është aplikuar e drejta materiale, aktgjykimet e atakuara është dashur të ndryshohen, në bazë të nenit 224.1 të LPK-së ashtu që kërkesëpapia e paditësit u refuzua si e pabazuar.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

E.Rev.nr.26/2023, i datës 21.11.2023

"Gjykata e Shkallës së parë e kishte pranuar kërkesëpadinë dhe e kishte obliguar të paditurën që në emër të kompensimit të borxhit të mbetur e të papaguar, për punët e kryera në shumën prej 50,000.00€, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar si pasoj e mos aktivizimit të makinerisë dhe materialeve tjera, duke përfshirë edhe fuqinë punëtore, t'ia paguaj shumën prej 658,664.68€, në emër të fitimit të humbur, t'ia paguaj shumën prej 178,927.79€. Gjykata e shkallës së dytë e kishte ndryshuar pjesërisht sa i përket shumave. Gjykata Supreme gjeti fakte kundërtëhënse dhe pa vërtetimin e tyre ishte i pamundur zbatimi i të së drejtës materiale.

Sipas dispozitës së nenit 106 të LMD-së, për kontratat dypalëshe kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e vet, pala tjetër mundet të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose ta zgjidhë kontratën. Sipas nenit 112 të LMD-së, kreditori i cili për shkak të mos përmbushjes së detyrimit të debitorit e zgjidh kontratën ka për detyrë që këtë t'ia komunikojë debitorit pa shtytje.

Gjykata e shkallës së parë e as ajo e shkallës së dytë nuk kanë dhënë përgjigje për kushtet e kontratës, se këto kushte a i referohen pa lejueshmërisë apo pamundësisë si në nenin 61 të LMD-së, ku parashihet se "Kushti i palejueshëm ose i pamundur 1. Është e pavlefshme kontrata në të cilën është vënë kushti shtyrës ose zgjidhës në kundërshtim me dispozitat urdhëruese, rendin publik ose moralin e shoqërisë. 2. Kontrata e lidhur nën kusht të pamundshëm shtyrës është e pavlefshme, ndërsa kushti i pamundshëm zgjidhës konsiderohet i paqenë".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Ekonomik, IV.E.K.nr.202/19, të datës 08.02.2021, gjykata e shkallës së parë, ka vendosur në pikën I të dispozitivit, miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses R. shpk me seli në P., ashtu që detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, që t'ia paguaj paditëses shumën e tërësishme prej 887,592,47€, dhe atë në emër të kompensimit të borxhit të mbetur e të papaguar, për punët e kryera në shumën prej 50,000.00€, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar si pasoj e mos aktivizimit të makinerisë dhe

materialeve tjera, duke përfshirë edhe fuqinë punëtore, t'ia paguaj shumën prej 658,664.68€, në emër të fitimit të humbur, t'ia paguaj shumën prej 178,927.79€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej datës së parashtrimit të padisë më 12.04.2019, e deri në pagesën definitive. Në pikën II Secila palë në këtë kontest gjyqësor do ti paguaj shpenzimet e veta procedurale.

2. Gjykata Komerciale e Kosovës, - Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vendosur sipas ankesës, me aktgjykimin e vet K.DH.SH.II.861/2022 të datës 06.07.2023, në pikën I të dispozitivit kishte aprovuar pjesërisht ankesën e të paditurës Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, kishte ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.nr.202/19, të datës 08.02.2021, dhe gjykohet si në pikën II të dispozitivit ku miratohet si e bazuar kërkesëpapia e paditëses R. shpk me seli në P., ashtu që detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, që t'ia paguaj paditëses shumën e tërësishme prej 813,039.50€, dhe atë në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar si pasoj e mos aktivizimit të makinerisë dhe materialeve tjera, duke përfshirë edhe fuqinë punëtore, t'ia paguaj shumën prej 658,664.68€, në emër të fitimit të humbur, t'ia paguaj shumën prej 154,374.82€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej datës së parashtrimit të padisë më 12.04.2019, e deri në pagesën definitive. Në pikën III refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër kërkesëpadiisë së paditëses R. shpk me seli në P., e precizuar me parashtrësën e datës 08.01.2021, ashtu që të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, që t'ia paguaj paditëses shumën prej 74,551.97€, dhe atë: në emër të kompensimit të borxhit të mbetur të papaguar për punët e kryera në shumën prej 50,000.00€, dhe në emër të fitimit të humbur t'ia paguaj shumën prej 24,551.97€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej datës së parashtrimit të padisë, më datë 12.04.2019, e deri në pagesën definitive. Në pikën IV Secila palë në këtë kontest gjyqësor do ti paguaj shpenzimet e veta procedurale.
3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, i autorizuari i të paditurës, Shoqata e Avokatëve S.Q., nga P., me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni i të paditurës si i bazuar, ndërsa të prishet në tërësi aktgjykimi gjykatës së shkallës së dytë dhe çështja ti kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, gjykatës së shkallës së parë.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 215 duke shqyrtuar ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur, gjeti se: Revizioni i të paditurës është i bazuar.
5. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, më datën 12.04.2019, ka paraqitur padi në gjykatën e së shkallës së parë, kundër të paditurës, për shkak të borxhit, dëmit të shkaktuar dhe fitimit të humbur. Ndër të tjera në padi dhe gjatë seancave gjyqësore, paditësja ka theksuar se më datën 29.07.2016, palët kanë lidhur kontratën me titull "Ndërtimi i Urave, në pjesën perëndimore të Unazës Qendrore", me çmimin total prej 1,969.163.08€. Afati kohor për përfundimin e punimeve ishte maksimumi 180 ditë, nga dita e cekur në planin e menaxhimit të kontratës dhe lejes për fillimin e punimeve nga zyrtari përgjegjës i prokurimit. Nga dispozitat e Kontratës së lartcekur, neni 4.1, Komunikimet, përcaktohet se të gjitha komunikimet me shkrim, që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit kontraktues nga njëra anë dhe kontraktuesit në anën tjetër do të pranohen nëse janë bërë në formë të shkruar me dorëzim, faks, e-mail. Kontraktuesit nga ana tjetër, duhet të cekin Titullin e kontratës, numrin e identifikimit të saj, dhe duhet të dërgohen me postë, faks e-mail, ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për autoritetin kontraktues mund ti adresohen autoritetit kontraktues ose menaxherit të projektit. Është kërkuar nga e paditura që të krijohen kushtet dhe hapësirat e punëve që është obligim i të paditurës si: dislokimi i objektit të Doganës, si dhe i binarëve të hekurudhës, tarifës dhe kabllave elektrike, etj, e të cilat janë raportuar vazhdimisht te e paditura, duke kërkuar evitimin e tyre edhe përkundër premtimeve, nuk janë evituar këto pengesa.
6. Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka dhënë shpjegime faktike dhe juridike, fillimisht duke konstatuar gjendjen faktike që rrjedhin obligimet kontraktuese mes palëve ndërgjyqëse, sipas Kontratës së lidhur. Gjykata referohet në obligimet që parashihen me nenin 17 pika (g), neni 30 pika 2 te Kushtet e përgjithshme të kontratës, që kanë të bëjnë me kompensimin në rast të pengesave për kryerjen e aktiviteteve ekonomike, të cilat nuk janë për shkak të jo profesionalizimit të kontraktuesit, njihjen e shpenzimeve me rastin e pezullimit të punimeve që i bart kontraktuesi.

7. Më tej paraqiten kronologjikisht veprimet – korrespondencat në mënyrë elektronike të mbajtura, ku paditësja e njofton të paditurën për punimet e kryera në vazhdimësi, menaxherin e projektit të caktuar nga e paditura H.F., pastaj për pengesat ne hapësirat e kryerjes së punëve për shkak të mos dislokimit të objektit të Doganës, dhe dislokimit të binarëve nga e paditura. E paditura kërkon nga paditësja si punë kryes-operator ekonomik ndërprejten e punimeve sipas kontratës deri sa të krijohen kushtet për punë, në mënjanimin e pengesave-dislokimin e objektit të Doganës dhe Binarët e hekurudhave, ndërsa objekti duhet të mirëmbahet dhe të merren masat e sigurisë në objekt derisa të krijohen kushtet për punë. Paditësja e informon të paditurën, përmes Raportit për humbjen financiare, se me zvarritjen e punimeve dhe pengesat për implementimin e projektit, kompanisë po i shkaktohen humbje financiare, për importimin e materialeve të parapara me kontratë me kosto të lartë financiare, numrin e punëtorëve të angazhuar në pritje, kompanitë konsulentë vendore dhe ndërkombëtare, amortizimi i elementeve ndaj qiramarrësve, humbje për pagesat e resurseve njerëzore, dhe duke qenë se janë aktiv në kantier-objekt, kompania ka dëme si: amortizimi i pahive (mbajta peng), amortizimi i skelave, amortizimi i makinerisë së rëndë, furnizimi me material specifik, etj. Paditësja kërkon nga e paditura evitimin e pengesave në realizimin e punëve për shkak të Trafos ekzistuese, për Urën e shkurt L=74m2, segmenti Lakrishte – Xhamia e Llapit, pengimi në fillimin e punëve të themeleve të shtyllave “Ura e gjatë” L=194m2, për shkak se ura kalon mbi vijën hekurudhore Prishtinë – Fushë Kosovë. Për shkak të mos zgjidhjes së këtyre problemeve të projektit, paditësja më datën 08.02.2019, e njofton autoritetin kontraktues, se janë të obliguar të ndërprejten marrëveshjet me bashkëpunëtorët e jashtëm, furnizuesit, stafin e inxhinierin e jashtëm, zvogëlimin e numrit të punëtorëve, ç ‘bllokimin e makinerisë, personelit, materialet tjera.
8. Gjykata konstaton se nga provat e shqyrtuara, deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, mendimet e konstatimet e ekspertëve të angazhuar në këtë çështje kontestuese, ekspertit të ndërtimitarisë, dhe dy ekspertëve financiar, deklaratës së dëshmitarit, komunikimet elektronike, fajtor për pengesat e lartcekura, si dhe ndërprejten e punëve, si dhe shkaktimit të dëmit, të konstatuar nga ekspertët, është bërë me fajin e të paditurës, pasi që në këtë rast ekziston lidhja kauzale në mes fajit dhe dëmit të shkaktuar nga pala e paditur Komuna e Prishtinës. Andaj gjykata ka miratuar kërkesëpadinë e paditëses si të

bazuar. Gjykata vendimin e mbështet në nenin 4, 8, 137, 173 të LMD-së, në këtë rast e paditura Komuna e Prishtinës nuk ka përmbush detyrimin e vet, ose është vonuar në përmbushjen e tyre, dhe kreditori në këtë rast paditësi ka të drejt edhe në shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak. Të gjitha dëmet e shkaktuara nga e paditura për shkak neglizhencës dhe jo azhuritetit të palës së paditur Komuna e Prishtinë, për eliminimin e pengesave para se të fillojnë punimet gjegjësisht para se të shpallet tenderi për ndërtimin e “Urave”, këto dëme i janë shkaktuar palës paditëse, pasi që disa herë është dashur të ndërprejë punët për “Urën e parë”, pastaj punëve të paparapara dhe punëve shtesë, ndërsa për “Urën e dytë”, as që ka pas mundësi për fillimin e punimeve edhe pse i ka bërë të gjitha përgatitjet si në materiale, makineri, resurse njerëzore. Gjykata konstaton se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar në ligj, dhe atë në kërkesën për kompensimin e borxhit për shkak të mos pagesës për punët e kryera, dëmit nga ndërprerjet e punëve (dëmit real), ashtu edhe kërkesën për kompensimin e fitimit të munguar. Gjykata konstatoi se precizimi i kërkesëpadisë së paditëses me parashtrësën e datës 08.01.2021, është në përputhje me vlerat e dëmeve të konstatuara nga ekspertiza e ndërtimtarisë, ekspertiza financiare, e më konkretisht në ekspertizën e ekspertit financiar, gjykata e ka miratuar padinë dhe kërkesëpadinë si të bazuar në nenin 4,8.1, 137 dhe 173 të LMD-së lidhur me krijimin e raporteve detyrimore, përmbushjen e tyre, krijimin e dëmit dhe kompensimin e tij.

9. Dhoma e shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, duke vendosur sipas ankesës, e aprovon pjesërisht vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, duke marrë për bazë pretendimet ankimore të paditurës, dhe gjendjen faktike të konstatuar nga administrimi i provave në gjykatën e shkallës së parë, konstatoi se ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar dhe vendosi ta ndryshoj aktgjykimin ankimor në pjesën që ka të bëjë me fitimin e humbur. Dhoma e shkallës së dytë, i pranoi si të drejta pretendimet ankimore në ankesë të paditurës, e cila thekson se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejt dhe saktë provat e administruara, përkritazi me vlerën e gjykuar për fitimin e humbur, dhe kompensimin e borxhit për punët e kryera e të pa paguara. Këto pretendime ankimore, Dhoma e shkallës së dytë i aprovoi si të bazuara, sepse aktgjykimi i atakuar në këto vlerësime të kompenzimit të borxhit të mbetur e të papaguar si dhe pjesërisht te vlera e fitimit të humbur, është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183 dhe 184 të LPK-së.

10. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës respektivisht nga provat e administruara, edhe pse gjykata e shkallës së parë, ia fali besimin ekspertizës të datës 13.11.2020 të punuar nga eksperti gjyqësor R.B., Dhoma e shkallës së dytë nuk e pranon në tërësi një vlerësim të tillë të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, sepse në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, nuk është përfshirë fare plotësimi i ekspertizës financiare nga i njëjti ekspert, i deklaruar në seancën gjyqësore të datës 08.01.2021, në raport me ballafaqimin me përfaqësuesin e palës së paditur, i cili sqaron konkretisht se nëse zbritet shuma e kontratës së datës 27.07.2020 prej 149,707.15€, nga shuma e mbetur me kontratën e mëparshme 1.091.023.15€, për shumën, rezulton diferenca prej 941,316.00€ mbi të cilën duhet llogaritur fitimi i humbur. Nëse bëhet llogaritja e fitimit të humbur si pjesë e shumë së kontratës së datës 27.07.2020, prej 149,707.5€, duke i përdor kriteret e parapara, e përlllogaritjes si në tabelën përkatëse në faqen 15 të ekspertizës me aplikimin e marzhës prej 16.4%, rezulton se fitimi do të ishte 24,551.97€. Ndërkaq po që se e zbresim shumën e fitimit të humbur të përlllogaritur si në faqen 15 prej 178.927.79€, rezulton se fitimi i humbur mbetet 154,374,82euro.
11. Dhoma e shkallës së dytë, nga provat që i ka administruar gjykata e shkallës së parë, vlerësoi se shuma e vlerësimit të fitimit të humbur që ndërlidhet me punët e kryera pa porosi, është e përfshirë në Kontratën e datës 27.07.2020 e lidhur mes dy palëve ndërgjyqëse, me titullin e njëjtë “ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të Unazës Qendrore - punë të paparapara, në vlerën prej 149,707.15€. Duke marrë për bazë këtë Kontratë të datës 27.07.2020 e lidhur mes palëve për punët e paparapara, ku pagesa do ti bëhet kontraktorit-paditësja në momentin kur i njëjti të tërheq kabllot e parandejës (mbajtëse në urën e gjatë dhe atë të përfunduar), dhe deklaratën e dëshmitarit H.F, menaxher i projektit i caktuar nga e paditura Komuna e Prishtinës, sipas të cilit kontrata nuk është ndërpre, ndërsa operatori ekonomik ka kërkuar kompensim për punët e paparapara, që do të thotë se punët e paparapara nuk janë në kontratën bazë dhe kontrata e datës 27.07.2020 lidhet me kontratën bazë, Dhoma e shkallës së dytë, vlerësoi ndryshe gjendjen faktike nga shkresat e lëndës (neni 201 pika (b) të LPK-së), dhe si rezultat i kësaj gjendje faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar nga gjykata e shkallës së parë, është aplikuar gabimisht edhe e drejta materiale nga gjykata e shkallës së parë, e cila me aktgjykimin e atakuar, në mënyrë të gabuar ka obliguar palën e paditur t’ia paguaj paditëses shumën prej 74,551.97€, dhe atë: në emër të kompensimit të borxhit të mbetur

të papaguar për punët e kryera në shumën prej 50,000.00€, dhe në emër të fitimit të humbur t'ia paguaj shumën prej 24,551.97€, prandaj Dhoma e shkallës së dytë vendosi ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

12. Sa i përket pretendimeve tjera ankimore te paditurës, lidhur me pjesën tjetër të aktgjykimin të atakuar, se është i përfshirë me shkelje të dispozitës së nenit 182 par. n) të LPK-së, dhe se kërkesa e paditëses për kompensimin e dëmit për makinerinë në pritje, është e pabazuar, Dhoma e shkallës së dytë nuk i vlerësoi se të njëjtat janë të argumentuara, të mbështetura në provat e lëndës, si dhe në pajtim me dispozita ligjore. Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, vlerësoi se dispozitivi i aktgjykimin është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimin dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 4 dhe 8 të LMD-së që parasheh e marrëdhëniet e detyrimeve dhe në ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto marrëdhënie.
13. Gjithashtu Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë është referuar me të drejtë në dispozitat e nenit 137 dhe 173 të LMD-së, që parashohin: -Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material),-I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur.
14. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës respektivisht nga provat e administruara dhe të siguruar edhe përmes ekspertizës nga lëmia e ndërtimtarisë të datës 03.07.2020, si dhe dy ekspertizave financiare të datës 13.07.2020, dhe 13.11.2020, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka nxjerr konstatimin që gjenë edhe mbështetje ligjore, se ndërprerja e punimeve sipas Kontratës me titull “Ndërtimi i Urave, në pjesën perëndimore të Unazës Qendrore”, është bërë nga ana e kontraktuesit-paditëses, për shkak të mos zgjedhjes së problemeve pronësore juridike të pjesës së Urës (U1) të majtë në perëndim të Unazës qarkulluese në Prishtinë, nga ana e të paditurës, dhe problemit tjetër e një pjese të Urës së majtë (U1) e cila sipas projektit

kryesor depërton në varrezat e ortodoksëve në lagjen Dragodan të Prishtinës, e i cili problem është dashur të zgjidhet para fillimit të ndërtimit të kësaj Ure. Në ndërtimin e Urës së djathtë (U1) me gjatësi prej $L_2=64m^2$, ka pasur pengesa të vazhdueshme në ndërtimin e saj siç ka qenë dislokimi i objektit të Administratës së Doganës së Kosovës, pastaj Objekti i Trafos së KEDSI-it. Për shkak të këtyre pengesave përgjegjës për mos zbatimin e kushteve kontraktuese, është e paditura Komuna e Prishtinës, ku sipas evidencave të nxjerra nga eksperti i ndërtimtarisë dhe të financave, vonesat për kryerjen e Urës së djathtë (U2) deri kur janë larguar objektet ekzistuese nga vendi i ndërtimit, janë gjithsejtë 169 ditë pune.

15. Prandaj Dhoma e shkallës së dytë nuk i aprovoi pretendimet ankimore sa i përket gjyqimit të pjesës së kërkesëpadisë në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar, për shkak të mos aktivizimit të makinerisë dhe materialeve tjera duke përfshirë edhe fuqinë punëtore. Kolegji vlerësoi se nuk është kontestuese se paditësja vazhdimisht e njofton të paditurën edhe përmes raportit për humbje financiare më datën 13.03.2018, për shkak të mos krijimit të kushteve për vazhdimin dhe përfundimin e punimeve kontraktuese, pastaj me importimin e materialeve të parapara në Kontratë, të cilat kanë një kosto të lartë financiare, ka një numër të lartë të punëtorëve, të angazhuar, si dhe kompanitë konsulente vendore dhe ndërkombëtare. Prandaj duke marrë për bazë dëmet e shkaktuara si pasojë e mos aktivizimit të makinerisë dhe materialeve tjera përfshirë fuqinë punëtore, për ditët e pritjes në punishte prej 169 ditë pune, duke qenë në dijeni të plotë e paditura, e cila më datën 07 nëntor 2017 përmes njoftimit me shkrim, kërkon nga paditësja që deri sa të krijohen kushtet për vazhdimin e punimeve sipas kontratës, objekti duhet të mirëmbahet dhe të merren masat e sigurisë në objekt, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë vlerësoi se ekziston baza ligjore e kompensimit të dëmit të shkaktuar dhe fitimi i humbur, i përlogaritur përmes ekspertizës financiare dhe plotësimit të ekspertit financiar në seancën gjyqësore datë 08.01.2021. Në rastin konkret kjo gjykatë vlerëson se pa mëdyshje është vërtetuar se në këtë raport kontraktues mes palëve ndërgjyëse, e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e vet, ose është vonuar në përmbushjen e tyre, dhe mbi bazën e këtyre veprimeve është krijuar baza ligjore e shkaktimit të dëmit dhe fitimit të humbur, ku paditësja gëzon të drejtat ligjore në shpërblimin e dëmit dhe fitimit të humbur, në vështrim të dispozitave të nenit 137 dhe 173 të LMD-së.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimi në pjesën e goditur me revizion, është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së, dhe me shkelje thelbësore të parashikuara me nenin 194 të LPK-së, ndërsa të dy aktgjykimet janë nxjerrë edhe me aplikim të gabuar të drejtës materiale, për të cilin shkak të dy aktgjykimet detyrimisht duhet të prishen në pjesën e atakuar, duke vepruar sipas revizionit të paditurës.
2. Gjykata Supreme duke vlerësuar shkresat e lëndës, ka arritur në përfundim se aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë janë nxjerrë me shkeljet thelbësore të lartpërmendura të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se gjykata e shkallës së dytë, në vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit, nuk ka dhënë arsye sa i përket vendosjes, dhe për cilat arsye gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar. Në rastin konkret arsyet e dhëna sa i përket bazës ligjore të kërkesëpadisë, janë jo të plota, të pa arsyetuara, se pse gjykata ka ardhur në këtë përfundim, madje arsyet e dhëna janë kontradiktore me shkresat e lëndës. Gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e atakuar, nuk është përgjigjur në pretendimet e ankimore të paditurës, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është një grumbull informatash të pa sistemuara, përshkrim i të gjitha veprimeve procedurale të ndërmarra para gjykatës së shkallës së parë, dhe pa arsye të vendosjes si në dispozitiv dhe në arsyetimin e vet, nuk ka shpjeguar arsyet e vendimmarrjes të shkallës së parë dhe nuk ka adresuar pretendimet ankimore duke vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 204-të LPK-së i cili parashihet se " Në arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht të aktvendimit, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësishme vendimtare për dhënien e vendimit të saj".
3. Për këtë arsye edhe aktgjykimi i shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së. Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se nuk janë sqaruar deri në fund së paku disa nga pretendimet e përmendura në revizion e që gjitha këto ishin edhe pretendime ankimore të cilave gjykata e shkallës së dytë nuk iu ka dhënë përgjigje.

4. Gjykata Supreme po ashtu vlerëson se përfundimet e gjykatës së shkallës së dytë, dhe të parë, janë të gabuara sa i përket aplikimit të drejtës materiale, respektivisht dispozitave të nenit 106 të LMD-së, dhe përfundimi se për kontratat dypalëshe kur njëra palë nuk e përbush detyrimin e vet, pala tjetër mundet të kërkojë përbushjen e detyrimit ose ta zgjidhë kontratën, nenit 112 të LMD-së, kreditori i cili për shkak të mos përbushjes së detyrimit të debitorit e zgjidh kontratën ka për detyrë që këtë t'ia komunikojë debitorit pa shtytje, nenit 113 i LMD-së, i cili parasheh se: "kontrata nuk mund të zgjidhet për shkak të mos përbushjes së pjesës së parëndësishme të detyrimit", kjo për faktin se arsyet e dhëna për aplikimin e këtyre dispozitave janë në kundërshtim me vetë shkresat e lëndës.

5. Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se kontrata ndërmjet palëve ishte e lidhur më 29.07.2016. Kontrata përcakton obligimet e palëve si objektin e punës, çmimin, kohën e kryerjes, kushtet e veçanta të kontratës të detajuara. Në nenin 11.1 parashihet se kontraktuesit mund të kërkojnë zgjatje të periudhës për ekzekutim vetëm për këto arsye:
a) autoriteti kontraktues dështon ti kryej obligimet e veta sipas kontratës dhe forca madhore siç përshkruhet në nenin 30.1 dhe 30.2. Gjykata e shkallës së parë nuk e sqaron fare se priti ja dhe vonesat a janë bërë në marrëveshje në mes palëve apo vetëm si vonesë e të paditurës për mënjanimin e pengesave që kanë qenë kushte të kontratës.

6. Për më tepër lidhur me kushtet të cilat janë paraqitur si pengesë, mënjanimi i ndërtesës së doganave, heqja e një pjese të hekurudhës Prishtinë Fushë Kosovë, heqja e trafaostacionit të KEK-KEDS dhe varrezat ortodokse dhe katolike të cilat janë dalë si pengesë, gjykata e shkallës së parë e as ajo e shkallës së dytë nuk kanë dhënë përgjigje se këto kushte a i referohen pa lejueshmërisë apo pamundësisë si në nenin 61 të LMD-së, ku parashihet se "*Kushti i palejueshëm ose i pamundur 1. Është e pavlefshme kontrata në të cilën është vënë kushti shtyrës ose zgjidhës në kundërshtim me dispozitat urdhëruese, rendin publik ose moralin e shoqërisë. 2. Kontrata e lidhur nën kusht të pamundshëm shtyrës është e pavlefshme, ndërsa kushti i pamundshëm zgjidhës konsiderohet i paqenë*". Kjo për faktin se këto kushte nuk varen nga vullneti vetëm i palës së paditur për mënjanim, por involvon autoritetet tjera të qeverisë qendrore dhe komuniteteve fetare, për të cilat në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi të marrjes së lejes apo dhënies së pëlqimit, pavarësisht faktit se në neni 17 pika d) e kushteve të kontratës

parashihet se kompensimi do të kërkohet për vonesat që shkaktohen nga kontraktuesit tjetër, autoritetet publike, shërbimet komunale ose vetë autoriteti kontraktues dhe pika g) kur kontraktuesi has në pengesa që nuk janë me faj apo jo profesionalizëm të punë kryesit.

7. Nga korrespondenca në shkresat e lëndës del se më 24.10.2016 konstatohet se e paditura është e kënaqur me tempin dhe kualitetin e punëve dhe se lejet për rrënimin e objekteve pengesë janë siguruar. Me 14.03.2017 paditësja e njofton të paditurën se po pëson humbje financiare dhe e paditura më datën 07.04.2017 e refuzon mundësinë e rishikimit të humbjeve financiare të paditëses. Më 01.04.2019 R. Shpk e njofton autoritetin kontraktues se pas dështimit të zgjidhjes së kontratës me marrëveshje do të inicioi procedurë në gjykatë Padia paraqitet në gjykatë me 12.04.2019. E paditura e kundërshton në tërësi me përgjigje dhe deklaron se nuk ka prova që argumentojnë bazën juridike dhe fajin e të paditurës.

8. Gjykata cakton ekspertizë ndërtimore dhe vlerësim se sa punë janë kryer nga S.B. Konstatohet se janë kryer punë në vlerë prej 878,139.93€ Janë paguar punë në vlerë prej 828.139.73€. Kanë mbetur të pa paguara 50.000.00€. Nga ekspertiza financiare të ekspertit R.F. del se paditësja ka mbajtur të bllokuar pajisje dhe makineri si 2 kamiona vetëshkarkues në peshë të rënda, 1 ekskavator, vemza, 1 ekskavator me goma, 1 auto vinq, 1 kamion mikser për transport betoni, 1 auto pompë për beton. Ndërprerje për 169 ditë pune ose 1352 orë pune, duke llogaritur çmimin e orës së punës konstaton se janë krijuar humbje prej 654,570.80 plus 44,616.00€ të makinerisë në pritje. Fitimi i humbur për 1,091,023.16€ punë të pakryera i llogaritur me shkallën 24% në shumë prej 261,845.55€ të minusuar për TVSH dhe tatim të fitimit të korporatave mbeten 188,528.81€. Me kërkesën e të paditurës gjykata cakton ekspert tjetër financiar R.B., i cili gjanë se dëmi i shkaktuar si pasojë e mos aktivizimit të makinerisë është 658,664.68, punë e kryer e pa paguar 50,000.00€, fitim i humbur sikur të realizohej kontrata në pjesën e mbetur 1,091,023.15€ shkalla e fitimit 16.40% që i bie 178,927.79€. Realisht sipas shkresave të lëndës mosmarrëveshja për shtyrje ka lindur më 13.03.2018 kur të paditurës i dërgohet kërkesa për kompensim të dëmit të shkaktuar si pasojë e pritjes. Në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se asnjëra nga palët të kenë kërkuar shkëputjen e kontratës.

9. Për Gjykatën Supreme të Kosovës mbetet e pa qartë se shtyrjet e kryerjes së punëve a janë bërë në pajtim me nenin 11.1 të kontratës ku parashihet se kontraktuesit mund të kërkojnë zgjatje të periudhës për ekzekutim. Për sa i përket kushteve të ekzekutimit të kontratës siç është mënjanimi i pengesave, heqja e ndërtesës së Doganave, heqja e Trafostacionit, një pjese të hekurudhës dhe rrethojave të varrezave ortodokse dhe katolike, gjykata nuk i ka vlerësuar në kuptim të dispozitave të nenit 61 të LMD-së se kushtet e kontratës a janë të palejueshme ose të pamundura, duke ditur faktin se ekzekutimi i këtyre kushteve dhe mënjanimi i pengesave nuk është varur vetëm nga e paditura por ka involvuar edhe subjekt të tjerë në pronësinë dhe përgjegjësinë e të cilave kanë qenë këto objekte. Të paqarta mbeten marrëveshjet mes palëve për kapacitetet e mbajtura në vend punishte si për makinerinë ashtu edhe për resurset njerëzore. Në vend punishtet e kontraktuara a kanë qenë të domosdoshme të qëndrojnë dhe a janë angazhuar në ndërkohë në ndonjë vend tjetër pune. Në ekspertizë përmenden periudhat kohorë kur "është punuar me kapacitet jo të plotë" dhe periudhat kur nuk është punuar fare" dhe nuk theksohet se a është zvogëluar dëmi për pjesën e aktivizuar dhe se sa ka qenë e nevojshme që këto resurse të mbahen në vend punishte. Është e paimagjinueshme se si me aktvendimin e datës 12.03.2020 dhe atë të datës 09.09.2020 gjykata e shkallës së parë cakton ekspertët përkatës por nuk ua përcakton detyrat që duhet ti kryejnë dhe përgjigjet që duhet dhënë me ekspertizë për të përcaktuar dëmin.
10. Duke u nisur nga fakti se në marrëdhëniet kontraktuale vullneti i palëve është element i qenësorë, gjykata e shkallës së parë nuk jep përgjigje perse nuk është kërkuar shkëputja e kontratës në një periudhë kohore prej 24.06.2016 deri më 01.04.2019, sepse sipas dispozitës së nenit 106 të LMD-së, për kontratat dypalëshe kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e vet, pala tjetër mundet të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose ta zgjidhë kontratën. Sipas nenit 112 të LMD-së, kreditori i cili për shkak të mos përmbushjes së detyrimit të debitorit e zgjidh kontratën ka për detyrë që këtë t'ia komunikojë debitorit pa shtyrje. Në pjesën e III të kontratës, në kushtet e veçanta në pikën 26.4, parashihet se përpos rrethanave të parapara kontrata mund të ndërpritet edhe në rast të paraqitjes së kontesteve pronësore dhe pamundësisë së zgjedhjes së tyre dhe se palët janë pajtuar se në rastet e tilla nuk do të kenë pretendime tjera. Nuk ka prova se paditësja ka bërë përpjekje që të zvogëloi humbjet dhe dëmin me angazhimin e resurseve teknike dhe njerëzore.

11. Edhe tek pjesa e fitimit të humbur nuk është vërtetuar gjendja faktike për sa i përket pjesë së punëve shtesë, pjesës së punëve të kryera dhe të pa paguara, mënyrës së si ka ardhur deri tek baza e llogaritjes në shkallë prej 16.4% për pjesën e punëve të pa kryera, të cilat po të kryheshin paditësja do të përfitonte nga kjo. Nuk jepen sqarime se mbi cilën bazë i dëmtuari ka të drejtë për shpërblimin e dëmit të rëndomtë si pasojë e mos aktivizimit të makinerisë dhe njerëzve, e në të njëjtën kohë po ashtu edhe të kërkoj shpërblimin e fitimit të humbur, të cilin do ta realizonte sikur të punonte sipas kontratës.
12. Duke u bazuar në këto paqartësi të gjendjes faktike, të cilat determinojnë zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që çështja ti kthehet Gjykatës Komerciale në shkallë të parë, për rigjykim, për faktin se e drejta materiale nga gjykata e shkallës së parë dhe të dytë është aplikuar mbi gjendjen faktike të pa vërtetuar në mënyrë të plotë, dhe nuk ekzistojnë kushtet që aktgjykimi të ndryshohet, për të cilën arsye është dashur që aktgjykimi i shkallës së dytë dhe të parë të prishen.
13. Në ri procedurë nga gjykata e shkallës së parë duhet të eliminohen të metat e lartë cekura, në atë mënyrë që të sqarohet se i dëmtuari a ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë si pasojë e mos aktivizimit të makinerisë dhe njerëzve, e në të njëjtën kohë po ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur; a janë bërë ndërprerjet me marrëveshje në kuptim të nenit 11.1 të kontratës, a kanë qenë kushtet e eliminimit të pengesave në ekzekutimin e kontratës si të lejueshme e të mundshme në kuptim të nenit 61 të LMD-së, ti ipen detyrat e detajuara ekspertit financiar, të kërkohet plotësim dhe sqarim i ekspertizës, ashtu që e njëjta të plotësohet dhe të japë sqarim për çështjet e ngritura nga pala e paditur, si dhe çështjet e ngritura në arsyet e dhëna në këtë aktvendim, ashtu që ekspertiza duhet të përmbajë arsye të plota për përfundimet e saj, po ashtu gjykata të marrë parasysh pretendimet e palëve gjatë procedurës, provat në shkresat e lëndës, të vlerësohen një nga një dhe të ndërlihdura në mes vete, ashtu që të krijohen kushtet që gjykata të vendos lidhur me kërkesëpadinë. Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim t'i mënjanojë të metat e lartpërmendura, duke i pasur parasysh edhe thëniet e tjera të ankesës dhe revizionit, ashtu që të trajtoj dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e palëve të parashtuara gjatë procesit gjyqësor. Ashtu që me rastin e vendosjes, të mund të vendoset pas vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, përmes administrimit të provave, dhe gjykata e shkallës së parë me rastin e përpilimit të aktgjykimit duhet të ketë kujdes që i njëjti të jetë në përputhje me nenin 160 të LPK-

së, ashtu që vendimi të jetë i ligjshëm, dhe të përmbajë arsye për faktet vendimtare të vendosjes dhe të mund të arrijë në përfundime të drejta dhe objektive lidhur me zgjidhjen e çështjes që është objekt shqyrtimi.

14. Mbi këtë bazë ligjore dhe gjendje faktike, në pajtim me nenin 224.2, të LPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës, vendosi që ta aprovoi ankesën e të paditurës, të prish aktgjykimet e instancave më të ulta dhe çështjen ta kthej në rigjykim, në shkallën e parë.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

CN.nr.38/2023, i datës 13.12.2023

"Divizioni Fiskal i cili tani është me Gjykatën Komerciale, është përgjegjës për të gjykuar në shkallë të parë çdo vendim nga Departamenti i Ankesave në lidhje me taksat, detyrimet doganore dhe çdo kontribut tjetër të caktuar nga legjislacioni në fuqi. Ky juridiksion i mbulon tatimet dhe detyrimet në vijim: si tatimin mbi të ardhurat personale; tatimin mbi të ardhurat e korporatave; Ligjin e TVSH-së; detyrimet doganore; detyrimet e akcizës; tatimi mbi pronën e paluajtshme; si dhe çdo tatim ose kontribut tjetër të aplikuar në Kosovë".

Duke u bazuar në faktin se sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale NR. 08/L-015 konkretisht nenit 13 paragrafi 1.11 ku përcaktohet se "Të gjitha çështjet e përcaktuara në nënparagrafin 1.11 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti Fiskal i cili është bartur në Gjykatën Komerciale dhe në dispozitat kalimtare, në nenin 37 ku është bërë shfuqizimi i ligjeve të tjera që ndërliken me këtë ligj, me hyrjen në fuqi të këtij ligji nuk preken dispozitat e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatë kompetente lëndore për të vendosur në këtë çështje është Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal".

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, me aktvendimin e vet, A.nr.2132/2022, të datës 23.01.2023, është shpallur jo kompetente, në pikëpamje lëndore, për të gjykuar në këtë çështje dhe pas formës së prerë të aktvendimit të cekur më lartë, shkresat e lëndës i ka dërguar Gjykatën Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal.
2. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, me aktvendimin e vet, KF.nr.122/2023, të datës 19.11.2023, ka hapur konfliktin e kompetencës midis Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-

Divizioni Fiskal dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative.

3. Në rastin konkret paditësi si tatimpagues ka dhënë me qira ndërtesat për dy banka komerciale dhe mbi këtë bazë është ngarkuar me tatim dhe i njëjti i ka ezauruar të gjitha mjetet juridike në procedurë para të paditurës. Pastaj ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar rivlerësimin e vendimit të paditurës. Sipas kësaj gjyqate, paditësi nuk e gëzon cilësinë e ndonjë shoqërie tregtare por ka cilësinë e personit fizik dhe i njëjti nuk është i regjistruar si biznes në ARBK-ë. Sipas nenit 13 paragrafi 1.11 të Ligjit nr.08/L-019 për Gjykatën Komerciale shprehimisht është përcaktuar se Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së parë Departamenti Fiskal është kompetent për të vendosur për: "kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore". Me vështrim në nenin 13 pika 1.1. të Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, parashihet se përveç tjerash "Gjykata Komerciale ka juridiksion ekskluziv vetëm në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës bazuar në nenin 25.2 të LPK-s dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr. 08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.
2. Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të legjislacionit të aplikueshëm për këtë çështje, gjeti se në rastin konkret duhet respektuar dispozitat e posaçme të Ligjit nr. 04/l-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, konkretisht nenit 81. B, lidhur me juridiksionin ku parashihet se "Divizioni Fiskal është përgjegjës për të gjykuar në shkallë të parë çdo vendim nga Departamenti i Ankesave në lidhje me taksat, detyrimet doganore dhe çdo kontribut tjetër të caktuar nga legjislacioni në fuqi. Ky juridiksion i mbulon tatimet dhe detyrimet në vijim: 2.1.

tatimin mbi të ardhurat personale; 2.2. tatimin mbi të ardhurat e korporatave; 2.3. Ligjin e TVSH-së; 2.4. detyrimet doganore; 2.5. detyrimet e akcizës; 2.6. tatimi mbi pronën e paluajtshme; 2.7. çdo tatim ose kontribut tjetër të aplikuar në Kosovë".

3. Neni 81.C është paraparë se "Për çështjet që nuk rregullohen me këtë ligj në lidhje me përgjegjësitë dhe rregullat procedurale të gjykatave kompetente, Ligji mbi konfliktet administrative, plotësim dhe ndryshim i Ligjit 03/L-202 dhe çdo ligj tjetër në fuqi në Kosovë duhet të zbatohet. Në rast të kundërshtimeve të këtij ligji me ligjet tjera dispozitat që gjenden në këtë ligj duhet të mbizotërojnë".
4. Duke u bazuar në faktin se sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale NR. 08/L-015 konkretisht nenit 13 paragrafi 1.11 ku përcaktohet se "Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.11 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti Fiskal i cili është bartur në Gjykatën Komerciale dhe në dispozitat kalimtare, në nenin 37 ku është bërë shfuqizimi i ligjeve të tjera që ndërlidhen me këtë ligj, me hyrjen në fuqi të këtij ligji nuk preken dispozitat e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatë kompetente lëndore për të vendosur në këtë çështje është Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal.
5. Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr. 08/L-015 Për Gjykatën Komerciale, gjeti se për të vendosur për këtë çështje lënda i dorëzohet Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.211/2023, i datës 07.06.2023

”E paditura, familjes së të ndjerit ia ka paguar pjesën e të ardhurave personale në shumën prej 295.00€ në muaj, të cilën pagesë e ka emërtuar si pension mbi bazën e Statutit të Fondit Pensional, ndërsa pagesa është ndërprerë nga data 01.07.2006.

Gjykata Supreme vlerëson se nuk janë shqyrtuar provat relevante mbi të cilat do të vërtetohej se a ekziston detyrimi i të paditurës që paditësve të ju kompensoj dëmin në formë të rentës, për shkak të vdekjes së familjarit mbajtësit të tyre dhe a ka bazë ligjore në zbatim të neneve 173, 174, dhe 188 par.1 dhe 2, LMD-së, që paditësit të gëzojnë këtë të drejtë, për faktin se i ndjeri F.A. ka vdekur si pasojë e lëndimeve të pësuar nga fatkeqësia në punë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.628/2018 të datës 11.10.2018, në pikën I të dispozitivit, refuzohet si e pabazuar kërkesëpadija e paditësve Xh., V., R., B., I. dhe G. Ademi nga fshati M. - Komuna e V., me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës-Prishtinë, që paditësve në emër të dëmit material për shkak të vdekjes së bashkëshortit-babait me datë 28.11.1999, në vendin e punës, secilit veç e veç t'ia paguaj rentën si edhe shpenzimet e procedurës, e të gjitha kërkesat në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbartimit ligjor. Në pikën II ishte vendosur që shpenzimet e procedurës i bartë secila palë.
2. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësve, me aktgjykimin Ac.nr.835/2019, të datës 11.11.2022, ka vendosur që të refuzohet si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të paditësve Xh., V., R., B., I. dhe G. Ademi nga fshati M. - Komuna e V., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm. C.nr.627/18 i datës 11.10.2018, vërtetohet.
3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditësve, avokat N.M., nga Prishtina në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës,

të aprovoj në tërësi revizionin si të bazuar, ashtu që të prishë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

4. E paditura, në përgjigje në revizionin e palës paditëse, e ka kundërshtuar revizionin dhe ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që ta refuzoi të njëjtin si të pa bazuar.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në pajtim me nenin 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, dhe gjeti se: Revizioni i të autorizuarit të paditësve, është i themeltë.
6. Nga shkresat e lëndës del se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, më datë 02.12.2012. kundër të paditurës, kanë parashtruar padi për kompensimin e fitimit të munguar-rentës mujore. Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës përgatitore, ka hedhur si të pas afatshme padinë e paditësve me aktvendimin C.nr.262/12 të datës 30.04.2015, ndaj të cilit aktvendim i autorizuari i paditësve ka ushtruar ankesë. Gjykata e Apelit, me aktvendimin Ac.nr.3706/15, të datës 14.02.2018, ka pranuar ankesën si të bazuar dhe çështjen i ka kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. Gjykata, ka mbajtur seancën kryesore ku ka administruar këto prova: flete aplikacioni i fondit pensional të KEK-ut, i datës 27.02.2003, vërtetimi i punës dhe certifikata e vdekjes, vërtetimet e datës 19.06.2006, i datës 05.06.2001, vendimi i datës 25.07.2006, njoftimi i datës 31.08.2006 dhe certifikatat e lindjes për paditësit, në bazë të cilave ka vendosur se kërkesa është parashkruar dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 373, paragrafi 1 dhe 3. nenit 376 të LMD-së, ka vendosur sinë dispozitivin e aktgjykimin.
7. Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j). (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

8. Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke pasur parasysh faktin se vdekja dhe shkaktimi i saj mund të jenë faktor relevant nga aspekti juridik i rregullave të së drejtës detyrimore lidhur me shpërblimin e dëmit. Dispozita e nenit 194. paragrafi 1 të LMD-së, (lidhur me shpërblimin e dëmit material përkitazi me humbjen e ushqimisë të cilën e kanë marr të dëmtuarit deri në momentin e vdekjes së personit nga i cili e kanë marrë atë, përmban rregullat dhe afatet përkitazi me gjykimin e kësaj forme të dëmit material shkaktuar si pasojë e vdekjes së personit. Ndërsa me dispozitën e nenit 376 të LMD-së. është paraparë se: "kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhen për tre vjet, nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar dëmin, dhe se në rastin konkret, ky afat i parashkrimit është afat subjektiv, që përbëhet nga dy fakte dhe atë: nga fakti kur i dëmtuari kupton për dëmin dhe nga fakti kur i dëmtuari kupton-mëson për personin i cili e ka shkaktuar dëmin.
9. Sipas kësaj gjykate vërtetohet fakti se bashkëshorti-babai i paditësve F.A., më datën 28.11.1999, ka ndërruar jetë si pasojë e lëndimeve të marra në punë. Paditësit fillimisht në Gjykatën Komunale në Vushtrri, kanë ushtruar padi në vitin 2006. Sipas aktvendimit C.nr 537/06, të datës 20.02.2008, kjo gjykatë është shpallur jokompetente për vendosje në këtë çështje ndërsa ka hedh padinë në këtë çështje. Paditësit, padinë në bazë të cilës zhvillohet kjo procedurë gjyqësore, e kanë parashtruar më datën 14.02.2012, ndërsa të njëjtit kanë marrë dijani për dëmin që nga momenti i vdekjes me datën 28.11.1999, dhe se padinë në gjykatë e kanë parashtruar fillimisht në vitin 2006, e pastaj në vitin 2012, nga çka sipas kësaj gjykate, rezulton se kërkesa për kompensimin e fitimit të munguar- rentës është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën e nenit 376 të LMD-së. Afati i parashkrimit është koha e caktuar me ligj në bazë të cilit mund të kërkohet ndonjë e drejtë dhe se pas kalimit të këtij afati, e drejta e kërkesës nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore. Po ashtu, realizimi i pensionit suplementar në periudhe prej 60 muaj, përkatësisht deri me datën 01.07.2006, nuk ka ndikim në llogaritjen e afatit të parashkrimit (ndërprerjes), pasi që në pyetje është forma e posaçme e kompensimit të dëmit, për të cilin afati i parashkrimit duhet të llogaritet në kuptim të dispozitës së nenit 376 të LMD-së.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i goditur dhe ai i shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 n dhe i të LPK-së dhe me zbatim të gabuar të drejtës materiale.
2. Pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të themelta, për shkak se gjykatat e instancave më të ulëta nuk i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë por i mungon vendimmarrja për pjesën e kërkesëpadisë që lidhet me afatin e parashkrimit në lidhje me kohën e paraqitjes së padisë në Gjykatën Komunale të Vushtrrisë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë nuk përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare.
3. Në këtë kontekst me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozita ligjore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të qëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimeve të instancave më të ulëta.
4. Gjykata Supreme vlerëson se nuk janë shqyrtuar provat relevante mbi të cilat do të vërtetohej se a ekziston detyrimi i të paditurës që paditësve të ju kompensoj dëmin në formë të rentës, për shkak të vdekjes së familjarit mbajtësit të tyre dhe a ka bazë ligjore në zbatim të neneve 173, 174, dhe 188 par.1 dhe 2, LMD-së, që paditësit të gëzojnë këtë të drejtë, për faktin se i ndjeri F.A. ka vdekur si pasojë e lëndimeve të pësuar nga fatkeqësia në punë, e cila rrethanë nuk është kontestuar nga e paditura në asnjë fazë të procedurës.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë fazë dhe mbi këtë gjendje faktike, e vlerëson të gabuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë se kërkesëpadia e paditësve është e

parashkruar sipas dispozitave të nenit 376 paragrafin 2 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve. Në këtë rast, në mënyrë të pa kontestuar konstatohet se data e shkakimit të dëmit është data 28.11.1999, periudha e pagesës 5 vjeçare nga Fondi Pensional i të paditurës 01.07.2006. Sipas padisë së paraqitur në Gjykatën Komunale të Vushtrrisë, e cila mbanë numrin C.nr.537/2006, (nuk ka shënime të sakta se kur është paraqitur padia) me aktvendimin e vet C.nr.537/2006, të datës 20.02.2008, kjo gjykatë shpallet jo kompetente në pikëpamje territoriale dhe njëkohësisht e hedh padinë e paditësve dhe në arsyetim ka potencuar se kompetente territoriale për këtë çështje është Gjykata Komunale në Prishtinë. Pala paditëse deklaroi se ka pritur ftesën nga Gjykata e deleguar por nuk ka të dhëna se a është përcjell lënda sipas aktvendimit. Gjykata e shkallës së parë konstaton se padia është paraqitur jashtë afatit respektivisht në periudhën pas 5 (pesë) vite nga dita e kur është shkaktuar dëmi, ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës në mungesë të një gjendje faktike ende të pa vërtetuar nuk mund ta pranojë këtë qëndrim, pavarësisht se padia është paraqitur pas 5 (pesë) vite, nga data e shkakimit të dëmit.

6. Me dispozitën e nenit 376 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78, 39/85, 57/89), përcaktohet se: “Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për 3 vite nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”, ndërsa në par. 2, të njëjtit nen përcaktohet se: “sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për 5 vite nga data kur është krijuar dëmi”. Përveç dispozitave të cituara me dispozitën e nenit 373 par. 1, të LMD-së, përcaktohet se: “Vetë e drejta nga e cila realizohet kërkesa periodike parashkruhet për 5 vite, duke llogaritur nga rrjedha për pagesë e kërkesës më të vjetër të pa përmbushur pas së cilës debitori nuk ka kryer dhënien”, ndërsa në par. 2, të njëjtit nen përcaktohet se: “kur parashkruhet e drejta nga e cila rezultojnë kërkesat periodike, atëherë kreditori humb të drejtën, jo vetëm të kërkojë dhëniet e ardhshme periodike, por edhe dhëniet periodike që kanë rrjedhë për pagesë para këtij parashkrimi”.
7. Nga interpretimi i dispozitave të cituara, del qartë se kërkesa për kompensimin e dëmit parashkruhet për 3 (tre) vite, përfshirë edhe kërkesat periodike, dhe në çdo rast ajo parashkruhet në periudhën prej 5 (pesë) vite, për shkak të parashkrimit të së drejtës, mirëpo në rastin konkret vlerësimi dhe qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, në këtë çështje juridike kontestuese është a ka ndodhur parashkrimi i kërkesës, kjo për

shkak të rrethanave specifike (faktike dhe juridike) të rastit, të cilat ndikojnë në vlerësimin për rrjedhën, momentin e rrjedhjes, respektivisht ndërprerjes së parashkrimit.

8. Rrethanë specifike në këtë rast është se e paditura familjes së të ndjerit ia ka paguar pjesën e të ardhurave personale në shumën prej 295.00€ në muaj, të cilën pagesë e ka emërtuar si pension mbi bazën e Statutit të Fondit Pensional, ndërsa pagesa është ndërprerë nga data 01.07.2006. Në këtë rast me vet faktin se e paditura me vendimin e vet, u ka pranuar paditësve pensionin suplementar, nuk nënkupton se është konsumuar në tërësi çështja kontestuese, respektivisht nuk janë konsumuar në tërësi kërkesat ligjore të paditësve ndaj të paditurës, mirëpo është konsumuar vetëm mbajtja e humbur për periudhën deri me datë 30.06.2006, në qoftë se kërkesa e paditësve për mbajtjen e humbur për këtë periudhë nuk do të ishte më e lartë se vlera e pranuar si pension suplementar.

9. Gjykata e shkallës së parë e për rrjedhojë as ajo e shkallës së dytë nuk sqarojnë se a ka parashkrim të kërkesës apo parashkrimi i vetë të drejtës dhe i referohet situatave kur për kërkesat e palës paditëse që kanë lindur në momentin e shkakimit të dëmit, dhe në vijim nuk ka pasur asnjë kërkesë të parashtruar në gjykatë, asnjë marrëveshje dhe asnjë përmbushje të detyrimit. Në rastin konkret paditësit kanë marrë pjesën e të ardhurave në shumën prej 295.00€ në muaj, të cilën pagesë e paditura e ka emërtuar si pension mbi bazën e Statutit të Fondit Pensional deri më 30.06.2006 kur ka kaluar afati 5 vjeçar sipas vendimit të paditurës. Menjëherë pas ndërprerjes kanë parashtruar padi në Gjykatën Komunale të Vushtrrisë e cila e ka shpallur vetën jo kompetente dhe e ka hedhë padinë në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 18.2 të LPK-së ku parashihet se vetëm në rastet "Kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër, do të shpallet in kompetente, do t'i shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur". Gjykata Komunale e Vushtrrisë është deklaruar me mungesë të kompetencës territoriale e ka hedhë padinë në të njëjtën kohë dhe në arsyetim ka cekur se kompetencë territoriale për këtë çështje ka Gjykata Komunale e Prishtinës, por ky fakt nuk është vërtetuar se a është bartur lënda në gjykatën kompetente sipas aktvendimit të njëjtë. Nga shkresat e lëndës nuk mund të përcaktohet se a ka përfunduar procedura në Gjykatën e Vushtrrisë pasi që ndaj

aktvendimit të kësaj gjykate pala ka pas mundësi të ushtroi ankesë. Pra mungojnë të dhënat për veprimet e mëtejme të palëve dhe të gjykatës. Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se në rrethanat e pasqaruara të veprimeve apo mosveprimeve të Gjykatës nuk mund të pësoi pala paditëse dhe të konsiderohet se ky veprim i ushtrimit të padisë nuk është marrë për bazë nga gjykata e shkallës më të ulët kur është refuzuar kërkesëpadia si e parashkruar qysh në vitin 2006.

10. Për shkak të shkeljeve të tilla, çështja është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, e cila gjykatë fillimisht duhet të qartësoj mbi bazën e fakteve, se a ka përfunduar procedura në Gjykatën Komunale të Vushtrisë me veprime ose mos veprime të palëve apo me vendime të gjykatës të cilat janë objekt shqyrtimi i ligjshmërisë në procedurën sipas revizionit. Pasi të vërtetohen këto fakte gjykata e shkallës së parë do të vendos për parashkrimin ose jo të kërkesës, të shqyrtoi lejueshmërinë dhe bazueshmërinë e padisë dhe në dritën e kësaj të vlerësoi meritat.
11. Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron se në rastin konkret, gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë sqaruar mjaftueshëm faktin se a ka ndodhur parashkrimi i kërkesës së paditëseve pasi që padia është parashtruar në periudhën brenda 3 (tre) vitesh, pas datës 01.07.2006, kur ka pushuar zbatimin e vendimit të paditurës për pensionin suplementar dhe kur kanë arritur kërkesat periodike të cilat nuk janë konsumuar me vendimin për pensionin suplementar. Kryerja e veprimeve të mësipërme dhe veprimeve të tjera që eventualisht mund të dalin gjatë rigjyimit, do ta lejojnë gjykatën e shkallës së parë që në përputhje me kërkesat e ligjit procedural dhe material, të mund të arrijë në përfundime më të drejta dhe objektive lidhur me zgjidhjen e çështjes që është objekt shqyrtimi.
12. Përfundimisht Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se për shkak të zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale dhe për shkak të shkeljeve të rregullave procedurale, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjyimit të goditur, prandaj e aprovon revizionin dhe e anulon tërësisht aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë, dhe çështjen ia dërgon për rigjykim gjykatës të shkallës së parë.
13. Gjykata Supreme e Kosovës, në pajtim me nenin 224.2 të LPK-së, i anuloi të dy aktgjykimet e instancave më të ulta dhe çështjen e kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.390/2023, i datës 01.11.2023

"I padituri nuk ka për detyrim që paditësit t'ia kompensoj dëmin mbi bazën e shpifjes, për shkak të informacionit shpifës ndaj personalitetit të paditësit në mënyrë publike, për arsye se në këtë rast rezulton se deklarata e të paditurit ndaj paditësit e dhënë në një gazetë, e cila në artikullin e vet ka përdorur edhe disa burime tjera informacioni dhe deklarata e të paditurit nuk përbën shpifje dhe fyerje, por se mund të konsiderohet një çështjeje e ngritur në interesin e përgjithshëm të qytetareve".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.796/2019, të datës 14.04.2023, është vendosur që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit A.K., avokat nga P., dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.976/2015, i datës 05.12.2018, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit R.H., i cili ka kërkuar që të detyrohet i padituri G.M. nga P., që në emër të kompensimit të dëmit material nga deklarata e shpifjes në të përditshmen austriake "Der Standard", t'ia paguajë shumën prej 250,000.00€, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Në pikën II të dispozitivit ishte vendosur që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.
2. Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, i autorizuari i paditësit, A.K., avokat nga P., ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni të aprovohet dhe të priset aktgjykimi i shkallës së dytë, dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
3. I padituri përmes të autorizuarit Besnik Berisha, avokat nga Prishtina, ka parashtruar përgjigje në revizion, duke i kontestuar pretendimet e revizionit si dhe duke konsideruar se revizioni është ushtruar pas afatit ligjor.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 215, gjeti se: Revizioni i të autorizuarit të paditësit është i pathemeltë.
5. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë ka kërkuar që të detyrohet i padituri G.M. nga P., që në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar si pasojë e intervistës në të përditshmen austriake “Der Standard” në gjuhën denigruese për R.H. ka shpifur se z. H. dhe njerëzit e tij ende bëjnë para me benzinë dhe lojërat e fatit, t’ia paguajnë shumën prej 250,000.00€, me kamatë ligjore, që nga arritja e kërkesës, e deri në pagesën definitive, fitimin e humbur, si dhe shpenzimet e procedurës. Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave materiale të përshkuara si në pjesën arsyetuese të aktgjykimit të atakuar, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.
6. Më datë 02.11.2015, i padituri kishte dhënë një deklaratë për shtypin austriak Der - Standard me autoren Adelheid Eöfl, duke u shprehur se: K., R.H., nuk e ka fjalën më në P., dhe qyteti i P., viteve të fundit është bërë më i qetë, qyteti në regjionin e D., deri pak kohe me parë vlente si kështjellë kriminaliteti. Ish luftëtarët e N.N.N./së, të cilët më vonë u gjenden në N.N.N., e kanë humbur ndikimin e tyre në D.
7. I padituri i ka kundërshtuar këto pretendime se deklarata është dhënë në formë dhe përmbajtje të tillë, por edhe po të ishte dhënë, këtë artikull të gazetës austriake, më përpara ishte botuar si raportime të shërbimeve të sigurisë së Aleancës Veri atlantike NATO, në të përditshmen lokale "Koha Ditore" nga data 16.05.2014 e deri më 26.05.2014, në një seri prej disa vazhdimesh.
8. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë thekson se nga provat e administruara të cilat janë propozuar, edhe nga përmbajtja e tekstit të pretenduar, rezulton se i padituri G.M., në cilësinë e politikanit e ka shpreh qëndrimin e tij politik në lidhje me veprimtarinë e tij dhe situatën politike në vend, ku ai është figurë publike dhe për më tepër kritikën e tij nuk janë të drejtuar ndaj personalitetit të paditësit por janë vetëm një analizë e situatës politike, ku mbi këtë nuk ka përmbajtje të tekstit të kontestuar ku ekzistojnë elemente të shpifjes dhe fyerjes dhe nuk janë plotësuar kushtet

ligjore në kuptim të nenit 3 të Ligjit civil nr.02/L-65, kundër shpifjes dhe fyerjes, ashtu siç janë dhënë përkufizimet për shpifjen dhe fyerjen, ku “shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë, të cilën publikuesi e din ose është dashur të dijë se fakti apo deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër”, që artikulli i kontestuar përmban elemente të shpifjes dhe fyerjes bazuar me nenin 14 dhe 15 të Ligjit kundër shpifjes dhe fyerjes si dhe nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhënien e Detyrimeve.

9. Më tutje ka arsyetuar, se me asnjë provë të vetme nuk është argumentuar pretendimi i paditësit se si pasojë e artikullit të publikuar, e njëjti ka pësuar dëm material në lartësinë e kërkuar me kërkesëpadi, ndërsa edhe nuk ka propozuar marrjen e ndonjë prove për të argumentuar pretendimet e tij. Rrjedhimisht gjykata e shkallës së parë ka theksuar se publikimi i një artikulli të tillë i thënë nga i padituri, nuk bart pasoja të përgjegjësisë civile për kompensimin e dëmit material, ngase me asnjë provë nuk është vërtetuar se me publikimin e një artikulli të tillë, paditësit i është shkaktuar ndonjë dëm. Meqenëse nuk është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë, atëherë është dashur të refuzohet kërkesëpadija e paditësit në tërësi si e pabazuar.
10. Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit, në procedurën sipas ankesës, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes në kontestin në fjalë, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj, drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye, aktgjykimi i atakuar është dashur të vërtetohet në tërësi.
11. Gjykata e Apelit vlerëson se edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë prej nga ka rezultuar se kërkesëpadija paditësit është e pa bazuar. Pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit për gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese të cekura si arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, të cilat janë propozuar nga pala paditëse, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

12. Në këtë drejtim, me provat materiale të administruara nga gjykata e shkallës së parë, është vërtetuar se nuk është provuar fakti se shkrimi i thënë nga i padituri, i publikuar në te përditshmen austriake “Der Standard”, përmban ndonjë element të shpifjes apo fyerjes, pasi që i padituri në intervistën e dhënë për gazetën e lartë cekur është mbështetur në të dhënat të cilat më herët janë publikuar në të përditshmen gazetën Koha Ditore, paditësi të njëjtat gjëra i ka deklaruar në intervistë, prandaj lajmi i dhënë gjatë intervistës mbështetet në burime të publikuara më herët, pra në të dhëna të shtypit ditor, për të cilat i padituri nuk e ka e ka ditur e as që ka mundur ta dijë se janë të pa sakta.
13. Nga kjo dispozitë ligjore, rrjedh se i padituri intervistën e dhënë në gazetën e lartë cekur e ka bërë në cilësi të përfaqësuesit politik dhe kryetarit të K. së P., duke e përshkruar veprimtarinë e tij politike, si dhe gjendjen a situatën e përgjithshme politike në vendin ku ai përfaqëson. Lajmi i cili ka qenë objekt i intervistës është publikuar më herët në të përditshmen Koha Ditore, i padituri gjatë intervistës ka deklaruar atë çka më herët e kishte publikuar gazeta e lartë cekur.
14. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së dytë e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e rregullt dhe të drejtë të dispozitave materialo – juridike, nga edhe ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditësit në rastin konkret është e pazuar. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për jo themelësinë e kërkesëpadisë është i drejtë dhe i bazuar, pasi që me dispozitën e nenit 3, nenin 14,15 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes dhe nenin 183 të LMD-së, është paraparë shprehimisht se në cilat raste ekziston shpifja dhe fyerja dhe si mundet të bëhet kompensimi i dëmit për shpifje dhe fyerje, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë, për çka edhe revizioni e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit u refuzua në tërësi si e pazuar, dhe u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, e pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me refuzimin si të pazuar të kundërpadisë, pasi që këto aktgjykime, në këtë çështje kontestimore, nuk përshihen me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as

me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, në të cilat në kuptim të nenit 215 të LPK, Gjykata e Revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykatat e instancave më të ulëta i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mënyrën e vendosjes meritore të çështjes kontestuese. Në këtë kontekst, janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritore, janë dhënë arsye për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të provave të shfrytëzuara.
3. Në logjikën e njëjtë është edhe aktgjykimi i shkallës së dytë në të cilin paraqiten arsye për konfirmimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm.
4. Në këtë kontekst me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozitë ligjore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimeve të instancave më të ulëta.
5. Sipas Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e nivelit më të ulët drejtë dhe në mënyrë të plotë i kanë vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave kanë krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, për arsye se nga provat prezentë në shkresat e lëndës në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar fakti se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shpifje dhe fyerje,

pasi që deklaratat e bëra nga ana e të paditurit nuk i përmbushin elementet ligjore për tu konsideruar si shpifje, ku i padituri në cilësinë e K. të K. së P., ka pas obligim ligjor që në bazë të funksionit të cilin e ushtron dhe duke marr parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes, të ngrejë çështje të caktuara, të cilat konsiderohen se janë në interes publik të qytetarëve, të cilët edhe i përfaqëson. Andaj në këtë rast mund të përfundojmë se i padituri nuk bart përgjegjësi subjektive për kompensimin e dëmit ndaj paditësit mbi bazën e shpifjes, bazuar në aspektin e përkufizimit të shpifjes si dhe kauzalitetit të veprimit në fjalë, të kualifikuar si shpifje. Artikulli i Gazetës Austriake përmban informacione të marra nga disa burime dhe i referohet gjendjes aktuale të sigurisë dhe ekonomisë së regionit për të cilën ka dhënë edhe i padituri një opinion të cilin e ka botuar kjo gazetë. Këto informata kanë qarkulluar në gazeta ditore dhe nuk janë plasuar në opinion nga i padituri.

6. Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron se nuk qëndrojnë pretendimet e revizionit se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsye se me nenin 3, pika a) të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: *“Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklaratë të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklaratat është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër”*, në pikën b), përcaktohet se: *“Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese”*, në pikën j), përcaktohet se: *“Zyrtar publik nënkupton çdo person i cili ushtron autorizime publike për një autoritet publik”*, ndërsa në pikën k), të po këtij neni, përcaktohet se: *“Çështje e interesit publik nënkupton çdo çështje e cila është në interes të publikut të publikohet duke përfshirë dhe mos u kufizuar në çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha degët e pushtetit, politikë, shëndetësi dhe siguri publike, zbatim të ligjit, administrim të drejtësisë, interes të konsumatorëve dhe interes shoqëror, ambient, çështje ekonomike, ushtrim të pushtetit, shkencë, art dhe kulturë”*.
7. Me nenin 5 paragraf 1 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: *“Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë ligj”*, ndërsa me paragrafin 4, të po këtij neni, përcaktohet se: *“Autoritetet publike ndalohen nga paraqitja e kërkesës për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shpifja ose fyerja. Zyrtarët publik mund të paraqesin kërkesë*

për kompensimin e dëmit nga shpifja ose fyerja, privatisht dhe ekskluzivisht në kapacitetin e tyre personal ”. Me nenin 7 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të një çështjeje me interes publik, nëse ata dëshmojnë se ishte e arsyeshme në të gjitha rrethanat për një person në pozitën e tyre të përhapë materialin me qëllim të mirë, duke marr parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështje të interesit publik që ai të marrë në kohë informacion për çështje të tilla ”.

8. Gjykata Supreme e mbështet arsyetimin e Gjykatës së Apelit nga se me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në nenin 10 parag. 1 është paraparë se: “Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 40 parag.1 përcakton: “Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush”. Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Ligji Nr.02/L-65), i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, rregullon përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje, ashtu siç përcaktohet në nenin 1 pika a) deri d) të këtij ligji.

9. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë drejt ka konstatuar faktin se i padituri nuk ka për detyrim që paditësit t’ia kompensoj dëmin mbi bazën e shpifjes, për shkak të informacionit shpifës ndaj personalitetit të paditësit në mënyrë publike, në shumën e gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se në këtë rast rezulton se deklarata e të paditurit ndaj paditësit e dhënë në një gazetë, e cila në artikullin e vet ka përdorur edhe disa burime tjera informacioni dhe deklarata e të paditurit nuk përbën shpifje dhe fyerje, por se mund të konsiderohet një çështjeje e ngritur në interesin e përgjithshëm të qytetareve. Andaj Gjykata Supreme e aprovon në tërësi qëndrimin juridik dhe arsyetimin e dhënë nga gjykatat e instancës më të ulët, kështu që u refuzuan si të pa bazuara pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga ana e gjykatave të shkallës më të ulët, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit.

10. Pretendimet për gjendjen faktike, të paraqitur në revizion nga i autorizuari i paditësit, nuk janë vlerësuar, pasi që sipas dispozitës së nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

11. Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK-së, e refuzoi revizionin si të pa bazuar duke konsiderua se gjykata e instancës më të ulët kanë vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe mbi këto fakte drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.543/2023, i datës 16.01.2024

"Gjykata e Shkallës së parë e kishte pranuar kërkesëpadinë e paditësit kishte anuluar njoftimin e të paditurës për ndërprerjen e kontratës së punës e cila ishte e lidhur në kohë të caktuar dhe nuk i është ripërtërirë, e njëjta ka skaduar sipas fuqisë ligjore (ex lege- neni 67 par.1, nënp.1.3 i Ligjit të Punës).

Me dispozitën e nenit 71. par.2 të Ligjit të Punës, përcaktohet që "Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftimin prej 30 ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim që të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë të punësuarin së paku 30 ditë para skadimit të kontratës".

Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se ka pasur një vendimmarrje të ndryshme në raste të ngjashme dhe për këtë, me qëllim të promovimit të zbatimit unik të ligjit në këtë lami, siç është e paraparë në nenin 27 të Ligjit Nr. 06/L - 054 Për Gjykatat, në Seancë të përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 26.07.2023, është nxjerr Qëndrimi Juridik me shenjen GJA-SU.A nr. 152/2023. Ligji i punës në tërësinë e tij, nuk parasheh mënyrë tjetër të themelimit të marrëdhënies së punës përpos me kontratë të punës, e cila sipas nenit 10 të këtij ligji mund të lidhet për një periudhë të pacaktuar, periudhë të caktuar dhe për punë dhe detyra specifike".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.49/2021, të datës 26.08.2021, është vendosur: që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e precizuar e paditësit M.H., nga P. dhe anulohet njoftimi i të paditurit Aeroporti Ndërkombëtar "Limak Kosova" sha në Prishtinë i datës 03.03.2015, dhe përgjigjia në kërkesë e të paditurës, HR- 2015-0103 të dt.19.03.2015 për mos përtëritjen e kontratës së punës së dt.03.04.2015, si joligjor dhe detyrohet i padituri t'ia kompensojë të ardhurat personale paditësit për periudhën nga dt.03.04.2015 deri me dt.31.06.2021 në shumë prej 24.277.05-€, në emër të kontributit pensional për periudhën kontestuese në shumë prej 1.214.01-€, në emër të tatimit në të ardhura në ATK, në shumë prej 1.013.42-€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dt.01.07.2021 e deri te pagesa

definitive, në emër të kamatës për kërkesën kryesore, shumë prej 3.798.54.-€, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësinë prej 2.863.00€, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

2. Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur me aktgjykimin Ac.nr.9821/2021, të datës 04.09.2023, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e të paditurit Aeroporti Ndërkombëtar "Limak Kosova" sh.a në Prishtinë, dhe ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.49/2021 të datës 26.08.2021.

1. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizionin e padituri, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të gjykatës së shkallës së dytë t'i ndryshoj dhe të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit.

2. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 215 gjeti se: Revizioni i të paditurit është i bazuar.

3. Nga shkresat e lëndës rezultojnë se paditësi ka kërkuar që të anulohet njoftimi i të paditurit i dt.03.03.2015, dhe përgjigja në kërkesën e të paditurës HR-2015-0103 të dt. 19.03.2015, për mos përtëritjen e kontratës së punës së dt.03.04.2015, si jo ligjore dhe që të detyrohet i padituri t'ia kompensojë të ardhurat personale paditësit për periudhën nga data 03.04.2015, deri më dt. 31.06.2021, në shumë prej 24.277,05 €, në emër të kontributit pensional për periudhën kontestuese në shumë prej 1.214,01 €, në emër të tatimit në të ardhura në ATK në shumë prej 1.013,42 €, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 01.07.2021 e deri te pagesa definitive, në emër të kamatës për kërkesën kryesore shumë prej 3.798,54 €, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2.863 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

4. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësi është punësuar te i padituri qysh më dt. 01.11.2013, dhe pas skadimit të kontratës të njëjtit i është vazhduar kontrata e punës në të njëjtin vend të punës deri me dt. 03.04.2015, dhe 30 ditë para skadimit të kontratës së fundit të punës e paditura e ka njoftuar me njoftimin e dt. 03.03.2015, paditësin se kontrata e punës me të paditurin nuk do të vazhdohet, duke u bazuar në kontratën e punës, ligjin e punës si dhe në politikat e bordit të drejtorëve. Paditësi i pakënaqur me njoftimin ka paraqitur kërkesë te i padituri për anulimin e njoftimit dhe i padituri nuk ka marr për bazë kërkesën e paditësit dhe në përgjigjen e saj ndaj kësaj kërkesë e arsyeton njoftimin për mos ripërtëritjen e kontratës së punës duke theksuar se njoftimi është i bazuar në ligjin e punës dhe kontratën e punës, për çka gjykata e shkallës së parë ka konsideruar se i padituri në kundërshtim me ligjin e punës paditësit nuk i ka vazhduar kontratën e punës sepse arsyetimi i të paditurit se kontrata e punës nuk iu është vazhduar paditësit në pajtim me politikat e bordit të drejtorëve, ligjit të punës dhe vendimit për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore nuk qëndron, sepse me asnjë provë deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor i padituri nuk e ka argumentuar këtë fakt të rëndësishëm se mos vazhdimi i kontratës së punës është bërë në bazë të asaj që u tha më lart, sepse e njëjta asnjë herë nuk ka prezantuar ndonjë vendim për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore e as ndonjë vendim për politikat e bordit të drejtorëve ku do të shihej apo përcaktohej se cilat shërbime janë reduktuar apo do të duhej të reduktoheshin në të ardhmen, këtu edhe vendi i punës së paditësit, andaj dështimi i të paditurit për vërtetimin e këtyre fakteve e bënë vendimin - njoftimin e të paditurit për mos vazhdimin e kontratës së punës të paligjshëm.
5. Me qenë se paditësit nuk i është vazhduar kontrata e punës në kundërshtim me ligjin, respektivisht njoftimi për mos vazhdimin e kontratës së punës është i kundërligjshëm, të njëjtit i takon e drejta në kompensimin e të gjitha pagave dhe benefiteve tjera të humbura gjatë kësaj kohe në shumën e vërtetuar nga ekspertiza financiare e ekspertit A.G., për periudhën kontestuese me kamatë ligjore nga data 01.07.2021 e deri në pagesën definitive si dhe shumën që kishte me ia paguar në trustin pensional për këtë periudhë dhe tatimin në pagë në ATK si dhe kamatën ligjore. Vendimin për kamatë e bazon në nenin 382 .2 të LMD-së.
6. Gjykata e Apelit e Kosovës, pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se sipas njoftimit mbi mos vazhdimin e kontratës së punës del se paditësit kontrata e punës

nuk i është vazhduar nga baza e vendimit të kompanisë për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore, i cili vendim asnjë herë nga ana e të paditurit nuk i është prezantuar gjykatës dhe as që është prezantuar plani i ardhshëm i resurseve njerëzore, si bazë për vlefshmërinë e njoftimit, e as Politikat e Bordit të Drejtorëve. Kjo gjykatë gjen se në këtë çështje konkrete i padituri nuk ka respektuar rregullat primare të procedurës dhe detyrimin e tij që gjykatës t'ia prezantoj faktet mbi të cilat mbështet pretendimet e veta dhe nuk ka prezantuar prova me të cilat do të kishte provuar bazueshmërinë e pretendimeve të tij, andaj dështimi i të paditurit në këtë drejtim mos vazhdimin e kontratës së punës së paditësit e bënë jo ligjore. Rrjedhimisht kjo gjykatë vlerëson se edhe pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit përkitazi me kompensimin e të ardhurave personale është e bazuar në ligj dhe gjykata e shkallës së parë në këtë drejtim ka marr vendim të drejtë e të ligjshëm, pasi që njoftimi përkatësisht largimi nga puna i paditësit vlerësohet si i paligjshëm dhe për këtë arsye paditësit i takon e drejta në kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna e në shumë të cilën gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar me ekspertizë financiare të ekspertit financiar gjyqësor A.G. Gjykata e Apelit në arsyet e saj ndër të tjera ka theksuar se, sipas dispozitës së nenit 80 par.1 pika 1 të Ligjit të Punës, i padituri ka obligim që paditësit t'ia paguaj pagat sipas kontratës së punës, ku nga shkresat e lëndës rezulton se, pagat e tilla për kohëzgjatjen e kësaj kontrate, i padituri ia ka paguar paditësit.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, pasi që aktgjykimi i shkallës së dytë dhe të parë, është përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
2. Parashtrimet e të paditurës si në revizion, sa i përket shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, Gjykata Supreme i vlerëson si të bazuara dhe sipas vlerësimit të Gjykata Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, dhe të dytë, për arsye se me nenin 10

Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: 1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji. 2. Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra specifike. 3. Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësisht për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar. 4. Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite. 5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore. 6. Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindënjzet (120) ditë brenda një (1) viti. 7. Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

3. Me nenin 67 paragraf 1 pika 1.3, të këtij ligji, përcaktohet se: Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: ... me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;... . Me nenin 71 paragrafi 2 i këtij ligji, përcaktohet se: Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë të punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë. Në rastin konkret paditësi ka filluar punën me të paditurin me kontratë në kohë të caktuar më datën 01.11.2013 dhe është rinovuar deri më 03.04.2015. Përfundimisht më datën 03.03.2015 është njoftuar nga i padituri se nuk do të vazhdohet kontrata e punës përtej skadimit më 03.04.2015.
4. Gjykata Supreme ka konstatuar se kontrata e punës është lidhur në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të cekura më lartë, se kushtet e kontratës të punës të lidhura në mes të paditësit dhe të paditurit duke marrë për bazë kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, si dhe përfundimin e marrëdhënies së punës, siç ka ndodhur në këtë rast janë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës dhe dispozitat e kontratës së punës. Në këtë rast i padituri me vendim e ka njoftuar paditësin për mos ripërtëritjen e kontratës së

punës, për shkak të skadimit të kontratës edhe pse nuk ka pasur detyrim ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të dispozitave ligjore të lartë cekura.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, merr parasysh faktin vendimtar - relevant, se marrëdhënia e punës ka qenë e themeluar në kohë të caktuar, prandaj, nga këtu, kontrata e punës, paditësit, nuk i është ripërtërirë, e njëjta ka skaduar sipas fuqisë ligjore (ex lege- neni 67 par.1, nënp.1.3 i Ligjit të Punës). Edhe sipas dispozitës ligjore të nenit 10 par.2, nënp.2.2 të Ligjit të Punës, parashihet se kontrata e punës lidhet edhe “ për një periudhë të caktuar”, sikundër edhe është rasti konkret juridiko-civil. Ndërkohë që, me dispozitën e nenit 71. par.2 të Ligjit të Punës, përcaktohet që “Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftimin prej 30 ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim që të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë të punësuarin së paku 30 ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do ti jap të drejtën të punësuarit për zgjatjen e 30 ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë ”, ndaj, dispozitat e sipër përmendura, në rastin konkret, janë zbatuar drejtë, sikundër ka gjetur edhe gjykata e shkallës së dytë, prandaj, nga këtu, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se, qëndrojnë thënie të revizionit për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, dhe se njoftimi për mos përtëritjen e kontratës së punës së paditësit i ka plotësuar standardet ligjore lidhur me mënyrën e mos vazhdimit të kontratës së punës dhe procedurat për shkëputjen e kontratës së punës e të cilat janë aplikuar në mënyrë të njëjtë dhe se nuk paraqet diskriminim tek paditësi për mos vazhdimin e kontratës së punës siç është paraparë me nenin 5 të Ligjit të punës.
6. Përkundër asaj që Gjykata e Apelit në arsyetimin e vet ka theksuar se vendimi i shkallës së parë me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar vendimi i të paditurit për mos vazhdimin e kontratës është në harmoni të plotë me praktikatat gjyqësore tani më të krijuara me aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës që lidhen për çështjen e anulimit të njoftimeve për mos përtëritjen e kontratës së punës, Gjykata Supreme e Kosovës nuk e aprovoi qëndrimin e gjykatave të instancës më të ulët. Gjykata Supreme e Kosovës e shqyrtoi këtë pretendim dhe erdhi në përfundim se ka pasur një vendimmarrje të ndryshme në raste të ngjashme dhe për këtë, me qëllim të promovimit të zbatimit unik të ligjit në këtë lami, siç është e paraparë në nenin 27 të Ligjit Nr. 06/L - 054 Për Gjykatat, në Seancë të përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 26.07.2023, është nxjerr Qëndrimi Juridik me shenjë GJA-SU.A nr. 152/2023,

në të cilin është marr qëndrim se Ligji i punës në tërësinë e tij, nuk parasheh mënyrë tjetër të themelimit të marrëdhënies së punës përpos se me kontratë të punës, e cila sipas nenit 10 të këtij ligji mund të lidhet për një periudhë të pacaktuar, periudhë të caktuar dhe për punë dhe detyra specifike. Në kuadër të nenit 10, paragrafi 5 të këtij ligji është përcaktuar situatë kur kontrata është lidhur për kohë të caktuar por që ripërtërihet në mënyrë të qartë apo vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se 10 vite, do të konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore. Në rastet tjera kontrata e lidhur në mes palëve për themelimin e marrëdhënies së punës në kohë të caktuar dhe e shkëputur me skadimin e këtij afati, me paralajmërim dhe në kushtet e parapara me ligj, nuk mund të konsiderohet si shkëputje e kundërligjshme.

7. Prandaj nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe dispozitave të kontratës së punës, si dhe nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar.
8. Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore Gjykata Supreme ka vendosur që secila palë të bartë shpenzimet e saj të procedurës, pasi pala paditëse e ka humbur kontestin, ndërsa pala e paditur nuk ka parashtruar sipas revizionit kërkesë për shpenzimet e procedurës, bazuar në nenin 449, 452 paragrafi 1, e lidhur me nenin 463 paragrafi 1 të LPK-së. Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas padisë të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.
9. Si përfundim Gjykata Supreme vendosi që ti ndryshoi aktgjykimet e instancës më të ulët ashtu që në pajtim me nenin 224 paragrafi 1 të LPK-së, e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.89/2024, i datës 07.03.2024

”Paditësja, ka paraqitur padi për shkak të pasurimit të pa bazë, kundër të paditurës dhe ka kërkuar që pjesën e mjeteve të paguara nga paditësja të kthehen, sepse janë fitim i pa bazë.

Nuk është provuar përgjegjësia e të paditurës në rastin në fjalë, në kuptim të nenit 8 të kontratës ku është paraparë përjashtimi i përgjegjësive për shkak të fuqisë madhore sepse të paditurës tri vjet radhazi i ishte shkaktuar dëm material në seren e saj nga reshjet e shiut, fakt ky që është vërtetuar me raportin e Zyrës së Kryetarit të Komunës së Drenasit të datës 19.12.2014 përkatësisht nga komisioni i përbërë prej 3 anëtarëve të cilët kishin konstatuar dëmet në vlerë prej 7,476.00 € të shkaktuara si pasojë e vërshimeve të reshjeve atmosferike dhe breshrit. Po ashtu nga raporti i datës 28.03.2016 nga zyra e kryetarit të Komunës së Drenasit ishte konstatuar se e paditura si pasojë e erërave të forta në muajin janar, shkurt dhe mars, kishte pësuar dëme në vlerë prej 9,650.00 € në serën e saj.

Për tu krijuar marrëdhënia e detyrimit nga pasurimi i pa bazë duhet që të plotësohen këto kushte: të ekzistojë pasurimi, rritja e pasurisë në anën e të pasuruarit; b) që të ekzistoj varfërimi, zvogëlimi i pasurisë në anën tjetër. Duhet pra që të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet rritjes së pasurisë në një anë dhe zvogëlim të pasurisë në anën tjetër. Në rastin konkret nuk ekziston pasurimi i palës së paditur për faktin se e mira e krijuar me këto investime është shkatërruar nga forca madhore“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, refuzohet tërësisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Qeveria e Kosovës – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë, rruga “Luan Haradinaj”, ish objekti i OSBE-së me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Q.G., nga G., sheshi “F. dhe Xh. Ll.”, B1 IV, hy.NN, nr.NN, që paditëses t’i kthej shumën prej 24,039.60€, në llogari të saj për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës dhe vendimit, me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë, ashtu që të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kanosjen e përbarimit të detyruar. Detyrohet paditësja, që të t’ia paguaj të paditurës, shumën prej 100 € në emër të shpenzimeve të

procedurës kontestimore lidhur me përgjigjen në padi në afatin prej 15 dite nga marrja e aktgjykimit nën kanosjen e përmbarimit të detyruar, ndërsa kërkesa e të autorizuarit të paditurës me të cilën ka kërkuar që të detyrohet paditësja që t'i kompensoj shpenzimet e procedurës të paditurës në shumën prej 100 € për dy seanca gjyqësore refuzohet si e pa bazuar.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.105/2021, datë 21.12.2023, refuzohet e pa themeltë ankesa e paditëses Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Prishtinë , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc, C.nr.464/2017, i datës 01.12.2020, vërtetohet.
3. Kundër aktgjykimit të sipër cekur të gjykatës së shkallës së dytë, paditësja me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe aplikimit të gabuar të së drejtes materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosoves, të aprovoj revizionin si të themeltë, dhe të dy aktgjykimet e sipër cekura t'i prishë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, ose që t'i ndryshoj ashtu që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovojë si të bazuar.
4. E paditura në përgjigje në revizion ka kundërshtuar pretendimet e paditëses dhe ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që ta refuzoj si të pa bazuar revizionin e paditëses.
5. Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë kontestimore (LPK) shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, revizionin e paditëses, si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se revizioni i paditëses është i pa bazuar.
6. Nga shkresat e lëndës, rrjedh se paditësja, më datë 02.09.2016, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi për shkak të pasurimit të pa bazë , kundër të paditurës dhe ka kërkuar që pjesën e mjeteve të paguara nga paditësja të kthehen, sepse janë fitim i pa bazuar. Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses ka administruar provat, si kërkesën e për kthimin e mjeteve të paditëses me nr. 2964 të datës 25.08.2016, formularin për aplikim të paditurës të datës 04.03.2014, certifikatën e regjistrimit të fermerit – të paditurës Qëndresa Gruda të datës 04.03.2014, me shenjen

NIF:1028574, ekstraktin e lindjes të paditurës lëshuar me datë 28.02.2014 nga Zyra e Gjendjes Civile në Skenderaj, konfirmimin bankar për llogarinë bankare të paditurës të datës 14.02.2014, kopjen e letërnjoftimit të paditurës, planin e biznesit të paditurës i cili është i datës së njëjtë me atë të aplikacionit, kthimin e investimeve të datës së njëjtë të aplikacionit, raportin e vlerësimit të aplikacionit të datës 13.05.2014, letër informimin e paditëses të datës 08.07.2014 me numër të referencës 07/4/03/270, kontratën për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural nr.100/2014 të datës 08.07.2014, kërkesën për pagesën e të paditurës drejtuar paditëses të datës 19.11.2014, raportin për kontroll në teren të paditëses të datës 03.07.2014, fotografitë në vendin e ngjarjes në dy fleta, vlerësimin e raportit të Inspektoratit nga shefi i sektorit të paditëses të datës 04.07.2014, formularin e aplikimit për mbështetje e kredisë për pagesë të datës 19.11.2014, fotografitë në vendin e seres, listën kontrolluese për autorizimin e kërkesës për pagesën me numër të projektit 19/019 të datës 20.12.2014, vendimin për mbështetje nga programi i mbështetjes rural i paditëses me numër të referencës 07/4/656/2014 të datës 08.01.2015, raportin nga kontrolli në teren i njohur si ekspost kontroll i datës 18.05.2016, tri fletë me nga 4 fotografi të serës së të paditurës të datës 18.05.2016, rikontrollen e datës 26.07.2016, katër fotografi me një fletë të datës 26.07.2016, ankesën e të paditurës drejtuar paditëses me datë 17.08.2016 dhe një shkresë të datës së njëjtë që i është bashkangjitur ankesës, raportin nga zyra e kryetarit të Komunës së Glllogocit të datës 19.12.2014, raportin nga zyra e kryetarit të Komunës së Glllogocit të datës 28.03.2016, përgjigja në ankesë e paditëses e datës 23.08.2016 me nr.3014, 4 fotografitë e serës së të paditurës, dhe pas vlerësimit të tyre ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar.

7. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se nuk është kontestues fakti se paditësja e ka mbështetur të paditurën në financimin e projektit inventiv të zhvillimit rural të paditurës për ngritjen e seres për prodhimin e perimeve të freskëta dhe kultura të ndryshme, pasi që në mes të palëve ishte lidhur edhe kontrata në bazë të cilës paditësja e ka financuar projektin e lartcekur të paditurës me shumën prej 24,363.00 €, apo 65 % nga vlera totale e pranueshme e projektit të financuar prej 37,482.00 €. Kontestuese në mes të palëve ishte kthimi i mjeteve të lartcekura financiare pasi që paditësja ka pretenduar se këto mjete nuk janë përdorur sipas qëllimit të kontratës ndërsa e paditura ka pretenduar se nuk është përgjegjëse për kthimin e tyre për shkak të vërshimeve të ndodhura nga forca madhore në kuptim të nenit 8 të kontratës.

8. Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, gjykata ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar edhe se e njëjta duhet refuzohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi për faktin se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, nuk është provuar përgjegjësia e të paditurës në rastin në fjalë, në kuptim të nenit 8 të kontratës ku është paraparë përjashtimi i përgjegjësive për shkak të fuqisë madhore sepse të paditurës tri vjet radhazi i ishte shkaktuar dëm material në serën e saj nga reshjet e shiut, fakt ky që është vërtetuar me raportin e Zyrës së Kryetarit të Komunës së Drenasit të datës 19.12.2014 përkatësisht nga komisioni i përbërë prej 3 anëtarëve të cilët kishin konstatuar dëmet në vlerë prej 7,476.00 € të shkaktuara si pasojë e vërshimeve të reshjeve atmosferike dhe breshrit. Po ashtu nga raporti i datës 28.03.2016 nga zyra e kryetarit të Komunës së Drenasit ishte konstatuar se e paditura si pasojë e erërave të forta në muajin janar, shkurt dhe mars, kishte pësuar dëme në vlerë prej 9,650.00 € në serën e saj.
9. Nga komisionet e zyrës së kryetarit të Drenasit, dëmi në serën e të paditurës ishte konstatuar edhe nga komisionet e vet paditëses të cilët në raportin e datës 18.05.2016, kishin konstatuar se të paditurës i ishte shkatërruar sera duke përfshirë edhe konstruksionin e saj si pasojë e erërave të forta, se sera ishte jashtë funksionit për shkak të vërshimeve dhe erërave, konstruksioni ishte i prishur, ka munguar folia plastike (mbulesa) dhe pjesët ballore nga materiali polister kishin filluar të dëmtohen, andaj duke u bazuar në këto prova gjykata erdhi në përfundim se sera është dëmtuar nga vërshimet dhe erërat me ç rast janë plotësuar kushtet që e paditura të përjashtohet nga përgjegjësia për përmbushjen e detyrimit ndaj paditëses në kuptim të nenit 8 par. 1 të kontratës ku është përcaktuar se “Sipas forcës madhore, pala është e përjashtuar nga përgjegjësia që parashihen me këtë kontratë” ndërsa në par.3 të nenit të njëjtë të kontratës është përcaktuar se “Si forcë madhore mundë të konsiderohen rastet siç janë: tërmetet, vërshimet, lufta, revolucionet, embargot etj” dhe se në rastin konkret forca madhore, përkatësisht vërshimi nga erërat e forta është konstatuar nga vet komisionet e paditëses dhe nga ato të Komunës së Drenasit.
10. Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore

dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e po ashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

11. Gjykata e shkallës së dytë gjeti se nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 parag.2 pika n) të LPK-së. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë i kuptueshëm dhe nuk është kontradiktor me vetë veten dhe as arsyetimin e aktgjykimit. Po ashtu gjykata e shkallës së parë në arsyetimin të aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftuara për faktet vendimtare dhe për vlerësimin e provave për ti konstatuar këto fakte.

12. Gjykata e Apelit e Kosovës në procedurë sipas ankesës ka vërejtur se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka konstatuar gjendjen faktike. E paditura ka marr subvencion prej paditëses në shumën sikurse në dispozitivi të aktgjykimit, për investime në sera. Por e paditura investimin nuk ka mundur ta bëjë si rezultat i reshjeve të mëdha të shiut tri vite radhazi të cilat i kanë shkaktuar dëme të paditurës. Kjo është konstatuar edhe nga vetë komisioni i MPBZH-së. Mbi këtë bazë e paditura përjashtohet nga përgjegjësia për kthimin e mjeteve të cilat i ka marr si subvencion për investime në sera, për faktin se sipas kontratës së lidhur në mes ndërgjyqësve ata me nenin 8 parag.1 të kësaj kontrate ishin pajtuar se sipas fuqisë madhore pala është e përjashtuar nga përgjegjësia që parashihet me këtë kontratë, ndërsa me nenin të kësaj kontrate është paraparë se fuqi madhore konsiderohet tërmetet, vështrimet , lufta embargot etj.

13. Gjykata e Apelit e vlerëson të pa qëndrueshëm pretendimin ankimor të paditëses, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se e paditura për periudhën kontestuese ka pësuar dëme në serat e saj, si pasojë e erërave të forta vërshimeve të ujit për shkak të të reshurave të mëdha atmosferike të cilat ia kanë dëmtuar serën, kjo përveç që është konstatuar nga komisioni përkatës komunal për evidentimin e dëmeve nga forca madhore apo shkaqet natyrore kjo është konstatuar edhe nga komisioni përkatës i vetë MBPZHR-së.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme pranon si të bazuar qëndrimin juridik të të dy gjykatave të sipër përmendura lidhur me refuzimin si të pa bazuar të kërksëpadisë së paditëses, nga se aktgjykimet e tyre në këtë çështje kontestimore nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nejit 215 të LPK kujdeset sipas detyrës zyrtare.
2. Pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykatat e instancave me të ulëta i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimet. Në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mënyrën e vendosjes meritore të çështjes kontestuese. Në këtë kontekst, janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritore, janë dhënë arsye për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të provave të shfrytëzuara.
3. Në logjikën e njëjtë është edhe aktgjykimi i shkallës së dytë në të cilin paraqiten arsyet për konfirmimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm.
4. Në këtë kontekst me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozitë ligjore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimeve të instancave më të ulëta.
5. Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon në tërësi qëndrimin e gjykatave të instancës më të ulët lidhur me zbatimin e të drejtës materiale dhe në këtë drejtim i refuzon si të pa

bazuara pretendimet e revizionit. Sipas Gjykatës Supreme të Kosovës për tu krijuar marrëdhënia e detyrimit nga pasurimi i pa bazë duhet që të plotësohen këto kushte: të ekzistojë pasurimi, rritja e pasurisë në anën e të pasuaruarit; b) që të ekzistoj varfërimi, zvogëlimi i pasurisë në anën tjetër. Duhet pra që të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet rritjes së pasurisë në një anë dhe zvogëlim të pasurisë në anën tjetër. Varfërimi i këtyllë ekziston, kur dikush ia paguan tjetrit një shumë të caktuar hollash, e paguan borxhin e huaj, bënë ndonjë shërbim, e bartë ndonjë të drejtë reale ose detyruese etj. Në rastin konkret nuk ekziston pasurimi i palës së paditur për faktin se e mira e krijuar me këto investime është shkatërruar nga forca madhore.

6. Edhe Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon qëndrimin se e paditura nuk është përgjegjëse, ngase të dy gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë gjejnë se, nuk mbanë përgjegjësi kontraktuesi për dëmet e shkaktuara si pasojë e forcës madhore. Kjo është paraparë shprehimisht edhe me nenin 8 parag.1 të kontratës për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural nr.100/2014, të datës 08.07.2014, ku pala lirohet nga përgjegjësia nëse dëmi i shkaktohet nga forca madhore e në rastin konkret dëmi është shkaktuar nga forca madhore nga erërat dhe shiu, e cila gjë është konstatuar sikundër u sqarua më lartë prej komisioneve gjegjëse për evidentimin e dëmeve në bujqësi por edhe shihet nga fotografit e bëra në vendin e ngjarjes.
7. Prandaj, në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike në procedurën e shkallës së parë, gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar edhe të drejtën materiale për çfarë arsye pretendimet në revizion paraqiten si të pabazuara.
8. Në revizion përsëriten thëniet e parashtruara në ankesë përkitazi me vlerësimin e fakteve të cilat gjykatat e instancës më të ulët i kanë vlerësuar dhe për të gjitha këto kanë dhënë arsye në arsyetimin e aktgjykimeve të tyre, ku përsëriten thëniet sa i përket gjendjes faktike. Pretendimet e tilla kjo Gjykatë i vlerëson sipas nenit 214.2 të Ligjit të Procedurës kontestimore, ku parashihet se revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike për derisa revizioni në të vërtetë për këtë arsye i godet aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët.
9. Për arsyet e paraqitura më lartë, Gjykata Supreme e Kosovës revizionin e paditëses e refuzoi si i pabazuar, andaj me zbatimin e nenit 222 të LPK-së.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.222/2024, i datës 23.05.2024

”Sipas nenit 101 të Ligjit Për Familjen i Kosovës (LFK), i cili parasheh që “At i fëmijës, i cili nuk ka lindur në martesë, as brenda afatit prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës, konsiderohet burri i cili e pranon për të vetin ose atësia e të cilit është vërtetuar me vendimin e gjykatës”. Ndërsa sipas nenit 110.1 i po të njëjtit Ligj, i cili parasheh që “Padinë për vërtetimin e atësisë së fëmijës së lindur jashtë martesës, përveç personit i cili e konsideron vetën at të fëmijës mund ta paraqesin fëmija dhe nëna e fëmijës.

At i fëmijës, është i padituri, pasi që një fakt i tillë është vërtetuar nga rezultati i ADN-së. Pretendimet e revizionit lidhur me ekspertizën nuk u aprovuan“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr. 224/2020, datë 21.12.2021, i datës 10.10.2019, me të cilën është vendosur: "I. Aprovohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses M.K., nga Gjilani, kundër të paditurit I.I., nga Gj. dhe vërtetohet se i padituri I.I. është baba biologjik i të miturës M.K., e lindur me datë NN në P. II. Refuzohet si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëse M.K. nga Gj., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri I.I. nga Gj., që në emër të kontributit për mbajtje dhe kujdesin ndaj të miturës, t'i paguaj shumën mujore prej 100€, duke filluar prej dt.05.11.2008 (nga momenti i lindjes), e deri ne ekzistimin e kushteve ligjore për mbajtje. III. Detyrohet i padituri I.I., nga Gj., që paditëses M.K., t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 694€, në afat prej 15 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm".
2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.1281/2022, të datës 21.03.2024, ishte vendosur që të refuzohet, si e pa themeltë ankesa e të paditurit I.I. nga Gj., lagjja D, Rr."B.M."nr.106, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.224/2020 datë 21.12.2021 në pikën I dhe III, vërtetohet. Pika II e dispozitivit të aktgjykimit Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.224/2020 datë 21.12.2021, mbetet e pa shqyrtuar.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i padituri përmes të autorizuarit avokat M.M., ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet revizioni dhe të prishen të dy aktgjykimet e lartpërmendura dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim . Padiësja nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin
4. Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të kundërshtuar dhe shkresave të lëndës në bazë të nenit 215 të LPK, ka gjetur se: Revizioni i të paditurit është i pabazuar.
5. Nga shkresat e lëndës rrjedh se padiësja M.K. nga Gj., të cilën e përfaqëson përfaqësuesja ligjore, nëna e saj R.K., nga Gj., Rr. "Gj.S.", lam-NN, kati 4, me datën 12.02.2020, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurit I.I. nga Gj., për shkak të vërtetimit të atësisë dhe alimentacion, me propozim që të aprovohet kërkesë padia e paditëses në tërësi si e bazuar. Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesë padinë e paditëses sa i përket vërtetimit të atësisë dhe e ka refuzuar kërkesë padinë e paditëses në lidhje me alimentacionin, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e ankimuar mes tjerash ka arsyetuar se: Duke u bazuar në gjendjen faktike të shpjeguar si më lartë, përkatësisht duke vërtetuar faktin se i padituri I.I. është baba i paditëses M.K., dhe kjo siç thamë më lartë është vërtetuar me testin e ADN-së, dhe nga kjo gjendje dhe bazuar në nenet 337, 338, 339 të Ligji Nr. 2004/32. *Ligji për familjen* i Kosovës (më tej LFK-së), gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Më tej ka shtuar se: Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke llogaritur se kërkesa për alimentacion është e parakohshme, për faktin se deri më tani nuk është ditur se kush është baba biologjik i paditëses, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, padiësja mund të paraqet padi për alimentacion. Më tej ka arsyetuar se: Gjykata vlerësoi edhe pretendimin e të paditurit se në rastin konkret kemi parashkrim që të paraqitet padia për vërtetimin e atësisë, por një gjë e tillë nuk u mor parasysh, për faktin se neni 110.2 i LFK-së, ka paraparë se fëmija i lindur jashtë martesës mund të paraqes padinë për vërtetimin e atësisë në çdo kohë, në rastin konkret siç është vërtetuar, padiësja ka lindur jashtë martesës dhe për të njëjtën në bazë të kësaj

dispozite nuk ka parashkrim. Gjykata e shkallës së parë vendimin e sajë e ka mbështetur në nenin 337, 338, 339 të LFK-së.

6. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit aktgjykimi i shkalles se pare, nuk është i përfshirë me të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivin i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetimin të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, nga gjendja faktike e vërtetuar, në mënyrë të drejtë ka aplikuar edhe të drejtën materiale pasi që sipas nenit 101 të Ligjit Për Familjen i Kosovës (LFK), i cili parasheh që *“At i fëmijës, i cili nuk ka lindur në martesë, as brenda afatit prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës, konsiderohet burri i cili e pranon për të vetin ose atësia e të cilit është vërtetuar me vendimin e gjykatës”*. Ndërsa sipas nenit 110.1 i po të njëjtit Ligj, i cili parasheh që *“Padinë për vërtetimin e atësisë së fëmijës së lindur jashtë martesës, përveç personit i cili e konsideron vetën at të fëmijës mund ta paraqesin fëmija dhe nëna e fëmijës”*. Andaj, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vërtetuar se at i fëmijës M.K. nga Gjilani, është i padituri I.I., nga Gj., pasi që një fakt i tillë është vërtetuar nga rezultati i ADN-së. Gjykata e Apelit analizoj pretendimet ankimore të paditurit në lidhje me kundërshtimin e ekspertizës së ADN-së përkatësisht në lidhje me metodat e aplikuara, por të njëjtat pretendime nuk janë marrë për bazë pasi që, eksperti B.M. në shqyrtimin kryesor, ka dhënë sqarimet e duhura në lidhje me këtë çështje, të cilat sqarime për gjykatën e Apelit janë adekuate dhe të bazuara në ligje, pasi që i njëjti ka sqaruar se metoda e përdoruar si në rastin konkret duke i marrë mostrat e fëmijës dhe të paditurit nga pështyma, është metodë që është e paraparë me ligj dhe saktësia e së cilës është e njëjtë edhe metodën e analizës së ADN-së përmes gjakut. Andaj, një kundërshtim i tillë është i a bazuar dhe si të tillë nuk është marrë për bazë.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës e pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditëses, ngase të dy aktgjykimet e tyre të sipërpërmendura janë përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, , dhe për pasojë, me të drejtë, kërkesëpapia e paditëses është aprovuar.
2. Pretendimi i vetëm i revizionit është shkelja esenciale dispozitive të procedurës kontestimore nga neni 182.2 n) duke cekur se kemi të bëjmë me dy aktgjykime të cilat nuk korrespondojnë me njëra tjetrën, dhe dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë nuk korrespondon me arsyetimin e dhënë nga gjykata.
3. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitive të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykatat e instancave me të ulëta i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, ndërsa aktgjykimi i shkallë së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mënyrën e vendosjes meritore të çështjes kontestuese. Në këtë kontekst, janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritore, janë dhënë arsye për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të provave të shfrytëzuara. Në logjikën e njëjtë është edhe aktgjykimi i shkallës së dytë në të cilin paraqiten arsyet për konfirmimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm. Në këtë kontekst me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozita ligjore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitive të procedurës kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimeve të instancave më të ulëta.

4. Ndërsa sa i përket pretendimit në revizion për aplikim të gabuar të së drejtës materiale, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se në revizion nuk ceket asnjë dispozitë e që të jetë aplikuar gabimisht, por kjo gjykatë, duke e shqyrtuar aktgjykimin e atakuar në bazë të nenit 215 të LPK-së, e miraton qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët për sa i përket aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses për arsye nga shkresat e lëndës konstatohet se në rastin konkret ekspertiza e ADN-së, përkatësisht raportin e ekspertimit të lëshuar nga Agjencia e Kosovës Për Forenzikë, e datës 18.10.2021, ka vërtetuar se baba i fëmijës M.K. këtu paditëse është I.I., këtu i paditur. Gjykata e revizioni vlerëson se gjykatat e shkallës më të ulët, nga gjendja faktike e vërtetuar, në mënyrë të drejtë kanë aplikuar edhe të drejtën materiale pasi që sipas nenit 101 të Ligjit Për Familjen i Kosovës (LFK), i cili parasheh që “At i fëmijës, i cili nuk ka lindur në martesë, as brenda afatit prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës, konsiderohet burri i cili e pranon për të vetin ose atësia e të cilit është vërtetuar me vendimin e gjykatës”. Ndërsa sipas nenit 110.1 i po të njëjtit Ligj, i cili parasheh që “Padinë për vërtetimin e atësisë së fëmijës së lindur jashtë martesës, përveç personit i cili e konsideron vetën at të fëmijës mund ta paraqesin fëmija dhe nëna e fëmijës”.
5. Andaj, në rastin konkret me të drejtë është aprovuar kërkesëpadia dhe vërtetuar se at i fëmijës M.K., nga Gjilani, është i padituri I.I. nga Gj., pasi që një fakt i tillë është vërtetuar nga rezultati i ADN-së, dhe në bazë të nenit 222 të LPK-së, revizioni i paditëses u refuzua si i pa bazuar.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.226/2024, i datës 30.05.2024

"Gjykata e shkallës së parë kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, kishte konstatuar se paditësi është pronar mbi bazën e mbajtjes me mirëbesim ndërsa kishte anuluar kontratës e lidhur në mes të palëve si nule. Gjykata e shkallës së dytë e kishte aprovuar ankesën dhe e kishte ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që kishte refuzuar kërkesëpadinë për anulimin e kontratës dhe vërtetimin e pronësisë mbi bazën e mbajtjes-parashkrimit fitues.

Parashkrimi fitues në vete përmban katër elemente të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të fituar të drejtën e pronësisë mbi një send të paluajtshëm: (1) mbajtësi i ligjshëm, (2) mirëbesimi, (3) kalimi i periudhës kohore të caktuar me ligj dhe (4) posedimi i sendit mbi të cilin dikush tjetër e ka të drejtën e pronësisë. Posedimi i mbajtësit është "i ligjshëm" nëse mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit, ndërsa posedimi mund të jetë ligjor dhe pa pëlqim, por mund të jetë i paligjshëm, por me pëlqim".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.79/17, të datës 03.11.2018, ishte vendosur si në vijim: "I. Aprovohet kërkesëpadia e paditësve F.R., M.F. dhe Z.F. dhe vërtetohet se paditësit janë pronar, në bazë të mbajtjes dhe parashkrimit fitues, me nga 1/3 të pjesës ideale të parcelës kadastrale me nr. P.nr. 70403013-1581-0, në vendin e quajtur "NN", me kulturë arë, e klasit të tretë, në sipërfaqe prej 1.15.06 ha, e evidentuar në bazë të certifikatës së pronësisë me numër të lëndës 10501-2017, të datës 29.09.2017, në emër të paditurit S.L.A. nga P. II. Anulohet kontrata e shitblerjes së paluajtshmërisë, e lidhur në mes të R.B., ish nga Gj., si shitës dhe S.A. nga P., si blerës, e vërtetuar në ish Gjykatën Komunale në Gj., me shenjë Vr. nr. 2570/2002, e datës 31.10.2002. III. Obligohen të paditurit që paditësve t'ia pranojnë këtë të drejtë si dhe të përmbahen e të durojnë që paditësit në bazë të këtij aktgjykimi në DGJKP të regjistroheshin si pronarë. IV. Obligohen të paditurit që paditësve t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës në shumën prej 2.961 €, të gjitha këto në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm".

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.496/2019, datë 22.12.2023 ishte vendosur "I. Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurit R.B. nga Gj. dhe ankesa e të paditurit S.A. nga P., ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.79/17, i datës 03.11.2018, ndryshohet dhe çështja lëndore gjykohet si në vijim: refuzohet kërkesëpadia e paditësve F.R. nga fshati V., Komuna e Gj., M.F. dhe Z.F., të dy nga Gj., me të cilën kanë kërkuar që të anulohet kontrata e shitblerjes së paluajtshmërisë e lidhur mes R.B., si shitës dhe S.A. nga P., si blerës, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjilan me shenjë Vr.nr. 2570/2002, datë 31.10.2002 dhe të Vërtetohet se paditësit janë pronar në bazë të mbajtjes dhe parashkrimit fitues, me nga 1/3 të pjesës ideale të parcelës kadastrale me nr. P 70403013-1581-0, në vendin e quajtur "B.D", me kulturë arë e klasit të tretë, në sipërfaqe prej 1.15.06 ha, e evidentuar në bazë të certifikatës së pronësisë me numër të lëndës 10501-2017 të datës 29.09.2017, në emër të paditurit S.L.A. nga P. dhe të obligohen të paditurit që paditësve t'ia pranojnë këtë të drejtë si dhe të përmbahen dhe të durojnë që paditësit në bazë të këtij aktgjykimi në DGJKP të regjistrohen si pronarë, si e pabazuar. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore".
3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor i autorizuari i paditësve, avokat M.M. nga Gj., ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni, që aktgjykimet e instancës më të ulët të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditësve të aprovohet si e bazuar ose të ndryshohen dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.
1. I padituri R.B, përmes të autorizuarit avokat A.Gj. nga P., në përgjigje të revizionit. ka kundërshtuar pretendimet e paditësve, duke kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që revizioni të refuzohet si i pa bazuar.
2. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion gjeti se: Revizioni i autorizuarit të paditësve, avokat M.M. nga Gj., është i pa bazuar.

3. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 18.08.2003, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi, kundër të paditurve, për anulimin e kontratës Vr.nr.2570/2002, datë 31.10.2002 të lidhur në Gjykatën Komunale në Gjilan për shitblerjen e paluajtshmërisë parcelës kadastrale nr. 1581, në vendin e quajtur “P.B.”, në sipërfaqe prej 1.15.06 ha. Paditësit me padi të veçantë përveç anulimit të kontratës, kishin kërkuar edhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë, prandaj gjykata sipas propozimit të paditësve në seancën e datës 04.04.2011, mori aktvendim për bashkimin e lëndëve C.nr. 430/03 dhe 431/03, ashtu që në vazhdim, lëndët do të udhëhiqen sipas shenjës C.nr. 430/03.
4. Gjykata Komunale në Gjilan, pas shqyrtimit të padisë, vlerësimit të pretendimeve të ndërgjyqësve dhe provave të administruara, me aktgjykimin C.nr. 430/2003 të datës 28.06.2011, ka vendosur të anulohet aktvendimi mbi shqyrtimin e trashëgimisë, T.nr. 195/2002, i datës 15.10.2002, me të cilin është shpallur trashëgimtar i vetëm R.B., nga Gj., të anulohet kontrata për shitblerjen e paluajtshmërisë Vr. Nr. 2570/2002, datë 31.10.2002, e lidhur në mes të shitësit R.B. dhe blerësit S.L. Ndërsa kërkesëpadinë e paditësve F.R., M.F. dhe Z.F. për vërtetimin e pronësisë në bazë të mbajtjes dhe kontratës verbale, e refuzoi si kërkesë të pabazuar, duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit. Gjykata e Qarkut në Gjilan, si gjykatë e shkallës së dytë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurve dhe ankesës së paditësve, me aktvendimin Ac.nr. 293/2011 të datës 18.04.2012 ka vendosur që aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje. Në procedurën e rigjykimit gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave, me aktgjykimin C.nr. 387/12, datë 04.11.2013, në pikën I të dispozitivit ka vendosur të anulohet kontrata e shitblerjes së paluajtshmërisë e lidhur në mes të R.B., nga Gj. si shitës dhe S.A. nga P., si blerës, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjilan, nën shenjën Vr.nr. 2570/2002 e datës 31.10.2002, në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke vërtetuar që paditësit janë pronar në 1/3 pjesë ideale të paluajtshmërisë parcelës kadastrale nr.1581, në vendin e quajtur “B.D.”, ZK Gjilan, duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit në fjalë.
5. Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur sipas ankesave të autorizuarve të paditurve, me aktvendimin CA.nr. 103/2014 të datës 04.11.2016, ka vendosur që të

prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr. 387/2012 i datës 04.11.2016 dhe lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje, me sugjerimet e dhëna. Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim ka zhvilluar procedurën për administrimin e provave, duke ardhur në përfundim që kërkesëpadia e paditësve është e bazuar. Prandaj, me aktgjykimin e atakuar C.nr.79/17, të datës 03.11.2018, e aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

6. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit dhe për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike, bashkë me ekspertët gjeodet ka bërë shikimin në vend, ndërsa si provë materiale ka administruar: certifikatën e pronës për njësinë kadastrale 01581-0, të datës 29.09.2017, me numër të lëndës 10501/2017, e cila parcelë evidentohet në emër të paditurit S.A.; ekspertizën e gjeodezisë të datës 20.06.2017 dhe ekspertizën plotësuese të datës 29.09.2017, të punuar nga eksperti B.K.; ekspertizën e ekspertit gjeodet M.H., të datës 21.12.2017. Ka dëgjuar dëshmitarët F.R., K.R., B.Gj., S.S., Zh.S., B.M. dhe R.A.. Ka bërë leximin e deklaratës së dëshmitarit A.N., të dhënë në procesverbalin e datës 28.06.2011 dhe deklaratën e dëshmitarit H.R. të dhënë në procesverbalin e datës 16.03.2005, ndërsa, në cilësinë e palës ka dëgjuar të paditurin S.A.
7. Më tej, në pjesën e arsyetimit gjykata ka përshkruar konstatimet dhe të gjeturat e ekspertëve gjeodet, për identifikimin e paluajtshmërisë, gjendjen në terren dhe pronat me të cilat kufizohet paluajtshmëria kontestuese, duke dhënë vlerësimin se ekspertizat i pranoi si prova të besueshme, ngase janë punuar nga ekspert gjeodet të licencuar dhe me përvojë në këtë fushë. Ka shtuar se deklarimeve të dëshmitarëve: A.N., F.R., K.R., B.M., R.A. dhe H.R., ia fali besimin e plotë ngase dëshmitarët ishin të sinqertë, dhe thëniet e tyre ishin në përputhje të plotë me njëra tjetrën dhe pretendimet e paditësve. Ndërsa, deklarimeve të dëshmitarëve B.Gj., S.S., Zh.S., gjykata nuk ia fali besimin me arsyetimin se nuk ishin të sinqerta gjatë deklarimeve të tyre dhe thëniet e tyre, nuk përkonin me realitetin faktik. Në fund, ka parashtruar se pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe në bazë të rezulttit të procedurës provuese, vërtetoi gjendjen faktike se paraardhësit e paditësit F.R. në vitin 1966-67 e kanë blerë nga i ndjeri V.B., parcelën e cila gjendet në vendin e quajtur "B.D." në Gj., e cila ka sipërfaqe prej 1.15,06 ha dhe pas pagesës në tërësi të çmimit të shitblerjes të njëjtit kanë hyrë në posedim dhe

shfrytëzimit të papenguar nga askush deri në vitin 2003. Këtë fakt gjykata e ka vërtetuar përmes dëshmitëve të dëshmitarëve A.N., F.R., K.R., B.M. (i njëjti është fqinjë në parcelën kontestuese), R.A. dhe H.R., të cilëve dëshmitarë gjykata ia fali besimin e plotë. Duke u bazuar në një gjendje të tillë faktike në njërin anë, dhe bazuar në nenin 28 (të LMTHPJ – së, gjykata e shkallës së parë erdhi në përfundim se paraardhësit e paditësve dhe paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë në këtë parcelë ngase kanë qenë mbajtës me mirëbesim dhe të ligjshëm të kësaj parcele.

8. Lidhur me arsyet për anulimin e kontratës së shitblerjes së paluajtshmërisë, të lidhur në mes të R.B., nga Gj., si shitës dhe S.A. nga P., si blerës, të vërtetuar në ish Gjykatën Komunale në Gjilan me shenjën Vr.nr.2570/2002, dt. 31.10.2002, gjykata ka parashtruar se i padituri R.B., në momentin e shitjes së parcelës tani kontestuese, nuk ka mundur të disponojë lirishit me këtë të drejtë ngase i njëjti nuk ka qenë pronar faktik i kësaj parcele, pasi që e njëjta ishte shitur nga babai i tij tani i ndjeri V.J.B. qysh në vitin 1966-67, paraardhësit të paditësit të parë F.R. Ky fakt vërtetohet në mënyrë të plotë dhe të qartë nga dëshmitë e dëshmitarëve të cilëve gjykata ia fali besimin e plotë e sidomos dëshmisë së dëshmitarit B.M., i cili është edhe fqinj me parcelën kontestuese dhe ai në mënyrë plotë e ka vërtetuar faktin se paraardhësit e paditësve dhe vetë paditësit e kanë punuar këtë parcelë.
9. Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes, përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi përveç që përfshihet në shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 lidhur me nenin 8 dhe 182.2 pika n) e LPK-së, i njëjti aktgjykim është rezultat i gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, e që ka ndikuar edhe në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
10. Sipas gjykatës së shkallës së dytë, arsyetimi i aktgjykimit të ankuar nuk i referohet qartë fakteve vendimtare për të vërtetuar themelësinë e kërkesëpadisë, ndërsa arsyet e parashtruara janë kontradiktore me njëra tjetrën dhe nuk vërtetojnë themelësinë e

kërkesëpadi. Gjykata është mjaftuar vetëm me përshkrimin e përmbajtjes së ekspertizave të gjeodezisë, në të cilat paraqitet sipërfaqja dhe kufizimi i paluajtshmërisë lëndore me pronat përreth, ndërsa gjykata ka theksuar se ekspertizat i pranoi si prova të besueshme ngase janë punuar nga ekspert gjeodet të licencuar dhe me përvojë në këtë fushë. Konstatimi se ekspertët janë të licencuar dhe me përvojë në këtë fushë, për gjykatën e shkallës së dytë, nuk paraqet asnjë relevancë për vendosje. Gjithashtu edhe grupimi i dëshmitarëve (të sinqertë dhe të pasinqertë), si në pjesën e arsytimit të gjykatës së shkallës së parë, pa e çmuar fuqinë provuese të tyre për faktet vendimtare, nuk paraqet arsye të mjaftueshme për të ardhur në përfundim se paditësit kanë fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë lëndore mbi bazën e nenit 28 të LMTHPJ-së, dhe rrjedhimisht as legjitimitetin e paditësve për të kërkuar anulimin e kontratës së shitblerjes, të lidhur në mes të paditurve, e cila kontratë është vërtetuar në gjykatë me datë 31.10.2002.

11. Gjykata ankimore me referim në ekspertizat e gjeodezisë vlerëson se nga e njëjta provë nuk rezulton që paluajtshmëria fizikisht është e ndarë në tre pjesë dhe që është shfrytëzuar nga paditësit, pasi posedimin dhe shfrytëzimin e paluajtshmërisë nga paditësit, ekspertët e konstatojnë vetëm mbi bazën e deklarimeve të paditësve dhe nuk paraqesin ndonjë provë materiale për të mbështetur konstatimet në këtë drejtim, gjersa deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar në gjykatën e shkallës së parë, nuk pasqyrojnë ndonjë gjendje faktike dhe bindëse se në të vërtetë ka ekzistuar një marrëveshje e lidhur gjatë viteve 1966/67 për shitblerjen e paluajtshmërisë dhe që ajo marrëveshje të jetë përmbushur. Aktgjykimin e ankimuar gjykata e ka mbështetur kryesisht në deklaratim e dëshmitarëve që kanë lidhje familjare apo miqësore me paditësit, dhe të cilat deklarata nuk janë të mjaftueshme dhe as objektive për të provuar faktet vendimtare për kushtet e fitimit të së drejtës në pronë në paluajtshmërinë lëndore. Për më shumë, nga koha kur paditësit pretendojnë se kanë të drejtën legjitime, përkatësisht nga shitblerja e paluajtshmërisë në mes të paraardhësit të paditësit të parë dhe paraardhësit të paditurit të parë, (në vitet 1966 apo 1967), e deri në parashtrimin e padisë, paditësit nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për bartjen e pronës dhe as nuk kanë parashtruar ndonjë provë se si shfrytëzues të paluajtshmërisë, kanë paguar obligime tatimore për paluajtshmërinë lëndore, apo që paluajtshmërinë e kanë shfrytëzuar me mirëbesim dhe për një periudhë më tepër se njëzetë vite pandërprerë. Prandaj, nga arsyet e parashtruara, gjykata ankimore vjen në përfundim që kërkesëpadija e paditësve, për vërtetimin e të drejtës në

pronë është e pathemeltë, ndërsa për shkak të pathemelësisë së kërkesëpadisë në këtë pjesë, paditësit nuk kanë legjitimitetin aktiv që të kërkojnë nga gjykata vlerësimin e ligjshmërisë së kontratës së shitblerjes Vr. Nr. 2570/2002 të lidhur me datë 31.10.2002, në mes të R.B. si shitës dhe S.A. si blerës, kontratë e cila është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjiilan. Prandaj sipas gjykatës së shkallës së dytë, rezultojnë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, me rastin e marrjes së aktgjykimit të atakuar, për arsye se është provuar fakti se në rastin e paditësve nuk plotësohen kushtet ligjore nga neni 28.4 i LMTHJP-së për të konstatuar se paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi parcelën kontestuese të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe ka rezultuar se kërkesëpadia e paditësve është tërësisht e pabazuar në ligj dhe fakte, gjykata e shkallës së dytë vendosi që të ndryshoj aktgjykimin e atakuar dhe të refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të tillë të çështjes, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë sipas nenit 215 të LPK kujdeset sipas detyrës zyrtare e as me shkelje të tjera të dispozitave ligjore të LPK-së, të pretenduara nga revizioni. Dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, Gjykata Supreme konsideron se pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykata e shkallës së dytë i është përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së dytë, dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, dhe përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare, ka përmbajtje koherente dhe janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozita ligjore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit të atakuar me revizion.

2. Ndërsa sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë, përkitazi me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit, dhe për këtë janë dhënë arsyet bindëse dhe të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Kjo gjykatë konsideron se referuar nenit 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, parashihet se e drejta e pronësisë fitohet sipas ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi apo me vendim të organit shtetëror në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me ligj. Në rastin konkret, paditësi nuk e ka provuar as bazën juridike e as mënyrën e fitimit (iustus titullus-modus aquirendi) të paluajtshmerisë kontestuese. Marrëveshjen për të cilën pretendon paditësi se e ka arritur paraardhësi i tij me paraardhësin e të paditurit të parë me qenë se nuk mundi ta dëshmoi sepse ishte lidhur sipas tij pa formë të shkruar dhe nuk kishte as dëshmi të plotësimit të pagesës. Gjykata e shkallës së dytë me të drejtë e cek edhe faktin se prova e vetme në të cilën bazohet gjykata e shkallës së parë janë deklaratat e familjarëve të paditësve, ndërsa nuk prova të besueshme se ka ndodhur shitja jo formale apo se është paguar çmimi.
3. Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, për arsye se paditësi nuk e ka fituar pronësinë në mënyrat e parapara me nenin 33 të Ligjit mbi Marrëdhëniet pronësore juridike (Gaz.Zyrtare e RSFJ Nr 6/80, 36/90, i cili parasheh se e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me një punë të vlefshme juridike dhe me regjistrimin në "librin publik (libri kadastral), ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj. Gjykata Supreme gjenë se është i drejtë dhe i ligjshëm qëndrimi se parashkrimi fitues në vete përmban katër elemente të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të fituar të drejtën e pronësisë mbi një send të paluajtshëm: (1) mbajtësi i ligjshëm, (2) mirëbesimi, (3) kalimi i periudhës kohore të caktuar me ligj dhe (4) posedimi i sendit mbi të cilin dikush tjetër e ka të drejtën e pronësisë. Posedimi i mbajtësit është "i ligjshëm" nëse mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorim të besimit, ndërsa posedimi mund të jetë ligjor dhe pa pëlqim, por mund të jetë i paligjshëm, por me pëlqim. Më tutje posedimi konsiderohet se është me mirëbesim, nëse mbajtësi nuk e di ose nuk mund ta

dijë se sendi nuk është i tij, ndërsa në raste të caktuara mirëbesimi supozohet. Si rrjedhojë, referuar provave të administruara rezulton, se në rastin e paditësve nuk përmbushen në mënyrë kumulative, elementet e cekura më lartë, për të konstatuar se të njëjtit e kanë fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues mbi parcelën kontestuese dhe se ë rastin konkret paditësit nuk kanë bërë të besueshëm mirëbesimin, për të cilin kusht kanë pretenduar se plotësohet në bazë të kontratës joformale të vitit 1966 apo 1967 për shitblerjen e paluajtshmërisë lëndore, mes babait të paditësit të parë, si blerës dhe babait të paditurit të parë, si shitës. Ky fakt nuk është vërtetuar me asnjë provë të besueshme, gjersa gjykata e shkallës së parë, shitblerjen e pohuar nga paditësit, e konsideroi si referencë për të ardhur në përfundim që paditësit janë posedues me mirëbesim. Deri sa nuk është arritur të dëshmohet posedimi i ligjshëm, mirëbesimi në këtë rast nuk mund të konsiderohet se ka ekzistuar e as që mund të supozohet.

4. Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se me të drejtë, Gjykata e Apelit i referohet aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Gjilan, C.nr. 406/03, datë 13.08.2003, (bashkëngjitur si provë në shkresat e lëndë), nga i cili aktvendim rezulton se sipas padisë për pengim posedim, të iniciuar nga paditësi S.A. (tani i paditur), gjykata ka vërtetuar se me datë 01.08.2003, të paditurit M.F. dhe Z.F. (tani paditës) nga Gj. e kanë penguar paditësin në posedimin e fundit faktik të parcelës kadastrale në vendin e quajtur "P.B." me kulturë arë e klasit të III në sipërfaqe prej 1.15.06 ha, duke i urdhëruar të paditurit që me heqjen e materialeve nga parcela, të kthejnë paluajtshmërinë në gjendjen e mëparshme. Kjo vë në pikëpyetje pretendimin e paditëseve për posedim të pa penguar përgjatë periudhës kohore që pretendohet.
5. Pretendimet në revizion se kontrata e lidhur në mes të R.B. si shitës, dhe S.A. si blerës është nule, sepse paraardhësi i shitësit V.B., ka pas edhe trashëgimtare tjerë përveç shitësit R.B., u refuzua si i pa bazuar sepse në këtë kontest nuk është duke u vendosur për procedurën trashëgimore pas të ndjerit V, të cilën nuk e ka kontestuar në rrugë ligjore asnjëri nga pasardhësit, dhe rrjedhimisht paditësit nuk kanë legjitimitet për të kërkuar diçka të tillë, por për punën juridike të shitësit, R., i cili ka qenë i evidentuar si pronarë dhe ka pas të drejtë të lidh kontratë me blerësin, kontratë e cila është realizuar në tërësi. Gjykata Supreme i referohet nenit 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78, 39/85, 57/89), të aplikueshme në kohën e transakcion, i cili parashih se kontratë nule është "Kontrata që është në

kundërshtim me rendin publik, dispozitat urdhëruese, ose moralin e shoqërisë " ndërsa sipas nenit 111 të LMD-së së njejtë parashihet që "Kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidhur pala me zotësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është caktuar në këtë ligj ose me dispozitë të veçantë". Prandaj u refuzuan si të pa bazuara këto pretendime.

6. Nga ana tjetër pala e paditur, dëshmoi se e ka fituar pronësinë në pajtim me ligjin në fuqi, konkretisht sipas nenit 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr. 6/80) dhe nenit 13 të Ligjit për Qarkullimin e Pronës së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e RS nr. 45/81), që kanë qenë në fuqi në atë kohë, ku përcaktohet se për të fituar të drejtën pronësore mbi pronën në fjalë, duhet kontratë me shkrim, me nënshkrimet e vërtetuara nga organi kompetent dhe ky fitim i pronësisë, duhet të regjistrohet në librat kadastral. Kontrata ishte vërtetuar në Gjykatën kompetente dhe në librat kadastral prona ishte e regjistruar në emër të paditurit. Edhe pretendimi i revizionit për rrëzueshmerinë e kontratës në vështrim dispozitave të LMD-së është i paqëndrueshëm sepse nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e parapara e ligj për sa i përket vullnetit të palëve.
7. Në revizion, përsëriten thëniet përkitazi me gjendjen faktike, të cilat gjykatat e instancës më të ulët, i kanë vlerësuar dhe për të gjitha këto kanë dhënë arsye në arsyetimin e aktgjykimit. Për më tepër kjo gjykatë shton, se sipas nenit 214.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, përderisa revizioni në të vërtetë, për këtë arsye i godet aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët duke potencuar se këto aktgjykime janë të bazuara në vlerësimin e gabueshëm, të cilat sipas gjykatës së revizionit janë sqaruar në procedurën e shkallës së parë dhe në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë në procedurë sipas ankesës.
8. Thëniet tjera në revizion janë përsëritje e të thënave në ankesë, ku për të gjitha faktet relevante gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të qarta dhe bindëse që janë të pranuar edhe për këtë Gjykatë.
9. Për arsyet e paraqitura më lartë, Gjykata Supreme e Kosovës e refuzoi revizionin si të pa bazuar, sipas dispozitës së nenit 222 të LPK-së.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.282/2024, i datës 12.07.2024

”Të dy gjykatat kanë nxjerr përfundimin pa e sqaruar mirë gjendjen faktike. Nuk është sqaruar ekzistimi dhe ligjshmëria e kontratës joformale, marrja ne posedim dhe autenticiteti i kontratës së dytë. Gjykata Supreme e Kosovës gjene se është e pa mundur të vlerësohet aplikimi i së drejtës materiale karshi këtyre fakteve të pa sqaruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë, andaj gjykata e shkallës së parë është dashur të sqaroi përmes shkresave të kontratës së privatizimit dhe kontratës së shitblerjes e cila pretendohet nga njëra palë të jetë e falsifikuar.

Mos arsyetimi i fakteve qenësore, aktgjykimin e shkallës së parë e bënë kontradiktor, pjesën e dispozitivit dhe arsyet e dhëna, si dhe me shkresat e lëndës, për të cilën arsye ka pasur pretendime se pronari i parë hy ne transaksion joformal të vullnetshëm dhe se për arsye të pa sqaruara bashkëshortja e tij një herë me deklaratë të vërtetuar e pohon ndërsa më vonë e mohon. Gjykata e shkallës së dytë nuk e sqaron implikimin e pronarit nëse ka hyrë në transaksion me vullnet por sqaron vetëm kalimin e afatit për rrëzueshmërinë e kontratës“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin , C.nr.376/2016, i datës 23.01.2019, ka vendosur si vijon : *“I. Aprovohet kërkesëpapia e paditëses-kundër të paditurës E.Sh. nga Gjilani. anulohet Kontrata mbi shitblerjen e banesës VR.nr. 79/2000, e datës 20.06.2000, e lidhur në mes të paditurit-kundër paditësit E.A. në cilësi të blerësit dhe tani të ndjerit B.A. ish nga Gjilani, si kontratë absolutisht nule. II. vërtetohet se paditësja-kundër e paditura E.Sh. nga Gjilani, në bazë të shitblerjes është pronare e banesës me numër të njësisë O-70403013-03602-0-15-0-10-0, shfrytëzimi aktual banesë, në rrugën “NN”, kati II-të, në sipërfaqe prej 64 m², ZK Gjilan, e cila në bazë të certifikatës pronësore UL-70403013-11109, në DGJKP evidentohet në emër të paditurit-kundër paditësit E.A. nga Gjilani. III. detyrohet i padituri-kundër paditësi E.A. nga Gjilani, që t’ia dorëzoj paditëses në posedim dhe shfrytëzim, duke ia liruar nga njerëzit dhe sendet banesën me numër të njësisë O-70403013-03602-0-15-0-10-0, shfrytëzimi aktual banesë, në rrugën “NN”, kati II-të, në sipërfaqe prej 64 m², ZK Gjilan, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit. IV. refuzohet si e pabazuar në ligj kundër kërkesëpapia e të*

paditurit-kundër paditësit E.A., e ushtruar ndaj paditëses-kundër të paditurës E.Sh., me të cilën ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të kontratës së shitblerjes së banesës me numër të njësisë O -70403013-03602-0-15-0-10-0, shfrytëzimi aktual banesë, në rrugën “NN”, kati II-të, në sipërfaqe prej 64 m², ZK Gjilan. V. secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.”

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2586/2020, të datës 24.04.2024, në pikën I të dispozitivit "Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurit- kundër paditësit E.A. nga Gjilani si dhe ankesa e të paditurve F., K., K., K., dhe K.A., të gjithë nga Gjilani, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.375/19, i datës 23.01.2019, dhe çështja gjykohet si vijon: Refuzohet kërkesëpapia e paditëses - kundër paditurës E.Sh. nga Gjilani dhe ndërhyrësit në anën e paditësit Sh.K., nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar që të anulohet kontrata mbi shitblerjen e banesës, VR.nr. 79/2000, e datës 20.06.2000, e lidhur në mes të paditurit-kundër paditësit E.A., në cilësi të blerësit dhe tani të ndjerit B.A., ish nga Gjilani, si kontratë absolutisht nule. Vërtetohet se paditësja-kundër e paditura E.Sh., nga Gjilani, në bazë të shitblerjes është pronare e banesës me numër të njësisë O-70403013-03602-0-15-0-10-0, shfrytëzimi aktual banesë, në rrugën “NN”, kati II-të, në sipërfaqe prej 64 m², ZK Gjilan, e cila në bazë të certifikatës pronësore UL-70403013-11109, në DGJKP evidentohet në emër të paditurit-kundër paditësit E.A., nga Gjilani si dhe detyrohet i padituri-kundër paditësi E.A. nga Gjilani, që t’ia dorëzoj paditëses në posedim dhe shfrytëzim, duke ia liruar nga njerëzit dhe sendet banesën me numër të njësisë O-70403013-03602-0-15-0-10-0, shfrytëzimi aktual banesë, në rrugën “A.T.”, kati II-të, në sipërfaqe prej 64 m², ZK Gjilan, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit, në tërësi si e pabazuar. II. Papia e të paditurit-kundërpaditësit E.A. nga Gjilani me të cilën ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të kontratës së shitblerjes së banesës me numër të njësisë O - 70403013-03602-0-15-0-10-0, shfrytëzimi aktual banesë, në rrugën “A.T.”, kati II-të, në sipërfaqe prej 64 m², ZK Gjilan, hedhet si e palejuar. III. Obligohet paditësja-e kundër paditura E.Sh. që të paditurve t’ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 12,455.20 €, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi".
1. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.2586/2020, të datës 24.04.2024, paditësja -kundër e paditura, përmes të autorizuarve Sh.P., avokat

nga Gjilani dhe Sh.S. nga Prishtina, në afatin ligjor ka ushtruar revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2.n, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale që ka të bëjë me nenin 117, par.3 të LMD-së dhe neneve 10,12, 16 dhe 103 të LMD-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të pranojë revizionin e paditëses- kundre të paditurës, në tërësi si të bazuar të ndryshojë, aktgjykimin e Gjykatës së Apelit duke e lënë në fuqi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, apo të prishë aktgjykimet e cekura më lartë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

2. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 215, gjeti se: Revizioni i paditësvë është i bazuar.
3. Nga shkresat e çështjes rezulton se paditësja E.Sh., më datë 11.01.2007, ka paraqitur padi, kundër të paditurave E.A., F., K., K., K., dhe K.A., për vërtetimin e së drejtës së pronësisë mbi banesën objekt kontesti dhe kërkon anulimin e kontratës së shitblerjes së lidhur mes të paditurit të parë E.A. dhe B.A., e vërtetuar me datë 20.06.2000. Paditësja pretendon se nga burri i të paditurës F. dhe babai i të paditurve K., K. dhe K.A., e B.A., nga fundi i vitit 1995, e ka blerë banesën e cila gjendet në Gjilan, ish pronë e F. së B., të cilën e ka pas në shfrytëzim B.A., dhe me kontratën e privatizimit në vitin 1993 e ka blerë nga dhënësi i banesës dhe e ka vërtetuar kontratën në gjykatë. Paditësja pretendon se e ka blerë për çmimin prej 65,000.00 DM, e ka paguar në tërësi çmimin blerës dhe se pastaj ka marrë në posedim banesën në fjalë ku ka jetuar deri në vitin 1998, ku më pas ka emigruar jashtë vendit në Zvicër dhe se kur është kthyer në vitin 2005 nga Zvicra, ka hasur në banesë personin E.A. respektivisht i padituri i parë me familje. Pas, kësaj situete e njëjta thekson se ka kontaktuar me bashkëshorten e të ndjerit B.A., F., për faktin se B. kishte ndërruar jetë, dhe nga e njëjta ka marrë një deklaratë e cila i ka konfirmuar se burri saj nuk i ka shitur tjetër kujt banesën në fjalë e cila më pastaj ka ndërruar deklaratën në fjalë. Paditësja pretendon se kontrata e lidhur mes B.A. dhe të paditurit E.A. është e kundërligjshme për arsye se B., por edhe gruaja e tij F., e kanë ditur që banesën në fjalë ma kanë shitur mua përmes ndërmjetësuesit M.B., nga i cili edhe kanë pranuar çmimin e shitjes së banesës në shumë prej 65,000.00 DM, dhe se për këtë kontrata e lidhur me datë 29.06.2000 duhet të anulohet si e

paligjshme, ndërsa të vërtetohet se paditësja ka të drejtën e pronësisë mbi bazën e shitblerjes, mbi banesën objekt kontesti.

4. I padituri i parë, me datë 12.06.2012, ka ushtruar kundërpadi kundrejt paditëses me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se është pronar dhe posedues i banesës objekt kontesti në bazë të punës juridike sipas marrëveshjes së shitblerjes. Pretendon në kundërpadi se banesën objekt kontesti e ka blerë nga i ndjeri B.A. në vitin 1998, për çmimin prej 200.000.00 dinarë, më 15.04.1998, mirëpo për shkak të pengesave/ndalesave burokratike administrative të kohës nuk ka mundur të vërtetoj në atë vit kontratën në gjykatë, por këtë e ka bërë në vitin 2000, ashtu që ka vërtetuar kontratën e shitblerjes së banesës më datë 29.06.2000, nën numrin Vr.nr.79/2000, në të cilën banesë jeton edhe sot me familjen e tij. Mbi bazën e kësaj kontrate e ka regjistruar në libra publik në kadastër, si pronë të tij. Gjykata e shkallës së parë mbi provat e administruara, dëshmitë e dëshmitarëve, deklaratimet e palëve erdhi në përfundim se kontrata e Vr.nr.79/2000, e datës 29.06.2000, e lidhur në mes të B.A. dhe tani të paditurit E.A., është e kundërligjshme dhe duhet anuluar, dhe se paditësja e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e transaksionit joformal, pagesës së çmimit dhe marrjes në posedim. Për këtë urdhëroi që i padituri ta liroi banesën nga njerëzit dhe sendet dhe të njëjtën t'ia lërë në posedim paditëses.
5. Gjykata e Apelit vlerësoi së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje me rëndësi esenciale të dispozitave të natyrës procedurale, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, por se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar me rastin e dhënies së zgjidhjes ligjore përkitazi me pretendimet sipas kërkesëpadisë së paditëses dhe kërkesës së kundër paditësit, kjo si pasojë e interpretimit të gabuar të gjendjes faktike të vërtetuar nga shkalla e parë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndaj në këtë drejtim është dashur që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet me synimin që të përligj gjendjen faktike nga e cila rezulton situatë e qartë se kërkesëpadia e paditëses-kundër paditurës është e pabazuar në ligj ndërsa kërkesa e të paditurit – kundër paditësit është e palejuar. Gjykata e Apelit, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktgjykimit të atakuar përmes pretendimeve ankimore të ngritura me ankesën e të paditurit ka gjetur se të njëjtat janë të bazuara dhe se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është dashur

të ndryshohet me qëllim të zbatimit të drejtë të së drejtës materiale e gjithë kjo ndikuar nga themeli faktik që ka rezultuar nga procesi të provuarit në shkallë të parë e i cili themel faktik nuk pasqyron rrethana në favor të pretendimeve sipas kërkesëpadisë së paditësit. Gjykata e Apelit kishte vlerësuar, si të qëndrueshme pretendimet ankimore të paditurve, lidhur me çështjen e lejueshmërisë së padisë së paditëses, për anulimin e kontratës Vr.nr.79/2000 të datës 20.06.2000. Në rastin konkret gjykata e faktit ka dështuar të vlerësoj drejtë çështjen e ekzistimit të prezumimeve procedurale negative lidhur me lejueshmërinë e padisë, në këtë rast, duke mos dhënë vlerësimin e duhur profesional lidhur me çështjen e afatshmërisë së padisë së paditëses, në kuptim të dispozitës së nenit 117 të LMD-së, afat ky prekludues për palët.

6. Gjykata e Apelit i vlerësoi si të qëndrueshme dhe të bazuara pretendimet ankimore për paligjshëmriinë e aktgjykimit të atakuar edhe në pjesën me të cilën është vlerësuar kërkesëpadia e paditëses, për nga meritat e saja, kur ka njohur të drejtën e pronësisë mbi bazën e shitblerjes, kjo nisur nga vlerësimi i tërësisë së fakteve dhe provave që janë administruar në çështjen kontestuese nga e cila *nuk rezultojnë* të vërtetuara pretendimet petitore të paditëses, për vërtetimin e së drejtës së pronësisë së saj mbi banesën objekt kontesti mbi bazën e shitblerjes, kjo për arsye se në rastin konkret nga themeli faktik që ka rezultuar në këtë çështje, i cili është formësuar në mënyrë të plotë, për të dhënë epilogun e çështjes, nuk është vërtetuar se paditësja ka lidhur kontratë shitblerjeje me tashmë të ndjerin B.A. Pra, në situatën e tillë duke vlerësuar ligjshëmriinë e pretendimeve të paditëses karshi fakteve dhe të provuarit të çështjes gjykata e shkallës së dytë vendosi se nuk është arritur të vërtetohen fakte me relevancë që determinojnë çfarëdo të drejte të paditëses mbi banesën objekt kontesti qoftë në raport me tashmë të ndjerin B.A. apo edhe me të paditurin e parë, e gjithë kjo në mungesë të provuarit të pretendimeve për ekzistimin e aktit të shitblerjes në mes të paditëses dhe të ndjerit B., ndërkohë që në këtë situatë kemi një kontratë të vërtetuar mes të paditurit E. Dhe B.A. mbi bazën e së cilës i padituri ka bartur në emër të tij banesën kontestuese tek regjistrat kadastral dhe se i njëjti është në posedim të saj qysh prej kohës së blerjes së saj - vitit 1998.
7. Gjykata e Apelit gjeti se padia e të paditurit të parë - kundër paditësit do të duhej hedhur si e palejuar nga gjykata e shkallës së parë për shkak të mungesës së ekzistimit të interesit juridik të paditurit të parë - kundër paditësit që të vërtetoj ekzistimin e një

raporti të tillë materialo-juridik duke qenë se ky raport, pra vet e drejta e pronësisë së të paditurit E.A. është e regjistruar zyrtarisht në regjistrat përkatës kadastral ndaj dhe në mungesë të interesit juridik për të ushtruar padi të tillë, kolegji ka gjetur se padia e të paditurit-kundër paditësit E.A. duhet hedhur si e palejuar në zbatim të dispozitës së nenit 2 parg.4 i LPK-së i cili parasheh se *“Pala duhet të ketë interes juridik për padinë dhe për veprimet procedurale tjera që mund të kryhen në procedurë”*, ndërsa me nenin 254 parag. 2 i LPK së parashihet se *“Padia e këtillë mund të ngrihet kur kjo është përcaktuar me dispozita të posaçme, apo kur paditësi ka interes juridik që gjykata të vërtetojë ekzistimin apo mosekzistimin e ndonjë të drejte apo të raportit juridik, ose vërtetësinë, respektivisht mos vërtetësinë e ndonjë dokumenti para se të jetë bërë e kërkueshme kërkesa për pretim nga raporti i njëjtë”*. Pra në rastin konkret kërkohet që i padituri- kundër paditësi të ketë interes juridik për të kërkesat e tija sipas padisë për vërtetimin e pronësisë ndaj dhe në mungesë të këtij interesi duke qenë se tashmë paditësi evidentohet zyrtarisht si pronar i banesës kontestuese, kolegji ka vendosur si në pikën (II) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 pika (n) të LPK, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuara me nenin 182.1 lidhur me nenin 194 dhe 204 të LPK, për të cilin shkak të dy aktgjykimet patjetër u deshtë të prishen.
2. Si me ankesë ashtu edhe me revizion kontestohet ligjshmëria e aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, me arsyetim se aktgjykimi i shkallës së parë dhe i shkallës së dytë janë kontradiktor, nga mënyra e vendosjes dhe arsytet e dhëna, të cilin pretendim si të bazuar e pranon Gjykata Supreme.
3. Në aktgjykimin e shkallës së parë, shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, qëndron për faktin se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, pasi që

dispozitiv i aktgjykimit të ankimuar është kontradiktor dhe kundërtëhënës, pra në kundërshtim të plotë me vet arsyet e dhëna, si dhe provat në shkresat e lëndës, vendosja si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë për nulimin e kontratës ekzistuese dhe gjykata e shkallës së dytë duke konstatuar se ka kaluar afati prej 5 vjetësh për kërkesën e anulimit të kontratës mbi bazën e rrëzueshmërisë. Gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar se B.A. kishte hyrë në transaksion jo formal me paditësen dhe se e kishte shitur banesën për çmim prej 65.000.00 DM (marka Gjermane) dhe se këtë çmim e kishte paguar në tërësi. Këtë me deklaratë formale të vërtetuar në Gjykatë e pohon edhe bashkëshortja e B.A., pronari i parë që e ka privatizuar banesën shoqërore, deklaratë të cilën më vonë e tërheq. Dëshmitari që nuk ka lidhje familjare e as kurrfarë afrie me palët është Ismet Latifi, i cili deklaron se ka qenë prezent bashkë me Ziadin Shkodrën dhe Mustafë Mustafën kur janë paguar nga njëri këstë i të hollave dhe është përpiluar me shkrim një shënim, të cilin pohon se e ka nënshkruar. Paditësja e ka lëshuar me qira banesën dhe personat që e kanë marr me qira e pohojnë një gjë të tillë, për faktin se ka ikur nga rrethanat që lidhen me luftën në Kosovë, duke shkuar në Zvicër dhe në mungesë të leje qarkullimit dhe dokumenteve, nuk ka ardhur në Kosovë deri në vitin 2005, kur e ka gjetur të uzurpuar nga i padituri.

4. I padituri deklaron se ka arritur marrëveshje jo formale më 15.04.1998, se ka hy në posedim në fund të vitit 1999, dhe se e ka formalizuar këtë kontratë më 20.06.2000, duke e nënshkruar kontratën me numër 79/2000, ndërsa në kërkesën e Prokurorisë për verifikimin e nënshkrimeve, Gjykata, zyrtari të cilës e ka nënshkruar dhe vulosur këtë kontratë përgjigjet se në librin e evidencës së gjykatës mungojnë fletët dhe të dhënat nga numri rendor 73 deri në nurin rendor 101, përfshirë edhe numrin 79 ku do të duhej të ishte verifikuar kontrata. As gjykata e shkallës së parë e as ajo sipas ankesë nuk e adresojnë këtë çështje e as që e kërkojnë fare dosjen me shkresat e lëndës. Nga shkresat e lëndës del se nënshkruesi i kësaj kantatë pronari B.A., ka ndërruar jetë më 29.06.2000. Paditësi e pohon se në fund të vitit 1999, kur e ka marr në posedim, prona ishte e zbrazët nga njerëzit po jo edhe nga sendet.
5. E paditura vazhdimisht ka kërkuar që të vërtetohet se kontrata e lidhur në mes të padituritë parë dhe tani të ndjerit B., është e falsifikuar, dhe këtë e potencon edhe në revizion, duke u thirrur në shkresën zyrtare të Gjykatës që i përgjigjet Prokurorisë së Gjilanit duke e njoftuar se evidenca e nënshkrimeve në librin e kontratave të kësaj

gjykatë, nuk ekziston. Nuk është sqaruar fare transaksioni midis B.A. dhe E.A. në vitin 1998, kurse deklaroi se e ka marrë në posedim në fund të viti 1999, dhe se e ka gjetur të zbrazët. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, kanë paraqitur arsye kundërtë dhe në kundërshtim me shkresat e lëndës në lidhje me faktet vendimtare që kanë të bëjnë me fitimin e pronësisë mbi bazën e një kontrate joformale ose të një kontrate cila nuk gjendet në evidencën e gjykatës. Të dy gjykatat kanë nxjerrë përfundimin pa e sqaruar mirë gjendjen faktike. Në kësi rrethanash të pa sqaruara, Gjykata Supreme e Kosovës gjene se është e pamundur të vlerësohet aplikimi i së drejtës materiale karshi këtyre fakteve të pa sqaruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë, andaj gjykata e shkallës së parë është dashur të sqaroi përmes shkresave të kontratës së privatizimit dhe kontratës së shitblerjes e cila pretendohet nga njëra palë të jetë e falsifikuar.

6. Mos arsyetimi i fakteve qenësore, aktgjykimin e shkallës së parë e bënë kontradiktor, pjesën e dispozitivit dhe arsyet e dhëna, si dhe me shkresat e lëndës, për të cilën arsye ka pasur pretendime se pronari i parë tani i ndjeri B.A. ka hyrë në transaksion joformal të vullnetshëm dhe se për arsye të pa sqaruara bashkëshortja e tij një herë me deklaratë të vërtetuar e pohon ndërsa më vonë e mohon. Varësisht se a ka ekzistuar shitja joformale, dhe a e ka tjetërsuar pronën me vullnet, i ndjeri duhet trajtuar çështja autenticitetit të nënshkrimeve në kontratë, për faktin se shitja e dytë do të ishte në kundërshtim me rendin publik dhe dispozitat urdhëruese. Gjykata duhet të sqaroi rrethanat e marrjes në posedim në dritën e faturave të komunaleve të cilat prej vitit 1997 deri në vitin 2004 janë të evidentuara në emër të paditëses.
7. Gjykata e shkallës së dytë ka qenë e detyruar që në procedurën ankimore sipas nenit 194 të LPK, të kujdeset sipas detyrës zyrtare, përkritazi me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 të këtij Ligji, për shkak se nuk ka vepruar në pajtim me këto dispozita ligjore ajo ka bërë shkeljen thelbësore të procedurës kontestimore nga neni 182.1 lidhur me nenin 194 për të cilat shkaqe u desh të prishet edhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë.
8. Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitohet shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të sipas propozimit të palëve, gjykata të ndërmerë hapat tjerë procedural në

drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, përmes administrimit të provave, shkresave të lëndës Ov.nr.511/1993, të datës 02.03.1993 dhe kontratën me numër të vërtetimit 79/2000, të datës 20.06.2000, dhe pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe kundër padinë e të paditurit, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si me lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

9. Nga sa u tha më lartë e me zbatim të nenit 224.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi që të prishen të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.303/2024, i datës 17.07.2024

"Komuna e Gjilanit nuk ka caktuar interes publik, nuk ka ushtruar pushtet sipas ligjit në rregullimin e territorit por ka investuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve lokal në zona të ndërtuara pa plan urbanistik. Prona nuk është marrë as juridikisht që të tjetërsohej nga titullari e as faktikisht sepse e njëjta ka mbetur në shfrytëzim të banorëve lokal, në kushte të njëjta siç ka qenë, si rruge dhe qasje e vetme, përfshirë edhe paditësin i cili kishte mbetur në evidencë pronar i një pjese të rrugës.

Me shtruarjen në asfalt e paditura nuk e ka ndërruar pronësinë e as destinimin e pronës për të cilën pretendohet se paditësi është shpronësuar. Edhe më tutje pjesa që ka qenë dhe mbetur rrugë në sipërfaqe prej 130 metra katrorë është e evidentuar në emër të paditësit dhe nuk i është dhënë atributi i rrugës publike, por rrugë lokale në shfrytëzim të banorëve që i kanë blerë trojet nga parcela amë e njëjta, dhe kjo pjesë shfrytëzohet si rrugë, nga banorët lokal, përfshi edhe paditësin".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.452/2015, datë 22.02.2021, ishte vendosur " I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpapia e paditësit S.I. nga Gjilani, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, dhe detyrohet e paditura, që në emër të paluajtshmërisë së shpronësuar dhe atë sipërfaqes prej 130m², sipërfaqe kjo në kuadër të ngastrës kadastrale numër 2479-4 ZK Gjilan, ti paguaj paditësit shumën e të hollave në lartësi prej 29,000.00€, me kamatë prej 8%, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas ditës së shpalljes së vendimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. II. Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit që paditësit S.I. nga Gjilani, t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 1,116.20 euro, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, kurse detyrohet paditësi që kësaj gjykate t'ia paguaj taksat shtesë në shumën prej 85 euro, në emër të taksës gjyqësore për dorëzimin e padisë."
2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7813/2021, datë 13.05.2024, refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit, ndërsa Aktgjykimi

Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.452/2015 i datës 22.02.2021, vërtetohet, përveç në pjesën që ka të bëjë me lartësinë e kamatës në të cilën pjesë ndryshohet dhe vendoset ashtu që: detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7813/2021, datë 13.05.2024, e paditura në afatin ligjor, ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni i të paditurës të aprovohet dhe që aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulët të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit ose të anulohen dhe kjo çështje të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
4. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se: Revizioni i të paditurës është i bazuar.
5. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi më datë 10.08.2015, ka paraqitur padi, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, për kompensimin e dëmit, duke pretenduar se ka asfaltuar një pjesë të rrugës lokale e cila është e evidentuar në pronësi të paditësit, dhe se ky asfaltim është bërë pa pëlqimin e pronarit. Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave materiale dhe vlerësimit të gjendjes faktike, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.452/15 i datës 22.02.2021, me të cilin është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit më gjerësisht si në dispozitiv dhe arsyetim të këtij aktgjykimi.
6. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit, ka konstatuar se padia dhe kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, sepse sipas ekspertizës së gjeodezisë të datës 14.10.2019, me konstatimin dhe mendimin e ekspertit V.A., i cili ka konstatuar se parcela kadastrale 2479-4, me sipërfaqe 637m², ku në pjesën jugore të kësaj parcele kadastrale për të cilën dhe kërkohet kompensimi nga ana e paditësit, faktikisht në teren është e shtruar me asfalt, në sipërfaqe prej 130m², dhe atë duke filluar nga kufiri faktik juglindor e deri te kufiri ligjor jugperëndimor. Sipas Ekspertizës- Raportit të vlerësimit

të punuar nga vlerësuesi i licencuar V.H., i datës 04.11.2020, i njëjti ka vlerësuar se sipërfaqja prej 130m², në vitin 2019 kur është bërë vlerësimi i pasurisë ka pasur vlerën prej 222.61 euro për m² e që shuma e përgjithshme për sipërfaqen 130m² është 28,938.71 euro, duke e rumbullaksuar në shumën prej 29,000.00 euro. i njëjti ka sqaruar se këtë vlerësim e ka bërë dhe duke u bazuar në kontratat mbi shitblerjen e pasurive të asaj kohe. Gjykata e shkallës së parë u ka falur besim të plotë të dy deklaratave, pasi që të njëjtit janë profesional, dhe raportet e tyre janë punuar në mënyrë të paanshme, të pavarur dhe profesionale. Nga shikimi i vendngjarjes nga ana e gjykatës është vërtetuar se një pjesë e parcelës 2479-4 ZK Gjilan, shfrytëzohet si rrugë. Duke marrë parasysh se paditësit i është marrë pasuria me qëllim të shfrytëzimit publik, dhe nuk i është paguar asnjëherë, atëherë gjykata ka konsideruar se të njëjtit i është shkaktuar dëm dhe në bazë të nenit 185 paragrafi 3 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978) ku përcaktohet se: "Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme ta bëjë këtë personi përgjegjës, gjykata do të caktoj që ai t'ia paguaj dëmtuesit shumën përkatëse të të hollave për kompensimin të dëmit." Gjykata gjithashtu është bazuar dhe në Ligjin për Rrugët (L.nr.2003/11), më saktësisht në nenin 5 paragrafi 2 i këtij ligji, ku përcaktohet se: "Komuna është autoritet për rrugë publike lokale dhe ato në vendbanime.", dhe nenin 9 paragrafin 2 të këtij ligji, nga ku përcaktohet se: "Komuna bënë eksproprijimin e çfarëdo pjese të tokës, përrua, ujëra, kanal, gardh ose mur, marrja dhe përvetësimi i të cilave, është e nevojshme për shfrytëzim, ndërtim ose mirëmbajtjen e rrugëve lokale". Nga këtu, shihet se komuna është i vetmi autoritet për eksproprijimin e rrugëve lokale, ku këto eksproprijime duhet të kryhen në bazë të Ligjit mbi Eksproprijimin duke respektuar procedurat ligjore.

7. Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerësoi së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, përveç në pjesën përkitazi me lartësinë e kamatës, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë. Gjykata e Apelit gjeti se baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit,

gjënë mbështetje në nenin 154, 158, 186 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 01 tetor 1978, nenit 3, nenit 8 dhe 48 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore, nenit 46 të Kushtetutës së republikës së Kosovës dhe nenin 1 të Prokollit të Konventës Evropiane për te Drejtat e Njeriut. Me nenin 3 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore përcaktohet se: “Pronari ka të drejtë që sendin e vet ta mbajë, ta shfrytëzojë dhe ta disponojë në kufijtë e caktuara me ligj. Secili ka për detyrë të përmbahet nga shkelja e së drejtës së pronësisë të personit tjetër.”, ndërsa me nenin 8 të po të njëjtit ligj përcaktohet se: “E drejta e pronësisë mund të merret ose të kufizohet vetëm në kushtet e përcaktuara me ligj në pajtim me kushtetutën.” Mbi këto arsyetime, Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e të paditurës dhe e vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në një gjendje të tillë të çështjes, përfundimet dhe vendosjen e gjykatave të instancës më të ulët, nuk mund ta pranohet si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, mbi gjendjen e tillë të vërtetuar faktike, të dy gjykatat e lartë përmendura gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Gjykata nuk e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë, dhe të gjykatës së shkallës së dytë, për shkak se me aktgjykimet e atakuara gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe nuk ka pasur shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të procedurës kontestimore, mirëpo nga ana e gjykatës të shkallës së parë gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, e po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale kur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar si të drejtë dhe të ligjshëm.
2. Gjykata Supreme konstaton se zbatimi i gabuar i së drejtës materiale në këtë rast lidhet me faktin Komuna e Gjilanit nuk ka caktuar interes publik, nuk ka ushtruar pushtet sipas ligjit në rregullimin e territorit por ka investuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve lokal në zona të ndërtuara pa plan urbanistik. Prona nuk është marrë as juridikisht që të tjetërsohej titullari, e as faktikisht, sepse e njëjta ka mbetur në shfrytëzim të banorëve lokal si ruge dhe qasje e vetme. Gjykata Supreme vlerëson se

gjykata e shkallës së dytë ka bërë konstatim të gabuar, kur ka theksuar se Komuna e Gjilanit i ka marrë paditësit pronën pa një procedurë të paraparë me ligj dhe se e njëjta duhet ta kompensoi këtë, dhe mbi këtë konstatim e ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale.

3. Nga shkresat e lëndës, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, del se Komuna e Gjilanit e kundërshtoi bazën ligjore të kërkesëpadisë edhe gjatë shqyrtimit që nga përgjigja në padi, përmes ankesë dhe në revizion dhe deklaroi se nuk ka shpallur interes publik në atë pjesë, dhe nuk e ka eksproprijuar pronën e paditësit. Duke u nisur nga fakti se është krijuar një vendbanim joformal, një lagje e terë në këtë lokacion, me kërkesën e banorëve dhe në bashkëpunim me ta, Komuna ka ushtruar autoritetin e vetë në përmirësim të kushteve të jetesës dhe i ka asfaltuar rrugët që i lidhin këto shtëpi me rrugët e qytetit. Kjo është bërë në pajtim dhe me pjesëmarrje të banorëve lokal. Në përgjigje në padi, e paditura ka deklaruar se sipas të dhënave të vitit 1983 e tërë parcela 2479 me sipërfaqe prej 0.41.82 ha, ka qene e evidentuar në emër të D.M. dhe nga kjo parcelë janë ndarë së disa parcela, midis të cilave edhe ajo 2479/4, me sipërfaqe prej 673 metra katrorë, që përfshinë truallin e paditësit në sipërfaqe prej 543 metra katrorë, si dhe rrugën në gjatësi me sipërfaqe prej 130 metra katrorë, që është qasja e vetëm e ngastrave tjera.
4. Gjykata Supreme e Kosovës vendimmarrjen e mbështet në faktin se Komuna e Gjilanit nuk kishte iniciuar procedurë të eksproprijimit dhe se pronari i ngastrave të shitura, kishte disponuar lirshëm me pronën kur e kishte shitur, duke e ndarë në ngastra më të vogla, me qëllim të ndërtimit të shtëpive të banimit dhe duke i lënë një sipërfaqe të caktuar, për rrugë në shërbim të lokalitetit. Sipas ekspertizës kjo rrugë ka ekzistuar edhe më përpara dhe është shfrytëzuar nga banorët e asaj rruge që tani është shtruar në asfalt. Asfaltimi i rrugëve ishte bërë me kërkesën dhe në bashkëpunim me banorët që kanë ndërtuar shtëpi në ato parcela dhe se e paditura nuk kishte ushtruar autoritet në raportet në mes tyre dhe as që ishte shpallur ndonjë interes publik përveç rregullimit të rrugës.
5. Pretendimet se e paditura pa procedurë shpronësimi i ka shtruar rrugët në asfalt dhe zhavorr edhe pse ato janë private tani me ndërhyrjen e Komunës kanë marr karakter publik, u konsideruan nga kjo Gjykatë si jo relevante për faktin se Komuna nuk ka

zhvilluar aktivitet publik e as që ka ndërhy në raportet në mes pronarit të tokës që shfrytëzohet për rrugë dhe banorëve të tjerë. Sipas përkufizimeve të nenit 2 paragrafit 1 të Ligjit nr.03/L-139, “shpronësim” nënkupton çdo vepër të një Organi Shpronësues, që përfshin marrjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është në zotërim ose pronësi të një personi në një pronë të paluajtshme, ose krijimin e detyrueshëm të një servituti ose një të drejte tjetër të shfrytëzimit në pronën e paluajtshme. Në rastin konkret e paditura nuk i ka kryer këto veprime por pronari me shitjen e pjesëve të ngastrave për troje për ndërtim të shtëpive të banimit i ka përcaktuar pjesët që do të shfrytëzohen për rrugë. Me shtruarjen në asfalt e paditura nuk e ka ndërruar pronësinë e as destinimin e pronës për të cilën pretendohet se paditësi është shpronësuar. Edhe më tutje pjesa që ka qenë dhe mbetet rrugë në sipërfaqe prej 130 metra katrorë është e evidentuar në emër të paditësit dhe nuk i është dhënë atributi i rrugës publike, por rrugë lokale në shfrytëzim të banorëve që i kanë blerë trojet nga parcela amë e njëjtte, dhe kjo pjesë shfrytëzohet si rrugë, nga banorët lokal, përfshi edhe paditësin.

6. Po ashtu Gjykata Supreme ka refuzuar kërkesën e paditësit që të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensojnë shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.116.20 €, vendimin e marrë konform nenit 451, të LPK-së, që secila palë të bartë shpenzimet e saj të procedurës, pasi pala paditëse ka humbur kontestin gjyqësor në këtë çështje, ndërsa pala e paditur nuk ka parashtruar kërkesë për shpenzimet e procedurës.
7. Gjykata Supreme më rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas padisë të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi, për shkak se me aktgjykimin e atakuar si dhe atë të shkallës së parë, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, mirëpo në këtë rast, gabimisht është aplikuar e drejta materiale, aktgjykimet e atakuara është dashur të ndryshohen, ashtu që kërkesëpadia e paditësit u refuzua si e pabazuar.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.337/2023, i datës 20.09.2023

”Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, me numër e datë si më poshtë, aprovohet propozimi i propozuesit, si ish pronar, dhe ndryshohet vendimi përfundimtar i Komunës së Prizrenit, për kompensimin e paluajtshmërive të shpronësuara me qëllim të realizimit të projektit të ndërtimit të impiantit të ujërave të zeza në fshatin Vllashnjë, me të dhënat tjera si më poshtë, përkatësisht si në shkresat e lëndës. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka refuzuar revizionin e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.641/2019 dt.20.06.2023, të kundër propozuesit Komuna e Prizrenit, si të pa themeltë, për arsye se aktvendimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me zbatimin e drejtë të dispozitave procedurale dhe materiale dhe të njëjtat, kanë vendosur në përputhje me nenin 46.1 të Kushtetutës së republikës së Kosovës, me nenin 1 të Protokollit të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, me nenin 15 të Ligjit për Shpronësimin dhe në harmoni me kriteret ligjore përkatëse dhe mbi bazën e provave të administruara“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.641/2019 datë 20.06.2023, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e kundër propozuesit dhe është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren Cn.nr.213/2017 dt.7.11.2018, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, aprovohet propozimi i propozuesit, si ish pronar, si i bazuar, dhe ndryshohet vendimi përfundimtarë i Komunës së Prizrenit, për kompensimin e paluajtshmërive të shpronësuara, të ish pronarit V.H. nga fsh. Zh., me nr.01-105/14 dt.18.07.2014 si dhe marrëveshjet për kompensimin e pronave të dt.31.08.2016 dhe 6.09.2018, të cilat paluajtshmeri evidentohen si parc.kad.nr.565 dhe 566 ZK-V., me kulturë arë, kl. II, në sipërfaqe të përgjithshme për të dy parcelat, prej 3711 m2, në shumë të përgjithshme prej 55,665.00 euro. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, obligohet kundër propozuesi Komuna e Prizrenit, si organ shpronësues dhe shfrytëzuese e shpronësimit, që ish pronarin V.H., në emër të paluajtshmërive të shpronësuara, të përmendura në pjesën I të dispozitivit, ta kompensojë me kompensim shtesë në shumën e të hollave prej 55,665.00 euro, si dhe shpenzimet procedurale në

shumë prej 1,970.00 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

2. Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, kundër propozuesi, në afatin ligjor ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, siç thuhet në të, që të aprovohet revizioni i kundër propozuesit, aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë t' i prish ose t' i ndryshoi ose çështjen ta kthejë në rivendosije.
3. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur në pajtim me nenin 215 , lidhur me nenin 230 të LPK-së, shkresave të lëndës, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në revizion, ka gjetur se: Revizioni i kundër propozuesit është i pa themeltë.
4. Nga shkresat e lëndës rezultojnë se kundër propozuesi me Vendimin Përfundimtar me numër e datë si më lartë, ka shpronësuar ngastrat kadastrale, po ashtu të sipër cekura, të propozuesit, në ZK - V., në sipërfaqe të përgjithshme prej 3711 m2, me qëllim të realizimit të projektit të ndërtimit të impiantit të ujërave të zeza në fshatin Vllashnjë. Nuk ishte kontestues fakti se propozuesit i janë marrë- shpronësuar ngastrat e sipër cekura, si në aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, në sipërfaqe prej 3711 m2, dhe po ashtu nuk është kontestues fakti se propozuesi është kompensuar me shumë prej 55,665.00 euro. Kontestues ishte vlerësimi i bërë nga kundër propozuesi, përkatësisht, raporti i vlerësimit dhe vendimi përfundimtar i kundër propozuesit, sipas të cilit kompensimi ishte caktuar në shumë prej 15 euro, për m2. Ndërkohë që, pas ekspertizave të kryera nga ekspertët përkatës, ai i gjeodezisë B.S. dhe nga ekspertja vlerësuese e licencuar e patundshmërisë D.G., Inxh.Dip.Ark. Vlerësues i Shkallës së Parë A; nr.VP-087, veç tjerash, rezultojnë se vlera e tregut për pronën vlerësuese është 30 euro për një (1) m2. Ky vlerësim, veç tjerash është bërë, duke marrë për bazë kriteret përkatëse të aplikueshme për rastet konkrete dhe metodën krahasuese, kontratat e shitblerjes, të përpiluara tek Noteri, në atë zonë kadastrale (LRP nr.338/2014, Refer.nr.142/2014, dt. 7.03.2014, etj, që gjenden në shkresat e lëndës), në të cilën, janë shitur paluajtshmëritë përkatëse, për çmimet si në dispozitat e tyre. Ekspertja e përmendur më lartë, ka vlerësuar në mënyrë të gjithanshme, të gjitha kushtet dhe parametrat si dhe ka përdorur sikundër u theksua edhe metodën e shitjeve krahasuese dhe

ka ardhur në përfundimin e sipër cekur dhe me të gjitha të dhënat e specifikuara detajisht në ekspertizën e saj me shkrim e cila gjendet në shkresat e lëndës, sipas të cilës shumata totale e kompensimit për sipërfaqen e sipër cekur të ngastrave të shpronësuara është në lartësinë e shënuar në ekspertizë, përkatësisht, 30 euro për m², si në ekspertizë.

5. Gjykata e shkallës së parë, duke u bazuar në gjendjen e këtyre të çështjes ka gjetur se, vlera e përcaktuar nga ekspertja e sipër përmendur, për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, Vlerësuese e shkallës së parë, në lartësi të vlerës së kompensimit të cekur më lart, është reale dhe e pranueshme si dhe në harmoni me dispozitat e nenit 36 të LSHPPK-së, ndaj, në bazë të dispozitës së nenit 15 par.1 të Ligjit të sipër përmendur, dhe dispozitave të LPJ-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të saj.
6. Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore, ka pranuar në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë, ndërsa, e ka refuzuar ankesën e kundër propozuesit si të pathemeltë dhe e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë si dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të sajë.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktvendimet e gjykatave të instancës më të ulët, janë marrë me zbatimin e drejtë të dispozitave procedurale dhe të së drejtës materiale, ato përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Aktvendimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare (neni 215 i LPK). Gjykata e instancës më të ulët me të drejtë ka gjetur se në rastin konkret, propozuesit, për shkak të shpronësimit të paluajtshmërisë së sipër përmendur, për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza në fshatin V., me të dhënat si më lartë, i takon kompensimi në lartësinë e përkrahur, si në dispozitivin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.
2. Kështu, me dispozitën e nenit 46.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se “ E drejta e pronës është e garantuar”. Gjithashtu, me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, veç tjerash, parashihet se “Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush

nuk mund të privohet nga prona e tij, përveç se për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare...”. Me dispozitën e nenit 15.1 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme parashihet se ”Kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut, e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6 të këtij neni”, përkatësisht, sikundër edhe në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.04/2011 për caktimin e vlerës së pronës së paluajtshme dhe standardet e vlerësimit, Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit, të cilat me, rastin e vendosjes së çështjes, janë marrë për bazë edhe nga gjykatat e instancës më të ulët.

3. Përveç kësaj, aktvendimi i goditur, është i bazuar edhe në ekspertizën e kryer në mënyrë profesionale nga ekspertja e licencuar, e sipërpërmendur, në të cilën janë sqaruar dhe arsyetuar në mënyrë të gjithanshme të gjithë parametrat dhe kushtet në të cilat është bazuar vlerësimi, konstatimi dhe mendimi i saj profesional, duke dhënë lartësinë e çmimit të paluajtshmërisë përkatëse të shpronësuar, në bazë të dhënave mbi vlerën qarkulluese në atë zonë, duke pasur parasysh edhe kriteret relevante ligjore të cilat kanë ndikuar në çmimin kushtues të sipërfaqes përkatëse të paluajtshmërisë, metodën e krahasimit të drejtpërdrejtë, (krahasimit të sipër përshkruar të kontratave për shitblerjen e paluajtshmërisë, në afërsi dhe për rreth patundshmërisë së shpronësuar), cilësisë së patundshmërisë, madhësisë, formës, etj, (më detajisht në ekspertizën me shkrim të ekspertës përkatëse, që gjendet në shkresat e lëndës).
4. Prandaj, nga arsyet e sipër përmendura, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e revizionit për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, sepse, e njëjta konsideron se në rastin konkret civil - juridik, gjykatat e instancave më të ulëta kanë marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.
5. Nga sa u theksua më lartë dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 222 lidhur me nenin 230 të LPK , u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.381/2023 i datës 27.09.2023

”Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas revizionit të palës së paditur, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5790/2020 dt.17.07.2023, ka marrë aktgjykim me të cilin të njëjtin e ka refuzuar si të pa themeltë, për arsye se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, janë marrë me zbatimin e drejtë të dispozitave procedurale dhe të së drejtës materiale dhe lidhur me kompensimin e dëmit material dhe jo material, si pasojë e lëndimit në punë të paditësit, mbi bazën e administrimit të provave përkatëse, kanë vendosur mbi themelësinë dhe lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit, në përputhje me dispozitat nenit 136, nenit 137, nenit 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nenit 7, nenit 319, nenit 323 të LPK-së, nenit 5 , nenit 6, nenit 21 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (nr.04/L-161) etj.“

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5790/2020 dt.17.07.2023, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë C.nr.726/14 dt.5.10.2020, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, me pjesën e II të dispozitivit të tij, detyrohet e paditura, që paditësit, t’ia kompensojë dëmin jo material dhe material si pasojë e lëndimeve të pësuar në vendin e punës, më dt.5.07.2013, në punishten “ M“ në P., me përgjegjësi të ndarë 50% me 50%, shumat si vijon: Dëmi jo material: a). në emër të dhimbjeve trupore shumë prej 1.500.00 euro, b). në emër të frikës së përjetuar 1.250.00 euro, c). Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 15%, shumë prej 3.000.00 euro, d). Në emër të shëmtimit trupor, shkalla e lehtë, 500.00 euro, gjithsejtë paditësit në emër të dëmit jo material në shumë prej 6.250.00 euro. Përtej shumës së aprovuar, për dëmin jo material, shumat tjetër e kërkuar nga paditësi, refuzohet si e pa bazuar. Dëmi material: a). Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumat prej 300.00 euro, b). Në emër të ushqimit të përforcuar 150.00 euro, c). Në emër të rehabilitimit shëndetësor 500.00 euro, d). Në emër të shpenzimeve të shërimit 2.600.00 euro, gjithsejtë në emër të dëmit material

shuma prej 3.550.00 euro. Përtej shumës së aprovuar, shuma tjetër e kërkuar, refuzohet si e pa bazuar. Me pjesën e III të dispozitivit, gjithsejtë paditësit për dëmin jo material dhe material, pa rentën për periudhën e kaluar dhe të tashmen, iu aprovua shuma prej 9.800.00 euro. Përtej shumës së aprovuar shuma tjetër i refuzohet si e pa bazuar dhe sipas ndarjes së përgjegjësisë 50% me 50%. Me pjesën e IV të dispozitivit, në emër të fitimit të humbur – rentës: a). Periudha e kaluar prej dt. Së aksidentit 5.07.2013 e deri në datën e nxjerrjes së ekspertizës 29.02.2020, prej shumës së llogaritur nga eksperti financiar 8.153.00 euro për pagesë i mbetet shuma prej 4.076.50 euro dhe b). Periudha e ardhshme prej dt.1.03.2020 e tutje deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore në shumën mujore të llogaritur nga eksperti financiar R=96 euro në muaj, për pagesë mbetet shuma prej R=48 euro në muaj, e cila pagesë bëhet çdo muaj duke filluar nga dt.1 deri 10 të çdo muaji, në xhirollogarinë e paditësit. Me pjesën e V të dispozitivit, shumat e provuara për paditësin, përpos rentës - fitimit të humbur, e paditura obligohet t’ia paguajë me kamatë ligjore prej 8% duke filluar t’i llogaritet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit e deri në pagesën përfundimtare. Me pjesën e VI të dispozitivit, refuzohet kërkesa e palës paditëse që shuma e aprovuar t’i llogaritet nga dita e lëndimit në punë të paditësit dt. 5.07.2013 e deri në pagesën definitive, si e pa bazuar. Me pjesën e VII të dispozitivit, obligohet e paditura që t’i paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1.950.00 euro dhe me pjesën e VIII të dispozitivit, shumën e aprovuar për paditësin dhe shpenzimet e procedurës kontestimore e paditura detyrohet t’i paguajë paditësit në afat prej 15 ditësh, pra pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

2. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, ka paraqitur revizion e paditura për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, siç thuhet në të, të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të refuzohet kërkesëpadia si e pa bazuar ose të njëjtin ta prish dhe shkresat e lëndës t’i kthejë në rigjykim.
3. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, si dhe vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion, gjeti se: Revizioni i të paditurës është i pathemeltë.

4. Nga shkresat e lëndës rezulton se më datën 30.12.2014, paditësi, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga lëndimi në punë, më datën 5.07.2013, me të dhënat tjera dhe kërkesën si në petitumin e padisë, përkatësisht, si në precizimin e sajë. Nuk është kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura. Nuk është kontestues fakti se paditësi më dt.5.07.2013 deri sa ishte duke punuar në punishten “M.” në P., rreth orës 11, në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës tek e paditura, ka qenë duke punuar. Nuk është kontestues fakti se gjatë punës, paditësi ka vendosur shkallët në gajbe (pa skele) për tu mbështetur në to dhe për ti kryer punët ditën e ndodhjes së fatkeqësisë në punë kur është thyer gajbja, shkallët kanë lëvizur dhe paditësi është rrëzuar si dhe ka rënë në tokë, me ç’ rast ka pësuar lëndime të rënda trupore me pasojë të përhershme për shëndetin e tij. Kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë, sepse sipas të paditurës, paditësi mban përgjegjësinë për lëndime e pësuar, nga se nuk i ka respektuar urdhrat gojore të dhëna nga punëdhënësi, deri sa të kundërtën e pretendonte pala paditëse. Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat shkresore dhe materiale të cilat gjenden në dosjen e lëndës si dhe super ekspertizën nga mbrojtja dhe siguria në punë, të grupit të ekspertëve nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, Prof.Dr. M.B., Prof Dr. I.D. dhe Prof.Ass. Dr. Sh.L., të dt.10.06.2019 dhe dëgjimit të tyre në seancën gjyqësore dt.17.09.2019, Ekspertizën mjekësore të dt.25.10.2019 të ekspertëve Dr. F.M., ortoped dhe Dr.V.S., psikiatër, ekspertizën e ekspertit të mjekësisë së punës Dr. A.H., ekspertizën e ekspertit financiar A.B. etj, dhe veç tjerash, ka gjetur se; sipas mendimit të grupit të ekspertëve të lartëcekur, të mbrojtjes dhe sigurisë në punë, del se në bazë të analizës së gjithmbarshme mund të përfundohet se deri te lëndimi ka ardhur në vendin e punës së punëtorit (paditësit) i punësuar në ndërmarrjen “ D. C.” duke bërë ngjyrosjen e pjesës para shkallëve të ndërtesës si çdo ditë tjetër si mjeshtër i stiroporit, fasadave dhe ngjyrave: 1.Mos përmbushjes së obligimeve të parapara me Ligj dhe Rregullore nga ana e punëdhënësit, për shkak të mosnjohjes së Ligjeve dhe Rregulloreve nga lëmia e mbrojtjes në punë dhe 2. Si pasojë e mos kujdesit dhe mos njohurive të mjaftueshme të punëmarrësit për shfrytëzimin e shkallëve, gjegjësisht jo stabilitetin e tyre të vendosura në gajbe dhe se palët i kanë lëshimet e tyre, punëdhënësi nuk ka ushtruar kontrollin e duhur gjatë kryerjes së punimeve, kurse, punëmarrësi ka neglizhuar punët e detyrat e tij (përgjegjësi e ndarë). Sipas ekspertëve e paditura nuk ka ofruar kushte për punë dhe ka dështuar në përmbushjen e obligimeve ndaj punëmarrësit – paditësit. Punëdhënësi është i obliguar të organizoi dhe të ndërmerr

masa të nevojshme për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, (nuk ka pasur skele brenda objekteve të punës, mungesa e mjeteve mbrojtëse për punë, mungesa e trajnimeve dhe urdhëresave me shkrim, etj), parandalimin e rreziqeve në punë, ofrimin e informatave, trajnimeve etj, ndaj, gjykata e shkallës së parë, nga provat e administruara, ka ardhur në përfundim për ekzistimin e përgjegjësinë së ndarë të palëve ndërgjyqëse, në përpjesëtim 50% me 50%. Sipas ekspertizës përkatëse mjekësore, të sipër cekur, lëndimi i punëmarrësit, këtu, paditësit, kualifikohet si lëndim i rënd trupor dhe me pasoja. Në rastin konkret bëhet fjalë për lëndimin si: Thyerje shumë fragmentale të kockës së tulusit me zhvendosje të fragmenteve kockore dhe prani të fragmenteve në njëjën t-c dhe subtalare e të cilësuar si lëndim i rënd trupor me pasoja të përhershme.

5. Punëmarrësi, paditësi, nga fatkeqësia dhe lëndimi i sipër cekur, ka pasur dhimbje fizike trupore dhe frikë të përjetuar në kohëzgjatje dhe të intensitetit të specifikuar në mënyrë detaje në ekspertizën e ekspertit të ortopedisë dhe psikiatrisë, si dhe, po ashtu, ka pasur zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 15%, shëmtim të shkallës së lehtë, pastaj, edhe zvogëlim të aktivitetit punues, siç ka konstatuar eksperti i mjekësisë së punës, dhe atë pas aksidentit dt.5.07.2013, ka pas pa aftësi të përkohshme dhe të plotë për çdo lloj pune fizike në shkallën prej 100%, për periudhën prej 5 muajve nga dita e lëndimit, pastaj, nga dt.5.12.2013 e një vit të plotë deri 5.12.2014, pa aftësia e përkohshme, por, e përsëritshme për punë të rënda fizike (të përshkruara në ekspertizë) ka qenë në shkallën prej 50%, nga ajo datë e tutje e deri më sot 30%, që do të thotë invaliditet i kategorisë së tretë. Nga ekspertiza e ekspertit financiar, është konstatuar lartësia e fitimit të humbur – rentës dhe rentës mujore për rastin e lëndimit në punë të paditësit, me të dhënat si në ekspertizën e tij me shkrim, e cila gjendet në shkresat e lëndës.
6. Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe në bazë nenit 176, nenit 183, etj, të LMD-së, si dhe nenit 7, nenit 319 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.
7. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, në tërësi ka miratuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se e njëjta

gjykatë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpapia e paditësit është pjesërisht e bazuar, ndaj, e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancës më të ulët, me rastin e marrjes së aktgjykimeve në fjalë, kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e së drejtës materiale dhe të njëjtat, nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, ndaj, pretendimet e revizionit përkritazi me shkeljet e pretenduara të së drejtës materiale nuk mund t'i vënë në pyetje aktgjykimet e instancave më të ulëta.
2. Për sa i përket shumave të gjykuara nga gjykata e instancës më të ulët, përkritazi me llojet e sipër përmendura të dëmit jo material (dhe material), në rastin konkret civil, drejtë është aplikuar dispozita e nenit 172, nenit 183 si dhe në harmoni me dispozitën e nenit 176 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe në përputhje me nenin 323 të LPK-ës, e kjo, duke pasur parasysh, në këtë rast, provat e administruara, konstatimet dhe mendimet e ekspertëve përkatës mjekësor, të ortopedisë dhe psikiatrisë, ekspertit financiar, ekspertit të mjekësisë së punës, si dhe mendimin e konstatimin e grupit të ekspertëve të mbrojtjes dhe sigurisë në punë, të sipër përmendur, etj, lëndimet e pësuar trupore dhe pasojat, natyrën, peshën, intensitetin e dhimbjeve trupore - fizike, llojin dhe intensitetin e frikës. Vlerësimi i shpërblimit për dëmin jo material (si një satisfacion që nuk ka qëllim lukrativ-fitimprurës), përfaqëson zbatimin e së drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, dhimbjeve trupore - fizike, por edhe të frikës si lloj i mëvetësishëm i dëmit jo material, gjykata sipas nenit 183 të LMD-së, duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por, edhe për faktin që të mos favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimin shoqëror, prandaj, duke pasur parasysh këto kritere të parapara me dispozitën e lartë cekur, shumat e caktuara nga gjykata e shkallës më të ulët, përkritazi me llojet e sipër cekura të dëmit, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë reale, në përputhje me kriteret e parapara ligjore dhe në harmoni me praktikën gjyqësore. Gjykata e instancës më të ulët, me rastin e vendosjes për llojet dhe shumat e

kompensimit të dëmit jo material të paditësit, ka pasur parasysht dhe ka marrë për bazë, konstatimet që u sipër theksuan më lartë, e veçanërisht, përkritazi me paditësin, llojin dhe natyrën e lëndimit trupor, intensitetin e dhimbjeve trupore - fizike dhe të frikës, si dhe shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, me manifestim të përshkruar të pasojave të konstatuara si në ekspertizat mjekësore dhe në shkresat tjera të lëndës.

3. Prandaj, nga këtu, thëniet e revizionit të paditurës përkritazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, kjo Gjykatë i vlerësojë si të pa themelta, nga se gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë kanë gjetur se e paditura është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të kërkuar nga paditësi, si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Kështu edhe kjo Gjykatë, në kontekstin e mësipërm, vlerëson se ky vendim ka mbështetje, veç tjerash, edhe në dispozitat e nenit 5, nenit 6, nenit 21 të Ligjit për Sigurinë dhe shëndetin në punë, (nr.04/L-161) si dhe në dispozitën e nenit 136 dhe 137 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndaj, nga këtu, e njëjta, aktgjykimin e gjykatës së instancës më të ulët, e konsideron të drejtë dhe të ligjshëm.
4. Nga arsyet e sipër përmendura dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.506/2023, i datës 15.12.2023

"Gjykata Supreme e Kosovës, në raport me paditësin e parë, e ka refuzuar si të pa themeltë revizionin e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr. 6605/19 dt.19.04.2023, lidhur me kompensimin e pagës shtesë për punët gjatë fundjavës të paditësit, sepse, veç tjerash, kjo e drejtë i takon paditësit, në mbështetje të dispozitës së nenit 56 të Ligjit të Punës, ndërsa, në raport me paditësin e dytë, revizioni i të paditurës hedhet si i palejuar, për shkak të vlerës së kontestit, në kuptim të nenit 211.2 të LPK-së".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3298/13 dt.23.05.2019, aprovohet në tërësi e bazuar kërkesëpapia e paditësve I.B. dhe S.P., nga Prishtina. Me pjesën e II të dispozitivit, detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a. (KEK), në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të pagave shtesë për punët gjatë fundjavës të papaguara, për paditësin e parë, për periudhën prej 1.01.2012 deri më dt.31.12.2018 t'ia kompensojë pagën shtesë bruto 4.050.77 euro, kontributin pensional 5% vlerë prej 202.54 euro, tatimi i mbajtur në burim në vlerë prej 364.62 euro dhe pagën neto 3.485.61 euro, ndërsa, për paditësin e dytë, për periudhën prej 1.01.2012 deri më dt.18.04.2014, t'ia kompensojë pagën shtesë bruto 870.17 euro, kontributin pensional 5% vlerë prej 43.51 euro, tatimin e mbajtur në burim në vlerë prej 60.47 euro, dhe pagën neto 766.19 euro. Me pjesën e III të dispozitivit, detyrohet e paditura, që paditësve t'ua kompensojë borxhin e cekur si më lartë së bashku me kamatën ligjore ashtu siç e parashohin bankat për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të veçantë, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit 23.05.2019 e deri në pagesën defintive. Me pjesën e IV të dispozitivit, detyrohet e paditura që paditësve t'ua kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,436.80 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përbarimit ligjor.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.6605/19 dt.19.04.2023, është refuzuar si e pa themeltë ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë C.nr.3298/13 dt.23.05.2019.
3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura në afat ligjor ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni, aktgjykimet e instancave më të ulëta të ndryshohen ashtu që të refuzohet kërkesëpadija e paditësve si e pa bazuar.
4. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së dhe shkresave të lëndës si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion, ka gjetur se: Revizioni i të paditurës është i pa themeltë.
5. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit kanë paraqitur padi kundër të paditurës, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, më datën 16.12.2013, për kompensimin e pagave shtesë për punën gjatë fundjavës. Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit ishin punëtor të paditurës, KEK-ut “ TC Kosopva A”, ”TC Kosova B“ dhe të Mihjes Sipërfaqësore, të cilët punojnë me ndërrime, nuk ishte kontestues fakti se paditësit kishin punuar te e paditura gjatë fundjavës (të shtunën dhe të dielën). Kontestuese midis palëve ndërgjyqëse ishte mos kompensimi i orëve të punës gjatë kohës së fundjavës (të shtuneve dhe të dielave). Nga ankesa e paditësve me nr.937 dt.27.03.2017, rezulton se paditësit i janë drejtuar strukturave udhëheqëse të paditurës, Korporatës- Bordit Ekzekutiv, me të cilën kanë kërkuar që tu kompensohen orët e punës gjatë fundjavës, për periudhën kontestuese. Nga shkresat e lëndës dhe provat e administruara, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se punëtorët posedojnë edhe kontratat e punës, nga të cilat del se të njëjtit punojnë me ndërrime, se të njëjtit kanë punuar edhe ditëve të fundjavës,(të shtunave dhe të dielave), ndërsa, e paditura nuk ua ka kompensuar (50% për orët, për punën gjatë fundjavës) e as nuk ua ka dhënë ndonjë ditë të lirë, në emër të pagës shtesë. Me disa nga kontratat e punës (2011) të lidhur midis të paditurës dhe punëtorve- paditësve, (në nenin 6 të saj), parashihet se, atyre u takon pagesa shtesë e sipër përmendur, sikundër edhe me nenin 39 të Kodit të Punës së të paditurës, ndërsa, në disa kontrata tjera të punës (2013) parashihej se një e drejtë e tillë,

përkatësisht, neni 56.2, nënp.2.5 i Ligjit të Punës, nuk zbatohet. Nga ekspertiza e ekspertit financiar gjyqësor, R.B., gjykata ka gjetur se e paditura, punëtorëve, tani këtu, paditësve, nuk ua ka paguar kompensimin shtesë për punën gjatë fundjavës, kurse, lartësia e kompensimit për secilin paditës është konstatuar nga eksperti përkatës i cili në raportin e ekspertizës, për paditësin I.B., për periudhën kontestuese prej dt.1.01.2012 deri 31.12.2018, duhet t'i kompensohet paga shtesë bruto prej 4.050.77 euro, ndërsa, paditësit S.P., për periudhën prej 1.01.2012 deri 18.04.2014, shumën prej 870.17 euro, me kontributet tjera si në ekspertizë përkatësisht si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Të njëjtit, pra, si punëtor me ndërrime kanë punuar edhe gjatë ditëve të fundjavës varësisht prej kohës së punës, me ç' rast është vërtetuar numri i orëve të punës të fundjavës për secilin paditës, është bërë përlogaritja e kompensimit shtesë të pagës në shkallë prej 50% të pagës e përlogaritur për orët shtesë, në mbështetje të pagës bazë, përfshirë edhe rritjen e pagave për periudhat përkatëse. Përlogaritja e pagës shtesë është bërë në shumën bruto, nga shuma bruto për secilin paditës është zbritur kontributi pensional si dhe tatimi në burim. Pra, eksperti në formën e shkruar dhe tabelore ka shpjeguar periudhën kohore për diferencën e pagave shtesë të papaguara, pagën neto, pagën bruto, kontributin pensional, tatimin në burim, të gjitha këto për secilin muaj veç e veç dhe shumën e tërësishme, me të dhënat tjera të detajizuara, si në ekspertizën e dt.8.01.2018.

6. Në këtë gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se e paditura nuk ua ka kompensuar paditësve pagesën shtesë për punën gjatë fundjavës, kurse, mos pagesa e kompensimit shtesë për punët gjatë fundjavës, nga ana e të paditurës, është në kundërshtim me nenin 6 të kontratave të punës të punëtorëve- paditësve, në kundërshtim edhe me nenin 39 të Kodit të Punës të paditurës, me të cilat akte parashihet kompensimi i pagesave shtesë, duke përfshirë këtu edhe kompensimin e pagës shtesë për punët që kryhen gjatë fundjavës. Një e drejtë e tillë e punëtorëve - paditësve, parashihet, po ashtu, shprehimisht me dispozitat e nenit 56 par.1 dhe 2, dhe nënp.2.5 të Ligjit të Punës, prandaj, gjykata e shkallës së parë e aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e padinë e paditësve dhe vendosi si në pjesën e I, II, III, IV të dispozitivit të aktgjykimit të sajë.
7. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se e njëjta

drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes konkrete juridiko civile, pranon si të themeltë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, lidhur me aprovimin si të themeltë të kërkesëpadisë së paditësve, përkitazi me kompensimin e pagës shtesë për punët gjatë fundjavës, nga se aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe se nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.
2. Objekt shqyrtimi në Gjykatën Supreme të Kosovës, ishin edhe pretendimet e revizionit lidhur me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale të LPK-së. Kjo Gjykatë vlerëson se këto aktgjykime nuk përfshihen me të meta e pa qartësi as në dispozitiv e as në arsyetimin e tyre, arsyet e dhëna janë të qarta, të mjaftueshme për faktet juridikisht të vlefshme për gjykimin e drejtë të çështjes, të cilat janë të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit. Kështu, revizioni thirret në shkeljet esenciale të dispozitave të LPK-së, (të cilat shprehimisht parashihen me dispozitat e nenit 182 të LPK-së), por, në të, nuk specifikohet asnjë shkelje konkrete, pos që theksohet, në mënyrë të përgjithësuar se vendimi është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së, andaj, si të tilla, ato pretendime nuk janë të qëndrueshme.
3. Gjithashtu, nuk qëndron as pretendimi vijues i të paditurës, se punëtorëve- paditësve nuk u takon kompensimi shtesë për punët gjatë fundjavës, sepse ata punojnë me ndërrime në kuadër të orarit të rregullt të punës prej 40 orë në javë, dhe mund të i bie që punojnë edhe ditëve të fundjavës deri sa ti mbushin 40 orë në javë, etj. Kështu, nga fakti sepse, një e drejtë e sipër përmendur e punëtorëve, këtu, paditësve, ishte paraparë edhe me kontratat e punës (2011), neni 6, pastaj, edhe me nenin 39.1 të Kodit të Punës të paditurës, në të cilin, veç tjerash, lidhur me pagesat shtesë, thuhet se "Për punën e kryer nga Punëmarrësi për ndërrimin e natës; ose përtej orarit të punës sipas kontratës

me punëmarrësin; gjatë festave zyrtare, ose gjatë ndonjë kohe tjetër që përshkruhet në Ligjin e zbatueshëm, punëmarrësi ka të drejtë që të marrë pagesat shtesë- pagesat do të bëhen sipas përqindjes së pagës bazë bruto për orë të punëmarrësit, e cila duhet të jetë në përputhshmëri me normat e detyruara me Ligjin e zbatueshëm...”. Dhe kur jemi këtu, duhet theksuar se edhe me dispozitat e nenit 4 të Ligjit të Punës, veç tjerash, parashihet se dispozitat e Kontratës Kolektive, Aktit të Brendshëm të Punëdhënësit, dhe Kontratat e Punës, duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij Ligji (neni 4.1 i LP-së), përkatësisht, ”Akti i Brendshëm i Punëdhënësit dhe Kontrata e Punës, mund të përmbajnë dispozita me të cilat përcaktohen më shumë të drejta dhe kushte të favorshme, nga të drejtat dhe kushtet e përcaktuara me ligj, përveç nëse me këtë ligj është përcaktuar ndryshe“ (neni 4.3 i LP-së).

4. Po kështu, në kontekstin e mësipërm, duhet theksuar se me dispozitën e nenit 56 par.2 të Ligjit të Punës, shprehimisht parashihet se “Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë: nënpar. 2.1. 20% në orë për kujdestari; nënpar. 2.2. 30% në orë për punë gjatë natës; nënpar. 2.3. 30% në orë për punë jasht orarit; nënpar. 2.4. 50% në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe nënpar. 2.5. 50% në orë për punë gjatë fundjavës”. Nga këtu, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se të punësuarve, në rastin konkret paditësve, u takon paga shtesë prej 50% në orë për punën gjatë fundjavës. Ndërkohë që, te ne, në Republikën e Kosovës, sikundër edhe në pjesën dominuese të kontinenteve, e shtuna dhe e diela, janë përcaktuar si ditë (ëëekend) të fundjavës, në të cilat sipas rregullit (në parim) nuk punohet, përpos, rasteve të rregulluara ndryshe me ligj, siç ka vepruar edhe Ligjdhënësi i ynë, në mënyrën e sipër përmendur.
5. Për sa i përket revizionit të së paditurës përkitazi me paditësin e dytë, S.P., kjo Gjykatë, e ka hedhur si të palejuar. Kështu, nga se me nenin 211.2 të LPK-së, parashihet se revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike, në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit apo me përmbyshjen e ndonjë prestimi tjetër, po qe se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk e kalon shumën prej 3000-euro. Për faktin se me revizion është goditur aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, për pagesën e pagës shtesë për paditësin e sipër cekur (870.17-euro), ndërkohë që kërkesa tij, nuk e kalon shumën e paraparë me dispozitën e nenit 211.2 të LPK-së, e cila konsiderohet për secilin paditës veç e veç (ata nuk janë bashkë

ndërgjyqës unik), ndaj, nga këtu, revizioni në raport me të njëjtin nuk është i lejuar dhe si i tillë duhet të hedhet poshtë.

6. Për arsyet e sipërpërmendura dhe në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.E.nr.16/2024, i datës 24.04.2024

”Përkritazi me revizionin e paraqitur nga i padituri, kundër aktgjykimit të gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë K.DH.SH. II. 722/23 dt.26.10.2023, në kontestin civil për shkak të lirimimit të paluajtshmërisë nga njerëzit dhe sendet, Gjykata Supreme e Kosovës, nga arsytet e mëposhtme, e ka refuzuar të njëjtin si të pa themeltë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.722/23 dt. 26.10.2023, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm K.P.nr.19/22 i dt.13.03.2022, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, aprovohet kërkesëpapia e paditësit, kurse, me pjesën e II të dispozitivit të tij, obligohet i padituri Gazeta “E.R.”, ta lirojë objektin, tri zyrat nga njerëzit dhe sendet, dhe t’i dorëzojë paditësit në posedim dhe shfrytëzim të lirë dhe atë: zyra e drejtorit me dimensione 7.20 m x 6.65 m = 40.68 m², zyra e drejtorit të marketingut me dimensione prej 3.36 m x 2.65 m = 8.90 m² dhe zyra e gazetarëve 3.36 m x 3.42 m = 11.49 m², në sipërfaqe të përgjithshme prej 61.07 m², i cili objekt gjendet në parcelën P-71914059-06219- 1 ZK - P., në sipërfaqe prej 17.272 m², me etazhitet të objektit B+P+8, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
2. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, në afat ligjor pala e paditur ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, siç thuhet në të, të miratohet revizioni, të anulohet aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë dhe ai i Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, të refuzohet padia si e pa bazuar ose çështja ti kthehet Dhomës së Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale në rishqyrtim dhe rivendosje.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 lidhur me nenin 505 të LPK-së, si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se: Revizioni i të paditurit është i pathemeltë.
4. Nga shkresat e lëndës rrjedh se pala paditëse më datën 10.10.2003, ka paraqitur padi kundër të paditurit për shkak të lirimimit të paluajtshmërisë, me të dhënat tjera si në petitumin e padisë dhe si në precizimin e saj, përkatësisht, si në dispozitiv të aktgjykimit të Dhomës së Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale. Nga leximi i kontratës për qira të lokalit nr.124 dt.20.07.1997, është provuar fakti se paraardhësi i paditësit, NP E., në cilësinë e qiradhënësit i ka lëshuar me qira hapësirën dhe atë ndërtesën “2100” ish rruga “K.B.”, Prishtinë, qiramarrësit “P.B” SD N.S., në sipërfaqe dhe mënyrën e pagesës si në kontratë. Nga leximi i kontratës nr.155 dt.28.07.1997, paraardhësi i sipër cekur i paditësit, në cilësinë e qiradhënësit i ka lëshuar me qira hapësirën dhe atë ndërtesën, e përshkruar si më lartë, qiramarrësit “I” Sh.a., në sipërfaqe dhe në mënyrën e pagesës si në kontratë. Me kontratën nr.183 dt.8.09.1997, paraardhësi i paditësit, si më lartë, në cilësinë e qiradhënësit i ka lëshuar me qira hapësirën dhe ndërtesën, si në adresën e sipër cekur, qiramarrësit “STR T” në sipërfaqe dhe mënyrën e pagesës si në kontratë. Nga leximi i aneksit të kontratës për qira të objekteve afariste nr.264 dt.31.12.1998, është provuar fakti se paraardhësi i sipër përmendur i paditësit, në cilësinë e qiradhënësit i ka dhënë me qira qiramarrësit “STR T.”, sipas këtij aneksi të kontratës, është vazhduar vetëm periudha kohore, edhe me kontratën nr.31 dt.11.02.1998, i ka dhënë po ashtu, me qira qiramarrësit “B.” dhe vetëm i është vazhduar periudha kohore, pastaj, i ka dhënë me qira edhe qiramarrësit “P.J.N.” hapësirën afariste “A” në rrugën dhe adresën e sipër përmendur, në sipërfaqe dhe në mënyrën e pagesës si në kontratën nr.151 dt.6.07.1998, etj. Nga leximi i regjistrimit gjyqësor të Gjykatës së Beogradit me nr.Fi.466/98, është provuar fakti se Kompania “JJ&B T.” ka ndryshuar emërimin në “JJ-Net”.
5. Nga leximi i certifikatës mbi të drejtat e pronës me numër të parcelës P-71914059-06219-1 dt.25.10.2007, është provuar fakti se parcela me numër P-71914059-06219-1, figuron në emër të Kombinatit për Përpunimin dhe Eksploitim të linjitet dhe është në sipërfaqe prej 17272 m², më gjerësisht si në certifikatën e përshkruar. Nga leximi i vazhdimit të Certifikatës së pronësisë të dhënat bazë për njësi me numër P-719114059-

06219-4 dt.25.10.2007, dhe në të dhënat bazë për njësi me numër P-719114059-06219-1 dt.25.10.2007, është provuar fakti se në parcelën me numër P-719114059-06219-1, në kolonën kulturë e kësaj parcele, figuron Shtëpi – ndërtesë në sipërfaqe prej 23 m², dhe shtëpi – ndërtesë në sipërfaqe prej 2260 m² dhe oborr në sipërfaqe prej 15012 m², në sipërfaqe të përgjithshme prej 17.272 m². Nga leximi i ekspertizës së gjeodezisë dt.28.12.2017, të ekspertit Q.H.a, u vërtetua se parcela me numër 06219-1, evidentohet në emër të paditësit K.E.K. Sh.a., lloji i pronësisë shfrytëzim aktual tokë ndërtim me kulturë shtëpi ndërtesë në sipërfaqe prej 2260 m², me oborr në sipërfaqe prej 15012 m², në sipërfaqe të përgjithshme prej 17272 m², ndërsa, i padituri kishte në shfrytëzim faktikë pjesën e objektit të ndërtuar në ngastrën kadastrale 06219-1.

6. Nga leximi i Certifikatës së pronësisë me numër të lëndës 11-942/03-0235534/22 dt.27.10.2022, është provuar fakti se parcela me numër P-71914059-06219-1 figuron në emër të Korporatës Energetike të Kosovës, lloji i shfrytëzimit të parcelës tokë ndërtimore (oborr) në sipërfaqe prej 15012 m² dhe tokë ndërtimore shtëpi-ndërtesë në sipërfaqe prej 2260 m². Nga leximi i ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë, të sipërpermendur, dt.6.12.2022, së bashku me skicën përcjellëse dhe fotot e realizuara të objektit kontestues, eksperti ka konstatuar se pas daljes në teren është bërë identifikimi i objektit kontestues i cili është në parcelën kadastrale me nr.06219-1. Sipas ekspertizës pas verifikimit të dokumentacionit e sipas evidencës në elaboratin kadastral ka konstatuar se kontesti ka të bëjë me objektin e ndërtuar në parcelën me nr.06219-1, në lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës shoqërore, zona urbane, lloji i shfrytëzimit, tokë ndërtimore, oborr në sipërfaqe prej 15012 m², shtëpi ndërtesë në sipërfaqe prej 2260 m², në sipërfaqe të përgjithshme prej 17272 m². Ndërsa, sipas gjendjes faktike në teren, kontesti është duke u zhvilluar në objektin afaristë të lokaleve të katit e parë, ku i padituri ka në shfrytëzim tri zyre për ushtrimin e veprimtarisë së vet. I padituri kishte në shfrytëzim faktikë pjesën e objektit të ndërtuar në parcelën me numër 06219-1, në sipërfaqe prej 61.07 m². Objekti kontestues është ndërtuar në vitin 1999 dhe se ngastra ku është ndërtuar objekti kontestit para vitit 1999 është evidentuar në pronësi të këtu paditësit, KEK Sh.a. dhe se objekti i ndërtuar nuk është i paraqitur në planet kadastrale e as në pjesën e gjeo - portalit shtetëror, objekti gjendet në mes të dy objekteve banesore afariste të cilat janë të lidhura me objektin lëndor, ndërsa, pas matjeve gjeodezike të gjendjes faktike, zyrat të cilat i shfrytëzohen nga pala e paditur, në sipërfaqe prej 61.07 m², janë zyrat që janë specifikuar më lartë, si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës

së shkallës së parë. Pra, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se, nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, kqyrja në vend, shkresave të tjera të lëndës, ngastra kadastrale me nr.06219-1, është në pronësi të paditësit dhe në këtë ngastër janë të ndërtuara objekte banesore gjithashtu pronë e paditësit, ndërsa, objekti kontestues S + 1 prej suteranit ky objekt gjendet mes të dy objekteve banesore afariste të cilat janë të lidhura me objektin lëndor, e një pjesë të objektit i padituri është duke e shfrytëzuar si zyre në sipërfaqe prej 61.07 m2, dhe sipas ekspertit të gjeodezisë, objektet në sipërfaqe prej 2260 m2 janë brenda sipërfaqes së parcelës me nr.06219-1 ZK- Prishtinë, ku sipas listës poseduese, figuron se pronar i kësaj parcele dhe objekteve në të, është këtu, paditësi.

7. Dhoma e Shkallës së Parë, e Gjykatës Komerciale, pas administrimit të provave, ka gjetur se pasuria e paluajtshme kontestuese, e përshkruar më lartë, sipas certifikatës pronësore, evidentohet në emër të këtu paditësit, KEK-u, si pronar i saj, ndaj, kërkesëpadinë e paditësit, që ka të bëjë me lirim të paluajtshmërisë të specifikuar si më lart, e ka aprovuar si të bazuar dhe ka vendosur si në pjesën I dhe II, të dispozitivit të aktgjykimit të saj.
8. Dhoma e Shkallës së Dytë e gjykatës Komerciale, në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të Dhomës së shkallës së parë duke vlerësuar se e njëjta drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, për të cilat arsye edhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes dhe në kontekst të pretendimeve të revizionit, vlerëson se aktgjykimet e gjykatës të instancës më të ulët, nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare e as me shkelje të tjera të LPK-së. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se thëniet e revizionit lidhur me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale dhe zbatimit të

gabuar të së drejtës materiale, nuk mund t'i vejnë në pyetje aktgjykimet e instancave më të ulëta gjyqësore.

2. Gjykata Supreme e Kosovës, e konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatës të instancës më të ulët, përkitazi me aprovimin e kërkesëpadisë së palës paditëse, si në dispozitivin e aktgjykimet të Dhomës së shcallës së parë, të Gjykatës Komerciale, pasi që janë dhënë arsyet bindëse dhe të pranueshme edhe nga kjo Gjykatë. Prandaj, edhe Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron se aprovimi i tillë i kërkesëpadisë së palës paditëse është i drejtë dhe i ligjshëm, me që paraprakisht, nga administrimi i provave, si në shkresat e lëndës, është vërtetuar se paluajtshmëria dhe objektet kontestuese në të, sikundër u përshkruan më sipër, sipas certifikatës pronësore përkatëse etj, evidentohen në emër dhe në pronësi të paditësit, KEK-u. Ndaj, nga këtu, aktgjykimi i goditur është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të së drejtës materiale, sepse, veç tjerash, pala e paditur, nga arsyet e sipër përmendura, objektet - zyrtar kontestuese të specifikuar më lartë, i posedojnë dhe i shfrytëzojnë pa bazë të vlefshme juridike dhe ligjore.
3. Dhe kur jemi këtu, duhet theksuar se e drejta e palës paditëse për të kërkuar kthimin e paluajtshmërisë së vet, nga jo pronari, (pala e paditur), i cili, sikundër u theksua më sipër, këtë paluajtshmëri e mban në posedim e shfrytëzim pa bazë juridike, gjën mbështetjen në nenin 3 dhe nenin 37.2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike. Kështu, me dispozitat e nenit 3 të ligjit të sipër përmendur, parashihet, veç tjerash, se pronarit të sendit i takojnë të gjitha autorizimet (tagrat) pronësore, (ius utendi, fruendi et abutendi), ta mbajë (posedojë), ta shfrytëzojë, të disponojë me sendin dhe në anën tjetër, çdokush është i detyruar që të përmbahet nga cenimi i të drejtës pronësore të personit tjetër. Ndërkohë që, me nenin 37 parashihet veç tjerash, edhe mundësia e paraqitjes së padisë për kthimin e sendit (rei vindikatio) dhe e cila padi nuk parashkruhet. Gjithashtu, në kuptim të nenit 72 të ligjit të sipër cekur, rezulton, se në rastin konkret civil, përkitazi me posedimin e palës së paditur të paluajtshmërisë kontestuese, nuk mund të bëhet fjalë për posedim ligjor dhe as me mirëbesim të saj. Pala e paditur, në rastin konkret civil, rezulton se nuk ka bazë të vlefshme juridike ndaj paluajtshmërisë lëndore, kontestuese, për posedimin dhe shfrytëzimin e saj.

4. Ndërsa, në kontekst të thënieve të revizionit dhe nga arsyet e sipër përmendura, kjo Gjykatë, vlerëson se të njëjtat nuk qëndrojnë, sikundër që nuk qëndron as pretendimi i revizionit përkitazi me çështjen e mungesës së legjitimitetit real aktiv të palës paditëse, për faktin sepse, kur jemi këtu, duhet theksuar se për palën përkatëse, themi se është e legjitimuar realisht nëse ajo palë është pjesëmarrëse e raportit materialo - juridik nga i cili ka lind kontesti, siç është edhe rasti konkret civil me palën paditëse Korporata Energjetike e Kosovës, e cila në këtë çështje juridike, ka legjitimitet real aktiv.

5. Prandaj, në rastin konkret, sikundër rezulton nga të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e administruara, pala paditëse, e ka provuar edhe bazën juridike (iustus titullus) përkitazi me pronësinë në paluajtshmerinë kontestuese, e me këtë edhe themelësinë e kërkesëpadisë së saj, nga këtu, edhe vlerësimi i kësaj Gjykate, se gjykata e instancës më të ulët, përkitazi me këtë çështje kontestuese juridiko - civile, ka marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

6. Për arsyet e sipërpërmendura revizioni i të paditurit u refuzua si i pa themelë, ndaj, sipas dispozitës së nenit 222 lidhur me nenin 505 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.8/2024, i datës 31.01.2024

”Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar si të themeltë revizionin e palës paditëse, ka prishur aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, dhe çështjen ia ka kthyer në rigjykim gjykatës së shkallës së parë, sepse në rastin konkret, nuk janë dhënë arsyet e plota, të drejta dhe ligjore për faktet relevante që kanë të bëjnë me paluajtshmërinë kontestuese dhe lidhur me këtë nuk ka një historiat të plotë rreth pjesës së ngastrës kontestuese nr.4322/23, në sipërfaqe prej 272 m2, me të dhënat tjera si në shkresat e lëndës, në emër të kujt ka qenë e regjistruar më parë kjo pjesë e ngastrës kontestuese, nëse është evidentuar edhe më parë si pronë shoqërore - Komuna e Pejës, si është bartur e regjistruar pronësia në emër të saj, mbi ç’bazë, prej kur, a është blerë edhe kjo pjesë e ngastrës kontestuese me kontratën e v.1963, pastaj duke pasur parasysh edhe shënimet e kadastrit përshkruar të v.1952 e këndeje, etj, për çka nuk ka deklarim të duhur dhe të plotë të gjykatave të instancës më të ulët“.

I. Rrethanat e Çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.871/19 datë 5.06.2023 është refuzuar si e pathemeltë ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.566/14 datë 4.01.2019, me të cilin, refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi si trashëgimtarë i vetëm i të ndjerit J.D.T., është pronarë i pjesës së ngastrës kadastrale 4322/23 e evidentuar si pronë shoqërore, rrugët dhe rrugicat, Pejë, në sipërfaqe prej 271 m2 sipas ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë të dt.16.11.2016, sipas dimensioneve nga ana veriore në gjatësi prej 19.99 m. (kah parcela fqinje nr.4321/2), në anën lindore (kah rruga publike) në gjatësi kadastrale prej 13.76 m, (nga pika e detajit 1 deri në 418), në anën jugore në gjatësi kadastrale të plotë prej 19.90 m (nga pika e detajit 417,418 deri 404), që është edhe kufiri kadastral zyrtar në parcelat fqinje dhe në anën perëndimore (kah parcela 4321/8) në gjatësi faktike prej 12.94 m (nga pika e detajit 404 deri në 1). Në këto dimensione realizohet sipërfaqja e plotë prej 272 m2 që është në posedim pala paditëse, dhe që të detyrohet e paditura që paditësit të ia njoh të drejtën e pronësisë dhe ta lejoj që e njëjta të regjistrohet pranë Zyrës Komunale Kadastrale në Pejë në emër të paditësit, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimin nën

kërcënim të përbarimit me dhunë si dhe të detyrohet e paditura që paditësit të ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore.

2. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, ka paraqitur revizion paditësi, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta pranojë revizionin dhe t'i anulojë aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët si dhe lëndën t'ia kthejë në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.
3. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion si dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se: Revizioni i paditësit është i themeltë.
4. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi më datën 10.07.2014, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, Komuna e Pejës, për shkak të vërtetimit të drejtës së pronësisë në paluajtshmërinë, me të dhënat si në padi dhe petitumin e saj, përkatësisht, si në precizimin e saj. Nga aktgjykimi në bazë të pohimit C.nr. 563/79 dt.19.06.1979 të Gjykatës Komunale në Pejë, vërtetohet se J.D.T., babai i paditësit D.T., i është pranuar e drejta e pronësisë në pjesën e ngas. kad. nr.4322/23 ZK-Pejë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.02,72 ha, por e njëjta nuk është bartur në emër të paditësit në librat kadastrale. Kjo ngastër, siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, evidentohet në emër të pronës shoqërore, rrugë dhe rrugica, Pejë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1280 m2. Nga aktvendkja me nr.16725/2011 dt.14.04.2011 vërtetohet se paditësi nuk është trashëgimtar i vetëm i të ndjerit J.D.T., pasi që i njëjti pas vetes ka lënë edhe vajzat B.V. dhe A.M. të cilat jetojnë në B. Paditësi me padi kërkon që të vërtetohet që i njëjti si trashëgimtarë i vetëm i të ndjerit D.T., të vërtetohet se është pronar i pjesës së ngastrës kadastrale me nr.4322/23 me sipërfaqe prej 0.02.72 ha, duke cekur se trashëgimtarët tjerë kanë hequr dorë nga e drejta e trashëgimisë në lëndën e shqyrtimit të trashëgimisë në Gjykatën Komunale në Pejë e cila lëndë evidentohet C.nr.91/11 përkatësisht aktvendimi i dt.17.05.2011, mirëpo, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se ngastra kontestuese nuk ka qenë objekt i shqyrtimit të trashëgimisë.

5. Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të sajë.
6. Në procedurën ankimore gjykata e shkallës së dytë në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ndaj, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, aktualisht nuk mund të pranojë një përfundim të tillë juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimet e cekura janë marrë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 lidhur me nenin 8, nga neni 182.2 pika (n), ndërsa, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë me shkelje nga neni 182.1 lidhur me nenin 204 të LPK-së dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, e që për pasojë, gjendja faktike ka mbetur pa u vërtetuar në mënyrë të plotë dhe për këtë arsye nuk ka kushte për ndryshimin e tyre, prandaj, për këtë shkak të dy aktgjykimet u deshtë të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim.
2. Sipas dispozitës së nenit 204 të LPK-së, parashihet se në arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht të aktvendimit, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësishme vendimtare për dhënien e vendimit të saj. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së dytë nuk i ka vlerësuar plotësisht thëniet ankimore në kuptim të dispozitës së përmendur.
3. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore konsistojnë në atë se ka kundërthënie midis dispozitivit e arsyetimit, se arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk përmban arsyet për faktet relevante për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, arsyet e paraqitura janë të pa qarta dhe kontradiktore. Nuk ka një analizë të provave të zhvilluara nga gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, nuk janë vënë në relacion krahasues dhe vlerësues, veç e veç e së bashku.

4. Kështu, shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetvete dhe me arsyet e tij, nuk janë dhënë arsyet e plota, bindëse dhe ligjore përkitazi me faktet relevante për vendosjen e drejtë dhe ligjore të këtij rasti juridiko- civil. Në kontekstin e mësipërm, gjykata e instancës më të ulët, nuk jep arsyet e plota, të drejta dhe ligjore, për faktet relevante që kanë të bëjnë me paluajtshmërinë kontestuese dhe përkitazi me këtë, nuk ka një historiat të plotë rreth pjesës së ngastrës kontestuese nr.4322/23, në sipërfaqe prej 272 m2, me të dhënat si më lartë, nuk janë dhënë arsyet dhe shpjegimi përkatës se në emër të kujt më parë ka qenë e regjistruar kjo pjesë e parcelës kontestuese, nëse është evidentuar edhe më parë si pronë shoqërore - Komuna e Pejës, si është bartur a regjistruar e njëjta në emër të saj, mbi çfarë baze, prej kur, apo nëse eventualisht ka qenë në emër të paditësit a paraardhësit të tij juridik, po ashtu mbi çfarë baze, prej kur, a është blerë edhe kjo pjesë e ngastrës kontestuese me kontratën e v.1963, që gjendet në shkresat e lëndës (për çka nuk ka deklarim të gjykatës), pastaj, sidomos, duke pasur parasysh përmbajtjen e dispozitivit të aktgjykimit në bazë të pohimit C.nr.563/79 dt.19.06.1979, të Gjykatës Komunale në Pejë, në të cilin përmendet edhe parcela kontestuese nr.4322/23 në sipërfaqe prej 272 m2, dhe Fletë posedimi nr.2805 ZK- Pejë, lidhur me të cilin, po ashtu, gjykata e instancës më të ulët, nuk ka dhënë arsye, as kurrfarë deklarimi se sipas atij fletë posedimi, në emër të kujt evidentohet paluajtshmëria kontestuese, dhe si evidentohet e njëjta, në emër të kujt, sipas operatit kadastral, etj, edhe para v.1979, sikundër, edhe në bazë të kadastrit përshkrues të v.1952 e këndej.
5. Përkitazi me këto rrethana dhe fakte relevante, nuk është dhënë shpjegim dhe arsyetim i plotë dhe i drejtë nga gjykata e shkallës më të ulët, ndërsa, në rastin konkret civil, përveç sa u theksua më sipër, duhet siguruar edhe një ekspertizë të plotë të ekspertit - ekspertëve përkatës të gjeodezisë, sikundër edhe një historiat i plotë dhe kronologjik rreth paluajtshmërisë kontestuese, shënimet kronologjike prej kadastrit përshkrues e këndej, nga radhët e ekspertëve të DGJKP-së, në Pejë apo edhe nga Agjensioni Kadastral i Kosovës.
6. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të bazuara thëniet e revizionit, që kanë të bëjnë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 pika (n), nenin 182.1 në lidhje edhe me

nenin 204 të LPK-së dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 i LPK-së.

7. Në rigjykim gjykata e shkallës së parë është e detyruar të mënjanojë të metat e lartcekura, t'i zhvillojë dhe t'i vlerësojë të gjitha provat e nevojshme, duke i vënë në relacion krahasues, veç e veç dhe së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me qëllim që të vërtetojë të gjitha faktet relevante të sipër përmendura, të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, nga ana e ekspertit – ekspertëve të gjeodezisë të kërkojë historiatin e plotë për paluajtshmërinë kontestuese, respektivisht të pjesës së saj, shënimet kronologjike kadastrale, për qartësimin e çështjeve të sipër përmendura, më pastaj, duke pasur parasysh edhe thëniet tjera në revizion, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.
8. Nga arsyet e sipër përmendura dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 224.2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.97/2024, i datës 12.03.2024

”Me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Trashëgiminë parashihet se trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshortja e tij. Personat e sipër cekur trashëgojnë në pjesë të barabarta dhe në bazë të nenit 184 të LPJ, parashihet se personin përkatës nuk e lidh aktvendimi për trashëgiminë apo legatin, ai mund t’i realizoi të drejtat e tij vetëm në procedurën kontestimore, siç edhe ka vepruar pala paditëse në rastin konkret civil. Gjykata Supreme e Kosovës ka refuzuar si të pathemeltë revizionin e të paditurit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me numër e datë si më poshtë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1387/2020 datë 4.05.2023, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e të paditurit, ndërsa, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Klinë C.nr.35/11 i datës 10.02.2020, me të cilin, me pjesën e I, të dispozitivit të tij, vërtetohet se paditësit, janë trashëgimtarë ligjor të ndjerit R.M.R., ish nga Klina, të cilëve në bazë të trashëgimisë iu takon e drejta e pronësisë nga 1/5 e pjesëve ideale të ngastrës kadastrale nr. 496-2, me kulturë livadh, në sipërfaqe prej 0.05,60 ha, në vendin e quajtur “S.”, Zona Kadastrale K., ku i padituri D.R., nga O., Komuna e I., detyrohet që këtë të drejtë tua njeh dhe të lejoj regjistrimin e pronësisë në Drejtorin për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në K., në emër të paditësve, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, me kërcënim përbarimi të detyrueshëm. Me pjesën e II të dispozitivit, detyrohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, që paluajtshmërinë e sipër cekur ta regjistrojë në emër të paditësve nga 1/5 e pjesëve ideale, siç është theksuar në pjesën e I të dispozitivit. Me pjesën e III të dispozitivit, refuzohet kërkesa e ndërhyrësve në anën e paditësve Z.R. nga B. dhe I.G. nga B., kur kanë kërkuar që t’ju vërtetohet e drejta e trashëgimisë sipas të drejtës së përfaqësimit, pas vdekjes së të ndjerit R.R., nga 1/5 përkatësisht nga 1/10 e pjesëve ideale, si e pa bazuar. Me pjesën e IV dispozitivit, masa e përkohshme e marrë me aktvendimin e gjykatës C.nr.35/11 dt.4.11.2013, mbetet në fuqi deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës, dhe me pjesën e V të dispozitivit, detyrohet i padituri që në emër të shpenzimeve të procedurës tu paguajë paditësve shumën prej 355,00 euro,

- të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.
2. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat ligjor i padituri ka paraqitur revizion, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni si i bazuar, të ndryshohen aktgjykimet gjykatave të instancave më të ulëta, ashtu që kërkesëpapia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar ose të njëjtat aktgjykime të prishen, dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim.
 3. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 215 të LPK-së, si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se: Revizioni i të paditurit është i pathemeltë.
 4. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit më datën 21.02.2011, në gjykatën e shkallës së parë, kanë ngritur padi kundër të paditurit, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se mbi bazën e trashëgimisë janë pronarë me nga 1/5 të paluajtshmërisë, me të dhënat si në petiutimin e padisë, përkatësisht, si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë gjatë procedurës, nga administrimi i provave, ka vërtetuar se trashëgimlënësi R.R., ka vdekur më 11.08.1998 në K. Pas vdekjes ka lënë trashëgimtarët ligjor, nga rendi i parë i trashëgimtarëve, djemtë D., J., R., R., të gjithë R. dhe vajzën I.D., e lindur R. Djali i trashëgimlënësit, R.R. ka vdekur më 4.06.2017, dhe ka lënë djalin Z.R. dhe vajzën I.G. e lindur R. Nga shkresat e lëndës të Gjykatës Komonale në K. T.nr.36/06 dhe aktvendimit për trashëgiminë të dt.5.12.2006, ka vërtetuar se para asaj gjykate me propozimin e të paditurit është udhëhequr procedura trashëgimore pas vdekjes së të ndjerit R.R. dhe është marrë aktvendimi për trashëgiminë, ashtu që trashëgimtarë i vetëm është shpallur i padituri D.R. dhe në bazë të kësaj, paluajtshmëria është regjistruar si parcelë 496/2 në emër të paditurit, siç del edhe nga certifikata e pronësisë dt.13.12.2010. Në seancën trashëgimore ka marrë pjesë edhe djali i trashëgimlënësit, R.R., i cili ka dhënë deklaratën trashëgimore me të cilin heq dorë nga trashëgimia në llogari të vëllait D., këtu të paditurit, pra, ka pranuar trashëgiminë dhe pjesën e vet ia ka kaluar vëllait të tij, D.
 5. Sa i përket testamentit të cilin i padituri ia ka dërguar gjykatës tek me parashtresën e dt.16.03.2016, dhe deri atëherë askund në shkresa nuk përmendet se trashëgimlënësi ka

lënë testament, dhe kjo as me rastin e përpilimit të akt vdekjes nga ofiqari në Klinë, si dhe as me rastin e zhvillimit të procedurës trashëgimore, ku me ç'rast ai, i padituri, decidivisht është përgjigjur në pyetjen e gjykatës se i ndjeri R., për të gjallë nuk ka lënë testament, as kontratë mbi mbajtjen e përrjetshme, dhe të ngjashme, me çka do të kishte ndarë pasurinë pas vdekjes, e i cili, gjykatës, gjatë procedurës i ka treguar një testament me dorëshkrim në të cilin gjendet nënshkrimi i trashëgimlënësit me dt.16.08.1994. Në testamentin e cekur gjendet edhe nënshkrimi i të paditurit D., si marrës i pasurisë. Gjykata e shkallës së parë, i ka vlerësuar si të bazuara thëniet e palës paditëse se testamenti është akt personal, rreptësisht formal, nuk është i përpiluar sipas ligjit, se në të nuk ka bazë ligjore për vënien e nënshkrimit nga ana e trashëgimtarit testamental (këtu të paditurit), dhe se testamenti shpallet vetëm pas vdekjes së trashëgimlënësit. Në lidhje me këtë që u theksua më lartë, gjykata e shkallës së parë, në procesverbal të dt.10.02.2020, e ka revokuar aktvendimin për ekspertizën grafologjike të nënshkrimit të trashëgimlënësit dhe kjo pas njoftimit nga ana e përfaqësuesve të palës paditëse dhe asaj të paditur që në lidhje me këtë janë të pëlqimit se ekspertiza është e panevojshme. Nga raporti i ekspertit të gjeodezisë A.Th. dt.6.06.2016, është kryer identifikimi i ngastrës kadastrale lëndore nr.496-2, sipërfaqe prej 560 m2, ndaj të cilit palët në procedurë nuk kanë kundërshtuar. Duke pasur parasysh faktin se pasurinë trashëgimore para të gjithëve e trashëgojnë fëmijët e tyre dhe bashkëshorti. Ata trashëgojnë në pjesë të barabarta, bashkëshortja e trashëgimlënësit ka vdekur para tij, duhet theksuar se paditësit nuk ishin të njoftuar mbi fillimin e procedurës (seancës) trashëgimore dhe si pasojë edhe nuk kanë marrë pjesë në të.

6. Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave dhe në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, ndaj, në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit mbi Trashëgiminë, nenit 184 të Ligjit mbi Procedurën Jo kontestimore, etj, ka vendosur si në pjesën I, II, III, IV dhe V të dispozitivit të aktgjykimit të saj.
7. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se e njëjta, drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje të së drejtës materiale. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit për shkelje të së drejtës materiale, nuk mund t'i vënë në pyetje aktgjykimet e instancave më të ulëta.
2. Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës më të ulët, përkritazi me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësve pasi që janë dhënë arsytet ligjore bindëse dhe të pranueshme edhe nga kjo gjykatë. Kështu sepse, siç rezulton nga provat e zhvilluara dhe të administruara, paditësit janë trashëgimtarët ligjor të trashëgimlënësit, se trashëgimlënësi pas vdekjes ka lënë trashëgimtarët djemtë dhe vajzën, siç u përshkrua më lartë, ka lënë pasurinë e paluajtshme të sipër përmendur. Me dispozitat e nenit 12 të Ligjit Për Trashëgiminë parashihet se trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshortja e tij (e cila ka vdekur para trashëgimlënësit). Personat e sipër cekur trashëgojnë në pjesë të barabarta. Ndërkohë që, me aktvendimin për trashëgiminë T.nr.36/06 dt.5.12.2006, të Gjykatës Komunale në Klinë, pas vdekjes së trashëgimlënësit R.M.R., ish nga K., i vdekur më 11.08.1998, në të cilin theksohet se nga pasuria e paluajtshme ka lënë parcelën e sipër cekur, ndaj, si trashëgimtar ligjor pas vdekjes së tij, shpallet djali D.R.R. nga K., këtu i padituri, në tërë pasurinë e paluajtshme. Në këtë procedurë trashëgimore nuk kanë qenë të njoftuar paditësit, ata nuk kanë marrë pjesë fare në seancën trashëgimore, në të ka marr pjesë vetëm vëllai i tyre, këtu i padituri dhe R.R.R., i cili kishte hequr dorë nga pjesa e vet takuese, në llogari të paditurit. Në të, veç tjerash, është theksuar se i ndjeri - trashëgimlënësi R., nuk kishte lënë pas vdekjes testament e as ndonjë dokument tjetër për ndarjen e pasurisë, e as kontratë mbi mbajtjen e përrjetshme, sikundër rrjedh edhe nga aktvdekja e lëshuar nga organi kompetent, (neni 148.1 i LPJ-së), por që, lidhur me këtë, edhe vet i padituri me rastin e marrjes pjesë në seancën trashëgimore dhe të dhënies së deklaratës

trashëgimore nuk është thirrur në atë se trashëgimlënësi ka lënë ndonjë testament dhe nuk ka treguar që ka edhe pasardhës të tjerë të trashëgimlënësit.

3. Me nenin 74 të Ligjit Për Trashëgiminë parashihet se testamenti është i vlefshëm në qoftë se testatori e ka shkruar atë, datuar dhe nënshkruar me dorën e vet ose e ka vënë gishtin e vet. Nënshkrimi duhet të përmbajë mbiemrin e testatorit si dhe të paktën njërin prej emrave të tij dhe duhet vënë në fund të testamentit (e jo që në të, të nënshkruaj edhe i padituri si trashëgimtar, siç ka ndodhur në rastin konkret). Në këtë kontekst, po ashtu, me dispozitën e nenit 79.2 të këtij ligji parashihet se “Nuk mund të jenë dëshmitarë kur përpilohet testamenti me shkrim në prani të dëshmitarëve dhe testamenti gjyqësor, as të përpilojnë testemantin sipas tregimit të testatorit personat me cilësinë e gjyqtarit, pasardhësit të testatorit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, paraardhësit e tij, prindërit e tij adoptues, personat në gjini në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, bashkëshortët e të gjithë këtyre personave dhe bashkëshorti i testatorit”.
4. Në anën tjetër, duhet theksuar gjithashtu, se lidhur me këtë çështje, me nenin 184 të LPJ-së, parashihet se “Personi të cilin nuk e lidhë aktvendimi për trashëgimin apo për legatin, i cili mendon se i takojnë të drejtat e trashëgimtarit apo legatarit, mund ti realizojnë të drejtat e tilla vetëm në procedurë kontestimore”, siç edhe kanë vepruar paditësit. Me nenin 20 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, parashihet, veç tjerash, se “E drejta e pronësisë fitohet me ligj, në bazë të punës juridike dhe me trashëgimi”, përkatësisht, me nenin 36 të këtij ligji, parashihet se “E drejta e pronësisë mbi sendin fitohet me trashëgim në momentin e hapjes së trashëgimisë në pasurinë e të vdekurit, nëse me ligj nuk është caktuar diç tjetër”, skundër është rasti me trashëgimtarët, këtu paditësit e sipër përmendur. Kështu, sepse nga provat e administruara rrjedh se trashëgimlënësi pas vdekjes, përveç djalit të tij, trashëgimtarit, këtu të paditurit D., ka lënë edhe djemtë dhe vajzën, këtu paditësit, të cilëve në bazë të ligjit u takon e drejta e pronësisë mbi bazën e trashëgimisë, në paluajtshmërinë e sipër përmendur.
5. Prandaj, nga këtu dhe nga arsyet e sipërpërmendura revizioni i të paditurit u refuzua si i pa themeltë, dhe sipas dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.139/2024, i datës 04.04.2024

"Në rastin konkret civil, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se janë plotësuar të gjitha parakushtet ligjore të përgjegjësisë së palës së paditur për kompensimin e dëmit palës paditëse, konform nenit 154, nenit 155, nenit 172.1 të LMD-së, ndaj, e ka refuzuar si të pa themeltë revizionin e të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1431/21, dt.16.10.2023".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1431/21 dt.16.10. 2023, refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3337/12 dt.19.10.2020, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe detyrohet e paditura që paditësin ta kompensojë në emër të dëmit material të pësuar në shtëpinë e tij, më dt. 24.04.2012, si pasojë e shpërthimit të gypit kryesor të ujit dhe atë; a) Në emër të dëmtimit të mobileve dhe inventarit: Dhoma e parë majtas nga korridori, dy shtretër dhe dy tepih, dhoma e dytë, dy shtretër, ormani, enëlarësi, dhoma e tretë, dy tepih, një orman, dhoma e katërt, tre shtretër, një orman, një tepih, kuzhina dhe elementet e kuzhinës, të gjitha në shumën prej 3,470.00 euro. b). Në emër të punëve ndërtimore zejtare (të brendshme) në bodrum - largimin e dyshemesë së vjetër, furnizimi me material dhe sanimi i dyshemesë së dëmtuar, gërryerja, mënjanimi dhe pastrimi i një pjese të murit prej ngjyrës së vjetër të dëmtuar dhe furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve dhe tavanit me ngjyrë, të gjitha në shumë prej 1,483.20 euro. c). Në emër të dëmtimit të pajisjeve elektrike siç janë: kalldaja, tre frigoriferë, shporeti elektrik, fshesa elektrike, nxemësja elektrike dhe laptopi, të gjitha në shumë prej 2,940.00 euro. Me pjesën e II të dispozitivit, detyrohet e paditura që shumën e përgjithshme prej 7,893.20 euro, në emër të dëmit material të gjykuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, t'ia paguajë paditësit, me kamatë në lartësinë të cilën e paguajnë bankat vendore, si për mjetet e afatizuara për një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga dt.19.10.2020, dita kur është marrë aktgjykimi, e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 914.00 euro, krejt në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit.

2. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, ka paraqitur revizion e paditura për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale (duke përfshirë në të, edhe pretendime rreth gjendjes faktike), me propozim, siç thuhet në të, që nga Gjykata Supreme e Kosovës të aprovohet revizioni si i bazuar dhe i argumentuar, dhe pas administrimit të provave, të merr aktvendimin me të cilin e ndryshon aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1431/21.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të revizionit dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, gjeti se: Revizioni i të paditurës është i pathemeltë.

4. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, kundër të paditurës, më datën 21.12.2012, ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material, t'i paguaj shumat si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, me të dhëna tjera si në petitumin e padisë, përkatësisht si në precizimin e saj. Gjykata e shkallës së parë, nga leximi i Shënimit Zyrtar 07 nr.087-15177 dt.30.04.2012, i lëshuar nga Komuna e Prishtinës, Inspektorët e MSH-së, ka konstatuar se më datën 24.04.2012, në bazë të thirrjeve telefonike të Qendrës Komonale për Informim dhe Alarmim Emergjent, kanë dalë në teren dhe kanë konstatuar se në rrugën “Gazmend Zajmi”, ngjitur me shtëpinë e F.V., ka ardhur deri te shpërthimi i gypit kryesor të ujësjetillës me gjerësi Fi-350, me ç’ rast janë vërshuar në masë të madhe sipërfaqet e shtëpisë, respektivisht të katit përdhësë të pronarit R.F, këtu paditësit. Gjatë shikimit dhe fotografimit të gjendjes është vlerësuar se nga vërshimet e ujit është dëmtuar në tërësi pjesa përdhësë e shtëpisë në gjerësi prej 140 m2, me katër dhoma dhe korridori. Në prezencën e pronarit të shtëpisë, kanë vlerësuar këto dëme materiale: nxemje qendrore - kalldaja me aparaturën gjegjëse - 1,500.00 euro, korridori me gjerësi 6 x 2m - frigoriferi, shporeti elektrik, dyshemeja dhe fshesa elektrike – 700.00 euro, dhoma e parë, 2 kauqa, regalli, 2 tepih, nxehtëse - 1,000.00 euro, shporeti elektrik, nxehtëse, dyshemeja - 1,700.00 euro, dhoma e tretë: një lllaptop, 2 tepih, regalli, nxehtëse dyshemeja - 1,100.00 euro, dhoma katërt: shporeti elektrik, frigoriferi, tre kauqa, regalli, 2 tepih, elementet e kuzhinës - 2,500.00 euro. Po ashtu, nga i njëjti shënim zyrtar konstatohet në vend shikim se dëmet janë shkaktuar nga gypi i shpërthyer i ujit, që mbikëqyret në këtë rast nga e paditura.

5. Nga ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë, dt.15.03.2019, e punuar nga eksperti S.B., konstatohet se shkaktar i dëmit material është pëlcitja e gypit të ujit për furnizim me ujë të pijes, dimension tërthor Fi 350 mm, i cili shtrihet në tokë për së gjati n Rr.”Rexhep Mala” në Prishtinë, lagja Aktash I, ndërsa, dëmi total i shkaktuar nga vërshimi i ujit në shtëpinë e paditësit, është në shumë prej 4,953.20 euro, me të dhënat tjera të specifikuara si në ekspertizën e këtij eksperti. Nga ekspertiza e ekspertit të elektroteknikës Z.B., dt.24.03.2019, dhe mendimi plotësues i të njëjtit, në seancën e dt.23.07.2019, del se dëmtimi total në pajisjet elektrike është 3,983.00 euro. Me propozimin e të paditurës, gjykata e shkallës së parë, ka nxjerrë provën me ekspertizën nga lëmi i ndërtimtarisë, e punuar nga grupi i ekspertëve dr. Q.K., dr. A.D. dhe Mr.sc. A.M., dt.22.01.2020, nga e cila rrjedh se plasja e gypit ka ardhur deri te rrjedhja e ujit nga presioni me ç’rast nga uji është vërshuar bodrumi i objektit banesor të pronarit R.F., - paditësit. Me rastin e vërshimit të ujit në shtëpinë e paditësit, janë shkaktuar dëmet e sipër përmendura dhe konstatimi i grupit të ekspertëve është se dëmi i shkaktuar në shtëpinë e paditësit është në lartësi prej 4,953.20 euro, siç është konstatuar edhe nga ekspertiza e dt.15.03.2019, nga eksperti i ndërtimtarisë S.B. Po ashtu, me propozimin e të paditurës, gjykata, ka nxjerrë edhe provën me ekspertizën nga lëmi i elektroteknikës, e punuar nga grupi i ekspertëve Prof.dr.G.P., Prof.dr. M.B. dhe Mr.sc. N.B., dt.30.07.2020, si dhe shpjegimi plotësues i tyre, në seancën e dt.8.10.2020, nga është konstatuar se vlera e përgjithshme e dëmit të shkaktuar në pajisjet elektrike në shtëpinë e vërshuar nga uji pas shpërthimit të gypit të kryesor për furnizim me ujë të lagjes, të specifikuara në ekspertizë, dhe të përmendura më lartë, është në lartësi prej 2,940.00 euro.
6. Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 172, nenit 154, nenit 155 etj., të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, të njëjtën e ka miratuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.
7. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, pasi që në tërësi ka aprovuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se e njëjta gjykatë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se

kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndaj, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes juridiko civile, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Dispozitivi i aktgjykimit është i çartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse në arsyetim janë dhënë arsye e mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet e pretenduara të së drejtës materiale dhe procedurale (të cilat nuk janë në masë të duhur të specifikuara), nuk mund t'i vejnë në pyetje aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta.
2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë dhe ajo e shkallës së parë, kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e së drejtës materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe kanë obliguar të paditurën që atij t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar në shtëpinë e tij, në mënyrën dhe kohën e sipër cekur, në lartësinë e shumës e cila është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, nga administrimi i provave si ekspertizat përkatëse, dhe me prova tjera materiale dhe shkresore që gjenden në dosjen e kësaj lënde dhe si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.
3. Në këtë gjendje të çështjes civilo-juridike, duhet theksuar se me dispozitën e nenit 154 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashihet se: "kush i shkakton dëm tjetrit ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij", përkatësisht, "për dëmin nga sendet ose nga veprimtaria nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga fajti". Në rastin konkret, pala paditëse ka arritur që të provojë, se e paditura, në mënyrën e përshkruar më lartë, asaj i ka shkaktuar dëm material, si më lartë, dhe se e njëjta është përgjegjëse për kompensimin e tij, ndaj, nga këtu, edhe kjo gjykatë, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, në mbështetje edhe të dispozitave të nenit 154, nenit 155, nenit 172.1 të LMD-së, drejtë e kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e

paditësit është e bazuar dhe në këtë drejtim, vendimi i tyre është i drejtë dhe i ligjshëm. Kështu sepse, kjo Gjykatë vlerëson se, në rastin konkret, janë plotësuar të gjitha parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit nga e paditura, siç janë ekzistimi i subjekteve të marrëdhënies detyrimore dhe të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, i dëmtuari dhe shkaktuesi i dëmit, fakti dëmtues nga rezulton dëmi, ekzistimi i dëmit të shkaktuar, lidhja shkakësore, etj., të cilat janë përmbushur kumulativisht, ndaj, nga këtu edhe përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit paditësit. Gjithashtu, veç tjerash, edhe me dispozitat e nenit 185 të po të njëjtit ligj, parashihet se personi përgjegjës është i obliguar që të rivendos gjendjen e cila ka ekzistuar para se të ndodh dëmi, përkatësisht, nëse rivendosja e gjendjes së mëparshme, nuk eviton dëmin në tërësi, ose nuk është e mundur rivendosja e gjendjes së mëparshme, personi përgjegjës është i obliguar që për dëmin e mbetur të jep kompensimin në të holla, respektivisht, gjykata e cakton se ai do ti paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse të hollave në emër të kompensimit të dëmit, siç është edhe rasti konkret juridik civil. Po ashtu, për sa i përket pretendimeve të revizionit (faqe 1 dhe 2), përkritazi me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, duhet theksuar se me dispozitën e nenit 214.2 të LPK-së, “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike”.

4. Nga arsyet e sipër theksuara, e në mbështetje të nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.169/2024, i datës 18.04.2024

”Gjykata Supreme e Kosovës, përkitazi me kontestin civil të pagave jubilarë, ka refuzuar revizionin e paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, si të pathemeltë, nga se në periudhën përkatëse, si në shkresat e lëndës (dhe si më poshtë), nuk ka qenë në fuqi as Kontrata e Përgjithshme Kolektive dhe as kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1883/22 dt.24.01.2024, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e paditësit, ndërsa, është vërtetuar aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.251/2019 dt.3.12.2021, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpapia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri, që paditësit në emër të tri pagave të shpërblimit jubilar t’ia paguajë shumën prej 1,830.93 euro, si dhe tri paga mujore për pensionim, në shumë prej 1,830.93 euro, me kamatë prej 8% duke filluar nga data 28.03.2019, si ditë e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive, si dhe për të rimbursuar shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.
2. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi në afat ligjor, ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, siç thuhet në të, të pranohet revizioni, të prishet aktgjykimin i gjykatës së shkallës së dytë dhe aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë, të sipër cekur, dhe lënda të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, për rigjykim.
3. Përgjigje në revizion ka paraqitur pala e paditur, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të refuzohet si i pa bazuar.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur dhe shkresave të lëndës sipas dispozitës së nenit 215 të LPK, si dhe pretendimeve të revizionit, ka gjetur se: Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

5. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi kundër të paditurit, më dt.28.03.2019, ka paraqitur padi për shkak të pagesës së tri pagave jubilarë në shumë prej 1,830.93 euro dhe pagesave shoqëruese pas pensionimit në shumë prej 1,830.93 euro, me të dhënat tjera si në petitumin e padisë. Paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek i padituri nga viti 1979 e deri më datën 25.05.2018, kur ai doli në pension, sipas fuqisë së ligjit, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Në datën e pensionimit të tij, 25.05.2018, nuk kishte asnjë marrëveshje, apo akt tjetër ligjor dhe nënligjor që parashihte të drejtën e paditësit për shpërblim jubilar dhe të drejtën e tri pagave mujore të fundit për shkak të daljes së tij në pension, sepse KPK, e cila ka hyrë në fuqi më dt.1.01.2015, ka pushuar të vlejë më 1.01.2018, kurse, paditësi në pension doli më dt.25.05.2018, dhe KKS për shëndetësinë kishte hyrë në fuqi më dt.11.06.2018 dhe të njëjtat nuk kanë parashkuar efekt retroaktiv të tyre.

6. Pra, jemi në prani të faktit relevant, se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më dt.1.01.2015 dhe e njëjta ka pasur shtrirje kohore të zbatimit deri më dt.31.12.2017. Ndërkohë që, me nenin 90 par.4 të Ligjit të Punës, parashihet se “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tre (3) vjet”. Pra, siç del edhe nga padia, bazën juridike ligjore të kërkesës së vet, paditësi e ka mbështetur në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, të sipër cekur, të lidhur dhe nënshkruar nga organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës, Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) dhe Qeveria e Kosovës. Pra, Marrëveshja Kolektive, e sipër cekur ishte nxjerrë për afat të caktuar kohor, dhe e njëjta pas dt.31.12.2017, ka pushuar së zbatuari dhe afati i saj ka skaduar dhe më pas nuk është lidhur ndonjë marrëveshje e re në bazë të së cilës do të mund të kërkohehin pagat jubilarë. Oda Ekonomike e Kosovës, si partner social, nënshkruese e MPKK-së, më dt.15.09.2017, me njoftimin nr.prot.392, ka njoftuar Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për tërheqjen nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

7. Gjykata e shkallës së parë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, ndaj, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.
8. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, ndaj, e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës.

1. Duke u nisur nga gjendja e këtillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës e pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë lidhur me refuzimin e kërkesëpadiës së paditësit, pasi që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkëlqe thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe se janë dhënë arsyet e mjaftueshme të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.
2. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se të dy aktgjykimet e sipër përmendura, përkitazi me refuzimin e kërkesëpadiës së paditësit, në mënyrë të drejtë kanë zbatuar edhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, nga se vërtetë mungon baza ligjore që paditësit t'i paguhen tri pagat e shpërblimit jubilar dhe tri pagat përcjellëse pas pensionimit, sepse, Kontrata e Përgjithshme Kolektive në bazë të së cilës paditësi konsideron se i takon e drejta për këto paga të kërkuara, nuk ka qenë në fuqi, ajo ka qenë në fuqi nga 1.01.2015 dhe përfundimisht deri më dt.31.12.2017, ndërsa, paditësi është pensionuar më dt.25.05.2018.
3. Me dispozitën e nenit 52 të Marrëveshjes Kolektive të sipër cekur (jo në fuqi), parashihej, veç tjerash, që lidhur me " Shpërblimet Jubilarë " i punësuari ka të drejtë në shpërblim jubilar dhe atë për 10 vite përvojë të punës të pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page të tij, për 20 vite përvojë, në vlerë të dy pagave mujore të tij, për 30 vite përvojë, në vlerë prej tri pagave mujore të tij, i cili shpërblim paguhet brenda një muaji " dhe në kontekstin e mësipërm, pra, me arritjen e vitit jubilar, krijohet

edhe e drejta, e cila nëse nuk është përmbushur në mënyrë vullnetare në afatin prej një muaji, lind e drejta që të kërkohej realizimi i saj në rrugë gjyqësore, me ç' rast, këtu, nuk ka ndonjë afat për paraqitjen e kërkesës, por nëse kalon afati prej tri viteve sa është afati i parashkrimit për këto kërkesa (sipas ligjit përkatës) dhe në anën tjetër parashtrohet prapësimi i parashkrimit, nëse kërkesa është parashtuar pas afatit prej tri viteve nga momenti i kalimit të një muaji nga lindja e kërkesës, kërkesa është e parashkuar dhe nuk mund të realizohet në rrugë gjyqësore.

4. Ndërsa, me dispozitën e nenit 2 të Ligjit të Punës, parashihet se “Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës”. Me dispozitën e nenit 90 par.4 të këtij ligji parashihet se “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri(3)vjet”. Kurse , me par.5 të tij, parashihet se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”, gjë që këtu, në këtë çështje juridike, nuk është rast, ndërkohë që, Marrëveshja Kolektive, nuk ka efekt retroaktiv. Gjithashtu, me dispozitat e Ligjit të sipërpërmendur, nuk është paraparë e drejta e punëtorit për pagesën e shpërblimit jubilar dhe e pagave përcjellëse për shkuarjen në pension të pleqërisë. Kurse, me dispozitën e nenit 77 të po të njëjtit Ligj, është paraparë që pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Nga këtu dhe në prani të rrethanave, fakteve si dhe nga arsyet e sipër përmendura, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se, gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale, nga se vërtetë, në rastin konkret civil-juridik, nga arsyet e sipër theksuara, mungon baza ligjore që pagat jubilarë kontestuese nga ana e të paditurit t’i paguhen paditësit, ndaj, nga këtu dhe në kontekstin e mësipërm, edhe pretendimet e revizionit janë të paqëndrueshme.
5. Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.304/2024, i datës 16.07.2024

”Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2842/21 dt.30.04.2021, është marrë me shkelje thelbore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenit 182.2 pika n), nenit 182. 1 në lidhje me nenin 92, nenin 93, nenin 99, nenin 102, nenin 103, nenin 110, nenin 204 etj, të LPK-së, si dhe në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndaj, nga arsytet e më poshtme, u deshtë që të pranohet si i themeltë revizioni i paditësit dhe lënda t’i kthehet Gjykatës së Apelit për vendosje sipas ankesës së palës paditëse“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2842/21 të dt.30.04.2021 është hedhur si e pa lejuar ankesa e parashtruar nga avokati N.H., nga P, në emër të paditësit H.Gj. nga fshati S., Komuna e D., ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1013/16 dt.3.11.2020, me të cilin konsiderohet se është tërhequr padia e paditësit H.Gj., paraqitur kundër të paditurës së sipër përmendur.
2. Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, paditësi, ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, siç thuhet në të, të aprovohet si e themeltë përsëritja e procedurës (duke menduar në revizionin) dhe të ndryshohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë C.nr.1013/16 dt.3.11.2020 dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë Ac.nr.2842/21 dt.30.04.2021, ashtu që për tu gjykuar ajo çështje, fillimisht të dërgohen ftesat për seancë, në adresën e tij.
3. Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 lidhur me nenin 230 të LPK, shkresave të lëndës dhe pas vlerësimit të pretendimeve të revizionit ka gjetur se: Revizioni i paditësit është i themeltë.

4. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi H.Gj. nga fshati S., Komuna e D., nëpërmjet avokatit N.H., nga Prishtina, (padija e vulosur dhe e nënshkruar nga avokati), kundër të paditurës KEDS, me seli në Prishtinë, ka paraqitur padi më dt.5.05.2016, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, me të dhënat tjera si në petitumin e padisë, përkatësisht, si në shkresat e lëndës. Gjykata e shkallës së parë, lidhur me këtë çështje ka caktuar seancën përgatitore për datën 3.11.2020, në të cilën ka konstatuar se për palën paditëse nuk ka prezentuar askush, pavarësisht se i autorizuari i paditësit (avokati i sipër cekur) ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, mirëpo, mungesën nuk e ka arsyetuar, ndaj, duke iu referuar nenit 409 par.1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, kurse, pastaj, kundër këtij aktvendimi ankesë ka parashtruar avokati N.H., nga P.
5. Në këtë gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se janë plotësuar kushtet për ta konsideruar të tërhequr padinë e paditësit, ndaj, duke iu referuar dispozitës së nenit 409.1 Ligjit të Procedurës Kontestimore, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të saj.
6. Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore, pasi shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, ka vlerësuar se në rastin konkret ankesa është paraqitur nga personi që nuk ka qenë i autorizuar për ndërmarrjen e një veprimi të tillë, nga se në shkresat e lëndës nuk hasi në ndonjë autorizim me shkrim apo deklaratë të dhënë nga ana e paditësit e me të cilën do të vërtetohej që paditësi H.Gj., ta ketë autorizuar avokatin N.H., që ta përfaqësojë në këtë çështje kontestimore. Po ashtu, një autorizim i tillë nuk është bashkangjitur as me rastin e parashtrimit të ankesës. Bazuar në këto fakte, Gjykata e Apelit e Kosovës, erdhi në përfundim se ankesa e parashtruar nga avokati N.H., është paraqitur nga personi i pa autorizuar, ndaj, në bazë të nenit 92.1, nenit 93.1, nenit 186.3 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të saj.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës aktualisht nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë, nga se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me

shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 p.n), nenit 182. 1 në lidhje me nenin 92, nenin 93, nenin 99, nenin 102, nenin 103, nenin 110, nenin 204 etj, të LPK-së, ndaj, u dashtë që aktvendimi i tillë të priset dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së dytë, për të vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të sipër cekur të gjykatës së shkallës së parë. Kështu sepse, veç tjerash, vërtetë me nenin 92.1 të LPK-së, përcaktohet se “Pala e jep autorizimin për përfaqësim në formë të shkruar ose gojarisht në procesverbal tek gjykata”, përkatësisht, me nenin 93.1, të njëjtit ligj, përcaktohet se “I autorizuari për përfaqësim ka për detyrë që me rastin e kryerjes së veprimit të parë në procedurë ta paraqes prokurën”. Kurse, gjykata e shkallës së dytë, siç u theksua edhe më lartë, ka konstatuar se nuk hasi në ndonjë autorizim me shkrim apo deklaratë të dhënë nga ana e paditësit me të cilin do të vërtetohej që paditësi, ta ketë autorizuar avokatin e sipër përmendur, që ta përfaqësojë në këtë çështje kontestimore dhe se një autorizim i tillë nuk i është bashkangjitur as me rastin e ushtrimit të ankesës. Mirëpo, sikundër rezulton edhe nga shkresat e lëndës, padinë e paditësit të dt.5.05.2016, në gjykatën e shkallës së parë e ka paraqitur avokati N.H., nga P., dhe në hyrje të padisë është shënuar se paditësin e përfaqëson me autorizim avokati N.H., i cili edhe e ka vulosur dhe e ka nënshkruar padinë për paditësin. Duke u nisur nga ky fakt, gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të seancës përgatitore dt.3.11.2020, e ka ftuar pikërisht vetëm avokatin e paditësit dhe më tej, ka konstatuar se në të njëjtën seancë nuk ka prezentuar i autorizuari i palës paditëse, edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt, e mungesën nuk e ka arsyetuar, ndaj, konform nenit 409.1 të LPK-së, ka vendosur si në aktvendimin e saj, pra, e ka konsideruar padinë e paditësit të tërhequr, ndërkohë që, me rastin e ankesës së paraqitur kundër këtij aktvendimi, në emër të paditësit, po nga avokati N.H., gjykata e shkallës së dytë, nga arsyet e sipër cekura, të njëjtën e hedh si të palejuar nga se është paraqitur nga personi i pa autorizuar, dhe për këtë diskrepancë ligjore, gjykatat përkatëse nuk kanë dhënë arsyet e plota, të sakta dhe të drejta dhe jo në harmoni me dispozitat e sipër përmendura ligjore. Kështu, edhe me dispozitën e nenit 110.1 të LPK-së, parashihet se “Padia, përgjigja në padi, letërthirrja për në seancë....., i dorëzohet personalisht palës, përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj.....” gjë që, në rastin konkret nuk është vepruar në pajtim me këtë dispozitë ligjore, dhe nëse qëndron konstatimi se avokati i tij, nuk ka pasur autorizim përkatës për përfaqësim, atëherë, domosdo, është dashtë të ftohet personalisht paditësi në seancën gjyqësore, përkatësisht, gjykata e instancës më të ulët, është dashtë të veprojnë në harmoni me

dispozitat ligjore të sipër përmendura. Veç tjerash, ky ka qenë edhe obligim i gjykatës më të ulët, që në rastin konkret të kujdeset për parimin e kontradiktoritetit dhe të “barazisë së armëve“, ndërmjet palëve, ku secilës palë ndërgjyqëse duhet dhënë mundësia për paraqitjen e rastit të vet në kushte që nuk e vënë atë në pozitë të pabarabartë me palën kundërshtarë. Ndaj, në kontekstin e mësipërm, çdo ankesë, duhet të shqyrtohet në mbështetje të nenit 31 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe nenit 6.1 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, gjë që, në rastin konkret, është vepruar në kundërshtim me atë që u theksua më lartë.

2. Nga sa u theksua, është e qartë se, në rastin konkret civil - juridik, nga gjykata e instancës më të ulët, nuk është vepruar në pajtim me dispozitat e sipër cituara ligjore. Kur jemi këtu, duhet pasur parasysh faktin se Gjykata Supreme e Kosovës, përkitazi, me çështjen e sipër cekur dhe në kontekstin e mësipërm, veç tjerash, edhe sipas nenit 215 të LPK-së, ka për detyrë që lidhur me përfaqësimin e rregullt të palës të kujdeset sipas detyrës zyrtare, që tani për tani, sipas ligjit, nuk mund të konstatohet se pala paditëse është përfaqësuar në mënyrë të rregullt.
3. Prandaj, nga arsytet e sipër përmendura, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të bazuara thëniet e revizionit, që kanë të bëjnë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.
4. Në rivendosje gjykata e shkallës së dytë duhet ti evitojë shkeljet e sipër përmendura, të vendos përkitazi me ankesën e palës paditëse, ti vlerësojë të gjitha thëniet ankimore, si dhe faktet me rëndësi relevante, për gjykimin e kësaj çështje juridike dhe më pas të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.
5. Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 223.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.316/2024, i datës 29.07.2024

”Gjykata Supreme e Kosovës, ka pranuar revizionin e palës së paditur dhe ka prishur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe atë të gjykatës së shkallës së parë, dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim, në gjykatën e shkallës së parë. Kështu, sepse, veç tjerash, në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, (si pjesa kryesore, qendrore e aktgjykimit) vendoset për kompensimin e pronës së paluajtshme të paditësve, mirëpo, në të, nuk identifikon, nuk specifikon fare individualisht ngastrat përkatëse kadastrale kontestuese, numrin kadastral të tyre, certifikatën pronësore, vendin e quajtur, sipërfaqet kulturën, klasën dhe të dhënat tjera, me të cilat ka të bëjë çështja kontestuese, ndaj, parashtrohet pyetja se për cilat ngastra është caktuar kompensimi, etj, si dhe për shkak të shkeljeve tjera përkatëse të dispozitave të LPK-së, të theksuara veçanërisht në arsyetimin e aktvendimit të saj, ka vendosur si më lartë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.171/21 datë 13.05.2024 është refuzuar si e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Podujevës, dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë C.nr.559/2012 datë 7.12.2020, me të cilin, miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve dhe detyrohet e paditura, që paditësve, t’ia kompensoi dëmin gjegjësisht kompensimin e pronës të marrë për nevoja të ndërtimit të rrugës në fshatin Dobërdol, Komuna e Podujevës dhe atë: - Në emër të pronës së pa shpronësuar - pa kompensuar shumën prej 16,992.00 euro, - Në emër të dëmeve të shkaktuara në drunjë frutor dhe pyjor shumën prej 4,710.00 euro, gjithsejtë në shumë prej 21,702.00 euro. Detyrohet e paditura, që shumën e aprovuar t’iu paguajë paditësve me kamatë ligjore siç paguajnë bankat afariste të Kosovës, për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar ti llogaritet nga data e nxjerrjes së aktgjykimit dt.7.12.2020, e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet procedurale kontestimore në shumën prej 2,172.40 euro, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përbarimit me dhunë.
2. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë ka paraqitur revizion e paditura për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe

zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni, të ndryshohen aktgjykimet e kontestuara apo të njëjtit të prishen, dhe lënda të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

3. Pas shqyrtimit të aktgjykimet të goditur sipas nenit 215 të LPK-së, pretendimeve të revizionit dhe shkresave të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se: Revizioni i të paditurës është i themeltë.

4. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, më dt.31.12.2012, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Podujevës, për shkak të kompensimit të dëmit, me të dhënat si në petitumin e padisë, përkatësisht, si në precizimin e padisë. Gjykata e shkallës së parë, ka bërë dëgjimin e dëshmitarit Sh.L., i cili në atë kohë ka qenë Menaxher i projektit, në cilësinë e punëtorit të autorizuar pranë të paditurës, i cili veç tjerash, ka deklaruar” se sa mbaj në mend në vitin 2007 është përfunduar ndërtimi i rrugës, mirëpo data e saktë përfundimit të saj ka theksuar se nuk i kujtohet, ndërtimi i saj është bërë në bashkëpunim me komunitetin të cilët kanë participuar edhe me mjete monetare, KFORI, dhe Komuna e Podujevës, gjatë punimeve në ndërtimin dhe asfaltimin e kësaj rruge nuk kemi pasur pengesa nga banorët apo pronarët e paluajtshmërive. Sa më kujtohet Komuna asnjëherë nuk ka bërë shpronësimin e pronave gjatë ndërtimit të rrugëve në gjithë territorin e Komunës, në këtë rast edhe ndërtimin e kësaj rruge.” Por, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se këtij dëshmitari nuk i fali besimin, nga se kjo ishte në kundërshtim me provat tjera, si Kontrata për asfaltimin e rrugës në fshatin Dobërdol dt. 27.11.2007 dhe Raportin e pranimit teknik për punët e kryera dt.12.03.2009, e që si rrjedhojë e kësaj, i bie që punimet në ndërtimin e asfaltimit të rrugës e cila ka kaluar nëpër ngastrat kontestuese (si në ekspertizën e gjeodezisë), kanë filluar pas nënshkrimit të kontratës ndërmjet të paditurës dhe punë kryesit KNPSH “Papenburg + Adriani“ dt. 27.11.2007 dhe kanë përfunduar më dt.12.03.2009 kur është bërë pranimi teknik i punimeve nga komisioni i të paditurës, ku dëshmitari i sipër cekur, ka qenë në cilësinë e anëtarit të komisionit. Me që sipërfaqja e ngastrave kontestuese, të cilat kanë qenë të prekura me rastin e ndërtimit të rrugës, ishte e pa përcaktuar, gjykata e shkallës së parë, ka caktuar ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë Xh.F., të bërë me shkrim më dt.15.07.2020, i cili në të, kishte deklaruar se ngastrat kadastrale nr.495-1, 495-2, 497-0, 496-0, 918

-0 dhe 916-0, (të paditësve, në të cilat është ndërrhyrë gjatë ndërtimit - asfaltimit të rrugës, si në ekspertizë dhe skicën e matjes), kanë sipërfaqe prej 1062 m², e cila, sipas saj, u është marrë atyre nga e paditura,(pa u zhvilluar më parë procedura e ekspropriimit), më pas, lidhur me këtë sipërfaqe, ka nxjerrë ekspertizën me shkrim të dt.9.08.2020 të ekspertit për vlerësimin e paluajtshmërisë, S.B., i cili ka dhënë vlerësimin për sipërfaqen e paluajtshmërive prej 1062 m² dhe për vlerën e drurëve frutor dhe pyjor, në shumë prej 16,992.00 euro, përkatësisht, në shumë prej 4,710.00 euro, krejt në shumë prej 21,702.00 euro.

5. Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, prandaj, në bazë të nenit 154, nenit 158 të LMD-së, nenit 13 të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ekspropriimin (G.Z nr.46 22 nëntor 1986), etj, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të sajë.
6. Në procedurën ankimore gjykata e shkallës së dytë në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ndaj, ka refuzuar ankesën e të paditurës, ndërsa, e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të sajë.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës aktualisht nuk mund të pranojë një përfundim të tillë juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimet e cekura janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) dhe nenit 182.1 lidhur me nenin 8 të LPK-së, ndërsa, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë me shkelje nga neni 182.1 lidhur me nenin 204, përkatësisht neni 214.1 pika b) të LPK-së dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, e që për pasojë, gjendja faktike ka mbetur pa u vërtetuar në mënyrë të plotë dhe për këtë arsye nuk ka kushte për ndryshimin e tyre, prandaj, për këtë shkak të dy aktgjykimet u dashtë të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim.
2. Sipas dispozitës së nenit 204 të LPK-së, parashihet se në arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht të aktvendimit, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësishme vendimtare për dhënien e vendimit të saj. Sipas

vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së dytë nuk i ka vlerësuar plotësisht thëniet ankimore në kuptim të dispozitës së përmendur.

3. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore konsistojnë në atë se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten, ka kundërthënë midis dispozitivit dhe arsytimit, arsytimi i aktgjykimit nuk përmban arsyet për faktet relevante për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, arsyet e paraqitura janë të pa qarta dhe kontradiktore. Po kështu, nuk ka një analizë të provave të zhvilluara nga gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ato nuk janë vënë në relacion krahasues dhe vlerësues, veç e veç e së bashku.
4. Kështu, veç tjerash, sikundër u theksua më lartë, shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se gjykata e shkallës së parë (me çka pajtohet edhe gjykata e shkallës së dytë), në dispozitivin e aktgjykimit të saj, (si pjesa kryesore, qendrore e aktgjykimit), vendos për kompensimin e pronës së paditësve, mirëpo, në të, nuk identifikon, nuk specifikon fare individualisht ngastrat përkatëse kadastrale kontestuese, numrin kadastral të tyre, certifikatën pronësore, vendin e quajtur, sipërfaqet, kulturën, klasën dhe të dhënat tjera, me të cilat ka të bëjë çështja kontestuese, ndaj, parashtrohet pyetja se për cilat ngastrat (paluajtshmëri) është caktuar kompensimi.
5. Gjithashtu, në kontekst të kësaj çështjeje juridike kontestuese, rezulton se nuk janë dhënë arsyet e plota, të sakta dhe ligjore lidhur me faktet vendimtare, kështu, nuk ka deklaram të gjykatës së instancës më të ulët përkitazi me çështjen se në kohën e ndërtimit - asfaltimit të rrugës në fshatin Dobërdol, Komuna e Podujevës, në pjesët kontestuese të ngastrave kadastrale të lartë cekura, a ka pas apo jo pemë të kultivuara, prej kur janë kultivuar, numri dhe lloji i tyre, sikundër që, (në rast të caktimit të kompensimit), nuk ka as krahasim të kontratave të shitblerjes në zonën e paluajtshmërive kontestuese ose të përafërt, të vërtetuara në organin kompetent shtetëror, (me çmimin e caktuar nga eksperti i vlerësimit), pastaj, lidhur me çështjen e participimit të komunitetit - fshatit për asfaltimin e rrugës, a kanë participuar edhe paditësit, a kanë qenë edhe paditësit të pajtimit për asfaltimin e rrugës, a ka pasur edhe pëlqim të tyre a po jo, a ka ekzistuar kjo rrugë edhe më parë, a kemi të bëjmë

me eksproprijim apo jo, kur saktë paditësit kanë marrë dënim për asfaltimin e rrugës, etj, pastaj, varësisht nga përfundimi i drejt dhe ligjor, duhet të ketë apo jo kompensim përkatës, etj. Përkitazi me këto fakte relevante, gjykata e shkallës më të ulët, nuk ka dhënë përgjigje të duhura dhe të mjaftueshme, dhe në këtë kontekst, pra, të administrimit të provave, duhet theksuar se, e njëjta, nuk ka zhvilluar edhe provat me dëgjimin e dëshmitarëve të tjerë të propozuar gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore dhe nuk ka bërë administrimin e provës me këqyrjen në vend, (dhe këtë e bën gjykata përkatëse, neni 326 i LPK-së, dhe jo eksperti i gjeodezisë), krejt këto me qëllim të vërtetimit të plotë, të saktë dhe të drejtë të fakteve relevante lidhur me rastin konkret civil.

6. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të bazuara thëniet e revizionit, që kanë të bëjnë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 pika (n), në lidhje edhe me nenin 204, respektivisht nenit 214.1 p.b) të LPK-së dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 i LPK-së.
7. Në rigjykim gjykata e shkallës së parë është e detyruar të mënjanojë të metat e lartcekura, jo vetëm lidhur me dispozitivin e aktgjykimit të goditur, por, t'i zhvillojë dhe vlerësojë edhe të gjitha provat e nevojshme, duke i vënë ato në relacion krahasues, veç e veç dhe së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me qëllim që të vërtetojë të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, në atë kontekst, sipas nevojës, nga eksperti për vlerësimin e paluajtshmërisë, të kërkohet të plotësojë mendimin dhe konstatimin e tij, (ose ekspertizë e re, në rast të nevojës për vendosjen e çështjes) me qëllim të vërtetimit të saktë, të plotë, të drejtë dhe reale të vlerës së tregut të paluajtshmërisë lëndore dhe lartësisë së dëmit eventual, duke marr për bazë edhe çështjet e ngritura më lartë, si dhe duke pasur parasysh edhe thëniet tjera në revizion, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.
8. Në bazë të asaj që u theksua e në mbështetje të dispozitës së nenit 224.2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendim i kolegjit Civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.339/23, i datës 29.11.2023

”Vendimet e gjykatës në secilin rast që i referohen shpifjes apo fyerjes, duhet të jenë në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e assesi përmes këtyre vendimeve të krijohet klima e frikës apo presionit të cenimit apo kufizimit të lirisë së shprehjes në raport me gazetarët, për arsye se kjo bie në kundërshtim me praktikën e GJEDNJ-së.

Gjykata në secilin rast të gjykimit në raport me shpifjen apo fyerjen duhet të balancojë që në njërin anë të kujdeset që të mbrohet dinjteti dhe personaliteti i individit, që gazetarët dhe të gjithë personat tjerë që ushtrojnë veprimtari mediale të veprojnë në kuadër të kornizës ligjore dhe akteve nënligjore duke respektuar në maksimum kodin e etikës gazetareske, mirëpo në anën tjetër duhet të ketë në konsideratë interesin publik për figura publike, nevojën e informimit dhe lirisë së shprehjes në atë mënyrë që asnjë vendim të mos ndikoj në cenimin e funksionimit të lirisë së shprehjes si një e drejtë po ashtu e garantuar me Konventë.

Vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rekomandojnë që lehtësisht në një masë mund të tejkalohet liria e shprehjes edhe në dëm të individit (personaliteti publik), por kjo duhet të përbën me të vërtetë interes publik, pra nevojën që publiku të informohet, por duhet me qenë të qartë që kjo assesi nuk nënkupton cenim dhe degradim të rëndë të personalitetit“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.627/2014 të datës 06.05.2019, është vendosur: Miratohet pjesërisht kërkesëpadia e paditëses M. S. nga P.. Detyrohet e paditura NGB “K. S.”, në P., me pronar R. K. dhe kryeredaktore M. K., në mënyrë solidare paditëses M. S. nga P., t’ia paguajnë dëmin jomaterial për shpifje dhe fyerje të bëra nga data 13.04.2010 e deri në vitin 2016, ashtu që për shpifje të paguajnë shumën 200,000 €, ndërsa për fyerje 50,000 €, të gjitha këto me kamatë si për mjetet e deponuara nëpër bankat private mbi një vit pa destinim të caktuar nga data 13.04.2010 e deri në pagimin definitiv, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme 3,572 €, të gjitha këto brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e miratuar e në lartësi deri në 700,000 €, refuzohet si e papabuar.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5765/19, të datës 03.05.2023, është vendosur: I. Aprovohet pjesërisht ankesa e të paditurës NGB “K. S.”, me seli në P., me pronar R. K. dhe M. K. kryeredaktore, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.627/2014 i datës 06.05.2019, ashtu që çështja gjykohet si vijon: Vërtetohet se e paditura NGB “K. S.”, me seli në P. përmes publikimit të artikujve gazetaresk, me përmbajtje të pavërteta - shpifëse dhe fyese, në të përditshmen “K. S.”, gjatë periudhës prej datës 13.04.2010 e deri në vitin 2016, ka shpifur për integritetin dhe fyer personalitetin e paditëses M. S. nga P.. II. Detyrohet e paditura NGB “K. S.”, me seli në P., me pronar R. K. dhe kryeredaktore M. K., që në emër të kompensimit të dëmit jomaterial, për vuajtjet e përjetuara nga shpifjet dhe fyerjet e bëra, paditëses M. S., solidarisht, t’ia kompensojnë shumën prej 18,000 €, me kamatën e cila do të llogaritet si për lartësinë për deponimet që aplikojnë bankat vendore të afatizuara për periudhë një vjeçare pa destinim të caktuar nga data 06.05.2019 e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës kontesimore në lartësi të shumës prej 3,572.40 €, ndërsa refuzohet si e pabazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses përtej shumave të gjykuara e deri në shumat e kërkuara.
3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësja, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, ta aprovojë revizionin si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ac.nr.5765/19 të datës 03.05.2023, ta ndryshojë dhe ta lë në fuqi aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.627/2014 të datës 06.05.2019.
4. Përgjigje në revizion nuk ka pasur.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215, sipas detyrës zyrtare vlerësojë se:

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës dytë dhe të parë, duhet të prishen dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja M. S. nga P., më datë 18.06.2010, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitë padi, kundër të paditurës, I. R. C. G. “K. S.”, në P., te Zona Industriale, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit jomaterial në emër të shpifjes dhe fyerjes, duke kërkuar shumat e specifikuara më saktësisht si në precizimin e padisë.
7. Më datë 05.12.2012, paditësja M. S. nga P., ka ushtruar padi kundër të paditurës I. R. C. G. “K. S.”, në P., te Zona Industriale, me pronar R. K. dhe Kryeredaktore M. K. nga P., me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit jomaterial në emër të shpifjes dhe fyerjes, për gjatë viteve 2011 dhe 2012, duke kërkuar shumat e specifikuara më saktësisht si në precizimin e padisë.
8. Gjykata Themelore në Prizren, me aktvendimin C.nr.627/14 të datës 23.02.2018, ka nxjerr aktvendim më të cilin ka bërë bashkimin e lëndëve C.nr.1370/10 dhe C.nr.3172/12, e cila është evidentuar me numër C.nr.627/14.
9. Më datë 04.03.2019, paditësja ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar më saktësisht si në parashtrësën për precizimin e padisë.
10. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditëses kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.627/2014 të datë 06.05.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.
11. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka administruar këto provave: shikimin në gazetën ditore “K. S.”, në artikujt e datave 13 - 22 prill 2010, 20 qershor 2011, 21 qershor 2011, 9 shtator 2011, 21 janar 2012, 19 prill 2012, 23 prill 2012, 3 maj 2012, 5 maj 2012, 22 maj 2012, 11 qershor 2012, 12 qershor 2012, 15 qershor 2012, 20 qershor 2012, 26 qershor 2012, 17 korrik 2012, 19 korrik 2012, 19 korrik 2012, 20 korrik 2012, 04 gusht 2012, 10 gusht 2012, 24 gusht 2012, 27 gusht 2012, 28 gusht 2012, 30 gusht 2012, 25 shtator 2012, 28 shtator 2012, 12 tetor 2012, 15 tetor 2012, 18 tetor 2012, 30 tetor 2012, 29 tetor 2012, 10 nëntor 2012, 12 nëntor 2012, 26 tetor 2012 dhe 26 nëntor 2012, 09

maj 2014, 20 maj 2014, 24 prill 2015, 27 prill 2015, 11 gusht 2015, 24 gusht 2015, 25 gusht 2015, 14 mars 2016 dhe 27 mars 2017, vendimin e Këshillit të Mediave të shkruara Ref. të datës 03 qershor 2010, kërkesën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 10 qershor 2010, aktvendim HP.nr.145/2010 të datës 01.09.2010, aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ka.nr.184/2010 të datës 28.04.2010, kontratën e lizingut financiar për paluajtshmeri nr. Agr - ... e lidhur më datë 29.08.2011, ekspertizën mjeko ligjore psikiatrike të datës 15.09.2018 dhe ekspertizën mjeko - ligjore psikologjike, të datës 26.10.2018.

12. Ka shtuar se sa i përket shumës se miratuar nga ana e gjykatës dhe atë për shpifje shumën 200,000 € dhe për fyerje shumën 50,000 €, vendosi pasi që vlerësoi se dëmi jomaterial është shkaktuar nga ana e të paditurës duke vlerësuar se dhimbjet shpirtërore të përjetuara nga shkrimet në vazhdimësi që nga viti 2010 e deri në vitin 2016, duke vazhduar edhe pas vitit 2016, kanë qenë të tilla sa që kanë cenuar rëndë integritetin dhe autoritetin e paditëses. Cenimi i integritetit dhe autoritetit ka qenë i tillë sa që ka shkaktuar tronditje psiko-emocionale, e cila tronditje ka shkaktuar ndryshime në rrjedhjen normale të jetës së paditëses deri në atë masë sa që te paditësja herë pas here janë shfaqur mendime suicidale, pasi që të gjitha akuzat dhe shkrimet janë bërë përmes medimeve publike që ka pasur shtrirje të gjerë në publik.
13. Sa i përket shumës 50,000 € për fyerje, ka vendosur për këtë shumë, duke pasur për bazë që pala e paditur nuk ka hedhur poshtë informacionet kundër paditëses, edhe pse me vendimin e Këshillit të Mediave të shkruara Ref. të datës 03 Qershor 2010, ka qenë e detyruar ta bëjë. Si dhe në vazhdimësi për vite të tëra ka përsëritur informacionet fyese dhe atë përmes mediumit publik. Gjykata gjatë gjykimit të shumës së dëmtshpërblimit për shpifje kundër të paditurës, ka vlerësuar edhe qëndrimin e Gjykatës për të Drejtat e Njeriut, sa i përket proporcionalitet në mes shumës së miratuar në lidhje me dëmtimin e shkaktuar ndaj reputacionit të paditëses duke ardhur në përfundim që shuma e miratuar është e drejtë.
14. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 154, 184, 200, të LMD-së, nenit 5, 14, dhe 15 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, nenit 8 dhe 10 të Konventës Evropiane për Lirit dhe të

Drejtat e Njeriut, dhe nenit 323 të LPK-së. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 452 të LPK-së.

15. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.5765/19, të datës 03.05.2023, ka vendosur që të aprovojë pjesërisht ankesën e të paditurës dhe ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.
16. Në arsyetim të aktgjykimit Gjykata e Apelit ka theksuar se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadiisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare, për të cilat shkaqe aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

2. Me nenin 215 të LPK-së, përcaktohet se: “Gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur vetëm në pjesën e tij të goditur me revizion dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësim të rregullt”.
3. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika k) e lidhur me nenin 73 dhe 76 të LPK-së, për faktin se gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar duke iu referuar gjendjes së theksuar më lartë nuk ka verifikuar identitetin e palëve në procedurë, në kuptimin procedural - cilësinë e palës së paditur, në fakt përveç të dhënave në padi të theksuara nga i autorizuari i paditëses, në shkresat e lëndës nuk ka prova të verifikuara lidhur me identitetin e palëve - gjegjësisht nuk ka të dhëna të pa kontestuara se pala e paditur NGB “K. S.”, në P., me pronar R. K. dhe kryeredaktoren M. K. dhe I. R. C. G. “K. S.”, në P., te Zona Industriale, me pronar R. K. dhe Kryeredaktoren M. K. nga P., në kohën kur pretendohet se është krijuar raporti juridik (kur pretendohet se ka ndodhur shpifja dhe fyerja) a kanë qenë si një subjekt juridik apo dy subjekte të ndara, nëse kanë qenë si subjekt i vetëm juridik kur janë ndarë dhe çfarë ka ndodhur me të drejtat dhe detyrimet e këtij subjekti. Po ashtu në shkresat e lëndës ekziston certifikata e regjistrimit me numër të biznesit dhe numër fiskal e datës 11.03.2019, nga e cila rezulton se NGB “K.S.” SH.P.K., është asgjësuar/shuar në mënyrë vullnetare, mirëpo e njëjta me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është përfshirë si palë e paditur. Ndërsa gjykata gjatë tërë procedurës duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedurale, nëse palën pa zotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizimin e veçantë kur ai është i nevojshëm siç përcaktohet me nenin 76 të LPK-së.
4. Në këtë rast nga provat prezentë në lëndë nuk mund të konstatohet në mënyrë të qartë se e paditura NGB “K. S.”, në P., me pronar R. K. dhe kryeredaktoren M. K. dhe I. R. C. G. “K.S.”, në P., te Zona Industriale, me pronar R. K. dhe Kryeredaktoren M. K. nga P., është i njëjti subjekt juridik, apo kanë qenë dy subjekte të pavarura nga njëra - tjetra. Po ashtu në këtë rast nga provat prezentë në lëndë nuk mund të konstatohet në mënyrë të qartë se e paditura NGB “K. S.”, në P., me pronar R. K. dhe kryeredaktoren M. K.,

gjatë zhvillimit të procedurë në gjykatën e shkallës së parë ka ekzistuar si palë-subjekt juridik, siç u theksuar me lartë.

5. Me padi të precizuar si në parashtrësit për precizimin e padisë, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë, nuk është përfshirë si palë e paditur pronari dhe kryeredaktorja e saj, e nga përmbajtja e aktgjykimit të shkallës së parë dhe të dytë nuk mund të kuptohet se a kemi një të paditur apo tre të paditur, a janë të paditur NGB “K. S.”, në P., apo janë të paditur edhe pronari dhe kryeredaktorja e saj.
6. Gjykata e shkallës së parë dhe të dytë në dispozitiv të aktgjykimit, e kanë detyruar të paditurit në kompensimi e dëmit në mënyrë solidare, mirëpo nuk ka dhënë arsye se në rastin konkret përgjegjësia e të paditurve a mundet me qenë solidare, sepse sipas vlerësimit të Gjykatës së Supreme të Kosovës, këtu përgjegjësia nuk mundet me qenë solidare, pasi veprimet duhet të jenë të individualizuara, dhe shkalla e përgjegjësive nuk mundet me qenë e njëjtë, andaj edhe kompensimi duhet me qenë i individualizuar sikurse veprimi i tyre. Përveç kësaj pronari dhe kryeredaktorja në këtë rast me padi të precizuar si në parashtrësit për precizimin e padisë, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk janë të përfshirë si palë e paditur.
7. Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, 182 paragrafi 2 pika k) e lidhur me nenin 73 dhe 76 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara.
8. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë. Në këtë kontekst Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se sipas Ligjit Civil Kundër

Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se ligji në fjalë interpretohet në mënyrë e cila siguron se aplikimi i dispozitave të tij, maksimalizon parimin e lirisë së shprehjes dhe do të jetë në pajtim me Kushtetutën si dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, siç zbatohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Vendimi në fjalë duhet të jetë në përputhje të plotë me frymën e vendimeve/praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me seli në Strasburg, sipas të cilës praktikë gjykatat vendore në çdo rast që kanë të bëjë me mediat, në raport me shpifjet apo fyerjet e pretenduara, kërkon kujdes maksimal të shqyrtimit para vendosjes, për arsye se kundër efekti i masave në raport me mediat nënkupton cenimin e frymës së lirisë së shprehjes dhe operimit të tyre.

9. Për caktimin e lartësisë së kompensimit gjykata e shkallës së parë ka caktuar ekspertizë nga lëmia e psikiatrisë dhe psikologjisë për të përcaktuar dhimbjet psikike që i ka pësuar paditësja si pasojë e shpifjes dhe fyerjes, mirëpo në këtë rast por edhe në raste të ngjashme gjykata ka në diskrecionin e saj autorizimin të vendos në bazë të njohurive dhe përvojës që ka duke marrë për bazë të gjitha rrethanat dhe atë: mënyrën e kryerjes së shpifjes apo fyerjes, pastaj veprimet e ndërmarrura nga pala e paditur me qëllim të zvogëlimit të dëmit, demanti apo tërheqja e informacionit nëse është bërë, kërkim falja nëse është shprehur, të ardhurat e personave që pretendohet se kanë kryer veprën e shpifjes, dhe krejt në fund të ketë kujdes që kompensimi më tepër duhet me qenë satisfacion moral.
10. Vendimet e gjykatës në secilin rast që i referohen shpifjes apo fyerjes, duhet të jetë në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e assesi përmes këtyre vendimeve të krijohet klima e frikës apo presionit të cenimit apo kufizimit të lirisë së shprehjes në raport me gazetarët, për arsye se kjo bie në kundërshtim me praktikën e GJEDNJ-së.
11. Me nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “ Për shpifjen ose fyerjen e kryer përmes subjekteve mediale, personat që vijojnë janë bashkëpërgjegjës ose përgjegjës individual: autori, redaktori, ose publikuesi apo dikush që ndryshe nga ata ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen e saj ”.

12. Në këtë kontekst fakti që duhet të merren parasysh të hyrat financiare të paditurve me rastin e caktimit të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga shpifja apo fyerja, vërteton faktin se përgjegjësia nuk mundet me qenë solidare, por individuale, edhe pse personat e theksuar në nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, mundën me qenë bashkëkryes, mirëpo nuk mund të kenë përgjegjësi solidare.

13. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk kanë arsyetuar lartësisë e kompensimit në raport me secilin të paditur, pra sa kanë qenë të hyrat e gazetës, pastaj kompensimi a është adekuat, por jo të arsyetohet në raport me lartësinë vetëm duke iu referuar njëres të paditur, kur kemi më shumë se një të paditur. Asnjë arsyetim nuk është dhënë në raport me lartësinë e kompensimit për pronarin dhe kryeredaktoren, sa kanë qenë të hyrat e tyre në kohën e shkrimit, lartësia me të njëjtin a është adekuate, si do të mund të ndikon lartësia e të njëjtit në cenimin apo kufizimin e lirisë së shprehjes, interesit publik të informimit nga ana e gazetarëve, dhe se vet konstatimi se ka pasur shpifje apo fyerje dhe një kompensim më tepër moral a do të mund të arrinte efektin e synuar dhe a është në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së.

14. Gjykata në secilin rast të gjykimit në raport me shpifjen apo fyerjen duhet të balancojë që në njërën anë të kujdeset që të mbrohet dinjiteti dhe personaliteti i individit, që gazetarët dhe të gjithë personat tjerë që ushtrojnë veprimtari mediale të veprojnë në kuadër të kornizës ligjore dhe akteve nënligjore duke respektuar në maksimum kodin e etikës gazetareske, mirëpo në anën tjetër duhet të ketë në konsideratë interesin publik për figura publike, nevojën e informimit dhe lirisë së shprehjes në atë mënyrë që asnjë vendim të mos ndikoj në cenimin e funksionimit të lirisë së shprehjes si një e drejtë po ashtu e garantuar me Konventë. Në rastet që i referohen mbrojtjes së personalitetit/dinjitetit të individit dhe lirisë së shprehjes, në një masë të caktuar vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rekomandojnë që lehtësisht në një masë mund të tejkalohet liria e shprehjes edhe në dëm të individit (personaliteti publik), por kjo duhet të përbën me të vërtetë interes publik, pra nevojën që publiku të informohet, por duhet me qenë të qartë që kjo assesi nuk nënkupton cenim dhe degradim të rëndë të personalitetit.

15. Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që

fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, duke vlerësuar të gjitha kushtet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit (për gjykatën, për palët, për objektin e kontestit dhe për padinë) dhe nëse konstaton se plotësohen kushtet për zhvillimin e shqyrtimit të caktojë seancën përgatitore apo drejtpërdrejtë të shqyrtimit kryesor (varësisht nga vlerësimi i gjykatës për nevojën e seancës përgatitore) t'i administrojë provat e nevojshme për vërtetimin e fakteve vendimtare, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditëses. Me rastin e vendosjes meritore, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitoje shkeljet procedurale të konstatuara si me lart nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

16. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 224 paragraf 2, e lidhur me nenin 215 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.448/23, i datës 06.11.2023

”E drejta e pronësisë është e drejtë subjektive e karakterit absolut dhe se për sendet e paluajtshme të cilat janë të regjistruara në librat kadastrale, vlen supozimi se sendi është në pronësi të personit në emër të cilit është e regjistruar, mirëpo edhe nëse paluajtshmëria nuk është e regjistruar në emër të atij, që kërkon pronësinë, në këtë rast paditësi ka pasur detyrim ta provoi pronësinë e tij, por edhe të paraardhësit të tij, deri sa mos të gjendet personi i cili pronësinë e ka fituar në ndonjërin prej mënyrave origjinare si mënyra të fitimit të pronësisë, dhe këto fakte në këtë rast, i ka provuar paditësja e jo i padituri“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.218/08 të datës 22.05.2009, është vendosur: Aprovohet kërkesëpadia e paditëses Ndërmarrja Publike Banesore në P., dhe detyrohet i padituri H. S. nga I., tani me vendbanim në P. Lagjja “D.”, ..., H. ... nr...., që ta liroj nga njerëzit dhe sendet banesën e cila gjendet në P., në Lagjen “D.”, ..., H. ... nr...., në sipërfaqe prej 57,07 m², dhe të njëjtën t’ia dorëzoj paditëses në posedim dhe shfrytëzim në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kanosjen e përmbarimit me dhunë. Me të njëjtin aktgjykim është vendosur që se cila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.
2. Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin Ac.nr.5280/2012, të datës 06.03.2015, ka vendosur që të: Refuzohet e pabazuar ankesa e të paditurit H. S. nga I., tani me vendbanim në P., Lagjja “D.”, ..., H. ... nr...., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.218/08 i datës 22.05.2009, vërtetohet.
3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizionin i padituri, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të pranojë si të bazuar revizionin, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, ta prish dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
4. Përgjigje në revizion nuk ka pasur.

5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurit është i pabazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, më datë 30.01.2008, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit, për lirimin dhe dorëzimin e banesës, duke kërkuar me saktësisht si në kërkesëpadi.
7. Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.218/08 të datës 22.05.2009, duke vendosur me decidivisht, si në dispozitivin të aktgjykimit.
8. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjenden faktike administroi këto prova: kontratën mbi ndërtimin e vitit 1985, vendimin e sekretariatit për urbanizëm... nr. ... të datës 22.04.1992, ftesën e datës 27.11.2003, vërejtjen me nr. të datës 10.12.2007, vendimin ...nr.... të datës 06.06.1985, shkresën drejtuar AKP-së, ...nr.... të datës 17.12.2007, dhe vërtetimin me nr. ... të datës 10.07.2000. Ka shtuar se nga kontrata për ndërtim nr., rezulton se me datë 28.06.1985, investitori, BVI-ja, për banesa dhe lokal afarist ka lidhur kontratë me kombinatin ndërtimor industrial “Ramiz Sadiku”, në P., për ndërtimin e objektit banesor afarist në bazë të dokumentacionit teknik dhe pëlqimit për ndërtimin e këtij objekti të dhënë nga sekretariati për urbanizëm me nr. ... të datës 06.06.1985. Nga aktvendimi i Sekretariatit për Urbanizëm dhe Lokale Afariste i Komunës së P., i datës 22.04.1992, rezulton se është caktuar komisioni profesional për kontrollim teknik të objekteve në Bllokun ..., që gjenden në lagjen “D.”. Nga aktvendimi i Sekretariatit për Urbanizëm dhe Lokale Afariste të Komunës së P., .. nr.... i datës 06.06.1985, rezulton se investitorit, BVI-së, së banimit dhe lokaleve afariste në P.(këtu paditëses), i është dhënë pëlqimi për ndërtimin e objekteve në Bll. dhe SU ..., e disa tjera objekteve që gjenden në lagjen “D.”, në P..

9. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 20 dhe 72 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 452 të LPK-së.
10. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i padituri ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.5280/2012, të datës 06.03.2015, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e të paditurit, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.
11. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se nisur nga një gjendje e tillë e çështjes. Gjykata e Apelit vlerëson se, thëniet ankimore të paditurit lidhur me atë se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, janë të pa bazuara, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar drejt dhe plotësisht faktet të cilët kanë qenë me rëndësi për të vërtetuar se paditësja e gëzon të drejtën e pronësisë në banesat kontestuese, ndërsa i padituri tash është në posedim jo ligjor të banesës kontestuese. E drejta e pronësisë në banesën kontestuese, paditëses i jep autorizim ligjor që të kërkojë rikthimin në posedim nga i padituri si posedues jo ligjor. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë i ka zbatuar dispozitat nga neni 72 paragrafi 1 dhe 2, si dhe nenin 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Pronësore Juridike Bazë (i cili ka qenë i zbatueshëm në kohën e paraqitjes së padisë në gjykatën e shkallës së parë), kur të paditurin si posedues jo ligjor, e ka detyruar që paditëses si pronare jo poseduese t'ia dorëzojë në posedim dhe shfrytëzim banesën kontestuese.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. I padituri në revizionin e paraqitur nuk i është referuar si bazë për parashtrimin e revizionit shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, prandaj Gjykata Supreme sa i përket kësaj baze është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së, me ç’ rast ka gjetur se aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt.
3. Pretendimet e paraqitura në revizion se paditësja nuk ka mundur të jetë palë në këtë rast dhe se të njëjtës i mungon legjitimiteti aktiv sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara, për arsye se paditësja në këtë rast e ka cilësinë e palës siç përcaktohet me nenin 73 të LPK-së, dhe se ka legjitimitet në kuptimin materialo - juridik, sepse me provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë dhe nga vet deklarimet e të paditurit gjatë shqyrtimit kryesor dhe kundërshtimeve të paraqitura në revizion pa mëdyshje është vërtetuar se i padituri është posedues me keqbesim dhe shfrytëzues i banesës që është objekt kontesti në këtë rast dhe se i njëjti ka refuzuar t’ia dorëzoi në posedim dhe shfrytëzim pronarit - këtu paditëses.
4. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

Me nenin 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, përcaktohet se: “E drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi si dhe në bazë të vendimit të organit shtetërorë në kushte dhe mënyrën e caktuar me ligj”, ndërsa me nenin 37 paragraf 1 dhe 2 të këtij ligji, përcaktohet se: “pronari mund të kërkojë në padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale, mirëpo pronari duhet të pranoi se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronës dhe se sendi gjendet nën zotërimin faktik të paditurit”.

5. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme, qëndrimin juridik nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, e pranon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se e drejta e pronësisë është e drejtë subjektive e karakterit absolut dhe se për sendet e paluajtshme të cilat janë të regjistruara në librat kadastrale, vlen supozimi se

sendi është në pronësi të personit në emër të cilit është e regjistruar, mirëpo edhe nëse paluajtshmëria nuk është e regjistruar në emër të atij, që kërkon pronësinë, në këtë rast paditësi ka pasur detyrim ta provoi pronësinë e tij, por edhe të paraardhësit të tij, deri sa mos të gjendet personi i cili pronësinë e ka fituar në ndonjërin prej mënyrave origjinare si mënyra të fitimit të pronësisë, dhe këto fakte në këtë rast, i ka provuar paditësja e jo i padituri.

6. Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga i padituri nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2 të LPK-së, përcaktohet se: “Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.
7. Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.
8. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.467/23, i datës 22.01.2024

”Gjykata Supreme vlerëson se nuk mund të gjykohet kompensim në emër të kontributit të dhënë në bashkësinë martesore ose jashtëmartesore për një periudhë të caktuar kohore për rastet kur konstatohet se bashkëshortët gjatë martesës ose bashkësisë jashtëmartesore nuk kanë krijuar fare pasuri të përbashkët. Në këtë rast nuk është vërtetuar që paditësja me të paditurin në bashkësi jashtëmartesore të kenë krijuar pasuri të përbashkët në mënyrë që më pas të krijohet mundësia për të kërkuar pjesëtimin të pasurisë dhe eventualisht edhe kompensimin financiar në emër të kontributit“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 132/17 i datës 04.12.2018, është vendosur: I. Refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditëses V. T. nga F., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri N. T., që të vërtetohet kontributi martesorë për 16 vit, nga viti 19.07.2001 deri më datë 22.01.2017, në shtimin, ruajtjen, krijimin dhe përkujdesjen në pasurinë e përbashkët bashkëshortore ashtu që i padituri të detyrohet t’ia paguajë shumën prej 30.000 €, në llogarinë bankare të paditëses në emër të kontributit gjatë jetës faktike (bashkëjetesës) për 16 vite, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, si e pabazuar. II. Detyrohet paditësja, që të paditurit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,508 €, si dhe kësaj gjykate ti paguaj taksën për padi në shumë prej 75 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3225/2019, të datës 20.07.2023, është vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa e paditëses V. T. nga fshati P., Komuna e Sh., ndërsa aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 132/17 i datës 04.12.2018, vërtetohet.
3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësja, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe

aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni i paditëses të aprovohet si i bazuar ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3225/2019 i datës 20.07.2023, dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr. 132/17 i datës 04.12.2018, të ndryshohen, ashtu që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet si e bazuar, ose aktgjykimet e goditura të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. Përgjigje në revizion nuk ka pasur.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:
Revizioni i paditëses është i pabazuar.
6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, më datë 20.02.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqit padi kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar ndarjen e pasurisë së përbashkët bashkëshortore, më saktësisht si në parashtrësën në fjalën përfundimtare të datës 27.11.2018.
7. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditëses kundër të paditurit, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.132/17 të datës 04.12.2018, me të cilin ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.
8. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen kontestuese ka administruar provat e propozuara dhe atë: ekstraktin e gjendjes civile me nr. serik E të datës 13.02.2017 në emër të D. T., ekstraktin e gjendjes civile me nr.serik E të datës 13.02.2017 në emër të Sh.T., ekstraktin e gjendjes civile me nr.serik E ... të datës 20.02.2017 në emër të E.T., vërtetimin nga Handikos të datës 13.02.2017, shkresa kërkim i thjeshtë nga Zyra Kadastrale F., aktgjykimin e Gjykatës Themelore më Ferizaj C.nr.133/17 të datës 26.02.2018, aktvendimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj T.nr.211/09 të datës 06.10.2009, kontratën për shitblerjen e palujtshëmrisë, të lidhur më

datë 19.10.2010, e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Lipjan me V.nr. ..., shkresën e transaksioneve të llogarisë së të paditurit në T. Banka, shkresën e llogarisë në P.C.B., në emër të paditurit në shkurt të 2017, ekspertizën e datës 30.07.2018 nga eksperti aktuar A. B. (18 fletë), raportin kreditorë i nxjerr pranë BQK, në emër të të paditurit në (5 fletë), lexohen - shiqohen fotot me paketime të veshmbathje të paditëses (4 fletë), plotësimin e ekspertizës të datës 25.10.2018, marrëveshjen kolaterale me garantues në emër të paditurit të datës 28.07.2016, kontratën për kredi në emër të të paditurit të datës 28.07.2016, planin e amortizimit të datës 28.07.2016, marrëveshjen kolaterale me garantuesin të datës 10.04.2017 në emër të të paditurit, deklaratën e shpalosjes së të vërtetës mbi kredinë të datës 15.04.2015, kontratën mbi kredinë të datës 10.04.2015 në emër të të paditurit, planin e amortizimit të datës 10.04.2015, raportet mbi kontrollet mjekësore në emër të paditëses dhe fëmijëve të tyre në (13 fletë).

9. Ka shtuar se nga provat e administruara gjykata konsideron se nuk është kontestuese fakti se paditësja me të paditurin kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore për 16 vite, mirëpo kontestuese në këtë çështje kontestimore ka qenë se paditësja, për gjatë jetës bashkëshortore ka kontribuar në shtimin e pasurisë duke gatuar “flija me pagesë për F. C.”, duke pastruar shtëpinë e vëllait dhe të motrës së të paditurit, të cilën punë paditësja pretendon se e ka bërë me pagesë e që nuk është vërtetuar me asnjë provë një pretendim i tillë. Gjithashtu kontestuese mes palëve ka qenë lartësia e shumës të cilën e ka kërkuar paditësja si kompensim në bazë të kontributit të përbashkët bashkëshortorë. Gjykata me rastin e vendosjes ka marrë parasysh kontributin e paditëses në shtimin e pasurisë lidhur me besueshmërinë e kërkesëpadsisë duke vlerësuar pasurinë e përbashkët bazuar në dispozitat e nenit 54 të LFK-së, ku paditësja me asnjë fakt nuk e vërteton se e njëjta gjatë viteve të bashkësisë jashtëmartesore ka punuar me të ardhura mujore duke ndikuar në shtimin e pasurisë edhe pse nuk i mohohet kontributi i saj në punët tjera të shtëpisë të parapara si në nenin 54 të LFK-së. Ngase pretendimet e paditëses në shtimin e pasurisë nuk qëndrojnë sepse nga administrimi i provave si kontrata për shitblerjen e palujtshëmrisë e lidhur më datë 19.10.2010, e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Lipjan me V.nr. ..., shihet se i padituri me paratë nga shitja e palujtshëmrisë e ka ndërtuar shtëpinë dhe objektet përcjellëse, të cilën paditësja pretendon se me kontributin e saj financiar është ndërtuar shtëpia ku kanë jetuar paditësja me të paditurin. Edhe me dëgjimin e dëshmitarëve nuk është provuar se paditësja ka kontribuar në atë mënyrë që do të ndikonte në shtimin e pasurisë në familjen e paditësit,

gjykata deklaratave të dëshmitarëve ia fali besimin sepse deklaratat nuk ishin kundërthënëse njëra me tjetrën si dhe nuk ishin në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Gjykata ekspertizës së ekspertit të aktuaristikës nuk ja fali besimin për arsye sepse e njëjta është e pabazuar nga fakti se eksperti ka bërë llogaritje të periudhës së jetës së përbashkët, pa marr për bazë faktin se nga kontributi i paditëses dhe të paditurit nuk është vërtetuar se është shtuar pasuria, por të gjitha pretendimet e paditëses në pasurin (objektet) ku kanë bashkëjetuar të njëjtit, është vërtetuar se janë ndërtuar nga shitja e pasurisë së trashëguar si pasuri e veçantë e të paditurit.

10. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 46, 47 dhe 54 të LFK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 të LPK-së.
11. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësja ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.3225/2019, të datës 20.07.2023, ka vendosur që të refuzoj ankesën e paditëses, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.132/17 të datës 04.12.2018, e ka vërtetuar, duke vendosur më decidivisht, si në dispozitiv të aktgjykimit.
12. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se: e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par 2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për Procedurën Kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Pretendimi ankimor i paditësit se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ngase sipas paditësit dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë.
13. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të

dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

14. Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara, për shkak se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.
15. Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.
16. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

Me nenin 47 të Ligjit për Familje të Kosovës, përcaktohet se: (1) Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë; (2) Pasuria e përbashkët mund të përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të detyrimeve; (3) Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët. (4) Bashkëshortët

janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh”.

17. Me nenin 48 të këtij ligji, përcaktohet se: “Ligjet në fuqi me të cilët rregullohen të drejtat dhe detyrimet në pasuri të patundshme do të zbatohen për pasurinë e përbashkët, përveç rasteve kur me këtë Ligj parashihet ndryshe”.
18. Me nenin 50 të këtij ligji, përcaktohet se: “ (1) Të drejtat e bashkëshortëve për sendet e paluajtshme, të cilat janë pasuri e tyre e përbashkët, ashtu siç parashihet në nenin 47 të këtij Ligji, regjistrohen në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët në pjesë të papërcaktuara. (2) Kur vetëm njëri prej bashkëshortëve regjistrohet si bartës i së drejtës pronësore për pasurinë e përbashkët në regjistrin e të drejtave në pasuri të patundshme, do të konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të dy bashkëshortëve. Pasuria nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve, ashtu siç është përcaktuar me ligjin në fuqi. (3) Në rastet kur që të dy bashkëshortët janë të regjistruar në regjistrin publik të paluajtshmërive si pronarë të përbashkët në pjesë të caktuara, konsiderohet se ata në këtë mënyrë e kanë bërë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët ”.
19. Me nenin 51 të këtij ligji, përcaktohet se: (1) Bashkëshortët mund të kontraktjnë që administrimi dhe disponimi i pasurisë së përbashkët, në tërësi ose pjesë të saj, të bëhet nga njëri prej bashkëshortëve. (2) Kontrata mund të kufizohet edhe vetëm në administrim ose vetëm disponim. Kur nuk është kontraktuar ndryshe, administrimi përfshin edhe posedimin në kuadër të aktiviteteve të rregullta. (3) Kontrata po ashtu mund t’i referohet të gjitha akteve të veçanta të administrimit të rregullt ose akteve të veçanta të përcaktuara”.
20. Me nenin 52 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Asnjëri nga bashkëshortët nuk mund që në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e tij ”.
21. Me nenin 53 të këtij ligji, përcaktohet se: “ (1) Bashkëshortët, në çdo kohë, mund të pjesëtojnë pasurinë e tyre të përbashkët me marrëveshje. (2) Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet kur bashkëshortët caktojnë ose kërkojnë t’u caktohen pjesët e tyre në pasurinë e përbashkët dhe kështu bëhen pronarë në pjesë të caktuara. (3)

Marrëveshja nga paragrafi 1 dhe 2 e këtij neni duhet të bëhet medoemos me shkrim në pajtim me kërkesat formale, të përcaktuara me ligjin në fuqi mbi pasurinë për arritjen e marrëveshjeve të tilla.

22. Me nenin 54 të këtij ligji, përcaktohet se: “(1) Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. (2) Gjykata kompetente vendos po ashtu në rast të mosmarrëveshjes lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve të paraparë sipas këtij neni”.

23. Me nenin 55 të këtij ligji, përcaktohet se: “(1) Pjesa e pasurisë së bashkëshortëve përcaktohet duke përdorur kriteret e njëjta ashtu siç janë përcaktuar në nenin 54 (1). (2) Pjesa më e madhe e pasurisë së bashkëshortit në një send apo në të drejtën e caktuar, mund të përcaktohet nga gjykata vetëm nëse ai send ose e drejtë ekonomikisht është e pavarur në krahasim me sendet dhe të drejtat e tjera në pasurinë e përbashkët, dhe bashkëshorti për fitimin e atij sendi apo të drejte ka marrë pjesë me të hyrat nga pasuria e tij e veçantë. (3) Bashkëshorti, i cili pas pushimit të bashkësisë martesore, përmes investimit, rrit vlerën e sendeve të pasurisë së përbashkët, ka të drejtën të kërkojë nga bashkëshorti tjetër kompensimin nëse investimet kanë qenë të domosdoshme dhe të dobishme. Kompensimi do të jetë në proporcion me pjesën e tij në atë send. (4) Bashkëshorti tjetër mund të lirohet nga detyrimi i tillë nëse pranon pjesën më të madhe së pjesës të atij sendi në proporcion me investimet e bëra ”.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë dhe e dytë drejt kanë aplikuar të drejtën materiale kur kanë konstatuar se paditësja në këtë rast nuk e ka të drejtën në kompensimin të shumës së kërkuar prej 30,000 € në emër të kontributit

në shtimin e pasurisë gjatë jetës faktike (bashkëjetesës) për 16 vite. Ky fakt vërtetohet nga kontrata për shitblerjen e palujtshëmrisë e lidhur më datë 19.10.2010, e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Lipjan me nr.V.nr...., ku shihet se i padituri me paratë nga shitja e palujtshëmrisë e ka ndërtuar shtëpinë dhe objektet përcjellëse, të cilën paditësja pretendon se me kontributin e saj financiar janë ndërtuar. Gjithashtu ky fakt vërtetohet edhe nga shkresat e tjera të lëndës, sidomos nga vet deklarimi i paditëses në seancë ku ndër të tjera ka theksuar se: “ Mjetet e fituara nga unë të cekura si më lartë janë mjetet të cilat i kam marrë në dorë dhe me to nuk kemi investuar diçka sepse ky i ka marrë dhe i ka shpenzuar. Parat që i kam fituar te “F. C.”, ku kam gatuar flija nga 10 € një fli, deri në katër flija në ditë i kam gatuar, mi ka marr i padituri. Është e vërtetë se shtëpia është ndërtuar me paratë që është shit toka, ndërsa mobilimi është bërë me paratë të fituara nga N., me paratë e tokës 78.000 €, shtëpia është lyer jashtë e brenda, janë vendosur dyer dhe dritare dhe është rregulluar dhe një pjesë shtesë e shtëpisë si dhe lokalet me paratë e tokës së shitur. Ndërsa me paratë prej 30.000 € e ka ndërtuar shtëpinë. Me kontributin tim nuk ka ndërtuar asgjë vetëm se i ka shpenzuar nëpër lokale të natës, edhe një herë dua të sqaroj se me shumën prej 30.000 €, e ka ndërtuar shtëpinë ndërsa me shumën prej 78.000 €, e ka rinovuar dhe i ka rregulluar lokalet në tërësi si dhe i ka kryer obligimet që i ka pasur vllaut tim borxh prej 6,000 € ”.

2. Gjykata Supreme vlerëson se nuk mund të gjykohet kompensim në emër të kontributit të dhënë në bashkësinë martesore ose jashtëmartesore për një periudhë të caktuar kohore për rastet kur konstatohet se bashkëshortët gjatë martesës ose bashkësisë jashtëmartesore nuk kanë krijuar fare pasuri të përbashkët. Në këtë rast nuk është vërtetuar që paditësja me të paditurin në bashkësi jashtëmartesore të kenë krijuar pasuri të përbashkët në mënyrë që më pas të krijohet mundësia për të kërkuar pjesëtimin të pasurisë dhe eventualisht edhe kompensimin financiar në emër të kontributit. Pra kushti është që fillimisht të konstatohet se gjatë martesës është krijuar pasuri e përbashkët, pastaj të identifikohet se cila është pasuria e përbashkët, cili është kontributi i bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët dhe pastaj të pjesëtohet pasuria sipas kriterëve që përcakton LFK-ja, në nenin 54 paragrafi 1.
3. Në këtë rast paditësja pretendon se nuk është marrë për bazë nga gjykatat e instancës më të ulët kontributi i paditëses në bashkësinë jashtëmartesore, përkatësisht kontributi në lindjen e fëmijëve, ushqimin dhe përkujdesjen për punët e shtëpisë, kujdesin ndaj

fëmijëve, dhe punëve të tjera të cilat pretendon se ka punuar me pagesë, e të cilat nuk i ka argumentuar me prova, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se as martesë e as bashkësia jashtëmartesore nuk duhet nënkuptuar si themelim të marrëdhënies së punës, për njërin bashkëshort dhe detyrimin e tjetrit që në rast të zgjidhjes së martesës apo pushimit të bashkësisë jashtëmartesore të kompensojë për kontributin në familje edhe kur nuk ka pasuri të përbashkët. Kriteri i kontributit në kujdesin për fëmijët, familjen, shtëpinë etj, është i rëndësishëm kur ka pasuri të përbashkët, ndërsa në raste kur nuk ka pasuri të përbashkët nuk mund të gjykohet asnjë lloj kompensimi. Në këtë rast nuk është krijuar pasuri e përbashkët me kontributin e të dy bashkëshortëve, mirëpo kjo pasuri që është objekt kontesti nga paditësja ka ardhur si rezultat i shitjes së paluajtshmërisë së cekur më lartë, ku me paratë nga shitja e paluajtshmërisë i padituri e ka ndërtuar shtëpinë dhe objektet përcjellëse, për të cilat objekte paditësja pretendon se ka kontribuar.

4. Pretendimet e paraqitura në revizion se paditësja ka kontribuar në ndërtimin e shtëpisë dhe objektet përcjellëse që është objekt i këtij kontesti, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara, për arsye se: paditësja në këtë rast nuk ka arritur ti vërtetojë faktet mbi të cilat e mbështet kërkesën e saj edhe pse kjo ka qenë detyrë e tij, në kuptim të nenit 322 paragraf 1 dhe 2 e lidhur me nenin 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: “Gjykata mund të kërkojë nxjerrjen e provave sipas detyrës zyrtare, për vërtetimin e fakteve edhe pse palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse ato prova po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirish të përcaktuara në kuptim të nenit 3 paragraf 3 të LPK-së”.
5. Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga paditësja nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.
6. Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.
7. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.508/23, i datës 17.01.2024

"Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelle thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura, t'ia kompensoj dëmin paditësit, për dëmin e shkaktuar për shkak të humbjes së vlerës së tokës, gjenë mbështetje në nenin 36 dhe 37 të Ligjit nr. 03/I-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/I-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenit 136, 140 dhe 169 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i datës 10 maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 dhjetor 2012, nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e lidhur me protokollin 1, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut“.

Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2765/18, të datës 05.10.2020, është vendosur: I. Aprovohet në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit M. J. nga P. dhe detyrohet e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës, me seli në P., që paditësit në emër të dëmit të shkaktuar për shkak të humbjes së vlerës së tokës në ngastrën kadastrale ... ZK – F. K., për pjesën e sipërfaqes prej 8,200 m² të mbetur jashtë shpronësimit, t'ia paguaj shumën prej 100,102 €, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,169 €.
2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.128/2021, të datës 04.09.2023, është vendosur: I. Refuzohet pjesërisht e pathemeltë ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, me seli në P., pjesa e pikës së I-rë, (ku është gjykuar kompensimi i dëmit për shkak të humbjes së vlerës së tokës) dhe pika e II-të, e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i

Përgjithshëm, C.nr.2765/18, i datës 05.10.2020, vërtetohet. II. Aprovohen pjesërisht të themelta ankesa e paditësit M. J., nga P. dhe e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, me seli në P., ndryshohet pjesërisht pika e I-rë, e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2765/18, i datës 05.10.2020 (vetëm për kamatën) dhe çështja tani gjykohet si në vijim: Detyrohet e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës, me seli në P., që paditësit për shumën e aprovuar dhe të vërtetuar sikurse nën I, të këtij aktgjykimi, t'ia paguaj kamatën ligjore prej 7% në vit dhe atë duke filluar nga data 05.03.2013 e deri në pagesën përfundimtare, ndërsa refuzohet pjesërisht pjesa tjetër e kamatës së kërkuar nga paditësi mbi përqindjen e aprovuar.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aprovohet në tërësi si i bazuar revizioni i të paditurës, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr.128/202 i datës 04.09.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2765/18 i datës 05.10.2020 dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.
4. Përgjigje në revizion nuk ka pasur.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:
Revizioni i të paditurës është i pabazuar.
6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, më datë 30.01.2019, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqit propozim, për caktimin e seancës gjyqësore, pasi që lënda nga procedura jokontestimore është dërguar në procedurë kontestimore, kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit nga shpronësimi, duke kërkuar shumën e specifikuar me saktësisht si në parashtrësën për precizimin e padisë të datës 22.01.2020.
7. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas propozimit/padisë së paditësit kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për

shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.2765/18, të datës 05.10.2020, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

8. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat si në vijim: ankesën kundër vendimit përfundimtar të Qeverisë së Kosovës e parashtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë më datë 06.03.2013, raportin mbi vlerësimin e çmimit të pronës së shpronësuar nga eksperti R. B. numër ... të datës 27.02.2013, vendimin përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.... të datës 16.01.2013, certifikatën e pronësisë për ngastrën kadastrale ... e cila evidentohet në emër të M. J. sipas numrit të certifikatës UL-.... të datës 11.16.2011, raportin mbi vlerësimin e pronës së shpronësuar nga eksperti Sh. J. të datës 25.02.2018, raportin e vlerësimit nga grupi i ekspertëve H. M., H. Ll. dhe L. D. të datës 10.05.2018, përgjigjen e grupit të ekspertëve drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë më datë 07.06.2018 në parashtrësën e avokatit Avdi Ahmeti, procesverbalin C.nr.165/13 të datës 14.06.2018, procesverbalin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.165/13 të datës 24.07.2018.
9. Ka shtuar se në këtë çështje juridike nuk ishte kontestues fakti se e paditura me vendimin përfundimtar Nr.... të datës 16.01.2013 e kishte aprovuar shpronësimin e pronave me interes për ndërtimin e autostradës, si pjesë e së cilës ishte përfshirë edhe paluajtshmëria e paditësit nr.... ZK – F. K.. Po ashtu, nuk është kontestuese se paditësi për paluajtshmërinë e shpronësuar - ngastrën kadastrale ... ZK F. K., në sipërfaqe prej 5732m², është kompensuar nga e paditura në shumë prej 65.000 €, sipas ujdisë gjyqësore të arritur në këtë gjykatë nr. Cn.165/13 të datës 24.07.2018. Më tutje, nuk ishte kontestuese se pas shpronësimit, respektivisht pas ndërtimit të autostradës M.-M., ngastra kadastrale ZK – F. K., pronë e paditësit, kishte mbetur e ndarë në dy pjesë. Njëra pjesë në pjesën lindore të autostradës, ndërsa pjesa tjetër në pjesën perëndimore të autostradës me sipërfaqe prej 8,200 m². Për këtë pjesë paditësi ka pretenduar dëmtimin e vlerës së pronës - gjë që edhe është objekt i këtij kontesti. Andaj, në këtë çështje juridike, kontestuese midis palëve ishte nëse paditësit i takon e drejta për kompensimin e dëmit për shkak të humbjes së vlerës së tokës së mbetur - ngastrës kadastrale .. ZK – F. K., në sipërfaqe prej 8,200m², e mbetur jashtë shpronësimit,

respektivisht në anën perëndimore të autostradës. Po ashtu, kontestuese ishte edhe lartësia e kompensimit për pjesën e vlerës së humbur.

10. Nga raporti i vlerësimit të çmimit të pronës së shpronësuar të datës 25.02.2018 të ekspertit Sh. J., gjykata ka vërtetuar faktin se në konstatimin e tij eksperti ka llogaritur se sipërfaqja e tokës së pa shpronësuar ishte 31,211 m². Nga kjo sipërfaqe është shpronësuar sipërfaqja prej 5,732 m², ndërsa sipërfaqja e mbetur e pa shpronësuar ishte 25,479 m². Nga kjo sipërfaqe e pa shpronësuar pjesa prej 8,185 m² kishte mbetur në anën perëndimore të autostradës. Për këtë sipërfaqe eksperti, në bazë të daljes në vend shikim, kishte konstatuar se pas shpronësimit njëra pjesë e ngastrës ka mbetur në anën lindore e cila kufizohet me lagjen e banimit, ndërsa pjesa tjetër ka mbetur në anën perëndimore të autostradës. Lidhur me këtë pjesë, eksperti ka konstatuar se puseta e cila ka shërbyer për ujitjen e tërë sipërfaqes së tokës, tani pas shpronësimit për shkak të ndarjes së pronës ka mbetur pa ujitje. Ky fakt, sipas ekspertit e bën të papërdorshme, e po ashtu për të arritur gjër te kjo pronë, është e nevojshme të kalohen afro 10km rrugë. Nga ekspertiza e grupit të ekspertëve të datës 10.05.2018 të njëjtit kishin ardhur në përfundim se pas shpronësimit vlera e humbur e pronës e cila ka mbetur në anën perëndimore të autostradës është 8,200m². Sipas grupit të ekspertëve, vlerësimi për çmimin e pronës që mund të ketë pasur është vlerësuar në shumë prej 27.13 €. Nga kjo vlerë, ekspertët sipas metodologjisë kanë konstatuar se për shkak të lokacionit vlera është zbritur prej -5%, qasja në rrugë -5%, mundësia e zhvillimit -10%, kushtet urbanistike -10% dhe largësia nga vendbanimi -15%, e që kanë ardhur deri te vlera prej 14.92 € për m². Sipas vlerësimit të ekspertëve nga vlera para shpronësimit prej 27.13 € është zbritur vlera prej 14.92 €, dhe kanë ardhur në përfundim se vlera e humbur është 12.21 € për m², e cila në sipërfaqen e mbetur në anën perëndimore prej 8,200 m² ka rezultuar në shumë prej 100,122 € si vlerë e humbur, për shkak të mbetjes së kësaj sipërfaqe të ndarë nga pjesa tjetër e pronës. Grupi i ekspertëve i ka dhënë sqarimet për këtë ekspertizë në parashtrësën e datës 07.06.2018 si dhe në seancën e datës 24.07.2018 sipas lëndës Cn.nr.165/13, në të cilën kanë sqaruar mënyrën dhe metodologjinë e llogaritjes së vlerës së humbur të pronës, e cila është përdorur me rastin e vlerësimit të humbjes së vlerës së pronës.
11. Nga gjendja faktike e vërtetuar më sipër dhe provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësor, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Deri te ky vlerësim, gjykata erdhi duke u bazuar në faktin se paditësi para shpronësimit ka qenë pronar i një ngastre kadastrale si tërësi në sipërfaqe prej 31,211 m², nga e cila pas shpronësimit, një pjesë e paluajtshmërisë në sipërfaqe prej 8,200 m² ka mbetur e dëmtuar, respektivisht i ka humbur vlera e pronës. Duke qenë se paluajtshmëria është ndarë me autostradën në mes, sipërfaqja prej 8,200 m² ka mbetur e ndarë nga pjesa lindore e parcelës. Rrjedhimisht, kjo pjesë e ngastrës ... ZK – F. K., ka mbetur pa qasje në pusëtën e ujit dhe me një distancë afro 10 km për qasje në rrugë. Të gjitha këto arsye kanë ndikuar që vlera e pronës të pësojë humbje edhe për një mori arsyesh të pamundësisë së zhvillimit, të cilat i kanë konstatuar ekspertët e vlerësimit të paluajtshmërive.

12. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenit 1 paragrafi 1 të Protokollit 1 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (20.III.1952), (e zbatueshme drejtpërdrejtë sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës), dhe nenit 136, 137, 169, dhe 174 të LMD-së. Për kamatën ju ka referuar nenit 382 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në 449, dhe 452 e lidhur me nenin 463 të LPK-së.
13. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi dhe e paditura kanë paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.128/2021, të datës 04.09.2023, ka vendosur që ta refuzojë pjesërisht ankesën e të paditurës dhe ta aprovojë pjesërisht ankesën e paditësit dhe të paditurës, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka ndryshuar sa i përket kamatës, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.
14. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes ka vlerësuar se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të atakuar me ankesë dhe as me shkelje nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, përveç në pjesën ku aktgjykimi është dashur të ndryshohet.

I. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.
2. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërtëhënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuara me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.
3. Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.
4. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me

gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për arsye se:

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura, t'ia kompensoj dëmin paditësit, për dëmin e shkaktuar për shkak të humbjes së vlerës së tokës, gjenë mbështetje në nenin 36 dhe 37 të Ligjit nr. 03/l-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenit 136, 140 dhe 169 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i datës 10 maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 dhjetor 2012, nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e lidhur me protokollin 1, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

5. Me nenin 36 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/l-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, përcaktohet se: “ Nëse në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, një Organ Shpronësues nxjerr një Vendim Përfundimtar, çdo Pronar ose Zotërues i Interesit në pronën dhe/ose të drejtat të cilat janë objekt i këtij vendimi mund të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e shumës së kompensimit dhe/ose dëmeve të cilat janë përcaktuar në vendim se do t'i paguhen atij Pronari dhe/ose Zotëruesi të Interesit.
6. Me nenin 37 paragrafi 1 të të njëjtit ligj përcaktohet se: “Nëse në përputhje me paragrafin 3. të nenit 18 të këtij ligji, Vendimi Përfundimtar autorizon shpronësimin e një pjese të parcelës së pronës së paluajtshme dhe kjo rezulton, ose me arsye pritet se do të rezultojë, në humbjen e vlerës së pjesës së pa shpronësuar, Pronari i pjesës së pa shpronësuar ka të drejtë të paraqesë ankesë sipas këtij neni dhe të kërkojë nga gjykata kompetente nxjerrjen e një aktgjykimi i cili e urdhëron Organin Shpronësues që të kompensojë humbjen e vlerës, nëse – dhe vetëm për aq sa – ky kompensim nuk është paraparë në Vendimin Përfundimtar“.
7. Me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: “E drejta e pronës është e garantuar, shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligje, në pajtim me interesin publik, askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona, Republika e Kosovës ose Autoriteti Publik i Republikës së Kosovës, mund të bëjë eksproprihimin e pronës nëse ky eksproprihim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet

me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve eksprijohet”.

8. Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”, me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”.
9. Me nenin 169 paragraf 1, 2, 3 dhe 4 përcaktohet se: “1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. 4. Gjykata do t’i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme.”
10. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin dhe vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë dhe të dytë, si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes, për faktin se të njëjtat drejtë kanë vendosur lidhur me kompensimin e paditësit nga e paditura lidhur me dëmin e shkaktuar për shkak të humbjes së vlerës së tokës në ngastrën kadastrale ... ZK – F. K., pjesën e sipërfaqes prej 8,200 m2 të mbetur jashtë shpronësimit, në shumën prej 100,102 €, me kamatë ligjore prej 7%. Gjykata vlersimin e saj e ka mbështetur në ekspertizën e bërë nga grupi i ekspertëve të datës 10.05.2018 të cilët kanë konstatuar se pas shpronësimit vlera e humbur e pronës e cila ka mbetur në anën perëndimore të autostradës është 8,200m2, çmimi i pronës që mund të ketë pasur është vlerësuar në shumë prej 27.13 €. Nga kjo vlerë, ekspertët sipas metodologjisë kanë konstatuar se për shkak të lokacionit vlera është zbritur prej -5%, qasja në rrugë -5%, mundësia e zhvillimit -10%, kushtet urbanistike -10% dhe largësia nga vendbanimi -15%, e që kanë ardhur deri te vlera prej 14.92 € për m2. Sipas vlerësimit të ekspertëve nga vlera para shpronësimit prej 27.13 € është zbritur vlera prej 14.92 € dhe kanë ardhur në përfundim se vlera e humbur është 12.21 € për m2, e cila në sipërfaqen e mbetur në anën perëndimore prej 8200 m2 ka rezultuar në shumë prej

100,122 € si vlerë e humbur, për shkak të mbetjes së kësaj sipërfaqe të ndarë nga pjesa tjetër e pronës. Grupi i ekspertëve i ka dhënë sqarimet për këtë ekspertizë në parashtresën e datës 07.06.2018 si dhe në seancën e datës 24.07.2018 sipas lëndës Cn.nr.165/13, në të cilën kanë sqaruar mënyrën dhe metodologjinë e llogaritjes së vlerës së humbur të pronës, e cila është përdorur me rastin e vlerësimit të humbjes së vlerës së pronës. Gjithashtu përfaqësuesi i grupit të ekspertëve z. H. Ll., në seancën e datës 21.09.2020, ka sqaruar se “ Nga shiqimi në terren dhe studimi ynë i bërë për vlerën e mundshme të pronës pas realizmit të shpronësimit kemi konstatuar se pjesa e mbetur në mes autostradës dhe shtëpive të mbetura në anën lindore nuk ka ndryshim dhe nuk ka dëm në vlerë në këtë pjesë. Ndërsa në anën perëndimore për sipërfaqen prej 8200m² kemi konstatuar se humbja e vlerës për 12.21€ për një metër katror që në total janë 100,122€, detajet rreth llogaritjes së humbjes së vlerës janë dhënë në tabelën në faqen 12”, andaj një vlerësim të tillë Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si tejet profesional dhe të bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, andaj bazuar në këtë vendosi ta refuzoj revizionin e të paditurës duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

11. Në raport me pretendimet e të paditurës në revizion se procedura në këtë çështje është dashtë të zhvillohet në procedurë jokontestimore dhe për të njëjtën çështje nuk mund të zhvillohet edhe një procedurë tjetër në procedurë kontestimore, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se një pretendim i tillë është i pa bazuar. Gjykata Supreme për situatat e tilla lidhur me shpronësimet dhe dëmet e shkaktuara për shkak të humbjes së vlerës së tokës si rezultat i shpronësimeve, ka nxjerr mendimin juridik GJ.A-Su.A.107/2022 të datës 12.05.2022 dhe në të ka sqaruar se në procedurën jokontestimore mund të vendoset edhe për dëmet e shkaktuara për shkak të humbjes së vlerës së tokës si rezultat i shpronësimeve, nëse gjykata e ka vlerën e saktë të dëmit. Përfundimisht Gjykata Supreme në mendimin juridik të lartcekur saktësisht pika III, e dispozitivit me të cilën përcaktohet se: “ Nëse në ankesën për caktimin e kompensimit për shpronësim nuk paraqitet kërkesa edhe për kompensimin e dëmeve tjera të cekura në pikën I, të këtij Mendimi Juridik, e të cilat nuk janë përfshirë në Vendimin përfundimtar për shpronësim, të cilat dëme lidhen me tërë paluajtshmërinë e shpronësuar apo me një pjesë të saj, kjo nuk do të thotë se ankuesi nuk ka të drejtë që të kërkojë kompensimin në procedurë kontestimore siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurë Kontestimore dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve”, e që rezulton se lidhur me

padinë e paditësit gjykata drejtë ka vendosur për pjesën e dëmit të shkaktuar për shkak të humbjes së vlerës së tokës si rezultat i shpronësimit, për faktin se në procedurë jokontestimore nuk është vendosur për këtë pjesë dhe rrjedhimisht vendosja në procedurë kontestimore është e drejtë dhe e ligjshme.

12. Në raport me pretendimet e të paditurës sa i përket kamatës ligjore, duke pretenduar se kamata ligjore është dashur të jetë 7% dhe jo 8%, ashtu siç është vendos, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ky pretendim është i pa bazuar për faktin se gjykata e shkallës së dytë e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në raport me kamatën ligjore duke e obliguar të paditurën që kompensimin e dëmit ta bëjë me kamat ligjore prej 7%, andaj bazuar në këtë aktgjykim pretendimi i të paditurës në këtë pjesë është i pa bazuar.
13. Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij revizioni, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljeve procedurale që ka të bëjnë me kompetencën lëndore, për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi. Në këtë kuptim nuk janë pranuar pretendimet sipas revizionit nga pala e paditur, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për këtë pjesë të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së dytë në përputhje me gjendjen faktike ka aplikuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, duke i'u referuar dispozitave ligjore dhe atyre kushtetuese si dhe Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, gjegjësisht Protokollin 1.
14. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike - kontestimore, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.
15. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.544/23, i datës 26.12.2023

”Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, me vendimet e saj është qartësuar se Kontrata e Punës, për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme, për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, do të konsiderohet si kontratë e lidhur në kohë të pacaktuar, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditësit në këtë rast është e pabazuar“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan C.nr.500/20, të datës 23.02.2021, është vendosur: I. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit V. S. nga L., si e bazuar dhe anulohet njoftimi i të paditurit Aeroportit Ndërkombëtar i Prishtinës “Limak Kosova”, sh.a., me seli në V., Komuna e L. i datës 06.03.2020, për mospërtëritjen e kontratës së punës të datës 13.04.2011 dhe obligohet e paditura, që paditësin në afat prej 7 dite nga dorëzimi i aktgjykimit, ta kthejë në punë dhe detyrat e punës ose në punët dhe detyrat e punës që i përgjigjen përgatitjes profesionale të paditësit me të njëjtën pagë mujore. II. Obligohet e paditura që në afat prej 7 dite nga dorëzimi i aktgjykimit t’ia paguaj paditësit shumën prej 2,799.47 €, në emër të dëmit të shkaktuar material për shkak të mosrealizimit të pagave për periudhën 04.04.2020 deri më datën 22.09.2020, me kamatë ligjore prej 8% vjetore duke filluar nga 23.09.2020, e deri tek pagesa definitive, në Trustin Pensional të Kosovës, në emër të paditësit shumen prej 154.92 €, si dhe shumën prej 162.48 € në llogari të Buxhetit të Kosovës, në emër të tatimit në pagë në emër të paditësit. III. Obligohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,024 €, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2755/2021, të datës 24.10.2023, është vendosur: Aprovohet e bazuar ankesa e të paditurit Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Limak Kosova”, sh.a., me seli në V. – Komuna e L., ndryshohet aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan C.nr.500/20, i datës 23.02.2021, dhe gjykohet si vijon: Refuzohet e pabazuar kërkesëpadia e paditësit V. S. nga L., me

të cilën ka kërkuar që të anulohet njoftimi i të paditurës Aeroportit Ndërkombëtar i Prishtinës “Limak Kosova”, sh.a., me seli në V., Komuna e L. i datës 06.03.2020, për mospërtëritjen e kontratës së punës të datës 13.04.2011, dhe të detyrohet e paditura, që paditësin në afat prej 7 dite nga dorëzimi i aktgjykimit, ta kthejë në punë dhe detyrat e punës ose në punët dhe detyrat e punës që i përgjigjen përgatitjes profesionale të paditësit me të njëjtën pagë mujore, si dhe të detyrohet e paditura që në afat prej 7 dite nga dorëzimi i aktgjykimit t’ia paguaj paditësit shumën prej 2,799.47 €, në emër të dëmit të shkaktuar material për shkak të mosrealizimit të pagave për periudhën 04.04.2020 deri më datë 22.09.2020, me kamatë ligjore prej 8% vjetore duke filluar nga 23.09.2020, e deri tek pagesa definitive, në trustin pensional. Obligohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,024 €, janë afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësi, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.2755/2021 i datës 24.10.2023 të ndryshohet dhe kërkesëpapia e paditësit sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan C.nr.500/2020 i datës 23.02.2021 në pikën I (një) dhe II (dy) të vërtetohet dhe paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës si në pikën III (tre) të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.
4. Me përgjigje në revizion i padituri, ka kërkuar që revizioni i paditësit të refuzohet në tërësi i pabazuar.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:
Revizioni i paditësit është i pabazuar.
6. Nga shkrësat e lëndës rezulton se paditësi, më datë 08.04.2020, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për anulimin e njoftimit për mospërtëritjen e kontratës së punës, kthim në punë dhe shpërblimin e dëmit, me të gjitha

të drejtat nga marrëdhënia e punës, duke kërkuar më saktësisht si në precizimin e padisë të bërë si në parashtrësën e datës 28.09.2020.

7. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit kundër të paditurit, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.500/20, të datës 23.02.2021, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.
8. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: shikimin dhe leximin e njoftimit për mospërtëritjen e kontratës së punës të datës 06.03.2020, ankesën e paditësit drejtuar të paditurës të datës 12.03.2020, kontratën e punës për periudhë të caktuar të nënshkruar më datë 28.02.2014, amendamentet e kontratës së punës për periudhë të caktuar të datës 03.04.2019, të datës 17.04.2018, të datës 29.03.2017, të datës 16.03.2016, të datës 26.03.2015, të datës 12.11.2013, dhe 11.12. 2012, vërtetimin e lëshuar nga i padituri më datë 08.09.2020, vërtetimin e lëshuar nga i padituri më datë 09.09.2020 pasqyra e trustit pensional për paditësin, vërtetimin e lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në F. K. të datës 10.09.2020, ekspertizën financiare të hartuar nga eksperti gjyqësor financiar G. B. të dorëzuar në gjykatë më datë 22.09.2020, procesverbalin e kësaj gjykate të datës 21.01.2020, procesverbalin e kësaj gjykate të datës 21.01.2020, vërtetimin e lëshuar nga i padituri më datë 26.01.2021, procesverbalin e takimit në mes të shoqatës së sindikatave të punëtoreve (SHSP) të ANP-së, “Adem Jashari”, dhe menaxhmentit të paditurit të datës 23.08.2019, vendimin e inspektoratit të punës nr. RAP të datës 02.04.2020, dhe vendimin e inspektoratit të punës së shkallës së dytë nr. 386/2020 të datës 06.08.2020.
9. Ka shtuar se mbi bazën e provave të administruara si më lartë, e të cilave gjykata në tërësi i'a fali besimin, është vërtetuar se paditësi tek i padituri me kontratën punës ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të caktuar, për vendin e punës duke filluar nga data 07.11.2012, e i është vazhduar kontrata e punës, me amendamente të kontratës së punës deri më datë 03.04.2020, për vendin e punës, për pagën bruto mujore prej 550 €, që nga data 04.04.2015, se paditësi është pjesëmarrës i grevës së datës 19.20 dhe 21 gusht 2019, të organizuar nga organizata Sindikale e Pavarur e të paditurit, se paditësi

nga ana e të paditurit nuk i është dhënë asnjëherë performancë e pakënaqshme për kryerje të detyrave të punës, për të cilat është caktuar, se i padituri nga koha e mbajtjes se grevave të punëtorëve nga data 21.08.2019 e deri më datë 03.04.2020, kur paditësit nuk i është vazhduar kontrata e punës, ka punësuar se paku 10 punëtor të rijnë, në pozitën ..., se vendi i punës me të cilën ka punuar paditësi është vend i përhershëm i punës tek i padituri, dhe i padituri edhe për kundër marrëveshjes së bërë në takimin e mbajtur në mes SH.S.P. (Shoqata sindikale e punëtorëve), ANP “Adem Jashari”, dhe menaxhementit të paditurit të datës 23.08.2019 dhe atë pikës 6 të kësaj marrëveshje, me të cilën parashihet se palët u dakorduan që punëdhënësi të ndaloj dhe të mos ndërmerri masa dhe nuk do të zhvilloj procedurë disiplinore kundër punëtorëve, të cilët gjatë grevës kanë bërë veprime të papërshtatshme, pa zhvilluar procedurë të brendshme për ndonjë cenim të detyrave të punës nga paditësi, me njoftim me shkrim e ka njoftuar paditësin se në përputhje me nenin 71.2, nuk do ti vazhdohet kontrata e punës që nga data 04.04.2020, ndaj të cilit njoftim paditësi ka ushtrua ankesë tek i padituri, për të cilën ankesë i padituri nuk ka vendos fare dhe po në afat të caktuar ligjor ka inicuar procedurë kontestimore, për mbrojtjen e të drejtave të tij, nga marrëdhënia e punës.

10. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 80 të Ligjit të Punës, si dhe nenit 4, 136, 154 të LMD-së, nenit 13 të Ligjit mbi Grevën (Ligji nr. 03/L-200. Për kamatën ju ka referuar nenit 382 LMD-së. Për shpenzimet e procedurës ju ka referuar nenit 452 dhe 453 të LPK-së.
11. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i padituri ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.2755/2021, të datës 24.10.2023, ka vendosur që ta aprovojë ankesën e të paditurit, ndërsa aktgjykimin e atakuar, ta ndryshoj, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar.
12. Gjykata e Apelit e Kosovës, në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se: përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga

shkresat lëndore. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e pabazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.
2. Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërtëhënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuara sipas dispozitave të LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decizive si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

Me nenin 10 Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “ 1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji. 2. Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra specifike. 3. Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar. 4. Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite. 5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore. 6. Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti. 7. Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

4. Me nenin 11 paragrafi 1 nga pika 1.1) deri në pikën 1.13), të këtij ligji është përcaktuar se çka duhet të përmbaj kontrata e punës.
5. Me nenin 67 paragraf 1 pika 1.3, të këtij ligji, përcaktohet se: “ Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: ... me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;... ”.
6. Me nenin 71 paragrafi 2 i këtij ligji, përcaktohet se: “ Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë të punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

7. Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe dispozitave të kontratave të punës të datës 11.12.2012, dhe 28.02.2014 dhe amendamentet e kontratave, të datës 12.11.2013, 26.03.2015, 16.03.2016, 29.03.2017, 17.04.2018 dhe 03.04.2019, si dhe nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës edhe Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar. Në këtë kontekst gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka konstatuar dhe ka vendosur që kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se paditësi dhe i padituri raportin e tyre - të drejtat dhe detyrat e tyre, punëdhënës - punëmarrës i kanë rregulluar me kontratë në formë të shkruar, duke përcaktuar saktë të drejtat dhe detyrat e tyre reciproke, gjykata ka konstatuar se kontratat e punës janë lidhur në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të cekura me lartë, se kushtet e kontratave të punës të lidhura në mes të paditësit dhe të paditurit duke marrë për bazë kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, si dhe përfundimin e marrëdhënies së punës, siç ka ndodhur në këtë rast janë në pajtim të plotë me dispozita ligjore të Ligjit të Punës dhe dispozitat e kontratave të punës. Në këtë rast i padituri me vendim e ka njoftuar paditësin për mos ripërtëritjen e kontratës së punës, për shkak të skadimit të kontratës edhe pse nuk ka pasur detyrim ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të dispozitave ligjore të lartë cekura.
8. Për hir të praktikës gjyqësore edhe pse në praktikën gjyqësore, e në veçanti në gjykatat e instancave më të ulëta, si në gjykatën e shkallës së parë ashtu edhe në gjykatën e shkallës së dytë rreth aplikueshmerisë së nenit 10 paragrafi 5 të Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, me të cilin përcaktohet se: “Kontrata e Punës, për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme, për një periudhë të punësimit më të gjatë se tri (3) vite, do të konsiderohet si kontratë e lidhur në kohë të pacaktuar, ka pasur dilema dhe vendimmarrje ndryshe, këto nuk janë me ndikim për vendimmarrje ndryshe në këtë rast nga kjo gjykatë, për arsye se secili vendim gjyqësor me të cilin përfundon procedura kontestimore mund ti nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë sipas mjeteve të goditjes të rregullta dhe të jashtëzakonshme ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore të LPK-së, mirëpo është fakt jokontestues se praktika gjyqësore si burim i së drejtës mund të përdoret vetëm kur ajo është krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, si e vetmja gjykatë kompetente në bazë të Ligjit për Gjykata, për krijimin e praktikës gjyqësore, si me qëndrime parimore, mendime juridike dhe udhëzues juridik, ashtu edhe me vendime gjatë vendosjes sipas

mjeteve të jashtëzakonshme. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, me vendimet e saj është qartësuar se Kontrata e Punës, për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme, për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, do të konsiderohet si kontratë e lidhur në kohë të pacaktuar, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditësit në këtë rast është e pabazuar.

9. Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga paditësi nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.
10. Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.
11. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktvendim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr. 564/23, i datës 11.03.2024

”Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkellje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkellje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.682/18 të datës 30.12.2019, është vendosur: I. Refuzohet kërkesëpadia e paditësve: S. (...) N., dhe I. (...) N., që të dy me banim në fshatin T. Komuna P., me të cilën kanë kërkuar që të: Vërtetohet shuarja e të drejtës së servitutit të kalimit rrugor që shtrihet nëpër ngastrën shërbyese nr. dhe nr. ZK – R. e A., i cili servituti shtrihet nëpër ngastrat kadastral nr. ... dhe ... ZK – R. e A., dhe fillon nga ana veriore e këtyre ngastrave në gjatësi prej ... m, dhe gjerësi prej ... m, në sipërfaqe prej ...m², e cila rrugë fillon nga rruga e asfaltuar në skicë pika detaje ... dhe ..., dhe vazhdon në drejtimin verilindje në gjatësi prej ... m, pika ... dhe ..., e shtruar me zhavorr dhe devijon nëpër rrjedhën e ujit -ngastrën ... dhe ... , dhe lidhet me rrugën e vjetër ngastrën kadastrale, e që janë në pronësi të paditësve S. (...) N. dhe I. (...) N., si trashëgimtar ligjor të A. (...) N., si dhe zhvendosjen e servitutit të gjertanishëm me parametra dhe paragrafë paraprakë dhe konstituohet servituti i kalimit rrugor në rrugën e vjetër kadastrale nëpër ngastrat kadastrale nr. ..., traseja e të cilës është hapur nga paditësit (sipas ekspertizës së datës ...), dhe të detyrohen të paditurit Komuna e Pejës dhe A. (...) N., që të pushojnë së

shfytëzuar tani e tutje këtë servitut të kalimit, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit, si e pabazuar. II. Refuzohet kërkesa e paditësve S. (...) N., dhe I. (...) N., të dy nga fshati T., Komuna P., me të cilën kanë kërkuar caktimin e masës së përkohshme të sigurisë dhe të paditurve, tu ndalohej deri në plotfuqishmërinë e çështjes për shuarje të servitutit, ndërhyrja dhe ndryshimi i gjendjes apo çfarëdo lloji të punëve tjera duke përfshirë asfaltimin e rrugës, e cila shtrihet në ngastrat kadastral ... dhe ... ZK-R. e A., dëmtimi tjetërsimi ngarkimi me ndonjë barrë reale apo çdo lloj ndryshimi i gjendjes faktike, dhe ju ndalohej të paditurve Komuna e P. dhe A. N., kalimi nëpër rrugë e cila shtrihet në ngastrën nr. ... dhe ... ZK – R. e A., si e pabazuar.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2055/2020, të datës 09.10.2023, është vendosur: Refuzohet ankesa e paditësve S. (...) N. dhe I. (...) N. nga fshati T., Komuna P., vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.682/18 i datës 30.12.2019.
3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor kanë paraqitur revizion paditësit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.682/18 i datës 30.12.2019 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2055/2020, i datës 09.10.2023, ashtu që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësve si e bazuar si në petitum të precizimit të datës 11.11.2019 ose të aprovohet në tërësi revizioni, të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.
4. Përgjigje në revizion nuk ka pasur.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:
Revizioni i paditësve është i bazuar.
6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, në gjykatën e shkallës së parë më datë 12.07.2018 kanë paraqitur padi, kundër të paditurve, me të cilën kanë kërkuar

vërtetimin e shuarjes të së drejtës së servitutit, duke kërkuar më saktësisht si në parashtrësën e datës 11.11.2019, për precizimin e padisë.

7. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësve, kundër të paditurve, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin C.nr.682/18 të datës 30.12.2019, me të cilin e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.
8. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar këto prova: kopjen e planit të datës..., akt vdekjen për të ndjerin A. (...) N., certifikatën e pronësisë të datës ..., listën e mjeteve të paguara nga banorët e fshatit P., listën e familjeve për pagesën e devijimit të rrugës nr...., kërkesën e bashkëfshatarëve drejtuar Kryetarit të Komunës së P., të datës..., dhe ..., vendimin në emër të banorëve të katundit të datës ..., aktvendimin për hedhjen e kallëzimit penal të datës ..., ..., nr.... . ekspertizën e datës..., ka dëgjuar dëshmitarët B. N., H. N., R. N., U. N., I. N., R2. N., Xh. N., J. (...) N., S. (...) N., J 2 (...) N., O. (...) N., R. (...) N., ka revokuar aktvendimin e datës..., për dëgjimin e dëshmitarit L. N., si dhe deklarimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse. Ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të paditësve që të nxjerrës si provë CD dhe USB, daljen e gjykatës sërish në vendin e ngjarjes, sigurimin e shkresave të lëndës C.nr.932/19 dhe C.nr 1045/14, certifikatën e martesës për I. dhe R. N., si prova irelevante, për të vendosur në këtë çështje juridiko kontestimore.
9. Ka shtuar se gjykata pas analizimit të provave shkresor në lëndë, pretendimeve të palëve nxjerr përfundim se kërkesa e paditësve është e pabazuar në ligj dhe duhet refuzuar. Paditësit S. N. dhe I. N., rezultojnë se janë pronarë të paluajtshmerisë të ngastrave shërbyese ... dhe ... ZK-R. e A., shuarja e stërviturit të kalimit që por kërkohet. Përveç paditësve, si pronar të palujshmerisë të ngastrave shërbyese ... dhe ... ZK-R. e A., shuarja e stërviturit që po kërkohet, janë edhe bashkëpronar të tjerë: A. (...) N. ..., R. (...) N. ..., S. (...) N. ..., H. N. ..., H. N. ..., H. N. H. N. ..., I. (...) N. ..., B. (...) N. ... B. (...) N. Sh. (...) N. ..., që rezultojnë e provuar nga ekspertiza e gjeodezisë së datës ..., dhe dy certifikatat e pronësisë të datës ..., të bashkangjitura ekspertizës gjyqësorë.

10. Ka shtuar se paditësit pretendojnë se: rruga e kalimit duhet të shuhet sepse shtrihet nëpër pronën e tyre, dhe duhet të zhvendoset servituti i deritashëm dhe të konstituohet servituti i kalimit rrugor në rrugën e vjetër kadastrale, që evidentohet si rrugë kadastrale që shtrihet në ngastrën kadastral nr. ... ZK – R. e A., rrugë e hapur aktualisht nga paditësit dhe bashkëfshatarët e tjerë të cilët kanë kontribuar në financimin dhe hapjen e rrugës kadastrale, dhe për t'ju siguruar kalimin bashkëfshatarëve, me kërkesën e tyre. Gjykata mendon se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shuarje të servitutit sepse rruga në fjalë është në pronësi të përbashkët dhe në këtë rast të gjithë pjesëtarët e kësaj pronësie e kanë të drejtën në mbrojtje pronësore dhe të gjithë në rast kontesti janë bashkëndërgjyqës unik (ose si të paditur të domosdoshëm) për shkak të natyrës dhe konceptit të pronësisë së përbashkët, sepse të gjithë pjesëtarët administrojnë bashkërisht me pasurinë e përbashkët e cila realisht dhe formalisht është e papërcaktuar për secilin veç e veç. Gjykata mendon se çështja e legjitimitetit real të palëve, përmban edhe një specifikë po ashtu të rëndësishme e që lidhet me rrethanën se rrugët e caktuara në mënyrë faktike nga pronësitë e përbashkëta të familjeve të mëdha nuk plotësojnë konditat e servitutit, sepse të gjithë ish pjesëmarrësit në pronësinë e përbashkët kanë pozitë të njëjtë ndaj asaj pjese të pronës e cila në mënyrë faktike është ndarë si rrugë.
11. Prandaj ndarja e rrugëve nga pronësia e përbashkët nuk konsiderohet konstituim i servitutit sepse për t'u konsideruar konstituim i servitutit duhet të plotësohen konditat e pronës sunduese dhe pronësisë shërbyese dhe nevojat që për qëllime të pronës sunduese të përdoret prona shërbyese, ndërsa në ato rrugë të caktuara më rastin e ndarjes së pronësive të përbashkëta edhe me tutje ekziston e drejta e të gjithë pjesëmarrësve në atë rrugë.
12. Në rastin konkret shuarja e servitutit të kalimit që po kërkohet është e kushtëzuar edhe nga vetë ndodhja e pronave dhe nga ana tjetër ky servitut paraqet vijueshmëri pasi që rezulton e provuar se vazhdon edhe mbi pronën tjetër pronësi që shtrihet nëpër prona të pronarëve të tjerë e që nuk janë palë në procedurë. Sa i përket kërkesës tjetër se rruga duhet të zhvendoset në rrugën kadastrale dhe të konstituohet si servitut kalimi, për gjykatën edhe ky pretendim është i pabazuar, për faktin se rruga ekziston është e hapur dhe evidentohet si rrugë kadastrale në evidencat kadastrale dhe shtrihet në ngastrën kadastral nr.... ZK – R. e A., dhe nuk kontestohet nga askush.

13. Gjykata ka refuzuar kërkesën e paditësve për lëshimin e masë se sigurisë, pasi që konsideroj se kërkesa është e pabazuar në dispozita ligjor nga nenin 297 paragrafi 1 pika a) dhe 2), të LPK-së, se nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet ligjor për një masë të tillë.
14. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 253, 256 dhe 260 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, nenit 143 dhe 297, të LPK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 450 të LPK-së.
15. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësit kanë paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.2055/2020, të datës 09.10.2023, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e paditësve, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka vërtetuar, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.
16. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se: aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare nga neni 194 e lidhur me nenin 182 par. 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së, e as në ato në të cilat thirret ankesa nga neni 182 paragrafi 2 pika n). Kjo për faktin se dispozitivi i aktgjykimit të goditur është i qartë dhe i plotë. Në të janë dhënë arsye për fakte vendimtare, e të cilat arsye i pranon edhe kjo gjykatë në tërësi.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

2. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata e shkallës së parë nuk i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat nuk i ka cituar as si përmbajtje, dhe nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë.
3. Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet e palëve duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore.
4. Përveç tjerash aktgjykimi i shkallës së parë është marr edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 1 të LPK-së, e lidhur me nenin 99, për arsye se: padia e datës 12.07.2018, dhe precizimi i padisë në parashtrësën e datës 11.11.2019, nuk përmban elementet që duhet ti përmbajë çdo parashtrësë, në fakt kërkesa në padinë është e paqartë dhe e pakuptueshme dhe se nuk është e specifikuar

saktë kërkesa se çka kërkojnë paditësit në këtë rast. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë, para se të vendosë në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësve është dashur që padinë e paditësve ta kthejë në korigjim, në kuptim të nenit 99 dhe 102 e lidhur me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së.

5. Aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë edhe në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragrafi 2 pika k) e lidhur me nenin 73, 76 dhe 78 të LPK-së, për faktin se gjykata e shkallës së parë, duke i referuar gjendjes së theksuar më lartë nuk ka verifikuar identitetin e palëve në procedurë, në kuptimin procedural - cilësinë e palës, në fakt përveç të dhënave në padi të theksuara nga paditësit, në shkresat e lëndës nuk ka prova lidhur me identitetin e palëve dhe se të njëjtit a mund të jenë palë në këtë procedurë dhe se në këtë rast a kemi të bëjmë me kërkesa për të cilat palët mund të disponojnë lirshëm. Në anën tjetër gjykata gjatë tërë procedurës duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedurale, nëse palën pa zotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizimin e veçantë kur ai është i nevojshëm siç përcaktohet me nenin 76 të LPK-së. Gjithashtu kur gjykata konstaton se personi që paraqitet si palë nuk mund të jetë palë në procedurë, dhe se kjo mungesë mund të evitohet, do ta ftojë paditësin që të bëjë ndreqje të nevojshme në padinë ose do të ndërmarrë masa të tjera me qëllim që procedura të mund të vazhdohet me personin që mund të jetë palë në procedurë, ashtu siç përcaktohet me nenin 78 të LPK-së. Gjithashtu nëse i referohemi dispozitivit të shkallës së parë rezulton se A. (...) N. është paraardhësi juridik i paditësve, mirëpo nuk është sqaruar se i padituri A. U. N. si palë e paditur në çfarë raporti është me paditësin. Po ashtu gjykata është e autorizuar ti vërtetoi edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti merr edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, kur nga rezultati i shqyrtimit dhe të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin e kërkesat me të cilat palët nuk mund të dispononin lirisht, siç përcaktohet me nenin 7 paragrafi 2 të LPK-së.
6. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, tani për tani nuk mund të pranohet përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe as të dytë, për faktin se gjykata e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, rreth

konstatimit dhe të provuarit të fakteve sipas pretendimeve nga padia, për arsye se gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vërtetoj faktet me rëndësi për të vendosur sipas padisë së paditësve, për arsye se: nëse i referohemi pretendimeve të palëve dhe shkresave të lëndës rezultojnë se, sipas certifikatës së pronësisë të datës ..., figurojnë se paditësit S. N. dhe I. N., janë pronarë të paluajtshmërisë të ngastrave shërbyese ... dhe ... ZK-R. e A., shuarja e stërviturit të kalimit që po kërkohet. Përveç paditësve, si bashkëpronar të paluajtshmërisë të ngastrave shërbyese ... dhe ... ZK-R. e A., shuarja e stërviturit që por kërkohet, janë edhe bashkëpronar të tjerë: A. (...) N. ..., R. (...) N. ..., S. (...) N. ..., H. N. ..., H2. N. ..., H3. N. ... H4. N. ..., I. (...) N. ..., B. (...) N. ..., B2. (...) N. Sh. (...) N. ..., të cilët nuk janë të përfshirë fare në këtë proces gjyqësor as në cilësinë e paditësve e as në cilësinë e palës së paditur, dhe nuk ka ndonjë sqarim nga ana e gjykatës në raport me këtë.

7. Gjykata e shkallës së parë edhe pse ka dalë në vendshikim për të bërë identifikimin e saktë të ngastrës kontestuese, në të cilën palët paditëse kanë kërkuar që të vërtetohet shuarja e të drejtës së servitutit të kalimit rrugor që shtrihet nëpër ngastrën shërbyese nr. ... dhe nr. ZK – R. e A., i cili servituti shtrihet nëpër ngastrat kadastral nr. ... dhe ... ZK-R. e A., ngastrën ... dhe ..., gjykata nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësit, të identifikojë saktësisht se cila është paluajtshmëria kontestuese në të cilën paditësit kërkojnë që të vërtetohet shuarja e të drejtës së servitutit të kalimit rrugor, më saktësisht si në kërkesëpadi lidhur me paluajtshmërinë kontestuese, duke mos e përshkruar saktësisht shtrirjen gjeografike të saj/tyre, gjatësinë dhe gjerësinë, sa është sipërfaqja e saktë e paluajtshmërisë/ve kontestuese dhe cila është gjendja faktike në teren lidhur me atë parcelë/a kadastrale, ekspertiza e ekspertit gjeodet është e mangët, jo e plotë, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Ky lëshim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka ndodhur për faktin se gjyqtari i çështjes nuk ka konstatuar gjendjen faktike në vend, nuk ka kërkuar korigjimin dhe plotësimin e ekspertizës së ekspertit gjeodet sepse nëse i referohemi të njëjtës nga e njëjta rezultojnë se nuk ka përshkrim të pronës, nuk ka të dhëna të sakta për parcelën kadastrale kontestuese si: nuk ka përshkrim të gjendjes faktike në vend - nuk ka të dhëna se objekt kontesti është parcela kontestuese apo pjesa e saj, nuk ka konstatuar se parcela kontestuese në momentin e shikimit në vend çfarë kulture ka detajisht - duke përshkruar pjesën e saj sipas kulturave në vend, cila është shtrirja gjeografike e saj, me cilat parcela fqinje kufizohet, nuk ka kërkuar historiatin e pronës, gjykata nuk ka konstatuar nëse

pjesa e ngastrës kontestuese – rruga që është objekt i padisë, a shfrytëzohet edhe nga persona të tjerë apo vetëm nga të paditurit, gjithashtu nuk ka dëgjuar palët në cilësi të palës në kuptim të dispozitave të LPK-së.

8. Përveç të cekuarave pjesa e dispozitivit të aktgjykimit me të cilin kërkohet zhvendosja dhe konstituimi i servitutit është i pa qartë dhe nuk ka qenë objekt i shqyrtimit, sepse e njëjta është bërë në seancën e fundit të shqyrtimit kryesor në të cilën nuk ka qenë prezent i padituri dhe rrjedhimisht nuk ju ka dhënë mundësia e deklarimit lidhur me ndryshimin e padisë dhe si pasojë e kësaj, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, ku përveç të cekuarave gjykata nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të LPK-së, etj.

9. Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitohet shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj gjykata do të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoi shqyrtimin kryesor dhe sipas propozimit të palëve, të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, pastaj së bashku me palët apo të autorizuarit e tyre dhe ekspertin gjeodet të dal në vend, ashtu që gjykata sipas përshkrimit të cilin do ta bëjnë palët, të udhëzoj ekspertin gjeodet që të bëjë identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtshmërisë/ve kontestuese (shtirjen gjeografike të rrugës eksistuese). Pas identifikimit dhe matjes së saktë e cila do të bëhet nga eksperti gjeodet, gjykata do duhet ta bëjë përshkrimin e gjendjes faktike në vend, sipas vërejtjeve të cekura më lartë dhe pastaj sipas mendimit - raportit me shkrim të cilin eksperti gjeodet do duhej t'ia sigurojë gjykatës, gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, nga Zyra Komonale Kadastrale në Pejë, të kërkohet historiat i pronës për paluajtshmërinë kontestuese, duke mos përjashtuar mundësinë e kërkimit të të dhënave edhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, dëgjimin e palëve ndërgjyqëse në cilësi të palës në kuptim të dispozitave të LPK-së, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet që janë krijuar raportet juridike në

mes të palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësve dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

10. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktvendim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.5/24, i datës 07.02.2024

"Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar me kujdes pretendimet e paditësit të paraqitura në revizion, dhe të njëjtat janë të bazuara, për faktin se afatet e përcaktuara me nenin 376 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 377 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), janë afate të përcaktuara, dhe të njëjtat afate nuk mund të zgjaten dhe as të shtyhen, dhe se në rast të kalimit të afatit, kërkesa arrin parashkrimin, ndërsa gjykata sipas prapësimit të palës e vlerëson nëse kërkesa është e parashkruar ose jo, e që në këtë rast gjykatat e instancave më të ulëta nuk e kanë vërtetuar saktë faktin nëse kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, për arsye se:

Me nenin 376 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: "Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin", ndërsa në paragrafin 2, përcaktohet se: "Sidoçoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi".

Me nenin 377 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: "Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, C.nr.66/16 të datës 30.12.2019, është vendosur: Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadija e paditësit M. Xh. nga S., detyrohet e paditura K. e S. "...", me seli në P., që paditësit në emër të dëmit të pësuar në aksidentin e trafikut më datë ...në S., reth orës ...në rrugën "...", me fajin e të siguruarit të paditurës në shkallën prej ...t'ia shpërblej dëmin në shumat si në vijim: Dëmi jomaterial: për dhimbjet fizike trupore shumë prej 2,000 €, për frikën e përjetuar shumë prej 1,500 €, për dhimbjet shpirtërore të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 14.5% shumë prej 6,000 €, për dhimbjet shpirtërore për shëmtim të shkallës së mesme shumë prej 1,200 €. Dëmi material: për ndihmën dhe kujdesin e huaj shumë prej 200 €, për ushqimin e përforcuar shumë prej 280 €. Gjithsej shumë prej 11,180 €, shumë e cila duhet të paguhet me kamatën ligjore në normën prej 8% nga dita e gjykimit, si dhe shpenzimet e procedurës

kontestimore dhe atë për hartim të padis shumë prej 104 €, taksë për padi shumë prej 25 €, për përfaqësime të avokatit në 6 seanca shumë prej 810 €, për ekspertiza mjekësore shumë prej 300 €, për ekspertizë të komunikacionit shumë prej 100 €, gjithsej shpenzime të procedurës shumë prej 1,389 €, të gjitha shumat e gjykuara duhet të paguhen në afatin prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit. Refuzohet si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë për dhimbjet fizike shuma 3,000 €, për frikën e përjetuar shuma prej 2,500 €, për dhimbje shpirtërore për zvogëlim të aktivitetit jetësor shuma prej 1,500 €, për dhimbjet shpirtërore për shëmtim trupor shuma prej 2,800 € për ndihmën e huaj shuma prej 200 €, për ushqimin e përforcuar shuma prej 120 €, dhe për rehabilitim klimatik shumë prej 500 €.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4678/20, të datës 14.09.2023, është vendosur: Aprovohet e themeltë ankesa e të paditurës K. e S. "...", me seli në P., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj C.nr.66/16, i datës 30.12.2019, ashtu që refuzohet e pabazuar kërkesëpadia e paditësit M. Xh. nga S., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura K. e S. "...", me seli në P., që paditësit M. Xh. në emër të dëmit të pësuar në aksidentin e datës ...ti paguaj shumat si në vijim: Në emër të dëmit jomaterial për dhimbje fizike shumë prej 5,000 €, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 4,000 €, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumë prej 21,000 €. Për shëmtim shumë prej 4,000 €. Për dëmin material: për ndihmën dhe kujdesin e huaj 400 €. Për ushqimin e përforcuar 400 €. Për rehabilitim klimatik shumë prej 500 €. Në emër të shpenzimeve të procedurës shumë prej 1,389€.
3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësi, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit, sipas aktgjykimit C.nr.66 të datës 30.12.2019 si e bazuar, ndërsa të anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr.476/20 i datës 14.09.2023.
4. Përgjigje në revizion nuk ka pasur.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditësit është i bazuar.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, më datë 18.02.2016, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar zhdëmtim nga autopërgjegjësia, duke kërkuar shumat e specifikuara më saktësisht si në parashtrësën për precizimin e padisë të datës 30.07.2019.
7. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.66/16 të datës 30.12.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.
8. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: meqenëse pala e paditur në përgjigje në padi gjatë shqyrtimit kryesore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar padinë në drejtim se e njëjta është ushtruar pas afatit ligjore dhe kërkesa është parashkruar sepse aksidenti ka ndodh më datë 03.02.2010, ndërsa padia është parashtruar më datë 18.02.2016, gjykata e administroj në cilësinë e provës certifikatën e lindjes të paditësit nr. rendor..., i ref.... të datës..., e lëshuar nga ..në S. nga e cila konstatohet se M. Xh. nga i ati A., dhe e ëma Sh. është lindur më datë në D. të Gj., duke u nisur nga ky fakt konstatohet se paditësi në momentin kur ka ndodhur aksidenti i trafikut ka qenë i mitur i moshës ...vjeçare ndërsa moshën ... vjeçare dhe aftësinë e veprimit e ka arritur më datë... Padia është ushtruar më datë..., duke ju referuar dispozitave të nenit 385 paragrafi 1 të LMD-së, Gazeta Zyrtare nr.29/78 - ligj i zbatueshëm sipas rregullores së UNMIK-ut, 24/1999, që e rregullon çështjen e kërkesës ndaj personave të paaftë për të vepruar shprehimisht është e përcaktuar: “Parashkrimi rrjedh dhe ndaj të miturit dhe personit tjetër të aftë për të vepruar paravarsisht nëse kanë ose jo përfaqësues ligjor të tyre”. Në paragrafin 2 të po këtij neni, është përcaktuar: “ Mirëpo, parashkrimi i kërkesës të miturit që nuk ka përfaqësues dhe i personit tjetër të paaftë për të vepruar pa përfaqësues, nuk mund të filloj të rrjedh gjersa të mos kenë kaluar 2 vjet, nga data kur janë bërë krejtësisht të aftë për të vepruar ose nga data kur e kanë fituar përfaqësuesin”. Në rastin konkret është vërtetuar se paditësi më datë ...e ka arrit moshën 18 vjeçare rrjedhimisht edhe aftësinë për të vepruar dhe prej datës ...ka filluar të rrjedh afati i parashkrimit dy (2) vjeçar në përputhje me dispozitat ligjore të

përmendura më lartë dhe padia e ushtruar nga paditësi më datë ...është e afatshme, prandaj rrjedhimisht nuk ka përshkrim të kërkesëpadisë.

9. Ka shtuar se prej referatit të padisë, raportit të aksidentit nr... të datës..., konstatohet se në rrugën "...", në S. ka ndodhur aksident trafiku kur drejtuesi i automjetit S. H. nga fshati T. gjatë drejtimit të automjetit në rrugën e lartpërmendur me të arritur në udhëkryq të rrugës "...", e "...", derisa dy fëmijë ishin duke rrëshqitur me saj nuk e ka vërejtur automjetin dhe e godasin me pjesën e përparme të anës së majtë, ku sipas saj pësojnë lëndime trupore si dhe dëm në automjet. Me qëllim të konstatimit të rrethanave në të cilat ka ndodhur aksidenti dhe faktorët tjerë që kanë ndikuar është nxjerr ekspertiza e komunikacionit nga eksperti S. B. i cili me mendimin dhe konstatimin e datës..., dhe në sqarimet e dhëna në seancë kryesore më datë ... ka ardhur në përfundim se këmbësori - tani paditësi gjatë rrëshqitjes më saj ka bërë mos dhënien e përparësisë së kalimit automjetit që ka lëvizur në rrugën kryesore të asfaltuar, kyçje të pasigurt nga rruga dytësore (kubëza) në rrugë kryesore (pa kujdesia gjatë kyçjes-me saj). Automjeti i siguar tek e paditura respektivisht drejtuesi i automjetit ka zhvilluar shpejtësinë jo adekuate sipas kushteve dhe rrethanave të krijuara në komunikacion nga moskujdesi në ngasje dhe jo vigjilenca e ngasësit, nuk ka pasur kujdes ndaj fëmijëve në rrugë. Ka shtuar se Eksperti ka ardhur në përfundim se paditësi dhe drejtuesi i automjetit ka dhënë kontribut të barabartë në shkaktim të aksidentit.

10. Me propozimin e përfaqësuesit të palës së paditur është nxjerrë ekspertiza nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, nga grupi i eksperteve Prof. Dr.... Mrs.cs... .., Mrs.cs. Grupi i eksperteve pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha provave në shkresat e lëndës vizitës në vendin e ngjarjes analizës së rrjedhjes së aksidentit dhe konstatimit të grupit të eksperteve të komunikacionit e kanë dhënë këtë përfundim:

Aksidenti ka ndodhur kur drejtuesi i veturës "M.", duke lëvizur rrugës "...", në S., në drejtim të rrugës "...", në momentin kur ka mbërritur në udhëkryq është goditur nga saja me fëmijë e cila ka trupuar rrugën nga ana e majtë në të djathtë të drejtimit të lëvizjes së veturës, rrugës "...", në drejtim të qendrës së qytetit. Lëndime trupore të rënda ka pësuar i miturit M. Xh. i ulur në saj bashkë me një të mitur tjetër. Shpejtësia e lëvizjes së sajës ka qenë rreth 33 km/h në çastin e goditjes ndërsa vetura M., ka qenë nën 40km/h sjellja e drejtuesit të veturës është në suaza normale të pjesëmarrësit në komunikacion ndërsa drejtuesi i sajës i mitur M. Xh. është në kundërshtim me rregullat në

komunikacion si pjesëmarrjen në rrugë ashtu edhe sjellja i ka kontribuar aksident në komunikacion. Në bazë të kësaj që është thënë më lartë është konstatuar se drejtuesi i sajës ka bërë lëshime primare. Të cilat kanë kontribuar në aksidentin e komunikacionit që janë: ka rrëshqitur natën me saj në rrugë publike e paraparë për trafik publik të pjesëmarrësve në komunikacion, nuk i ka dhënë përparësi kalimi automjetit i cili ka pasur të drejtën për kalim duke e goditur, nuk e ka përshtatur shpejtësinë e ngasjes së sajës rrugës dhe kushtet të natës në rastin e paraqitjes së pengesës në rrugë-automjeti i cili ka pasur përparësi kalimi. Gjykata i ka vlerësuar ekspertizat e komunikacionit dhe ekspertizës së grupit të eksperteve i ka dhënë bindje të plotë si prova të besueshme ngase ekspertet me argumente të bazuara, profesionale dhe shkencore kanë vërtetuar gjendjen faktike duke i eliminuar të gjitha dilemat për rrethanat faktorët që kanë ndikuar në aksident të trafikut dhe objektivisht është konstatuar kontributi i pjesëmarrësve në shkaktimin e tij, prandaj ekspertizën e grupit të eksperteve gjykata e ka marr si provë vendimtare sa i përket gjendjes faktike se si ka ndodhur aksidenti i trafikut ku është caktuar kontributi primarë i paditësit dhe sekondarë i të siguarit të paditurës.

11. Sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjekësorë Dr... .. ortoped-tramatolog paditësi në aksident të trafikut ka pësuar lëndim trupor thyerje e kockës së kofshës së djathtë e trajtuar me operacion, thyerje e nëngjurit të djathtë e trajtuar me operacion. Si pasojë e këtyre lëndimeve trupore ka qenë i hospitalizuar për trajtim kirurgjik në klinikën e Ortopedisë në QKUK, nga data 03.02.2010 deri më datë 17.02.2010. Si pasojë e këtyre lëndimeve të natyrës së rëndë trupore paditësi ka përjetuar dhimbje fizike trupore të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 1 orë 20 minuta, duke marr parasysh llojin e lëndimeve trupore, dhënien e ndihmës së parë, mënyrën e transportit dhe mënyrën e mobilizimit. Dhimbjet fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 72 ore ose 3 ditë duke marrë parasysh lëndimet trupore të përcjellura me thyerje complete të anës së djathtë-këmbës së djathtë, pjesa e femurit, ashti i kofshës se pjesa e nëngjurit. Dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 6 javë, gjatë kësaj periudhe kohore paditësi ka qenë i obliguar që të mbaj imobilizim me gips të bëhet heqja e penjëve kirurgjik përcjellja në fotografimin-rëngën, e konsolidim kockor të thyerjeve të lartpërmendura pas operacionit. Dhimbje fizike të intensitetit të ulët vazhdon të ketë edhe tani sidomos gjatë ngjitjeve nëpër shkallë. Duke marr për bazë intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, natyrën e lëndimeve trupore, si dhe

moshën e paditësit por duke vlerësuar edhe përgjegjësin primare në shkaktim të aksidentit është aprovuar shuma prej 2000 €. Paditësi si pasojë e lëndimeve trupore ka zvogëlim të aktivitetet të përgjithshëm jetësor të shprehur në shkallen 14.5% e bazuar në kapitullin 3 pika 2.3 dhe nënpika (b) që konsiston në lëvizshmërinë e zvogëluar në shkallë të mesme të nëngjurit krahasuar me këmbën e shëndoshë, që paraqet lëvizshmërinë e zvogëluar në shkallë të lehtë të njëjës së zotit të këmbës së djathtë pas lëndimeve traumatike bazuar në kapitullin 3 pika 2.4. nën pika 2.4.3 nën (a), dhe ky zvogëlim është i përhershëm. Duke marrë për bazë shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor, moshën e paditësit është e natyrshme që përjeton dhimbje shpirtërore sa herë që i ndien këtë zvogëlim të aktivitetit jetësor me kufizime në lëvizshmëri të shprehura në aktivitete jetësore, aktivitete sportive, rekreative dhe për këtë gjykata e ka aprovuar shumën prej 6,000 €, duke marrë për bazë edhe kriteret tjera që u përmenden më lartë. Tek paditësi ka mbetë shëmtim truporë i shkallës së mesme, për shkak të plagëve post operative në regjionin e kofshës së djathtë të cilat janë afër gjurit në gjatësi prej 15 cm, dhe gjerësi prej 10 mm për shkak të 2 operacioneve të domosdoshme, si dhe shenjës post operative në regjionin e njëjës së zotit të këmbës së djathtë dhe pjesës së poshtme të nëngjurit të djathtë po ashtu post operatore si pasojë e thyerjes së asaj pjese. Për këtë formë të dëmit gjykata e ka aprovuar shumën prej 1,200 €, sepse paditësi do të përjetoj dhimbje shpirtërore sa herë që vesh pantallona të shkurtë, gjatë aktiviteteve sportive, rreztjes në det, sepse plagët janë të dukshme dhe është e natyrshme që nuk ndihet mirë në mesin shoqëror dhe përjeton dhimbje shpirtërore. Paditësi në momentin e aksidentit ka përjetuar frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekondash pasiqë i njëjti e ka parë veturën duke ju afruar me drita të ndezura. Kjo frikë është përcjellë me ndjenjën se tani ka përfunduar gjithçka dhe se ky është fundi i jetës së tij. Frika sekondare e intensitet të lartë ka zgjatë 6 orë kohë e nevojshme për të marrë ndihmën e parë dhe për të vazhduar trajtimin në QE, në Prishtinë duke ju nënshtruar procedurave për operimin e tij. Kjo frikë është manifestuar në formë të konfuzionit, brengës për paraqitjen e pasojave se mos po mbetet i palëvizshëm. Frika sekondare e intensitet të mesëm ka zgjatë 4 muaj e manifestuar me vështirësi rreth adoptimit më kushte të reja për shkak të lëndimeve të kufizuara nga imobilizimi në pengesa gjatë aktivitetit ditorë duke i shkaktuar ankth, pagjumësi, dridhje të trupit etj. Frika sekondare e intensitetit të ulët vazhdon edhe sot siç deklaroi edhe vet paditësi e cila është e herë pas herë që shkaktonte nervoz të paqëndrueshmërisë emocionale. Duke marrë për bazë intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës dhe rrethanat tjera për rastin konkretë, gjykata e ka aprovuar shumën prej 1,500

€, e cila është e përfaqshme me dëmin e pësuar duke marrë për bazë të gjitha kriteret vlerësuese. Për ndihmën dhe kujdesin e huaj në kohëzgjatje prej 5 javë gjykata e ka aprovuar shumën prej 200 €, në bazë të pagës mesatare në Kosovë nga fakti se ka qenë e nevojshme kjo ndihmë për aktivitetet të përditshme jetësore siç janë ushqimi, veshmbathja, mbajtja e higjienës personale dhe dhënia e ndihmës gjatë trajtimit mjekësorë. Për ushqimin e përforcuar që ka qenë i nevojshëm për 4 javë i pasur me minerale, proteina dhe vitamina në raport me ushqimin e rëndomtë për konsolidim më të shpejtë të lëndimeve të pësuar është aprovuar shuma prej 280 €, në bazë të shujtës ditore prej 10 €, për në ditë.

12. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 154, 178, 195, 200 të LMD-së. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 449 dhe 452 paragrafi 2 të LPK-së. Për kamatë ligjore ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së.
13. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.4678/20, të datës 14.09.2023, ka vendosur që ta aprovoj ankesën e të paditurës dhe ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.
14. Në arsyetim të aktgjykimit Gjykata e Apelit ka theksuar se nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Për kundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, dhe mënyra e vendosjes nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e

shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.
2. Pasi që në revizion pretendimet e paditësit janë vetëm në raport me refuzimin e kërkesëpadisë për shkak të parashkrimit të kërkesës, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë në kontestet që kanë të bëjnë me parashkrimin e kërkesës lidhur me kompensimin e dëmit, gjykata i shqyrton gjithëherë sipas prapësimit të palës, prandaj në këtë rast e paditura, ka paraqitur pretendim lidhur me parashkrimin e kërkesës ndaj saj, me pretendimin se ka kaluar afati i parashkrimit, ndërsa gjykata e shkallës së dytë gabimisht e ka vlerësuar këtë fakt dhe ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar.
3. Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar me kujdes pretendimet e paditësit të paraqitura në revizion, dhe të njëjtat janë të bazuara, për faktin se afatet e përcaktuara me nenin 376 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 377 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), janë afate të përcaktuara, dhe të njëjtat afate nuk mund të zgjaten dhe as të shtyhen, dhe se në rast të kalimit të afatit, kërkesa arrin parashkrimin, ndërsa gjykata sipas prapësimit të palës e vlerëson nëse kërkesa është e parashkruar ose jo, e që në këtë rast gjykatat e instancave më të ulëta nuk e kanë vërtetuar saktë faktin nëse kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, për arsye se:

Me nenin 376 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet prë tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe

për personin që e ka bërë dëmin”, ndërsa në paragrafin 2, përcaktohet se: “Sidoçoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi”.

4. Me nenin 377 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”.
5. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, tani për tani nuk mund të pranohet përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, për faktin se të njëjtat nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me faktet vendimtare rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, për arsye se: në këtë rast gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk e kanë vërtetuar faktin nëse kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesëpadisë së paditësit. Gjykatat e instancave më të ulëta nuk e kanë vërtetuar faktin nëse ndaj shkaktarit të aksidentit është iniciuar procedurë penale ose jo. Në shkresat e lëndës kemi vetëm një aktvendim të lëshuar nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1060/2012 të datës 10.09.2015, me të cilin është angazhuar eksperti i komunikacionit ing., që të bëjë ekspertizën e komunikacionit i cili ka të bëjë me raportin me shkresat e tjera përcjellëse, nr.2010 – BR-066, në drejtim të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, mirëpo nuk kemi të dhëna tjera nëse është vazhduar më tutje me procedurë penale ose jo. Nga ky aktvendim nuk mund të konstatohet fakti nëse është filluar procedurë penale dhe nëse është filluar në cilën fazë të procedurës gjendet. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nëse kemi inicim të procedurës penale dhe ende nuk kemi ndonjë aktgjykim të formës së prerë lidhur me këtë çështje, atëherë për parashkrimin e kërkesës së paditësit vlejné dispozitat e parashkrimit të veprës penale, ashtu siç është paraparë me dispozitën ligjore nga neni 358 të LMD-së, ndërsa nëse gjykata e shkallës së parë vërteton faktin se nuk kemi fare inicim të procedurës penale, ose kemi ndonjë vendim të formës së prerë, atëherë duhet të veprojmë konform dispozitave të LMD-së, të cekura më lartë, sepse është determinuese për gjykatën të konstatojmë nëse pala e dëmtuar është në njohuri për dëmin dhe shkaktarin e dëmit dhe si pasojë e mos veprimit në këtë drejtim, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, ku përveç të cekurave gjykata nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë

shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i kësaj ka bërë shkelje dispozitive të lartcekura të LPK-së.

6. Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, duke vlerësuar të gjitha kushtet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit dhe nëse konstaton se plotësohen kushtet për zhvillimin e shqyrtimit të caktojë seancën përgatitore apo drejtpërdrejtë të shqyrtimit kryesor (varësisht nga vlerësimi i gjykatës për nevojën e seancës përgatitore) dhe sipas propozimit të palëve, të administrojë provat për vërtetimin e fakteve vendimtare, në atë mënyrë që fillimisht, të konstatojë se në këtë rast a është kontestuese baza juridike sa i përket shkaktarit të incidentit, nëse edhe me tej mbetet kontestuese baza juridike sa i përket shkaktarit të incidentit ti marr në shikim shkresat penale nëse është e nevojshme ti kërkojë sipas detyrës zyrtare, dhe pas kësaj gjykata të ndërmerë hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.
7. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 224 paragraf 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.21/24, i datës 08.02.2024

”Për të pasur sukses në kërkesëpadinë, pala paditëse është dashur që të argumentoi se: vendosja e trafostacionit, ia pamundëson shfrytëzimin e paluajtshmërisë dhe paraqet rrezik për jetën e njerëzve dhe gjësendeve në rrethinën e saj, nga tensioni i lartë i energjisë elektrike, mirëpo paditësit nuk kanë arritur të argumentojnë se gjendja teknike e trafostacionit është jo e mirë dhe vendosja e tij paraqet rrezik për jetën e njerëzve dhe për gjësendet në rrethinën e tij dhe se mbrojta e trafostacionit nga aspekti teknik dhe teknologjik nuk është realizuar sipas normave dhe standardeve të pranuar për mbrojtjen e një trafostacioni dhe faktin se trafostacioni është vendosur pasi që paditësit janë bërë pronar të pronës në të cilën gjendet trafostacioni“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.408/2008, të datës 20.05.2019, është vendosur: I. Refuzohet kërkesëpadia e paditësve Sh. V., F. V., si dhe A. V., të tre nga Gj., me të cilën kanë kërkuar që të detyrohen të paditurat K. E. e K. sh.a. (...), D. i F. në Gj. dhe K. K. për D. dhe F. me E. E. sh.a., (...), me seli në P., t’ia kthej në posedim paditësve pjesën e ngastrës së tyre kadastrale nr. ... ZK – Gj., në anën veriore, në atë mënyrë që të mënjanoj trafostacionin elektrik ..., i cili është i ndërtuar në ... e objektit të ..., në paluajtshmërinë e paditësve, e në mënyrë që paditësve tu krijohet mundësia e qarkullimit të lirë dhe të natyrshëm ndërmjet paluajtshmërisë së paditësve dhe rrugës publike, e cila lidhje ka ekzistuar gjithnjë deri në vendosjen e TS-it, nga ana e të paditurve në pjesën e paluajtshmërisë së paditësve. Detyrohen të paditurat ... dhe ..., që të dyja me seli në P. që paditësve në emër të kompensimit për shfrytëzimin e pabazë të pjesës së ngastrës kadastrale . ZK – Gj. – Q., e cila është pronë e paditësve, t’ia paguaj kompensimin në shumë prej ... €, me kamatë përkatëse ligjore duke llogaritur nga dita e vendosjes së ST-it, në pronën e paditësve e deri në momentin e mënjanimit të tillë nga kjo paluajtshmëri”, në tërësi si e pabazuar. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.
2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3444/19, të datës 27.09.2023, është vendosur: Refuzohet si e pathemeltë ankesa e paditësve Sh. V., F. V. dhe A. V.,

të gjithë nga Gj., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithëshem C.nr.408/2008, i datës 20.05.2019, vërtetohet.

3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor kanë paraqitur revizion paditësit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, të aprovoj revizionin, ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë, duke aprovuar në tërësi padinë e paditësve, apo që ti prishë aktgjykimet e lartcekura dhe çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje.
4. Me përgjigje në revizion e paditura e parë, ka kërkuar që revizioni i paditësve të refuzohet në tërësi i pabazuar dhe të vërtetohen aktgjykimi i shkallës së parë dhe i shkallës së dytë.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:
Revizioni i paditësve është i pabazuar.
6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit më datë 11.06.2008, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi, kundër të paditurave, me të cilën kanë kërkuar kthimin e paluajtshmerisë dhe kompensimin e dëmit, duke kërkuar më saktësisht si në padi.
7. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësve, kundër të paditurave, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr...., të datës ..., me të cilin e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.
8. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: më qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka administruar këto prova: kopjen e planit e lëshuar më datën ..., fletën poseduese me nr.... të datës ... së bashku me kopjen e planit, vendimin nr. ... të datës ... të lëshuar nga Kryeministri i Kosovës, vendimin nr.... të datës ..., marrëveshjen për shërbime të përbashkëta ndërmjet ..., dhe ...,

ekspertizën e ekspertit B. M. dhe G. B. - gjeodet të datës ., si dhe plotësim ekspertizën e datës . dhe dëgjimi i ekspertëve në shqyrtim kryesor, historiatin me nr.... të datës ..., marrëveshjen për transfer - draft V2 e datës ..., marrëveshjen për shitblerjen e kapitalit aksionar të K. K. për F. dhe D. me E. E. të datës ., si dhe marrëveshjen për transfer në mes të ... dhe ..., ekspertizën e ekspertit M. Gj. ekspert i elektroteknikës e datës ... si dhe dëgjimi i të njëjtit në seancën e shqyrtimit kryesor. Ka shtuar se në rastin konkret, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv nën I, të aktgjykimit.

9. Ka theksuar se nga administrimi i provave nuk është kontestuese se paditësja e parë ..., shumë kohë më parë e ka vendosur ... kontestues, i cili..., pjesa prej ... e tij është e vendosur në parcelën me numër ... e cila evidentohet në pronësi të paditësve si dhe pjesa tjetër prej ... është e vendosur në rrugën publike. Nga administrimi i provave gjykata nuk ka mundur të vërtetojë faktin se e paditura e parë ..., në cilin vite e kishte vendosur këtë ...në vendin ku tani ekziston ky ..., kjo për faktin se paditësit në vitin ..., nga kontrata e shitblerjes me nr.leg.nr....të datës ..., janë bërë pronarë të kësaj paluajtshmërie nga shitësja M. Zh., e veja e Gj., dhe kjo vërtetohet nga historiatin me nr.... i datës ..., që do të thotë se paditësit kanë dështuar të vërtetojnë faktin se ... që është vendosur në pronën kontestuese, a është vendosur pasi që paditësit janë bërë pronarë të kësaj paluajtshmërie dhe për këtë nuk kanë ofruar as një provë të vetme gjë që sipas nenit 7.1 të LPK-së, janë të obliguar që të paraqesin prova për ti vërtetuar faktet vendimtare, dhe fakti se tani shihen se ekzistojnë disa dyer të oborrit të shtëpisë, për gjykatën nuk mund të vërtetohet faktin se trafo është vendosur pasi që paditësit kanë hyrë në posedim të paluajtshmërisë.
10. Ka theksuar se gjykata në rastin konkret nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se të gjitha asetet e energjisë elektrike, kanë qenë në pronësi të ..., këtu e paditur, kjo për faktin se Ligji nr. 03/L-184 për Energjinë i cili në nenin 24 paragrafi 1 parasheh që. “ Çdo ndërmarrje e energjisë e cila ka në pronësi, shfrytëzim (ose ka të drejtën e shfrytëzimit), operon ose ka në posedim stabilimente energjetike të vendosura në një pronë për të cilën ndërmarrja e energjisë nuk ka siguruar ose nuk i është dhënë formalisht një servitut, e drejta e shfrytëzimit ose e drejta pronësore dhe këto stabilimente energjetike janë në posedim ose shfrytëzim të ndërmarrjes së energjisë në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, atëherë kjo ndërmarrje do të ketë, përmes veprimt

të këtij ligji, të gjitha servitutet, të drejtat e shfrytëzimit dhe/ose të drejtat tjera pronësore në ose ndaj pronës përkatëse. Këto servitute, të drejta të shfrytëzimit ose të drejta pronësore u nënshtrohen kushteve të përcaktuara në këtë nen”, ndërkaq në paragrafin 2 të po të njëjtit nen, parashihet që: “ Prona në të cilën ndodhen stabilimentet energjetike përveç linjave ose tubave të transmisionit dhe shpërndarjes së energjisë do të jepet në shfrytëzim me kohëzgjatje prej nëntëdhjetë e nëntë (99) viteve që fillon nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Sipas kësaj të drejtë të shfrytëzimit, ndërmarrja përkatëse e energjisë do të ketë të drejtat në vijim”. Andaj në rastin konkret e paditura e parë KEK, sipas ligjit për Energjinë, i cili është ligj special që rregullon në mënyrë të veçantë çështjen e energjisë, kanë qenë dhe tani është e paditura e dytë ..., pronare e asetëve dhe e tokës ku janë të ndërtuara trafostacionet e energjisë dhe kjo sipas vendimeve të lartcekura.

11. Gjithashtu gjykata ka vërtetuar faktin se të gjitha asetet që kanë qenë në pronësi të ..., dhe atë asetet ... kv, si dhe transformatorët ... kv dhe ..., kanë kaluar në pronësi të ..., dhe kjo vërtetohet me vendimin e lëshuar nga Kryeministri i Kosovës Hashim Thaqi i datës 03.11.2011, i cili vendim është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga dita e nënshkrimit të këtij vendimi.
12. Gjithashtu gjykata nga administrimi i provave ka vërtetuar faktin se të gjitha asetet që kanë qenë në pronësi të të paditurës së parë ..., janë bartur në pronësi të të paditurës së dytë ..., dhe atë sipas marrëveshjes së datës ..., nga e cila marrëveshje e paditura e dytë është pronare e të gjitha asetëve dhe trafostacioneve të energjisë elektrike ku edhe trafo stacioni kontestues bënë pjesë si dhe prona në të cilën është e vendosur ky trafostacion dhe kjo vërtetohet edhe nga vendimi me nr. ... i datës ..., me të cilin vendim ndërmarrjeve të energjisë ju njihet e drejta e servitutit, shfrytëzimit ose të drejtat tjera pronësore në pronat në të cilat janë të vendosura trafo stacionet, për të cilat prona formalisht nuk kanë të siguruar të drejtën e pronës në pajtim me legjislacionin në fuqi. Andaj, në rastin konkret paditësit edhe pse formalisht janë pronar të paluajtshmerisë nr., e paditura e dytë ..., është juridikisht pronare dhe atë sipas Ligjit për Energjinë, si dhe me vendimin nr. ... të datës
13. Sa i përket kërkesës për kompensimin e paluajtshmerisë për shfrytëzimin pa të drejtë nga të paditurat, gjykata të njëjtën e refuzoi si të pa bazuar pasi që nga administrimi i

provave ka vërtetuar se të paditurat kanë qenë dhe janë pronare edhe të pjesës së parcelës nr...., në të cilën është e vendosur ... e ..., pasi që me Ligjin për Energjinë, por edhe me vendimet e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, janë pronare të paditurat dhe i bartin të gjitha të drejtat edhe në tokat ku janë të vendosura Andaj, në rastin konkret paditësit nuk e gëzojnë të drejtën e kompensimit për shfrytëzimin e paluajtshmerisë nga të paditurat, pasi që të paditurat janë në posedim dhe në pronësi të kësaj pjese të paluajshmerisë me bazë ligjore dhe jo në mënyrë arbitrare siç pretendojnë paditësit. Andaj nga të gjitha të cekurat si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

14. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 18 dhe 93 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, nenit 24 të Ligjit për Energjinë dhe nenit 7 dhe 143 të LPK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 450 të LPK-së.
15. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësit kanë paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr..., të datës ..., ka vendosur që ta refuzojë ankesën e paditësve, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka vërtetuar, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankmuar.
16. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës

materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërtëhënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decizive si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.
3. Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.
4. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e drejt, të së drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për arsye se:

Me nenin 138 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kushdo mund të kërkojë prej tjetrit që të mënjanojë burimin e rrezikut të dëmit të rëndësishëm që i kanoset atij ose numrit të pacaktuar njerëzish si dhe të përmbahet nga veprimtaritë nga të cilat rezulton trazimi ose rreziku i dëmit në qoftë se lindja e trazimit ose e dëmit nuk mund të parandalohet me masa përkatëse ”, ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “ Gjykata do të urdhërojë sipas kërkesës së personit të interesuar që të ndërmerren masat përkatëse për parandalimin e shkaktimeve të dëmit ose të shqetësimit, ose të evitohet burimi i rrezikut, me shpenzime të mbajtësit të burimit të rrezikut, në qoftë se ky vetë nuk e bën këtë ”.

5. Me neni 24 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë, përcaktohet se: “Çdo ndërmarrje e energjisë e cila ka në pronësi, shfrytëzim (ose ka të drejtën e shfrytëzimit), operon ose ka në posedim stabilimente energjetike të vendosura në një pronë për të cilën ndërmarrja e energjisë nuk ka siguruar ose nuk i është dhënë formalisht një servitut, e drejta e shfrytëzimit ose e drejta pronësore dhe këto stabilimente energjetike janë në posedim ose shfrytëzim të ndërmarrjes së energjisë në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, atëherë kjo ndërmarrje do të ketë, përmes veprimit të këtij ligji, të gjitha servitutet, të drejtat e shfrytëzimit dhe/ose të drejtat tjera pronësore në ose ndaj pronës përkatëse. Këto servitute, të drejta të shfrytëzimit ose të drejta pronësore u nënshtrohen kushteve të përcaktuara në këtë nen”, me paragrafin 9 të këtij neni, përcaktohet se: “Në bazë të kushteve të përcaktuara në paragrafin 10 të këtij neni, çdo person privat i cili konsideron se të drejtat të cilat i janë dhënë një ndërmarrje të energjisë sipas këtij neni i cenojnë të drejtat e tij/saj pronësore në atë mënyrë që mund të konsiderohet si shpronësim për të cilin duhet të paguhet kompensimi sipas Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, në çdo kohë brenda tridhjetë e gjashtë (36) muajve nga data e përmbushjes së kushteve të njoftimit për pronën e prekur sipas paragrafit 8 mund të paraqesë kërkesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, për pagimin e kompensimit nga Qeveria e Kosovës. Qeveria e Kosovës ka të drejtën e rimbursimit ose zhdëmtimit nga ndërmarrja përkatëse e energjisë për çdo kompensim të cilin gjykata kërkon të paguhet, përveç nëse një kontratë në të cilën Republika e Kosovës është palë shprehimisht përcakton ndryshe. Në rast të vendimit për pagimin e kompensimit, shumica e kompensimit do të përcaktohet në përputhje me dispozitat për kompensimin të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me atë ligj”, dhe me paragrafin 10 pika 3 të këtij neni përcaktohet se “ Asnjë kompensim

sipas paragrafit 9 të këtij neni nuk do t'i paguhet një personi nëse ligji i aplikueshëm në kohën e vendosjes së stabilimenteve në pronën përkatëse ka lejuar kompensimin, mirëpo pronari ose pronarët e prekur, pa ndonjë arsye bindëse dhe të ligjshme, nuk i kanë ushtruar me kohë të drejtat e tyre ligjore për marrjen e kompensimit brenda afateve të aplikueshme ligjore, afate këto që fillojnë në datën në të cilën stabilimentet së pari janë vendosur në pronën përkatëse”.

6. Me nenin 30 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Zonat e sigurisë duhet të vendosen përreth zonat energjetike ”, me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “Brenda çfarëdo zone të sigurisë është i ndaluar ose i kufizuar ndërtimi ose ngritja e çfarëdo ndërtese apo godine, prerja e bimëve ose pemëve, ose ushtrimi i aktiviteteve që mund të paraqesin rrezik ndaj sigurisë ose veprimtarisë së pandërprerë të instalimeve energjetike, sigurisë së shëndetit, jetës dhe pronës”, dhe me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “ Kushtet dhe mënyra e përcaktimit të lokacionit, madhësia, kufijtë e zonave të sigurisë, rregullimi i tyre si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve përcaktohen me akt nënligjor që miratohet nga Ministria”.
7. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë dhe shkallës së dytë, me të drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale kur e kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditësve për zhvendosje të..., i cili gjendet në pjesën e ngastrës kadastrale nr. ...ZK. ... ,..., i cili është i ndërtuar në .. e objektit të ..., në paluajtshmërinë e paditësve, për shkak të pamundësisë për shfrytëzimin e paluajtshmerisë dhe rrezikut nga tensioni i lartë i energjisë elektrike, për arsye se paditësit me asnjë provë të vetme nuk e kanë argumentuar faktin se ... si i tillë paraqet rrezik për jetën e njerëzve dhe gjësendeve në rrethinën e saj, gjithashtu nga provat që gjenden në shkresat e lëndës paditësit nuk ka mundur të vërtetojnë faktin se e paditura e parë ..., e kishte vendosur këtë... në vendin ku tani ekziston pasi që paditësit janë bërë pronar i pronës kontestuese, kjo për faktin se paditësit në vitin ... nga kontrata e shitblerjes me nr. leg.nr. ... të datës ... janë bërë pronarë të kësaj paluajtshmërie nga shitësja M. Zh., e veja e Gj., dhe kjo vërtetohet nga historiatit me nr. ... i datës ..., që do të thotë se paditësit kanë dështuar të vërtetojnë faktin se ... që është vendosur në pronën kontestuese, a është vendosur pasi që paditësit janë bërë pronarë të kësaj paluajtshmërie dhe për këtë nuk kanë ofruar as një provë të vetme. Gjithashtu paditësit me asnjë provë nuk e kanë vërtetuar faktin se të njëjtëve iu

pamundësohet kyçja në rrugë publike, e që për gjykatën një pretendim i tillë është i pa mbështetur në prova dhe i pa argumentuar, sepse ...i ka një kohë të gjatë i cili është i vendosur në pronën kontestuese dhe se paditësit nuk kanë paraqitur ndonjë kërkesë për pengim posedim, apo ndonjë kërkesë për masë të sigurisë, për ta kontestuar vendosjen e ..., të njëjtit vetëm në vitin ..., kanë paraqitur padi me pretendimin se vendosja e ... ia pamundëson kyçjen në rrugë publike, e që një gjë të tillë nuk kanë arritur me asnjë provë bindëse t'ia argumentojnë gjykatës.

8. Në raport me kërkesën për kompensimin e dëmit lidhur me shfrytëzimin e paluajtshmërisë pa të drejtë nga e paditura, Gjykata Supreme vlerëson si të drejtë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, për faktin se nga administrimi i provave ka vërtetuar se të paditurat kanë qenë dhe janë pronare edhe të pjesës së parcelës nr. ... në të cilën është e vendosur ... e ..., pasi që me Ligjin për Energjinë, por edhe me vendimet e Kryeministrit të Republikës së Kosovës janë pronare të paditurat dhe i bartin të gjitha të drejtat edhe në tokat ku janë të vendosura trafo stacionet, e që rrjedhimisht kërkesa për kompensimin e dëmit sa i përket kësaj pjese është e pa bazuar.
9. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, paditësit në këtë rast nuk kanë arritur ti vërtetojnë faktet mbi të cilat e mbështetin kërkesën e vet edhe pse kjo ka qenë detyrë e tyre, në kuptim të nenit 322 paragrafi 1 dhe 2, e lidhur me neni 7 paragrafi 1 dhe 319 paragrafi 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: “Gjykata është e autorizuar ti vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuara në nenin 3 paragraf 3 të këtij ligji) në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe”.
10. Për të pasur sukses në kërkesëpadinë, pala paditëse është dashur që të argumentoi se: vendosja e trafostacionit, ia pamundëson shfrytëzimin e paluajtshmërisë dhe paraqet rrezik për jetën e njerëzve dhe gjësendeve në rrethinën e saj, nga tensioni i lartë i energjisë elektrike, mirëpo paditësi nuk ka arritur të argumentojnë se gjendja teknike e trafostacionit është jo e mirë dhe vendosja e tij paraqet rrezik për jetën e njerëzve dhe për gjësendet në rrethinën e saj dhe se mbrojta e trafostacionit nga aspekti teknik dhe

teknologjik nuk është realizuar sipas normave dhe standardeve të pranura për mbrojtjen e një trafostacioni dhe faktin se trafostacioni është vendosur pasi që paditësit janë bërë pronar të pronës në të cilën gjendet trafostacioni.

11. Në këtë kuptim pretendimi i palës paditëse se në këtë rast i takon e drejta për të kërkuar zhvendosjen e trafostacionit, si i tillë është i pabazuar, për çka edhe Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpapia e paditësve është në tërësi e pabazuar dhe se pretendimi i paditësve se vendosja e trafostacionit paraqet pengesë dhe rrezik për jetën e njerëzve dhe gjësendeve në rrethinën e saj dhe se e njëjta iu paraqet pengesë për kyçje të pa penguar në rrugë publike, mbetet vetëm supozim.
12. Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga paditësit nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.
13. Gjykata Supreme, e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimi të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.
14. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.92/24, i datës 21.05.2024

”Për të pasur sukses në kërkesëpadinë pala paditëse është dashur që të argumentoi me prova se janë pronar të paluajtshmërisë, në këtë rast të paluajtshmërisë kontestuese, çka nuk kanë arritur të argumentojnë se paraardhësi juridik i tyre, nuk ka lidhur kontratë verbale me paraardhësin e të paditurve dhe se nuk është paguar çmimi i kontraktuar për të njëjtën paluajtshmëri, përkundrazi nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, e sidomos nga dëshmitë e dëshmitarëve është sqaruar në mënyrë të qartë dhe të drejtë se paraardhësi i të paditurve paluajtshmerinë kontestuese e ka blerë nga paraardhësi i paditësve, për të cilën paluajtshmëri e ka paguar çmimin e kontraktuar, për më tepër në shkresat e lëndës shihet se të paditurit janë bashkëpronar me nga 1/2 pjesë ideale të paluajtshmërisë kontestuese të regjistruar në regjistrat kadastral, dhe nga viti ...e deri me tani, fillimisht paraardhësi juridik i tyre e pastaj këtu të paditurit paluajtshmerinë kontestuese e kanë pasur në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar nga askush, me bindje të thellë se prona është e tyre, dhe në këtë paluajtshmëri kanë të ndërtuara shtëpi të banimit dhe objekte ndihmëse“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.618/16, të datës 19.11.2018, është vendosur: I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve I. S. H. dhe R. S. H., ndaj të paditurve R. M. Sh. dhe Sh. M. A., për njohjen dhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë për ngastrën kadastrale. nr...., ..., .., ..., ... dhe ..., ZK D., me kulturë, arë, pemishte, kopshte, shtëpi dhe oborr, të regjistruara si bashkëpronar për nga 1/2 e pjesës ideale në emër të R./M. S.i, sipas certifikatës nga lënda nr...., e lëshuar më datë 24.05.2016, nga DGJKP, në Gj. dhe në emër të Sh. M. A., sipas certifikatës nga lënda nr...., e lëshuar më datë 24.05.2016, nga DGJKP, në Gj.. II. Detyrohen, paditësit në mënyrë proporcionale t’ia kompensojnë të paditurve, shpenzimet e procedurës dhe atë për hartimin e përgjigjes në padi 104 €, për 5 seanca të plota të përfaqësimit, nga 135,20 €, të llogaritura prej 766 €, të gjitha këto në lartësi prej gjithsejtë 876 €, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me vërejtje të përmbarimit të detyruar.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.347/19, të datës 28.12.2023, është vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësve R. M. Sh. dhe Sh. M. A., të dy nga fshati D., Komuna Gj., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.618/16 i datës 19.11.2018, vërtetohet.
3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor kanë paraqitur revizion paditësit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet revizioni i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr. 618/2016 të datës 19.11.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.347/19 të datës 28.12.2023, të prishen tërësisht aktgjykimet e lartcekura dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.
4. Përgjigje në revizionin e paditësve nuk ka pasur.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:
Revizioni i paditësve është i pabazuar.
6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, në gjykatën e shkallës së parë më datë 02.08.2016 kanë paraqitur padi, kundër të paditurve, me të cilën kanë kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë, duke kërkuar më saktësisht si në padi.
7. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësve, kundër të paditurve, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.618/16, të datës 19.11.2018, me të cilin e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.
8. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar këto prova: certifikatën sipas lëndës nr....., të lëshuar më datë 24.05.2016, nga DGJKP, në Gj., certifikatën sipas lëndës nr.....,

e lëshuar më datë 24.05.2016, kopjen e planit nr...., të lëshuar më datë 24.05.2016, nga DGJKP, në Gj., konstatimin me skicë të hartuar dhe orto-foto ngjyrë kolor, nga vendi i ngjarjes, i hartuar më datë 13.04.2018, prej ekspertit gjeodet, I. J., nga Gj., deklaratën nën betim prej, O. S., nga fshati D., Komuna e Gj., sipas LRP nr., të vërtetuar më datë 29.01.2018, nga Noteri, H. M., Gj., certifikatën -vërtetimin nr...., të lëshuar më datë 28.04.1955, prej Kuvendit Komunal të Popullit, në R., certifikatën - vërtetimin nr., të lëshuar më datë 10.12.1955, prej Kuvendit Komunal të Popullit, R., certifikatën - vërtetimin nr., të lëshuar më datë 17.11.1955, prej Kuvendit Komunal të Popullit, R., certifikatën - vërtetimin nr., të lëshuar më datë 17.12.1955, njoftimin, nr. ... të lëshuar më datë 13.11.2007 prej Drejtorisë Republikane Mbi Të Drejtat e Pronës, të Republikës së S., në B., njoftimin, nr., të lëshuar më datë 26.08.2014, prej Republikës së S., Agjencioni për Kthim /Restitucionit/ Njësia Regjionale B., M., të lëshuar më datë 13.11.2007, në V., referenca sipas lëndës nr., të lëshuar më datë 22.06.2018, nga DGJKP, në Gj., deklaratën nën betim prej R. Y. nga T., sipas LRP nr., të vërtetuar më datë 28.07.2018, nga Noteri, H. M., Gj., deklaratën nën betim prej A. R. nga T., sipas LRP.nr., të vërtetuar më datë 31.07.2018, nga Noteri, H. M., Gj., deklaratën nën betim prej D. D., nga T., sipas LRP nr., të vërtetuar më datë 28.07.2018, nga Noteri, H. M., Gj., konkluzionin - vendimin, nr., të lëshuar më datë 14.04.2012 dhe datë 12.06.2014, prej Republikës së S., Agjencioni për Kthim /Restitucionit, Njësia Regjionale B., aplikacioni i Agjencisë Restitucionit të Republikës së S., sipas nr. ...-Urgjent/shumë urgjent/, i ushtruar më datë 16.07.2014, nga Ministria e Punëve të Jashtme, Ambasada B.

9. Ka shtuar se gjykata pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, dëshmitarëve, ekspertit gjeodet dhe administrimit të gjitha provave në hollësi veç e veç nga lënda, e ka konstatuar gjendjen faktike dhe ka arritur qëndrimin juridik se paditësit me as një provë valide nuk e kanë vërtetuar themelësinë e kërkesëpadisë, ata vetë kanë konfirmuar se nëna e tyre dhe babai e kanë shitur pasurinë, kinse nuk iu është paguar nga blerësi i atëhershëm, ndërsa nuk kanë pasur prova se ndonjëherë nga viti ... e deri më tani, ta kenë paguar tatimin në pronë, me çka vërtetohet se nuk e kishin pasur në shfrytëzim pasurinë e tyre mbi 60 vite, dhe e kishin shkëputur në tërësi kujdesin dhe lidhjen me pronën e tyre. Se pasuria kontestuese ishte pronë e të paditurve në shfrytëzim dhe e regjistruar në emër të tyre dhe të paditurit kanë ndërtuar shtëpitë e tyre dhe objektet përcjellëse, që banonin me familjet e tyre mbi 60 vite të pa penguar nga shitësi i atëhershëm, familja e tyre apo

megjenikët - paditësit dhe paraardhësi i tyre nga viti 1955 deri në vitin 2016 asnjëherë nuk kishin ushtruar padi për pengim posedimi, kthim të pasurisë, kompensim apo vërtetimin e pronësisë. Se të gjithë dëshmitarët dhe palët ndërgjyqëse në mënyrë të drejtpërsëdrejti apo tërthorazi e kanë konfirmuar rrethanën se në mes S. R. në cilësi të shitësit dhe M. Sh., ishte lidhur kontrata për shitblerjen e pasurisë së palaujtëshme për çmimin kontraktues në lartësi prej 175,000 dinar, ndërsa në mes të palëve në tërësi ishin përmbushur detyrimet kontraktuese, me çka gjykata në mënyrë të plotë ka vërtetuar se ka ekzistuar raporti materialo - juridik në mes palëve. Në bazë të certifikatave nr. ..., të lëshuara në vitin 1955, nga Kuvendi Popullor në R., S. R. e ka shitur pasurinë e palaujtshme dhe ka realizuar shumën e parave për shkuarje dhe shpërngulje në Turqi.

10. Gjykata nuk ka mundur ta vërtetoi faktin se S. R. ishte shpërngulur në T. nga dhuna dhe presioni pushteti të atëhershëm serb të ushtruar nga Aleksandër Rankoviqi, nuk iu kishte marr toka me dhunë nga shteti apo personat tjerë fizik, nuk ishte vërtetuar rrethana kinse në shtëpinë e tyre është gjetur mitroloz, allti, shpata, e armatim nën stogun e sanës, kjo rrethanë e treguar nga të paditurit nuk është vërtetuar me as një provë apo dëshmitarë. Se deklaratat e paditësve dhe dëshmitarëve të tyre të propozuar, ishin jo bindëse të pa qëndrueshme dhe të pabazuara në prova dhe pjesërisht ishin kundërtshënës në mes veti, ndërsa deklaratat e paditësve dhe dëshmitarëve të tyre ishin të bazuar dhe vërtetuar në provat përkatësisht në certifikatat - vërtetimet e lëshuara nga Kuvendi Popullor i Komunës së R.
11. Të paditurit në as një moment nuk kanë mundur ta kundërshtojnë as një deklaratë të dëshmitarëve të propozuar nga paditësit, gjatë ballafaqimit në seanca gjyqësore dhe në heshtje e kanë pranuar se shitblerja në mes paraardhësve të palëve kontraktuese ishte kryer dhe janë përmbushur në tërësi detyrimet kontraktuese në mes palëve të atëhershme kontraktuese. Se disa nga palët ndërgjyqëse dhe dëshmitarët kanë pohuar tërthorazi se në mes kontraktuesve të atëhershëm kishte ekzistuar një kontratë e shitblerjes me shkrim por ajo tani është humbur apo asgjësuar si pasojë e mos ruajtjes së sajë. Lidhur me këtë gjykata konstatoi se paditësit me as një provë valide nuk ka mundur ta vërtetojnë themelësinë e kërkesëpadisë dhe për këtë gjykata në mungesë të provave e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të pabazuar.

12. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 73 të Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe nenit 43 të LPK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 të LPK-së.
13. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësit kanë paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.347/19, të datës 28.12.2023, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e paditësve, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka vërtetuar.
14. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se dhe qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkeljet e procedurës kontestimore të cilat janë pretenduar me ankesë. Aktgjykimi nuk është i përfshirë as në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.
2. Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182

paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara.

3. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërtshënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale dhe ka rezultuar më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.
4. Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

Nga provat në shkresat e lëndës rezulton se paraardhësit e paditësve dhe të paditurve kanë pasur marrëveshje verbale për shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese në vitin 1955, për të cilën kanë qenë në dijeni edhe paditësit, mirëpo edhe përkundër kësaj prej kur paraardhësit e paditësve janë shpërngulur nga K., për të jetuar në T., të njëjtit

asnjëherë më parë deri në paraqitjen e padisë në gjykatën e shkallës së parë, as paditësit e as paraardhësit juridik i tyre, nuk kanë kërkuar realizimin e të drejtave të tyre, në procedurë gjyqësore.

6. Përveç të cekurave duhet theksuar edhe faktin se nëse i referohemi shkresave të lëndës e në veçanti ekspertizës së ekspertit gjeodet të datës ..., dhe Historiatit për parcelat kadastrale - objekt kontesti të datës ..., rezulton se: fillimisht paluajtshmeria kontestuese është regjistruar në emër të paraardhësit juridik të të paditurve në vitin ... sipas aëroinqizimit, dhe sipas regjistrimit të fletave poseduese nr..., Zona Kadastrale D., gjendja nga viti ..., parcelat kadastrale kontestuese - objekt kontesti evidentoheshin në emër të paraardhësit juridike të të paditurve, ndërsa sipas regjistrimit të ndërrimeve nr. ..., këto parcela kadastrale në bazë të aktvendimit mbi trashëgimin LRP.nr..., T.nr.... të datës 25.02.2014, bartën/regjistrohen në emër të bashkëpronarëve - këtu të paditurve R. A. dhe Sh. A. me nga 1/2 pjesë ideale.
7. Me nenin 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, përcaktohet se: “ E drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe trashëgimi si dhe në bazë të vendimit të organit shtetërorë në kushte dhe mënyrën e caktuar me ligj ”, ndërsa me nenin 37 paragraf 1 dhe 2 të këtij ligji, përcaktohet se: “ pronari mund të kërkojë në padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale, mirëpo pronari duhet të pranoi se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronës dhe se sendi gjendet nën zotërimin faktik të paditurit ”.
8. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës, qëndrimin juridik nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, e pranon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se e drejta e pronësisë është e drejtë subjektive e karakterit absolut dhe se për sendet e paluajtshme të cilat janë të regjistruara në librat kadastrale, vlen supozimi se sendi është në pronësi të personit në emër të cilit është e regjistruar, mirëpo edhe nëse paluajtshmeria nuk është e regjistruar në emër të atij, që kërkon pronësinë, në këtë rast paditësit kanë pasur detyrim ta provojnë pronësinë e tyre, por edhe të paraardhësit të tyre, deri sa mos të gjendet personi i cili pronësinë e ka fituar në ndonjërin prej mënyrave origjinare si mënyra të fitimit të pronësisë, dhe këto fakte në këtë rast, i kanë provuar të paditurit dhe jo paditësit.

9. Paditësit në këtë rast nuk kanë arritur ti vërtetojnë faktet mbi të cilat e mbështetin kërkesën e tyre edhe pse kjo ka qenë detyrë e tyre, në kuptim të nenit 322 paragrafi 1 dhe 2 e lidhur me nenin 7 paragrafi 1 dhe 319 paragrafi 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: “Gjykata mund të kërkojë nxjerrjen e provave sipas detyrës zyrtare, për vërtetimin e fakteve edhe pse palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse ato prova po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht të përcaktuara në kuptim të nenit 3 paragraf 3 të LPK-së”.
10. Për të pasur sukses në kërkesëpadinë pala paditëse është dashur që të argumentoi me prova se janë pronar të paluajtshmërisë, në këtë rast të paluajtshmërisë kontestuese, çka nuk kanë arritur të argumentojnë se paraardhësi juridik i tyre, nuk ka lidhur kontratë verbale me paraardhësin e të paditurve dhe se nuk është paguar çmimi i kontraktuar për të njëjtën paluajtshmëri, përkundrazi nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, e sidomos nga dëshmitë e dëshmitarëve është sqaruar në mënyrë të qartë dhe të drejtë se paraardhësi i të paditurve paluajtshmerinë kontestuese e ka blerë nga paraardhësi i paditësve, për të cilën paluajtshmëri e ka paguar çmimin e kontraktuar, për më tepër në shkresat e lëndës shihet se të paditurit janë bashkëpronar me nga 1/2 pjesë ideale të paluajtshmërisë kontestuese të regjistruar në regjistrat kadastral, dhe nga viti ...e deri me tani, fillimisht paraardhësi juridik i tyre e pastaj këtu të paditurit paluajtshmerinë kontestuese e kanë pasur në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar nga askush (si paraardhësi juridik i paditësve, këtu paditësve apo pretendim nga person të tretë), me bindje të thellë se prona është e tyre, dhe në këtë paluajtshmëri kanë të ndërtuara shtëpi të banimit dhe objekte ndihmës të përshkruara me saktësisht si në ekspertizën e ekspertit gjeodet.
11. Gjykata Supreme, e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

12. Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga paditësit nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

13. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.94/24, i datës 21.05.2024

"Pretendimet e paraqitura në revizion se gjykata e shkallës së dytë ka vendosur gabimisht dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara, për arsye se: paditësi në këtë rast nuk ka arritur ti vërtetojë faktet mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij edhe pse kjo ka qenë detyrë e tij, në kuptim të nenit 322 paragraf 1 dhe 2 e lidhur me nenin 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare për arsye se me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se:

Gjykata mund të kërkojë nxjerrjen e provave sipas detyrës zyrtare, për vërtetimin e fakteve edhe pse palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse ato prova po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirish të përcaktuara në kuptim të nenit 3 paragraf 3 të LPK-së".

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc, C.nr.137/19 të datës 04.12.2019 është vendosur: I. Miratohet pjesa e kërkesëpadisë e paditësit F. D. nga G. si e bazuar, dhe Detyrohet e paditura Komuna e Glllogocit që paditësit në emër të rrënimt të lokaleve afariste në ngastrën ZK G. në dy etazhe ...(...) përdhese në sipërfaqe prej 109.20 m², ndërsa nën kulm në sipërfaqe prej 93,84 m² t'ia paguaj shumën prej 83.400 €, me kamatë ligjore që aplikohet si në mjetet e deponuara në bankat e Kosovës pa destinim kthimi mbi një vit llogaritur nga data 01.03.2005 e gjerë te pagesa definitive, si dhe detyrohet e paditura t'ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurës në shumën prej 2.074 €, të gjitha këto detyrime në afatin prej 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi e nën kanosjen e përmbarimit ligjor. Pjesa tjetër për shpenzime të procedurës në shumën prej 2.266 €, refuzohet e pabazuar. II. Refuzohet si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë e paditësit F. D. nga G. me të cilën ka kërkuar të detyrohet e paditura Komuna Glllogocit që në emër të fitimit të humbur, për shkak të mos shfrytëzimit të lokalit afarist të përshkruar si në pikën I, të këtij aktgjykimi ti paguaj paditësit 500 € në muaj duke llogaritur nga data 01.04.2005 deri më datë 20.11.2019 me kamat 3.5 % sipas arritjes për pagesë, e po ashtu edhe pas datës 20.11.2019 deri me pagimin e shumës nga pika I, e dispozitivit.

2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.394/2020, të datës 28.12.2023, është vendosur: I. Refuzohet e pabazuar ankesa e paditësit F. D. nga G., ndërsa pika e II, e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc C.nr.137/19 i datës 04.12.2019, vërtetohet. II. Aprovohet e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Glllogocit, ndryshohet pika e II-të, e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc, C.nr.137/19 i datës 04.12.2019 dhe çështja kontestuese gjykohet si vijon refuzohet si e papabazuar kërkesëpadia e paditësit F. D. nga G. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të rrënimt të lokaleve afariste në ngastrën ... ZK G. në dy etazhe ...(...) përdhese në sipërfaqe prej 109.20 m², ndërsa nënkulmi në sipërfaqe prej 93,84 m², ti paguaj shumën prej 83.400 €, me kamatë ligjore që aplikohet si në mjetet e deponuara në bankat e Kosovës pa destinim kthimi mbi një vit llogaritur nga data 01.03.2005 e gjerë te pagesa definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 2.074 €. Të gjitha këto detyrime në afatin prej 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi e nën kanosjen e përmbarimit ligjor.
3. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e revizionit aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës ta ndryshojë dhe të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, ose të njëjtin aktgjykim ta prish dhe lëndën ta kthej në rivendosje.
4. E paditura me përgjigje në revizion ka kërkuar që revizioni i paditësit të refuzohet si i pabazuar.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:
Revizioni i paditësit është i pabazuar.
6. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi në gjykatën e shkallës së parë, më datë 10.09.2009, ka paraqitur padi, kundër të paditurës, për kompensim dëmi material, duke kërkuar më saktësisht si në fjalën përfundimtare të datës 02.12.2019.

7. Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësit, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin C.nr.137/19 të datës 04.12.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht padinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.
8. Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se: duke vepruar sipas padisë së paditësit, në procedurën e provave ka administruar këto prova: aktvendimin e Këshillit Komunal ... të datës 06.05.1996, në emër të E. G., aktvendimin ... të datës 28.10.1999 në emër të E. G., lejën urbanistike ... të datës 26.09.1997, kontratën mbi shitblerjen e lidhur në mes të E. G. dhe F. D. të datës 05.12.2001, kontratën mbi qiranë e lokalit afarist të përpiluar më datë 01.02.2007, të lidhur në mes të qiradhënësit paditësit F. D. dhe qiramarrësit J. K., kontratën mbi qiranë e lokalit afarist të përpiluar më datë 26.02.2005, të lidhur në mes të paditësit në cilësinë e qiradhënësit F. D. dhe I. Z. nga K. në cilësinë e qiramarrësit, deklaratën e E. G. të datës 05.12.2001 të vërtetuar në këtë gjykatë me shenjën VR... të datës 01.04.2005, procesverbalin e kësaj gjykate në procedurën e nxjerrës së provës N.nr. ... të datës 28.02.2005, për sigurimin e provës, ekspertizën e ekspertit të ndërtimtarisë J. T. të datës 01.03.2005, aktvendimin e të paditurës nr.... të datës 03.03.2002, vendimin e të paditurës mbi anulimin e aktvendimeve për objektet të cilat përfshihen mbi bazën e zgjidhjes urbanistike të sheshit "...” ... të datës 08.03.2002, vendimin e të paditurës mbi aprovimin e bazës së rregullimit urbanistik të sheshit Skënderbeu në G. ... të datës 08.03.2002, aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A.nr.552/2005 të datës 17.05.2006, aktvendimin e të paditurës nr. ... të datës 14.04.2005, vendimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Qeverisë së Kosovës nr. ... të datës 20.08.2005, si dhe deklaratën e dëshmitarit E. G. të dhënë në procesverbalin e datës 20.11.2019, dhe pas vlerësimit të tyre ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.
9. Ka shtuar se e paditura me aktvendimin e Këshillit Komunal ... nr. ... të datës 06.05.1996 dhe aktit të lejes urbanistike - Drejtorisë për Urbanizëm ... të datës 26.09.1997, E. G. i ka dhënë në shfrytëzim të përhershëm tokën ndërtimore për ndërtim të lokalit afarist në vendin e quajtur "...” në lokacionin nr...., në parcelën nr.... në sipërfaqe prej 110 m², e evidentuar në fletën poseduese nr.... ZK G., me kompensim për shfrytëzim të tokës ndërtimore në shumën prej 22.000 dinarë. E paditura me aktin e lejes urbanistike i ka

aktuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta tekniko - urbanistike, për ndërtim të objektit - lokalit afarist me dimensione gabarite të objektit ... m, në etazh ... (...), E. G. sipas aktvendimit të Këshillit Komunal të paditurës ...të datës 06.05.1996 dhe lejes urbanistike të paditurës Drejtorisë për Urbanizëm ... të datës 26.09.1997, në vjeshtë të vitit 1997, ka ndërtuar lokalin afarist ndërsa për shkak të kushteve atmosferike sezonës dimërore ka vazhduar punimet në pranverën e vitit 1998, ku ka vendosur kulmin e objektit dhe ka bërë meremetimin e tij përkatësisht ka përfunduar objektin në tërësi të cilën e ka aftësuar për ushtrim të veprimtarisë së pavarur, më datë 05.12.2001 i ka shitur këtë lokal afarist paditësit F. D. sipas kontratës së shitblerjes në çmimin prej 40.000 DM, ndërsa nga deklarata E. G. të dhënë në shqyrtimin kryesor në cilësi të dëshmitarit u vërtetua se E. nga paditësi F. D. ka pranuar në emër të shitblerjes 40.000 Dollar Amerikan në emër të 40.000 DM, pasi që paditësi ishte duke punuar dhe jetuar në A.

10. Meqenëse është vërtetuar se paditësi F. D. ka paguar në tërësi çmimin e shitblerjes E. G. në vitin 2001, dhe paditësi ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim të lokalit afarist fakt i vërtetuar nga dëshmia e E. G. të dhënë në shqyrtimin kryesor në cilësinë e dëshmitarit dhe nga deklarata e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gllgoc të datës 01.04.2005 me shenjën Vr.nr. ..., si dhe në bazë të procesverbalit të Gjykatës Komunale në Gllgoc N.nr. ... të datës 28.02.2005.
11. Sipas propozimit të paditësit F. D. për sigurimin e provës me rastin e daljes së gjykatës në vendshikim së bashku me ekspertin e ndërtimtarisë është vërtetuar se lokali i cili është objekt shqyrtimi lëndor ka qenë funksional me të cilin janë ushtruar veprimtari të pavarura në bazë të kontratave mbi qiranë të dhëna nga paditësi me ç ‘rast me vet faktin e vërtetuar se paditësi ka përbushur detyrimin në tërësi për shitblerjen e lokalit dhe ka qenë në posedim dhe shfrytëzim të tij, para se të rrënohet lokali nga e paditura.
12. Kontrata për shitblerje komform nenit 73 të LMD-së, është bërë e plotfuqishme përkatësisht ka prodhuar efekt juridik dhe nga ky fakt paditësi ka legjitimitetin aktiv në këtë çështje për kompensimin e dëmit material, për rrënimin e lokalit afarist të cilin ka pasur në posedim dhe shfrytëzim kur e paditura i ka rrënuar, për lirim të tokës ndërtimore, për ndërtim të sheshit “Skënderbeu”, pa i kompensuar paditësit lokalin e ndërtuar në tokën ndërtimore urbane me shfrytëzim të përhershme, pa përfunduar definitivisht procedura administrative sipas padisë në konfliktin administrative në

Gjykatën Supreme të Kosovës sipas aktgjykimit A.nr.552/05 të datës 17.05.2006, me rastin e rrënimt të lokalit nga e paditura paditësi ka pësuar dëme material në lartësinë e gjykuar si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi i cili deri më tani nuk i është kompensuar.

13. Sa i përket lartësisë së dëmit të gjykuar si në pikën I, të dispozitivit për të cilin është detyruar e paditura ti paguaj paditësit, gjykata është bazuar në ekspertizën e ekspertit të ndërtimtarisë J. T. e siguruar sipas aktvendimit të gjykatës në sigurimin e provave me shenjën ... të datës 28.05.2005, të cilën ekspertizë në formën me shkrim e ka dorëzuar në gjykatë më datë 01.03.2005, eksperti lokalin afarist që është objekt shqyrtimi lëndor ka vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 83.400 €, duke pasur për bazë të gjithë parametrat e nevojshëm të cilin konstatim dhe mendim të ekspertit gjykata pas vlerësimit dhe analizimit i dhuroj besimin e plotë dhe aprovojë në tërësi nga fakti se ishte i argumentuar dhe bindës për gjykatën nga se gjendja e objektit është konstatuar edhe me rastin e daljes së gjykatës në vendshikim së bashku me ekspertin me rastin e sigurimit të provës i cili objekt ka qenë i ndërtuar me normat dhe rregullat standarde të ndërtimtarisë e që konsiston në vlerësimin e specifikuar për të gjitha pozicionet i cili vlerësim është bërë në pajtim me nenin 189 al. II, të LMD-së, e duke vlerësuar se kjo shumë si në ekspertizë i përgjigjet këtij dëmi që gjendja materiale e paditësit të sillet ku ka qenë po mos të kishte veprim dëmtues nga e paditura, e drejta e paditësit në kompensim në të holla është bazuar në nenin 185 al. IV, të LMD-së, ndërsa kamata për pjesën e gjykuar të kompensimit është e bazuar në nenin 277 të LMD-së.
14. Gjykata e shkallës së parë pas analizimit dhe vlerësimit të provave të administruara dhe pretendimeve të paditësit, për kërkesëpadinë me të cilën ka kërkuar të detyrohet e paditura Komuna Glllogoc, që në emër të fitimit të humbur për shkak të mos shfrytëzimit të lokalit afarist të përshkruar si në pikën I, të dispozitivit t'ia paguaj paditësit 500 €, në muaj llogaritur nga data 01.04.2005 deri më datë 20.11.2019, me kamat 3.5 % sipas arritjes për pagesë, e po ashtu edhe pas datës 20.11.2019 deri me pagimin e shumës nga pika I, e dispozitivit, gjeti se është e pa argumentuar jo bindëse dhe si e tillë e ka refuzuar si të pabazuar si në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit bazuar në këto fakte, paditësi deri në përfundim të shqyrtimit kryesor nuk i ka prezantuar gjykatës provë - fletëpagesë për të argumentuar se qiradhënësi I. Z. nga K., i ka paguar qiranë mujore prej 200 € në muaj, për periudhën kohore nga data 26.02.2005 deri më datë 26.02.2007

dhe as provën marrëveshjen e posaçme për pagesën e qirasë siç është përcaktuar në nenin 5 të Kontratës mbi Qiranë e lidhur në mes të paditësit në cilësinë e qiradhënësit dhe J. K. nga T. në cilësinë e qiramarrësit për periudhën kohore nga data 01.02.2007 deri më 31.01.2008, apo provën fletëpagesën e bankës për të argumentuar kërkesëpadinë në emër të fitimit të humbur, përkatësisht se nga qiraja e këtij lokali ka realizuar të ardhura nga baza e qirasë në shumën mujore 500 € në muaj.

15. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 24 dhe 39 të Ligjit mbi Token Ndërtimore Gazeta Zyrtare KSAK-së, nr.14/80 e lidhur me nenin 9 të ligjit të njëjtë mbi ndryshimet dhe plotësimet Gazeta Zyrtare. nr. 42/86, nenit 41 dhe 87 të Ligjit mbi Ndërtimet e Objekteve Investive Gazeta Zyrtare KSAK-së, nr. 5/86, nenit 73 dhe 154 dhe 172 LMD-së, nenin 7 dhe 319 të LPK-së. Për shpenzimet e procedurës iu ka referuar nenit 451 dhe 452 të LPK-së.
16. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi dhe e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.394/2020, të datës 28.12.2023, ka vendosur që të refuzojë ankesën e paditësit ndërsa ta aprovojë ankesën e të paditurës, duke vendosur më decidivisht, si në dispozitiv të aktgjykimit.
17. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e pabazuar, për çka në këtë rast ka kushte që

aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.
2. Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërtshënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.
3. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, për arsye se:

Me nenin 17 të Ligjit për Tokën Ndërtimore, përcaktohet se: “Pronari i mëparshëm i tokës së pa ndërtuar urbane ndërtimore ka të drejtë që ta mbaj në posedim atë tokë dhe ta përdori për qëllime të lejuara, në mënyrën në të cilën nuk ndryshohet forma dhe cilësia e parcelës së tokës, gjërë në ditën kur në bazë të vendimit organi kompetent është i detyruar që t’ia dorëzojë Komunës, respektivisht shfrytëzuesit të caktuar me qëllim të përgatitjes së kësaj toke për qëllimin e paraparë. Pronari i mëparshëm mundet edhe para asaj dite t’ia dorëzojë tokën Komunës, kurse Komuna është e detyruar këtë tokë ta marrë nga pronari i mëparshëm”.

4. Me nenin 18 të të njëjtit ligj, përcaktohet se: “Pronari i përparshëm i tokës së pa ndërtuar urbane ndërtimore ka të drejtë përparësie në shfrytëzimin e kësaj toke me qëllim të ndërtimit të ndërtesës në të cilat sipas ligjit mund të fitojë të drejtën e pronës, në kufijtë e një parcele ndërtimore sipërfaqja e së cilës është e nevojshme për përdorimin e rregullt të ndërtesës, në qoftë se në bazë të planit të hollësishëm urbanistik në këtë tokë mund të ngritët ndërtesa e tillë”.
5. Me nenin 19 të të njëjtit ligj, përcaktohet se: “Të drejtat nga neni 17 dhe 18 të këtij ligji pronari i përparshëm mund ti bartë vetëm në bashkëshortin, pasardhësin, në adoptues, prindër dhe të adoptuar të cilët këto të drejta nuk mund ti bartin me veprime në personat e tjerë. Të drejtat nga alineja 1 e këtij neni mund ti trashëgojnë trashëguesit ligjor të pronarit të përparshëm, si dhe trashëguesit ligjor të bashkëshortit, pasardhësit, të adoptuarit, prindërit dhe adoptuesit, në të cilat pronari i përparshëm i ka bartur këto të drejta. Puna juridike e lidhur kundër dispozitës së alinesë 1 të këtij neni është nulë”.
6. Me nenin 23 të të njëjtit ligj, përcaktohet se: “Personi i cili realizon të drejtën e përparësisë së ndërtimit, si dhe personi i cili e fiton në shfrytëzim parcelën ndërtimore drejtpërdrejtë dhe në bazë të konkursit nuk mundet me veprim juridik ta tjetërsoj ndërtesën e pakryer, si dhe as ndërtesën e kryer, në afat prej 5 vjetëve prej ditës së dhënies së lejes për përdorimin e ndërtesës. Kontrata e lidhur në kundërshtim me dispozitën e alinesë 1 të këtij neni është nulë.
7. Me nenin 154 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit të datës 30 Mars 1978, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01 Tetor 1978, përcaktohet se: “1. Kush i shkakton tjetrit

dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.

8. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezultojnë se gjykata e shkallës së dytë, me të drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kompensimin e dëmit material të shkaktuar, me rastin e rrënimit të lokaleve afariste në ngastrën ... ZK Glllogoc në dy etazhe ... (...) përdhese në sipërfaqe prej 109.20 m², ndërsa nën kulm në sipërfaqe prej 93,84 m², si dhe në emër të fitimit të humbur, për shkak të mos shfrytëzimit të lokalit afarist të përshkruar si më lartë. Në këtë rast gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë i ka zbatuar dispozitat e lartcekura, e njëjta ka bërë në mënyrë të drejtë vlerësimin e provave materiale dhe pretendimet e paditësit sipas padisë mirëpo të njëjtat nuk kanë pasur bazë që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar.
9. Në raport me pretendimet në revizion se e paditura ka rrënuar objektin pa ndonjë vendim të plotfuqishëm, sepse Gjykata Supreme e ka detyruar organin e shkallës së dytë, përkatësisht Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, që në afat prej 30 ditësh të vendos lidhur me ankesën e paditësit, Gjykata Supreme këto pretendime i vlerëson si të pabazuar. Në këtë rast sipas Ligjit për Procedurën Administrative, organi i shkallës së dytë ka një afat të caktuar për vendosjen lidhur me ankesën, mirëpo i njëjti ligj ia mundëson palës që në rast të mos veprimi sipas ankesës nga organi i shkallës së dytë, i njëjti të veprojë sipas procedurave ligjore të cilat e rregullojnë heshtjen administrative, prandaj mosveprimi sipas mjeteve juridike në rastin e heshtjes administrative, e bënë vendimin e organit të shkallës së parë, të plotfuqishëm, prandaj një pretendim i tillë nga paditësi është në tërësi i pabazuar. Përveç te cekurave në procedurë administrative dhe në procedurën e konfliktit administrativ të cituar palë ka qenë personi E. G., e jo paditësi.
10. Në raport me pretendimet e paditësit se gjykata e shkallës së dytë gabimisht ka zbatuar dispozitat e Ligjit mbi Tokën Ndërtimore, Gjykata Supreme vlerëson se pretendimi i tillë nuk qëndron ngase me dispozitat e këtij ligji shihet qartë se fituesi i shfrytëzimit të pronës Komunale (E. G.), ka qenë i njoftuar për kushtet dhe rregullat e përfitimt të së drejtës së shfrytëzimit të tokës ndërtimore komunale për ndërtimin e lokalit afarist - tregtar dhe me të drejtat dhe detyrimet që parashihen edhe me dispozitën ligjore nga

neni 17 i Ligjit mbi Tokën Ndërtimor, të cituar më lartë, i njëjti ka qenë në dijeni se tokën të cilën e ka në shfrytëzim ka të drejtë ta mbaj në posedim dhe ta përdori për qëllime të lejuara në mënyrën që nuk e ndryshon formën dhe cilësinë e parcelës së tokës gjërë në ditën kur në bazë të vendimit të organit kompetent është i detyruar që të ia kthej në gjendjen e mëparshme në afatin që kërkon organi kompetent - dorëzoi Komunës, respektivisht shfrytëzuesit të caktuar me qëllim të përgatitjes së kësaj toke për qëllimin e paraparë dhe jo edhe të ndërtojë dhe ta bartë të personat e tjerë.

11. Prandaj paditësi në këtë rast nuk e ka të drejtën e kompensimit të dëmit në raport me të paditurën, për faktin se e paditura ka vepruar duke u mbështetur në vendimin ... të datës 03.03.2005 dhe dispozitave ligjore të lartcekura, dhe se kompensimi i dëmit paditësit nuk mund ti takoj në këtë rast ashtu siç përcaktohet, me dispozitën ligjore nga neni 154 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit të datës 30 Mars 1978, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01 Tetor 1978, për arsye se: Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën. Nga vetë përmbajtja e nenit 154 të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka detyrim t'ia shpërblejë atë. Sipas kësaj dispozite për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) që të shkaktohet dëmi; b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faji i dëmtuesit; d) që të ekzistojë aftësia delikatore dhe e) të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit. Në këtë rast nuk janë plotësuar këto parakushte ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e të paditurës, për kompensimin e dëmit, paditësit.
12. Përveç të cekurave përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë se Kontrata mbi Shitblerjen e lidhur me datë 05.12.2001, e cila nuk është vërtetuar në gjykatë komform nenit 73 të LMD-së, është bërë e plotfuqishme përkatësisht ka prodhuar efekt juridik dhe nga ky fakt paditësi ka legjitimitetin aktiv në këtë çështje për

kompensimin e dëmit material, për rrënimin e lokalit afarist të cilin ka pasur në posedim dhe shfrytëzim kur e paditura i ka rrënuar, për lirim të tokës ndërtimore, për ndërtim të sheshit “Skënderbeu”, pa i kompensuar paditësit lokalin e ndërtuar në tokën ndërtimore urbane me shfrytëzim të përhershme, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme është i gabuar për arsye se:

Me nenin 32c të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme, përcaktohet se: “Sipas kontratave të cilat në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk janë vërtetuar në gjyq nuk mund të behet bartja e drejtës së pronësisë”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se kontratat mbi qarkullimin e paluajtshmerisë (në këtë rast kontrata e shitblerjes) nuk mund të konvalidohet, për arsye se një kontratë e tillë për të krijuar efekt juridik, duhet të jetë në formën me shkrim dhe vërtetuar në gjykatë. Në këtë kontekst neni 73 i LMD-së, nuk gjënjë zbatim e nga kjo rezulton se paditësit në këtë rast i mungon legjitimiteti aktiv në kuptimin material, për arsye se e paditura në bazë të ligjit/ligjeve në fuqi nuk ka asnjë detyrim në raport me paditësin në këtë rast, për arsye se në mes të paditësit dhe të paditurës nuk ka ekzistuar e as nuk ekziston ndonjë raport juridik (raporti juridik ka ekzistuar në mes të personit E. G., i cili në këtë rast nuk është palë në këtë çështje juridiko-kontestimore dhe të paditurës).

13. Baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit nuk gjënjë mbështetje as në nenin 41 dhe 87 të Ligjit mbi Ndërtimet e Objekteve Investive Gazeta Zyrtare KSAK-së, nr. 5/86, për arsyet e theksuara me lartë.
14. Pretendimet e paraqitura në revizion se gjykata e shkallës së dytë ka vendosur gabimisht dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara, për arsye se: paditësi në këtë rast nuk ka arritur ti vërtetojë faktet mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij edhe pse kjo ka qenë detyrë e tij, në kuptim të nenit 322 paragraf 1 dhe 2 e lidhur me neni 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare për arsye se me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: “Gjykata mund të kërkoj nxjerrjen e provave sipas detyrës zyrtare, për vërtetimin e fakteve edhe pse palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse ato prova po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht të përcaktuara në kuptim të nenit 3 paragraf 3 të LPK-së”.

15. Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga paditësi nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.
16. Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.
17. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.290/2020, i datës 22.11.2023

"Rregullat e dëmtimit përtej gjysmës kanë të bëjnë me kontratat e dyanshme detyruese, posaçërisht situatën kur mes detyrimeve të palëve të kontratat e dyanshme në kohën e lidhjes së kontratës ka ekzistuar një shpërpjesëtim i qartë dhe pala e dëmtuar në momentin e lidhjes së kontratës nuk ka ditur e as që është dashur të dinte vlefshëm e vërtetë të prestimit të saj.

Andaj, nuk mund të kërkohet kompensim dëmi për shkak të dëmtimit përtej gjysmës në rastet kur paditësi pretendon se është kompensuar në mënyrë jo të drejtë lidhur me paluajtshmërinë e shpronësuar, meqenëse kompensimi në emër të shpronësimit nuk rrjedh nga ndonjë raport kontraktues, por është kompensim për paluajtshmërinë e shpronësuar i cili është caktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë mbi bazën e procedurës jokontestimore".

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësit H.1, H.2, A., B., Q. dhe N. Xh. që të gjithë nga B. i M., pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë ka paraqitur padi kundër të paditurit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) me seli në P., për kompensimin e dëmit në emër të tokës së eksproprijuar.
2. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2167/19 të datës 09.03.2020, në pikën I të dispozitivit është refuzuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve H.1, H.2, A., B., Q. dhe N. Xh. që të gjithë nga B. i M., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) me seli në P., që në emër të kompensimit të dëmit në emër të tokës së eksproprijuar dhe atë, për ngastrën kadastrale, nr..., arë e klasit të III-të, në sipërfaqe 0.29.75 ha, shumën prej 22.312.00 € dhe për ngastrën kadastrale, nr..., arë e klasit të IV-të, në sipërfaqe 0.52.95 ha, shumën prej 34.417.50 €, e në shumë të përgjithshme prej 56.730.00 €, në emër të fidanëve shumën prej 96 € dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 10.104.64 €, të gjitha këto në shumën e tërësishme prej 66.930.64 €, e cila zvogëluar për shumën prej 21.781.00 €, e paguar në emër të eksproprijimit në procedurën e mëparshme jo kontestimore, ashtu që e paditura KEK të obligohet që paditësve t'iu paguaj diferencën prej 45.149.64 €, me kamatë ligjore nga data 01.06.2006 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat

prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, si e pabazuar. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

3. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësve me aktgjykimin Ac.nr.6320/20 të datës 27.04.2023, ka vendosur që të refuzoj të pathemeltë ankesën e paditësve ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.2167/19 të datës 09.03.2020.
4. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditësve në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin e paditësve, të prishë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit ashtu që lëndën ta kthej në rigjykim dhe vendosje.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se revizioni i të autorizuarit të paditësve është i pathemeltë.
6. Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e plotfuqishëm N.nr.15/97, datë 30.10.1997, të marrë nga Gjykata Komunale në Prishtinë, në procedurë jo kontestimore është caktuar lartësia e kompensimit për paluajtshmëritë e ekspropriuara - ngastra kadastrale nr.359, me kulturë arë e klasit të tretë, në sipërfaqe prej 0.29,75 ha dhe arë e klasit të katërt në sipërfaqe prej 0.52,95 ha, të cilat kanë qenë të evidentuara në emër të paraardhësit të paditësve M.Xh. Në këtë procedurë është caktuar kompensimi në shumë prej 113,164.00 dinar, e cila shumë është kërkuar në procedurë të përbarimit që ka filluar me datë 18.03.2008, por për shkak të rrethanave të kohës është dashur që e njëjta procedurë të përsëritet sipas propozimit për përbarim i përtërirë me numër E.nr.253/2003, datë 12.12.2004. Në procedurën përbarimore të përtërirë shuma e caktuar e kompensimit në emër të shpronësimit, kamata dhe shpenzimet e procedurës janë konvertuar në euro, në shumën e tërësishme prej 23,196.01 €, të cilën shumë e ka pranuar paraardhësi i paditësve. Paditësi, tani i ndjeri, M.Xh. para se të përfundoj procedura e përbarimit, e përtërirë më datë 12.12.2004 në Gjykatën Komunale në Prishtinë, më datë 09.09.2002 ka paraqitë padi për kompensim të paluajtshmërisë së

lartpërmendur, me pretendim se me aktvendimin e plotfuqishëm të gjykatës N.nr.15/97, datë 30.10.1997, është caktuar kompensimi real, në shumë të përgjithshme prej 113.164,00 dinar të atëhershëm, me kamatë dhe shpenzime gjyqësore, me kohë ka ushtruar propozim për ekzekutim, mirëpo asnjë herë nuk është ekzekutuar dhe realizuar kërkesa e tij, sipas propozimit me numër E-244/98, datë 09.04.1998.

7. Pas paraqitjes së padisë në gjykatë, paditësi M.Xh në procedurë përmbarimore të ripërtërirë në vitin 2004 ka ekzekutuar kompensimin në shumën prej 23,196.01 €, që i është njohur në procedurën e shpronësimit të zhvilluar në vitin 1997. Përkundër kësaj, paditësi ka vazhduar ta ndjek çështjen në procedurë kontestimore me pretendim se me aktvendimin me të cilin i është caktuar kompensimi sipas shpronësimit është diskriminuar në bazë nacionale dhe është dëmtuar përtej gjysmës, ndërsa lartësinë e kërkesës e ka mbështetur në ekspertizën financiare të vitit 2006, të përpiluar nga eksperti K.F., sipas të cilës ekspertizë çmimi real i paluajtshmërisë së eksproprijuar është në shumë prej 66.930,64 €. Në ndërkohë ka vdekur paditësi M.Xh., ndërsa procedurën e kanë vazhduar trashëgimtarët e tij këtu paditësit, të cilët mbi bazën e diskriminimit dhe dëmtimit përtej gjysmës kanë kërkuar kompensimin e sipër theksuar.
8. Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetim se paditësit procedurën kontestimore në vitin 2002 e kanë filluar duke u thirrur në atë se për pronën e eksproprijuar nuk janë kompensuar asnjëherë, mirëpo siç rezulton edhe nga provat e paraqitura pala paditëse në procedurë përmbarimore të përtërirë ka marrë kompensimin në vitin 2004, pikërisht duke u bazuar në vendimin e vitit 1997, vendim i formës së prerë me të cilin ka përfunduar procedura e eksproprijimit dhe është caktuar vlera e kompensimit për paluajtshmërinë e shpronësuar. Kjo gjykatë ka vlerësuar se në kohën kur është zhvilluar procedura e eksproprijimit sipas aktvendimit N.nr.15/97, datë 30.10.1997, me të cilin është caktuar kompensimi për paluajtshmërinë e eksproprijuar, vërehet se janë marrë për bazë dispozitat ligjore të Ligjit për Eksproprijim (Gazeta Zyrtare KSAK Nr.21/78, 46/86 dhe 25/89) konkretisht neni 45 ku është përcaktuar se: “pronari i mëparshëm ka të drejtë për kompensimin të cilin do ta realizonte në mënyrën e deri atëhershme të shfrytëzimit të paluajtshmërisë së eksproprijuar, nga dita e hyrjes në posedim të shfrytëzuesit të eksproprijimit deri në ditën e lidhjes së marrëveshjes për kompensim, gjegjësisht deri në ditën e vendosjes së shkallës së parë mbi kompensimin, të vërtetuar sipas rrethanave në momentin e lidhjes së marrëveshjes, gjegjësisht në

momentin e prurjes së vendimit nga shkalla e parë për kompensimin”. Nga gjykata e shkallës së parë është vlerësuar se, në rastin konkret gjykata në procedurë jo kontestimore, ka vendosë për kompensimin real sipas aktvendimit N.nr.15/97, datë 30.10.1997, e të cilin kompensim e ka pranuar paditësi, tani i ndjeri M.Gj.

9. Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës të autorizuarit të paditësve ka refuzuar të pabazuar ankesën e paditësve dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke vlerësuar përfundimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm, sepse me vërtetimin e plotë të gjendjes faktike në këtë çështje të paditësve të iniciuar - tani në procedurë kontestimore, atëherë edhe si rrjedhojë e kësaj, drejtë i ka zbatuar edhe dispozitat konkrete ligjore që i referohen situatave si në rastin konkret, pra nenit 44 të LMTHJP, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se, e drejta e pronësisë pushon me kalimin e sendit në pronësi shoqërore, e kjo ka ndodhur edhe në rastin konkret, me pronën e shpronësuar të paditësit, ndërsa në anën tjetër paditësi është kompensuar për paluajtshmërinë e ekspropriuar dhe atë mbi bazën e vendimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm gjyqësor. Si rezultat i kësaj gjendje të vërtetuar faktike, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se kërkesa e paditësve për fitimin e humbur apo dëmtimin përtej gjysmës nuk është e bazuar, kjo për faktin se paluajtshmëria e paditësit atëherë M.Xh., ishte shpronësuar me aktvendimin e plotfuqishëm për shpronësimin dhe atë gjatë viteve 1978, ndërsa për paluajtshmërinë e tillë pala paditëse është kompensuar në tërësi, mbi bazën e aktvendimit gjyqësor të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare. Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura nga paditësit në ankesë dhe ka dhënë arsye të qarta në lidhje me çështjet e ngritura që kanë të bëjnë me shkeljen esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe me zbatimin e gabuar të dispozitave materiale. Gjykata e shkallës së dytë me arsyet e

dhëna në aktgjykimin e atakuar me revizion ka përmbushur kërkesat ligjore nga neni 204 të LPK-së, si në pikëpamje të kufijve të shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe në aspektin e dhënies së arsyeve për të gjitha çështjet e ngritura në ankesë.

2. Padiësit në revizionin e paraqitur për nga baza nuk u janë referuar shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, prandaj Gjykata Supreme sa i përket kësaj baze është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në përputhje me dispozitën e nenit 215 të LPK-së.
3. Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, bazuar në dispozitat e lartcekura, me të drejtë kanë gjetur në rastin konkret, se padiësve nuk u takon kompensimi pasi që të njëjtit janë shpërblyer për pronën, pra të njëjtëve u është paguar shpërblimi në tërësi për paluajtshmërinë e eksproprijuar sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë të vitit 1978. Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast kompensimi i kërkuar nga padiësit nuk rrjedh nga një raport kontraktues andaj si i tillë nuk mund të gjë mbështetje në rregullat që kanë të bëjnë me dëmtimin përtej gjysmës. Rregullat e dëmtimit përtej gjysmës kanë të bëjnë me kontratat e dyanshme detyruese, posaçërisht situatën kur mes detyrimeve të palëve te kontratat e dyanshme në kohën e lidhjes së kontratës ka ekzistuar një shpërpjesëtim i qartë dhe pala e dëmtuar në momentin e lidhjes së kontratës nuk ka ditur e as që është dashur të dinte vlefshën e vërtetë të prestimit të saj. Në rastin e padiësve kompensimi në të cilën thirren ata nuk rrjedh nga ndonjë raport kontraktues, por është kompensim i cili është caktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë mbi bazën e procedurës jokontestimore, që ka të bëjë me caktimin e kompensimit për paluajtshmërinë e shpronësuar, ku në atë procedurë është caktuar kompensimi, ndërsa paraardhësi i padiësve kompensimin e njohur e ka ekzekutuar në procedurë të përmarimit të përfunduar në vitin 2004.
4. Në rrethana të tilla kjo gjykatë vlerëson se baza e dëmtimit përtej gjysmës nuk mund të përdoret për të kërkuar kompensim, siç nuk mund të përdoret as diskriminimi mbi baza nacionale, kjo pasi që në atë kohë është zhvilluar procesi për shpronësim të paluajtshmërisë së paraardhësit të padiësve, procedura jokontestimore në të cilën është caktuar kompensimi ka kaluar në të gjitha instancat gjyqësore të përcaktuara me legjislacion të kohës, të njëjtën shumë paraardhësi i padiësve e ka pranuar duke iniciuar

procedurë të përmbartimit në atë kohë të përtërirë pas luftës dhe të realizuar në vitin 2004.

5. Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

6. Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 222 dhe 224.1 të LPK-së, kolegji civil i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi që të REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditësve H.1, H.2, A., B., Q. Dhe N.Xh., , të gjithë nga fshati, Komuna F. K., i paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.6320/20, datë 27.04.2023.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës,

Rev.nr.383/23, i datës 26.10.2023

"Për tu lejuar përsëritja e procedurës nga baza e nenit 232 pika c) e LPK-së, pala që e paraqet propozimin, ka për obligim që me prova konkrete të vërtetoj se vendimi përfundimtar është bazuar në deklarata të rreme të dëshmitarit apo ekspertit dhe se për këtë dëshmitari apo eksperti është dënuar me aktgjykim penal të formës së prerë, ndërsa deklarata e tillë ka qenë bazë për nxjerrjen e vendimit.

Kësisoj, propozimi për përsëritje të procedurës duke u thirrur në atë se aktgjykimi i shkallës së parë është marr si rezultat i deklarimit të rremë të dëshmitarëve dhe ekspertit, në mungesë të aktgjyqimeve penale të formës së prerë që vërtetojnë fajësinë e dëshmitarit apo ekspertit për deklarimin e rremë, nuk paraqet bazë nga neni 232 pika c) të LPK-së për përsëritje të procedurës“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësit N. M., S. I., M. B., S. A. dhe N. M., të gjithë nga Gjilani, pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës, kanë paraqitur kërkesë për përsëritjen e procedurës të përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.130/11 i datës 24.04.2017.
2. Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, të gjyqtarit individual CN.nr.50/21 të dates 08.10.2021 është refuzuar e pabazuar kërkesa e përfaqësuesit të paditësve N. M., S. I., M. B., S. A. dhe N. M., të gjithë nga Gjilani, për përsëritjen e procedurës të përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.130/11 i datës 24.04.2017.
3. Gjykata e Apelit të Kosovës, koleggi prej 3 gjyqtarëve me aktvendimin Ac.nr.1736/2022 të dates 18.07.2023 ka refuzuar të pathemeltë ankesën e paditësve N. M., S. I., M. B., S. A. dhe N. M., të gjithë nga Gj., ndërsa ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CN.nr.50/21 të datës 08.10.2021.
4. Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditësve në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të cenimit të rëndë të dispozitave ligjore të procedurës

kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë revizionin e paditësve, ashtu që të ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.130/11 dhe të aprovojë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, duke e detyruar të paditurën të bëjë pagesën e të ardhurave personale të mbetura sipas raportit të ekspertit financiar dhe të bartë shpenzimet procedurale.

5. Pala e paditur ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditësve, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë përgjigjen në revision, të refuzojë revizionin e palëve paditëse dhe të vërtetoj aktvendimin C.nr.130/11 të datës 24.04/2017 dhe aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.1736/2022 të datës 18.07.2023, si të pabazuar në legjisacionin e Republikës së Kosovës.
6. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se revizioni i të autorizuarit të paditësve është i pathemeltë.
7. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit në gjykatën e shkallës së parë kanë parashtruar padi për pagesën e të ardhurave personale. Fillimisht me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.130/11, të datës 24.04.2017, në pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadija e paditësve N. M., S. I., M. B., S. A. dhe N. M., të ushtuar kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, me të cilën paditësit kanë kërkuar vërtetimin e të drejtës nga marrëdhënia e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale. Me të njëjtin aktgjykim, në pikën II të dispozitivit, është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore, kurse paditësit në mënyrë të barabartë detyrohen që kësaj gjykatë t'ia paguajnë shumën e të hollave në lartësi prej 100 € në emër të përpilimit me shkrim të këtij aktgjykimi, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.
8. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.2514/2017, të datës 20.09.2019, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësve N. M., S. I., M. B., S. A. dhe N. M., të gjithë nga Gj., ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.130/2011 të datës 24.04.2017.

9. Ndaj aktgjykimit të lartcekur, palët paditëse më datë 12.06.2020 kanë paraqitur kërkesë për përsëritjen e procedurës. Gjykata Themelore në Gjilan me aktvendimin C.nr.130/11 të datës 17.06.2020 paditësve ua ka kthyer në plotësim parashtrësën - propozimin për përsëritjen e procedurës dhe pasi që paditësit të njëjtën kërkesë nuk e kanë plotësuar, e njëjta gjykatë me aktvendimin C.nr.130/11 të datës 23.06.2020 ka hedhë poshtë propozimin për përsëritjen e procedurës të datës 12.06.2020, i paraqitur nga ana e të autorizuarit të paditësve.
10. Kundër aktvendimit C.nr.130/11 të datës 23.06.2020, për hudhje poshtë të propozimit për përsëritje të procedurës, i autorizuari i paditësve ka paraqitur ankesë. Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me aktvendimin Ac.nr.5439/20 të datës 16.12.2020 ka aprovuar si të bazuar ankesën e të autorizuarit të paditësve dhe ka prishë aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.130/11, datë 23.06.2020, duke e detyruar shkallën e parë që pas pranimit të aktvendimit lëndën ta dorëzoj në gjykatën e shkallës së dytë për vendosje sipas propozimit.
11. Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë me aktvendimin e atakuar CN.nr.50/21 të datës 08.10.2021 ka refuzuar të pabazuar kërkesën e përfaqësuesit të paditësve N. M., S. I., M. B., S. A. dhe N. M., të gjithë nga Gj., për përsëritjen e procedurës të përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.130/11 të datës 24.04.2017. Kundër këtij vendimi paditësit kanë paraqitur ankesë, ndërsa kolegji prej 3 gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit me aktvendimin Ac.nr.1736/2022, datë 18.07.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e paditësve dhe ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës CN.nr.50/21 të datës 08.10.2021.
12. Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit e ka refuzuar propozimin për përsëritje të procedurës si të pa bazuar, duke vlerësuar se nuk janë plotësuar kushtet për përsëritje të procedurës ngase i autorizuari i paditësve-propozuesve propozimin për përsëritjen e procedurës e ka mbështetur në dispozitat e nenit 232 lidhur me nenin 234 paragrafi 3 dhe nenin 236 të LPK-së, mirëpo nuk është dhënë asnjë arsye e bazuar dhe propozimit nuk i është bashkangjitur asnjë mjet provues, me të cilat do të arsyetoheshin

pretendimet e tij, që eventualisht të plotësohet ndonjëri nga kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 232 të LPK-së, për lejimin e përsëritjes së procedurës.

13. Gjykata e Apelit ka pranuar vlerësimin e gjyqtarit individual sa i përket bazueshmërisë së propozimit për përsëritjen e procedurës, përkatësisht kolegji ka vlerësuar se nuk qëndron pretendimi ankimor se me rastin e vendosjes si në aktgjykimin i cili kërkohet të anulohet të ketë pasur shkelje të nenit 232 pika c) të LPK-së, ngase ky kusht ligjor për përsëritjen e procedurës nuk është plotësuar pasi që në shkresat e lëndës nuk ka prova se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e formës se prerë C.nr.130/11 të datës 24.04.2007, ta ketë marrë si pasojë e veprës penale të kryer nga dëshmitarët, ekspertët apo dokument që është falsifikuar apo është verifikuar përbajtja e pa saktë e tij.
14. Gjykata e Apelit ka vërtetuar vendimin e gjyqtarit individual lidhur me vendosjen për propozimin për përsëritjen e procedurës, me vlerësim se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për ndonjë provë të re në kuptimin e relevancës që do të mund të ndryshonte rrjedhën e gjykimit apo vendimmarrjen, sepse i autorizuari i paditësve me asnjë provë nuk i ka mbështetur pretendimet se posedon ndonjë provë të re apo është në dijeni për ndonjë fakt të ri, e të cilin sikurse ta kishte në dijeni gjykata e shkallës së parë, apo të cilin do të mund ta përdorte/shfrytëzonte ankuesi dhe përmes së cilës do të arrihej një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendosur.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktvendimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.
2. I autorizuari i paditësve në revizionin e paraqitur pretendon se ka shkelje të dispozitavenprocedurale, mirëpo asnjë shkelje nuk është specifikuar dhe nuk janë paraqitë arsye, andaj Gjykata Supreme është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në përputhje me dispozitën e nenit 215 të LPK-së, me ç'rast ka

gjetur se aktvendimi nuk është i përfshirë në shkelje për të cilat duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare.

3. Siç rezulton nga shkresat e lëndës propozimi për përsëritjen e procedurës është paraqitur mbi bazën e nenit 232 pika c) të LPK-së, me të cilën është përcaktuar se: "Në qoftë se vendimi përfundimtar i gjykatës është bazuar në deklarata të rreme të dëshmitarëve apo ekspertëve ose në dokumentin që është falsifikuar apo në të cilin është verifikuar përmbajtja e pa saktë", Nga formulimi i tillë i dispozitës rezulton se për tu lejuar përsëritja e procedurës sipas kësaj baze, pala që e paraqet propozimin ka për obligim që me prova konkrete të vërtetoj se vendimi përfundimtarë është bazuar në deklarata të rreme të dëshmitarit apo ekspertit dhe se për këtë dëshmitari apo eksperti është dënuar me aktgjykim penal të formës së prerë, ndërsa deklarata e tillë ka qenë bazë për nxjerrjen e vendimit. Në këtë rast i autorizuari i paditësve propozimin për përsëritje të procedurës e ka paraqitur duke u thirr në atë se aktgjykimi i shkallës së parë është marr si rezultat i deklarimit të rremë të dëshmitarëve dhe ekspertit, mirëpo përveç që ka konstatuar një gjë të tillë nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme për të dëshmuar se vendimi përfundimtarë është marrë si rezultat i deklaratave të rrejshme të dëshmitarëve apo ekspertit dhe se për këto deklarata të pretenduara si të rrejshme dëshmitarët apo ekspertit të jenë dënuar me aktgjykim penal të formës së prerë andaj, në mungesë të provave për të argumentuar bazën ligjore nga neni 232 pika c) të LPK-së, Gjykata Supreme vlerëson se me të drejtë Gjykata e Apelit ka vlerësuar se në këtë rast nuk është plotësuar kushti ligjor për përsëritjen e procedurës, ashtu siç është pretenduar nga i autorizuari i paditësve.
4. Duhet pasur parasysh se propozimi për përsëritjen e procedurës është mjet i jashtëzakonshëm dhe marrë për bazë natyrën e tij pala që e përdorë një mjet të tillë duhet që të ketë prova konkrete për të argumentuar pretendimet, ngase nuk mjafton vetëm të përdoret dispozita ligjore që shërben si bazë për përsëritje të procedurës por duhet që me prova konkrete të vërtetohet çdo bazë e pretenduar.
5. Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 222 dhe 230 të LPK-së, kolegji civil i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi që të REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditësve N. M., S. I., M. B., S. A. dhe N. M., të gjithë nga Gj., i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1736/2022, datë 18.07.2023.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës,

Rev.nr.459/23, i datës 05.12.2023

"Paditësit nuk i takon e drejta që të kërkoj kompensimin e dëmit si rezultat i pamundësisë së shfrytëzimit të pjesës së paluajtshmërisë në të cilën shtrihen barrët sendore kjo përderisa paditësi, me rastin e blerjës së paluajtshmërisë, është pajtuar me barrën ekzistuese, e cila si një të drejtë sendore mbi sendin e huaj, paraqet kufizim të të drejtës së pronësisë së pronarit të paluajtshmërisë.

Andaj nuk mund të konsiderohet se autoriteti publik i ka cenuar paditësit të drejtën e pronës me asfaltimin e rrugës e cila kalon nëpër pronë private kjo meqenëse rruga ka qenë e ndërtuar në kohën sa prona ka qenë nën menaxhimin e AKP-së, rruga në fjalë është shfrytëzuar nga banorët e parcelave që gjenden afër këtyre parcelave në fjalë para se paditësi ta blej këtë paluajtshmëri, ndërsa për këtë paditësi ka qenë i informuar se me blerjen e paluajtshmërisë merr përsipër të gjitha ngarkesat-barrat ekzistuese që nënkupton edhe rrugën e ndërtuar“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësja I. M. nga fshati ..., Komuna e L., pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan ka paraqitur padi kundër të paditurit Komuna e L., për kompensimin e dëmit në emër të paluajtshmërisë së uzurpuar për ndërtimin e rrugës.
2. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, C.nr.74/16 të datës 03.04.2019, në pikën I të dispozitivit është vendosur të refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e precizuar e paditësit I. M. nga fshati ..., Komuna e L., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e L. që paditësit t'ia kompensoj dëmin në emër të paluajtshmërisë së uzurpuar për ndërtimin e rrugës në pjesën e ngastrave nr....., në sipërfaqe prej 384 m2 dhe ngastrës kadastrale nr. ..., në sipërfaqe prej 38 m2, sipërfaqja e përgjithshme prej 422 m2, shumën prej 43.102.00 €, në emër të uzurpimit të tokës, si dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj dëmin për vlerën e humbur të ngastrës kadastrale nr., në sipërfaqe 153 m2, në anën verilindore dhe sipërfaqen prej 872 m2, në anën jug - perëndim në shumë prej 16.954.00 €, të gjitha këto me kamatë 8%, duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e deri në pagesën

definitive. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

3. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësit me aktgjykimin Ac.nr.5236/2019 të datës 12.07.2023, ka vendosur që të refuzoj të pabazuar ankesën e paditësit I. M., nga fshati ..., Komuna e L., ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.74/16 të datës 03.04.2019.
4. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, i autorizuari i palës paditëse në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin e paditësit, të anuloj aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, ose të ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se: Revizioni i të autorizuarit të paditësit është i pathemeltë.
6. Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 18.02.2016, paditësi I. M. nga fshati ..., në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, me kërkesë për kompensimin e dëmit për shkak të uzurpimit të paluajtshmërisë. Sipas pretendimeve të paditësit e paditura ka shtruar rrugë nëpër pronën e tij, ngastrën kadastrale nr. ..., dhe ..., ZK L., pa zhvilluar asnjë procedurë administrative për shpronësim. Meqenëse paditësi, në mënyrë të kundërligjshme është privuar nga e drejta në pronë në një pjesë të paluajtshmërisë lëndore, gjykatës i ka propozuar që mbi bazën e ekspertizës për vlerësimin e paluajtshmërisë, të detyrohet e paditura të kompensoj shumën reale të pjesës e cila shfrytëzohet si rrugë si dhe t'ia kompensoj vlerën e humbur të një pjese të mbetur të paluajtshmërisë, shfrytëzimin e të cilës paditësi e ka të pamundur.
7. E paditura në përgjigjen në padi dhe në seanca gjyqësore e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, me pohimet se paditësi në kohën e blerjes së

paluajtshmërisë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit ka qenë i informuar se në një pjesë të ngastrave kadastrale gjendet rruga, gjersa sipas marrëveshjes së shitblerjes neni 2 pika 4, blerësi është pajtuar me gjendjen ekzistuese të paluajtshmërisë. Nga arsyet e parashtruara ka propozuar që kërkesëpadia të refuzohet e pabazuar.

8. Gjykata e shkallës së parë mbi bazën e provave të administruara, gjendjes faktike të vërtetuar, ka vlerësuar se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi është pronar i ngastrave kadastrale ..., dhe ..., të cilën pronë e ka fituar sipas marrëveshjes për shitblerjen, të lidhur më datë 16.02.2011 me AKP, e të cilat ngastra, para menaxhimit të AKP kanë qenë në pronësi të Ndërmarrjes Shoqërore për prodhimin e letrës, kartuçit dhe ambalazhit "S. A.", L. Gjykata referuar marrëveshjes për shitblerjen e pronës dhe ekspertizës së gjeodezisë, ka vlerësuar se paditësi nuk ka të drejtë në kompensimin e dëmit të kërkuar ngase me arritjen e marrëveshjes me AKP është pajtuar që paluajtshmërinë ta pranoj me barrën e cila ka ekzistuar në momentin e shitblerjes së paluajtshmërisë, gjegjësisht me rrugën e shtruar e cila ka ekzistuar në momentin e lidhjes së marrëveshjes për shitblerjen dhe bartjen e pronës.
9. Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës të autorizuarit të paditësit ka refuzuar të pa themeltë ankesën e paditësit dhe ka vlerësuar se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje esenciale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as në shkelje në të cilat pretendohet në ankesë nga paditësi.
10. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se pala paditëse me asnjë provë të vetme nuk ka arritur ta argumentoj faktin se në këtë rast ka të drejtë që të kërkoj kompensimin e pronës nga e paditura, në pjesën në të cilën gjendet rruga, pasi prona para transferimit është menaxhuar nga AKP, ndërsa me rastin e transferimit blerësi ka qenë në dijeni për gjendjen ekzistuese të pronës dhe ka pranuar ta blejë në gjendjen çfarë është, pra bashkë me barrën e cila ka ekzistuar para dhe në kohën e lidhjes së kontratës.
11. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të

dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

12. Paditësi në revizionin e paraqitur për nga baza nuk u është referuar shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, prandaj Gjykata Supreme sa i përket kësaj baze është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në përputhje me dispozitën e nenit 215 të LPK-së.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë nga ka rezultuar se kërkesëpadia është e pathemeltë. Sa i përket të drejtës së paditësit në kompensimin e dëmit nën supozimin e uzurpimit të pasurisë, Gjykata Supreme pranon qëndrimin e instancave më të ulëta, duke vlerësuar se e drejta e kërkesës së paditësit për kompensimin e dëmit për pronën e lartcekur nuk i takon, kjo për faktin se paditësit me rastin e lidhjes së marrëveshjes së shitblerjes me AKP, duke vepruar si administratore me mirëbesim e NSH, i janë batur të gjitha të drejtat, titulli dhe interesat në pronë nga NSH "S. A." dhe atë në vartësi ose me përfitimin e të gjitha servituteve, të drejtave, marrëveshjeve, kufizimeve, qiramarrjeve, okupimeve dhe çdo barrë tjetër të çfarëdo lloji që e ngarkojnë pronën siç përcaktohet në Shtojcën 2 të Marrëveshjes. Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të qarta dhe të mbështetura në prova të administruara, posaçërisht në përfundimet e nxjerra nga ekspertit gjeodet dhe bazuar në marrëveshjen e lartcekur, ku në mënyrë të qartë është konstatuar se ekziston rruga e cila kalon në parcelën nr..., e cila rrugë është rrugë jozyrtare e përkohshme dhe nuk është e regjistruar në regjistrat kadastral. Kjo rrugë është shfrytëzuar nga banorët e parcelave që gjenden afër këtyre parcelave në fjalë para se paditësi ta blej këtë paluajtshmëri nga AKP, ndërsa me rastin e blerjes ka qenë në dijeni të ekzistimit të rrugës.
2. Në rrethana të tilla nuk mund të konsiderohet se e paditura ia ka cenuar paditësit të drejtën e pronës, dhe mbi këtë bazë pala paditëse nuk mund të kërkoj as kompensim,

kjo pasi që paditësi ka blerë paluajtshmërinë nga AKP sipas procesit të privatizimit ku kjo pronë ka qenë e Ndërmarrjes Shoqërore për prodhimin e letrës, kartuçit dhe ambalazhit "S. A.", L., dhe në kohën kur kjo ka qenë pronë shoqërore dhe nën menaxhim të AKP-së është ndërtuar rruga, ndërsa për këtë paditësi ka qenë i informuar në kohën kur e ka blerë këtë paluajtshmëri, përkatësisht AKP me Marrëveshjen për Shitblerjen dhe Bartjen e Pronës e ka informuar atë dhe ia ka bërë të ditur se me blerjen e paluajtshmërisë merr përsipër të gjitha ngarkesat ekzistuese që nënkupton edhe rrugën e ndërtuar (shih pikën 2.4 të Marrëveshjes lidhur me Shtojcën 2 të Marrëveshjes), e që sipas ekspertizës së gjeodezisë e njëjta figuron nga viti 2004. Pra paditësi ka pranuar që paluajtshmërinë ta blejë me një gjendje të tillë dhe mbi këtë bazë nuk mund të kërkojë kompensim dëmi për rrugën që është shtruar në kohën kur paluajtshmëria ka qenë pronë e ndërmarrjes shoqërore dhe nën menaxhim të AKP.

3. Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, kolegji civil i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi që të REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditësit I. M. nga fshati ..., Komuna L., i paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5236/2019 të dates 12.07.2023.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës,

Rev.nr.511/23, i datës 25.01.2024

"Fakti se punëdhënësi dhe punëmarrësi me pajtimin reciprok përcaktojnë pagën, lartësinë e saj dhe beneficionet tjera në kontratën e punës, nuk e përjashton obligimin e punëdhënësit që ta paguaj punëmarrësin në mënyrë të barabartë, për punë të njëjtë ose punë me vlerë të barabartë, pa diskriminim. Puna e barabartë ose puna me vlerë të barabartë mbështetet në gjithë kriteret përkatëse, veçanërisht në natyrën e punës, cilësinë dhe sasinë e saj, kushtet e punës, formimin profesional dhe vjetërsinë në punë, përpjekjet fizike dhe intelektuale, përvojën dhe përgjegjësitë.

Andaj, refuzimi i kërkesëpadisë së paditëses për kompensim të diferencës së pagave vetëm nisur nga fakti se paditësja me vullnet ka nënshkruar akt emërimit dhe është pajtuar me kushtet e kontratës përfshirë edhe lartësinë e pagës, nuk mund të mirret për bazë përderisa nuk trajtohen pretendimet e paditëses për shkelje të nenit 5 i Ligjit të Punës që i referohet ndalimit të gjitha llojeve të diskriminimit në ndërlidhje me Ligji Kundër Diskriminimit (Ligji Nr.2004/3)".

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësja M. G., nga P., pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë ka paraqitur padi kundër të paditurit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës në P., për kompensim të diferencës së pagës.
2. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1135/20 të datës 15.04.2021, në pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses M. G., nga P., me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës në P., që në emër të kompensimit të diferencës së pagës të paguaj shumën prej 7,168.35 €, ndërsa në emër të kontributit pensional për diferencën e pagës të paguaj shumën prej 838.40 €, si dhe në emër të tatimit për diferencën e pagës të paguaj shumën prej 796.48 €, si dhe shpenzimet procedurale, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

3. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditëses me aktgjykimin Ac.nr.5934/2021 të datës 10.08.2023, ka vendosur që të refuzoj të pa themeltë ankesën e paditëses M. G., nga P., ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1135/20 të datës 15.04.2021.
4. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i palës paditëse në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin e paditëses, të prishë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe çështjen t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, apo që i njëjti aktgjykim të ndryshohet dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditëses si e bazuar.
5. Pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditëses.
6. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se: Revizioni i të autorizuarit të paditëses është i themeltë.
7. Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja përmes të autorizuarit të saj, më datë 06.03.2020 ka paraqitur padi kundër të paditurës, duke kërkuar kompensimin e diferencës së pagës në raport me kolegët e saj, duke pretenduar se në këtë rast është diskriminuar në pagë në raport me të tjerët për punën dhe pozitën e njëjtë.
8. Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes dhe pas administrimit të provave dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, mori aktgjykimin C.nr.1135/20, të datës 15.04.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.
9. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit mes tjerash ka theksuar se, pas vlerësimit të deklarimeve të palëve dhe shqyrtimit të secilës provë, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar, ashtu që ka gjetur se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja është e punësuar tek e paditura sipas Akt

Emërimin të datës 18.03.2013, në pozitën ..., në Klinikën e Pulmologjisë me koeficient H-56 apo 5.4, sikurse nuk ishte kontestuese as rritja e koeficientit të paditëses sipas kontratës së re të punës me nr..., të datës 20.01.2020, me koeficient të ngritur sipas Kodit të Postit H-30 apo 7.2.

10. Më tej gjykata ka theksuar se nga procedimi gjyqësor ka rezultuar se kontestuese mes palëve ndërgjyqëse në këtë çështje juridike ishte fakti lidhur me pagesën e paditëses nga e paditura në mënyrë retroaktive të diferencës së pagës, për periudhën nga data 03.12.2014 deri më datë 15.01.2020 së bashku me shtesat tjera të pagës bazë. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga vendimi i Inspektoratit të Punës 01 Nr.60-62/19 të datës 13.05.2019, në të cilin është bazuar kërkesëpapia e paditëses, askund nuk përcaktohet se e paditura ka për obligim që në mënyrë retroaktive të paguaj diferencën e pagës për paditësen. Në këtë vendim vetëm se është obliguar që e paditura të ngrisë koeficientin e paditëses për periudhën e ardhme gjë e cila edhe ka ndodhur sipas kontratës nr..., të datës 20.01.2020. Për më tepër, paditësja në të gjitha kërkesat e saja parashtruar tek e paditura dhe tek inspektorati ka kërkuar nivelizimin - rritjen e koeficientit, mirëpo askund nuk ka kërkuar që të kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca e pagave bazë përfshirë edhe shtesat tjera.
11. Gjykata vlerëson se Akt Emërimi i lëshuar nga e paditura me të cilin ndër të tjera është përcaktuar edhe grada e paditëses është në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës, përkatësisht me dispozitat e nenit 11 paragrafi 1, pika 1.8 të Ligjit të Punës, me të cilin është paraparë se: “kontrata e punës duhet të përmbajë “lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër”, në rastin konkret paditësja në tërësi është pajtuar me kushtet e punësimit dhe pozitën përkatëse duke përfshirë edhe lartësinë e pagës bazë të përcaktuar prej 5.4. Pra, lidhur me kushtet e marrëdhënies së punës të parapara me Akt Emërimin të lidhur mes paditëses dhe të paditurës, duke përfshirë edhe lartësinë e pagës, përkatësisht gradën sipas së cilës do të paguhet paga e paditëses, është pajtuar edhe vet paditësja me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës tek e paditura. Bazuar në nenin 55 paragrafi 2 të Ligjit të Punës është përcaktuar: “Të drejtën për pagë, pagën shesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me kontratën e punës”, në këtë kontekst paditësja duhet

të argumentoj me prova materiale ndryshimin e gradës nga punëdhënësi për periudhën kontestuese për të cilën pretendon se ka të drejtë ta realizoj.

12. Në fund, gjykata ka theksuar se meqenëse Akt emërimi ishte në pajtim me dispozitat ligjore, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses për periudhën kontestuese për kompensimin e diferencës së pagave të papaguara është e pabazuar edhe pse me propozimin e paditëses është bërë llogaritja e të ardhurave personale me anë të ekspertizës financiare. E drejta e kompensimit të të ardhurave personale paditëses do ti takonte vetëm në situatën kur ndryshimi i kushteve të kontratës së punës do të ishte bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Gjykata në procedurë bëri shtjellimin e të gjitha provave të parashtruara nga ndërgjyqësit, kurse në arsyetimin e aktgjykimit iu referua vetëm provave që kishin ndikim vendimtar në marrjen e vendimit, si në dispozitiv.
13. Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës të autorizuarit të paditëses ka refuzuar të pa themel të ankesën e paditëses dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke vlerësuar përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.
14. Kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses për arsye se në rastin konkret paditësja me të paditurën kanë themeluar marrëdhënie pune, pra në atë kohë paditësja ka pasur Akt Emërim i cili ka qenë në përputhje me dispozitat ligjore, paditësja është pajtuar me kushtet e punës, e ka pranuar edhe koeficientin që ka qenë i përcaktuar si dhe me këto edhe pagën e caktuar. Neni 55 paragrafi 2 i Ligjit të Punës përcakton se: “Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me kontratën e punës”. Duke pasur parasysh se paditësja me vullnet të plotë e ka nënshkruar akt emërimin dhe është pajtuar me kushtet e kontratës, nuk mund të qëndrojnë pretendimet se të njëjtës i takon diferenca në pagë për periudhën e caktuar. Fakti se paditësja ka nënshkruar më pas kontratë me koeficient të ri, nuk nënkupton se paditëses i takon diferenca në pagë, sepse e njëjta deri më datë 20.01.2020 ka qenë me koeficient tjetër, Akt Emërimi fillestar ka qenë në fuqi deri me këtë datë si dhe nuk është kontestuar asnjëherë ligjshmëria e tij. Pra, kjo gjykatë gjen

se pretendimet se e paditura i ka mohuar paditëses kompensimin e pagës nuk qëndrojnë dhe kjo për arsye se paditësja asnjëherë nuk ka theksuar se nuk ka pranuar pagën për punën që ka qenë duke e kryer në pajtim me Akt Emërimin, por çështja ka qenë tek nivelizimi i koeficientit, që pas lidhjes së kontratës së re është caktuar edhe paga tjetër.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i goditur dhe ai i shkallës së parë janë marrë si rezultat i aplikimit të gabuar të drejtës materiale, për çka aktgjykimet patjetër është dashtë të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
2. Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, në këtë rast gjykata e shkallës së parë e as gjykata e shkallës së dytë nuk kanë trajtuar pretendimet e ngritura nga pala paditëse në të gjitha fazat e procedurës e që kanë të bëjnë me diskriminim në pagë, kjo pasi që paditësja pretendon se ka qenë e diskriminuar brenda QKUK, bazuar në akt emërimin e datës 18.03.2013, sipas të cilit akt ka realizuar pagë me koeficient H-56 apo 5.4, ndërsa në klinika tjera brenda QKUK-së, për pozitë të njëjtë, kolegët e saj janë paguar me koeficient më të lartë. Pala paditëse gjatë gjithë procesit gjyqësor ka pretenduar se ka qenë e diskriminuar, duke paraqitur si prova kërkesat e saj të vazhdueshme në Drejtorinë e SHSKUK-së dhe krahasimin e pozitës së saj me kolegët e tjerë në klinika tjera brenda QKUK.
3. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë si bazë për refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses kanë marrë faktin që paditësja me vullnet ka nënshkruar akt emërimin dhe është pajtuar me kushtet e kontratës përfshirë edhe lartësinë e pagës dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ekziston baza juridike për kompensim të diferencës së pagave. Të dy gjykatat kanë interpretuar nenin 11 paragrafi 1, pika 1.8 dhe nenin 55 paragrafi 2 të Ligjit të Punës, që kanë përcaktuar se çka duhet të përmbajë kontrata e punës dhe çështjen e realizimit të pagës dhe beneficioneve të tjera ashtu siç është përcaktuar me kontratën e punës, mirëpo çështja e paditëses nuk është trajtuar dhe fare nuk janë marrë për bazë dispozitat nga neni 5 i Ligjit të Punës që i referohet ndalimit të gjitha llojeve të

diskriminimit dhe po ashtu nuk është marrë për bazë Ligji Kundër Diskriminimit (Ligji Nr.2004/3), që në këtë rast ka qenë obligim ngase pretendimet e ngritura nga paditësja kanë të bëjnë me këtë çështje.

4. Është i vërtetë fakti se paga, lartësia e saj dhe beneficionet tjera punëdhënësi dhe punëtori i përcaktojnë me kontratën e punës, kjo pasi që marrëdhënia e punës konsiderohet si raport kontraktues, mirëpo përveç kësaj është detyrim i punëdhënësit i cili ofron kontratën për nënshkrim për punëtorin që të paguaj punëmarrësit në mënyrë të barabartë, për punë të njëjtë ose punë me vlerë të barabartë, pa diskriminuar. Puna e barabartë ose puna me vlerë të barabartë mbështetet në gjithë kriteret përkatëse, veçanërisht në natyrën e punës, cilësinë dhe sasinë e saj, kushtet e punës, formimin profesional dhe vjetërsinë në punë, përpjekjet fizike dhe intelektuale, përvojën dhe përgjegjësitë.
5. Nga këto arsye janë prishë aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, në mënyrë që në rivendosje të evitohen shkeljet e paraqitura dhe nëse pala ka ngritur çështjen e diskriminimit në pagë në raport me të tjerët, gjykata duhet të fokusohet në trajtimin e fakteve që japin përgjigje në atë se ka apo jo diskriminim sipas ndonjë baze të përcaktuara me ligjet e sipërcituara, pra a ka pasë dallim në trajtim me kolegët e tjerë dhe kategoria e të punësuarve të cilëve u është referuar paditësja, a janë në situata të “ngjashme dhe/ose analoge”. Nëse paditësja pretendon se për periudhën 03.12.2014 deri më datën 15.01.2020 është diskriminuar në pagë pasi që për pozitën e njëjtë në këtë periudhë është paguar me koeficient më të ulët se kolegët e saj që kanë punuar në të njëjtën pozitë, atëherë gjykata është dashur të jep përgjigje lidhur me këtë se a kemi të bëjmë me punën e njëjtë, kualifikimin e njëjtë dhe në të njëjtën periudhë kolegët e paditëses çfarë koeficienti kanë pasë.
6. Kryerja e veprimeve të mësipërme, si dhe e të tjerave që eventualisht mund të dalin gjatë rigjyimit, do ta lejojnë gjykatën e shkallës së parë që, në përputhje me kërkesat e ligjit procedural dhe material, të mund të arrijë në përfundime më të drejta dhe objektive lidhur me zgjidhjen e çështjes që është objekt shqyrtimi.
7. Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 224.2 të LPK-së, kolegji civil i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi që të PRANOHET si i bazuar revizioni i të autorizuarit të paditëses M. G., nga P., prishet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5934/2021 i datës 10.08.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1135/20 i datës 15.04.2021, çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës,

Rev.nr.352/2022, i datës 22.03.2023

”Parashkrimi fitues nuk mund të jetë bazë për të fituar të drejtën e pronësisë mbi një paluajtshmëri kjo përderisa i padituri si pronar, ja ka dhënë paraardhësit të paditësit këtë paluajtshmëri në shfrytëzim të përhershëm pa të drejtë të tjetërsimit (pra pa autorizime të pronarit dhe vetëm me qëllim të ndërtimit të shtëpisë së banimit) ndërsa pala e paditur ka ngelur pronare e paluajtshmërisë.

Andaj, përkundër që paraardhësi i paditësit dhe paditësi janë posedues të ligjshëm të paluajtshmërisë së dhënë në shfrytëzim, ligjshmëria e posedimit shtrihet në kufijtë e autorizimeve ligjore që derivojnë nga e drejta e shfrytëzimit ndërsa në asnjë mënyrë nuk e krijon mirëbesimin në posedim, si kusht për fitimin e pronësisë sipas parashkrimit fitues“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësja Z.J. nga G., pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan ka paraqitur padi kundër të paditurës K. L., për vërtetimin e të drejtës së pronësisë.
2. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega Lipjan C.nr.249/17 të datës 08.07.2020, në pikën një të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Z.J. nga G., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se e ka fituar të drejtën e pronësisë në ngastrën kadastrale nr.363/8, në vendin e quajtur “Selo” në sipërfaqe prej 0.06.50 ha në ZK Grackë e Vjetër, mbi bazën e mbajtjes përmes regjistrimit në regjistrat e paluajtshmërive më shumë se 20 vite dhe të detyrohet e paditura K.L., që të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë e përshkruar më detajisht në paragrafin I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia njoh paditësit dhe t’ia lejoj që kjo patundshmëri në regjistrin e paluajtshmërive të K.L., për ZK Grackë e Vjetër, të regjistrohet në emër dhe pronësi të paditësit, në të kundërtën kjo e drejtë do të regjistrohet sipas këtij aktgjykimi i cili paraqet titull juridik për regjistrim. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.
3. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësit me aktgjykimin Ac.nr.4735/2020 të datës 08.06.2022, e ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë/Dega Lipjan, C.nr.249/2017 të datës 08.07.2020,

ashtu që në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të miratoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Z.J. nga G., dhe të vërtetohet se ai/paditësi është pronar i paluajtshmërisë, ngastër kadastrale nr. 363/8, në sipërfaqe prej 0.06.50 ha, e cila gjendet në vendin e quajtur “Selo” në ZK Grackë e Vjetër, K. L.. Në pikën II të dispozitivit detyrohet e paditura K. L, që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj shumën në lartësi prej 1.377.20 €, brenda afatit partitiv prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kanosjen e përbarimit të detyrueshëm. Në pikën III të dispozitivit është vendosur që ekspertiza nga lëmi i gjeodezisë e bërë nga ekspertja D.T.G, më datë 8.4.2020 - është pjesë përbërëse e këtij aktgjykimi dhe në pikën IV të dispozitivit është vendosur që ky aktgjykim do të shërbej si titull juridik për bartjen e paluajtshmërisë së përshkruar si në paragrafin I të tij, në emër të paditësit – si pronar në operatin kadastral të K. L.

4. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e autorizuara e të paditurës në afat ligjor ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranoj revizionin, të ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe të lë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë, apo të prishë aktgjykimin e goditur dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë, gjegjësisht shkallës së dytë në rigjykim dhe rivendosje.
5. Pala paditëse nuk ka paraqitë përgjigje në revizionin e të autorizuarës së të paditurës.
6. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se: Revizioni i të paditurës është i themeltë.
7. Nga shkresat e lëndës dhe padia e paditësit e ushtruar më datë 08.06.2017 rezulton se paditësi ka kërkuar të vërtetohet se është pronarë në paluajtshmërinë ngastër kadastrale nr. 363/8, mbi bazën e mbajtjes me mirëbesim mbi 20 vite dhe përmes regjistrimit në regjistrat e paluajtshmërive. Ka theksuar se këtë paluajtshmëri e ka trashëguar në vitin 2015 nga paraardhësi i tij juridik përkatësisht babai i tij tani i ndjeri M.J., i cili ka vdekur më datë 30.07.2012, e të cilit këtë paluajtshmëri ia ka dhënë K. L. në vitin 1997, si trull për ndërtimin e shtëpisë familjare, gjë që i ndjeri e ka bërë dhe e ka

shfrytëzuar/poseduar bashkë me familjen e tij, e që së fundi me të njëjtën posedon paditësi këtu si i vetmi trashëgimtar dhe ka bartur në emër të vetin në operatin përkatës kadastral.

8. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të deklaratave të palëve ndërgjyqëse dhe provave nga shkresat e lëndës lidhur me çështjen konkrete juridike, përfshirë këtu edhe dokumentacionin kadastral por edhe ekspertizën e ekspertes së bërë nga D.T.G. më datë 08.04.2020, me pjesën grafike të saj, nga dita e daljes në vendshiqim më datë 21.02.2020, me zbatimin e nenit 20, nenit 28 paragrafi 4 dhe nenit 29 lidhur me nenin 72 paragrafi 2 të LTHMPJ-së, (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr.6/80), pastaj nenit 9 të Ligjit për Qarkullimin e Paluajtshmërive, nenit 6 paragrafi 2 të Ligjit mbi Tokat Bujqësore, ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ashtu siç figuron në dispozitivin e aktgjykimit të goditur.
9. Gjykata e Apelit në trajtimin e ankesës së palës paditëse ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje juridike ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale që ka rezultuar me refuzimin e padrejtë të kërkesëpadisë së paditësit, andaj aktgjykimin e shkallës së parë e ka ndryshuar në kuptim të nenit 201 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 194 paragrafi 1 pika e) e LPK-së me miratimin e kërkesëpadisë së paditësit.
10. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se nga shkresat e lëndës kuptohet qartë se paluajtshmërinë lëndore, ngastër kadastrale nr. 363/8, në vendin e quajtur “Selo” në sipërfaqe prej 0.06.50 ha, në ZK Grackë e Vjetër, Komuna e Lipjanit në vitin 1997 ja ka ndarë babait të paditësit, tani të ndjerit M.J. në shfrytëzim të përhershëm, (pa të drejtë tjetërsimi) për ndërtimin e objektit familjar për banim sipas Vendimit të saj 02.Nr.464-354 të datës 05.05.1997. Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestues fakti se tani i ndjeri M.J. në këtë paluajtshmëri menjëherë pas marrjes së saj si truall në vitin 1997, ka ndërtuar shtëpi banimi familjare, me leje ndërtimore të dhënë nga vet Komuna e paditur, e që nga ajo kohë të njëjtën e ka poseduar/shfrytëzuar me familjen e tij. Këtë paluajtshmëri ai edhe e ka regjistruar në emër të tij si shfrytëzues i përhershëm i të njëjtës. Më pas këtë paluajtshmëri e ka trashëguar Z.J., këtu paditësi si fëmijë i të ndjerit M. dhe i vetmi trashëgimtar i tij, i cili pretendon se i takon e drejta e pronësisë mbi të njëjtën sipas dispozitave ligjore në fuqi, pasi që me të posedojnë si posedues të ndërgjegjshëm dhe të ligjshëm mbi 20 vite dhe njësoj e kanë të regjistruar në emër të

vetin mbi 20 vite (fillimisht ka qenë e regjistruar në emër të babait të tij e pas vdekjes së tij në emër të paditësit).

11. Gjykata e Apelit ka theksuar se gjykata e shkallës së parë, vendimin e vet refuzues e ka bazuar kryesisht në nenin 29 të LMTHJP-së (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr.6/80), me të cilin ka qenë e paraparë se “mbi sendet në pronësinë shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrim fitues”, duke anashkaluar faktin se neni 29 i LMTHJP-së është fshirë/hequr me nenin 16 të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e LMTHJP-së (Gazeta Zyrtare e RSJ, nr. 29/96), në fuqi nga data 03.08.1996, me të cilin barazohen pronat private me pronat shoqërore dhe duke e kualifikuar gabimisht paditësin si “posedues me keqbesim”, gjë që bie ndesh me nenin 28 paragrafi 4 të LMTHJP-së, në të cilin paditësi edhe e bazon kërkesëpadinë e tij, por bie ndesh edhe me nenin 72 paragrafi 1 të po të njëjtit Ligj, i cili i referohet posedimit të ligjshëm.
12. Gjykata e shkallës së dytë vlerëson në mënyrë të padyshimtë se paditësi Z.J. është posedues i ligjshëm dhe me mirëbesim, sepse paluajtshmërinë lëndore e ka trashëguar nga babai i tij, i cili ka pasur bazë të plotfuqishme juridike të posedimit sipas Vendimit të vet Komunës së paditur, 02.Nr.464-354, datë 05.05.1997, me të cilin truallit ngastër kadastrale nr.363-8 ZK Grackë e Vjetër, KK Lipjan, i është dhënë në shfrytëzim të përhershëm për ndërtim të objektit për banim familjar, gjë që tani i ndjeri edhe e ka bërë/ndërtuar, e që këtë paluajtshmëri i ndjeri M., sa ka qenë gjallë, me kohë edhe e ka regjistruar në emër të vetin në operatin kadastral, e pas vdekjes së tij e njëjta evidentohet në emër të paditësit Z., si i vetmi trashëgimtarë ligjor i tij. Po ashtu, sipas nenit 30 paragrafi 2 të LMTHJP-së, në kohën që duhet për mbajtje, llogaritet edhe koha gjatë së cilës paraprakët e mbajtësit aktual e kanë mbajtur sendin e caktuar, si mbajtës/posedues të ligjshëm e të ndërgjegjshëm - e që si i tillë kualifikohet paditësi nga gjykata e shkallës së dytë, të cilit koha e posedimit, si posedues i ndërgjegjshëm e me mirëbesim i llogaritet edhe koha e posedimit të paluajtshmërisë lëndore nga parapraku përkatësisht nga babai i tij tani i ndjeri M.J., që bëjnë më shumë se 20 vite në momentin e ushtrimit të padisë më datën 08.06.2017, prandaj plotësohen të gjitha kushtet ligjore që kërkesëpadia e tij të miratohet në tërësi si e bazuar dhe paditësit ti njihet e drejta e pronësisë në paluajtshmërinë, objekt i lëndës. Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit sigurohet edhe me nenin 40 të LPDTS, në fuqi nga Tetori 2009.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk mund ta pranoj si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, kjo pasi që aktgjykimi i kundërshtuar është i përfshirë në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilin shkak gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.
2. Gjykata Supreme e Kosovës pranon në tërësi qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, mirëpo vlerëson se gjykata e shkallës së dytë mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar gabimisht ka aplikuar dispozitat materiale kur ka vendosur lidhur me këtë çështje.
3. Në këtë rast nuk është kontestues fakti që fillimisht paraardhësi i paditësit në vitin 1997, e më pas paditësi sipas trashëgimisë, kanë marrë nga e paditura në shfrytëzim të përhershëm (pa të drejtë tjetërsimi) ngastrën kadastrale nr. 363-8 ZK Grackë e Vjetër, K. L. Në bazë të certifikatës për të drejtat e pronës me nr.1428/2015, të datës 12.11.2015, është vërtetuar se paditësi është posedues i paluajtshmërisë kontestuese. Kjo gjykatë vlerëson se parashkrimi fitues nuk mund të jetë bazë për të fituar të drejtën e pronësisë në këtë paluajtshmëri, kjo pasi që pala e paditur paraardhësit të paditësit ja ka dhënë këtë paluajtshmëri në shfrytëzim të përhershëm pa të drejtë të tjetërsimit (pra pa autorizime të pronarit) ndërsa pala e paditur ka ngelur pronare e paluajtshmërisë, ashtu siç figuron edhe sot që kjo ngastër evidentohet si pronë shoqërore. Në këtë rast është e vërtetë që paraardhësi dhe paditësi janë posedues të ligjshëm të paluajtshmërisë kontestuese, por që ligjshmëria e posedimit shtrihet në kufijtë e autorizimeve ligjore që derivojnë nga e drejta e shfrytëzimit ndërsa në asnjë mënyrë nuk e krijojnë mirëbesimin në posedim, si kusht për fitimin e pronësisë sipas parashkrimit fitues.
4. Për të fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim, përveç tjerave, duhet të ekzistoj edhe mirëbesimi i posedimit, çka në rastin konkret nuk mund të konsiderohet e as të prezumohet mirëbesimi, sepse e paditura u kishte dhënë në shfrytëzim të përhershëm ngastrën kontestuese me qëllim të ndërtimit të shtëpisë por pa të drejtë të tjetërsimit,

andaj nuk mund të flitet për rrjedhje të afatit të parashkrimit përderisa paraardhësi i paditësit dhe paditësi e kanë ditur dhe është dashur ta dinjë se kjo paluajtshmëri u është dhënë vetëm në shfrytëzim, ndërsa pronare ka ngelur pala e paditur.

5. Në rrethana të tilla rezulton se në këtë rast që nga fillimi i ndërtimit të raportit mes palëve ndërgjyqëse, paraardhësi i paditësit dhe paditësi kanë qenë në dijeni të faktit se ata e kanë vetëm të drejtën e shfrytëzimit në paluajtshmërinë kontestuese, pa të drejtë të tjetërsimit, ndërsa e paditura është pronare, kështu që duke ju referuar nenit 72 të LMTHPJ nuk mund të konstatohet ligjshmëria e posedimit dhe mirëbesimi në posedim si kusht për të ndërtuar bazën e parashkrimit fitues si mënyrë e fitimit të pronësisë, kjo pasi që ligjshmëria e posedimit në këtë rast mbështetet në të drejtën e shfrytëzimit, ndërsa mirëbesimi në posedim nuk ekziston ngase paraardhësi i paditësit dhe vet paditësi kanë qenë në dijeni të faktit se kjo paluajtshmëri u është dhënë vetëm në shfrytëzim për qëllim të ndërtimit të shtëpisë pa të drejta pronësore, ngase shprehimisht në vendim me të cilin paluajtshmëria u është dhënë në shfrytëzim është konstatuar se paluajtshmëria nuk mund të tjetërsohet nga shfrytëzuesi. Kjo gjykatë vlerëson se në rrethana të tilla pala paditëse nuk ka plotësuar asnjë nga kushtet ligjore të përcaktuara në nenet 20, 28.4 dhe 29 të LMTHPJ për ta fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese, andaj nuk është pranuar qëndrimi i gjykatës së shkallës së dytë në këtë çështje ku edhe aktgjykimi i atakuar me revizion është ndryshuar, ndërsa ka mbetë në fuqi aktgjykimi i shkallës së parë.
6. Nga arsyet e paraqitura dhe në pajtim me nenin 224.1 të LPK-së, kolegji civil i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi që të pranohet si i themeltë revizioni i të autorizuarës të paditurës, të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4735/2020 i datës 08.06.2022, ashtu që të mbetet në fuqi aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.249/17, i datës 08.07.2020.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.23/2024, i datës 22.07.2024

”Në rastet kur nga autoriteti shtetëror është shpronësuar sendi i paluajtshëm, është paguar kompensimi i shpronësimit dhe pronësia është regjistruar në emrin e organit shpronësues përmes vendimit për shpronësimi, pavarësisht faktit se personit nga i cili është shpronësuar paluajtshmëria nuk i është marrë edhe posedimi faktik i sendit, nuk i jep të drejtën këtij të fundit që të kërkojë vërtetimin se është pronar i sendit mbi bazën e parashkrimit fitues“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.4/2017 të datës 03.05.2019, në pikën I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Xh.H., e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Gjilanit dhe është vërtetuar se paditësi është pronar i njësisë kadastrale me numër P-.....-.....- në sipërfaqe të përgjithshme prej ... m2, nga e cila tokë ndërtimore-oborr në sipërfaqe prej ... m2, ndërsa në sipërfaqe prej .. m2 tokë-ndërtimore-shtëpi, në vendin e quajtur “....., Zona Kadastrale Gj. e cila pronë e paluajtshme - njësi kadastrale në Regjistrat e të Drejtave të Pronave të Paluajtshme në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Gj, formalisht evidentohet sipas certifikatës së pronës me numër të lëndës 9667-2016 të datës 22.08.2016, në emër të P.SH. BVI për Banim dhe Veprimtari Komunale-Banesore, KK - Gjilan. Në pikën II të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumën prej 905 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
2. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr.2907/19 të datës 25.10.2023, në pikën I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit dhe është ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.04/2017 i datës 03.05.2019 dhe çështja lëndore gjykohet si në vijim: refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Xh.H., nga Gj., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi në bazë të parashkrimit fitues është pronar i paluajtshmërisë-njësisë kadastrale P-.....-.....-, në sipërfaqe të përgjithshme prej ... m2 , tokë ndërtimore-oborr në sipërfaqe prej ...m2 dhe tokë ndërtimore shtëpi-ndërtesë në sipërfaqe prej 58 m2 , në vendin e quajtur “.....”,

Zona Kadastrale Gj., e cila paluajtshmëri-njësi kadastrale në Regjistrin e të Drejtave të Pronave të Paluajtshme në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Gjilan, formalisht evidentohet në emër të P.SH. BVI për Banim dhe Veprimtari Komunale - Banesore KK. Gjilan; të obligohet e paditura që këtë të drejtë t'ia njohë paditësit dhe të duroj që kjo paluajtshmëri në bazë të këtij aktgjykimi të regjistrohet në emër të paditësit, e po ashtu të obligohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 905 euro dhe atë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërinë të aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale dhe në pikën III të dispozitivit është hedhë poshtë si e palejueshme parashtrësia me deklaratë për ndërhyrje në këtë proces kontestimor, në emër të S.H., dhe V. H., nga Gj dhe ankesa e ushtruar nga Zyra e Avokatisë B&B SH.P.K., në Gjilan, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.04/2017 i datës 03.05.2019.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, revizion ka paraqitur i autorizuari i paditësit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të pranoj revizionin e paditësit, të ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ashtu që të vërtetoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 905 € dhe revizionit në shumë prej 1062 €, ose aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të priset dhe çështja ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së dytë.
4. I autorizuari i të paditurës, ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditësit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës revizionin e paditësit ta refuzoj, ashtu që të vërtetoj aktgjykimin e Gjykatës së Apelit si të bazuar në legjislacionin e Republikës së Kosovës.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, revizionin e të autorizuarit të paditësit, si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se: Revizioni i të autorizuarit të paditësit është i pathemeltë.

6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes përfaqësuesit të tij, më datë 23.12.2016 në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për vërtetimin e pronësisë nga baza e parashkrimit fitues, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, me arsye sikurse në padi. Gjykata e shkallës së parë ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se njësia kontestuese ka numrin ...-..... Gj dhe ka sipërfaqen prej ...m2, tokë ndërtimore-oborr në sipërfaqe prej ...m2, dhe tokë ndërtimore shtëpi në sipërfaqe prej .. m2 . Paluajtshmërinë paditësi e kishte trashëguar nga babai, tani i ndjeri M.A, ndërsa babai i tij M e kishte trashëguar nga babai i tij M.I., Gj., dhe se paditësi dhe paraardhësit e tij paluajtshmërinë e kanë shfrytëzuar me mirëbesim dhe në mënyrë të ligjshme që nga viti 1945, ku BVI e atëhershme për banim dhe shfrytëzim ia ka ndarë këtë paluajtshmëri M I., Gj dhe se të njëjtit që nga ajo kohë e shfrytëzojnë të papenguar nga askush.
7. Gjykata e shkallës së parë më tej ka shtuar se nga provat e paraqitura shihet qartë se është zhvilluar procedura e eksproprijimit, mirëpo shihet se ajo procedurë ka mbetur vetëm në letër ngase qëllimi i eksproprijimit asnjëherë nuk është realizuar në terren dhe as paraardhësi i paditësit, e as paditësi asnjëherë nuk kanë marrë kompensimin për atë eksproprijim. E po ashtu nga aktvendimi i datës 10.09.1982, me nr. të protokollit ...-...-...-./...-., gjykata vërtetoi faktin se është marrë nga posedimi e drejta e shfrytëzimit të tokës ndërtimore të ndërtuar të qytetit të pronarit të mëparshëm M.I.A nga Gj., lidhur me ngastrën kadastrale nr.... dhe është eksproprijuar e drejta e pronësisë në kompensim, në dobi të BVI-së për Banim dhe se lartësia e kompensimit për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit dhe eksproprijimit do të caktohet në bazë të dispozitave të Ligjit mbi Eksproprijim, në procedurë të veçantë.
8. Gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit ka bazë ligjore dhe të njëjtën e aprovoi, meqë është vërtetuar themelësia e saj, ashtu që paditësi në bazë të nenit 28 të LTHMPJ-së e ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese, duke theksuar se paditësi ngastrën lëndore e ka poseduar me mirëbesim më tepër se 20 vjet, pra këtu paditësi së bashku me paraardhësit e tij e ka poseduar dhe shfrytëzuar këtë paluajtshmëri pa u penguar nga askush që nga viti 1945, nga çka rezulton se paditësi është mbajtur me mirëbesim dhe i ligjshëm i ngastrës lëndore dhe se në këtë rast pushteti faktik është shndërruar në pushtet juridik dhe mbi këtë bazë ka rezultuar bazueshmëria e kërkesëpadisë së paditësit. Ka arsyetuar po ashtu se me

dispozitën e nenit 29 të LMTHPJ-së, ka qenë e paraparë që në sendet në pronën shoqërore nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me mbajtje, mirëpo ky nen është fshirë me nenin 16 të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e LMTHPJ-së (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr.29/96) në fuqi nga data 04.07.1996, i cili nuk ka fuqi prapavepruese.

9. Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës së të paditurës, ka aprovuar si të bazuar ankesën, duke vlerësuar se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Sipas kësaj gjykate aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, mirëpo sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore, për pasojë ka pasur edhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
10. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e pabazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet konform nenit 201 pika b) të LPK-së, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.
11. Gjykata e Apelit, pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës ka theksuar se sipas gjendjes së fundit të vitit 1983, ngastra kadastrale nr. ka pasur sipërfaqe prej ... m2, nga e cila shtëpi në sipërfaqe prej .. m2, oborr ... m2 dhe pemishte ... m2, e cila ka qenë e evidentuar në emër të M. I H nga Gj. për nevojat e rregullimit të shtratit të lumit M – atëherë D kjo ngastër kadastrale me vendimin e Sekretariatit Komunal për Punë Komunale Banesore dhe Pronëso-ro-Juridike është shpronësuar dhe se pas përfundimit të procedurës së shpronësimit kjo ngastër kadastrale në sipërfaqen prej ...m2 është ndarë, nga e cila janë krijuar dy njësi kadastrale dhe atë ngastra kadastrale nr.....- me sipërfaqe prej ... m2, shtëpi .. m2 dhe oborr ... m2, e cila ngastër është regjistruar në

emër të P.SH. BVI për Banim dhe Veprimtari Komunale Banesore, e cila edhe ishte organ shpronësues dhe ngastra kadastrale nr. ...-, me sipërfaqe prej ... m2 me shtëpi ... m2 dhe oborr ... m2, e cila është e evidentuar në emër të pronarit M.I.H., fakt ky i vërtetuar nga certifikatat mbi të drejtat e pronës së paluajshmë.

12. Nga provat tjera të cilat janë administruar si prova materiale nga gjykata e shkallës së parë dhe gjenden në shkresat e lëndës, siç është aktvendimi nr.10-465-47/84-01 i datës 15.06.1984, vërtetohet fakti se është anuluar aktvendimi i Sekretariatit numër 10-465-47/82-01 i datës 10.09.1982, me të cilin vendim pronarit të mëparshëm M/I .H., i ishte marrë nga posedimi ngastra kadastrale nr., me kulturë shtëpi, me sipërfaqe prej ./..... ha, oborr me sipërfaqe prej ./..... ha dhe pemishte në sipërfaqe prej..... ha, e në sipërfaqe të përgjithshme prej ha, në vendin e quajtur “.....”, e regjistruar në fletën poseduese nr..... ,KK. Gjilan, për nevojat e BVI për Banim dhe Veprimtari Komunale për rregullimin e Lumit D., dhe se me pikën 2 dhe 3 të këtij aktvendimi është vendosur që M.I.H.,t’i mirret nga posedimi dhe i është eksproprijuar me kompensim në dobi të BVI për Banim dhe Veprimtari Komunale të Komunës së Gjilanit, paluajshmëria me kulturë shtëpi, oborr dhe pemishte që gjendet në ngastrën kadastrale, në sipërfaqe prej ha, pra me këtë aktvendim është zvogëluar sipërfaqja e eksproprijuar ngam2 në sipërfaqen prej m2. Po ashtu nga procesverbali i datës 15.06.1984, i përpiluar pranë Sekretariatit për Punë Komunale Banesore dhe Pronësore Juridike rezulton se palët prezentë përfshirë edhe M.I H . , - paraardhësin e këtu paditësit janë marrë vesh dhe janë pajtuar për kompensimin e paluajshmërisë së eksproprijuar - ngastrës kadastrale nr. dhe se në këtë marrëveshje në një paragraf të saj është konstatuar se ka fuqinë e titullit ekzekutiv, fakt ky i vërtetuar edhe nga parashtrësja e Kuvendit të Komunës së Gjilanit - Sekretariati për Punë Komunale Banesore dhe Pronësoro-juridike numër ..-...-./...-/. e datës 23.08.1984, me të cilën është konstatuar se është arritur marrëveshja për caktimin e lartësisë së kompensimit për tokën e eksproprijuar me M. I. H. Pra nga ky procesverbal dhe parashtrësja është vërtetuar fakti se ish pronari, gjegjësisht këtu parardhësi i paditësit ishte pajtuar me këtë eksproprijim dhe kompensimin e caktuar për ngastrën e eksproprijuar.
13. Si rrjedhojë e të cekurave më lart, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë si rezultat i së cilës edhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht, kjo për faktin

se nga provat e administruara rezultojnë se ngastra lëndore përmes procedurave të rregullta ligjore, e sipas ligjeve të cilat kanë qenë në fuqi në atë kohë, nga organi shpronësues Kuvendi Komunal i Gjilanit - Sekretariatit për Punë Komunale Banësore dhe Pronësore Juridike, i është eksproprijuar paraardhësit të këtu paditësit, ku me rastin e eksproprijimit të saj, paraardhësit të paditësit, tani të ndjerit M.I H., i është caktuar kompensimi përkatës në të holla dhe se paraardhësi i paditësit ishte pajtuar me këtë eksproprijim dhe kompensim. Pas eksproprijimit të bërë ngastra lëndore në mënyrë të rregullt ligjore në librat kadastrale është regjistruar si pronë shoqërore, pasi që eksproprijimi i saj është bërë në interes të BVI për Banim dhe Veprimtari Komunale për Rregullimin e Lumit D., – tani M.

14. Gjykata e Apelit me vlerësimin e provave të nxjerra dhe të administruara nga gjykata e shkallës së parë gjen se kërkesa e paditësit për vërtetimin e pronësisë nga baza e mbajtjes - parashkrimi është e pabazuar edhe për kundër faktit se i njëjti pretendon se paluajtshmërinë lëndore- ngastrën kontestuese e ka në posedim dhe shfrytëzim më tepër se 20 vjet, ngase paditësi në rastin konkret duhet të provoj faktin se ka fituar pronësinë sipas nenit 28 paragrafi 4 të LMTHPJ-së. Në fakt, sipas paragrafit 4, të këtij neni, për t'u fituar e drejta e pronësisë, duhet që sendi të mbahet në posedim të pandërprerë dhe të ligjshëm (me mirëbesim) për 20 vite. Në rastin konkret, referuar provave të cekura më lart dhe gjendjes faktike e cila rezultojnë nga këto prova, Gjykata e Apelit vlerëson se e drejta e pronësisë nuk mund t'i njihet paditësit bazuar në provat e dhëna nga ai, duke qenë se është e qartë që nuk janë përmbushur kushtet për fitimin e një pronësie të tillë, sipas nenit 28 të LMTHPJ-së. Dispozita e tillë, kërkon që mbajtësi i paluajtshmërisë për 20 vite, duhet të jetë me mirëbesim, e në rastin konkret, nuk ka asgjë që e vërteton një gjendje të tillë. Përkundrazi, ashtu siç është vërtetuar nga të gjitha provat materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, përfshirë edhe certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme të administruara nga gjykata e shkallës së parë, rezultojnë se paditësi që nga fillimi ka qenë në dijeni se kjo ngastër nr. 3815-1 objekt kontesti, ka qenë dhe është në pronësi të paditurës Komuna e Gjilanit.
15. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit vlerëson se parashkrimi fitues në vete përmban katër elemente të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të fituar të drejtën e pronësisë mbi një send të paluajtshëm: (1) mbajtësi i ligjshëm, (2) mirëbesimi, (3) kalimi i periudhës kohore të caktuar me ligj dhe (4) posedimi i sendit mbi të cilin dikush

tjetër e ka të drejtën e pronësisë. Si rrjedhojë, referuar provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë vlerëson se në rastin e paditësit nuk përmbushen në mënyrë kumulative elementet e cekura më lart, për të konstatuar se i njëjti e ka fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues mbi ngastrën lëndore. Përveç të cekurave më lartë, sipas Gjykatës së Apelit, mirëbesimi paraqet një gjendje përmes së cilës ai në vetvete supozohet se ekziston, deri sa nuk provohet e kundërta, mirëpo meqë kemi të bëjmë me pronë shoqërore, pronë kjo specifike që gëzon një mbrojtje dhe pozitë të veçantë në të drejtën aktuale pozitive, çështja e mirëbesimit në këtë rast duhet të provohet qartazi dhe dukshëm, pa lënë vend për mëdyshje. Në mungesë të një vërtetimi të tillë të ekzistimit të mirëbesimit në shfrytëzimin e ngastrës lëndore nga paditësi, në të cilin shfrytëzim ky i fundit ka bazuar kërkesën për vërtetim të së drejtës së tij të pronësisë, Gjykata e Apelit konsideron se kërkesa e padisë së paditësit për vërtetimin e pronësisë nga baza e parashkrimit fitues është e pabazuar. Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, me rastin e marrjes së aktgjykimit të atakuar, për arsye se është provuar fakti se në rastin e paditësit nuk plotësohen kushtet ligjore nga neni 28 i LMTHJP-së, për të konstatuar se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi ngastrën kontestuese të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e evidentuar si pronë shoqërore në emër të paditurës Komuna e Gjilanit.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme

1. Gjkata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së kujdeset sipas detyrës zyrtare.
2. I autorizuari i paditësit në revizionin e paraqitur pretendon se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), lidhur me nenin 160 paragrafi 4 të LPK-së. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se pretendimet e tilla nuk janë të themelta, kjo për shkak se gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të qarta në lidhje me ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit. Gjykata e

shkallës së dytë bazuar në pretendimet ankimore ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë. Kjo gjykatë qartë ka arsyetuar se ka vlerësuar ndryshe gjendjen faktike nga gjykata e shkallës së parë dhe mbi bazën e këtij vlerësimi ka nxjerrë përfundim se paditësi me asnjë provë nuk ka arritur të vërtetojë se i takon e drejta e pronësisë në ngastrën kadastrale numër .-.....-, në sipërfaqe të përgjithshme prej ...m2, pastaj janë dhënë arsye të qarta pse paditësi nuk mund ta fitoj pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese sipas bazës së parashkrimit fitues.

3. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e Gjykatës së Apelit edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme nga ka rezultuar se kërkesëpadia është e pabazuar. Nga faktet e paraqitura rezulton se paraardhësit e paditësit dhe paditësi kanë qenë në shfrytëzim të paluajtshmërisë kontestuese që nga viti 1945, ku BVI e atëhershme për banim dhe shfrytëzim ia ka ndarë këtë paluajtshmëri M.I Gj, paraardhësit të paditësit. Sipas historikut të pronës - gjendjes së fundit të vitit 1983, ngastra kadastrale nr..... në sipërfaqe prej ...m2, për nevojat e rregullimit të shtratit të lumit – atëherë, me vendimin e Sekretariatit Komunal për Punë Komunale Banesore dhe Pronësoro-Juridike nr..... i datës 10.09.1982 është shpronësuar. Me aktvendimin tjetër të Sekretariatit Komunal për Punë Komunale Banesore dhe Pronësoro-Juridike, nr..... të datës 15.06.1984, rezulton se është anuluar aktvendimi i Sekretariatit numër i datës 10.09.1982, me të cilin vendim pronarit të mëparshëm M.I H., i ishte marrë nga posedimi ngastra kadastrale nr., me kulturë shtëpi, me sipërfaqe prej ha, oborr me sipërfaqe prej ha dhe pemishte në sipërfaqe prej ha, e në sipërfaqe të përgjithshme prej..... ha, në vendin e quajtur “.....”, e regjistruar në fletën poseduese nr.....KK. Gjilan, për nevojat e BVI për Banim dhe Veprimtari Komunale për Rregullimin e Lumit D dhe se me pikën 2 dhe 3 të këtij aktvendimi është vendosur që M.I.H., t’i mirret nga posedimi dhe i është ekspropriuar me kompensim në dobi të BVI për Banim dhe Veprimtari Komunale të Komunës së Gjilanit, paluajtshmëria me kulturë shtëpi, oborr dhe pemishte që gjendet në ngastrën kadastrale 3815, në sipërfaqe prej 0.04.80 ha, duke e zvogëluar kështu sipërfaqen e ekspropriuar nga 771 m2, në sipërfaqen prej 480 m2. Po ashtu nga

procesverbali i datës 15.06.1984, i përpiluar në Sekretariatën për Punë Komunale Banesore dhe Pronësore Juridike rezulton se palët ndërgjyqse janë marr vesh dhe janë pajtuar për kompensimin e paluajtshmërisë së eksproprijuar - ngastrës kadastrale nr. 3815, e nga parashtrësja e Kuvendit të Komunitetit të Gjilanit - Sekretariati për Punë Komunale Banesore dhe Pronësore-juridike, numër 10-465- 47/84-01 e datës 23.08.1984, është konstatuar se është arritur marrëveshja për caktimin e lartësisë së kompensimit për tokën e eksproprijuar me M.I. H., Pastaj pas përfundimit të procedurave të shpronësimit është krijuar gjendja e re ashtu që parcela nr. ...me sipërfaqe prej ... m2 është ndarë, nga e cila janë krijuar dy njësi kadastrale dhe atë ngastra kadastrale nr....., me sipërfaqe prej.... m2, shtëpim2 dhe oborrm2, e cila ngastrë është regjistruar në emër të P.SH. BVI për Banim dhe Veprimtari Komunale Banesore, e cila edhe ishte organ shpronësues dhe ngastra kadastrale nr., me sipërfaqe prej... m2 me shtëpi ... m2 dhe oborr.... m2, e cila është e evidentuar në emër të pronarit M.I.H, fakt ky i vërtetuar nga certifikatat mbi të drejtat e pronës së paluajtshme.

4. Gjykata Supreme vlerëson të pa themeltë pretendimin në revizion se regjistrimi i paluajtshmërisë në emër të BVI-së nuk është me ndikim në humbjen e pronësisë së paditësit, kjo pasi që paraardhësit të paditësit i është marrë nga posedimi e drejta e shfrytëzimit të tokës ndërtimore, përkatësisht ngastra kadastrale nr.3815-1, me sipërfaqe prej 280 m2, ndërsa kjo është bërë sipas vendimit për shpronësimin nr.10-465-47/84-01 të datës 15.06.1984, ku për shpronësimin e bërë paraardhësi i paditësit është kompensuar, ashtu siç rezulton nga procesverbali i datës 15.06.1984, sipas të cilit palët kanë arritur marrëveshje për caktimin e lartësisë së kompensimit për tokën e eksproprijuar. Pas përfundimit të procesit të shpronësimit, ngastra kontestuese është regjistruar në emër të BVI-së, ndërsa në shkresë të lëndës nuk ka asnjë provë që paraardhësi i paditësit apo paditësi ta kenë kontestuar procesin e shpronësimit në ndonjë formë dhe brenda afateve prej 3 dhe 10 viteve, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin mbi Eksproprijimin të vitit 1978, marrë për bazë pretendimin e paditësit se kjo paluajtshmëri asnjëherë nuk ka kaluar në posedim dhe shfrytëzim të BVI.
5. Kjo gjykatë vlerëson se paditësi e ka humbur të drejtën e tij në paluajtshmërinë kontestuese, ndërsa e paditura sipas nenit 20 të LMTHJP ka fituar të drejtën e pronësisë në këtë paluajtshmëri sipas bazës ligjore, përkatësisht vendimit të organit shtetërorë, në

këtë rast vendimit për shpronësim. Në rrethana të tilla kjo gjykatë vlerëson se paditësi nuk mund ta fitojë të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese sipas bazës së parashkrimit fitues nga neni 28 i LMTHPJ, kjo pasi që paluajtshmëria ka kaluar në emër të paditurës sipas bazës së ligjshme të ekspropriimit, paditësit apo paraardhësit të tij i është njohur kompensim për shpronësim, ndërsa fakti që ata nuk janë depozedu nga kjo paluajtshmëri ata nuk i bënë posedues me mirëbesim, ngase e kanë ditur dhe është dashur ta dijnë se kjo paluajtshmëri nuk është e tyre, pasi që ajo u është shpronësuar dhe për këtë janë kompensuar. Nga kjo rezulton se në asnjë rrethanë nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga dispozitat e nenit 28 të LMTHPJ për fitim të pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues.

6. Pala paditëse në revizionin e paraqitur pretendon se me asnjë provë e paditura nuk ka arritur të argumentoj që në ndonjë formë ta ketë kompensuar paditësin për paluajtshmërinë e marrë me shpronësim. Gjykata Supreme pretendim e tillë e ka vlerësuar si pa ndikim në vendosje në lidhje me çështjen e ngritur që ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë, kjo pasi që pala paditëse nuk ka pasur kërkesë për kompensim të paluajtshmërisë së shpronësuar, ndërsa gjykatat kanë kufizim ligjor që të mos dalin jashtë kufijve të kërkesave të palëve. Gjykatat kanë trajtuar kërkesën e palës paditëse në lidhje me vërtetimin e pronësisë, andaj kjo gjykatë vlerëson të pranueshëm vendimin e Gjykatës së Apelit për refuzim të kërkesëpadisë së paditësit, pasi që paditësi me asnjë provë nuk ka arritur të vërtetoj plotësimin e ndonjë kushti për të fituar pronësinë sipas ndonjë bazë të vlefshme ligjore. Parashkrimi fitues nuk ka mundur të përdoret në këtë rast si bazë për fitim të pronësisë, kjo pasi që e paditura ka marr paluajtshmërinë e paditësit sipas vendimit të shpronësimit që ka marrë formë të prerë, pala paditëse nuk ka bashkangjitur prova që ka atakuar atë në ndonjë formë, pastaj ekzistojnë prova për procesin e kompensimit, ndërsa për këtë pala paditëse vetëm pretendon se nuk është kompensuar por që nuk paraqet kërkesë për kompensim dhe nuk e argumenton të kundërtën. Mbi bazën procesit të shpronësimit konsiderohet se e paditura me bazë ligjore është regjistruar pronare e paluajtshmërisë kontestuese, andaj përjashtohet baza e parashkrimit fitues që paditësi ta fitoj pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese.
7. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, kolegji civil i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi që të refuzohet i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditësit Xh. H nga Gjilani, i paraqitur kundër aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2907/19 të datës 25.10.2023.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.56/2024, i datës 18.07.2024

”Kontrata për shitjen e sendit të paluajtshëm, e cila nuk është lidhur në formën e pëcaktuar ligjore, nuk mund të shërbejë si titull në bazë të të cilit mund të njihet pronësia mbi sendin e paluajtshëm. As fakti që pala paditëse ka përmbushur pjesërisht kontratën kjo atë nuk e bënë titull të vlefshëm, por që i mundëson të kërkoj kthimin e asaj që ka dhënë“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.1301/19 të datës 13.07.2021, në pikën I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.M., nga fshati, Komuna e F., ndaj të paditurive: B.R.,nga fshati, Komuna e F., dhe Z.B., nga K., R e S.. Në pikën II të dispozitivit vërtetohet se paditësi A. M., (trashëgimtari ligjor i të ndjerit M.M), është pronar i paluajtshmërive të evidentuara si parcelat numër ..vendi i quajtur “L të Sh”, në sipërfaqe prej ha, me kulturë oborr, në sipërfaqe prej, ha, sipërfaqja prej,vendi i quajtur “L të Sh”, me kulturë arë e klasit .., në sipërfaqe prej, ha;../.vendi i quajtur “L te J”, me kulturë livadh-klasa e .., me sipërfaqe prej, ha;3 vendi i quajtur “...”, me kulturë arë e klasës së..., me sipërfaqe prej.... ha; vendi i quajtur “...”, me kulturë arë e klasës 3, me sipërfaqe prej ha; vendi i quajtur “...”, me kulturë arë e klasës së .., me sipërfaqe prej ha;vendi i quajtur “.....”, me kulturë livadhi klasës së .., me sipërfaqe prej ha; vendi i quajtur “.....”, me kulturë arë e klasës .., me sipërfaqe prej..... ha; vendi i quajtur ‘’.....’’, arë e klasës së . me sipërfaqe prej ha, të gjitha të regjistruara në Zonën Kadastrale N., në bazë të shitblerjes. Në pikën III të dispozitivit janë detyruar të paditurit: B. R., nga fshati N, Komuna e F dhe Z.B nga K., (trashëgimtari ligjor i T. B, që paditësit A.M, t’ia njohin të drejtën e pronësisë në paluajtshmëritë e përshkruara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe i padituri Z.B., të pranojë nga paditësi shumën prej € (njëqindmijë euro-kundërvlerën prej DM), të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit me shkrim të këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim paditësit do t’i shërbejë si titull juridik për regjistrimin e të drejtave të pronësisë në regjistrat kadastral. Në pikën IV të dispozitivit janë detyruar të paditurit që në mënyrë solidare, në emër të shpenzimeve të procedurës, t’i paguajnë paditësit

shumën prej (..... në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar. Ndërsa, ky aktgjykim është korrigjuar me anë të aktvendimit C.nr.1301/19 të datës 15.09.2021, vetëm për sa i përket parcelës me nr.....N., ashtu që sipërfaqja e kësaj parcele duhet të jetë ha, kurse pjesët e tjera të aktgjykimit kanë mbetur të pandryshuara.

2. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesave të paditurve, me aktgjykimin Ac.nr.9443/2021 të datës 07.11.2023, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të aprovoj si të themeltë ankesën e të paditurit B.R nga fshati N, Komuna e F dhe ankesën e të paditurit Z.B nga K., Republika e Serbisë, ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1301/19 të datës 13.07.2021, i korrigjuar me anë të aktvendimit C.nr.1301/19 të datës 15.09.2021 dhe çështja lëndore gjykohet si në vijim: “Refuzohet tërësisht e pabazuar kërkesëpapia e paditësit A.M., nga fshati N, Komuna e F., me të cilën ka kërkuar që të “Vërtetohet se paditësi A.M., (trashëgimtari ligjor i të ndjerit M M), është pronar i paluajtshmërive të evidentuara si parcelat numër ... vendi i quajtur “L të Sh”, në sipërfaqe prej ha, me kulturë oborr, në sipërfaqe prejha, sipërfaqja prej..... ha;..... vendi i quajtur “.....”, me kulturë arë e klasit .. në sipërfaqe prejvendi i quajtur “..... te”, me kulturë livadh-klasa e ..., me sipërfaqe prej.....; vendi i quajtur “....”, me kulturë arë e klasës së .., me sipërfaqe prej ha; vendi i quajtur “....”, me kulturë arë e klasës... me sipërfaqe prej..... ha; vendi i quajtur “....”, me kulturë-arë e klasës së ..., me sipërfaqe prejha; vendi i quajtur “...t”, me kulturë livadhi klasës së ., me sipërfaqe prej..... ha; vendi i quajtur “.....”, me kulturë arë e klasës .., me sipërfaqe prej ha; vendi i quajtur “.....”, arë e klasës së.. me sipërfaqe prej ha, të gjitha të regjistruara në Zonën Kadastrale N, në bazë të shitblerjes, si dhe të detyrohen të paditurit B. R nga fshati N, Komuna e F dhe Z.B nga K., (trashëgimtari ligjor i T B), që paditësit A.M t’ia njohin të drejtën e pronësisë në paluajtshmëritë e përshkuara si më lartë, si dhe i padituri Z. B të pranojë nga paditësi shumën prej € (njëqindmijë euro-kundërvlerën prej DM), të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit me shkrim të këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim paditësit do t’i shërbej si titull juridik për regjistrimin e të drejtave të pronësisë në regjistrat kadastral”. Në pikën II të dispozitivit është detyruar paditësi A.M. nga fshati, Komuna e F., që të paditurit Z.B nga K, R e S., në emër të shpenzimeve të procedurës

ti paguajë shumë prej, euro, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditësit, në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin, të prishë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ashtu që lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë - kolegjit tjetër në rivendosi, apo të ndryshoj aktgjykimin e shkallës së dytë dhe të vërtetojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe të detyrojë të paditurit që në mënyrë solidare të paguajnë shpenzimet për paraqitjen e revizionit dhe taksës për revizion.
4. I autorizuari i të paditurit B.R., ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditësit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës revizionin e paditësit ta refuzoj si të pathemeltë, ashtu që të vërtetoj aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.
5. I autorizuari i të paditurit Z.B., nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditësit.
6. Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, revizionin e të autorizuarit të paditësit, si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se: Revizioni i të autorizuarit të paditësit është i pathemeltë.
7. Nga shkresat e lëndës rezulton se fillimisht paditësi M. M., nga fshati N., Komuna e F., më datë 12.07.2001 ka paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë (ish-Gjykatën Komunale të Ferizajt), kundër të paditurit N.R nga fshati N., Komuna e F., për vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe dorëzimin e të njëjtës, me arsyet sikurse në padi. Më datë 03.12.2001 përfaqësuesi i paditësit ka bërë precizimin e padisë në kuptimin subjektiv, ku si të paditur ka evidentuar N. R., nga fshati N., Komuna e F., T.B., nga K., R e S., dhe B. R., nga fshati..., Komuna e F, ndërsa është kërkuar vërtetimi i të drejtës së pronësisë lidhur me paluajtshmëritë e specifikura në kërkesëpadi e mbi bazën e kontratës së shitblerjes së datës 1 gusht 2000. Më datë 12.09.2002 i padituri B.R., ka ushtruar kundërpadi ndaj T.B dhe M.M., me të cilën ka kërkuar të drejtën e pronësisë

në patundshmërinë e evidentuar në fletën poseduese nr.20 dhe 23 të KK Nekodim. Gjykata e shkallës së parë, ish-Gjykata Komunale në Ferizaj, kishte zhvilluar procedurën e provave dhe kishte nxjerrë aktgjykimin C.nr.884/04 të datës 08.08.2005, me të cilin e kishte refuzuar kërkesëpadinë e paditësit dhe kishte aprovuar kundërpadinë e të paditurit kundërpaditësit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

8. Kundër aktgjykimit C.nr.884/04 të datës 08.08.2005, kishte ushtruar ankesë pala paditëse, kurse gjykata e shkallës së dytë, në atë kohë ish-Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktvendimin AC.nr.80/2006, të datës 25.02.2008, kishte kthyer lëndën në rigjykim.
9. Gjykata e shkallës së parë - Gjykata Themelore Ferizaj në riprocedurë, duke vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës së shkallës së dytë, kishte zhvilluar procedurën e provave dhe kishte nxjerrë aktgjykimin C.nr.111/2008 të datës 27.02.2013, me të cilin e kishte refuzuar kërkesëpadinë e paditësit dhe kundërpadinë e të paditurit-kundërpaditësit si të pabazuara, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të atij aktgjykimi.
10. Kundër aktgjykimit C.nr.111/2008 të datës 27.02.2013, kishte ushtruar ankesë pala paditëse, kurse Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin Ac.nr.1275/13 të datës 30.01.2018, kishte kthyer lëndën në rigjykim për pikën I (një) të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, e cila kishte të bënte me refuzimin e kërkesëpadisë së palës paditëse.
11. Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë kishte nxjerrë aktgjykimin C.nr.113/18, të datës 18.10.2018, me të cilin kishte aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit A. M., si të bazuar, ndërsa kishte hedhur poshtë si të palejuar kundërpadinë e të paditurit-kundërpaditësit B.R, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të atij aktgjykimi.
12. Kundër aktgjykimit C.nr.113/18 të datës 18.10.2018, kishin ushtruar ankesë i padituri i parë dhe i padituri i dytë, kurse Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin Ac.nr.4884/18 të datës 15.10.2019, kishte prishur pikat I, II, III dhe V të aktgjykimit C.nr.113/18, të datës 18.10.2018 dhe për këto pjesë kishte kthyer lëndën në procedim të sërishëm, ndërsa kishte vërtetuar pikën IV të të njëjtit aktgjykim.

13. Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.1301/19, të datës 13.07.2021, me të cilin ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit A. M., duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

14. Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se mes palëve nuk kanë qenë kontestuese faktet se më datë 01.08.2000 është lidhë kontrata e shitblerjes për paluajtshmëritë kontestuese, në mes të paraardhësit të paditësit A.M., - M.M., dhe paraardhësit të paditurit të dytë Z.B – T.B., të cilët ishin pajtuar që çmimi kontraktues të jetë DM, ndërsa kjo kontratë është përmbushë pjesërisht (gjysma e saj), nga ana e paditësit, duke ia paguar paraardhësit të paditurit të dytë shumë prejDM. Gjithashtu nuk ishte kontestuese se shitësi T.B., në kohën e lidhjes së kontratës 01.08.2000 deri më 2004, nuk ishte pronar i parcelave kontestuese, dhe dhe se të njëjtat kanë qenë të regjistruara në emër të Komunës së F.,. Ndërsa, si fakt kontestues mes palëve ishte mos përmbushja e kontratës në mes paraardhësit të paditësit M.M., kundrejt paraardhësit të paditurit të dytë T.B.. Gjykata e shkallës së parë më tej ka vlerësuar pretendimin e paditësit se arsyeja e mos përmbushjes në tërësi të kontratës me kohë ka qenë fakti se parcelat ... dhe,..... dhe në kohën e arritjes së marrëveshjes, nuk kanë qenë të regjistruara pranë Drejtorisë së Kadastrit, në emër të paraardhësit të paditurit të dytë, ndërsa të paditurit e kanë kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit me pretendimin se paditësi nuk ka arritur ta përmbushë në tërësi kontratën e shitblerjes së datës 01.08.2000, duke e justifikuar veprimin e paraardhësit të paditurit të dytë, i cili përmes deklaratës pranë Gjykatës në K., e ka shkëputur në mënyrë të njëanshme kontratën. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga plotësimi i ekspertizës së gjeodezisë nga eksperti R.A, rezulton se parcelat, dhe, kanë kaluar nga Kuvendi i Komunës së Ferizaj, tek pronari i ri në atë kohë në emër të paraardhësit të paditurit të dytë, T. B, e që rezulton se ndërrimi i pronarëve të këtyre parcelave është bërë në vitin 2004.

15. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi kishte arritur që pjesërisht apo gjysmën e shumës kontraktuese ta përmbushë dhe se pamundësia e përmbushjes së kontratës nga ana e paditësit është paraqitur gjatë ekzekutimit të kontratës, andaj në rastin konkret pretendimi i paditësit rreth pasigurisë në lidhje me ekskluzivitetin e titullit juridik të parcelave të cekura më lartë, gjen mbështetje në dispozitivin e nenit 123 paragrafi 1 të LMD-së. Palët me rastin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së

paluajtshmërive konsiderohet se kanë qenë të shtyrë nga vullneti mirë dhe po ashtu konsiderohet se edhe qëllimi i tyre ka qenë që të materializohet vullneti i tyre ashtu siç ka përcaktuar dispozita e nenit 28 paragrafi 2, lidhur me nenin 26 të LMD-së, pasi që është vërtetuar se palët në momentin e nënshkrimit të kontratës, nuk kanë të shtyrë nga asnjë shkak në realizimin e marrëveshjes, andaj veprimi padituri të parë, respektivisht paraardhësit të dytë duke deklaruar në mënyrë të njëanshme kontratën e shitblerjes, sipas bindjes së gjykatës përbën shmangie dhe devijim të vullnetit të përbashkët kontraktues. Madje një veprim i tillë tejkalon edhe frymën ligjore të përcaktuar me dispozitën e nenit 19 të LMD-së.

16. Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesave të autorizuarve të paditurve, ka aprovuar ankesat dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke vlerësuar se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palëve ankuese, mirëpo sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat e lëndës, ku për pasojë ka pasur edhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
17. Kjo gjykatë ka vlerësuar se ka pasur zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë, andaj me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e pabazuar.
18. Gjykata e Apelit si fakt kryesor kontestues mes palëve ka konsideruar mos përmbushjen e kontratës interne të shitblerjes së paluajtshmërive lëndore, e lidhur në mes të ndjerit M.M., (paraardhës i tani paditësit A. M) dhe të ndjerit T.B (paraardhës i të paditurit të dytë Z.B) e datës 01.08.2000, andaj për ta trajtuar këtë çështje i është referuar nenit 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore (LMTHJP, i vitit 1980), i cili

ka përcaktuar fitimin e të drejtës së pronësisë dhe shprehimisht ka paraparë se: “E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj”. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se për të fituar të drejtën e pronësisë në rastin konkret në mes palës paditëse dhe palës së paditur (M.M i ndërsa procedura zhvillohet me A.M., dhe T.B, tani të dytë të ndjerë, ndërsa procedura zhvillohet me Z.B), është dashur të ekzistoj një veprim juridik siç mund të jetë lidhja e një kontrate mbi shitblerjen e paluajtshmërive të caktuara e vërtetuar tek organi kompetent, si dhe e njëjta të regjistrohesh në regjistrin e patundshmërive (justus titulus dhe modus aquirendi). Në lidhje me këtë, neni 33 i LMTHJP-së (i vitit 1980) shprehimisht ka përcaktuar se: “Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj”. Në rastin konkret, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se në këtë rast për tu fituar e drejta e pronësisë në paluajtshmëritë e specifikuar në kontratën e datës 01.08.2000, të lidhur në mes M.M dhe T.B., përveç që të jetë lidhur kontrata para organit kompetent (në kohën e lidhjes së saj është dashur të vërtetohet në gjykatën kompetente), do duhej që edhe të bëhej regjistrimi i saj në librat publik kadastral përkatës. Referuar Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (i vitit 1978), i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko-civil, si ligj material që duhet zbatuar në rastin konkret, në dispozitën e nenit 25 paragraf 1, shprehimisht ka përcaktuar:“(1) Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me kontratat aplikohen ndaj të gjitha llojeve kontratash, përveç nëse për kontratat në ekonomi nuk është caktuar, shprehimisht ndryshe”.

19. Më tej, kjo gjykatë ka theksuar se bazuar në kapitullin kur parashihen të drejtat e njëjës palë kur pala tjetër nuk e përmbushë detyrimin e vet, përkatësisht sipas dispozitës së nenit 124 të LMDsë, (i vitit 1978), i cili shprehimisht përcakton se: “Për kontratat dypalëshe kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e vet, pala tjetër mundet në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushte parashikuara në nenet e mëpastajmë, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë në qoftë se zgjidhja e kontratës lind sipas vetë të drejtës, e sidoqoftë ka të drejtë t’i kompensohet dëmi”.

20. Gjykata e Apelit vlerëson se kontrata e datës 01.08.2000 është kontratë dypalëshe e cila edhe pse nuk është lidhur në formën e paraparë ligjore para organit kompetent, e njëjta përmban të gjitha elementet e kontratës duke e përfshirë objektin - paluajtshmëritë e specifikuar në kontratën në fjalë dhe çmimin kontraktues, përkatësisht përmban afatin brenda të cilit palët kontaktuese kishin përcaktuar shumat dhe datat e pagesës. Duke vlerësuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe nga provat në shkresat e lëndës, kësaj i gjykate i rezultoi se kontrata interne e datës 01.08.2000 nuk ishte përmbushur ashtu siç ishin marrë vesh palët kontraktuese, për arsye se blerësi M.M.,-tani i ndjerë nuk e kishte përmbushur plotësisht kontratën, përkatësisht nuk kishte paguar çmimin kontraktues në tërësi, por vetëm gjysmën e atij çmimit, përkatësisht nga çmimi total prej, DM, për të cilin palët kontraktuese ishin pajtuar dhe kishin lidhur kontratën në fjalë, vetëm,DM ishin paguar me rastin e nënshkrimit të kontratës dhe DM më datën 06.01.2001. Nga provat në shkresat e lëndës rezultoi se çmimi i mbetur prej DM nuk është paguar asnjëherë nga ana e palës paditëse-blerësit si palë kontraktuese. Sipas dispozitës së nenit 125 paragraf 1 të LMD-së (i vitit 1978), shprehimisht është përcaktuar: “Kur përmbushja e detyrimit në afatin e caktuar është pjesë përbërëse esenciale e kontratës, ndërsa debitori nuk e përmbushë detyrimin brenda këtij afati, kontrata zgjidhet me vetë të drejt”. Në paragrafin 3 po të njëjtit nen shprehimisht është përcaktuar: “Në qoftë se kreditori ka kërkuar përmbushjen, por nuk e ka marrë brenda afatit të arsyeshëm, mund të deklarojë zgjidhjen e kontratës”, ndërsa në paragrafin 4 shprehimisht është përcaktuar: “Këto rregulla vlejné si në rastin kur palët kontraktuese kanë parashikuar që kontrata të konsiderohet e zgjidhur në qoftë se nuk do të përmbushët brenda afatit të caktuar, ashtu edhe atëherë kur përmbushja e kontratës brenda afatit të caktuar është pjesë përbërëse esenciale e kontratës sipas vetë natyrës së punës”.
21. Kjo gjykatë ka vlerësuar se bazuar edhe në dispozitat e nenit 4 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit mbi Patundshmëritë RS (Gazeta Zyrtare e RS nr.53/93, 67/93 dhe 48/94), i cili ligj në raportin konkret juridik aplikohet në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 dhe plotësisht të saj me Rregulloren e UNMIKU-ut nr.2000/59, në rastin konkret del se kontrata mbi shitblerjen e patundshmërive të cilën këtu i padituri i dytë T.B., si shitës e ka lidhur me tani të ndjerin M. M., si blerës, është e pavlefshme sepse nuk është respektuar forma e detyrueshme ligjore e lidhjes së kontratës e cila nënkupton vërtetimin e detyrueshëm gjyqësor të nënshkrimeve të kontraktuesve, meqë nuk është

vërtetuar në gjykatë. Në bazë të kontratës së këtillë të cilën T.B., e ka lidhur me tani të ndjerin M.M., do të thotë se i ndjeri M.M., nuk e ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmëritë lëndore, sepse kontrata e tillë nuk prodhon efekt juridik, pasi e njëjta edhe nuk ka mundur të konvalidohet për shkak të detyrimit ligjor që të vërtetohet para organit kompetent, por edhe për shkak se kontrata në fjalë nuk është përbushur në kuptim të çmimit të shitblerjes as në tërësi e as në pjesën kryesore, sepse blerësi e ka paguar vetëm gjysmën e shumës së çmimit kontraktues, ndërsa paluajtshmëritë asnjëherë nuk i janë dorëzuar në posedim dhe shfrytëzim këtu paditësit nga ana e shitësit. Në këtë drejtim, nuk qëndron arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë i dhënë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, citim: “...pretendimi i paditësit sipas të cilit paditësi nuk e ka realizuar në tërësi kontratën e shitblerjes nga fakti se parcelat ../., dhe, në kohën e arritjes së marrëveshjes, nuk kanë qenë të regjistruara pranë Drejtorisë së Kadastrit, në emër të paraardhësit të paditurit të dytë, ka qenë i arsyeshëm dhe rrjedhimisht i bazuar, kjo mbase është edhe e logjikshme, sepse për çdo blerës të zakonshëm në situata të ngjashme, do të mbizotëronte ndjenja e pa sigurisë në lidhje me statusin e ardhshëm të parcelave, andaj paditësi në mënyrë bindëse e ka bërë të besueshme pretendimin e tij në lidhje me mos përbushjen e kontratës në tërësi, e që sipas saj ka qenë dashur të përbushet deri më 1 maj 2001”. Kjo për arsye se në kohën e lidhjes së kontratës së shitblerjes së datës 01.08.2000, blerësi M.M., nuk e ka kontestuar këtë çështje, apo të deklaron se lidh kontratë me kushte, pasi që rezultoi se i padituri i dytë, përkatësisht paraardhësi i tij, sipas provave që gjenden në shkresat e lëndës ka qenë posedues i parcelave për të cilat paditësi ka pretenduar se për shkak se shitësi T.B., nuk ka qenë edhe pronar juridik nuk është bërë përbushja e kontratës. Në lidhje me këtë, sipas aktvendimit për de eksproprijimin e tri ngastrave, përkatësisht,, dhe, nr....., të datës 18.11.1996, rezultoi se të njëjtat i ishin kthyer në pronësi të pronarit – paraardhësit tani të paditurit të dytë Z.B - T B., dhe mbi bazën e kësaj edhe i njëjti ka lidhur kontratën interne për shitblerjen e paluajtshmërive kontestuese me datën 01.08.2000, me paraardhësin e tani paditësit A.M – M. M.,

22. Kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, me rastin e marrjes së aktgjykimit të atakuar, për arsye se është provuar fakti se në rastin e paditësit nuk plotësohen kushtet ligjore për të konstatuar se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi ngastrat kontestuese të cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të kontratës interne të shitblerjes të datës 01.08.2000, të lidhur në

mes M. M., dhe T.B., Ndryshimi i aktgjykimit të shkallës së parë dhe refuzimi i kërkesëpadisë së paditësit është mbështetur në rrethanat e krijuara pas heqjes dorë nga kontrata interne e lidhur në mes paditësit-paraardhësit të tij dhe të paditurit të dytë-paraardhësit të tij, nga ky i fundit, si dhe lidhja e kontratës mbi shitblerjen Vr.nr.802/01, datë 07.08.2001, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj, e lidhur në mes T. B., në cilësinë e shitësit dhe B. R., në cilësinë e blerësit, ku objekt i kësaj shitblerje është ngastra kadastrale nr....., si dhe lidhja e kontratës interne të shitblerjes e pasurive të paluajtshme e datës 09.10.2001, e lidhur në Prishtinë në mes të shitësit T.B dhe blerësit B.R., ku objekt i saj ka qenë shitblerja e paluajtshmërive të evidentuara në fletën poseduese nr... në ZK F dhe atë ngastrat kadastrale,,,,,,, si dhe paluajtshmëritë e evidentuara në fletën poseduese nr... në ZK F., dhe atë ngastrat kadastrale nr.....,,... dhe ..., për çmimin e blerjes në shumën prej DM. Andaj, meqenëse kontrata në fjalë rezulton të jetë përmbushur plotësisht nga palët kontraktuese (fakt i pohuar edhe nga të paditurit), ndërsa i padituri B. R., është futur menjëherë pas nënshkrimit të kontratës dhe pagesës së çmimit në posedim të paluajtshmërive në fjalë, si dhe ka ndërtuar tri shtëpi në të cilat edhe jeton, fakt ky i provuar edhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë R. A., e datës 01.09.2018, atëherë edhe nuk plotësohet asnjë kusht ligjor për t'ia njohur të drejtën e pronësisë mbi ngastrat kontestuese këtu paditësit, (situatë tjetër do të ishte nëse i padituri i dytë apo paraardhësi i tij do të ja dorëzonte në posedim ngastrat kontestuese këtu paditësit apo paraardhësit të tij në momentin e lidhjes së kontratës interne). Shtu këtu edhe faktin se i padituri i dytë gjatë deklarimeve në shqyrtimet e mbajtura në gjykatën e shkallës së parë, por edhe në fjalën përfundimtare ndër të tjera ka pohuar faktin se të paditurin B.R., e konsideron të vetmin blerës të ligjshëm dhe me mirëbesim të ngastrave kontestuese, për çka edhe çështjen e pronësisë me të do ta zgjidhin në procedurë të veçantë. Në anën tjetër, është e drejtë e paditësit që përmes procedurës gjyqësore edhe të kërkoj kthimin e mjeteve financiare të paguara paraardhësit të paditurit të dytë në emër të blerjes së ngastrave kadastrale, meqenëse në këtë procedurë nuk ka pasur të parashtruar një kërkesë të tillë, ndërsa gjykata në zbatim të dispozitës së nenit 2.1 të LPK-së nuk e ka trajtuar këtë çështje.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së

dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

2. Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura nga të paditurit dhe ka dhënë arsye të qarta në lidhje me çështjet e ngritura që kanë të bëjnë me shkeljen esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe me zbatimin e gabuar të dispozitave materiale.
3. Gjykata e shkallës së dytë me arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar me revizion ka përmbushur kërkesat ligjore nga neni 204 të LPK-së, si në pikëpamje të kufijve të shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe në aspektin e dhënies së arsyeve për të gjitha çështjet e ngritura në ankesë. Paditësi në revizionin e paraqitur pretendon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së. Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e tilla janë të pa bazuara, kjo pasi që Gjykata e Apelit ka paraqitur arsye të qarta për të gjitha pretendimet ankimore të ngritura nga përfaqësuesit e të paditurve, njëherit janë dhënë arsye të qarta për kushtet që duhet plotësuar sipas të drejtës materiale për të fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmëritë kontestuese, që në këtë rast mbi bazën e fakteve dhe provave të paraqitura është vlerësuar se paditësi nuk ka plotësuar kushtet ligjore për ta fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmëritë kontestuese. Pra gjykata e shkallës së dytë ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decizive si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë.
4. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e Gjykatës së Apelit edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme nga ka rezultuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Nga faktet e paraqitura rezulton se paraardhësi i paditësit M.M., në bazë të kontratës së shitblerjes më datë 01.08.2000,

nga paraardhësi i të paditurit të dytë T.B ka blerë paluajtshmëritë kontestuese, respektivisht ngastrat kadastrale, nr..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., dhe E më vonë i njëjti pra T.B., me kontratat e datës 07.08.2001 dhe 09.10.2001, të njëjtat ngastra ia shet të paditurit të parë B. R. Padiësi mbi bazën e kontratës së shitblerjes të datës 01.08.2000 kërkon vërtetimin e të drejtës së pronësisë në pronat objekt kontesti, me pretendim se ish paraardhësi i tij ka blerë këto prona në vitin 2000, ndërsa ish të paditurit T.B i është paguar shuma e të hollave prej DM. Sipas kësaj gjykate fakti që paraardhësi i paditësit ka përbushur pjesërisht kontratën, pra ka paguar gjysmën e çmimit, kjo nuk e bënë që kontrata të jetë titull i vlefshëm për fitim të pronësisë, pasi që për të qenë titull duhet të lidhet në formën e caktuar, vërtetohet në gjykatë dhe regjistrohet në organin kompetent, ashtu siç është paraparë me nenin 33 të LMTHJP-së, ku është përcaktuar se: “Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj”. Pala paditëse pretendon se nuk është paguar pjesa tjetër e çmimit prej DM, përkatësisht deri të mos përbushja e kontratës ka ardhur për shkak se shitësi nuk ka pasur në emrin e tij ngastrat kadastrale nr..., ..., dhe ..., mirëpo sipas kësaj gjykate një konstatim i tillë nuk ka asnjë ndikim në fuqizimin e kontratës si titull juridik për ta fituar pronësinë, ashtu siç është kërkuar nga pala paditëse që të vërtetohet se mbi bazën e kësaj kontrate është pronar i paluajtshmërive.

5. Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast nuk mund të vlejë rregulli i përcaktuar me nenin 123 paragrafi 1 të LMD-së, (Ligji i vitit 1978), ku është përcaktuar se: *“Në qoftë se është kontraktuar më parë që palë ta përbushë detyrimin e vet, e pastaj pas lidhjes së kontratës rrethanat materiale të palës tjetër keqësohen deri në atë masë saqë e pasigurt nëse ajo do ta përbushë detyrimin e vet, ose pasiguria rezulton nga shkaqet e tjera serioze, atëherë pala që është obliguar ta përbushë e para detyrimin e vet mund ta shtyjë përbushjen e tij gjersa pala tjetër mos ta përbushë detyrimin e vet, apo të mos ta japë sigurimin e mjaftueshëm se do ta përbushë atë”,* të cilës i është referuar gjykata e shkallës së parë dhe i autorizuari i paditësit, kjo pasi që paraardhësi i paditësit ka pranuar që të hyj në një raport kontraktues të shitblerjes ku për objekt ka pas qarkullimin e paluajtshmërisë dhe në kuadër të ngastrave kadastrale kanë qenë edhe ngastrat të cilat në momentin e krijimit të raportit nuk kanë qenë në emër të shitësit T.B., Pra rrethana apo pasiguria e përbushjes që i referohet pala paditëse nuk është që është paraqitur më vonë dhe ka kushtëzuar përbushjen e kontratës, ngase blerësi në

këtë rast paraardhësi i paditësit këtë fakt e ka ditur që në momentin kur ka hyrë në raport kontraktues, por që ka pranuar të bëjë këtë dhe kur është dashur që ta paguaj çmimin kontraktues në tërësi këtë e ka kushtëzuar me faktin se disa nga ngastrat e blera nuk janë në emër të shitësit. Nga dispozita e sipërcituar rezulton se të drejtën për të shtyrë përmbushjen e detyrimit për shkak të përmbushjes së pasigurt të detyrimit nga pala tjetër, i cili ka ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës, mund ta ketë vetëm pala që nuk ka ditur për ekzistimin e gjendjes së pamundësisë së përmbushjes. Në këtë rast paraardhësi i paditësit që në ndërtimin e raportit kontraktues e ka ditur apo është dashur të dijë se po hyn në një raport kontraktues ku shitësi i paluajtshmërisë nuk është pronar i gjitha parcelave dhe se për të prodhuar efekt juridik kontrata e tillë dhe ai të mund ta bart paluajtshmërinë në emrin e tij, shitësi duhet që patjetër të jetë pronar i paluajtshmërive.

6. Në këtë frymë drejtë është aplikuar edhe dispozita nga neni 124 të LMD-së, (ligji i vitit 1978), me të cilën dispozitë është përcaktuar se: *“Për kontratat dypalëshe kur njëra palë nuk e përmbushë detyrimin e vet, pala tjetër mundet në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushte parashikuara në nenet e mëpastajmë, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë në qoftë se zgjidhja e kontratës lind sipas vetë të drejtës, e sidoqoftë ka të drejtë t'i kompensohet dëmi”*. Ndërsa me nenin 125 paragrafi 1 të LMD-së (të vitit 1978), është përcaktuar se: *“Kur përmbushja e detyrimit në afatin e caktuar është pjesë përbërëse esenciale e kontratës, ndërsa debitori nuk e përmbushë detyrimin brenda këtij afati, kontrata zgjidhet me vetë të drejtë”*. Në këtë rast kontrata e datës 01.08.2000, e lidhur në mes të paraardhësit të paditësit M. M dhe paraardhësit të paditurit të dytë T.B., nuk është zbatuar, respektivisht pronat objekt kontesti nuk janë bartur në emrin e paraardhësit të paditësit. Pra, përkundër faktit se paraardhësi i paditësit ka paguar gjysmën e shumës së të hollave, rezulton se kontrata nuk është përmbushë në tërësi, marrë për bazë faktin se palët në kontratën e lartcekur janë marrë vesh që përmbushja e detyrimit të kryhet deri më datë 01.05.2001, mirëpo e njëjta gjë nuk ka ndodhur dhe si rrjedhojë kontrata është shkëputur, bazuar në deklaratën Vr.nr.5223/02, datë 13.09.2002, e vërtetuar nga paraardhësi i të paditurit të dytë në Gjykatën Komunale në K, R e S, i cili edhe e kishte ftuar paditësin, përkatësisht paraardhësin e tij që ta pranojë kthimin e shumës prej,DM, të paguar në emër të shitblerjes së ngastrave kontestuese, i cili me kontratat e

datës 07.08.2001 dhe 09.10.2001, të njëjtat ngastra ia ka shitur tani të paditurit të parë B.R.,

7. Gjykata Supreme ka vlerësuar pretendimet e të autorizuarit të paditësit se gjykata e shkallës së dytë nuk është dashur të zbatoj dispozitat nga nenet 20 dhe 33 të LMTHJP-së, kjo pasi që sikur paditësi ta kishte titullin juridik atëherë do ta regjistronte paluajtshmërinë në emrin e tij, mirëpo sipas kësaj gjykate duhet të kihet parasysh fakti se gjykatat janë të obliguara që të veprojnë brenda kërkesave të palëve, të tilla ti trajtojnë në raport me të drejtën materiale që rregullon atë çështje, referuar gjendjes faktike të konstatuar në proces gjyqësor. Pala paditëse është ajo që ka kërkuar vërtetimin e pronësisë mbi bazën e kontratës së datës 01.08.2000 dhe në këtë rast është vlerësuar se kontrata e tillë në asnjë rrethanë nuk mund të shërbej si titull për fitimin e pronësisë dhe se vlerësimi që nuk mund të shërbej si titull juridik është mbështetur me të drejtë në dispozitat ligjore nga nenet 20 dhe 33 të LMTHJP-së që rregullojnë këtë çështje. Mbi këto rrethana me të drejtë është vlerësuar se kontrata e lidhur mes palëve nuk mund të shërbej si bazë për të fituar pronësinë, kjo pasi që kjo kontratë, përveç që nuk është lidhur në mënyrën e përcaktuar me ligj, nuk është përmbushur në tërësi nga paraardhësi i paditësit dhe nuk ka hyrë në posedim të paluajtshmërive objekt i shitblerjes, ndërsa shitësi nuk ka pasur vullnetin që të qëndroj më tutje në këtë raport kontraktues dhe të njëjtat paluajtshmëri ia ka shitur personit tjetër, i cili edhe ka hy në posedim të tyre, ndërsa ka shpreh gatishmërinë që paratë e marra nga blerësi të ia kthej. Gjykatat në këtë rast nuk kanë mundur që kontratën ta përdorin as si fakt për të vlerësuar plotësimin e kushteve për fitimin e pronësisë sipas bazës së parashkrimit fitues, kjo pasi që paditësi qysh në vitin 2001 ka paraqitë padi dhe ka kërkuar vërtetimin e pronësisë sipas kësaj kontrate (një vit pas lidhjes së saj), pastaj paditësi nuk ka hyrë në posedim të paluajtshmërive objekt kontestit.
8. Pra, kjo gjykatë vlerëson se kontrata e tillë në asnjë rrethanë nuk mund të shërbej si bazë për të fituar pronësinë në paluajtshmëritë kontestuese, ndërsa fakti që pala paditëse ka përmbushur pjesërisht kontratën kjo atë nuk e bën titull të vlefshëm, por që i mundëson që të kërkoj kthimin e asaj që ka dhënë, gjë që në këtë rast nuk ka pasur kërkesë të kësaj natyre.

9. Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

10. Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi Refuzohet i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditësit A.M nga fshati N, Komuna Ferizaj, i paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.9443/2021 të datës 07.11.2023.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.248/2023, i datës 06.11.2023

”Padiësi nuk mund të kërkojë obligimin e Komunës për kompensimin e dëmit për objektin e rrënuar në paluajtshmërinë e tij, përderisa me ndonjë provë nuk vërtetohet që deri te rrënimin i objektit ka ardhur me veprimet e ndërmarra nga pala e paditur (qoftë me nxjerrjen e ndonjë vendimi për rrënim apo rrënim pa vendim).

Pala e paditur nuk ka ekzistuar në kohën kur pretendohet se është shkaktuar dëmi dhe gjithashtu përgjegjës për sigurinë dhe rendin në atë kohë nuk ka mundur të jetë pala e paditur por që bazuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit nr.1244, përgjegjës për gjendjen e sigurisë në Kosovë, ka qenë KFOR-i dhe UNMIK-u“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.284/18 të datës 03.12.2019 është refuzuar në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e padiësit V. M. nga P., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se e paditura Komuna e Pejës, rr. “..” nr..., nga viti 2012 e kryen posedimin e shfrytëzimit të pa drejtë në dëm të padiësit, ashtu që me pa të drejtë e ka rrënuar objektin ndërtimor dhe ka ndërtuar parkun e fëmijëve, e paraprakisht nuk e ka iniciuar procedurën e eksproprijimit të tokës së dëmtuarit dhe me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Komuna Pejës që padiësit M. V., në emër të kompensimit të dëmit, t’ia kompensoj dëmin në shumë prej 120.750 €, në emër të rrënimin të objektit banesorë afarist dhe shfrytëzimit të pllacit dhe truallit, si dhe shpenzimet e procedurës, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.
2. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të padiësit me aktgjykimin Ac.nr.3889/20 të datës 13.03.2023, ka vendosur që të refuzoj të pa themel të ankesën e padiësit V. M. nga P., tani me vendbanim në N., ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.284/18 të datës 03.12.2019.

3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i palës paditëse në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin e paditësit, aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta ti anuloh dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në përsëritje të procedurës dhe vendosje, respektivisht gjykatës së shkallës së dytë.
4. Pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditësit.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se: Revizioni i të autorizuarit të paditësit është i pathemeltë.
6. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi V. M. nga P., me vendbanim tani në N., më datë 10.10.2012 ka paraqitur padi për kompensim dëmi, kundër të paditurës Komuna e Pejës, me pretendim se është pronar i parcelës nr..., në sipërfaqe prej 3.22 ha, e cila i është ndarë nga Komuna e Pejës për ndërtim të objektit banesor. Në këtë parcelë dhe në përputhje me planin urbanistik pretendohet se është ndërtuar objekti ndërtimor afarist ku paditësi me familjen e tij ka jetuar deri në muajin Qershor të vitit 1999, ku më pas kjo është uzurpuar nga persona të panjohur dhe është rrënuar shtëpia me objekt afarist. Në të gjitha fazat e procedurës është kërkuar nga paditësi që të vërtetohet se e paditura pa të drejtë e ka rrënuar objektin ndërtimor dhe ka ndërtuar parkun e fëmijëve, e paraprakisht nuk e ka iniciuar procedurën e ekspropriimit të tokës së dëmtuarit dhe me të cilën e ka kërkuar që të obligohet e paditura Komuna Pejës që paditësit M. V., në emër të kompensimit të dëmit t'ia kompensoj dëmin në shumë prej 120.750 €, në emër të rrënimt të objektit banesorë afarist dhe shfrytëzimit e pllacit dhe truallit.
7. Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, provave të administruara në këtë proces, ka refuzuar kërkesëpadinë e palës paditëse me arsyetim se paditësi sipas konkursit Br..., të datës 18.04.1997, i jepet në shfrytëzim me kompensim toka, e cila pjesërisht është e rregulluar për ndërtim, sipas planit urbanistik e dedikuar në qytetin e Pejës dhe i është ndarë ngastra kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 0.03.22 ha. Nga historiat i pronës vërtetohet se sipas regjistrimit të ndërrimeve nr..., njësia kadastrale nr.... në sipërfaqe prej 322 m², objekt i këtij kontesti regjistrohet në emër të

P.SH.K.K, Pejë, në emër të cilës udhëhiqet edhe tani. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se i autorizuari i paditësit në referatin e padisë së tij, potencon se objekti afarist - banesor është uzurpuar dhe shkatërruar nga personat e panjohur, çka do të thotë se edhe nën supozimin se po të ishte rrënuar objekti banesor, nuk është rrënuar nga e paditura, konform nenit 154 të LMD-së dhe nenit 134 të LMD-së Nr. 04/ L-077, kush shkakton dëm tjetrit ka për detyrë ta kompensoi, në rastin konkret nuk u vërtetua ekzistimi i fajësisë së të paditurës. Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar që i paditësi ka ra në vonesë për të kërkuar shpërblim të dëmit si palë e dëmtuar nga pala e paditur, ngase pala paditëse padinë për kompensimin e dëmit e ka parashtruar më datë 10.10.2012, ndërsa në padi potencon se në muajin qershor 1999 nga personat e pa njohur i është shkatërruar objekti banesorë – afarist, të cilën e ka vërtetuar Drejtorati për Çështjen e Pronësisë, me vendimin e saj të datës 22.10.2004, çka do të thotë se edhe po të merret viti 1999 apo viti 2004 koha kur ka rënë në dijeni pala paditëse për rrënimin e objektit në fjalë, pala paditëse në rastin konkret ka humbur të drejtën që të kërkojë përmbushjen e detyrimit në procedurë gjyqësore, sepse kërkesa e tij është parashkruar në kuptim të dispozitave nga neni 376. paragraf 1, të LMD-së, për faktin se nga momenti i shpërblimit të dëmit e deri të paraqitja e padisë në gjykatë nga ana e palës paditëse, ka kaluar afati i paraparë ligjor prej tri (3) viteve.

8. Po ashtu gjykata ka theksuar se me vendimin e HPCC me nr. DS... të datës 22.10.2004 me HPCC/..., u vërtetua se që nga viti 2004, parcela ka qenë e zbrazët dhe nuk ka ekzistuar pasuria e ndërtuar. Pra, parcela ka qenë e zbrazët qysh në vitin 2004, për këtë gjendje ka qenë në dijeni pala paditëse, çka do të thotë se tani paditësi nuk mund të thirret se në vitin 2012, i është rrënuar objekti banesor afarist kur vet i njëjti e ka prezantuar provën e cekur si më lartë që vërteton të kundërtën. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 452.2 dhe dispozitave të nenit 463.1 të LPK-së, ngase pala paditëse e ka humbur kontestin në tërësi, ndërsa nga i padituri nuk ka pasur kërkesë të specifikuar të shpenzimeve.
9. Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës të autorizuarit të paditësit ka refuzuar të pa themeltë ankesën e paditësit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar me revizion, të përshkruar si më lart.

10. Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë.

11. Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të pa bazuara pretendimet ankimore të paditësit për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka kërkuar shpërblim dëmi për objektin e rrënuar në Pejë, ndërkaq nuk ka kërkuar shpërblim dëmi për privimin nga posedimi të tokës në të cilën ka qenë i ndërtuar objekti i rrënuar. Është konstatuar plotësisht fakti se objekti të cilin e ka shfrytëzuar paditësi është rrënuar nga persona të panjohur, kjo është pohuar edhe nga vetë paditësi gjatë gjyqimit në shkallë të parë, përveç këtij pohimi të vetë paditësit se lokali është rrënuar përpara vitit 2004 nga persona të panjohur, këtë e vërteton edhe vendimi i Habitatit, HPCC nr.DS..., i datës 22.10.2004, ku Habitatit ka konstatuar se objekti ndërtimor për të cilin kërkohet shpërblim i dëmit është rrënuar para vitit 2004, pasi me këqyrjen e bërë është konstatuar se parcela ku ka qenë i ndërtuar ky objekt ka qenë e zbrazët.

12. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë nenin 376 të LMD-së, parashkrimin e kërkesëpadisë së paditësit, si dhe referatin e padisë ku potencon se objekti afarist banesor është uzurpuar nga personat e panjohur, do të thotë që edhe nën supozimin se po të ishte rrënuar objekti banesor, nuk është provuar se është rrënuar nga e paditura, konform nenit 154 të LMD-së dhe nenit 134 të LMD-së, që kush shkakton dëm tjetrit ka për detyrë të kompensoj, e në rastin konkret nuk ekziston fajësia e të paditurës, apo ajo nuk është provuar, por megjithatë edhe po të provohej fajësia e të paditurës nga koha kur është rrënuar objekti, viti 2004 e deri në ditën e paraqitjes së padisë, datë 10.10.2012, kërkesa për shpërblim dëmi është parashkruar, pasi kanë kaluar më shumë se 5 vite, përkatësisht 8 vite.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.
2. I autorizuari i paditësit në revizionin e paraqitur pretendon se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 182.2, pika n) të LPK-së, kjo pasi që aktgjykimi i shkallës së dytë është kontradiktor mes asaj që është arsyetuar dhe përmbajtjes së provave në bazë të cilave është nxjerrë aktgjykimi. Gjykata Supreme e Kosovës një pretendim të tillë e vlerëson si të pa themeltë, kjo pasi që aktgjykimi i shkallës së dytë është i qartë dhe për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së dytë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë janë dhënë arsye. Gjykata e Apelit ka dhënë arsye të duhura për vërtetimin e aktgjykimin të shkallës së parë, si duke dhënë vlerësime të qarta mbi bazën e fakteve dhe provave të paraqitura, në këtë kontekst në arsyetimin të aktgjykimin janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.
3. Nga shkresat e lëndës dhe gjitha fazat e procedurës rezulton se i autorizuari i paditësit si kërkesë të padisë ka pasur kërkesën për kompensim e dëmit në emër të rrënimit të objektit banesorë afarist dhe shfrytëzimit të pllacit dhe truallit. Të dy gjykatat kanë vendosur dhe është dashur t'i përmbahen kërkesës së paditësit, andaj mbi bazën e provave të administruara kanë nxjerrë përfundimin dhe kanë dhënë arsye të qarta se pala paditëse me asnjë provë nuk ka arritur të vërtetojë faktin se e paditura ka ndër marrë ndonjë veprim në rrënimin e objektit të pretenduar. Madje vet pala paditëse në padi dhe faza tjera të procedurës ka deklaruar se objekti është rrënuar nga persona të panjohur, atëherë shtrohet çështja se a mund të detyrohet e paditura në kompensimin e dëmit të pretenduar nga paditësi e të shkaktuar nga personat e panjohur.
4. Për dëmin që paditësi pretendon se i është shkaktuar në vitin 1999 nga persona të panjohur pala e paditur nuk mund të detyrohet në kompensim, kjo pasi që e paditura

nuk ka ndërmarr asnjë veprim në rrënimin e objektit të pretenduar. Fakti që e paditura me vendimin nr. 09-8103, datë 29.09.2008 ka anuluar vendimin nr. ..., datë 26.05.1997, me të cilin paditësit i është dhënë paluajtshmëria, ku pretendohet se ka qenë i ndërtuar objekti, kjo nuk paraqet bazë për kompensim të objektit, pasi që në kohën kur është marrë vendimi nuk ka ekzistuar objekti, e gjithashtu vendimi nuk ka përmbajtur ndonjë masë për rrënimin e ndonjë objekti. Përveç kësaj, nga shkresat e lëndës, përfshirë ekspertizën e gjeodezisë, vlerësimin e ekspertit financiar për paluajtshmërinë si dhe vendimi i Habitatit (HPCC/...), rezulton se parcela ka qenë e zbrazët dhe se objekti është rrënuar para vitit 2004. Në këtë rast është kërkuar kompensimi i dëmit, ndërsa baza ligjore për kompensim parashihet në nenin 154 paragrafi 1 të LMD-së, ku është përcaktuar se: “Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”. Bazuar në dispozitën ligjore të sipërcituar, rrethanat e çështjes, kjo gjykatë vlerëson se pala e paditur nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në rrënimin e objektit të pretenduar nga pala paditëse dhe fakti që është marrë vendimi për paluajtshmërinë ku pretendohet se ka qenë i ndërtuar objekti, më këtë akt nuk i është shkaktuar dëm paditësit në objekt, pasi që me anë të këtij vendimi nuk është vendosur për rrënim të objektit por për statusin e paluajtshmërisë.

5. Pretendimet e paraqitura në revizion mbi këtë bazë kjo gjykatë i ka vlerësuar të pabazuara pasi që objekt shqyrtimi në këtë rast nuk ka qenë ligjshmëria e vendimit të paditurës, e as çështja e të drejtës në raport me paluajtshmërinë, por që objekt shqyrtimi ka qenë kompensimi për objektin e rrënuar, pretenduar nga pala paditëse. Detyrimi për kompensim lind atëherë kur me ndonjë provë vërtetohet që deri te rrënimi i objektit ka ardhur me veprimet e ndërmarra nga pala e paditur (qoftë me nxjerrjen e ndonjë vendimi për rrënim apo rrënim pa vendim), që në këtë rast me asnjë provë nuk është vërtetuar që e paditura ka ndërmarrë ndonjë veprim në këtë aspekt. Përveç kësaj, pala paditëse ka pretenduar se në vitin 1999 i është shkaktuar dëmi nga persona të panjohur, andaj me të drejtë shtrohet çështja se a mund të detyrohet e paditura në kompensimin e dëmit që është shkaktuar nga personat e panjohur, pastaj pala e paditur nuk ka ekzistuar në kohën kur pretendohet se është shkaktuar dëmi dhe gjithashtu përgjegjës për sigurinë dhe rendin në atë kohë nuk ka mundur të jetë pala e paditur por që bazuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit nr.1244, përgjegjës për gjendjen e sigurisë në Kosovë, ka qenë KFOR-i dhe UNMIK-u. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/1, të datës 25 qershor 1999, neni 1 është e paraparë se: “I gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në

lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, i vishet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm”. Me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/45, të datës 11.08.2000, mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës (neni 1 dhe 2), mes tjerash, parashihet se: “Me këtë Rregullore themelohen institucionet e përkohshme për vetëqeverisje autonome dhe demokratike në nivel komunal, si njësi themelore territoriale të qeverisjes lokale të cilat e ushtrojnë tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për pushtetin qendror”. Në nenin 3 të po kësaj Rregulloreje, në mënyrë taksative parashihen përgjegjësitë e Komunës ashtu që përgjegjësitë për Rendin dhe Sigurinë në Kosovë nuk janë përfshirë në këtë nen e as në ndonjë dispozitë tjetër të kësaj Rregulloreje. Nga kjo, mes tjerash, rezulton edhe përfundimi se nuk ekziston suksesioni juridik në mes të ish komunave dhe komunave të themeluara pas vitit 2000 përmes Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/45, kështu që përgjegjësia e komunës nuk mund të nxirret as nga baza e suksesionit juridik.

6. Nga arsyet e paraqitura, bazës ligjore të sipër theksuara, kjo gjykatë vlerëson se e paditura në asnjë rrethanë nuk mund të detyrohet në kompensimin e dëmit të pretenduar nga pala paditëse, pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar që e paditura e ka shkaktuar dëmin - nuk ka marrë asnjë veprim në drejtim të rrënimt të objektit, ndërsa për dëmin që ka mundur të shkaktohet nga personat e panjohur gjatë vitit 1999 e paditura nuk mund të jetë përgjegjëse marrë për bazë kohën kur është themeluar si institucion si dhe faktin që nuk ka pasur kompetenca për rend dhe siguri.
7. Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 222 të LPK-së, kolegji civil i Gjykatës Supreme vendosi që të: Refuzohet i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditësit V.M, nga P, tani me vendbanim në N, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3889/20 të datës 13.03.2023.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.251/2024, i datës 03.07.2024

”Gjykata Supreme vlerëson se nuk ekziston asnjë mundësi ligjore që gjykata me vendim ta zëvendësoj mungesën e pëlqimit të prindit që fëmija të udhëtoj jashtë vendit me prindin tjetër, apo atë ta detyroj që ta jep pëlqimin. Për një çështje të tillë QPS është mekanizmi i duhur, ku përmes ndërmjetësimit të tyre dhe komunikimit me prindër duhet të gjinden mënyra për të tejkaluar pengesat e tilla, gjithnjë duke marrë për bazë interesin më të mirë të të miturit“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1861/2021 të datës 07.02.2023, në pikën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit V.Gj nga Prizreni. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që fëmija i mitur A.F. Gj, i lindur më datë, në Prishtinë, i besohet në ruajtje, mbajtje dhe edukim paditësit – babait të tij V.Gj nga Prizreni. Në pikën III të dispozitivit detyrohet paditësi V.Gj nga Prizreni, që t’ia mundësojë të paditurës–nënës N.B nga Prizreni, kontaktin me fëmijën e mitur A.F.GJ, dhe atë: 1. Çdo të marte dhe të enjte fëmija i mitur do të qëndroj me të paditurën nga ora 16:00 deri në ora 20:00, ashtu që paditësi do t’ia dorëzoj fëmijën të paditurës në adresën e saj (rr. “.....” nr.69, banesa nr.9) në ora 16:00, ndërsa e paditura do ta dorëzoj fëmijën në ora 20:00, në adresën e paditësit (rr. “.....”, hyrja III, nr.8). 2. Të premtën e parë dhe të tretë të muajit, e paditura do ta marrë fëmijën e mitur, ku paditësi do t’ia dorëzoj fëmijën të paditurës prej orës 15:40, deri të hënën kur e paditura do ta dorëzoj fëmijën në ora 09:00. 3.Ti mundësohet nënës kontakti me fëmijën ditën e dytë të festave shtetërore dhe fetare, si dhe gjatë pushimit vjetor 10 ditë të pushimit. 4. Ti mundësohet të paditurës kontakti me fëmijën e mitur në ditëlindjen e tij ashtu që djali një vit të festojë me babain, duke filluar nga ditëlindja e ardhshme me datë 01.11.2023, kurse vitin tjetër me nënën, e kjo mënyrë e kontaktimit të vazhdojë edhe në vitet në vijim. 5. Kontakti nga pika 2 deri në 4 sipas këtij dispozitivi në mes të nënës N.B me të miturin A.F.Gj, do të bëhet përmes Qendrës për Punë Sociale në Prizren, përveç nëse palët merren vesh ndryshe. Në pikën IV të dispozitivit është hedhë poshtë si e palejuar kërkesa nga padia e paditësit V.Gj nga Prizreni ndaj të paditurës N.B nga Prizreni, lidhur me të cilën ka kërkuar që paditësi V.Gj pa pëlqimin shprehimor të të paditurës N.B, mund të rregulloj dokumentacionin

personal letërnjoftimin dhe pasaportën si dhe vizën në Ambasadën përkatëse për fëmijën A.F.Gj. Në pikën V të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesa nga padia e paditësit ndaj të paditurës N.B nga Prizreni, lidhur me të cilën ka kërkuar që paditësi V.Gj pa pëlqimin shprehimor të të paditurës N.B, ta merr fëmijën A.F.Gj në botën e jashtme jashtë Republikës së Kosovës, në çdo shtet në të cilin jeton dhe punon paditësi me të në përkujdesje, edukim dhe ushqimi, dhe në pikën VI të dispozitivit secila palë është obliguar që ti bartë shpenzimet e veta të procedurës.

2. Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin Ac.nr.2283/23 të datës 06.02.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit V.Gj nga Prizreni, rruga “.....”, hyrja III, nr.8 dhe ankesën e të paditurës N.B nga Prizreni, rruga “.....”, nr.69, banesa nr.9, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.1861/21 të datës 07.02.2023.
3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditësit ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj revizionin e paditësit si të bazuar, ashtu që lëndën ta kthejë në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
4. I autorizuari i të paditurës nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditësit.
5. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215, gjeti se: Revizioni i të autorizuarit të paditësit është i pathemeltë.
6. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi V.Gj nga Prizreni ka jetuar në bashkësi jashtëmartesore me të paditurën N.B nga Prizreni, ndërsa gjatë kësaj kohe u ka lindur fëmija A.Gj, (lindur më datë 01.11.2020). Ndërkohë palët janë ndarë, ndërsa fëmija i mitur ka vazhduar të jetoj me paditësin. Paditësi më datë 17.09.2021 ka paraqitur padi, kundër të paditurës, lidhur me çështjen e besimit të fëmijës atij, të caktohet kontakti me të paditurën, si dhe është kërkuar që pa pëlqimin shprehimor të palës së paditur- nënës,

paditësi-babai, të rregulloj dokumentacionin personal për fëmijën dhe ta marr fëmijën në botën e jashtme, në çdo shtet në të cilin jeton dhe punon paditësi.

7. Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësim të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.1861/21 të datës 07.02.2023, me të cilin ka vendosur që fëmija i mitur A.F.Gj t'i besohet në ruajtje, mbajtje dhe edukim paditësit - babait të tij V.Gj nga Prizreni, duke caktuar edhe kontaktin dhe mënyrën e realizimit të kontaktit të fëmijës së mitur me nënën e tij, këtu të paditurën, duke vendosur më saktësisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.
8. Gjykata e shkallës së parë bazuar në raportin e shërbimit social 05/06 nr. 296, të datës 12.05.2022, sqarimin e këtij raporti nga ana e përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale në Prizren në seancën e datës 29.12.2022, ekspertizën e punuar nga ekspertja e psikiatrisë për adoleshentë dhe fëmijë Dr. D.G.B të datës 31.10.2022, referuar neneve 139 paragrafi 2 dhe 140 paragrafi 2 të LFK-së, ka vendosur që paditësit- babait t'ia besoj në ruajtje, kujdes dhe edukim fëmijën e mitur A.F.Gj. Është vlerësuar se interesi më i mirë i fëmijës është që ai ti besohet babait, duke vlerësuar se kushtet dhe rrethanat ekzistuese për rritje dhe edukim, e duke marrë për bazë edhe aftësitë e prindërve për ruajtje, edukim, mirërritje dhe për mbajtje të fëmijës së mitur, mundësitë socio-ekonomike dhe të banimit të palëve, e me theks të veçantë të paditësit me të cilin tashmë jeton i mituri, pra gjendjen momentale dhe vendqëndrimin e fëmijës, nga momenti i ndarjes së prindërve të tij, kujdesin prindëror nga i ati, përkatësisht gjyshja dhe gjyshi biologjik i fëmijës, lidhjen emocionale të fëmijës me rrethin ku jeton, si dhe kushtet dhe ambientin e përshtatshëm ku banon fëmija.
9. Në lidhje me caktimin e kontaktit në mes të fëmijës së mitur me nënën e tij - këtu të paditurën, gjykata ka vlerësuar se duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijës së mitur dhe me qëllim që të njëjtit ti mundësohet zhvillimi normal fizik dhe shpirtëror, e duke u bazuar edhe në raportin e shërbimit social 05/06 nr. 296, të datës 12.05.2022, ku të njëjtit kanë propozuar që raportet mes nënës-të paditurës dhe të miturit të jenë sa më shpesh që është e mundur (çdo dy ditë), në ambiente të përshtatshme për interesin më të mirë të fëmijës, e po ashtu edhe paditësi ka shprehur dëshirën që kontaktet mes

të paditurës dhe fëmijës së mitur të jenë të rregullta dhe pa pengesë, e duke marrë për bazë edhe ekspertizën e ekspertës së psikiatrisë për adoleshentët dhe fëmijë, gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit. Me rastin e vendosjes për kontaktin me fëmijën gjykata ka arsyetuar se ka pasur parasysh edhe faktin se që nga shkëputja e bashkësisë jashtëmartsore e deri më tani, fëmija i mitur në vazhdimësi është takuar me nënën e tij dhe nuk ka pasur pengesa nga ana e paditësit.

10. Lidhur me vendosjen si në pikën IV (e shënuar gabimisht si pika VI nga gjykata e shkallës së parë) të dispozitivit për hedhjen e padisë si të palejuar, me të cilën ka kërkuar që paditësi V.Gj pa pëlqimin e të paditurës N.B të mund të rregulloj dokumentacionin personal për fëmijën A.F.Gj, gjykata ka arsyetuar se paditësi nuk ka interes juridik për të kërkuar njohjen e një të drejtë që i njihet me legjislacionin në fuqi, me të cilat rregullohet çështja e aplikimit për pajisje me dokumente të identifikimit, pasi që ekzistojnë akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë fushë. Ndërsa lidhur me vendosjen si në pikën V të dispozitivit kjo gjykatë është bazuar në nenin 141 paragrafi 1 të LFK-së, duke e refuzuar kërkesën e paditësit me të cilën ka kërkuar që paditësi V.Gj pa pëlqimin shprehimor të të paditurës N.B, ta merr fëmijën A.F.Gj në botën e jashtme jashtë Republikës së Kosovës.
11. Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesën e paditësit, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë me vlerësim se i njëjti nuk është përfshi në shkelje esenciale të dispozitave procedurale në të cilat është thirrë pala në ankesë dhe as shkelje për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.
12. Gjykata e Apelit ka pranuar në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me besimin e fëmijës, për shkak se vlerëson se me provat e administruara në këtë çështje juridike kontestuese gjykata ka ndjekur parimin e interesit më të mirë të të miturit, i cili rrjedhë si detyrim për gjykatën nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve e zbatuar drejtpërdrejt në Kosovë dhe po ashtu edhe nga dispozita e Ligjit për Familjen i Kosovës.
13. Sa i përket mënyrës së caktimit të kontaktit të paditurës me fëmijën e mitur, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur, pasi që mënyra e caktimit të kontaktit është bërë pas vlerësimit dhe hetimit të mirëfilltë të të gjitha rrethanave dhe fakteve, e krejt kjo me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit të

marrëdhënies në mes të fëmijës dhe prindit me të cilin nuk jeton fëmija. Mënyra si është caktuar kontakti nga gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë e ka vlerësuar si të koordinuar dhe të mjaftueshme, duke marrë për bazë interesin më të mirë të fëmijës, e gjithë kjo me qëllim të mbajtjes së lidhjes prind fëmijë ku kontaktet e rregullta të fëmijëve me të dy prindërit ndikojnë pozitivisht në zhvillimin fizik, emocional, intelektual dhe social të fëmijës, që fëmija të ketë kontakte të rregullta me të dy prindërit. Kjo gjykatë gjeti se përkundër ndarjes së prindërve, fëmija për një zhvillim të mirëfilltë psikik, fizik dhe social, ka nevojë që të rritet dhe edukohet nga të dy prindërit, andaj edhe kontaktet me nënën janë të domosdoshme.

14. Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm kur padinë e paditësit me të cilën ka kërkuar që paditësi V.Gj pa pëlqimin shprehimor të të paditurës N.B të mund të rregulloj dokumentacionin personal për fëmijën A.F.Gj, e ka hedhë të palejueshme në mungesë të interesit juridik, për të cilën bazuar në dispozitat ligjore përkatëse ka dhënë arsye të cilat janë të pranueshme edhe për gjykatën ankimore. Po ashtu kjo gjykatë e ka vlerësuar të drejtë edhe vendosjen si në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë lidhur me refuzimin e kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar që paditësi pa pëlqimin shprehimor të të paditurës, ta merr fëmijën A.F.Gj në botën e jashtme, jashtë Republikës së Kosovës.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme

Lidhur me vendosjen si në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së.
2. Përfaqësuesi i paditësit në revizionin e paraqitur për nga baza i është referuar shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, mirëpo në arsyetim të revizionit

nuk ka përmendur shprehimisht ndonjë dispozitë ligjore apo ndonjë arsye për ndonjë shkelje procedurale, prandaj Gjykata Supreme sa i përket kësaj baze është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në përputhje me dispozitën e nenit 215 të LPK-së.

3. Marrë për bazë faktin se revizioni i është referuar pikave të caktuara të vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë, përkatësisht pikave të aktgjykimit të shkallës së parë që janë vërtetuar nga ajo e shkallës së dytë, Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme nga ka rezultuar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.
4. Kontestimet e paraqitura në revizion i referohen vendimeve që kanë të bëjnë me çështjen e rregullimit të kontaktit të fëmijës me nënën- të paditurën, që në këtë rast Gjykata Supreme mbështet qëndrimin e dhënë nga gjykatat e instancës më të ulët sa i përket vendosjes lidhur me këtë çështje. Sipas kësaj gjykate, gjykatat e instancës më të ulët vendosjen në këtë mënyrë e kanë arsyetuar me interesin më të mirë të fëmijës, ndërsa këtë e kanë bazuar në mendimin e ekspertës së psikiatrisë dhe raportit nga Qendra për Punë Sociale. Edhe kjo gjykatë vlerëson se në moshën në të cilën gjendet fëmija, është më se e nevojshme të ketë mbështetjen emocionale të nënës dhe kjo mbështetje mund të vij vetëm përmes mënyrës së rregullimit të kontakteve që nëna të ketë më shumë kontakte më fëmijën në mënyrë që të kontribuoj edhe ajo si prind në rritjen dhe edukimin e tij. Përmes kontaktit nënës i ipet mundësi për ta dhënë kontributin në rritjen e fëmijës, por njëkohësisht realizon të drejtën e fëmijës që të merr kujdesin e dy prindërve dhe të mbaj kontakte të rregullta me të dy prindërit.
5. Në rrethana të tilla kjo gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë vlerësuar faktet e çështjes dhe mbi këtë bazë drejtë janë aplikuar dispozitat nga nenet neni 145, 141 dhe 140 paragrafi 3 të LFK-së, në lidhje me vendosjen sa i përket rregullimit të kontaktit të fëmijës së mitur me nënën.
6. Sipas kësaj gjykate nuk bjen ndesh me interesin më të mirë të fëmijës fakti që gjykata e shkallës së parë ka hedhur kërkesën e paditësit për çështjen e rregullimit të

dokumenteve personale për fëmijën dhe refuzimin e kërkesës për marrjen e fëmijës jashtë vendit pa pëlqimin e nënës, kjo pasi që interesi i fëmijës nuk mund të vlerësohet vetëm mbi këtë bazë, ngase ai është shumë dimensional dhe varet nga shumë faktor.

7. Në vlerësimin e interesit të fëmijës gjykata duhet të merr për bazë edhe raportin e fëmijës me të dy prindërit, që në këtë rast është vlerësuar se është në interes të fëmijës që ai ti besohet babait, por se ky interes duhet shikuar edhe në aspektin e mbështetjes emocionale të nënës dhe nevojave e nënës dhe fëmijës që të kenë kontakte të rregullta.
8. Gjykata Supreme pas vlerësimit të pretendimeve në revizion të palës paditëse, jep vlerësimin se nuk ekzistojnë rrethana të cilat arsyetojnë vendosjen ndryshe, përkatësisht një mënyrë ndryshe të rregullimit të kontaktit të nënës me fëmijën ashtu siç është përcaktuar me aktgjykimin e atakuar. Të gjitha provat e administruara, e posaçërisht ekspertiza e ekspertës së psikiatrisë, vërtetojnë nevojën për realizim të shpeshtë të kontaktit të nënës me fëmijën, marrë parasysh moshën e fëmijës, në mënyrë që e ëma të ketë mundësi për ta ushqyer, për ta larë dhe për të luajtur me fëmijën, për ta dërguar në kopsht dhe anašnjelltas, për ti lexuar përrallë, si dhe për ta vënë fëmijën në gjumë. Duhet pasur parasysh se në rrethanat ekzistuese, pra mungesës së kontaktit të fëmijës me nënën, rezulton se duhet të bëhet përpjekje që kontakti të realizohet në mënyrën siç është përcaktuar me aktgjykimin e formës së prerë, për shkak se është në interes të fëmijës që ti sigurohet mbajtja e lidhjes me nënën, që gradualisht ta krijojë kontaktin e humbur në mënyrë që të fitojë sigurinë dhe besimin për të qenë në prani saj. Vendosja ndryshe, përkatësisht një mënyrë e re e rregullimit të kontaktit ashtu siç është propozuar nga pala paditëse, nuk do të ishte në interesin e fëmijës së mitur dhe njëherit do të cenonte të drejtën e nënës në kontakt me djalin, përkatësisht do e vështirësonte edhe më tej përpjekjen për të krijuar kontaktin e humbur të saj me djalin, ashtu siç është përcaktuar në mendimin e ekspertës së psikiatrisë dhe raportin e QPS në Prizren, në bazë të cilave në mënyrë të qartë është konstatuar nevoja dhe domosdoshmëria e vazhdimit të kontaktit mes të paditurës dhe fëmijës së saj.
9. Gjykata Supreme vlerëson se nuk ekziston asnjë mundësi ligjore që gjykata me vendim ta zëvendësoj mungesën e pëlqimit të prindit që fëmija të udhëtoj jashtë vendit me prindin tjetër, apo atë ta detyroj që ta jep pëlqimin. Për një çështje të tillë QPS është mekanizmi i duhur, ku përmes ndërmjetësimit të tyre dhe komunikimit me prindërit

duhet të gjinden mënyra për të tejkaluar pengesat e tilla, gjithnjë duke marrë për bazë interesin më të mirë të të miturit.

10. Nga rrethanat e rastit rezulton se QPS duhet të ketë rolë aktiv dhe të ketë mbikëqyrje të vazhdueshme në lidhje me sjelljet e anëtarëve të familjes së paditësit në raport me fëmijën, përkujdesjen e babait të cilit i është besuar fëmija dhe në bazë të autorizimeve ligjore që i ka të ndërmarrë të gjitha masat e parapara me qëllim të mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës në këtë rast.
11. Të dy palët ndërgjyqëse duhet ta kenë parasysh faktin se vendimi për caktimin e kontaktit është marrë në praninë e rrethanave ekzistuese, mbi bazën e të cilave është vlerësuar se interesi ma i mirë i fëmijës është që ta ketë formë të kontakti me prindër, ndërsa nëse në të ardhmen ndryshohen rrethanat, pra vlerësohet se interesi me i mirë i të miturit është një vendim tjetër, atëherë ligji ka parapa si mundësi që gjykata sërish ta rregullojë mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të prindërve, nëse këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara.

Lidhur me vendosjen si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi

12. Gjykata Supreme ka vendosur si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pra e ka lënë të pashqyrtuar dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë, me të cilin është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë në pikat në pikat I, II, dhe VI të dispozitivit, kjo pasi që asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk ka paraqitur revizion kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, që ka vendosur për këto pika të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë.
13. Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij revizioni, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.
14. Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi kolegji civil i gjykatës supreme vendosi që të: I. Refuzohet i pa bazuar revizioni i të autorizuarit të paditësit V.Gj nga Prizreni, i paraqitur kundër

aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2283/23 i datës 06.02.2024, me të cilin është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1861/2021 i datës 07.02.2023, në pikat III, IV dhe V të dispozitivit. II. Mbetet i pashqyrtuar aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2283/23 i datës 06.02.2024, me të cilin është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1861/2021 i datës 07.02.2023, në pikat I, II dhe VI të dispozitivit.

Aktgjykim i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev.nr.262/2023, i datës 27.11.2023

”Në rastet kur kërkohet anulimi i Kontratës për shkak të të metave të vullnetit, pala që pretendon se ekzistojnë të meta në shprehjen e vullnetit me rastin e lidhjes së kontratës, duhet që me prova konkrete të vërtetojnë se cilat veprime ka ndërmarr pala e paditur që për pasojë atë e ka sjellë në lajthim apo mashtrim në lidhjen e kontratës“.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.686/18 të datës 09.10.2019, në pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve M. P. dhe S. P. që të dy nga Gj., e parashtruar kundër të paditurit Sh. P.u nga Gj.a, me të cilën kanë kërkuar që të anulohet kontrata mbi dhuratën e lidhur në mes paditësve M. P.u dhe S.e P. që të dy nga Gj. si dhuratëdhënës dhe të paditurit Sh. P. nga Gj. si dhuratëmarrës, kontratë e vërtetuar tek Noteri nën numrin punues LRP.nr..., me numër të referencës Ref.nr.... të datës 04.03.2016. Në pikën II të dispozitivit, është vendosur që të mbetet në fuqi aktvendimi mbi caktimin e masës së përkohshme të sigurisë deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi dhe në pikën III të dispozitivit është vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.
2. Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësve me aktgjykimin Ac.nr.153/20 të datës 15.03.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e paditësve M. P. dhe S. P., të dy nga Gj., ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.686/18 të datës 09.10.2019.
3. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditësve në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin si të bazuar, aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta t'i prishë, ashtu që çështjen ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

4. Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215, gjeti se: Revizioni i të autorizuarit të paditësve është i pathemeltë.
5. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit M. P. dhe S. P., janë babai dhe nëna e të paditurit Sh. P., dhe se më datë 04.03.2016 përmes kontratës së dhurimit, LRP.nr..../2016, të lidhur tek Noteri, me të cilën paditësit ja kanë dhuruar të paditurit parcelën kadastrale me nr.P-..., ZK Gj., tokë jopjellore, me sipërfaqe 570 m2 dhe njësia kadastrale nr. P-..., ZK Gj., vendi i quajtur qytet, tokë jo pjellore, me sipërfaqe 194 m2 dhe P-..., ZK Gj., qytet vendi i quajtur qytet, shfrytëzim kulture tokë jopjellore me sipërfaqe prej 174 m2.
6. Kjo kontratë ka prodhuar efekte juridike ngase prona është regjistruar në emërin e të paditurit në regjistrat e paluajtshmërisë në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë. Paditësit më datë 22.10.2018, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurit, me të cilën kanë kërkuar të anulohet kontrata për dhuratën, me pretendim se paditësit me rastin e lidhjes së kësaj kontrate ishin mashtruar dhe vënë në lajthim nga djali i tyre, përkatësisht i padituri.
7. Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.686/2018 të datës 09.10.2019, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpudinë e paditësve. Kjo gjykatë ka vlerësuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për anulimin e kontratës së dhurimit në kuptim të nenit 49 paragrafi 1 të LMD-së, pasi që nuk është vërtetuar fakti se i padituri përmes mashtrimit apo keqpërdorimit të besimit i ka mashtruar paditësit që të ia dhurojnë parcelat të cilat janë objekt i kontratës së dhurimit. Në lidhje me këtë çështje ndaj të paditurit është ngritur kallëzim penal, por Prokuroria Themelore në Gjakovë kallëzimin penal e ka hudhur, ndërsa si provë në këtë çështje janë marrë edhe shkresat e lëndës të formuar tek noteri me numër LRP.nr. ..., dhe numër të referencës ..., e cila përmban kontratën mbi dhurimin e përpiluar me datë 04.03.2016, e cila kontratë është e nënshkruar nga të gjitha palët në procedurë fletë për fletë, po ashtu me rastin e lidhjes së kësaj kontrate janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore nga ana e noterit lidhur me dokumentacionin duke filluar me letërnjoftimet e palëve nënshkruese të kontratës së bashku me nënshkrimet në letërnjoftim, dëshmitë për pronësinë e ngastrave të dhuruara, dëshmitë mjekësore

për gjendjen fizike dhe mendore të dhuratëdhënësve dhe më pas është përpiluar kontrata.

8. Gjykata e shkallës së parë ka dëgjuar edhe noterin që ka hartuar kontratën mes palëve ndërgjyqëse dhe duke ja falur besimin e plotë kësaj deklaratë dhe mbi bazën e provave të tjera ka nxjerr përfundimin se në këtë çështje duhet refuzuar kërkesëpadia e paditësve pasi që nuk janë plotësuar kushtet ligjore për anulimin e kontratës.
9. Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës të autorizuarit të paditësve, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e të autorizuarit të paditësve dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke vlerësuar se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.
10. Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pathemelësinë e kërkesëpadiës së paditësve, është i drejtë dhe i bazuar, pasi që me dispozitën e nenit 536 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve, përcaktohet se "Me kontratën për dhuratën një person (dhuratëdhënësi) merr përsipër që pa shpërblim të bartë të drejtën e pronësisë apo ndonjë të drejtë tjetër tek dhuratëmarrësi apo në ndonjë mënyrë tjetër të pasurojë dhuratëmarrësin nga llogaria e dhuratëdhënësit, si dhe dhuratëmarrësi të jep pëlqimin për një gjë të tillë". Po ashtu në nenin 97 të këtij ligji parashihet se "*Kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidhur pala me aftësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është caktuar me këtë ligj ose me dispozitë të veçantë*", ndërsa me nenin 98 paragrafi 1 parashihet se "*Pala kontraktuese, në interesin e së cilës është vërtetuar rrëzueshmëria, mund të kërkojë që kontrata të shpallet e pavlefshme*". Në bazë të provave të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, me asnjë provë nuk është provuar bazueshmëria e kërkesëpadiës së paditësve, sepse vetë paditësit kanë

dështuar në argumentimin e pretendimeve se në rastin konkret janë përmbushur kushtet ligjore për anulimin e kontratës konform dispozitave ligjore në fuqi.

11. Po ashtu edhe me dispozitat e neneve 542, 543 dhe 544 të të njëjtit ligj është paraparë mundësia e revokimit të kontratës mbi dhuratën, mirëpo në rastin konkret edhe për këtë me asnjë provë nuk është vërtetuar se janë plotësuar kushtet për revokimin e kontratës mbi dhuratën në raport me të paditurin, pasi që nuk është vërtetuar se dhuratëdhënësi ka kaluar në gjendje varfërie, pasi që gjendja e tij ka mbetur pothuajse e njëjtë dhe e pandryshuar. Po ashtu nuk është provuar as fakti se dhuratëmarrësi ka shprehur ndonjë mosmirënjohje të thellë ndaj dhuratëdhënësit, apo se dhuratëdhënësi të jetë bërë me fëmijë tjetër, pasi që edhe në momentin e lidhjes së kontratës mbi dhuratën gjendja, përkatësisht statusi familjar i dhuratëdhënësit ka qenë i njëjtë me atë të kohës kur është kërkuar zgjidhja e saj, për çka edhe gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar kërkesëpadinë e tyre si të pabazuar, të cilin qëndrim në tërësi e përkrah edhe Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë.

II. Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme

1. Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.
2. Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura nga paditësit dhe ka dhënë arsye të qarta në lidhje me çështjet e ngritura që kanë të bëjnë me shkeljen esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe me zbatimin e gabuar të dispozitave materiale.
3. Gjykata e shkallës së dytë me arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar me revizion ka përmbushur kërkesat ligjore nga neni 204 të LPK-së, si në pikëpamje të kufijve të

shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe në aspektin e dhënies së arsyeve për të gjitha çështjet e ngritura në ankesë.

4. Paditësit në revizionin e paraqitur pretendojnë se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelle thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së. Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e tilla janë të pa bazuara, kjo pasi që gjykatat e instancave më të ulëta në procedurën gjyqësore të zhvilluar në këtë çështje kanë garantuar objektivitetin e procesit gjyqësor, barazinë e palëve në proces dhe ligjshmërinë e vendimmarrjes përmes vlerësimit të kërkesave ligjore si në aspektin procedural por edhe në aspektin e zbatimit të drejtës materiale. Aktgjykimet e atakuara me revizion janë mjaft të qarta, të rregullta në strukturë dhe përmbajtje. Gjykata e shkallës së dytë ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimet të shkallës së dytë.
5. Mbi gjendjen faktike të konstatuar, Gjykata Supreme vlerëson se e drejta materiale në këtë çështje juridike kontestuese është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, kjo pasi që nga faktet e paraqitura rezulton se paditësit me të paditurin kanë lidhur kontratë për dhuratën tek zyra e Noterit, me të cilën kontratë i janë dhuruar të paditurit paluajtshmëritë e caktuara. Paditësit gjatë gjithë procesit gjyqësor kanë pretenduar se i padituri i ka mashtruar ata dhe i ka sjell në lajthim ngase nuk kanë qenë në dijeni se janë duke lidhur kontratë për dhuratën. Duke pretenduar se të njëjtit janë mashtruar dhe janë vënë në lajthim kanë kërkuar anulimin e kësaj kontrate.
6. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve me nenin 46, paragrafi 1 ka përcaktuar se: “Lajthimi është thelbësor, në qoftë se ka të bëjë me elementet thelbësore të objektit, me personin me të cilin lidhet kontrata, në qoftë se lidhet duke marrë parasyshë këtë person, si dhe me rrethanat të cilat sipas dokeve që praktikohen ose sipas qëllimit të palëve, konsiderohen vendimtare, ndërsa pala që është në lajthim nuk do ta lidhte përndryshe kontratën me përmbajtje të tillë” ndërsa me nenin 49, paragrafi 1 të këtij ligji është përcaktuar se: “Në qoftë se njëra palë shkakton lajthim te pala tjetër, ose mban në

lajthim me qëllim që me këtë ta shtyj për lidhjen e kontratës, pala tjetër mund të kërkojë të shpallet e pavlefshme kontrata edhe atëherë kur lajthimi nuk është thelbësor”.

7. Dispozitat e tilla ligjore përcaktojnë bazën kur mund të vjen në shprehje lajthimi dhe mashtrimi si e metë në shprehjen e vullnetit nga palët kontraktuese, ndërsa pala që ka interes në raportin kontraktues duhet që me prova konkrete të vërtetojë se në lidhjen e kontratës ka pasur të meta në shprehjen e vullnetit, përkatësisht ka pasur lajthim apo mashtrim. Pastaj me nenin 97 të po këtij ligji është përcaktuar se: “Kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidhur pala me aftësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është caktuar me këtë ligj ose me dispozitë të veçantë”. Mbi bazën e tillë ligjore, pala që pretendon se ekzistojnë të meta në shprehjen e vullnetit në lidhjen e kontratës, siç është pretenduar nga paditësit në këtë rast, duhet që me prova konkrete të vërtetojnë se cilat veprime ka ndërmarr pala e paditur që për pasojë ata i ka sjellë në lajthim apo mashtrim në lidhjen e kontratës.
8. Nga provat e administruara në këtë proces nuk është arritur të vërtetohet se paditësit me rastin e lidhjes së kontratës të jenë vënë në lajthim apo mashtrim, kjo pasi që kontrata është hartuar nga Noteri, pasi që paraprakisht është siguruar raporti mjekësor që ka treguar për gjendjen shëndetësore, fizike dhe psikike të dhuratëdhënësve - paditësve, provat tjera për pronësinë dhe pasi që palët janë vënë në dijeni rreth kontratës ajo është hartuar dhe më pas u është dhënë mundësia për ta lexuar, ku edhe të njëjtën e kanë nënshkruar. Se procesi i përpilimit të kontratës dhe nënshkrimit nuk ka pasur të meta, gjykata e shkallës së parë këtë e ka vërtetuar përmes dosjes së siguruar nga Noteri dhe dëgjimit të tij në cilësi të dëshmitarit, përfshirë edhe ballafaqimin me dëshmitarë të tjerë.
9. Pra i gjithë procesi gjyqësor në shkallë të parë ka qenë i orientuar në drejtim të vërtetimit të fakteve që kanë të bëjnë me ekzistimin apo jo të metave në vullnetin e shprehur të palëve kontraktuese dhe nga provat e siguruar nga palët nuk është arritur të vërtetohet se pala e paditur në ndonjë mënyrë ti ketë vënë paditësit në lajthim apo mashtrim për lidhjen e kontratës, por që paditësit të vetëdijsëm për veprimet e ndërmarra kanë nënshkruar kontratën për dhuratën, e cila njëherit edhe ka krijuar pasoja juridike mes palëve.

10. Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast procesi kontestimor ka filluar dhe gjatë gjithë rrjedhës së tij i autorizuari i paditësve ka kërkuar anulimin e kontratës për shkak të metave në vullnetin e shprehur nga paditësit, andaj edhe në këtë mënyrë procesi është mbyllë me vlerësimet e kësaj gjykate se nuk është vërtetuar baza ligjore për anulimin e kontratës së dhuratës, ashtu siç është pretenduar nga paditësit në këtë çështje dhe ashtu siç është përcaktuar me nenet 46, 49 dhe 97 të LMD-së.

11. Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

12. Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos që të: Refuzohet i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditësve M.P dhe S.P që të dy nga Gjakova, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.153/20 të datës 15.03.2023.

Gjykata Supreme e Kosovës Pallati i Drejtësisë – Lagjja "Prishtina e Re", Prishtinë

TI: +383 (0) 38/200 18775

TI: +383 (0) 38/200 18779

Email: gjykatasupreme@rks-gov-net



Gjykata Supreme e Kosovës Pallati i Drejtësisë – Lagjja "Prishtina e Re"

Prishtinë

T1: +383 (0) 38/200 18775

T1: +383 (0) 38/200 18779

Email: gjykatasupreme@rks-gov-net